



INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E HABITATIT
Seria e Botimeve Profesionale



PLANIFIKIMI URBAN

Editor: **Besnik ALIAJ**

Volumi 2
PLANIFIKIMI RREGULLUES

Për studentët dhe
specialistët e
ARKITEKTURËS dhe
URBANISTIKËS

TIRANË 2003



711

ALI

Planifikimi Urban

Volumi 2: Planifikimi Rregullues

(Per studentet dhe specialistet e arkitektures dhe urbanistikes)

Editor: **Besnik Aliaj**

Seria e Publikimeve te:

Co-PLAN,
Instituti per Zhvillimin e Habitatit

Tirane, 2003



540-299

Planifikimi Urban

Volumi 2: Planifikimi Rregullues

Per studentet dhe specialistet e arkitektues dhe urbanistikes

Seria e Publikimeve te:



Instituti per Zhvillimin e Habitatit

Rr. Dervish Hima, Kulla Ada, Ap.4, KP 2995 Tirana Albania

Tel: +355.(0)4.257808/9; Fax: +355.(0)4.257807

Cel: +355.(0)68.20.34126/32957

E-mail: co-plan@co-plan.org

Internet: www.co-plan.org

Editor:

Ark. Urb. **Besnik Aliaj**

Master ne Manaxhim Urban

Copyright ©: Co-PLAN, Institute for Habitat Development
Tirane, 2002

Shenim

Botimi "Planifikimi Urban" eshte nje perpjekje per te siguruar nje baze informacioni profesional per studentet dhe specialistet e arkitektures dhe urbanistikes, vecanerisht ne Shqiperi, por edhe me gjere ne vendet fqinje ku flitet shqip. Kjo perpjekje merr me shume kuptim po te kihet parasysh mungesa e botimeve ne kete fushe sidomos per shkak te izolimit disavjecar te Shqiperise gjate gjysmes se dyte te shekullit te 20te.

Volumi i pare i botuar ne fillim te vitit 2003 fokusohet ne panoramen e pergjithshme mbi planifikimin urban, dhe ne menyre te vecante mbi planifikimin e veprimit. Ky volum u konceptua dhe editua nga Besnik Aliaj, dhe u publikua nga Co-PLAN, Instituti per Zhvillimin e Habitatit permes financimit te Cordaid (Holande). Permbajtja e volumit u pasurua me tej nga kontributi i vecante i Projektit EGUG (Mundesimi i nje Qeverisje te Mire Urbane ne Shqiperi) financuar nga Qeveria Holandeze dhe zbatuar nga Co-PLAN, me asistencen e IHS, Instituti per Studime te Strehimit dhe Zhvillimit Urban (Rotterdam, Holande). Nje falenderim i vecanate shkon per koordinatoret e projektit Dritan Shutina, Artan Karini dhe Andre Herzog, te cilet mundesuan perdorimin e materialit.

Nderkohe volumi i dyte qe merrni ne dore fokusohet ne konceptin e planifikimit rregullues dhe eshte hartuar dhe edituar perseri nga Besnik Aliaj. Edhe kete rradhe publikimi eshte realizuar nga Co-PLAN me financimin e Cordaid (Holande). Ne kete volum i eshte dhene perparesi experiences Angleze te planifikimit rregullues si nje rast tipik, perfshi legjislacionin e saj perkates ne kete fushe. Editori falenderon ne menyre te vecante ndihmen e Criss Berry (Angli) nje ekspert i jashtem i Co-PLAN/IHS, i cili siguroi materialet e nevojshme per volumin e dyte. Sidoqofte, duhet theksuar se ekperienca ligjore e planifikimit rregullues ne Angli nuk eshte automatikisht me e mira ne pergjithesi, dhe ne menyre specifike per Shqiperine. Ajo eshte perzgjedhur per shkak se bazohet ne llogjiken e urbanizimit te shpejte, gje qe perben nje sfide aktuale edhe per urbanistiken Shqiptare. Nuk duhet harruar se per vete Angline, ky legjislacion nuk eshte i pandryshueshem, dhe aktualisht eshte vete ne proces permiresimi dhe evolimi. Sidoqofte, kjo perben nje pike interesante referimi per profesionistet Shqiptare te planifikimit.

Duke shpresuar qe te dyja volumet (te cilat do te pasohen se afermi nga volume te tjere) do te ndihmojne sadopak konsolidimin e planifikimit urban ne Shqiperi, urojme lexim te mbare.

Co-PLAN,
Instituti per Zhvillimin e Habitatit.

Permbajtja

	Faqja		
1. Orientime te EU-se per Planifikimin Urban	1	x. Zhvendosja e mineraleve	115
a. Parathenie	1	y. Telekomunikacioni	117
b. Parime te pergjithshme	5	z. Ndertesarat historike dhe monumentet	125
c. Aspekte Pozitive	6	aa.Argetimi	126
d. Permiresime te mundshme	6	bb. Parqet	127
e. Rekomandime per permiresim	8	cc.Sisitemet e njoftimit te shoferave	128
2. Planifikimi rregullues dhe kontrolli i zhvillimit	11	dd. Mbledhja e taksave te rrugeve	129
3. Planifikimi dhe instrumentat rregullues/imponues	20	ee.Shembia e ndertimeve	131
a. Perdorimi i klasave	21	ff. Shkollat, kolegjet, universitetet dhe spitalet	134
b. Spjegime plotesuese	27	5. Akti mbi planifikimin ne qytete/fshatra – Angli/Uells/Skoci	139
4. Planifikimi dhe zhvillimet urbanistike me leje	31	a. Autoritetet planifikuese	139
a. Parathenie	33	b. Planet per zhvillim,	145
b. Zhvillimet e lejuara	37	i. Vleresimet dhe studimet	146
c. Kufizimi i zhvillimeve te lejuara	40	ii. Hartimi/adoptimi i planeve te njesuara	146
d. Transparanca publike	44	iii. Kompetencat e autoritetit qendror	151
e. Toka	48	iv. Ndryshimi planeve	154
f. Ndertimi i nje banese brenda parceles	49	v. Planet e perbashketa/integruara	157
g. Punimet e vogla	54	c. Zonat metropolitane	145
h. Ndryshimet e funksionit	55	i. Planet e strukturave	164
i. Ndertimet e perkoheshme	58	ii. Planet lokale	170
j. Parkimet dhe karvanet	60	iii. Konformiteti midis planeve	178
k. Ndertimet publike	60	d. Kontrolli mbi zhvillimet	188
l. Ndertime ne pyje	69	i. Kerkesat per leje planifikimi	191
m. Ndertime industriale dhe magazinat	72	ii. Lejet e ndertimit	192
n. Riparimi rrugeve dhe rruget private	74	iii. Publikimi i aplikimit	196
o. Riparime te sherbimeve publike	74	iv. Vendimi per aplikimet	203
p. Zhvillime te autoriteteve lokale	77	v. Lejet e dhena te planifikimit	218
q. Zhvillime te autostradave dhe drenazhimeve	78	vi. Kohezgjatja e lejes se planifikimit	219
r. Zhvillime perreth lumejve	79	vii. Revokimi dhe adoptimi i lejes se planifikimit	224
s. Zhvillime te kanalizimve te zeza	80	viii. Hetimi i planeve	228
t. Siper marrjet ligjore	82	e. Kompensimet	234
u. Zhvillime per qellime aviacioni	92	i. E drejta e pronesise dhe blerja e interesit	263
v. Zhvillimet prane minierave	102	ii. Shpronesimet ne toka bujqesore	272
w. Depozitimi i mbeturinave ne miniere	110	iii. Perfaqesimi, partneriteti dhe hipoteka	288
		f. Zbatimi	290
		g. Pemet	310
		h. Reklammat	338
		i. Blerje dhe marrje me qira te tokes	343
		j. Autostradat	360
		k. Siper marrja e autorizuar	374
		l. Komplikime financiare	417
		m. Seancat e shqyrtimit lokal dhe hetime te tjera	428
		n. E drejta e hyrjes ne parcelen private	430

6. Anekse te aktit mbi planifikimin	448
a. Funksionet lokale te planifikimit	448
b. Planet e ndertimit	462
c. Zhvillimet qe nuk konsiderohen te reja	479
d. Kushte per perdorimin e tokes	483
e. Kushte mbi perdorimin e mineraleve	484
f. Apelime te vecanta	490
g. Zonat me lehtesime planifikimi	496
h. Komisionet e shqyrtimit te planifikimit	506
i. Kerkesa per nderprerje punimesh ne miniera	511
j. Kushtet per rindertime	519
k. Kompesimi per perpunimin e mineraleve	520
l. Demtimi i tokave	525
m. Procedurat per rrugicat/rruget e pasfaltuara	534
n. Aplikimi dhe apelimi	540
o. Vlera e zhvillimit	546

PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT HAPESINOR EUROPIAN¹ (P.ZH.H.E.)

*Komente dhe rekomandime nga Forumi Keshillimor
Euopian per Mjedisin dhe Zhvillimin e Qendrueshem*

Janar 1999

Parathenie

Forumit Keshillimor Euopian per Mjedisin dhe Zhvillimin e Qendrueshem eshte formuar si njesi keshillimore me Vendim Komisioni ne vitin 1997 (97/150/EC) ne kuadrin e Programit te Peste te Veprimit "Drejt Qendrueshmerise". Qellimi i njesise eshte te keshilloje Komisionin mbi politikat e zhvillimit dhe te krijojte nje ure lidhje me sektore te ndryshem te shoqerise Europiane. Anetaret e saj caktohen nga Komisioni mbi bazen e meritave personale dhe duke marre parasysh sugjerimet e grupeve te interesuara Europiane. Ne marrjen e vendimeve perfaqesohen ne menyre te balancuar organizatat jo-qeveritare (OJQ), industria, biznesi, konsumatorët, autoritetet lokale dhe rajonale, unionet, shkencat dhe te tjere te interesuar.

Nder te tjera, Forumi ka organizuar nje Grup Pune per Ceshtjet Urbane dhe Hapesinore, pasi beson se ekzistojne lidhje te forta ndermjet zhvillimit urban dhe organizimit hapesor me zhvillimin qendrueshem, si dhe me ambjentin, konsumin e energjise, levizjen e popullsisë, shendetin dhe cilesine e jeteses. Gjithashtu, zhvillimi urban dhe hapesor merret me ceshtje qe trajtohen nga grupe te ndryshme pune te Forumit Keshillimor, si per shembull bujqesia, zgjerimi, integrimi, ndryshimet globale te klimes, shendetesia, dhe cilesia e jeteses.

Detyra e pare e Grupit te Punes ishte analizimi dhe vleresimi i versionit fillestar te dokumentit "Perspektivat e Zhvillimit Hapesinor Euopian" (P.ZH.H.E). Anetaret e Grupit te Punes moren pjese ne seminare nderkombetare te organizuara me 1998 per te diskutuar aspekte te ndryshme te ketij dokumenti. Eshte marre parasysh se P.ZH.H.E ka lidhje me nje numer inisiativash Europiane dhe globale, sic jane:

¹ Shqiperimi i ketij materiali nga anglishtja u be nga Kleva Gruda dhe Besnik Aliaj. Per me shume informacion mund te kontaktoni: The European Consultative Forum on Environment and Sustainable Development, Secretariat: European Commission DG.XI Rue de la Loi 200, B-1046 Bruxelles, Belgium Office BU-5 4/101; Telephone: +32.2.299.58.73; Fax: +32.2.299.08.95; E-mail: forum@dg11.cec.be; Internet: www.europa.eu.int/en/comm/dg11/dg11home.html

- “Eurocities” – Euroqytetet (nje rrjet i krijuar prej 81 qyteteve me te medha nga 25 vende te Europes);
- Keshilli Nderkombetar per Inisiativat Lokale Mjedisore;
- Agjenda Lokale 21;
- Programi i Komunitetit European mbi Politikat dhe Veprimet ne lidhje me Mjedisin dhe Zhvillimin e Qendrueshem (Programi i Peste i Veprimeve Mjedisore);
- Grupi i Eksperteve i Komisionit European mbi Mjedisin Urban;
- Direktiva e Komisionit European mbi mbrojtjen e mjedisit (Natyra 2000);
- Komunikimi nga Komisioni mbi Zhvillimin e Qendrueshem Urban ne Bashkimin Euopian: nje Baze per te Vepruar (COM 605);
- Lidhjet (rrjetet) Nder-europiane;
- Inisiativa “Habitati II”.

Vleresimi i pare i P.ZH.H.E u diskutua ne nje Sesion Plenar te Forumit Keshillimor me 14 Tetor 1998 ne Kopenhagen dhe komentet e rekomandimet u aprovuan nga Forumi me 27 Janar 1999 ne Bruksel. Shpresojme qe keto komente dhe rekomandime te jene nje kontribut i vleshem per nje inisiative Europiane kaq te rendesishme.

Jens Kampmann

Kryetar
Forumit Keshillimor Euopian per
Ambjentin dhe Zhvillimin e
Qendrueshem

Permbledhje

Parime te pergjithshme mbi zhvillimin hapasinor:

- Respektimi i qellimeve te qendrueshmerise gjate marrjes se vendimeve qe ndikojne ne ndryshime hapasinore.
- Nevoja e Vleresimit te Ndikimit Strategjik te ketyre vendimeve.
- Balancimi i kohezionit social dhe qendrueshmerise me tregjet dhe konkurrencen me anen e zhvillimit hapasinor.
- Ruajtja e ndryshueshmerise se pasur territoriale te Europes.
- Respektimi i ekuilibrit ekologjik ndermjet sistemeve natyrore dhe antropike.
- Kontributi i planifikimit hapasinor mbi ndryshimet e klimes lokale dhe asaj globale.

Aspekte pozitive te P.ZH.H.E.

- Per te paren here jane integruar konsideratat e gjithe kontinentit European.
- Perdorimi i kuadrit te zhvillimit hapasinor per te kordinuar nje game te gjere te politikave.
- Planifikimi eshte proaktiv dhe me perfshirje ndersektoriale.

Permireshime te Mundshme:

Probleme sociale dhe kulturore:

- Duhet te merren parasysh konfliktet qe ekzistojne ndermjet qellimeve qe kane konkurrenca dhe kohezioni social.
- Duhet vene me shume theksi ne aspektet sociale dhe ndikimet e tyre hapasinore, vecanarisht ne sistemet urbane.
- Duhet te merren parasysh pabarazite qe ekzistojen ndermjet B.E. – se dhe rajoneve fqinje ne Lindje dhe Jug.
- Ruajtja e ndryshueshmerise se perdorimit te tokes ne Europe, dhe shmangja e homogjenizimit te teritoreve te saj.

Probleme te Mjedisit:

- Kercenimi i fragmentizimit te territorit te Europes nga rrjetet e transporteve.
- Konfuzione te mundshme qe krijohen ne “zhvillimin e qendrueshem” te trashegimise natyrore dhe kulturore, qe eshte nje pasuri Europiane qe duhet ruajtur dhe zgjeruar.
- Mbrojtja e ndryshueshmerise biologjike jo vetem nepermjet “rrjetit ekologjik”, por nepermjet nje menaxhimi te integruar te te gjithe teritorit.
- Menaxhimi i qendrueshem i qarkullimit te ujit.
- Perfshirje me e madhe e problemeve te shendetit dhe cilesise se ujit.

- Kontributi me ane te politikave planifikuese ne perpjekjet per ndryshimin e klimes lokale dhe globale.

Rekomandime per zbatimin e P.ZH.H.E:

- Duhet vene theksi me shume ne formulimin e politikave te qarta dhe te guximshme.
- Ndergjegjesim me i madh i vendimmarresve, planifikuesve dhe publikut te gjere per iniciativen P.ZH.H.E, nepermjet trainimeve dhe fushatave te ndryshme.
- Eshte e nevojshme nje rishikim i dokumentit per te qartesuar afatet dhe per te theksuar me tej mesazhin e tij.
- Hartimi i rregullores per Perdorimin e Treguesve te Qendrueshmerise dhe Vleresimit Strategjik Mjedisor.
- Forcimi i rolit te Rrjetit te Observimit ne kordinimin e procesit.

Konkluzion:

P.ZH.H.E, eshte nje initiative Europiane mjaft pozitive, qe duhet te mbeshtetet dhe te permiresohet me tej, me anen e nje procesi konsultimi ne nivele te ndryshme.

1. Parime te Pergjithshme mbi Zhvillimin Hapesinor

Forumi Keshillimor i konsideron parimet e meposhtme si baze per te gjitha nismat qe lidhen me zhvillimin hapesinor ne Europe ne kuadrin e qendrueshmerise, duke respektuar ne te njejten kohe parimin e marrjes se masave paraprake:

- Politikat dhe vendimet qe ndikojne ne zhvillimin hapesinor, vecanarisht ato ekonomike, qe prekin kryesisht fushat e bujqesise, vendosjes se popullsise, transportit, energjitikes, turizmit, dhe industrise, nuk duhet te kene ndikim negativ ne zhvillimin e qendrueshem dhe objektivat e tij.
- Per te arritur sa me siper, dhe perpara se te merren vendime qe sjellin ndryshime hapesinore, eshte e nevojshme te behet nje Vleresim Strategjik i Mjedisit per te pare ndikimet ekologjike afat gjata dhe per te monitoruar me ane te treguesve perkates ndryshimet ekologjike. Instrumenti qe perdoret tani per tani per Vleresimin e Ndikimeve mbi Mjedisin nuk eshte i mjaftueshem per te siguruar mbrojtjen e duhur dhe shpesh abuzohet me te.
- Parimet me siper kane rendesi themelore ne rastet e vendimeve politike qe mund te cojne ne katastrofa sic jane thatesirat, permbytjet, rreshqitjet e tokes dhe erozioni, si dhe ndotja e tokes se punueshme, ujit dhe atmosferes.
- Planifikimi hapesinor duhet te gjejë balancen ne mes te objektiveve te kohezionit social dhe qendrueshmerise, dhe te nevojave te konkurences se lire dhe kerkesave te tregjeve, bazuar ne interesat e publikut.
- Me rendesi themelore eshte ruajtja e ndryshueshmerise se pasur te Europes, ku perfshihen aspekte gjeomorfologjike, biologjike, kulturore dhe sociale, pejzazhet, dhe perdorimi i tokes. Duhet te shmangen me kujdes perpjekje pa vend per "harmonizim" dhe homogjenizim. Ne fakt, ndryshueshmeria e pejsazheve, kontribuon ne ndryshueshmeri ekologjike, vecanarisht ne ndryshueshmeri biologjike.
- Arritja e ekuilibrit ekologjik kerkon qe te merret parasysh balanca ne mes sistemeve komplekse natyrore dhe antropike, duke shmangur veprimet e njeaneshme.
- Meqe menyra e perdorimit te tokes mund te kete pasoja te demshme ne klimen, duhet qe planifikimi hapesinor te perdoret si mjet efektiv per te luftuar ndryshimet lokale dhe globale te klimes.

2. Aspekte pozitive te P.Zh.H.E.

Dokumenti Perspektivat e Zhvillimit Hapesinor Europian (P.Zh.H.E.), versioni i pare i te cilit u aprovua ne qershor te vitit 1997 nga ministri e planifikimit hapesinor te B.E.-se ne Noordwijk te Hollandes, eshte rezultat i 4 viteve pune intensive te vendeve anetare dhe Komisionit (kryesisht DG XVI) qe nga viti 1993. Bisedime te veshtira u mbajten ne kuadrin e shume presidencave te B.E., dhe gradualisht (nganjehere me mjaft veshtiresi) u arrit nje nivel i pranueshem konsensusi. Nga ky proces shpjegohen anet pozitive dhe negative te ketij dokumenti. Ne cdo rast, mangesite e P.Zh.H.E. nuk e zbehin rendesine e tij historike si nisma e pare zyrtare qe konsideron territorin e Europes ne teresi dhe qe planifikon te ardhmen me nje fryme bashkepunimi dhe kohezioni.

Prandaj objektivat e P.Zh.H.E. jane te gjera dhe fisnike. Ato mund te permbledhen ne qellimin per te perdorur kuadrin hapesinor per kordinimin e nje numri te madh politikash per kontinentin, te cilat ndikojne ne kushtet dhe perdorimin e territorit Europian. Ne kete kuptim, P.Zh.H.E. hap shtigje te reja ne menytrat e perdorura per integrimin dhe perfshirjen nder-sektoriale si dhe per stilin proaktiv. P.Zh.H.E. eshte ne kontrast te dukshem me menytrat e planifikimit tradicional, akoma ne perdorim ne disa zona te Europes, qe eshte kryesisht reaguese dhe rregulluese, dhe qe shikon dimensionet hapesinore vetem nga ana fizike dhe teknike. Prandaj kjo inisiativ e duhet te mbeshtetet fuqimisht per nje te ardhme me te mire per Europen dhe popullsine e saj.

3. Permireshime te Mundshme

Dokumenti ka dobesi qe duhet te ndreqen gjate procesit aktual te debateve dhe permireshimeve.

Ndoshta dobesia kryesore eshte mungesa e perpjekjeve te mjaftueshme per te reduktuar tensionin qe ekziston ne mes konkurrences dhe kohezionit. Kerkesat qe parashtrrojne globalizimi dhe tregu i lire duket se bien ne konflikt me deshiren per nje ekuilibër me te madh social dhe territorial. Rritja ekonomike mund te mos jete ne harmoni me qendrueshmerine, te pakten ne periudhen afat shkurter. P. Zh. H. E. edhe pse e njeh ne detaje rendesine e problemeve sociale ne Europe dhe pabarazine ne kushte dhe mundesi qe ekziston ne rajone te ndryshme te Europes, ne kapitullin e politikave nuk perfshin nisma te qarta dhe decisive per keto probleme, ndoshta per shkak te mosmarreshjeve ndermjet Shteteve Anetare. Si rrjedhim problemeve sociale ne Europe (pabarazite, papunesia, migracioni ekonomik, menjanimet sociale, etj.) dhe dimensioneve te tyre hapesinore nuk u eshte dhene rendesia e duhur.

Ceshtjet sociale kane rendesi te vecante ne zonat urbane ku banon dhe punon shumica e popullsise Europiane. Organizimi urban, menaxhimi i energjise, planifikimi i transportit urban, levizshmeria, zhurmat, mbeturinat dhe menaxhimi i ndotjes, rigjenerimi urban, rrjetet ekologjike urbane, telamatika, koordinimi i politikave sektoriale, solidariteti dhe integrimi social jane te gjitha aspekte te qendrueshmerise qe duhet te perfshihen ne menyre konsistente, per te arritur nje cilesi me te larte jetese per qytetaret.

Keto probleme theksohen kur merren parasysh pjeset periferike te B.E. apo vendet fqinje. Europa nuk eshte dhe nuk mund te konsiderohet si ishull. Pabarazite qe ekzistojne me shtetet me pak te begate te B.E. dhe me shume vende rreth e rrotull (sic jane ato te Mesdheut Jugor e Lindor dhe Europes Lindore) jane teper te medha dhe vazhdimisht ne rritje. Problemet ekonomike dhe sociale ne keto vende kane ndikim ne rritje ne B.E., kryesisht nepermjet fluksit te pakontrolluar te popullsise me rrjedhime te dukshme hapesinore.

Ne pjesen analitike te P.Zh.H.E. njihet ndryshueshmeria e territorit Europian dhe theksohet nevoja e ruajtjes se saj, me anen e planifikimit te zgjidhjeve te bazuara ne vecantite lokale. Megjithate, ne kapitullin e politikave perfshihen nje sere qellimesh qe sabotojne kete ndryshueshmeri, sic jane rritja e aksesit, shperndarje me e barabarte e aktiviteteve ekonomike, rritja e stimuljve per zhvillim. Do ishte me e udhes te merreshin parasysh karakteristikat e cdo rajoni dhe te perqendrohej ne epersite perkatese. Ne kete menyre, mozaiku i qendrave urbane te populluara dendur, zonave rurale me aktivitet ekonomik te kufizuar, dhe zonave natyrore me nderhyrje minimale, do ti ofroje qytetareve te Europes zgjedhje me te shumta dhe te qendrueshme.

Persa i perket mjedisit, kjo menyre do te linte te paprekuara zona me te medha ne kontinent, i cili tashme po copetohet me nje shpejtesi te papare nga zgjerimi i vazhdueshem i rrjeteve te transportit. Ne kete kuader eshte pa vend politika qe ka per qellim lidhjen e te gjitha rrjeteve te transportit lokal me ato nderkombetare.

P.Zh.H.E. thekson nevojën e ruajtjes se ndryshueshmerise biologjike dhe pasurive kulturore te Europes nepermjet "menaxhimit te kujdesshem dhe zhvillimit te trashegimise natyrore dhe kulturore". Propozohet krijimi i nje "rrjeti ekologjik" sic eshte realizuar nga "Natyra 2000". Dy verejtje ne kete pike:

- Trashegimia natyrore dhe kulturore ka padyshim vlere ekonomike, sic vertetohet nga numri i vizitoreve ne disa qytete historike Europiane apo ne parqet natyrore te pakta; dhe kjo perben nje avantazh ekonomik ne shkalle globale qe duhet ruajtur me cdo kusht. Megjithate, te flasesh per "zhvillim te saj" (edhe pse nje zhvillim i qendrueshem) mund te kaloje ne teprim.

- Ndryshueshmeria biologjike e kontinentit nuk mund te sigurohet vetem nepermjet krijimit te nje rrjeti ekologjik te zonave te mbrojtura, sepse natyra bazohet ne vazhdimesi. Nje shembull tipik eshte kercentimi i ndotjes se Parkut Nacional Donana. Se bashku me parimin e qendrueshmerise, duhet realizuar menaxhimi i integruar i gjithe territorit dhe i aktiviteve njerezore ne te.

Per sa i perket menaxhimit te ujit duhet te merren parasysh ruajtja e ciklit ujor, shperndarja se ujit per ruajtjen e ekosistemeve, problemet ekologjike nga transferimi i ujit, ndikimet negative mbi mjedisin te punimeve inxhinierike per menaxhimin e ujrave, si dhe thatesirat dhe permbytjet.

Rendesi e madhe duhet tu jepet problemeve te shendetit dhe te cilesise se jeteses, te cilat duhet te perfshihen ne te gjitha politikat dhe nderhyrjet hapasinore qe parashikohen ne P.Zh.H.E.

Gjithashtu, vemendje duhet t'i kushtohet ne P.Zh.H.E., planifikimit territorial per zvogelimin e shkarkimeve te gazrave ne atmosfere (sic eshte nje organizim me i mire i aktiviteve ne hapesine per te reduktuar nevojen e levizjeve) ne kuadrin e perpjekjeve per te kontrolluar ndryshimin e klimes globale. Duhet te inkurajohen perpjekjet per te zvogeluar udhetime duke sjelle me afer banesat dhe qendrat e punes, duke permiresuar cilesine e jeteses ne qytete, duke u mbeshtetur ne teknologji te reja, si dhe duke zhvilluar shprehi te reja te prodhimit dhe konsumimit.

4. Rekomandime per Zbatimin dhe Zhvillimin e P.Zh.H.E

Duke pasur parasysh rendesine e dimensionit hapasinor ne procesin e arritjes se nje zhvillimi te qendrueshem, Forumi konkludon se P. Zh. H. E duhet te zhvillohet me tej. Duhet te ndryshoje theksi nga analizat dhe perqendrimi i drojtur ne objektivat, ne krijimin e nji grupi politikash kurajoze, te qarta dhe orientuese per kontinentin e Europes dhe rajonet fqinje. Kjo do ti kaperceje kufizimet qe u vendosen ne Leipzig me 1994, per nje stil udhezues e jo pershkruar.

Hartimi i formulimeve me te qarta dhe te drejtperdrejta do te bente qe P.Zh.H.E te kuptohet dhe te pranohet nga nje publik me i gjere. Tani per tani, kjo nisme e rendesishme Europiane njihet vetem nga nje qark i kufizuar nepunesish te Komisionit European dhe qeverise, si dhe nga disa eksperte te perfshire ne proces. Shume shpejt, duhet te njihet dhe te kuptohet nga tre grupe kryesore: vendim-marresit, profesionalistet e perfshire ne proceset e planifikimit, dhe nga publiku i gjere European. Kjo detyre duket mjaft direkte per grupin e pare, dhe shume me e veshtire per t'u realizuar me dy grupet e tjera. Sugjerohet qe per

profesionistet, te perfshihen ne programet mesimore universitare kurse perkatese trainimi, ndersa per te punesuarit keto kurse te zhvillohen nepermjet organizatave te ndryshme profesionale. Gjithashtu, te inkurajohen shkembime shkencore per kete ceshtje midis vendeve te ndryshme ne Europe me mbeshtetjen financiare te B.E., dhe rezultatet te merren parasysh seriozisht gjate marrjes se vendimeve. Per sa i perket ndergjegjesimit te publikut nje rol te rendesishem mund te luajne organizatat jo qeveritare.

Procese te tilla trajnimi dhe ndergjegjesimi kerkojne pune sistematike, mbeshtetje te mjaftueshme, dhe duhet te zbatohen njekohesisht ne nivelet kombetare, rajonale dhe lokale. Gjithashtu keto procese kerkojne nje rishikim te versionit aktual te P.Zh.H.E. ne menyre qe:

- Te qartesohen termat e perdorura per te shmangur konfuzionin (vecanarisht ne perkthime);
- Te qartesohen formulimet per t'u asimiluar me lehte nga publiku i gjere.
- Te perfshihen shembuj dhe raste konkrete per t'i bere qellimet e politikave me konkrete dhe me pak te ngaterruara.

Gjithashtu, duhet te theksohet se sukcesi i kesaj nisme varet nga informacioni i mjaftueshem, bashkekohor, dhe do kufizohet dukshem ne qofte se nuk ekzistojne harta te sakta, duke perfshire perdorimin e tokave bujqesore, si dhe materiale nga Sisteme te Informacionit Gjeografik (GIS), informacioni ekzistues mbi cilesine e ambjentit dhe prodhimshmerine e funksionimin e burimeve natyrore.

Per kete qellim, eshte urgjente te azhurnohet informacioni mbi perdorimin e tokave bujqesore. Ky informacion eshte kthyer ne nje injstrument me vlere per planifikimin, Vleresimin Strategjik te Mjedisit, monitorimin e ndryshimeve dhe per prodhimin e treguesve territorial. Shumica e hartave aktuale bazohen ne fotografite satelitore te marra me 1990, keshtu qe duhet te azhurnohen te pakten nga viti 2000 dhe t'i shperndahen te gjithe perdoruesve te mundshem.

Gjithashtu, gjate rishikimit te P.Zh.H.E duhet te perfshihen er te gjithe vendimet kryesore, perdorimi i Treguesve te Qendrueshmerise dhe Vleresimi Strategjik i Mjedisit.

P.Zh.H.E duhet te kuptohet si proces afat gjate brenda Bashkimit European, qe do te zhvillohet dhe maturohet ne vitet qe vijne. Gjate ketij procesi Rrjeti European i Observimit te Planifikimit Hapesinor (Rr.E.O.P.H) mund te perbeje nje strukture te dobishme, jo vetem ne sigurimin e te dhenave te besueshme (sic eshte propozuar), sigurisht ne bashkepunim me Agjensine Europiane te Mjedisit dhe Zyren Statistikore te Europes, por edhe per kordinimin e ketij procesi dhe perhapjen e informacionit te duhur.

PLANIFIKIMI RREGULLUES DHE KONTROLLI I ZHVILLIMIT¹

Ne kete kapitull do te pershkruajme ndermjet te tjerash hartimin e rregulloreve dhe sistemit te kontrollit te zhvillimit, fillimisht duke u bazuar ne praktiken angleze, dhe me pas duke marre parasysh edhe pervojat ne vende te tjera – pra aty ku jane shfaqur apo shfaqen presione te nje urbanizimi te shpejte dhe zgjerim te c'rregullt te zonave urbane.

Nje presion i tille vjen per shkak se njerezit qe banojne ne zonat rurale shohin ne zonat urbane me shume shanse, duke marre me pas vendimin e rendesishem per t'u shperngulur kur atyre ju lejohet kjo gje. Kjo perben shpesh nje vendim te guximshem, mbushur me pasiguri. Sidoqofte, zonat urbane nuk jane gjithmone te gatshme te presin te tilla flukse, aq me teper kur me pare levizje te tilla kane qene frenuar.


Me poshte do te perqendrohemi me teper tek planifikimi i kontrollit dhe rregullimit, duke ilustruar keto me shembuj nga Shqiperia, si dhe nga pervoja te tjera mbareboterore e me gjere. Mendoj se, deri diku, vend te vecante do te kete edhe pervoja angleze e cila eshte eksperience tipike e urbanizimit te shpejte per shkak te industrializimit te shoqerise.

Per te krijuar disa nje ide me te plote do te nisim me nje pershkrim te kontrollit te planifikimit ne Britanine e Madhe, qe ne kete vend emertohet me konceptin "*zhvillim i kontrolluar*", duke filluar qe ne fundin e shekullit te 19-te. Pra, miliona njerez do te shpernguleshin per ne qytete si rrjedhoje e Revolucionit Industrial, mirepo zonat urbane te atehershme nuk ishin te pergatitura pothuajse fare per te pritur keta njerez.

Brenda nje kohe shume te shkurter u ngriten shtepi, pa ndonje standart, duke shkaktuar probleme jo te pakta per shendetin publik. Per te qene me te sakte, nismat e para per te kontrolluar planifikimin moren emrin

¹ Ky kapitull eshte pergatitur mbi bazen e leksionit te mbajtur nga eksperti anglez i planifikimit rregullues Chriss Berry, prane Hotel "Tirana International", ne kuadrin e konsulences qe Co-PLAN, Instituti per Zhvillimin e Habitatit ka dhene per Bashkine e Tiranës, me qellim iniciimin e nje procesi per hartimin e planit te ri rregullues per qytetin e Tiranës (Prill 2002). Materiali u perkthye dhe interpretua nga anglishtja ne shqip nga Besnik Aliaj.

Chriss Berry eshte arkitekt dhe menaxher urban dhe ka punuar si ne pushtetin lokal edhe ne ate qendror ne Britanine e Madhe, perfshire ketu edhe detyren si Asistent Kryearkitekt i Komisionit te Urbanistikës se Londres. Gjithashtu ai ka qene drejtor i kompanise private Halcrow, qe merret me studime planifikimi dhe inxhinjerike, nje nga me te fuqishmet ne Britani. Kjo firme ka dhene ekspertize keshillimore per qeverite ne mbare boten, perfshire ketu edhe projektet e Bankes Boterore, Kombeve te Bashkuara, Bashkimit Europian, etj. Berry ka drejtuar nje grup pune qe ka punuar per projekte planifikimi dhe rigjenerimi kryesisht ne Europe. Tashme, ai ushtron aktivitetin ne Londer, ne fushen e planifikimit urban, me specialitet menaxhimin dhe projektimin urban.



Aktet e Shendetit Publik, dhe u themeluan per te parandaluar perhapjen e semundjeve si pasoje e mungeses se ujit te rrjedhshem, kanalizimeve, dhe hedhjes se mbeturinave.

Ne vitin 1874, qeveria e asaj kohe vendosi standartet e para baze per sa i perket dendesise dhe shtrirjes se shtepive, me qellim qe te mund te siguroheshin; uji i rrjedhshem, rruget e brendshme, dhe kanalizimet. Me pas vijoi nje periudhe e gjate evolimi per idete e planifikimit, perfshire ketu edhe *Levizjen per Qytetin Kopesht* (te gjelber), si dhe rregulloret e posacme per rastin e Londres, ku zhvillimi po perparonte pergjate linjave te reja hekurudhore pa asnje lloj kontrolli.

Megjithate, *Akti i plote per Planifikimin e Qyteteve dhe te Qendrave te Vogla Urbane* do te hartohet vetem ne vitin 1947. Kjo akt-rregullore e rendesishme do te perbente bazen ku do te mbeshtetej cdo gje qe do vinte me pas. Rregullorja, fillimisht mori persiper te sqaronte mbi baza shkencore proceset e reja te zhvillimit urban qe ishin shfaqur ne mjaft vende te botes.

Sot, pavaresisht nga interpretimet e ndryshme, procesi i planifikimit urban perbehet nga dy elemente kryesore:

- Plan i Pergjithshem i Zhvillimit
- dhe Procesi Rregullues

Te hartosh nje plan, aq me teper ne nivel strategjik, eshte dicka stimuluese dhe entuziasmuese. Cdonjeri mund te ngacmohej nga ideja per te menduar se cila eshte e ardhmja, sidomos per nje vend si Shqiperia, apo Tirana, ku ka kaq shume dinamike dhe energji. Dhe, ne nje kuptim te pergjithshem, kete aktivitet e quajme '*planifikim i se ardhmes*'.

Mirepo, keto plane jane pa vlere ne qofte se nuk shoqerohen me rregullore te mirefillta dhe fuqi ligjore - c'ka perben shpesh per planifikuesit burim pakenaqesie. Mirepo, rregullorja statutore, e pasuar me ligje si forme kontrolli ndaj zhvillimit, eshte jetike per planifikimin lokal dhe ate strategjik ne menyre qe keto te fundit te kene sukses.

Keto plane, qofshin te emertuara si *Plane Zhvillimi*, *Plane Strukturash*, *Plane Strategjike*, *Masterplane*, apo sipas terminologjise me te fundit Europiane si: *Strukturat e Zhvillimit dhe Strategjite Hapesinore*, kerkojne qe rregullorja dhe angazhimi ligjor ne kete drejtim te kene efekt. Me poshte do t'i referohemi ketij niveli te planifikimit si *Planifikimi i Zhvillimit*, dhe pa kaluar ne perseritje, mund te shikojme ne detaje disa paragrafe per te shpjeguar se cfare nenkuptohet me '*plan zhvillimi*' dhe

'*proces rregullimi*', dhe me pas te verejme se sa perputhen keto me situaten ketu ne Shqiperi.

Ritmi i zhvillimit ne Shqiperi eshte me i larte se kudo tjeter ne Tirane, prandaj dhe duhet te tregohemi pragmatiste dhe fleksibel per te marre parasysh nje numer te kufizuar ceshtjesh si me prioritaret, te cilat do te sillnin nje ndryshim me te shpejte ne kushtet e banimit dhe te punes edhe ne qytetet dhe qendrat me te voglat te banimit.

Per kete arsye *Planet e Zhvillimit* duhet te sherbejne si pikenisje vendimtare. Ashtu sic u permend edhe me siper, s'ka rendesi emertimi i tyre; ne pergjithesi ato perfshijne plane ne nje shkalle te gjere per zona me shtrirje te madhe gjeografike dhe te nje natyre te gjere te perdorimit te tokes dhe te aktiviteteve. Ato duhet te perfshijne gjithashtu edhe dokumentacionin shoqerues me parashikime apo parafrime te nivele te ardhshme te ketyre aktiviteteve, ne menyre qe te behet pajisja e nevojshme me sherbime dhe elemente te tjere plotesues per banoret, punetoret dhe vizitoret.

Ajo qe mund te thuhet ne rastin e Tiranes eshte se si *Plan Zhvillimi*, tani per tani, akoma perdoret *Plani i Zonimit Funkcional*, i cili ende perben bazen per shqyrtimin e lejeve te ndertimit ne territorin e Bashkise se Tiranes. Ky plan ka qene pergatitur ne vitin 1989, keshtu qe me ndryshimin e sitemit ekonomik dhe politik patjeter qe i ka ikur koha.

Planet e zonimit funksional te detajuara jane pervec te tjerave shume statike, dhe sapo merret nje vendim qe shkon ndesh me planin, cilado qofte arsyeja, ky plan eshte kompromentuar. Keto plane nuk te japin mundesine per te qene fleksibel ne vendim-marrje ngaqe ato identifikojne vetem perdorimin dhe jo zhvillimin tokes. Prandaj keto plane kane vlere per zona me shtrirje te madhe qe kane nje destinacion te caktuar, psh: strehimi apo industria, ku edhe jane perdorur me teper si ne rastin e SH.B.A.-ve

Tashme, ky lloj plani nuk eshte me dhe aq i pershtatshem per kushtet e Europes. Ne kete aspekt, nevoja per t'a bere Tiranen me nje Plan te ri Zhvillimi eshte me se e qarte. Ky plan mund te jete baza per proceset rregulluese te planifikimit. Nje fillim mjaft i mire eshte bere me *Planin Strategjik te Tiranes se Madhe*, qe eshte edhe plani me i fundit per Tiranen, pergatitur ne kuadrin e *Projektit te Menaxhimit te Tokes Urbane*, prane Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit me mbeshtetjen e Bankes Boterore. Sidoqofte, edhe ne se ky plan do te sherbente drejtpersedrejti si baze per nje proces planifikimi statutor-rregullator, duhet pranuar se ai ka nevojte per plotesime te tjera.

Pas ketij diskutimi te pergjithshem, duhet te kalojme ne diskutimin rreth sistemit rregullator te planifikimit duke u bazuar ne llogjiken e nje plani te plote zhvillimi per te gjithë territorin e nje bashkie. Per te qene me konsekuent ne lidhje me diskutimin e lidhur me Tiranen, dhe per te qene me te sakte, duhet pranuar se edhe vende te zhvilluara si Anglia po kalojne nje proces reformimi te sistemit te planifikimit, i cili tashme ka nevojë te tejkalohet disa nga format klasike te se shkuara.

Per arsye pragmatike, duhet te kete edhe nje faze tjeter ndermjetese midis *planit te zhvillimit* dhe *procesit rregullator*, sidomos ne situata te ngjajshme me ato ne Tirane. *Planet e Veprimit me Baze Lokale*, apo *Strukturat e Zhvillimit Lokal* (s'ka rendesi terminologjia), mund te hartohen brenda nje kohe shume me te shkurter se sa planet strategjike te zhvillimit te nje shkalle me te gjere, ne menyre qe t'i japin pergjigje problemeve specike, duke marre si pikenisje gjendjen e terrenit.

Ajo cfare duhet te dale ne pah ne kete rast jane objektivat e politikave te cilat hartohen per te trajtuar *Strukturën e Zhvillimit Lokal*. Keto objektiva duhen shpjeguar dhe shprehur grafikisht aty ku duhet.

Qellimi i pergjithshem i kesaj pjese te procesit te planifikimit eshte per te hartuar *Kornizen e Zhvillimit Lokal* apo *Planet e Veprimit per Zonat Prioritare*, per te trajtuar probleme te vecanta te planifikimit, ose per te orientuar zhvillimin drejt zonave te vecanta per arsye ekonomike, sociale apo mjedisore. Me pas, ky grup planesh dhe dokumentash mund te sherbeje si ure lidhese dhe te jape informacion per *planin e zhvillimit* apo ate *strategjik* qe natyrisht mbeten per t'u hartuar, ashtu si edhe *procesit rregullator*. Ne kete menyre, *Planet e Veprimit*, duhet te kene te njejten fuqi ne procesin rregullator te planifikimit, ashtu sikurse edhe ne rastin e nje plani zhvillimi i plote.

Pasi te jete pergatitur *Planin e Zhvillimit*, apo nje sere *Planesh Veprimi* ne rastin e situates qe ka aktualisht Tirana, duhet te kthehemi tek *procesit rregullator*. Ne Britanine e Madhe procesi rregullator i planifikimit permban *Ligjin e Qeverisjes* i cili ja delegon autoriteteve lokale pushtetin per kontrollin e zhvillimit. Ne te vertete sistemi Britanik eshte me i centralizuar se kudo tjeter ne Evrope, por ne pergjithesi provincat apo bashkite me te medha i pergatisin vete ligjet te planifikimit, ne varesi te disa kufizimeve nga qeveria qendrore, si psh, kontrolli mbi ambientin.

E megjithese autoritetet lokale ne Britani ndodh qe te jene edhe te lodhura, ngaqë jo te gjitha i pergatisin dot ligjet e veta te planifikimit, perparesia e "imponimit" te qeverise qendrore qendron ne ate se sigurohet nje kompaktesi per ato qe kerkon zhvillimi dhe ata qe me merren me zhvillimin. Keta te fundit nuk mund te nxjerrin jashte loje nje

autoritet lokal ne kurriz te nje tjetri, aq me teper ne vende te vogla si Anglia, Wellsi, Skocia apo edhe Shqiperia. Me pak fjale ne keto vende qeveria qendrore eshte ne rolin e nje arbitri per te siguruar qe loja e zhvillimit urban eshte e ndershme – nje koncept ky tipik anglez.

Sidoqofte, ne rastin e Shqiperise ne Ligjin e Urbanistikes duhet te percaktohet qarte se cfare nenkupton koncepti "*zhvillim*". Ne Britanine e Madhe, Aktet per Planifikimin e Qyteteve dhe Qendrave me te Vogla te Banimit, shprehin qarte se cfare do te thote zhvillim. Me poshte specifikohet cfare thote per kete gje ligji britanik:

"kryerja e veprimeve ndertimore, inxhinjerike, minerare apo te tjera, ne, mbi apo nen toke, ose kryerja e ndonje ndryshimi material ne destinacionin e perdorimit te ndertesës apo te tokes."

Nje tjeter ceshtje thelbesore ne situata si ajo e Shqiperise, eshte sqarimi i konceptit se per te bere nje zhvillim te caktuar nuk mjafton vetem pasja e pronesisë mbi token – gje e cila ne vetvete nuk te jep automatikisht te drejten per te kryer zhvillim (ndertim) ne kete toke. Perkundrazi, me pare duhet te kerkohet leja nga autoritetet lokale perpara se te kryhen veprime per t'a zhvilluar (ndertuar) ate, e njohur kjo si *leja e planifikimit* (leje sheshi). Ne te kundert objekti (zhvillimi) konsiderohet i paligjshem.

Sidoqofte, kjo nuk nenkupton qe cdo centimeter i nje zhvillimi te caktuar ne nje truall te caktuar, kerkon patjeter leje planifikimi. Ashtu sic mund te merret me mend, kjo do te bente qe procesi i zhvillimit te bllokohej ne zyrat e urbanistikes, dhe sic dihet, rradhat per kete nuk jane te pakta.

Kjo do te thote se ne mjaft vende te botes ekziston dhe aplikohet nje proces i "*zhvillimit (ndertimit) te lejuar*", i cili lejon kryerjen e disa zhvillimeve (ndertimeve) me permasa te vogla ose disa ndryshime te destinacionit te perdorimit te tokes/objektit pa patur nevojë per leje urbanistike. Pembajtja e zhvillimit (ndertimit) te lejuar gjendet zakonisht ne nje rregullore te vecante te quajtur *Klasifikimi i Pergjithshem i Zhvillimit (Ndertimit)*, dhe ndryshimet qe lejohen ne destinacion te perdorimit te tokes/objektit jepen ne nje rregullore tjeter te quajtur *Renditja e Klasave te Destinacionit te Perdorimit te Tokes/Ndertimit*.

Sigurisht, qe ka edhe shume rregullore te tjera specike dhe udhezime te leshuara nga qeveria lokale apo qendrore, por sidoqofte keto qe permendem me lart jane elementet me kryesore. Kushdo qe deshiron te zhvilloje token e tij, apo ka lejen nga pronari i tokes per t'a bere kete gje per llogari te ketij te fundit, duhet te aplikojë atehere per siguruar nga autoritetet nje leje planifikimi.

Kjo është e ngjashme me aplikimin për lejen e ndertimit. Dallimi qëndron në atë se aplikimi për lejen e planifikimit shqyrtohet nga *Zyrat e Urbanistikes*, dhe pastaj i parashtrahet një *Komisioni Planifikimi* me anetare të emeruar (rasti i KRRT-ve në Shqipëri) apo keshilltare të zgjedhur (sipas sistemit në Britaninë e Madhe,) të cilët e japin lejen ose e hedhin poshtë kërkesën. Natyrisht që duhet të ekzistojë e drejta për t'u ankuar/apeluar kundër vendimit të refuzimit të lejes në një *Njësi Shqyrtuese/Hetimore të Planifikimit* që administrohet nga qeveria qendrore ose ajo rajonale, gjithnjë një shkallë më lart se sa pusheti që ka refuzuar lejen.

Aplikimi për leje duhet të përfshijë ndërmjet të tjerave destinacionin e përdorimit të tokës/objektit, madhësinë, qëllimin, dhe projektin e zhvillimit të propozuar. Shqyrtimi nëse një propozim i tillë zhvillimi është i pranueshëm apo jo, lidhet para se gjithash me faktin nëse zhvillimi është konform kërkesave të *Planit të Zhvillimit, Kornizës së Zhvillimit Lokal*, apo *Planit të Veprimt.*

Pyetja që bëhet shpesh është se, pse ata që merren me zhvillimin u dashka të marrin për bazë planet e zhvillimit, dhe pse të mos anashkalojnë atë?

Kjo ka një përgjigje të dyfishtë:

(i) Se pari, pas hartimit nga ana e bashkësive perkatëse, plani i zhvillimit i nënshtrohet asaj që quhet *shqyrtim publik i planit*, që shoqërohet nga një vëzhgim i kryer në publik nga ana e inspektorëve të qeverisë qendrore. Ky shqyrtim i jep mundësinë interesave të ndryshme, qofshin atyre të biznesit, ambientit, komunitetit e madje edhe individëve që të 'perplasen' dhe ballafaqohen me propozimet e autoriteteve lokale.

Raporti përfundimtar i këtij shqyrtimi në publik i dërgohet autoriteteve lokale, por nuk ka forcë detyruese mbi ta. Këta të fundit mund t'i përfillojnë ose jo përfundimet e inspektorëve të Qeverisë. Megjithatë, raporti bëhet i njohur përmes publikimit në media, dhe kështu që banorët lokalë, të cilët janë natyrisht votues, mund të shikojnë se sa dhe si i marrin parasysh autoritetet lokale opinionet e tyre. Kështu, në këtë mënyrë krijohet mbështetja për planin e zhvillimit, dhe pranohet se ky është ligji si dhe qëllimi legjitim i autoriteteve lokale. Prapëseprapë, edhe pas këtij procesi, ka një arsye tjetër pse plani i zhvillimit merret seriozisht.

(ii) Se dyti, çdo autoritet lokal, me anë të personave që hetojnë zbatimin e ligjit, sipas të vëzhgimeve të veta apo informatave nga publiku, kontrollojnë nëse kanë nisur ndertime pa leje, apo ndertime që kanë shkelur projektet e dorezuara dhe të aprovuara. Masat ndëshkimore në

vende të tjera mund të jenë të renda dhe variojnë, përfshi këtu që nga gjopa e deri tek burgimi. Nderkohe që autoritetet lokale mund të ngulin këmbë nga ana e tyre deri në shembjen e ndertimit të pa-autorizuar.

Sigurisht, që është patjetër jetike që Ligji i Urbanistikes të hartohet si duhet për t'i dhënë mbështetjen e duhur procesit të planifikimit. Dihet nevoja e fuqishme që ligji i planifikimit duhet të sigurojë një perkufizim të mjaftueshëm për zhvillimin. Vetvetiu kuptohet që ai duhet gjithashtu t'i japë planit të zhvillimit edhe fuqinë statutores/ligjore (imponuese).

Sa u shpjegua më sipër i perket me tepër praktikës angleze. Me tej do të flasim për përvorjen në vende të tjera të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Indirekt, u trajtua më sipër praktika amerikane, ku në përgjithësi, bashkë të cilat kanë shumë me pak funksione se shumica e qyteteve evropiane kanë tendencën të përdorin planin e zonimit funksional për kërkesat e planeve të tyre të zhvillimit.

Jo për t'i thjeshtuar gjërat më tepër se ç'duhet, porse historikisht, në SH.B.A situata ka qenë krejt e ndryshme. Toka në Amerikë ka qenë historikisht me bollëk dhe kryesisht planifikimi është kryer me tepër për të inkurajuar, se sa për 'frenuar' zhvillimin.

Një tipar i mjaft qyteteve amerikane, është prania e zonave të brendshme urbane ku ekzistojnë lagje, jo të vogla, të lena pas dorë e të harruara që gjenden në degradim. Në shumicën e rasteve, ata që merreshin me zhvillimin largoheshin nga ato zona ku gjendja kishte nisur drejt degradimit, duke e shpërngulur zhvillimin diku tjetër. Kështu që, relativisht, ndoshta vetëm kohët e fundit autoriteteve amerikane në qytetet me të mëdha dhe me të vjetra iu është dashur të marrin parasysh plane rigjenerimi dhe rinovimi. Aktualisht ata po përdorin mekanizma që varen nga një perzierje midis detyrimit dhe inkurajimit, për shembull nëpërmjet shkurtimeve të taksave të tokës për t'u rikthyer përdorimit të tokës brenda në qytet.

Sidoqoftë në rastin e Shqipërisë, shumë rendesi ka përvorja evropiane, dhe megjithatë praktika ndryshon, theksi është më i fortë mbetet tek kontrolli rigoroz nga njëra anë, dhe nga ana tjetër në inkurajimin nëpërmjet zonimit funksional ku kontrolli është më pak rigoroz. Për këtë të fundit, kemi shembullin e zonave të zhvillimit ekonomik në shumicën e autoriteteve lokale në Francë, ku industria dhe tregtia nxiten aktivisht nëpërmjet pajisjes me infrastrukture dhe troje publike falas.

Pa kaluar në rrezikun e thjeshtimit më tepër sa duhet, ndoshta kontrollojnë më të rreptë ndaj zhvillimit e kanë disa qytete në Zvicër dhe Gjermani, ku praktikisht për çfaredolloj zhvillimi duhet paraqitur projekt-skica dhe formate të hollësishme, sidomos në ruajtjen e



ambienteve historike, ku nuk lejohet asnjë ndryshim i tyre dhe për këto rregullat janë edhe më të forta.

Për t'iu rikthyer perseri argumentit kryesor në fillim të këtij kapitulli, autoritetet lokale në vende të ndryshme në Europë përcaktojnë shpesh zona, të cilat efektisht janë destinuar për Plane Veprimi, ose zona për përdorim të tokës ku përdorimi dhe aktivitetet e vecanta ose kontrollohen ose inkurajohen. Këto plane gëzojnë mbështetjen e ligjit lokal ose kombëtar dhe në pjesën dërrmuese pranojnë si logjike dhe legjitime.

Në përfundim të këtij argumenti, mund të themi se kërkesa kryesore në Shqipëri dhe sidomos në Tiranë është promovimi i parimit se, kontrolli i zhvillimit në një nivel të caktuar bëhet për të mirën publike, në kuptimin e zbulimit të qytetit, lehtësimit të trafikut, zhvillimit të një cilësie jetese më të mirë dhe i një ambienti më të mirë për të gjithë.

Nuk është e lehtë për një qytet kur liria për t'u zhvilluar është një ndjesi e re. Sidoqoftë, Tirana ka një potencial të madh për të qenë një qytet dinamik dhe i bukur evropian. Ky shans për ta bërë atë të tillë nuk duhet lënë të iki. Për këto gjë duhet operuar në maksimum përmes një kombinimi të Planeve të Veprimit, Planit Strategjik të Zhvillimit, dhe reformimit të Ligjit të Urbanistikës përfshi rregulloret lokale. Kjo gjë duhet të bëhet sa më mirë që të jete e mundur për të qenë të sigurtë që ky qytet të bëhet i tillë.

Teknikisht, kjo është krejtësisht e realizueshme pasi mund të bazohemi tek eksperiencën e pasur të vendeve të tjera. Sfidat qëndron në ndryshimin e qëndrimit ndaj zhvillimit, dhe promovimin e përfitimit publik mbi fitimin e ngushtë privat, i cili në fund të fundit është pikerisht ai që na pasuron të gjithëve.



PLANIFIKIMI DHE INSTRUMENTAT RREGULLUESE (IMPONUESE)¹

1987 Nr: 764

PLANIFIKIMI I QYTETEVE DHE FSHATRAVE NE ANGLI DHE UELLS

Urdheresa e Vitit 1987
mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave
(KLASAT E PERDORIMIT)

Nxjerre me 28 Prill 1987
Hyri ne fuqi me 1 Qeshor 1987

Sekretari i Shtetit per Mdjedisin ne funksion te ushtrimit te kompetencave qe iu deleguan ne baze te pjeseve 22(2) (f) dhe 287 (3) te Aktit te Planifikimit ne Qytet dhe Fshat 1971 (a) si edhe ne perputhje me teresine e kompetencave qe e mundesojne ate te veproje ne emer te tij, nxjerr Urdheresen e meposhtme.

Citimi dhe hyrja ne fuqi:

1. Kjo Urdherese mund te citohet si - *Urdheresa mbi Planifikimin ne Qytete dhe Fshatra (Perdorimi i klasave) 1987* - dhe hyn ne fuqi date 1 Qeshor 1987.

Interpretimi:

2. Termat vijuese te kesaj Urdherese kane kete domethenie me perjashtim kur parashikohet ndryshe ne kontekst.

"kujdes" - nenkupton kujdesin personal per njerezit te cilet kane nevoje per kujdes si pasoje e moshes se thyer, invaliditetit, ose kur jane varesi te pijeve alkolike dhe droges (ne te tashmen apo ne te shkuaren) apo ne rastin e c'rregullimeve mendore (ne te tashmen apo ne te shkuaren), ndersa ne klasen C2 perfshihet kujdesi personal per femijet apo kujdesi dhe trajtimi mjeksor.

¹ Ky kapitull bazohet ne legjislacionin e Britanise se Madhe mbi fushen e planifikimit rregullues. Eshte zgjedhur Britania e Madhe pasi ajo perben nje rast tipik te urbanizimit te shpejte dhe radikal. Me gjithë ndryshimet e njohura ky legjislacion paraqet mjaft interes per realitetin shqiptar sot. Materiali u shqiperua nga anglishtja ne shqip nga Kleva Gruda dhe Besnik Aliaj

"qender e specializuar per pleq dhe handikapate" - nenkupton godinat te cilat vizitohen gjate dites per qellime sociale apo clodhese apo per qellime te tjera si per trajnime profesionale apo per qellime rehabilitimi, ne te cilat ofrohet kujdes.

"substance e rrezikshme" dhe *"sasi e deklaruar"* - kane kuptimin e atyre termave qe jane perdorur ne Rregulloret per Vendosjen dhe Perdorimin e Substancave te Rrezikshme.

"proces industrial" - nenkupton nje proces ne funksion te apo qe lidhet me njerin nga qellimet si me poshte:

- (a) prodhimi i cdo lloj produkti apo pjese te tij (qofte kjo anije, mjet, film, video apo paisje incizimi).
 - (b) ndryshimin, ndreqjen, mirembajtjen, zbukurimin/dekorimin, perfundimin, pastrimin, larjen, ambalazhimin, konservimin, pershtatjen per shitje, shkeljen apo dhunimin e cdo neni: ose
 - (c) marrjen, mbulimin apo trajtimin e cdo minerali;
- gjate zhvillimit te cdo lloj tregtie apo biznesi pervec bujqesise, ndryshe nga nje perdorim qe kryhet ne apo prane nje miniere apo gurore.

"Aneks" - nenkupton Aneksin e kesaj Urdherese:

"vend punimesh" nenkupton teresine e truallit brenda nje njesie te vetme okupimi.

Perdorimi i klasave:

3.--(1) Ne varesi te dispozitave te kesaj Urdherese ku ndertesa apo toka perdoret per qellime te ndonje klase te parashikuar ne Aneksin perkates, perdorimi i nderteses apo i ndonje toke tjeter per qellime te ndryshme te se njejtës klase nuk do te perbeje zhvillim te tokes.

(2) Referenca ne paragrafin (1) per nje ndertese perfshin referenca per token e cila zihet nga ndertesa dhe perdoret per qellime te njejtës.

(3) Nje perdorim qe perfshihet dhe qe lidhet zakonisht me cdo perdorim te klases qe percaktohet ne Aneks, nuk perjashtohet nga perdorimi me te cilin ai lidhet zakonisht thjesht vetem se eshte parashikuar ne Aneks si njesi e ndare.

(4) Ne rastin kur toka ne nje vend punimi te vetem apo ne vende punimesh afer qe perdoren si pjese te nje ndermarrje te vetme perdoret per qellime qe perfshijne apo perbehen nga qellime qe gjenden ne dy apo me shume nga klasat B1 deri B7 ne Aneks, ato klasa mund te trajtohen

si nje klase e vetme duke patur parasysh perdorimin e truallit per qellime te kesaj Urdherese per sa kohe qe zona e perdorur per nje qellim sipas klases B2 ose sipas klasave B3 deri B7, si rrjedhoje nuk eshte rritur ndjeshem.

(5) Asnje nga klasat e parashikuara ne kete Aneks nuk perfshijne perdorime per qellime prodhimi, perpunimi, mbajtje apo perdorimi te nje substance te rrezikshme ne situata te tilla sa qe ajo te rezultojte ne nje kohe si sasi e konsiderueshme dhe mund te gjendet mbi, nen ndertesën apo token apo ne ndonje vend punimi ku ndertesa apo toka jane elemente perberes te tij.

(6) Asnje klase e parashikuar ne Aneks nuk perfshin perdorimin si -

- a) teater
- b) qender argetimi apo panair,
- c) per qellime larje apo pastrimi te rrobave apo materialeve ne makinat automatike apo ne godina ku mallrat pastrohen dhe merren direkt nga publiku,
- d) per shitjen e naftes per automjete,
- e) per shitjen apo ekspozimin e automjeteve,
- f) per sherbimin taksi apo per te dhene me qira automjetin,
- g) per varreza makinash apo per oborre me qellim grumbullimin apo shperndarjen e mineraleve apo prishjen e automjeteve.

Ndryshimi i perdorimit te pjeses se ndertesës apo truallit:

4. Ne rastin kur ndertesa perdoret per qellime te klases C3 (banesa) sic parashikohet ne Skedule, perdorimi si nje banese e ndare e cdo pjese te ndertesës apo e cdo pjese toke te zene qe perdoret per qellime te njejta te ndertesës, nuk mund te konsiderohet ne baze te kesaj Urdherese si pjese perberese e zhvillimit.

Revokimi:

5. Urdheresa 1972 (a) mbi Planifikimin ne Qytete dhe Fshatre (Klasat e Perdorimit) si edhe Urdheresa 1983 (b) (Amendamenti) mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat jane te revokueshme.

ANEKSI

PJESA A

Klasa A1. - Dyqane

Perdorimi per te gjithë apo njerin nga qellimet si me poshte:

- (a) per shitje me pakice me perjashtim te ushqimeve te gatshme
- (b) si zyre postale
- (c) per shitjen e biletave apo per qellime te agjencive udhetimesh
- (d) per shitjen e sanduiceve apo te ushqimeve te tjera te gatshme per konsumim jashte godinave
- (e) per qellime parukerie
- (f) per administrimin e sherbimeve funerale
- (g) per qellime te ekspozimit te mallrave per shitje
- (h) per te dhene me qira mallra personale apo objekte
- (i) per marrjen e mallrave per larje, pastrim apo riparim kur publikut vizitues i ofrohet sherbimi i shitjes, ekspozimit etj.

Klasa A2. - Sherbime financiare dhe profesionale

Perdorim per dispozita te-

- (a) sherbimeve financiare ose
- (b) sherbime profesionale (me perjashtim te sherbimeve mjekesore) ose
- (c) cdo lloj sherbimi (perfshire perdorimin e dyqaneve te basteve/llojarive) qe eshte e pershtatshme te ofroje sherbime ne qendren tregtare,

ku sherbimet i ofrohen kryesisht vizitoreve ose publikut.

Klasa A3. - Ushqime dhe Pije

Perdorimi per shitjen e ushqimeve dhe pijeve per konsumim ne godina apo shitja e ushqimeve gatshme per konsumim jashte godinave.

PJESA B

Klasa B1. - Biznesi

Perdorimi per te gjithë apo njerin nga qellimet si me poshte.

- (a) per zyra me perjashtim te perdorimit te cituar ne klasen A2 (sherbime financiare dhe profesionale)
- (b) per kerkime apo zhvillime te produkteve apo proceseve, ose
- (c) per procese industriale,

perdorim i cili mund te kryhet ne zona banimi pa demtuar komoditetin e zones nga zhurmat, lekundjet, ererat, tymrat, smogu, bloza, hiri, pluhuri apo cakulli.

Klasa B2. - Industri e pergjithshme

Perdorimi per kryerjen e nje procesi industrial me perjashtim te atij grupi qe klasifikohet nen klasen B1 lart apo brenda klasave B3 deri B7 poshte.

Klasa B3. - Industri e Vecante, Grupi A

Perdorimi ne lidhje me cdo pune te regjistruar nen kategorine "Alkalin", etj. Akti i Rregulloreve per Punen 1906 (a) dhe qe nuk perfshihet ne asnjeren nga klasat B4 deri B7 me poshte.

Klasa B4. - Industri e Vecante, Grupi B

Perdorim ne lidhje me proceset e meposhtme me perjashtim kur procesi eshte ne varesi te marrjes, mbeshtjelljes, trajtimit te minerale dhe kryhet ne ose prane mineres apo gurores.

- (a) shkrirja, kalcifikimi, apo reduktimi i xeheroreve, mineraleve, koncentrateve apo matiteve;
- (b) ndryshimi, perpunimi, ri-ngrohja, ngurtesimi, shkrirja, karbonizimi, imitimi apo derdhja ne forme te metaleve me perjashtim te prodhimit me derdhje me presion.
- (c) pastrimi i metaleve nga hekurishtete, llumi apo frasheri.
- (d) galvanizimi
- (e) pastrimi kimit te metaleve ne acid
- (f) veshja ne pllaka metalike te kromit

Klasa B5. - Industri e Vecante, Grupi C

Perdorimi per qeillime te meposhtme me perjashtim kur procesi eshte ne varesi te marrjes, mbeshtjelljes, trajtimit te mineralve dhe kryhet ne ose prane mineres apo gurores.

- (a) shkrumbezimi i tullave ose tubave
- (b) shkrumbezimi i gelqeres se pashuar ose dolomite
- (c) prodhimi i zink oksidit, cimentos ose aluminit
- (d) shkumezimi, shtypja, shoshitja ose ngrohja e mineraleve ose baltes prej xeherori
- (e) prodhimi i hirit te pulverizuar te lendeve ushqyese nepermjet ngrohjes
- (f) prodhimi i gelqeres se karbonizuar ose i gelqeres se hidratuar
- (g) prodhimi i pigmenteve jo-organike me ane te kalcifikimit, djegjes ose shtypjes

Klasa B6. - Industri e vecante, Grupi D

Perdorimi per proceset e meposhtme:--

- (a) distilimi, rafinimi ose perzierja e naftes (pervec petrolum apo produkteve te petrolum);
- (b) prodhimin ose perdorimin e celulozes ose perdorimin e presionit per te lyer metalet (pervec lyerjes se makinave ne oficine ne lidhje me riparime te vogla, ose aplikimi i pluhurit plastik per teknika te vecanta);
- (c) zierja e vajit linsed ose gomes se shkrirje;
- (d) procese qe kane te bejne me perdorimin e bitumit (pervec perdorimit te bitumit ne punishte ne temperatura qe nuk I kalojne 220 Grade Celcius)
- (e) shkrirje te veshtjeve enamel;
- (f) prodhimi i aliphatic esters nga acide, acidi byturik, karamel, hexamine, iodoform, naftols, produkte resini (duke perjashtuar shkrirjet plastike ose prodhimin e fleteve plastike, tubave,

filamenteve, fibrave ose komponenteve optike te prodhuar nga shkrirja, hedhja, kalenderimi), acidi salisilik ose perberje organike te sulfonizuara;

- (g) prodhimin i gomes;
- (h) proceset kimike ne te cilat perdoren chlorphenhols ose chlorcresols;
- (i) manifakturimi i acetilenit nga kalcioni karbid;
- (j) manifakturimi ose perdorimi i pyridine ose picolines, cdo metili ose etili amin ose akrilateve.

Klasa B7. - Industri e vecante, Grupi E

Perdorime per kryerjen e bizneseve, tregtive, apo industrive te meposhtme -

- Zierja e gjakut, chiterlings, netting or soap.
- Zierja, djegja, girja ose avullimi i kockave.
- Zierja dhe pastrimi i plencave.
- Rritja e kimbave per ceshtje te kafsheve.
- Pastrimi, adaptimi osr trajtimi i flokeve te kafsheve.
- Kurimi i peshkut.
- Punime me mbeturimat dhe kockat (qe perfshin marrjen, magazinimin, rregullimin e mbeturinave, ose te kockave, lekurave te lepujve, yndrave te kafsheve, etj)
- Veshja ose heqja e lekures se peshkut.
- Tharje lekure.
- Nxjerrje te produkteve nga kockat, peshku, gjaku, ose nga kafshe te ndryshme.
- Trajtimin e zorreve.
- Prodhimin e qymyrit nga kafshet, gjaku, qirinjeve, ngjitesve, vajit te peshkut, ushqimeve per kafshet, ose shpendet nga mishi, peshku, gjaku, kockat, puplat, yndyra, qe kalohen ne procese qe shkaktojen noxious apo effluvia te demshme.
- Pregatitje e lekures per punime.

Klasa B8. - Magazinimi apo Shperndarja

Perdorim per magazinim apo qendra te shperndarjes.

PJESA C**Klasa C1. - Hotele dhe Azile**

Perdorimi i hotelit, pensionit, shtepise se miqve per funksione strehe ku nuk ofrohen ne cdo rast elemente te rendesishme kujdesi.

Klasa C2. - Institucione Banimi

Perdorimi ne funksion te dispozites te akomodimeve rezidenciale dhe kujdesi per njerezit ne kerkim te kujdesit (me perjashtim te perdorimit sipas klases C3 (shtepi banimi).

Ne funksion spitali apo qendre per te semure kronike

Ne funksion shkolle, kolegji apo qender trajnimi

Klasa C3. - Shtepi banimi

Perdorimi i shtepise se banimit (nese perdoret apo jo si banesa kryesore)

(a) nga nje person apo disa persona qe jetojne se bashku si nje familje, ose

(b) nga jo me shume se 6 residente qe jetojne se bashku si nje shtepi e vetme

(perfshire nje familje ku ofrohet kujdes per residentet)

PJESA D**Klasa D1. - Institucione jo-residenciale**

Cdo lloj perdorimi qe nuk perfshin perdorim per qellime banimi

(a) per dispozite te sherbimeve mjekesore me perjashtim te perdorimit te godinave bashkangjitur baneses se konsulentit apo praktikantit

(b) per cerdhe femijesh apo cerdhe ditore

(c) per dispoziten e arsimimit

(d) per ekspozimin e veprave te artit (me perjashtim te atyre per shitje apo qera)

(e) per muzeum

(f) per biblioteke publike ose dhome leximi

(g) salle publike apo ekspozite

(h) per apo ne lidhje me tempujt dhe me institucione fetare

Klasa D2. - Mbledhjet dhe koha e lire

Perdorim per :

(a) kinema

(b) salle koncerti

(c) salle bingo, casino

(d) salle vallezimi

(e) pishine, fushe patinazhi, palester apo hapësire per aktivitete sportive brenda apo jashte ne natyre ose aktivitete clodhese me perjashtim te motoreve dhe armeve zjarri)

28 Prill 1987

Nicholas Ridley
Sekretar i Shtetit per Mjedisin

Shenime shpjeguese:

(Ky shenim nuk eshte pjese e Urdhereses)

Kjo Urdherese shfuqizon dhe zevendeson Urdheresen 1972 mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat (Perdorimi i Klasave) e ndryshuar me Urdheresen 1983 (Amendamenti) mbi Planifikimin ne Qytet dhe ne Fshat (Perdorimi i Klasave).

Kjo Urdherese specifikon klasat e perdorimit te ndertesave apo te truallit per qellime te parashikuara ne seksionin 22 (2) te Aktit 1971 mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat. Seksioni 22 (2) parashikon operacionet ose perdorimet te cilat nuk duhet te merren per qellime te Aktit qe perbejne zhvillim, dhe si rrjedhoje nuk kerkojne leje per planifikim. Ne paragrafin (f) parashikohet qe ndryshimi i perdorimit nuk duhet te merret si zhvillim ne te cilin perdorimi i meparshem dhe perdorimi aktual gjenden brenda se njejtës klasete specifikuar ne urdherese ne baze te paragrafit.

Ne kete Urdherese ndryshime kane pesuar klasat e perdorimit te specifikuar ne Skedulin e Urdhereses 1972.

Klasa I ne Urdheresen 1972 parashikon perdorimin e dyqanit (perkufizimi i te cilit jepet ne Urdherese) ne varesi te perjashtimeve specifike. Perjashtimet specifike per dyqane plenci, dyqane per mace, dyqane per kafshe shtepiake nuk gjenden ne klasen e re A1 "per dyqanet". Perdorimi per shitjen e udhqimeve te shpejta gjendet ne klasen e re A3 (ushqime dhe pije) e cila perjashtohet kategorikisht nga klasa A1. Perjashtimi i meparshem i perdorimit per shitjen e automjeteve parashikohet ne nenin 3(6) (e).

Klasa A2 i referohet klases se re mbi perdorimin e sherbimeve financiare, profesionale dhe sherbimeve te tjera. Kjo perkon me disa perdorime te meparshme zyrtare te Klases II dhe me disa perdorime te meparshme nen perkufizimin "dyqan" ne funksion te perdorimit te ndertesave per qellime te volitshme per nje qender tregtare. Testi i volitshmerise per nje qender tregtare dominon teresine e klases A2.

Klasa A3 (ushqime dhe pije) perben nje klase te re. Ajo kombinon perdorimin per shitjen e udhqimit te gatshme qe u perjashtua fillimisht nga Klasa I me perdorimin e restorantit apo me shitjen e pijeve.

Klasa B1 kombinon disa nga perdorimet zyrtare te meparshme brenda Klases II me perdorime per qellime te industrise se lehte te cilat

perfshiheshin ne klasen e biznesit III. Nje test i ngjashem u zbatua ne Klasen III – d.m.th perdorimi i cili mund te kryhet ne cdo zone banimi pa demtuat komoditetit e asaj zone – dominon aktualisht te gjitha qellimet ne kete kategori.

Klasa B2 (industri e pergjithshme) pasqyron Klasen e vjeter IV

Klasat B3 deri ne B7 pasqyrojne Klasat e meparshme V ne IX (Grupe te Vecanta Industriale) (A) ne (E). Pavaresisht nga ri-organizimi, permbajtja e ketyre klasave eshte e njejte.

Klasa B8 (magazinimi dhe shperndarja) bazohet ne Klasen e meparshem X ndonese shtrihet per perdorimin e truallit te hapur dhe te perdorimit te qendres se shperndarjes.

Klasa C1 (hotele dhe azile) pasqyrojne gjeresisht klasen e meparshme XI ndonese vihet ne dukje qe kjo klasenuk mbulon ndonje ndertese banimi ku mund te ofrohet kujdesi i duhur. (parashikuar ne nenin 2)

Klasa C2 (institucione banimi) nderthuret me klasen e meparshme XII dhe XIV.

Klasa C3 (shtepi banimi) eshte nje klasee re e cila perfshin perdorimin e banesave nga ana e nje individi, apo njerezve qe jetojne se bashku si familje por jo me shume se gjashte residenteve qe jetojne se bashku si nje familje. Kur njerezit jetojne se bashku ne formen e nje familje sesa ne formen e nje familje te mirefillte perdorimi do te perfshihet brenda klasen pavaresisht nese ofrohet apo jo kujdesi (sic parashikohet ne nenin 2) per residentet. Qellimi i kesaj kategorie eshte te perfshije per shembull perdorimin e nje banese nga individet te cilet jetojne se bashku brenda nje komuniteti te cilet kane qene me pare ne nje institucion te ketij lloji.

Klasa D1 perfshin perdorimet te cilat jane perdorur me pare ne Klasat XIII, XV dhe XVI.

Nuk pefshihen farmacite spitalore dhe keta do te perfshihen ose ne klasen A1 (dyqane) ose aty ku keto jane ne varesi te spitalit, brenda klases C2 institucione banimi.

Klasa D2 (grupimi dhe koha e lire) perfshin perdorimet e meparshme te klasave XVII dhe XVIII. Kjo klaseperfshin gjithashtu aktivite sportive jashte dhe brenda me perjashtim te aktiviteve me motor apo te sporteve me arme lufte. Kinemate te cilat renditeshin nen Klasen XVII nuk perfshihen me ne asnjeren nga keto klase(shih nenin (3) (6).

Ndryshimi midis kesaj Urdherese dhe Urdhereses se vitit 1972 qendron ne ate qe ne Pjeset A dhe B te Skedulit te kesaj Urdherese perdorimet e

specifikuara nenkuptojne perdorimet e ndertesave ose te truallit ndersa equivalentet e tyre ne Urdheresen 1972 parashikojne perdorime te ndertesave. Gjithashtu ekzistojne perdorime te tjera qe nuk perfshihen ne klasete cilat renditen ne nenet (3) (6) te kesaj Urdherese.

Paragrafi 1 i Skedulit 11 i Aktit 1986 mbi Planifikimin dhe Strehimin ndryshoi pjesen 22(2) (f) te Aktit 1971 ne te cilin thuhet se ndryshimi i perdorimit te pjeses se nderteses apo truallit nuk eshte nje ndryshim material i perdorimit ku ndryshimi i pare dhe ndryshimi i fundit i pjeses gjenden brenda se njejtës klasene varesi te dispozitave te nje urdherese sipas paragrafit.

Neni 4 i Urdhereses parashikon se perdorimi i baneses se ndare apo i nje pjese te nderteses apo truallit qe perdoret per qellime te klases C3 (shtepi banimi) nuk duhet te merret parasysht ne baze te kesaj Urdherese si perberese e zhvillimit.



PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMET URBANISTIKE ME LEJE^a

1995 No.418

PLANIFIKIMI I QYTETEVE DHE FSHATRAVE NE ANGLI DHE UELLS

Urdherese e Vitit 1995
Mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave
(ZHVILLIMET URBANISTIKE ME LEJE)

Nxjerre me:
Paraqitur ne parlament:
Hyri ne Fuqi

22 Shkurt 1995
6 Mars 1995
3 Qershor 1995

NENI

	Faqe
1. Citime, parathenie dhe interpretime	3
2. Aplikime	6
3. Zhvillime te Lejuara	6
4. Direktiva qe kufizojne zhvillimin e lejuar	7
5. Miratimi i Sekretarit te Shtetit per direktiva te nenit 4(1)	9
6. Njoftimi dhe konfirmimi i direktivave te nenit 4(2)	10
7. Direktiva qe kufizojne zhvillimet me leje nen Klasen B te Pjeses 22 ose Klasen B te Pjeses 23	11
8. Direktivat	12
9. Revokimet	12

ANEKSI 1

PJESET

	Faqe
1. Neni 1(4) toka	13
2. Neni 1(5) toka	13
3. Neni 1(6) toka	13

^a Ky kapitull bazohet ne legjislacionin e Britanise se Madhe mbi fushen e planifikimit rregullues. Eshte zgjedhur Britania e Madhe pasi ajo perben nje rast tipik te urbanizimit te shpejte dhe radikal. Me gjithë ndryshimet e njohura ky legjislacion paraqet mjaft interes per realitetin shqiptar sot. Materiali u shqiperua nga anglishtja ne shqip nga Kleva Gruda dhe Besnik Aliaj

ANEKSI 2:
ZHVILLIME TE LEJUARA

PJESET	Faqe
1. Zhvillime brenda parceles se nje shtepie banimi	15
2. Punime te vogla	18
3. Ndryshimet ne Perdorim	18
4. Ndertesa dhe perdorime te perkoheshme	20
5. Vendet e karvaneve	21
6. Ndertesa dhe punimet bujqesore	21
7. Punime dhe ndertesa pylltare	26
8. Zhvillime industriale dhe magazina	27
9. Riparime te rrugeve te paadoptuara dhe rrugeve private	29
10. Riparime te sherbimeve	29
11. Zhvillime nen akte dhe urdheresa lokale apo private	29
12. Zhvillime te autoriteteve lokale	30
13. Zhvillime te autoriteteve lokale te autostradave	31
14. Zhvillime nga ndermarjet e drenazhimit	31
15. Zhvillime te autoritetit kombetar te lumenjve	31
16. Zhvillime nga ose ne emer te sipermarresve te ujrave te zeza	32
17. Zhvillime nga sipermarres ligjore	33
18. Zhvillime Aviacioni	38
19. Zhvillime ndihmese te punimeve minerare	40
20. Zhvillime ne minierat e qymyrgurgurit nga autoriteti i qymyrgurgurit dhe sipermarres te licensuar	43
21. Hedhja e mbeturinave ne nje miniere	47
22. Explorimi i Mineraleve	48
23. Zhvendosja e materialeve nga depozitat mineral-punuese	50
24. Zhvillime nga operues te kodeve te sistemeve te telekomunikacionit	51
25. Zhvillime te tjera te telekomunikacionit	55
26. Zhvillime nga Komisioni i Ndertesaive Historike dhe Monumenteve	56
27. Perdorimi nga anetaret e organizatave argetuese	56
28. Zhvillime ne Parqet e Lodrave	57
29. Sistemi i informimit te shofereve	57
30. Ambjente te takses rrugore	58
31. Shembje e ndertesaive	59
32. Shkollat, kolegjet, universitetet dhe spitalet	61
33. Kamera televizive me qark te shkurter	62

ANEKSI 3:

INSTRUMENTE LIGJORE TE REVOKUARA	63
----------------------------------	----

Sekretari i Shtetit per Mjedisin, per Angline, dhe Sekretari i Shtetit i Uellsit, per Uellsin, ne ushtrim te pushtetit qe u eshte dhene nga seksionet 59, 60, 61, 74, dhe 333(7) te Aktit mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1990 ^(a), seksioni 54 i Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994 ^(b) dhe nga cdo pushtet tjetër qe i mundeson ato per t'i perfaqesuar, nxjerrin urdheresen sa me poshte:

Citime, parathenie dhe interpretime

1.- (1) Kjo Urdherese mund te citohet si Urdheresa mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave (Zhvillimet me Leje) 1995 dhe hyn ne fuqi me 3 Qershor 1995.

(2) Ne kete Urdherese, me perjashtim te konteksteve te vecanta – “Akt” do te thote Akti mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave 1990; “Akti i Vitit 1960” do te thote Akti mbi Vendet e Karvaneve dhe mbi Kontrollin e Zhvillimit 1960 ^(c); “aerodrom” do te thote aerodrom sic eshte perkufizuar ne nenin 106 te Urdhereses mbi Navigacionin Ajror 1989 ^(d) (interpretim) qe parashikon:

- (a) I licensuar sipas kesaj Urdherese,
- (b) Aerodrom Qeveritar,
- (c) Ne nje aerodrom te tille, prodhimi, riparimi dhe mirembajtja e avioneve kryhet nga nje person qe ka biznes si prodhues, riparues ose mirembajtjes avionash,
- (d) Ku ka aviona qe perdoren per transportimin publik te pasagjereve apo mallrave, apo per qellime ajrore, ose;
- (e) I idendifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil perpara 1 Mars 1986, per t'u perfshire ne Indeksine e Aerodromeve te Britanise se Madhe.

Dhe, ne funksion te ketij perkufizimi, termat “pune ajrore”, “Aerodrom Qeveritar”, dhe “transport publik” jane te shpjeguar ne nenin 106;

- “ujesjelles” ose “viadukt” nuk perfshin linjat nentokesore;
- “zone me bukuri te rralle natyrore” kupton nje zone te caktuar si te tille nga nje urdherese e nxjerre nga Komisioni per Zonat Rurale, per Angline, ose nga Keshilli per Zonat Rurale, per Uellsin, sipas seksionit

^(a) 1990 c.8; seksioni 74(1A) eshte shtuar, dhe seksioni 74(2) eshte plotesuar, nga seksioni 19(1) dhe nga paragrafi 17 I i Aneksit 7 te Aktit mbi Planifikimin dhe Kompensimin 1991 (c.34).

^(b) 1994 c.21.

^(c) 1960 c.62; nje amendament i rendesishem ne seksionin 13 te Aktit mbi Vendet e Karvaneve 1968 (c.52).

^(d) S.I. 1989/2004, te cilet jane amendamente jo relevante per kete Urdherese.

87 te Aktit mbi Parqet Kombetare dhe Perdorimin e Zonave Fshatare 1949 ^(c) (caktimin e zonave me bukuri te rralle natyrore) sic konfirmohet nga Sekretari i Shtetit;

- “ndertese” –
 - (a) perfshin cdo strukture apo ndertim dhe, pervec Pjeseve 24, 25, dhe 33, dhe Klases A te Pjeses 31, Aneksi 2, perfshin cdo pjese te nje ndertese, sic perkufizohet ne kete artikull, dhe;
 - (b) nuk perfshin fabrika dhe makineri dhe, ne Aneksin 2, pervec ne Klases B te Pjeses 31 dhe Pjeses 33, nuk perfshihen porta, gardhe, mure apo ndertime te tjera rrethuese;
- “karvan” ka te njejtin kuptim si ne Pjesen I te Aktit 1960 (vende karvanesh)
- “vende karvanesh” nenkupton nje pjese toke ne te cilen eshte vendosur nje karvan me qellim banimi dhe toka qe perdoret ne lidhje me truallin mbi te cilen eshte vendosur karvani;
- “rruge e klasifikuar” do te thote nje autostrade ne funksionim ose nje autostrade e planifikuar e cila—
 - a) eshte rruge e klasifikuar ose kryesore e percaktuar sipas seksionit 12(1) te Aktit mbi Autostradat 1980^(d) (dispozita te pergjithshme mbi rruget kryesore dhe te klasifikuara); ose;
 - b) eshte klasifikuar nga Sekretari i Shtetit per qellim dekretimi sipas seksionit 12(3) te ketij Akti;
- “permbajtja kubike” kupton volumin kubik te nje strukture ose ndertese te matur nga jashte;
- “shtepi banimi” nuk perfshin ndertesa qe kane nje ose me shume apartamente, ose nje apartament te perfshire brenda nderteses;
- “ndertim” ka te beje me ndertesa sic percaktohen ne kete nen, dhe perfshin shtesa, ndryshime, dhe ri-ndertime;
- “ekzistuese” ben fjale per ndertesa ose fabrika ose makineri te perdorura (perjashtohen ato qe perkufizohen si “origjinale”) qe ekzistojne perpara se te fillojne punimet per zhvillim ne lidhje me ate ndertese, fabrike, makineri sic pershkruhen ne kete Urdherese;
- “apartament” nenkupton ndertime te brendshme, me ndarje, te ndertuara ose te pershtatura per qellime banimi, dhe qe perbejne pjese te nderteses qe ndahen horizontalisht nga njera tjetra;
- “siperfaqja e dyshemese” nenkupton hapesiren totale te dyshemese qe perfshihet ne nje ose disa ndertesa;
- “proces industrial” eshte procesi per te arritur qellimet sa me poshte—
 - (a) prodhimi i nje objekti/artikulli ose pjese te nje objekti/artikulli (duke perfshire ketu anije, filma ose video, ose incizime zeri);
 - (b) ndryshime, riparime, mirembajtje, vendosje ornamentesh, punime te brendshme, pastrime, larje, paketime, konservime, adaptime per shitje, thyerje apo rrezim i nje ndertese apo neni, ose

^(c) 1949 c.97; seksioni 87 eshte plotesuar nga seksioni 130 I paragrafit 1(12) te Skedules 8 te Aktit mbi Mbrojtjen e Mjedisit 1990 (c.43).

^(d) 1980 c.66.

- (c) nxjerrja, trajtimi, veshja e mineraleve ne kuadrin e cdo biznesi apo tregtie, pervec bujqesise, dhe pervec proceseve qe zbatohen ne toka te perdorura per miniera ose te bashkangjitura me nje miniere;
- “drenazhim i tokes” ka te njejtin kuptim si ne seksioni 116 te Aktit mbi Drenazhimin e Tokes 1976^(a) (interpretim);
- “ndertese ne liste” ka te njejtin kuptim si ne seksionin 1 te Aktit mbi Planifikimin (Ndertesa ne Liste dhe Zonat te Mbrojtura) 1990 ^(b) (listimi i ndertesave me interes te vecante historik ose arkitekturor);
- “ne reklamim lokal” do te thote botimi i reklames ne te pakten nje gazete qe qarkullon ne zonen lokale, ku perfshihet zona e mbrojtur;
- “makineri” perfshin cdo strukture apo ndertim qe ben pjese ne llojin e makinerive;
- “mikrovale” nenkupton spektrin e valeve te radios mbi 1,000 MHz;
- “antene me mikrovale” nenkupton nje antene satelitore ose nje antene tokesore mikrovalesh;
- “miniere” nenkupton cdo vend ku kryhen punime minerare;
- “punime minerare” do te thote nxjerrja apo gjetja e mineraleve me ane te punimeve nen ose mbitoke;
- “tubacion i shenuar” nenkupton nje tubacion, sic percaktohet ne seksionin 65 te Aktit mbi tubacionet 1962^(c) qe permban ose qe mund te permbaje substanca te rrezikshme, sic percaktohen ne ne rregullen 2(1) te Rregullores mbi Njoftimet pervec—
 - (a) tubacioneve, ndertimi i te cilave eshte autorizuar nen seksionin 1 te Aktit mbi Tubacionet 1962 (tubacionet qe nuk mund te ndertoehen pa miratimin e Ministrit); ose;
 - (b) tubacione qe nuk permbajne ose nuk parashikohet te permbajne substanca te rrezikshme pervec —
 - (i) gaze te ndezeshme (sic specifikohen ne piken 1 te Pjeses II te Aneksit 1 te Rregullores mbi Njoftimet (klasat e substancave te rrezikshme qe nuk specifikohen ne Pjesen I.) me trysni absolute me pak se 8 bar; ose;
 - (ii) leng ose perzierje lengjesh, sic specifikohet ne piken 4 te Pjeses II te ketij Aneksi;
- “Rregullorja mbi Njoftimet” do te thote Rregullorja mbi Njoftime per Instalime dhe Marrje me Substanca te Rrezikshme 1982 ^(d)
- “origjinale” do te thote: ka lidhje me nje ndertese qe ka ekzistuar me 1 Korrik 1948, ose nje ndertese qe eshte ndertuar ne ose pas 1 Korrikut 1948;
- “fabrike” perfshin cdo strukture ose ndertim qe ben pjese ne llojin e fabrikave;
- “rruge private” nenkupton nje autostrade qe nuk mirembahet me fondet e qeverise dhe cdo rruge tjetere qe nuk eshte autostrade;

^(a) 1976 c.70.

^(b) 1990 c.9.

^(c) 1962 c. 58

^(d) S.I. 1982/1357.

- o "autostrade e propozuar" ose planifikuar ka te njejtin kuptim si ne Aktin e Autostradave 1980 (dispozita te metejshme subjekt interpretimi);
- o "automjet i sherbimit publik" nenekupton nje automjet te sherbimit publik te perkufizuar ne seksionin 1 te Aktit mbi Automjetet Publike per Pasagjeret 1981 ^(a) (perkufizimi i mjeteve te transportit publik) ose nje tramvaj sipas kuptimit ne seksionin 192(1) te Aktit mbi Trafikun Rrugor 1988 ^(b) (interpretime te pergjithshme);
- o "antene satelitore" nenkupton aparatin e ndertuar per te transmetuar ose per te marre mikrovale radioje satelitore, ku perfshihet cdo montim ose shtese qe i eshte bere ketij aparati;
- o "monumente te planifikuara" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 1(11) te Aktit mbi Monumentet Antike dhe Zonat Arkeologjike 1979 ^(c);
- o "me afishim" nenkupton vendosjen e nje lajmerimi me ngjitje ne nje objekt, apo te ekspozuar ne menyre te tille qe te shihet e lexohet lehtesisht nga publiku;
- o "vende me interes arkeologjik" nenkupton token qe eshte perfshire ne planifikimin e monumenteve, te hartuar nga Sekretari i Shtetit nen seksionin 1 te Aktit mbi Monumentet Antike dhe Zonat Arkeologjike 1979, ose ne nje zone qe eshte percaktuar si zone me rendesi arkeologjike nen seksionin 33 te ketij Akti, ose qe eshte rregjistruar sipas rezolutes nga Keshilli i Qarkut dhe e njohur si "Tokat e Qarkut dhe Caktimi i Monumenteve";
- o "vend me interes te vecante shkencor" jane vendet ku aplikohet seksioni 28 (1) i Aktit mbi Rezervat Natyrore dhe Fshatrat 1981 ^(d);
- o "Sipermarres ligjore" perfshin pervec atyre qe permenden ne seksionin 262(1) te Aktit, Sherbimin Postar, Autoritetin e Aviacionit Civil, Autoritetin e Lumejve, cdo sipermarres ujqor, cdo furnizues karburanti dhe cdo person i licensuar sipas seksionin 64(1) te Aktit mbi Elektricitetin 1989^(e);
- o "antene mikrovale tokesore" nenkupton nje aparat per marrje ose transmetim te mikrovaleve te radios ne mes te dy pikave;
- o "rruge nacionale" nenkupton nje autostrade ose nje autostrade te propozuar qe perkufizohet si rruge nacionale nga seksioni 10(1) ose 19 i Aktit mbi Autostradat ^(f) (dispozita te pergjithshme per rruget nacionale, dhe rruge te vecanta, si dhe rruge te tjera qe do behen rruge nacionale) ose nga ndonje legjislacion tjeter;
- o "Urdheresa mbi Perdorimin e Klasave" do te thote Urdheresa mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1987 ^(g).

^(a) 1981 c. 14; seksioni 1 u shtua nga Aneksi 8 ne Aktin mbi Transportin 1985 (c.67).

^(b) 1988 c. 52.

^(c) 1979 c. 46.

^(d) 1981 c. 69.

^(e) 1989 c. 29.

^(f) 1980 c. 66; seksioni 19 u shtua nga seksioni 21(1) i Aktit mbi Rruget e Reja dhe Punimet ne Rruge 1991 (c.22).

^(g) S.I. 1987/764 i shtuar nga S.I. 1991/1567, 1992/610, 1992/657, 1994/724, 1995/297.

(3) Me perjashtim te disa rasteve me kontekst te vecante, cdo reference per lartesine e ndertesave, fabrikave apo makinerive ne kete urdherese, do te merret si reference e lartesis se matur nga niveli i tokes; dhe per qellim te ketij paragrafi "nivel toke" do te thote niveli i siperfaqes se tokes ngjitur me ndertesën, fabriken apo makinerine, ose ne rastet kur niveli i tokes nuk eshte i barabarte merret pika me e larte.

(4) Toka e referuar ne kete Urdherese si toke sipas nenit 1(4) eshte toke sic pershkruhet ne Pjesen 1 te Aneksit 1 te kesaj Urdherese.

(5) Toka e referuar ne kete Urdherese si toke sipas nenit 1(5) eshte toke sic pershkruhet ne Pjesen 2 te Aneksit 2 te kesaj Urdherese (Parqe Kombetare, zona me bukuri te rralle natyrore dhe zona te mbrojtura, etj.)

(6) Toka e referuar ne kete Urdherese si toke sipas nenit 1(5) eshte toke sic pershkruhet ne Pjesen 3 te Aneksit 1 te kesaj Urdherese (Parqe Kombetare dhe zona perreth).

Aplikime

2.—(1) Kjo urdherese aplikohet ne te gjithe territorin e Anglise dhe Uellsit, por ne rastet kur toka eshte nen nje urdherese te vecante per zhvillim, te nxjerre perpara ose pas fillimit te kesaj urdherese, kjo Urdherese do te aplikohet ne keto toka vetem me kusht modifikimi apo pershtatje sic kerkohet nga keto urdheresa te vecanta.

(2) Asgje ne kete Urdherese nuk aplikohet ne rastin e ndonje leje te dhene sipas seksionit 222 te Aktit (lejet per planifikim nuk nevojiten per reklama sipas rregullave).

Zhvillime te Lejuara

3.—(1) Sipas dispozitave te kesaj Urdherese dhe rregullave 60 dhe 63 te Rregullores mbi Mbrojtjen (Natyrore dhe Mjedisit) 1994 ^(a) leja per planifikim i jepet klasave per zhvillim qe kane leje per zhvillim sic pershkruhet ne Aneksin 2.

(2) Cdo leje e dhene si ne paragrafin (1) i nenshtrohet cdo perjashtimi, kushti apo kufizimi qe parashtrohet ne Aneksin 2.

(3) Referimet qe behen ne dispozitat e meposhtme te kesaj Urdherese, per lejet e dhena nga Aneksi 2 ose nga ndonje Pjese, Klase apo paragraf i

^(a) S.I. 1994/2716.

ketij Aneksi, kane te bejne me lejet qe jepen nga ky nen ne lidhje me zhvillimet e pershkruara ne ate Aneks ose ne ate dispozite te saj.

(4) Kjo urdherese nuk lejon zhvillime ne kundershtrim me ndonje kusht te vendosur nga ndonje leje per planifikim qe eshte dhene apo eshte vendosur per t'u dhene sipas Pjeses III te Aktit, pervec se nga kjo Urdherese.

(5) Leja qe jepet sipas Aneksit 2 nuk aplikohet ne qofte se:

- (a) leja jepet ne lidhje me nje ndertese ekzistuese, dhe veprimet per ndertime ne kete ndertese jane te paligjshme.
- (b) leja jepet ne lidhje me nje njesi ne perdorim, dhe perdorimi eshte i paligjshem.

(6) Lejet qe jepen sipas Aneksit 2 nuk autorizojne, pervec ne rastin e zhvillimeve te lejuara nga Pjeset 9, 11, 13, ose 30, zhvillime qe kerkojne ose kane te bejne me krijimin, shtrirjen, vendosjen e materialeve per hyrje ne nje autostrade ekzistuese qe eshte rruge nacionale ose rruge e klasifikuar, ose qe krijon pengese ne pamje per persona qe perdorin autostraden, si rrjedhim perben rrezik per keta persona.

(7) Cdo zhvillim qe perfshihet ne Pjesen 11 te Aneksit 2 ne pritje te nje miratimit ose leje, te autorizuar nga nje Akt apo urdherese, nuk do te konsiderohet nga kjo Urdherese si i autorizuar deri sa te merret leja apo autorizimi, me perjashtim te rasteve kur Akti apo urdheresa eshte miratuar perpara 1 Korrikut 1948, dhe perban dispozita ne kontradite me sa me siper.

(8) Aneksi 2 nuk jep leje per shtrirjen apo ndertimin e nje tubacioni, pervec ne rastet e lejeve per te shtrire nje tubacion te shenuar nga nje furnizues publik gazi ne perputhje me Klasen F te Pjeses 17 te ketij Aneksi.

(9) Pervec atyre qe parashtrohen ne Pjesen 31, Aneksi 2 nuk lejon ndonje zhvillim qe kerkon ose ka te beje me shembjen e nje ndertese, por ne kete rast me "ndertese" nuk nenkuptohen pjeset e nje ndertese.

(10) Kushtezuar nga paragrafi (12), zhvillimi nuk lejohet nga kjo Urdherese ne qofte se nje aplikim per leje planifikimi per kete zhvillim eshte nje aplikim i Aneksit 1 apo i Aneksit 2 sipas Rregullores mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave (Vleresimi i Ndikimit mbi Mjedisin) 1988 ("Rregullorja mbi Vleresimin e Mjedisit")^(b) (pershkrime tezhvillimit).

(11) Aty ku –

^(b) S.I. 1988/1199, shtuar nga S.I. 1990/367, 1992/1494 dhe 1994/677.

(a) Autoriteti planifikues lokal ka dhene nje opinion sic parashikohet ne rregullen 3 te Rregullores mbi Planifikimin e Qyteteve dhe Fshatrave (Vleresimi i Mjedisit dhe Zhvillimi me Leje) 1995 ("Rregullat e Zhvillimit me Leje")^(c) qe nje aplikim per nje zhvillim te caktuar eshte nje aplikim i Aneksit 1 apo i Aneksit 2 sipas kuptimit te Rregullores mbi Vleresimin e Mjedisit dhe kur Sekretari i Shtetit nuk ka dhene ndonje direktive per te kunderten nen rregullen 4 te Rregullores per Zhvillim me Leje (direktiva nga Sekretari i Shtetit); ose

(b) Sekretari i Shtetit ka dhe nje opinion sipas rregulles 5 te Rregullores per Zhvillim me Leje (zhvillim i propozuar ne te cilin ka interes nje autoritet planifikues perkates) qe nje aplikim per nje zhvillim te caktuar eshte i Aneksin 1 ose Aneksin 2 sipas kuptimit te Rregullores mbi Vleresimin e Mjedisit, zhvillimi me te cilin lidhet opinionin do te konsiderohet, sic parashtrohet ne paragrafin (10), si zhvillim qe nuk lejohet nga kjo Urdherese.

(12) Paragrafi (10) nuk aplikohet kur—

- (a) zhvillimi ka te beje ose eshte pjese e nje projekti qe i sherben qellimeve te mbrojtjes kombetare;
- (b) zhvillimi konsiston ne punet permiresuese ne kadrin e Rregullores mbi Punimet Permiresuese per Drenazhimin e Tokes (Vleresimi i Ndikimeve mbi Mjedisin) 1988^(b) qe kryen nje ent drenazhues ne kuadrin e Aktit per Drenazhimin e Tokes 1991^(a);
- (c) zhvillimi qe ka te beje me instalime te linjave elektrike (ne kuadrin e Pjeses 1 te Aktit mbi Elektricitetin 1989^(c) (furnizimi me energji elektrike)) qe zevendesojne linja ekzistuese (sic percaktohet ne rregullen 2 te Rregullores mbi Linjat e Siperme 1990^(d)) per te cilat nuk kerkohet miratim nen seksionin 37 te atij Akti sipas rregulles 3(1)(e) te kesaj Rregullore (perjashtime nga seksioni 37(1) i Aktit mbi Elektricitetin 1989); pa dyshim kur ne rethanat e permendura ne paragrafin (1)(a) ose (b) te rregulles 5 te kesaj Rregullore (kufizime te metejshme mbi perjashtimet ka ne rregullen 3) eshte percaktuar qe nuk do kete ndonje efekt te rendesishem negativ ne mjedis, jashte paragrafit (2);
- (d) zhvillimi qe ju eshte dhene leja nga Pjesa 7, Klasa D e Pjeses 8, Pjesa 11, Klasa B e Pjeses 12, Klasa B e Pjeses 12, Klasa F(a) e Pjeses 17, Klasa A ose Klasa B e Pjeses 20 ose Klasa B e Pjeses 21 te Skedules 2;
- (e) zhvillimi qe ju eshte dhene leja nga Klasa C ose Klasa D e Pjeses 20, Klasa A e Pjeses 21, ose Klasa B e Pjeses 22 te Skedules 2 ku toka e cila do zhvillohet eshte—

^(c) S.I. 1995/417

^(b) S.I. 1988/1217.

^(a) 1991 c. 59. Perkufizimi i nje "trupit drenazhues" mund te gjindet ne seksionin 72(1)

^(c) 1989 c. 29. Shih perkufizimin ne seksionin 64(1).

^(d) S.I. 1990/2035.

- (i) ne rastin e Klases C ose Klases D te Pjeses 20, ne te njejtin vend te autorizuar;
 - (ii) ne rastin e Klases A te Pjeses 21, ne te njejtat premisa, ose ne te njejtin toke minerare,
 - (iii) ne rastin e Klases B te Pjeses 22, ne te njejtin vend ose ne vendet ngjitur,
- ose zhvillime te lejuara nga e njejtja Klase qe jane kryer perpara 3 Qershorit 1995;
- (f) Kompletimi i zhvillimit ka filluar perpara 3 Qershorit 1995.

Direktiva qe kufizojne zhvillimin e lejuar

4.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit ose autoritete te planifikimit lokal perkates e konsiderojne te dobishme qe zhvillimet e pershkruara ne cdo Pjese, Klase ose paragraf ne Aneksin 2, pervec ne Klasen B te Pjeses 22 ose Klasen B te Pjeses 23, te mos behen pa ju dhene leje per nje aplikim, ai ose ata mund te japin direktive sipas ketij paragrafi qe leja e dhene nga neni 3 te mos aplikohet ne —

(a) te gjithë ose ne ndonje zhvillim sipas Pjeses, Klases ose paragrafit ne fjale ne zonat te specifikuara ne direktive; ose;

(b) cdo zhvillim i vecante, qe perfshihet ne ate Pjese, Klase apo paragraf, qe specifikohet ne direktive,

dhe direktiva duhet te specifikojë qe eshte bere nen kete paragraf.

(2) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal e konsideron te dobishme qe ndonje zhvillim i vecante i pershkruar ne paragrafin (5) me poshte nuk duhet te zbatohet ne nje pjese apo ne te gjithë zonen e cila eshte e mbrojtur, pervec ne rastet kur u eshte dhene leja ne aplikim, ata mund te nxjerrin direktive sipas ketij paragrafi qe leja e dhene sipas nenit 3 nuk do aplikohet ne nje ose disa zhvillime te Klases ne fjale brenda nje pjese apo te gjithë zones se mbrojtur, dhe direktiva do te specifikojë zhvillimin dhe mbrojtjen e zones ose pjeses se asaj zone per te cilen behet fjale ne kete paragraf.

(3) Direktiva qe nxirret sipas paragrafeve (1) ose (2) nuk prek zbatimin e -

(a) zhvillimeve me leje nga Pjesa 11 te autorizuar nga nje Akt i nxjerre pas 1 Korrikut 1948 ose nga nje Urdherese qe kerkon miratimin e te dy Dhomave te Parlamentit e miratuar pas kesaj date;

(b) cdo zhvillimi ne raste emergjence; ose

(c) cdo zhvillimi te permendur ne Pjesen 24, pervec ne rastet kur percaktohet keshtu specifikisht nga direktiva.

(4) Nje direktive e dhene ose me efekt si te ishte dhene sipas ketij neni, pervec ne qofte se percaktohet ne kete direktive, nuk do te ndikojë ne zbatimin nga nje sipermarres i autorizuar te zhvillimeve sa me poshte--

(a) mirembajtje e urave, ndertesave dhe stacioneve hekurudhore;

(b) ndryshime dhe mirembajtje te binareve te hekurudhave, dhe parapregatitje e mirembajtje te paisjeve te binareve, duke perfshire kutiat e sinjaleve, aparatet e sinjalizimit dhe aparate apo punime te tjera ne lidhje me levizjen e trafikut hekurudhor;

(c) mirembajtje e dokeve, skelave, moleve, kanaleve dhe vendeve te rimorkimit;

(d) pergatitja dhe mirembajtja e aparateve dhe paisjeve (perfshire paisjet per sinjalizim) qe duhen per qellime lundrimi ose ne lidhje me ngarkimin, shkarkimin, transportimin e pasagjereve, bagetive apo mallrave ne dok, skele, mol, banke apo liman;

(e) ndonje zhvillim qe kerkohet ne lidhje me permiresimin, mirembajtjen ose riparimin e drenazhimeve ose rrjedhjen e ujrave;

(f) mirembajtje e ndertesave, pistave te aerodromeve, parkime te taksive apo pjeseve te perparme te nje aerodromi;

(g) pergatitja, ndryshimi apo mirembajtja e paisjeve apo aparateve dhe punimeve ne nje aerodrom, qe kerkohen ne lidhje me levizjen e trafikut ajror (pervec ndertesave, konstrukteve, ngritjeve, rikonstrukcionin, ose ndryshime te lejuara nga Klasa A e Pjeses 18 te Aneksit 2).

(5) Zhvillimet qe permenden ne paragrafin (2) jane zhvillime te pershkruara ne—

(a) Klasen A te Pjeses 1 te Aneksit 2, qe konsistojne ne zgjerimin, permiresimin dhe modifikimet ne nje banese, ku ndonji pjese e zgjerimit, permiresimit apo ndryshimit eshte perballe nje vendi te rendeshishem;

(b) Klasen C te Pjeses 1 te ketij Aneksi, ku modifikimet do te behen ne nje ane catie qe ka perballe nje vend te rendeshishem;

(c) Klasen D te Pjeses 1 te ketij Aneksi, ku dera e jashtme ne fjale perballat me nje vend te rendeshishem;

(d) Klasen E te Pjeses 1 te ketij Aneksi, ku ndertesa ose rrethimi, pishina per not ose per qellime te tjera do perballen me nje vend te rendeshishem, ose kur pjese te ndertesës, rrethimit te mirembajtur, permiresuar a modifikuar, do te perballen me nje vend te rendeshishem;

(e) Klasen F te Pjeses 1 te ketij Aneksi, ku siperfaqja e ngurte do te perballat me nje vend te rendeshishem;

(f) Klasen H te Pjeses 1 te ketij Aneksi, kur pjeset e nje ndertese ose strukture mbi te cilen do ngrihet, modifikohet ose nderrohet antena satelitore do te perballen me nje vend te rendeshishem;

(g) Pjesen 1 te ketij Aneksi, qe konsiston ne ngritjen, modifikimin, heqjen e nje oxhaku ne nje shtepi banimi ose ne nje ndertese brenda oborrit te shtepise se banimit;

- (h) Klasen A te Pjeses 2 te ketij Aneksi, ku dera e jashtme, gardhi, murri rrethues ose ndonje mjet tjetër rrethues do jete brenda oborrit te shtepise se banimit dhe perballen me nje vend te rendesishem;
- (i) Klasen C te Pjeses 2 te ketij Aneksi, qe konsiston ne lysterjen e pjeses se jashtme qe perballen me nje vend te rendesishem, te nje—
 - (i) shtepie banimi; ose
 - (ii) cdo ndertese apo rrethimi ne kuadrin e oborrit te shtepise se banimit;
- (j) Klasen B te Pjeses 31 te ketij Aneksi, ku dera e jashtme, gardhi, muret dhe mjetet e tjera te rrethimit jane brenda oborrit te nje shtepie banimi dhe te perballen me nje vend te rendesishem;

(6) Ne kete nen dhe ne nenet 5 dhe 6—

- o "autoritet planifikimi lokal i pershtatshem" do te thote—
 - (a) ne zonat e mbrojtura ne nje qark jo-metropolitan, autoritet planifikues i qarkut ose autoriteti planifikues i rrethit; dhe
 - (b) ne zonat e tjera, autoriteti i planifikimit lokal, funksioni i te cilit eshte te percaktoje nje aplikim per leje planifikimi per zhvillimin me te cilin lidhet direktiva, ose qe propozohet te lidhet;
- o "vend te rendesishem" do te thote nje autostrade, rruge ujore apo hapësire.

Miratimi i Sekretarit te Shtetit per direktivat e nenit 4(1)

5.—(1) Me perjashtim te rasteve te percaktuara ne paragrafet (3) dhe (4), nje direktive nga nje autoritet planifikimi lokal nen nenin 4(1) kerkon miratimin e Sekretarit te Shtetit, i cili mund te miratoje direktiven me ose pa modifikime.

(2) Gjate nxjerrjes se nje direktive nen nenin 4(1) ose gjate paraqitjes se kesaj direktive per miratim nga Sekretari i Shtetit—

- (a) nje autoritet planifikimi qarkor duhet te njoftoje cdo autoritet planifikimi te rrethit me te cilin ka lidhje kjo direktive; dhe
- (b) pervec ne rrethet metropolitane, autoriteti i planifikimit ne rreth duhet te njoftoje autoritetin e qarkut, ne qofte se ekziston;

(3) Me perjashtim te rasteve kur direktiva ka te beje me nje zhvillim qe kryhet nga nje sipermarres i autorizuar sipas nenit 4(4), miratimi i Sekretarit te Shtetit nuk kerkohet kur direktiva ka te beje me—

- (a) nje ndertese te listuar;
- (b) nje ndertese qe i eshte paraqitur autoritetit nga Sekretari i Shtetit si ndertese me vlere arkitekture apo historike; ose;
- (c) zhvillime brenda oborrit te nje ndertese te listuar, dhe qe nuk lidhet me ndonje lloj tjetër toke.

(4) Ne varesi te paragrafit (6), miratimi i Sekretarit te Shtetit nuk kerkohet per nje direktive te nxjerre sipas nenit 4(1) ne lidhje vetem me zhvillimet me leje ne Pjeset 1, 4 ose 31 te Aneksit 2, ne qofte se autoriteti lokal perkates konkludon qe zhvillimi do influencoje planin ne zonen e tij ose kercenon sherbimet publike ne zone.

(5) Direktiva qe nuk kerkon miratimin e Sekretarit te Shtetit sipas paragrafit (4) skadon pas gjashte muajve nga data e nxjerrjes, me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe nga Sekretari i Shtetit.

(6) Paragrafi (4) nuk aplikohet per nje direktive te dyte ose pasuese qe lidhet me te njejtin zhvillim ose me zhvillime te se njejtës Klases ose te Klasave te njejtës, ne te njejtën zone ose pjese te se njejtës zone ne te cilën zbatohet direktiva e pare.

(7) Autoriteti i planifikimit lokal duhet ti jape kopje te cdo direktive qe nxjerr sipas paragrafit 4, Sekretarit te Shtetit jo me vone se data ku nxirret njoftimi per kete direktive ne perputhje me paragrafet (10) ose (12).

(8) Sekretari i Shtetit mund te njoftoje autoritetin e planifikimit lokal qe ka anuluar nje direktive dhe qe kjo direktive nuk eshte me ne fuqi.

(9) Autoriteti i planifikimit lokal duhet te nxjerre njoftimin sa me shpejt te jete praktikisht e mundur per anulimin e nje direktive ne te njejtën menyre sic eshte dhene njoftimi per nxjerrjen e saj.

(10) Ne varesi te paragrafit (12), autoriteti i planifikimit lokal do njoftoje sa me shpejt te jete praktikisht e mundur pas nxjerrjes, per cdo direktive te nxjerre sipas nenit (4), pronarin apo perdoruesin e cdo cepi te tokes qe perfshihet ne zonen e direktives; ne rastet kur direktiva duhet te miratohet nga Sekretari i Shtetit njoftimi behet sa me shpejt mbas marrjes se miratimit; dhe direktiva hyn ne fuqi per nje pjese te tokes ne zonen perkatese ne daten kur njoftimi i eshte dhene perdoruesit te tokes, ose ne qofte se nuk ka perdorues, pronarit.

(11) Ne qofte se nje direktive qe i nenshtrohet paragrafit (4) miratohet nga Sekretari i Shtetit brenda periudhes 6 mujore te permendur ne paragrafin (5), atehere (pervecse kur aplikohet paragrafi (12)) autoriteti qe ka pergatitur direktiven do te njoftoje per miratimin e saj, pronarin ose perdoruesin e tokes ne zonen e direktives sa me shpejt te jete praktikisht e mundur; dhe kur Sekretari i Shtetit e ka miratuar direktiven me modifikime atehere njoftimi duhet te sqaroje efektin e ketyre modifikimeve.

(12) Ne qofte se sherbimi individual ne perputhje me (10) ose (11), konsiderohet jo praktik per arsyet e parashtruara ne (14) nga nje autoritet per nje direktive sipas nenit 4(1)(a), atehere ky autoritet duhet te beje njoftimin per direktiven apo miratimin e saj me reklamim lokal.

(13) Nje njoftim i nxjerre sipas paragrafit (12) duhet te perfshije rezultatet e nje direktive dhe te cdo modifikimi te bere nga Sekretari i Shtetit, dhe duhet te perfshije emrin ose emrat e vendeve ku mund te gjendet dhe shikohet, brenda oreve te arsyeshme, kopje e direktives se bashku me harten e zones perkatese.

(14) Arsyet qe permenden ne paragrafin (12) jane: kur numri i pronareve apo perdoruesve ne zonen qe ka te beje me direktiven ben qe sherbimin individual te mos jete praktik, ose kur ka veshtiresi identifikimi ose lokalizimi te nje ose me shume prej tyre.

(15) Kur njoftimi per nje direktive eshte nxjerre ne perputhje me paragrafin (12), direktiva hyn ne fuqi ne daten kur njoftimi eshte nxjerre per here te pare.

(16) Nje autoritet planifikimi lokal mund te, - me nxjerrjen e nje direktive te mepasme dhe pa miratimin e Sekretarit te Shtetit, - anulloje cdo direktive qe ka nxjerre nen nenin 4(1), dhe Sekretari i Shtetit mund te nxjerre nje direktive qe anulon cdo direktive nen nenin 4(1) te nxjerre nga autoriteti i planifikimit lokal.

(17) Paragrafet (10) dhe (12) deri ne (15) do te aplikohen per cdo direktive te nxjerre nen paragrafin (16).

Lajmerimi dhe konfirmimi i direktivave te nenit 4(2)

6.—(1) Njoftimi mbi cdo direktive te nxjerre nen nenin 4(2) duhet te jepet nga autoriteti i planifikimit lokal, sa me pare qe te jete praktikisht e mundur pas nxjerrjes, --

(a) me reklamim lokal; dhe

(b) me njoftim te pronareve dhe perdoruesve te cdo shtepie banimi brenda nje pjese ose ne teresi te zones se mbrojtur me te cilen lidhet direktiva, duke ju nenshtruar paragrafeve (4) dhe (5).

(2) Njoftimi te cilit i referohet paragrafi (1) do te --

(a) perfshije nje pershkrim te zhvillimit dhe te zones se mbrojtur ose te pjeseve te saj qe kane te bejne me direktiven dhe pershkrim te efektit te direktives;

(b) specifikojte se kjo direktive nxirret nen nenin 4(2) te kesaj Urdherese;

(c) emrin e vendit ku ka kopje te direktives dhe hartes se zones se mbrojtur qe lidhet me direktiven, dhe ku keto kopje mund te shikohen ne cdo ore te arsyeshme;

(d) percaktoje nje periudhe prej te pakten 21 diteve, duke perfshire daten e fillimit te kesaj periudhe, brenda sejciles cdo verejtje qe lidhet me kete direktive mund te paraqitet perpara autoritetit te planifikimit lokal.

(3) Direktiva hyn ne fuqi ne lidhje me cdo pjese te nje terreni te mbrojtur ose pjese te nje zone --

(a) ne daten ne te cilen njoftimi i eshte bere perdoruesit te asaj pjese te tokes, ose ne qofte se nuk ka perdorues, pronarit; ose;

(b) ne rastet kur aplikohet paragrafi (4) dhe (5), ne daten kur nxirret per here te pare njoftimi ne perputhje me paragrafin (1)(a).

(4) Autoriteti i planifikimit lokal mund te mos i jape njoftimin individual pronarit ose perdoruesit ne perputhje me paragrafin (1)(b) ne rastin kur behet praktikisht e veshtire per ta gjetur apo identifikuar.

(5) Autoriteti i planifikimit lokal mund te mos jape njoftimin ne perputhje me paragrafin (1)(b) ne rastin kur numri i pronareve ose i perdoruesve brenda zones se mbrojtur ose nje pjese te saj, e ben njoftimin individual praktikisht te veshtire.

(6) Per nxjerrjen e nje direktive si ne nenin 4(2)—

(a) autoriteti planifikues i qarkut duhet te njoftoje cdo autoritet planifikues te rrethit ku perfshihet zona e mbrojtur ose pjese te saj qe kane te bejne me direktiven; dhe

(b) pervec se ne rrethet metropolitane, nje autoritet planifikues i rrethit duhet te njoftoje autoritetin planifikues te qarkut, ne qofte se ka nje te tille.

(7) Nje direktive sipas nenit 4(2) i mbaron afati ne fund te gjashte muajve nga data e nxjerrjes pervec ne rastet kur konfirmohet nga autoriteti planifikues lokal perkates ne perputhje me paragrafet (8) dhe (9) perpara mbarimit te afatit 6 mujor.

(8) Per te marre vendimin mbi konfirmimin e nje direktive te nxjerre sipas nenit 4(2), autoriteti planifikues lokal do te marre ne konsiderate cdo verejtje te marre gjate periudhes se percaktuar ne njoftim sipas paragrafit (2)(d).

(9) Autoriteti i planifikimit lokal nuk do konfirmoje direktiven perpara se te mbushen te pakten 28 dite nga data e dhenies se njoftimit te fundit ne lidhje me kete direktive.

(10) Autoriteti i planifikimit lokal perkates duhete te jape njoftimin per konfirmimin e nje direktive sa me shpejt te jete praktikisht e mundur ne te njejten menyre si ne paragrafet (1)(a) dhe (b) me siper.

Direktiva qe kufizojne zhvillimet me leje nen Klasen B te Pjeses 22 ose Klasen B te Pjeses 23

7.—(1) Ne qofte se pas marrjes se njoftimit nga cdo person qe propozohet per kryerjen e zhvillimit brenda Klases B te Pjeses 22 ose Klases B te Pjeses 23 te Aneksit 2, nje autoritet i planifikimit minerar eshte i bindur sipas paragrafit (2) me poshte, ata brenda nje periudhe 21 ditore qe nga fillimi i marrjes se njoftimit, mund te nxjerrin direktive qe leja e dhene sipas nenit 3 te kesaj Urdherese nuk aplikohet per kete zhvillim ose pjese te zhvillimit.

(2) Autoriteti i planifikimit minerar mund te nxjerre nje direktive nen sipas ketij neni ne qofte se jane te bindur se zhvillimi ose nje pjese e tij, mund te mos zbatohet perderisa leja t'i jepet ne nje aplikim sepse—

(a) toka ne te cilen do behet zhvillimi eshte brenda –

(i) nje Parku Kombetar,

(ii) nje zone me bukuri te vecante natyrore,

(iii) nje zone me interes arkeologjik, dhe kur punimet qe do kryhen nuk jane te pershkruara ne Aneksin e Urdhereses mbi Zonat me Rendesi Arkeologjike 1984 ^(a) (punime te perjashtuara)

(iv) nje zone me interes te vecante shkencor, ose

(v) the hapësirat e gjera te lumejve, liqeneve apo deteve;

(b) zhvillimi, i marre ne vecanti ose ne lidhje me zhvillime te tjera, qe po kryhet ne nje zone per te cilen eshte dhene njoftimi perkates ne perputhje me dispozitat e Klases B te Pjeses 22 ose Klases B te Pjeses 23, shkakton deme serioze ne zonen ku do zbatohet ose ndikon negativisht ne nje ndertese te cilesuar si e Shkalles I ne listen e ndertesave me interes te vecante arkitekturor apo historik te hartuar nga Sekretari i Shtetit nen seksioni 1 te Aktit mbi Planifikimin 1990 ^(b) (Ndertesa te Listuara dhe Zona te Mbrojtura) (krijimi i listave te ndertesave me interes te vecante arkitekturor apo historik);

(c) zhvillimi perben bezdi per banoret e ndertesave aty afer, spitaleve ose shkollave; ose

(d) zhvillimi do rrezikojte perdorimin e avioneve ne nje aerodrom fqinj.

(3) Nje direktive e bere sipas ketij neni do permbaje nje deklarate qe permban ditën ne te cilen hyn ne fuqi (ne qofte se nuk anulohet si ne

^(a) S.I. 1984/1286.

^(b) 1990 c. 9.

paragrafin (5) me poshte), qe do jete 29 dite nga dita kur njoftimi i dergohet Sekretarit te Shtetit ne perputhje me paragrafin (4) me poshte.

(4) Sa me shpejt qe te jete praktikisht e mundur, duhet t'i dergohet nga autoriteti i planifikimit minerar kopje e nje direktive Sekretarit te Shtetit dhe personit qe njoftoi mbi propozimin per zbatimin e ketij zhvillimi.

(5) Sekretari i Shtetit mund te anulloje direktiven, ne cdo kohe brenda periudhes 28 ditore duke filluar me datën ne te cilen u nxorr direktiva; dhe menjehere pas marrjes se njoftimit me shkrim nga Sekretari i Shtetit qe direktiva eshte anuluar, autoriteti i planifikimit minerar do njoftoje me shkrim personin qe ka dhene njoftimin e propozimit qe ai eshte i autorizuar te procedoje me zhvillimin.

Direktivat

8. Ndonje fuqi dhene nga kjo Urdherese per te nxjerre direktive perfshin fuqine per te anuluar ose ndryshuar direktiven me nje direktive pasuese.

Revokime

9. Instrumentet ligjore te specifikuara ne kolonen 1 te Aneksit 3 jane te revokuara ne shtrirjen e specifikuar ne kolonen 3.

Nenshkruar me:
21 Shkurt 1995
22 Shkurt 1995

Nga:
Sekretari i Shtetit per Mjedisin
Sekretari i Shtetit per Uellsin

ANEKSI 1

PJESA 1:

NENI 1(4) TOKA

Toka qe perfshihet ne qarqet e meposhtme—
Cleveland, Cornwall, Cumbria, Devon, Durham, Dyfed, Greater Manchester, Gwynedd, Humberside, Lancashire, Merseyside, Northumberland, North Yorkshire, South Yorkshire, Tyne and Wear, West Glamorgan, West Yorkshire.

PJESA 2:

NENI 1(5) TOKA

Toka brenda -

- (a) nje Parku Kombetar;
- (b) nje zone me bukuri te vecante natyrore;
- (c) nje zone te caktuar nen mbrojtje sipas seksionit 69 te Aktit mbi Planifikimin (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) 1990 ^(a) (caktimi i zonave te mbrojtura);
- (d) nje zone te caktuar nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri i Bujqesise, Peshkimit dhe Ushqimit per qellime te seksionit 41(3) te Aktit mbi Zonat Natyrore dhe Fshatare 1981 ^(b) (zgjerimi dhe mbrojtja e bukurive natyrore dhe pasurive te fshatit);
- (e) the pejsazhet e gjera ujore.

PJESA 3:

NENI 1(6) TOKA

Toka brenda nje Parku Kombetar ose ne zonat e meposhtme—
(a) (Shenim: Emrat e zonave te vecanta dhe parqeve kombetare jane listuara per gjithe Angline dhe Uellsin. Shih dokumentin origjinal.)

^(a) 1990 c. 9.

^(b) 181 c.69.

ANEKSI 2

PJESA 1

ZHVILLIMI BRENDA PARCELES TE NJE SHTEPIE BANIMI

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

Zhvillimi
nuk lejohet

A. Zgjerimi, permiresimi ose ndryshime te tjera ne shtepite e banimit

- A.1 Nuk jepet leja per zhvillim nga Klasa A ne qofte se—
- (a) madhesia kubike e ndertesës qe rezulton pas zhvillimit kalon madhesine kubike te shtepise origjinale te banimit me —
 - (i) ne rastin e nje shtepie me tarrace ose ne rastin e nje shtepie banimi ne tokat e nenit 1(5), me me shume 50 m³ ose 10%, cilado qe te jete me e madhe;
 - (ii) ne cdo rast tjetër, me me shume se 70 m³ ose 15%, cilado te jete me e madhe,
 - (iii) ne cdo rast me me teper se 115 meter kub;
 - (b) pjesa e ndertesës e zgjeruar, permiresuar ose ndryshuar eshte me e larte se pjesa me e larte e catisë se shtepise origjinale te banimit;
 - (c) pjesa e ndertesës e zgjeruar, permiresuar ose ndryshuar do jete me afer nje autostrade qe lidh parcelen me shtepine e banimit se—
 - (i) pjesa me e afert me autostraden e shtepise origjinale, ose
 - (ii) ndonje pjese e saj eshte 20 metra nga autostrada cilado nga keto dyja te jete me afer autostrades.
 - (d) pervec rasteve te vendosjes, zgjerimit, permiresimit, ose ndryshimeve te tjera te nje dritareje ne nje mur ekzistues te nje shtepie banimi, pjesa e ndertesës qe zgjerohet, permiresohet, ose ndryshohet, do jete brenda 2 metrave nga kufiri i parces se shtepise dhe i kalon 4 metra lartesi;
 - (e) e gjithe pjesa e tokës e zene nga ndertesa brenda parces (pa llogaritur shtepine origjinale te

banimit) kalon 50% te te gjithë zones se parceles (pa llogaritur shtepine origjinale te banimit);

- (f) zhvillimi perfshin instalimin, levizjen ose nderrimin e nje antene satelitore;
- (g) zhvillimi konsiston apo perfshin ngritjen e nje ndertese brenda parceles se nje ndertese te listuar; ose
- (h) konsiston ose perfshin nje ndryshim te pjeseve te catise.

A.2 Ne rastin kur kemi nje shtepi banimi nga tokat e permendura ne nenin 1(5), zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A, ne qofte se konsiston apo perfshin veshjen e ndonje pjese te jashtme me gure, gure artificial, dru, materiale plastike ose pllaka.

Interpretime te Klases A

A.3 Per qellime te Klases A--

(a) ngritja e nje ndertese brenda parceles me madhesi qe kalon 10 m³ do trajtohet si zgjerim te shtepise se banimit per te gjithë qellimet (duke perfshire edhe llogaritjen e permasave kubike) kur—

(i) shtepia e banimit eshte ne token e nenit 1(5), ose

(ii) ne cdo rast tjeter, kur nje pjese e nderteses eshte brenda 5 metrave largesi nga nje pjese e shtepise se banimit;

(b) Kur ndonje pjese e shtepise se banimit eshte brenda 5 metrave larg nga nje ndertese ekzistuese brenda te njejtës percele, kjo ndertese do trajtohet si pjese e nderteses perfundimtare, per qellime llogaritje permasash.

Klasa B Zhvillimi Lejohet

Zhvillimi
nuk lejohet

B. Zgjerimi i nje shtepie banimi konsiston ne shtese apo ndryshim te catise se saj.

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—

- (a) si rezultat i punimeve, ndonje pjese e shtepise se banimit, kalon lartesine e pjeses me te larte te catise ekzistuese;
- (b) si rezultat i punimeve, ndonje pjese e shtepise se banimit, shtrihet pertej planit ekzistues te anes se catise qe ndodhet nga ana e autostrades;
- (c) permasat kubike te shtepise se banimit do rriten me me shume se 40 m³ ne rastet e shtepive me tarrace, ose 50 m³ ne cdo rast tjeter;

- (d) permasat kubike te nderteses se perfunduar kalojne permasat kubike te nderteses origjinale —
 - (i) me me shume se 50 m³ ose 10%, cilado qe te jete me e madhe, ne rastet kur shtepia eshte me tarrace;
 - (ii) 70m³ ose 15%, cilado qe eshte me e madhe, per cdo rast tjeter, ose
 - (iii) me meshume se 115 m³, ne ndonje rast; ose
- (e) shtepia e banimit eshte ne token e permendur ne nenin 1(5).

Klasa C: Zhvillimi Lejohet

Zhvillimi
lejohet

C. Ndryshime te tjera ne catite e shtepive te banimit

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C ne qofte se nuk rezulton ne ndryshimin material te formes se shtepise se banimit.

Klasa D: Zhvillimi Lejohet

Zhvillimi
nuk lejohet

D. Ngritja ose konstruksioni i nje verande jashte cdo dere te jashtme te nje shtepie banimi.

D.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa D ne qofte se —

- (a) shtrirja e struktures i kalon 3 meter katror;
- (b) ndonje pjese e kesaj strukture eshte me teper se 3 meter lartesi nga niveli i tokes; ose
- (c) ndonji pjese e kesaj strukture eshte 2 meter a me pak larg nga kufiri i parceles te nje shtepie banimi qe bie ne autostrade.

Klasa E: Zhvillimi Lejohet

Zhvillimi
nuk lejohet

E. Dispozitat per brenda parceles se nje shtepie banimi, te nje ndertese apo rrethimi, pishine noti apo lloj tjeter qe duhet per qellim argetimi ne shtepi, ose mirembajtja, permiresimet, ose ndryshime te tjera mbi kete ndertese a rrethim.

E.1 Zhvillimet nuk lejohen nga Klasa E ne qofte se --

- (a) lidhen me nje antene satelitore;
- (b) ndonje pjese te nderteses ose te rrethimit qe do ndertohej do te jete afer ndonje autostrade —

1. se pjesa me e afert me autostraden e shtepise origjinale, ose
 2. ndonje pike me largesi 20 m nga autostrada, cilido rast te jete me afer autostrades.
- (c) ne rastet kur ndertesa qe do ndertohet ka nje madhesi kubike me te madhe se 10 m³, ndnje pjese e saj eshte 5 metra larg shtepise se banimit;
- (d) lartesia e ndertimit kalon –
- (i) 4 metra, ne rastin kur ndertesa ka nje cati me kulm; ose
 - (ii) 3 metra ne cdo rast tjetër;
- (e) zona e pergjithshme e mbuluar me ndertime brenda parces (pervec shtepise origjinale) i kalon 50% te zones se pergjithshme te parces (duke perjashtuar zonen e shtepise origjinale); ose
- (f) ne rastin e ndonje zone te percaktuar ne nenin 1(5) ose toke e perfshire ne parcelen e nje ndertese te listuar, ndertimi konsiston ne ndryshimet e permiresimet e nje ndertese me nje madhesi qe kalon 10 meter kub.

Interpretime
te klases E

E.2 Per qellim te Klases E—

“qellim argetimi” perfshin mbajtjen e pulave, bleteve, kafsheve shtepiake, zogjve, ose kafsheve te tjera per nevoja shtepiake ose kenaqesi personale te banoreve te shtepise se banimit.

Klasa F:
Zhvillimi
Lejohet

F. Dispozitat brenda parces te siperfaqeve te forta per qellime argetimi ne banese.

Klasa G:
Zhvillimi
Lejohet
Zhvillimi
nuk lejohet

G. Ngritja brenda parces e depozitave per te mbajtur nafte per ngrohjen e baneses.

G1. Zhvillimet nuk lejohen nga klasa G ne qofte se –

- (a) kapaciteti i depozites kalon 3,500 litra;
- (b) ndonji pjese e depozites eshte me e larte se 3 metra nga toka; ose
- (c) ndonje pjese e depozites eshte me afer ndonje autostrade se –
 - (i) pjesa me e afert e baneses origjinale me kete autostrade,ose
 - (ii) 20 metra nga autostrada,

cilido rast te jete me afer autostrades aplikohet.

Klasa H:
Zhvillimi
Lejohet

H. Instalimi, ndryshimet, ose zevendesimi, i nje antene satelitore ne nje shtepi banimi ose brenda parces se nje shtepie banimi.

Zhvillimi
nuk lejohet

H.1 Zhvillimet nuk lejohen nga Klasa G ne qofte se –

- (a) permasat e antenes (me perjashtim te elementeve qe perforcojne anet e saj, montimin dhe mbeshtetesen) kur matet me cfaredo dimensionit kalojne—
 - (i) 45 centimetra ne rastin kur antena instalohet mbi nje oxhak;
 - (ii) 90 centimetra ne rastet kur antena instalohet mbi ose brenda parces te nje shtepie banimi ne zonat e nenit 1(4) me perjashtim te oxhakit;
- (b) pjesa me e larte e antenes qe instalohet ne cati ose oxhak do kaloje lartesine –
 - (i) e pjeses me te larte te catise, ne rastin kur antena instalohet ne cati;
 - (ii) e pjeses me te larte te oxhakit, ne rastin kur antena instalohet mbi oxhak;
- (c) ekzistojne antena te tjera satelitore mbi cati ose ne parces;
- (d) ne rastin kur toka i perket zonave te nenit 1(5) antena do instalohet mbi—
 - (i) nje oxhak;
 - (ii) mbi nje ndertese qe kalon lartesia 15 metra;
 - (iii) mbi nje mur ose cati qe eshte ne anen e nje autostrade ose rruge ujore ne rastin e pejsazheve ujore.

Kushte:

H.2 Zhvillimet lejohen nga Klasa H me kushtet e meposhtme—

- (a) antena e instaluar ne ndertese te jete e vendosur ne menyre te tille qe te minimizojne sa me shume te jete e mundur ndikimin e saj ne pamjen e jashtme te nderteses;
- (b) nje antene qe nuk perdoret me per transmetimin ose marrjen e mikrovalëve te radios do te hiqet sa me shpejt te jete e mundur.

Interpretime
te Pjeses 1

I. Per qellime te Pjeses 1--

- “ndertesa qe rezulton pas zhvillimit” do te thote ndertesa e banimit e zgjeruar, permiresuar, ose ndryshuar, duke marre per baze cdo zgjerim, permiresim apo ndryshim qe i eshte bere ndertesese origjinale, ne qofte se lejohen ose jo nga kjo Pjese; dhe;
- “tarrace e shtepise” do te thote nje shtepi banimi qe ndodhet ne mes te 3 ose me shume shtepive te tjera te banimit te perdorura ose te projektuara per qellim banimi, ku
 - (a) ndan nje mur ndares ose ka nje mur kryesor qe bashkohet me murin kyesor te baneses tjeter; ose
 - (b) eshte ne fund te nje radhe, ndan nje mur ndares ose ka nje mur kryesor qe bashkohet me murin kyesor te baneses tjeter;

PJESA 2: **PUNIME TE VOGLA**

Klasa A: **Zhvillimi** **Lejohet**

Zhvillimet nuk lejohen

A. Ngritja konstruksioni mirembajtja, permiresimet ose ndryshimet ne nje porte te jashtme, gardh, mur ose menyre tjeter rrethimi.

- A1. Zhvillimet nuk lejohen nga Klasa A ne qofte se -
- (a) lartesia e nje porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi te ngritura ose te ndertuara prane nje autostrade, pas punimeve kalon nje meter mbi nivelin e tokes;
 - (b) lartesia e cfaredo porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi kalon dy metra mbi nivelin e tokes;
 - (c) lartesia e ndonje porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi te mirembajtur, ndryshuar, apo permiresuar, si rezultat i zhvillimit, kalon lartesine e meparshme ose lartesine e percaktuar ne paragrafet (a) dhe (b) si lartesia e pranueshme kur ndertohen, cilado qe te jete me e madhe.
 - (d) Zhvillimi ka te beje me percelen nje ndertese te listuar.

Klasa B: **Zhvillimi** **Lejohet**

Klasa C: **Zhvillimi** **Lejohet**

Zhvillimi nuk Lejohet

B. Formimi, shtrirja, dhe konstruksioni i menyrave te lidhjes me autostraden qe nuk eshte nje rruge private ose e klasifikuar, ku kjo lidhje ka te beje me zhvillimin elejuar nga ndonje Klase ne kete Aneks (pervec Klases A te kesaj Pjese).

C. Lyerja e pjeseve te jashtme te nje ndertese ose punimi.

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C kur lyerja ka per qellime reklamimi, njoftimin ose dhenien e drejtimeve.

C.2 Ne Klasen C, “lyerje” perfshin aplikimin e ngjyrave.

PJESA 3 **NDRYSHIMET NE PERDORIM**

Klasa A: **Zhvillimi** **Lejohet**

Klasa B: **Zhvillimi** **Lejohet**

A. Zhvillimet qe konsistojne ne ndryshimin e perdorimit te nje ndertese per perdorime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit, nga perdorime qe bien ne Klasen A3 (ushqime dhe pije) te ketij Aneksi ose nga perdorime per shitje, ose nxjerrje per shitje, te automjeteve.

B. Zhvillimet qe konsistojne ne ndryshimin e perdorimit te nje ndertese—

- (a) ne perdorime per qellime brenda Klases B1 (biznes) te Aneksit se Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit nga ndonje perdorim qe bie ne Klasen B8 (magazinim dhe shpendarje) te ketij Aneksi;
- (b) ne perdorime per qellime qe bien ne Klasen B8 (magazinime dhe shpendarje) te atij Aneksi nga perdorime qe bien ne Klasen B1 (biznes) ose B2 (industrie ne pergjithesi).

- “ndertesa qe rezulton pas zhvillimit” do te thote ndertesa e banimit e zgjeruar, permiresuar, ose ndryshuar, duke marre per baze cdo zgjerim, permiresim apo ndryshim qe i eshte bere ndertesese origjinale, ne qofte se lejohen ose jo nga kjo Pjese; dhe;
- “tarrace e shtepise” do te thote nje shtepi banimi qe ndodhet ne mes te 3 ose me shume shtepive te tjera te banimit te perdorura ose te projektuara per qellim banimi, ku
 - (a) ndan nje mur ndares ose ka nje mur kryesor qe bashkohet me murin kyesor te baneses tjeter; ose
 - (b) eshte ne fund te nje radhe, ndan nje mur ndares ose ka nje mur kryesor qe bashkohet me murin kyesor te baneses tjeter;

PJESA 2: **PUNIME TE VOGLA**

Klasa A: **Zhvillimi** **Lejohet**

A. Ngritja konstruksioni mirembajtja, permiresimet ose ndryshimet ne nje porte te jashtme, gardh, mur ose menyre tjeter rrethimi.

Zhvillimet
nuk lejohen

- A1. Zhvillimet nuk lejohen nga Klasa A ne qofte se –
- (a) lartesia e nje porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi te ngritura ose te ndertuara prane nje autostrade, pas punimeve kalon nje meter mbi nivelin e tokes;
 - (b) lartesia e cfaredo porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi kalon dy metra mbi nivelin e tokes;
 - (c) lartesia e ndonje porte, gardhi, muri ose menyre rrethimi te mirembajtur, ndryshuar, apo permiresuar, si rezultat i zhvillimit, kalon lartesine e meparshme ose lartesine e percaktuar ne paragrafet (a) dhe (b) si lartesia e pranueshme kur ndertohen, cilado qe te jete me e madhe.
 - (d) Zhvillimi ka te beje me percelen nje ndertese te listuar.

Klasa B: **Zhvillimi** **Lejohet**

B. Formimi, shtrirja, dhe konstruksioni i menyrave te lidhjes me autostraden qe nuk eshte nje rruge private ose e klasifikuar, ku kjo lidhje ka te beje me zhvillimin elejuar nga ndonje Klase ne kete Aneks (pervec Klases A te kesaj Pjese).

Klasa C: **Zhvillimi** **Lejohet**

C. Lyerja e pjeseve te jashtme te nje ndertese ose punimi.

Zhvillimi
nuk Lejohet

- C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C kur lyerja ka per qellime reklamimi, njoftimin ose dhenien e drejtimeve.
- C.2 Ne Klasen C, “lyerje” perfshin aplikimin e ngjyrave.

PJESA 3 **NDRYSHIMET NE PERDORIM**

Klasa A: **Zhvillimi** **Lejohet**

A. Zhvillimet qe konsistojne ne ndryshimin e perdorimit te nje ndertese per perdorime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit, nga perdorime qe bien ne Klasen A3 (ushqime dhe pije) te ketij Aneksi ose nga perdorime per shitje, ose nxjerrje per shitje, te automjeteve.

Klasa B: **Zhvillimi** **Lejohet**

- B. Zhvillimet qe konsistojne ne ndryshimin e perdorimit te nje ndertese—**
- (a) ne perdorime per qellime brenda Klases B1 (biznes) te Aneksit se Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit nga ndonje perdorim qe bie ne Klasen B8 (magazinim dhe shpendarje) te ketij Aneksi;
 - (b) ne perdorime per qellime qe bien ne Klasen B8 (magazinime dhe shpendarje) te atij Aneksi nga perdorime qe bien ne Klasen B1 (biznes) ose B2 (industrie ne pergjithesi).

Zhvillimi
nuk lejohet

B.1 Zhvillimet nuk lejohen nga Klasa B kur ndryshimet ne perdorim bien brenda Klases B8 te ketij Aneksi, ne qofte se ndryshimet ne perdorim lidhen me me shume se 235 meter katror te siperfaqes se ndertesës.

Klasa C:
Zhvillimet
e Lejuara

C. Zhvillime qe konsistojne ne ndryshime ne perdorim, ne perdorime qe bien ne Klases A2 te Skedules se Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit (sherbime financiare dhe profesionale) nga nje perdorim qe bie brenda Klases A3 (ushqime dhe pije) te ketij Aneksi.

Klasa D:
Zhvillimet
e Lejuara

D. Zhvillime qe konsistojne ne ndryshime ne perdorim te cdo ndertese me dritare vitrine ne katin e perdhës ne perdorime qe bien ne Klases A1 (dyqane) te Aneksit se Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit nga perdorime qe bien ne Klases A2 (sherbime financiare dhe profesionale) te ketij Aneksi.

Klasa E:
Zhvillimet
e Lejuara

E. Zhvillime qe konsistojne ne ndryshime ne perdorim te nje ndertese ose te ndonje toke me leje te dhene ne aplikim, ne nje perdorim tjeter per te cilin eshte dhene leja ne aplikim.

Zhvillimi
nuk lejohet

E.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa E ne qofte se—

- (a) aplikimi per leje planifikimi eshte bere perpara dates 5 Dhjetor 1988;
- (b) do te zbatohet pas me shume se 10 vjeteve nga dhenia e lejes per planifikim; ose
- (c) do rezultojte ne thyerjen e ndonji kushti, kufizimi, ose specifikimi percaktuar ne lejen e dhene ne lidhje me perdorimin ne fjale.

Klasa F:
Zhvillimet
e Lejuara

F. Zhvillime qe konsistojne ne ndryshim ne perdorim te ndertesës—

- (a) ne perdorime te ndryshme per qellime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit dhe si apartament i vetem, nga perdorime brenda Klases A1 te ketij Aneksi;
- (b) ne perdorime te ndryshme per qellime brenda Klases A2 (sherbime financiare dhe profesionale)

te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit dhe si apartament i vetem, nga perdorime brenda Klases A2 te ketij Aneksi;

(c) kur ndertesa ka nje dritare vitrine ne katin perdhës, ne perdorime te ndryshme per qellime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit dhe si apartament i vetem, nga perdorime per qellime brenda Klases A2 (sherbime financiare dhe profesionale) te ketij Aneksi.

Kushte:

F1. Zhvillimet e lejuara nga Klasa F u nenshtrohen ketyre kushteve—

- (a) disa ose te gjitha pjeset e ndertesës te perdorura per qellime qe bien brenda Klases A1 ose Klases A2, te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit, do te vendoset ne pjesen e poshtme te ndertesës nen pjesen qe perdoret si nje apartament;
- (b) kur zhvillimi konsiston ne nje ndryshim ne perdorim te cdo ndertese me nje dritare vitrine ne katin perdhës, kati perdhës nuk mund te perdoret ne teresi ose pjeserisht si apartament banimi;
- (c) apartamenti nuk duhet te perdoret per qellime te tjera pervec se per banim (si banese kryesore ose jo)—
 - (i) nga nje person i vetem ose nga njerez qe jetojne se bashku si familje, ose
 - (ii) nga jo me shume se gjashte persona qe jetojne se bashku si nje familje (duke perfshire edhe rastet kur ka banore qe kerkojne perkujdesje nga te tjeret).

Interpretime
te Klases F

“perkujdesje” do te thote kujdesje per njerez qe kane nevojë per arsye te moshës se madhe, invaliditet, varesi ne te kaluaren ose te tashmen ndaj alkoholit ose droges, persona me probleme mendore.

Klasa G:
Zhvillimet
e Lejuara

G. Zhvillime qe konsistojne ne ndryshimin e perdorimit te ndertesës—

- (a) ne nje perdorim per qellime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit nga nje perdorim i ndryshem per qellime brenda Klases A1 te ketij Aneksi dhe per nje apartament te vetem;

- (b) ne nje perdorim per qellime brenda Klases A2 (sherbime financiare dhe profesionale) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit nga perdorime te ndryshme per qellime brenda Klases A2 dhe per nje apartament te vetem;
- (c) ne rastet kur ndertesa ka dritare vitrine ne katin perdhes, ne perdorim per qellime brenda Klases A1 (dyqane) te Aneksit te Urdhereses mbi Klasat e Perdorimit, nga perdorime te ndryshme per qellime brenda Klases A2 (sherbime financiare dhe profesionale) te ketij Aneksi dhe per nje apartament te vetem.

Zhvillimi
nuk lejohet

G1. Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa G vetem kur pjeset e ndertesës te perdorura si apartament kane qene perdorur, heren e fundit perpara ketij zhvillimi, per ndonje qellim brenda Klases A1 ose Klases A2 te Aneksit te Urdhereses mbi Klasate Perdorimit.

PJESA 4

NDERTESA DHE PERDORIME TE PERKOHESHME

Klasa A:
Zhvillime
te Lejuara

A. Dispozitat e tokes se ndertesave, strukturave te levizshme, punimeve, fabrikave, ose makinerive qe duhen per perdorim te perkohshme ne lidhje me punimet dhe per kohezgjatjen e ketyre punimeve, qe do te zbatohen mbi, nen ose ne krah te kesaj toke.

Zhvillimi
nuk Lejohet

A1. Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—

- (a) punimet e permendura me siper jane punime minerare, ose
- (b) kur kerkohet leje per planifikim per keto punime, por nuk eshte dhene akoma.

Kushte

A2. Zhvillimi lejohet nga Klasa A me kushtet qe kur te perfundojne punimet —

- (a) cdo ndertese, strukture, punim, punishte, apo makineri te lejuar nga Klasa A do te zhvendoset, dhe

- (b) cdo toke ngjitur qe eshte perdorur sipas Klases A, te vendoset ne gjendjen e meparshme, si perpara fillimit te punimeve per zhvillimin, sa me shpejt te jete e mundur.

Klasa B:
Zhvillime
te Lejuara

B. Perdorimi i nje toke per cfaredo qellimi per jo me teper se 28 dite gjithsej brenda nje viti kalendarik, nder te cilat 14 dite gjithsej mund te jene per qellime qe referohen ne paragrafin B.2, dhe dispozitat e cdo strukture te levizshme ne toke per qellime te perdorimit me leje.

Zhvillimi
nuk Lejohet

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—

- (a) toka ne fjale eshte nje ndertese ose eshte per brenda parceses/truallit te nje ndertese,
- (b) toka perdoret si vend karvani;
- (c) toka eshte me interes te vecante shkencor dhe perdorimi i saj ka te beje me —
- qellime qe i referohet paragrafi B.2(b) ose sporte te tjera motorike;
 - gjuajtje te pellumbave prej balte; ose
 - me ndonje loje tjeter lufte,
- ose
- (d) toka perdoret per te bere nje reklamim.

Interpretime
Klases B

B2. Qellimet e permendura ne Klasen B me siper te jane—

- (a) krijimi i nje tregu;
- (b) gara motorcikletash, ose makinash, duke perfshire matje te shpejtesive dhe stervitjet per keto aktivitete.

B3. Ne Klasen B, "loje lufte" do te thote nje lufte imagjinare, e skenuar, e zhvilluar me arme qe nuk jane projektuar te demtojne (duke perfshire bombat tymuese, pushket ose granadat qe gjuajne boje ose lende te tjera per te shenuar pjesemarresit), dhe qe perjashton ndonje aktivitet ushtarak ose stervitje te organizuar nga autoritete te Sekretarit te Shtetit per Mbrojtjen.

PJESA 5

VENDET E KARVANEVE

Klasa A: Zhvillime te Lejuara

A. Perdorimi i tokes, qe nuk i perket nje ndertese, si nje vend karvanesh ne rrethanat e referuara ne paragrafin A.2.

Kushte:

A.1 Zhvillimi lejohet nga Klasa A me kushtin qe mund te nderpritet kur rrethanat e specifikuara ne paragrafin A.2 nuk ekzistojne me, dhe te gjithë karvanet duhet te zhvendosen nga vendi sa me shpejt te jete praktikisht e mundur.

Interpretime:

A.2 Rrethanat e permendura ne Klasen A jane ato te specifikuara ne paragrafet 2 deri ne 10 te Skedules 1 te Aktit te vitit 1960 (rastet kur nuk kerkohet licenca per vend karvanesh), por ne lidhje me ato qe permenden ne paragrafin 10 nuk perfshin perdorimin per muajt e dimrit.

Klasa B: Zhvillime te Lejuara

B. Zhvillimet qe duhen per kushtet e licences se vendit per periudhen qe eshte ne fuqi Akti i vitit 1960.

PJESA 6

NDERTESAT DHE PUNIMET BUJQESORE

Klasa A: Zhvillime te Lejuara

Zhvillimet ne njesite me 5 hektare e me siper:

A. Punimet sa me poshte, ne nje toke bujqesore qe perfshihen ne nje njesi prej 5 a me shume hektarësh, --

- (a) punime per ngritjen, zgjerimin, ndryshimin e nje ndertese; ose**
- (b) ndonje ekskavim ose punim inxhinierik, qe jane te nevojshme per qellime bujqesore ne ate njesi.**

Zhvillimi

A1. Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—

nuk Lejohet

- (a) zhvillimi do te zbatohet ne nje parcele te ndare qe perben pjese te nje njesie me te vogel se nje hektar;
- (b) konsiston ne, ose perfshin, ngritjen, zgjerimin ose ndryshimin e nje ndertese banimi;
- (c) perfshin dispozitat e nje ndertese, strukture apo punimi, qe nuk eshte projektuar per qellime bujqesore;
- (d) toka qe do mbulohet nga ---
 - ndonje punim apo strukture (pervec gardheve) per te strehuar bagetine ose ndonje fabrike apo makineri qe duhen per punime inxhinierike; ose
 - ndonji ndertese e ngritur, zgjeruar, ose ndryshuar, per qellimet e permendura te Klases A,
 - qe kalon 465 meter katror, te llogaritur sic pershkruhet ne paragrafin D.2 me poshte;
- (e) lartesia e nje pjese te ndonje ndertese, strukture apo punimi brenda 3 km te perimetrit te nje aerodromi, i kalon 3 metrat;
- (f) lartesia e nje pjese te ndonje ndertese, strukture apo punimi jo brenda 3 km te perimetrit te nje aerodromi, i kalon 12 metrat;
- (g) ndonje pjese e zhvillimit eshte brenda 25 metrave largesi me pjesen e mbrojtetes se metalizuar te nje rruge private apo te klasifikuar;
- (h) konsiston apo perfshin ngritjen, ndertimin apo zbatimin e punimeve ne nje ndertese, strukture apo ekskavim te perdorur ose qe do perdoret per strehimin e bagetive ose per magazinimin e ujrave te zeza, ku kjo ngritje, ndertim apo ekskavim eshte, ose do jete, brenda 400 metrave te parcelës se nje ndertese te mbrojtur; ose
 - perfshim ekskavime ose punime inxhinierike, ne tokat e nenit 1(6) qe lidhen me kultivimin e peshkut.

Kushte:

A.2(1) Zhvillimet lejohen nga Klasa A me kushtet e meposhtme—

- (a) aty ku zhvillimi zbatohet brenda 400 metrave nga parcela e nje ndertese te mbrojtur, cdo ndertese, strukture, ekskavim qe rezulton nga zhvillimi nuk do te perdoret per strehimin e bagetive pervec ne rrethanat e pershkruara ne paragrafin D.3 me poshte ose per magazinimin e ujrave te zeza.
- (b) kur zhvillimi perfshin —

- nxjerrjen e ndonje minerali nga toka (ku perfshin edhe levizjen e dheut ne nje hekurudhe qe nuk perdoret); ose
 - nxjerrjen e ndonje minerali nga nje vend punimi minerar,
 - minerali nuk duhet te zhvendoset nga njesia;
- (c) mbeturinat nuk duhet te sillen ne toke nga diku tjeter per t'i depozituar pervec per perdorim ne punime te pershkruara ne Klasen A(a) ose ne dispozitat e nje siperfaqe te forte, dhe cdo material i sjellur do te perfshihet ne ndertese ose ne punimet ne fjale.
- (2) Kushtezuar nga paragrafi (3), zhvillimi qe konsiston ne --
- (a) ngritjen, zgjerimin ose ndryshimin e nje ndertese;
- (b) krijimin ose ndryshimin e nje rruge private;
- (c) punime ekskavimi ose depozitimi mbeturinash (ku zona perkatese sic perkufizohet ne D.4 me poshte, i kalon 0.5 hektare); ose
- (d) vendosjen ose montimin e nje depozite ne vende ujore;
- lejohet nga Klasa A me kushtet e meposhtme-
1. perpara se te fillojne punimet zhvilluesi duhet te aplikojte tek autoriteti lokal per te vendosur nese kerkohet aprovim paraprak i autoritetit per vendosjen, projektimin dhe pamjen e jashtme te nje ndertese, vendosjen dhe menyren e ndertimit te nje rruge private, vendosjen e nje ekskavimi ose depozite, ose pamjen e jashtme te nje depozite;
 2. aplikimi duhet te shoqerohet me nje pershkrim me shkrim te zhvillimit te propozuar dhe nje plan te gjithe vendit te punimeve, dhe me pagesen e kerkuar;
 3. zhvillimi nuk duhet te filloje perpara se te realizohet njera nga pikat meposhte--
 - (aa) aplikanti merr nga autoriteti i planifikimit lokal nje njoftim me shkrim ku konfirmohet qe nuk kerkohet aprovim paraprak;
 - (bb) kur autoriteti i planifikimit lokal i jep aplikantit brenda 28 diteve pas dates se marrjes se aplikimit njoftim per vendimin qe kerkohet aprovim paraprak; dhenia e nje aprovimi te tille;

- (cc) mbarimi i afatit prej 28 diteve qe pasojne daten e marrjes se aplikimit nga autoriteti lokal, pa u marre asnje vendim nga autoriteti lokal nese aplikimi kerkohet ose pa dhenie njoftimi per ndonje vendim;
4. ose
- (aa) kur autoriteti i planifikimit lokal i jep aplikantit njoftimin qe kerkohet aprovim paraprak, aplikanti duhet te nxjerre nje njoftim per vendin e punimeve se bashku me pamje te ketij vendi ne ose afer tokes ku propozohet zhvillimi, duke e lene njoftimin jo me pak se 21 dite ne periudhen prej 28 diteve nga data ne te cilen autoriteti i planifikimit lokal dha njoftimin aplikuesit;
 - (bb) kur njoftimi eshte hequr, prishur apo bere i palexueshem perpara periudhes 21 ditore te referuar sa me siper (aa), pa ndonje qellim apo faj nga aplikanti, aplikanti do te konsiderohet qe i ka permbushur kerkesat ne qofte se ka marre masa te arsyeshme per te mbrojtur lajmerimin, duke perfshire edhe zevendesimin e tij, ne qofte se ka nevojte;
5. pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit lokal vendos ndryshe, zhvillimi do te zbatohet --
- (aa) kur aprovimi paraprak kerkohet, ne perputhje me detajet e aprovuara;
 - (bb) kur aprovimi paraprak nuk kerkohet, ne perputhje me detajet te paraqitura me aplikimin; dhe
6. zhvillimi do te zbatohet --
- (aa) kur aprovimi eshte dhene nga autoriteti i planifikimit lokal, dhe brenda periudhes 5-vjecare nga data ne te cilen eshte dhene aprovimi;
 - (bb) ne ndonje rast tjeter, brenda periudhes 5-vjecare nga data ne te cilen autoriteti i planifikimit lokal ka marre informacionin te cilit i referohet paragrafi (d)(ii).

(3) Kushtet ne paragrafin (2) nuk aplikohen ne rastet e zgjerimit apo ndryshimit te nje ndertese ne qofte se ndertesa nuk eshte ne tokat sipas nenit 1(6) pervec se ne rastet e ndonje zgjerimi ose ndryshimi te konsiderueshem.

(4) Zhvillimet qe konsistojne ne zgjerime apo ndryshime te konsiderueshme te nje ndertese mund te zbatohen vetem sipas Klases A(a).

**Klasa B:
Zhvillime
te Lejuara**

Zhvillimet ne njesi me me pak se 5 hektare

B. Punime ne toka bujqesore te perfshira ne nje njesi bujqesore me te madhe se 0.4 hektare dhe me te vogel se 5 hektare ne nje zone zhvillimi qe konsiston ne -

1. zgjerimin ose ndryshimin e nje ndertese bujqesore;
2. instalimin e ndonje makinerie apo punishte shtese, ose zevendesimin e atyre ekzistuese;
3. dispozitat, riorganizimin ose zevendesimin e nje grope te zeze, kanali te ujrave te zezave, tubi, ose ndonje aparati tjeter;
4. dispozitat, riorganizimi ose zevendesimi i nje rruge private;
5. dispozitat e nje siperfaqe te forte;
6. depozita e mbeturinave; ose
7. zbatimin e ndonje punimi ne lidhje me kultivimin e peshkut, si per shembull, riparimi i rezervuarve ose pellgjeve; instalimin e makinerive per matje te ndryshme, paisje ventilimi, mateset e rrjedhjeve; thellimin e pellgjeve; dhe zevendesimin e depozitave dhe rrjetave,

ne qofte se zhvillimi eshte i nevojshem per te realizuar qellime bujqesore brenda kesaj njesie toke.

Zhvillimi
nuk lejohet

B1. Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—

- (a) zhvillimi do te zbatohet ne nje parcele te vecante qe formon nje njesi me te vogel se 0.4 hektare;
- (b) pamja e jashtme e ndertesave do te ndryshohet materialisht;
- (c) ndonje pjese e zhvillimit do jete brenda 25 metrave largesi nga nje pjese e mbrojtese e metalizuar e nje rruge ose rruge te klasifikuar;
- (d) konsiston ose perfshin zbatimin e punimeve ne nje ndertese ose strukture te perdorur ose qe perdoret per strehimin e bagetive ose per depozitimin e ujrave te zeza, kur ndertesa apo struktura eshte

brenda 400 metra largesi nga parcela e nje ndertese te mbrojtur;

- (e) lidhet me kultivimin e peshkut dhe perfshin vendosjen e nje depozite ne toke ose uje, ose ndertimin e nje pellgu ku do rritet peshk ose nje zgjerim i nje depozite ose pellgu ku rritet peshku;

B.2 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B(a) ne qofte se -

- (a) lartesia e nje ndertese do rritet;
- (b) permbajtja kubike e nje ndertese origjinale do rritet me me teper se 10%;
- (c) cdo pjese e nje ndertese te re eshte me teper se 30 metra larg nga ndertesa origjinale;
- (d) zhvillimi perfshin zgjerimin, ndryshimin ose dispozitat e nje banese;
- (e) ndonje pjese e zhvillimit do te zbatohet brenda 5 metrave nga vija e kufirit te nje njesie; ose
- (f) shtrirja tokesore e nje ndertese te zgjeruar sipas Klases B(a) i kalon 465 metra katror.

B.3 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B(b) ne qofte se -

- (a) lartesia e ndonje makinerie a punishte shtese, qe eshte brenda 3 kilometrave largesi me nje aeroport, i kalon 3 metrat;
- (b) lartesia e ndonje makinerie apo punishte shtese qe nuk eshte brenda 3 kilometrave largesi me nje aeroport i kalon 12 metrat;
- (c) lartesia e ndonje makinerie apo punishte te zevendesuar e kalon lartesine e makinerise apo punishtes origjinale; ose
- (d) zona qe mbulohet nga zhvillimi kalon 465 meter katror te llogaritur sic pershkruhet ne paragrafin D.2 me poshte.

B.4 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B(e) ne qofte se zona e mbuluar nga zhvillimi i kalon 465 meter katror te llogaritur sic pershkruhet ne paragrafin D.2 me poshte.

Kushte:

B.5 Zhvillimi i lejuar nga Klasa B dhe i zbatuar brenda 400 metrave te parcelave se nje ndertese te mbrojtur i nenshtrohet kushtit sipas te cilit nje ndertese e zgjeruar apo e ndryshuar, ose cdo punim rezultuar nga zhvillimi nuk do te perdoret per strehimin e bagetive pervec rasteve te pershkruara ne paragrafin D.3 me poshte per depozitimin e ujrave te zeza.

B.6 Zhvillime qe konsistojne ne zgjerimin apo ndryshimin e nje ndertese qe gjendet ne tokat e parashikuara nga neni 1(6) ose dispozitat, riorganizimi ose zevendesimi i nje rruge private ne toka te tilla lejohet kur u nenshtrohen –

- (a) kushtit qe zhvilluesi, perpara se te filloje zbatimin, do te aplikojte tek autoriteti i planifikimin lokal per te percaktuar nese aprovim paraprak kerkohet per vendosjen, projektimin dhe pamjen e jashtme te nje ndertese qe do zgjerohet apo ndryshohet, ose vendosjen dhe mjetet per ndertimin e nje rruge private; dhe
- (b) kushteve te percaktuara ne paragrafet A.2(2)(ii) deri (iv) me siper.

B.7 Zhvillimi lejohet nga Klasa B(f) pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

- (a) mbeturinat nuk sillen ne toke nga diku tjeter per depozitim pervec ne qofte se perdoren per punime te pershkruara ne Klasen B(a), (d) ose (e) dhe jane inkorporuara me ndertesën ose punimet ne fjale; dhe
- (b) lartesia e siperfaqes se tokes nuk do te rritet materialisht nga depozitimi.

Klasa C: Zhvillime te Lejuara

Punime minerale per qellime bujqesore:

C. Punimet ne toka te zena me perdorime per qellime bujqesore te cdo minerali te nevojshem per qellime bujqesore brenda njesise bujqesore ne te cilen perfshihet.

Zhvillimi
nuk Lejohet

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C ne qofte se ndonje eskavim do behet brenda 25 metrave largesi nga pjesa e metalizuar e nje rruge ose rruge te klasifikuar;

Kushte:

C.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa C pasi i nenshtrohet kushtit qe asnje mineral i nxjerre gjate punimeve do te zhvendoset ne ndonje vend jashte tokes nga e cila u nxorr, pervec rasteve kur toka eshte e zene dhe perdoret per qellime bujqesore.

Interpretime
te Pjeses 6

D.1 Per qellime te Pjeses 6 –

- “toke bujqesore” do te thote toke e cila perpara se te zbatohet zhvillimi i lejuar ne kete Pjese eshte toke qe perdoret per bujqesi dhe e cila perdoret me qellim tregtie dhe biznesi, dhe ku perjashtohen banesat dhe kopshtet;
- “njesi bujqesore” do te thote toke bujqesore e cila perdoret si njesi per qellime bujqesore, duke perfshire—
 - o ndonje shtepi banimi ose ndertese tjeter ne ate toke te perdoruar per qellime punimi toke nga personi qe zoteron kete njesi, ose
 - o ndonje shtepi banimi te njerezve qe punojne token;
- “ndertese” nuk perfshin dicka qe rezulton nga punime inxhinierike;
- “kultivim peshku” nenkupton shumimin, rritjen ose mbajtjen e peshkut ku perfshihen edhe molusqet (qe perfshin te gjithë llojet me guaske) ;
- “prodhime deti” perfshin peshqit ose molusqet te cilet kultivohen;
- “ndertese nen mbrojtje” do te thote cdo ndertese permanente qe normalisht eshte zene me njerez, ose do te zihet, dhe qe perdoret per qellimet e duhura, por qe perjashton—
 - o nje ndertese brenda njesise bujqesore; ose
 - o nje ndertese banimi ne nje njesi bujqesore tjeter qe perdoret per ose ne lidhje me pune bujqesore;
- “zgjerim i konsiderueshem” ose “ndryshim i konsiderueshem” do te thote cdo zgjerim apo ndryshim te nje ndertese ku madhesia kubike e ndertesës origjinale kalohet me me shume se 10% ose kur lartesia e ndertesës pas zgjerimit apo ndryshimit eshte me e madhe se lartesia e ndertesës origjinale;
- “jashteqitje” do te thote fekalet dhe urina e kafsheve (edhe ne rastet kur u eshte shtuar uje per perpunim); dhe
- “depozite” perfshin cdo kafaz apo strukture tjeter per tu perdorur per kultivimin e peshkut.

D.2 Per qellime te Pjeses 6–

- (a) nje zone e llogaritur sic pershkruhet ne kete paragraf perben zonen qe do te mbulohet nga zhvillimi, se bashku me token e ndonje ndertese (pervec shtepi banimi), ose te nje strukture, makinerie, punishte, pellgu apo depozite, brenda se

njejtes njesi, qe ekziston apo qe eshte krijuar ne dy vitet e fundit dhe ku cdo pjese e se ciles eshte brenda 90 metrave largesi nga zhvillimi i propozuar;

(b) 400 metra duhet te maten perreth tokes.

D.3 Rrethanat e referuara ne paragrafin A.2(1)(a) dhe B.5 jane—

- (a) qe nuk ekziston ndertese ose strukture tjeter per strehimin e bagetive, 400 m ose me larg nga parcela/trualli i nje ndertese te mbrojtur; dhe
- (b) (i) nevoja per te strehuar bageti del nga —
- (aa) kerkesat per karantine; ose
- (bb) nje emergjence shkaktuar kur nje ndertese apo strukture tjeter nuk mund te strehoje bageti per arsye te demtimeve a shkaterrimeve nga zjarri, permbytja apo stuhia; ose
- (ii) ne rastin kur bagetite mbahen normalisht perjashta, ato kerkojne strehim te perkohshem ne nje ndertese apo strukture --
- (aa) sepse jane semure ose duke lindur apo te porsalindur; ose
- (bb) per strehim ne kushte ekstreme te motit.

D.4 Per qellimet e paragrafit A.2(2)(c), zona perkatese eshte zona e nje ekskavimi te propozuar ose zona ne te cilen eshte propozuar te depozitohen mbeturinat se bashku me zonat e te gjitha ekskavimeve te tjera brenda njesise qe nuk jane mbushur dhe te gjitha pjeset e njesise ne ose nen te cilat jane depozituar dhe qe nuk jane hequr mbeturinat.

D.5 Ne paragrafin A.2(2)(iv), "njoftim per vendin e punimeve" do te thote nje njoftim qe permban—

- (a) emrin e aplikantit,
- (b) adresen ose vendosjen e zhvillimit te propozuar,
- (c) nje pershkrim te zhvillimit te propozuar dhe te materialeve qe do te perdoren,
- (d) nje thene qe kerkohet aprovimi paraprak i autoritetit per vendosjen, projektin, pamjen e jashtme te nje ndertese, vendosjen dhe menyren e ndertimit te nje rruge private, vendosjen e nje ekskavimi ose depozite ose vendosjen dhe paraqitjen e nje rezervuari peshku, dhe sipas rastit,
- (e) emrin dhe adresen e autoritetit te planifikimit lokal, si dhe nenshkrimi i aplikantit dhe data e nenshkrimit.

D.6 Per qellime te Klases B—

- (a) ngritja e nje ndertese shtese brenda parceses se nje ndertese tjeter do te trajtohet si shtese e asaj ndertese dhe ndertesa shtese nuk do trajtohet si nje ndertese origjinale;
- (b) kur ka dy ose me shume ndertesa origjinale brenda te njejtes parcele dhe perdoren per te njejtin qellim ato do te trajtohen si nje ndertese e vetme origjinale ne lidhje me zgjerimin ose ndryshimin e ndonjeres prej tyre.

D.7 Ne Klasen C, "qellime bujqesore" perfshin pleherimin e tokes se perdorur per qellime bujqesore dhe mirembajtjen, permiresimin apo ndryshimin e ndonje ndertese, strukture te perdorur per qellime te tilla ne token e lartpermendur.

PJESA 7

PUNIME DHE NDERTESA PYLLTARIE

Klasa A: **Zhvillime** **te Lejuara**

Zhvillimi
nuk Lejohet

- A. Zbatimi ne toka te pyllezuara, perfshire pyllezimin, e zhvillimeve te aresyeshme per qellime qe konsistojne ne --**
- (a) punime per ngritjen, zgjerimin, ose ndryshimin e nje ndertese;
- (b) krijimin apo ndryshimin e nje rruge private;
- (c) punime ne ate toke per te siguruar lendet e nevojshme per krijimin, ndryshimin apo mirembajtjen e rruges te tilla;
- (d) punime te tjera (me perjashtim te punime inxhinierike dhe minerare).

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—

- (a) konsiston ose perfshin dispozitat ose ndryshimin e nje banese;
- (b) lartesia e nje ndertese brenda perimetrit te 3 kilometrave nga nje aeroport i kalon 3 metra; ose
- (c) cdo pjese e nje zhvillimi eshte brenda 25 metrave largesi nga nje pjese mbrojtese e metalizuar e rruges ose rruges se klasifikuar;

A.2(1) Duke ju nenshtruar paragrafit (3), zhvillimi konsiston ne ngritjen e nje ndertese ose ne zgjerimin apo ndryshimin e nje ndertese, ose ndryshimin e nje rruge private lejohet nga Klasa A me kushtet e meposhtme—

- (a) perpara se te filloje zhvillimi, zhvilluesi duhet te aplikojte prane autoritetit te planifikimit lokal per nje vendim nese duhet aprovim paraprak nga ky autoritet per vendosjen, projektimin dhe pamjen e jashtme te nje ndertese, ose, vendosjen, dhe materialet e ndertimit te nje rruge private;
- (b) aplikimi do te shoqerohet me nje pershkrim me shkrim te zhvillimit te propozuar, materialeve qe do te perdoren, dhe nje plan qe tregon gjithë vendin e punimeve se bashku me ndonje pagese qe kerkohet;
- (c) zhvillimi nuk duhet te filloje pa u realizuar njera nga pikat me poshte—
 - (i) aplikanti merr nga autoriteti i planifikimit lokal nje njoftim me shkrim qe aprovimi paraprak nuk kerkohet;
 - (ii) marrja e aprovimit, ne rastet kur autoriteti i planifikimit lokal i jep aplikuesit njoftim me shkrim brenda 28 diteve nga data e marrjes se aplikimit se nje aprovim i tille kerkohet;
 - (iii) mbarimi i afatit 28 ditore nga data ne te cilen aplikimi u mor nga autoriteti i planifikimit lokal pa u marre asnje vendim nga ky autoritet nese aprovim paraprak kerkohet ose pa njoftuar aplikuesin per ndonje vendim;
- (d) ose
 - (i) ne rastin kur autoriteti i planifikimit lokal njofton aplikuesin se kerkohet aprovimi paraprak aplikuesi duhet te nxjerre nje njoftim mbi vendin e punimeve, ne ose prane tokes ne te cilen zhvillimi i propozuar do te zbatohet, duke e lene njoftimin e shpallur per jo me pak se 21 dite brenda periudhes 28 ditore nga data ne te cilen autoriteti i planifikimit lokal i dha njoftimin aplikuesit;
 - (ii) kur njoftimi zhvendoset, behet i palexueshem, apo shkaterrohet perpara mbarimit te periudhes 21 ditore sic referohet ne nen-paragrafin (i), pa fajin apo qellimin e aplikantit, ai do te konsiderohet sikur i ka permbushur kerkesat e ketij nene-paragrafi pasi ka marre masa te aresyeshme per

mbrojtjen e njoftimit, qofte edhe per zevendesimin e tij po qe nevoja;

- (e) pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit lokal vendos ndryshe me shkrim, zhvillimi do te zbatohet —
 - (i) kur aprovim paraprak kerkohet ne perputhje me detajet e aprovuara;
 - (ii) kur aprovim paraprak nuk kerkohet, ne perputhje me detajet e paraqitura ne aplikim;
- (f) zhvillimi do te zbatohet—
 - (i) kur aprovimi eshte dhene nga autoriteti i planifikimit lokal, dhe brenda periudhes 5-vjecare nga data ne te cilen jepet aprovimi,
 - (ii) ne cdo rast tjeter, brenda nje periudhe 5-vjecare nga data ne te cilen autoriteti i planifikimit lokal ka marre informacionin te referuar ne nen-paragrafin (b).

(2) Ne rastet kur zhvillimi konsiston ne zgjerim te konsiderueshem ose ndryshim te konsiderueshem te nje ndertese, nje zhvillim i tille mund te zbatohet vetem nje here.

(3) Paragrafi (1) nuk pengon zgjerimin ose ndryshimin e nje ndertese, ne qofte se nuk eshte ne tokat e nenit 1(6), pervec rasteve kur kemi zgjerime te konsiderueshme apo ndryshime te konsiderueshme.

Interpretime te Klases A

A.3 Per qellime te Klases A—

- “zgjerim i konsiderueshem” dhe “ndryshim i konsiderueshem” do te thote cdo zgjerim apo ndryshim te nderteses ku madhesia kubike e nderteses origjinale kalohet me me teper se 10%, ose kur lartesia e nderteses pas ndryshimeve apo zgjerimeve eshte me e madhe se lartesia e asaj origjinale;
- “njoftim per vendin e punimeve” do te thote nje njoftim qe permban—
 - (a) emrin e aplikantit,
 - (b) adresen ose vendosjen e zhvillimit te propozuar,
 - (c) nje pershkrim te zhvillimit te propozuar dhe te materialeve qe do te perdoren,
 - (d) nje thenje qe kerkohet aprovimi paraprak i autoritetit per vendosjen, projektin, pamjen e jashtme te nje ndertese, ose vendosjen dhe

- menyren e ndertimit te nje rruge private, dhe sipas rastit,
- (e) emrin dhe adresen e autoritetit te planifikimit lokal,
- (f) si dhe nenshkrimi i aplikantit dhe data e nenshkrimit.

PJESA 8

ZHVILLIMET INDUSTRIALE DHE MAGAZINAT

Klasa A: Zhvillime me Leje

Zhvillimi
nuk lejohet

A. Zgjerime ose ndryshime ne ndertesa industriale ose magazina.

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se –
- (a) ndertesa pasi zgjerohet apo ndryshohet do perdoret per qellime te tjera nga ato te permendura;
- (b) ndertesa do perdoret per qellim tjeter nga sa me poshte--
- (i) ne rastin e nje ndertese industriale, per realizimin e nje procesi industrial ose per dispozitat e ambjenteve te punonjesve;
- (ii) ne rastin e nje magazine, per magazinim, ose shperndarje, ose dispozita te ambjenteve te punetoreve;
- (c) lartesia e nderteses se zgjeruar apo ndryshuar kalon lartesine e nderteses origjinale;
- (d) madhesia kubike e nderteses origjinale kalohet me me teper se --
- (i) 10% ne rastin kur zhvillimi behet ne tokat qe perfshihen ne nenin 1(5), ose
- (ii) 25% ne cdo rast tjeter;
- (e) siperfaqja e dyshemese te nderteses origjinale kalohet me me teper se—
- (i) 500 meter katror ne rastin e zhvillimeve ne tokat qe perfshihen ne nenin 1(5), ose
- (ii) 1000 meter katror ne cdo rast tjeter;
- (f) pamja e jashtme e nderteses qe perdoret per qellimet mesiper do te ndryshohet materialisht;
- (g) ndonje pjese e zhvillimit do kryhet brenda 5 metrave largesi nga ndonje paqrcele; ose

- (h) zhvillimi do sjelle reduktimin ne hapesine te siperfaqes se parkimit dhe te kthimit te automjeteve.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A me kushtet qe cdo ndertese e zgjeruar apo e ndryshuar—

- (a) do te perdoret vetem –
- (i) ne rastin e ndertesave industriale, per realizimin e nje procesi industrial per qellime te caktuara ose per dispozitat e ambjenteve te punonjesve;
- (ii) ne rastin e magazinave, per magazinimin ose shperndarjen per qellime te caktuara ose per dispozitat e ambjenteve te punonjesve;
- (b) nuk do te perdoret per ambjente te punonjesve prej ores 7:00 te darkes deri me 6:30 te mengjezit, per punonjes te tjere pervec atyre qe po kryejne detyren;
- (c) nuk do te perdoret per ambjente te punonjesve ne qofte se ekziston ne ndertese nje sasi e konsiderueshme te substancave te rrezikshme.

Interpretime
te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A—

- (a) ngritja e ndonje ndertese shtese brenda parceles se nje ndertese tjeter (sipas percaktimeve ose jo te Klases A) dhe qe perdoret ne lidhej me te, duhet te trajtohet si pjese e kesaj ndertese, dhe ndertesa shtese nuk do trajtohet si ndertese origjinale;
- (b) kur dy ose me shume ndertesa origjinale ndodhen brenda te njejtës parcele dhe perdoren per te njejtin qellim, duhet te trajtohen si nje ndertese e vetme origjinale kur behen matjet;
- (c) “ambjente te punonjesve” nenkupton ambjente shoqerore, argetuese dhe shlodhese per punonjesit, qe perfshin edhe cerdhe per femijet e tyre.

Klasa B: Zhvillim me Leje

- B. Zhvillimet e zbatuara ne tokat industriale per qellime industriale qe konsistojne ne –**
- (a) instalimin e makinerive ose punishteve shtese,
- (b) dispozitat, riorganizimin, ose zevendesimin e gropave te ujrave te zeza, kanaleve, tubacioneve, ose aparateve te tjera, ose
- (c) dispozitat, riorganizimin, ose zevendesimin e rrugeve private, hekurudhave private, etj.

Zhvillimi

nuk lejohet

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B (a) ne qofte se—
 (a) ndryshon materialisht pamjen e jashtme te nderteses ku zhvillohet aktiviteti ne fjale, ose
 (b) ndonje punishte apo makineri kalon lartesine 15 metra mbi nivelin e tokes, ose lartesine e asaj te zevendesuar, merret cilado nga keto lartesi qe te jete me e madhe.

Interpretime
te Klases B:

B.2 Ne Klases B "toke industriale" do te thote toke e perdorur per kryerjen e nje procesi industrial, duke perfshire toka qe perdoren per qellime te aktiviteteve industriale si nje liman, port apo skele, por nuk perfshin toka te zena ose prane nje miniere.

**Klasa C:
Zhvillim
me Leje**

C. Dispozitat e nje siperfaqeje te forte brenda parces se nje ndertese industriale ose magazine qe perdoren per aktivitete te caktuara.

**Klasa D
Zhvillim
me Leje**

D. Depozitimi i mbeturinave qe rezultojne nga proceset industriale ne nje toke e cila eshte perdorur per nje qellim te tille me 1 Korrik 1948 pa patur parasysh nese siperfaqja ose lartesia e depozites eshte rritur si rezultat i depozitimit.

Zhvillimi
nuk lejohet

D.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa D ne qofte se—
 (a) mbeturinat perfshijne materiale qe rezultojne nga nxjerrja dhe punimi i mineraleve, ose
 (b) toka perdorej me 1 Korrik 1948 per depozitimin e materialeve qe rezultojne nga nxjerrja dhe punimi i mineraleve.

Interpretime
te Pjeses 8:

E. Per qellime te Pjeses 8 ne Klasat A dhe C—
 "ndertese industriale" do te thote nje ndertese qe perdoret per kryerjen e nje procesi industrial dhe qe perfshin nje ndertese te perdorur per kryerjen e nje procesi te tille ne toke qe perdoret si liman, port, apo skele per qellime industriale, por nuk perfshin ndertesa ne toka prane ose te zena me miniera.

PJESA 9

RIPARIME TE RRUGEVE TE PAADOPTUARA DHE RRUGEVE PRIVATE

**Klasa A:
Zhvillime
me Leje:**

A. Kryerja e punimeve per mirembajtjen ose permiresimin e rrugeve te paadoptuara ose rrugeve private, ne toka brenda kufijve te rrugeve private apo te paadoptuara.

Interpretime
te Klases A

A.1 Per qellime te Klases A—
 "rruge e pa-adoptuar" do te thote nje rruge qe nuk eshte nje autostrade e mirembajtur me shpenzime publike sipas kuptimit te Aktit mbi Autostradat 1980^(a).

PJESA 10

RIPARIME TE SHERBIMEVE PUBLIKE

**Klasa A:
Zhvillime
me Leje**

A. Kryerja e punimeve per qellime inspektimi, riparimi, ose rinovimi te ndonje kanali ujrash te zeza, tubi, ose aparati tjeter, duke perfshire edhe germimin e tokes per qellime te tilla.

PJESA 11

ZHVILLIME NEN AKTE DHE URDBERESA LOKALE APO PRIVATE

**Klasa A:
Zhvillime
te Lejuara**

**A. Zhvillimet e autorizuara nga --
 (a) nje Akt lokal ose privat i Parlamentit,**

^(a) 1980 c.66.

- (b) nje urdherese nga te dyja Dhomat e Parlamentit, ose
- (c) nje urdherese nen seksionin 14 ose 16 te Aktit mbi Portet 1964^(b) (urdhera per sigurimin e eficences se porteve, etj., dhe urdhera per kompetencat per permiresimin, ndertimin, etj., te porteve)
- te cilat percaktojne sakte natyren e zhvillimit te autorizuar dhe token mbi te cilen do realizohet.

Kushte:

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se konsiston ne ose perfshin—
- (a) ngritjen, ndertimin, ndryshimin ose zgjerimin, e ndonje ndertese, ure, ujesjellesi, dige, ose
- (b) formimin, shtrirjen ose ndryshimin e rrugeve lidhese me nje autostrade e perdorur nga trafiku i automjeteve,
- pervec kur merret aprovimi paraprak nga autoriteti perkates per planin e detajuar dhe vecorite.

Aprovime
Paraprake:

- A.2 Aprovimi paraprak i permendur ne paragrafin A.1 nuk mund te refuzohet nga autoriteti perkates dhe as nuk mund te vendosen kushte pervec kur keto autoritete jane te bindur qe—
- (a) zhvillimi (pervec dispozitave dhe punimeve te kryera ne nje dige) duhet dhe mund te zbatohet ne nje pjese tjeter te tokes, ose
- (b) projekti ose pamja e jashtme e nje ndertese, ure, ujesjellesi, apo dige demton pamjen e ambjentit te lagjes apo zones dhe mund te modifikohet lehtesisht per te shmangur kete demtim.

Interpretime
te Klases A:

- A.3 Ne klasen A "autoritet perkates" do te thote—
- (a) autoriteti i planifikimit lokal ne Londren e Madhe ose ne nje qark metropolitan;
- (b) autoriteti i planifikimit qarkor, ne Parqet Kombetare, jashte nje qarku metropolitan,

^(b) 1964 c. 40; seksioni 14 eshte shtuar nga paragrafi 2, dhe seksioni 14 dhe 16 jane shtuar nga paragrafi 3, 4 dhe 14, te Skedules 6, dhe nga Pjesa II e Skedules 12 te, Aktit mbi Transportin 1981 (c.56); seksioni 14 u shtua nga paragrafi 1, dhe seksioni 16 u shtua nga paragrafi 2, I Skedules 3 te Aktit mbi Transportin dhe Punimet 1992 (c.42).

- (c) autoriteti i planifikimit te rrethit, ne cdo rast tjeter^(a).

PJESA 12

ZHVILLIME TE AUTORITETEVE LOKALE

Klasa A: Zhvillime te Lejuara

- A. Ngritja ose ndertimi dhe mirembajtja, permiresimi ose ndryshime te tjera nga autoritetet lokale ose nga nje korporate e zhvillimit urban te --
- (a) cdo ndertese te vogel ndihmese, punimeve, ose paisjeve ne token qe u takon ose qe mbahet nga ata, qe duhet per qellime te ndonje funksioni te ushtruar nga ata mbi token, pervec funksioneve si sipermarres ligjore;
- (b) standardeve mbi llambat, kioskat e informacionit, strehime per pasagjeret, strehime publike dhe stola, kutia telefonike, alarme zjarri, cezma uji publike, govata per kuaj, kosha ose kuti per plehera, pengesa per kontroll perpara se njerezit te hyjne ne automjetet e sherbimit publik, dhe struktura ose punime te ngjashme te nevojshme ne lidhje me kryerjen e sherbimeve publike qe administrohen nga ata.

Interpretime
te Klases A:

- A.1 Per qellime te Klases A—
"korporate e zhvillimit urban" ka te njejtin kuptim si ne Pjesen XVI te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Vendosjen 1980^(b) (zhvillimi urban).

- A.2 Referimi ne Klasen A te ndonje ndertese te vogel ndihmese, punimeve ose paisjeve eshte referim per cdo ndertese ndihmese, punime apo paisje qe nuk i kalon 4 metra lartesi ose nuk ka kapacitet me te madh se 200 meter kub.

Klasa B:

^(a) Per rastet kur funksionet jane transferuar nga keshilli I qarkut tek keshilli I rrethit ose anasjelltas shih rregullen 5 ne Ndryshime ne Qeverine Lokale per Rregulloren Angleze 1994 (S.I. 1994/867) dhe seksionin 1 te Aktit.

^(b) 1980 c. 65.

**Zhvillime
te Lejuara**

B. Depozitimi i mbeturinave nga autoritetet lokale ne nje vend qe eshte perdorur per ate qellim me 1 Korrik 1948 pa marre parasysh nese siperfaqja ose lartesia jane rritur si rezultat i ketij depozitimi.

**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se materialet e mbeturinave jane ose perfshijne materiale qe rezultojne nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve.

**Interpretime
te Pjeses 12:**

**C. Per qellime te Pjeses 12—
“autoritet lokal” perfshin famullite dhe keshillat e komuniteteve.**

PJESA 13**ZHVILLIME TE AUTORITETEVE LOKALE TE AUTOSTRADAVE****Klasa A:
Zhvillime
te Lejuara**

A. Kryerja e punimeve te duhura ose te nevojshme per mirembajtjen ose permiresimin e autostradave nga nje autoritet lokal i autostradave ne token jashte por prane kufijve te nje autostrate ekzistuese.

PJESA 14**ZHVILLIME NGA NDERMARRJET E DRENAZHIMIT****Klasa A:
Zhvillime
te Lejuara**

A. Zhvillimet nga nje ndermarje qe merret me drenazhimet ne, mbi ose nen nje rrjedhje uji ose punime per drenazhimin e tokes qe kerkohen ne lidhje me permiresimin, mirembajtjen, apo riparimin e kesaj rrjedhej uji apo ketyre punimeve.

**Interpretime
te Klases A:**

A.1 Per qellime te Klases A—

“ndermarrje drenazhimi” ka te njejtin kuptim si ne seksionin 72(1) te Aktit mbi Drenazhimin e Tokes 1991^(a) (interpretime) ndryshe nga Autoriteti Kombetar i Lumejve.

PJESA 15**ZHVILLIME TE AUTORITETIT KOMBETAR TE LUMEJVE****Klasa A:
Zhvillime
te Lejuara**

A. Zhvillime nga Autoriteti Kombetar i Lumejve, per qellime te funksioneve te tyre, qe konsistojne ne --

- (a) zhvillime jo mbi siperfaqen e tokes te duhura ne lidhje me konservimin, rishperndarjen ose mbledhjen e burimeve ujore,**
- (b) zhvillimet ne, mbi ose nen nje rrjedhje uji ose punime drenazhimi qe kerkohen ne lidhje me permiresimin, mirembajtjen, apo riparimin e kesaj rrjedhje ujore,**
- (c) dispozitat e nje ndertese, punishteje, makinerie apo aparati ne, mbi ose nen toke per qellime studimi dhe hetimi,**
- (d) mirembajtja, permiresimi, apo riparimi i mjeteve per matjen e rrjedhjes ne cdo rrjedhje uji ose kanal,**
- (e) cdo pune e autorizuar ose qe kerkohet ne lidhje me nje urdher ne seksionin 73 te Aktit mbi Burimet Ujore 1991^(b) (fuqia per te nxjerre urdhera ne raste te zakonshme ose emergjente),**
- (f) cdo zhvillim tjeter, ne mbi ose nen toke, pervec dispozitave te nje ndertese por duke perfshire zgjerimin, ose ndryshimin e nje ndertese.**

**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—**
- (a) ne rastin e zhvillimeve ne Klasen A(a) perfshin ndertimin e nje rezervuari,**
 - (b) ne rastin e zhvillimeve ne Klasen A(f), konsiston ne ose perfshin zgjerimin apo ndryshimin e nje ndertese se ciles—**

^(a) 1991 c.59

^(b) 1991 c.57.

- (i) i është ndryshuar materialisht pamja e jashtme ose projekti,
 (ii) i është kapercyer lartësia e ndërtesës origjinale, ose madhësia kubike e ndërtesës origjinale është kaluar me më shumë se 25%, ose
 (iii) dyshemeja e ndërtesës origjinale kalohet me më shumë se 1,000 meter katror, ose
- (c) në rastin e zhvillimeve të Klases A(f), konsiston në instalimin ose ngritjen e ndonjë makinerie apo punishte që i kalon 15 metra lartësi, ose që kalon lartësinë e asaj që zëvendëson, merret cilado nga këto lartësi të jete me e madhe.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A(c) pasi i nënshtrohet kushtit që, në perfundim të studimit apo investigimit, ose pasi skadon afati 6 mujor nga fillimi i zhvillimit, merret cilado kohë të jete me e shkurter, të gjithë punimet duhet të pezullohen dhe të gjithë ndërtesat, punishtet apo makinerite duhet të levizën dhe toka të kthehet sa më shpejt të jete praktikisht e mundur në kushtet fillestare (ose në kushte për të cilat mund të jete rënë dakord me autoritetin e planifikimit lokal).

PJESA 16

ZHVILLIME NGA OSE NE EMER TE SIPERMARRESVE TE UJRAVE TE ZEZA

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

- A. Zhvillime nga ose në emer të sipermarresve të kanalizimeve të ujrave të zeza që konsistojnë në—
- (a) zhvillime jo mbi nivelin e tokës të dhura në lidhje me dispozitat, permiresimet, mirembajtja, ose riparimi i kanalizimeve, tubave, impiantit kryesor, ose aparateve shoqerues;
- (b) dispozitat e një ndërtese, punishteje, makinerie, apo aparati, në, mbi, ose nën tokë për qellime studimi e investigimi;
- (c) mirembajtja, permiresimi, ose riparimi i punimeve për matjen e rrjedhjes në cdo rrjedhje uji ose kanal;

- (d) cdo punim i autorizuar ose kerkuar në lidhje me një urdherese të bërë nën seksionin 73 të Aktit mbi Burimet Ujore 1991 (fuqia për të nxjerrë urdhera në kushte të zakonshëm ose emergjente);
- (e) cdo zhvillim tjetër, në, mbi, sipër ose nën token e operimit të tyre, me perjashtim të dispozitave të një ndërtese, por duke përfshirë zgjerimin, ose ndryshimin e një ndërtese.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A(e) në qofte se—
- (a) konsiston në, ose përfshin zgjerimin, ose ndryshimin, e një ndërtese se ciles—
- (i) i është ndryshuar materialisht pamja e jashtme ose projekti,
 (ii) i është kapercyer lartësia e ndërtesës origjinale, ose madhësia kubike e ndërtesës origjinale është kaluar me më shumë se 25%, ose
 (iii) dyshemeja e ndërtesës origjinale kalohet me më shumë se 1,000 meter katror, ose;
- (b) konsiston në instalimin ose ngritjen e ndonjë punishteje, apo makinerie, që kalon 15 metra lartësi, ose lartësinë e cdo gjeje që ka zëvendësuar, merret lartësia me e madhe.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A(b) pasi i nënshtrohet kushtit që, në perfundim të studimit apo investigimit, ose pasi skadon afati 6 mujor nga fillimi i zhvillimit, merret cilado kohë të jete me e shkurter, të gjithë punimet duhet të pezullohen dhe të gjithë ndërtesat, punishtet apo makinerite duhet të levizën dhe toka të kthehet sa më shpejt të jete praktikisht e mundur në kushtet fillestare (ose në kushte për të cilat mund të jete rënë dakord me autoritetin e planifikimit lokal).

Interpretime
të Klases A:

- A.3 Për qellime të Klases A—
- “aparati shoqerues”, në lidhje me kanalizimet e ujrave të zeza, tubave kryesore ose lidhese, do të thote pompe, makineri ose aparat, që ka lidhje me kanalizimin perkates, ose tubat;
 - “impiant kryesor” do të thote tub ose sistem tubash (se bashku me pompa, makineri, ose aparate shoqeruese) për të shndërruar ujrën e zeza të trajtuara, në përpunime të metejshme, duke

perfshire produktet perfundimtare pas heqjes se ujit, apo djegjen e mbeturinave te tilla.

PJESA 17

ZHVILLIME NGA SIPERMARRES LIGJORE

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

Sipermarrje ne hekurudha

A. Zhvillime nga sipermarres te hekurudhave ne tokat ne te cilat operojne, te nevojshme per levizjen e trafikut ne shina.

Zhvillimi nuk Lejohet;

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se konsiston ne ose perfshin—

- (a) ndertimin e nje hekurudhe,
- (b) ndertimin ose ngritjen e nje hoteli, stacioni hekurudhor, ose ure, ose;
- (c) me perjashtim te rasteve kur perfshihen teresisht ne nje stacion hekurudhor, ndertimin ose ngritjen e—
 - (i) zyre, ndertese banimi apo shkollimi, ose te ndonje ndertese te perdorur per procese industriale, ose;
 - (ii) parkim makinash, dyqane, restorant, garazhe, stacione karburanti, ose ndertese apo strukture tjeter te perfshire ne legjislacionin e transportit.

Interpretime te Klases A:

A.2 Per qellime te Klases A, referencat ne drejtim te ndertimit te ndonje ndertese apo strukture perfshin referenca per rikonstruktim, apo ndryshim, te nje ndertese apo strukture, qe ndryshojen materialisht pamjen e jashtme ose projektin e saj.

Klasa B: Zhvillimi Lejohet:

Sipermarrje ne porte, limane, skela, transport uxor, kanale, ose lundrim te brenshem

B. Zhvillime nga sipermarres ligjore ose nga qiramarres ne tokat ne te cilat operojne ne lidhje me sipermarrje te ndryshme ne porte, limane, skela, transport uxor, kanale, ose lundrim i brenshem, te nevojshme per —

- (a) per qellime te transportit te mallrave, ose;
- (b) ne lidhje me ngarkimin, shkarkimin, hipjen dhe zbritjen e pasagjereve, te bagetive ose mallrave ne nje port, liman apo skele, ose me levizjen e trafikut ne kanal ose lundrim te brenshme, ose me ndonje pjese hekurudhe qe perfshihen ne kete sipermarrje.

Zhvillimi nuk Lejohet

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se konsiston ne ose perfshin—

- (a) ndertimin ose ngritjen e nje hoteli, ure apo ndertese tjeter qe nuk kerkohet ne lidhje me perballimin e trafikut,
- (b) me perjashtim te rasteve kur perfshihet teresisht ne nje skele, apo port, ndertimin ose ngritjen e—
 - (i) nje ndertese aresimore, ose
 - (ii) nje parkimi, dyqani, restoranti, garazhi, stacioni karburanti, ose ndertese apo strukture tjeter te perfshire ne legjislacionin e transportit.

Interpretime te Klases B:

B.2 Per qellime te Klases B, referencat ne drejtim te ndertimit te ndonje ndertese apo strukture perfshin referenca per rikonstruktim, apo ndryshim, te nje ndertese apo strukture, qe ndryshojne materialisht pamjen e jashtme ose projektin e saj, dhe referencat per toke ne te cilen operojne, perfshijne toka te caktuara nga nje urdherese te nxjerre nen seksionin 14 dhe 16 te Aktit mbi Portet 1964^(a) (urdheresa mbi sigurimin e eficences se porteve, etj., dhe urdheresa per dhenien e fuqise per permiresime, ndertime, etj., ne porte), qe ka hyre ne fuqi pa marre parasysh nese urdheresa i nenshtrohet dispozitave te Aktit mbi Urdheresat Ligjore 1945^(b).

Klasa C: Zhvillimi Lejohet

Punime ne rruget ujore te brenshme

C. Permiresimi, mirembajtja, ose riparimi, i rrugeve te brenshme ujore, (pervec atyre tregetare dhe trasportit te shpejte e te posacem) ku aplikohet Akti mbi Transporti 1968^(c) dhe riparimi ose

^(a) 1964 c.40; seksioni 14 u shtua nga paragrafi 2, dhe seksionet 14 dhe 16 u shtuan nga paragrafet 3, 4 dhe 14, te Aneksit 6 dhe nga Pjesa II e Aneksit 12 te Aktit mbi Transportin 1981 (c.56); seksioni 14 u shtua nga paragrafi 1, dhe seksioni 16 u shtua nga paragrafi 2, i Aneksit 3 te Aktit mbi Transportin dhe Punimet (c.42).

^(b) 1945 c. 18 (9 dhe 10 Geo.6)

^(c) 1968 c.73.

mirembajtja e nenkalimeve ujore, digave, pengesave, ujesjellesve, pritave, valvolave te shkarkimit, ne lidhje me kontrollin dhe punimet e ketyre rrugeve ujore.

Klasa D Zhvillimi Lejohet

Germime kanalesh

D. Perdorimi i tokes nga sipermarres ligjore ne lidhje me portet, skelat, limanet, transportin ujqor, kanalet ose lundrime te brendshme, per perhapjen e materialeve ne kanale.

Klasa E: Zhvillimi Lejohet

Sipermarrje ujore ose hidraulike

E. Zhvillime per qellime sipermarrje nga sipermarres ligjore per furnizimin me uje ose fuqine hidraulike qe konsiston ne -

- (a) zhvillime jo mbi siperfaqen e tokes qe kerkohen ne lidhje me furnizimin me uje, ose per konservimin, rishperndarjen, ose grumbullimin e ujit, ose per shnderrimin e trajtimit te ujrave te zeza,
- (b) zhvillime ne, mbi ose nen ndonje rrjedhje ujore qe kerkohen ne lidhje me permiresimin ose mirembajtjen, e kesaj rrjedhje ujore,
- (c) dispozitat e nje ndertese, punishteje, makinerie apo aparati, ne, mbi ose nen toke per qellime investigimi,
- (d) mirembajtja, permiresimi, ose riparimi i mjeteve per matjen e rrjedhjes ne ndonje rrjedhje uji ose kanal,
- (e) instalimi ne nje sistem te shperndarjes se ujit e nje stacioni perforcues, valvole, matesi, ose mjete per ndryshimin e marsheve,
- (f) ndonje punim i autorizuar ose i kerkuar ne lidhje me nje urdherese te nxjerre nen seksionin 73 te Aktit mbi Burimet Ujqore 1991^(a) (dhenia e fuqise per te nxjerre urdheresa te zakonshme ose emergjente),
- (g) ndonje zhvillim tjeter, ne, mbi ose nen token ne te cilen operojne, pervec ndertimit te ndertesave, por qe perfshin zgjerime dhe ndryshime ne ndertesa.

Zhvillimi

^(a) 1991 c. 57.

nuk Lejohet

E.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa E ne qofte se—

- (a) ne rastin e zhvillimeve te Klases E(a), perfshin ndertimin e rezervuareve,
- (b) ne rastin e zhvillimeve te Klases E(e) kur ka te beje me instalimin e nje stacioni ose shtepie me kapacitet me te madh se 29 meter kub, instalimi kryhet ne ose mbi nivelin e tokes ose nen nje autostrade te perdorur nga trafiku i automjeteve,
- (c) ne rastin e zhvillimeve te Klases E(g), perfshin zgjerimin ose ndryshimin e nje ndertese se ciles—
 - (i) i eshte ndryshuar materialisht pamja e jashtme ose projekti;
 - (ii) lartesia e nderteses origjinale kalohet, ose madhesia kubike e nderteses origjinale kalohet me me shume se 25%, ose
 - (iii) siperfaqja e dyshemese se nderteses origjinale kalohet me me shume se 1,000 meter katror, ose
- (d) ne rastin e zhvillimeve te Klases E(c), konsiston ne instalimin ose ngritjen e nje makinerie apo punishteje qe i kalon 15 metra lartesi, ose kur lartesia e saj eshte me e madhe se lartesia e asaj qe eshte zevendesuar, merret cilado lartesi te jete me e madhe.

Kushte:

E.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa E(c) pasi i nenshtrohet kushtit qe, ne perfundim te studimit apo investigimit, ose pasi skadon afati 6 mujor nga fillimi i zhvillimit, merret cilado kohe te jete me e shkurter, te gjitha punimet duhet te pezullohen dhe te gjitha ndertesat, punishtet apo makinerite duhet te levizen dhe toka te kthehet sa me shpejt te jete praktikisht e mundur ne kushtet fillestare (ose ne kushte per te cilat mund te jete rene dakord me autoritetin e planifikimit lokal).

Klasa F: Zhvillimi Lejohet

Furnizuesit e Gazit

F. Zhvillime nga nje furnizues publik gazi per qellime qe konsistojne ne -

- (a) shtrirjen e tubacineve ose aparateve te tjera;
- (b) instalimin ne nje sistem te shperndarjes se gazit e nje aparati mates, shenues, kontrollues per ndryshimin e trysnise, rrjedhjes se volumit te gazit, dhe struktura per mbajtjen e aparateve te tilla;
- (c) ndertimi ne ndonje zone magazinimi ose zone te mbrojtur, i specifikuar ne nje urdherese te bere

nen seksionin 4 te Aktit mbi Gazin 1965^(a) (urdheresa mbi magazinime), i puseve, dhe ngritja ose ndertimi ne keto zona te ndonje punishteje apo makinerie te kerkuara ne lidhje me ndertimin e ketyre puseve;

- (d) vendosja dhe magazinimi ne toke i tubave dhe aparateve qe perfshihen ne tubacione qe po shtrohen ose ndertohen pasi eshte dhene leja e planifikimitos e qe do te jepet nen Pjesen III te ketij Akti (kontrolli mbi zhvillimet);
- (e) ngritja ne token ku operon nje furnizues publik gazi, e nje ndertese vetem per mbrojtjen e makinerise apo punishtes;
- (f) ndonje zhvillim tjeter qe kryhet ne, mbi ose nen token ne te cilen operon furnizuesi publik i gazit.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

F.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa F ne qofte se—

- (a) ne rastin e ndonje zhvillimi ne Klasen F(b) qe perfshin instalimin e nje strukture per te mbajtur aparatet qe kalojne kapacitetin 29 meter kub, keto instalime do kryhen ne ose mbi nivelin e tokes, ose nen nje autostrade qe perdoret per trafikun e automjeteve,
- (b) ne rastin e zhvillimeve te Klases F(c)—
- (i) pusi perfshihet ne nje urdherese te aprovuar nga Sekretari i Shtetit per Tregetine dhe Industrine per qellime te seksionit 4(6) te Aktit mbi Gazin 1965; ose
- (ii) ndonje makineri apo punishte i kalon lartesine 6 metra, ose
- (c) ne rastin e zhvillimeve te Klases F(e), ndertesa e kalon lartesine 15 metra, ose
- (d) ne rastin e zhvillimeve ne Klase F(f)—
- (i) konsiston ose perfshin ngritjen e nje ndertese, ose rikonstruksionin apo ndryshimin e nje ndertese se ciles i ndryshohet materialisht pamja e jashtme ose projekti;
- (ii) perfshin instalimin e nje makinerie apo punishteje qe kalon lartesine 15 metra, ose qe eshte me teper se 15 metra e larte pa bere punime; ose
- (iii) konsiston ne ose perfshin zevendesimin e ndonje makinerie apo punishteje, me nje tjeter qe

^(a) 1965 c.36; seksioni 4 u shtua nga paragrafi 6 I Skedules 7, dhe Pjesa I e Skedules 9, te Aktit mbi Gazin 1986(c. 44), dhe nga paragrafi 12 te

kalon lartesine 15 metra, ose qe kalon lartesine e asaj te zevendesuar, merret cilado lartesi te jete me e madhe.

Kushte:

F.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa F pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

- (a) ne rastin e zhvillimeve te Klases F(a), furnizuesi i gazit publik duhet te jape njoftim me shkrim autoritetit te planifikimit lokal qe do te filloje punimet per te shtruar nje tubacion, jo me vone se 8 jave perpara fillimit te ketyre punimeve, dhe duke percaktuar token ku do behet ky zhvillim,
- (b) ne rastin e zhvillimeve te Klases F(d), pasi perfundohet shtrirja ose ndertimi i tubacioneve, ose kur skadon periudha 9 mujore qe nga fillimi i zhvillimit, merret cilado periudhe te jete me e shkurter, cdo tubacion ose aparat tjeter i vendosur ne toke duhet te hiqet dhe toka dhe toka te kthehet sa me shpejt te jete e mundur ne kushtet e mepareshme (ose ne kushtet qe eshte rene dakord me autoritetin e planifikimit lokal),
- (c) ne rastin e zhvillimeve te Klases F(e), duhet te merret aprovimi mbi projektin dhe pamjen e jashtme te nje ndertese, perpara se te filloje ky zhvillim, dhe ky aprovim merret nga --
- (i) autoriteti i planifikimit lokal, ne Londren e Madhe ose ne qarqe metropolitane;
- (ii) autoriteti i planifikimit te qarkut, ne Parqet Kombetare, jashte qarqeve metropolitane,
- (iii) autoriteti i planifikimit te rrethit^(b), ne cdo rast tjeter.

**Klasa G:
Zhvillimi
Lejohet**

Sipermarrje Elektrike

G. Zhvillimi nga sipermarres ligjore per gjenerimin, transmetimin, apo furnizimin e elektricitetit per qellime qe konsistojne ne -

- (a) instalimin ose zevendesimin ne, mbi, ose nen toke te linjave elektrike dhe ndertimin e shtyllave dhe tuneleve, si dhe instalimin ose zevendesimin e ushqyesve ose shtyllave ose stacioneve transformatore ose te stacioneve te stakimit, te nevojshme per nje linje elektrike;

^(b) Ne rastet kur funksionet jane transferuar nga Keshilli i Qarkut ne Keshillin e Rrethit ose anasjelltas shih rregullen 5 te Ndryshimeve ne Qeverine Lokale per Rrregulloren e Anglise 1994(S.I.1994/867) dhe seksionin 1 te Aktit.

- (b) instalimin ose zevendesimin e linjave te komunikacionit te cilat lidhin nje pjese te nje linje elektrike me ndonje ndertese apo punishte, dhe instalimin ose zevendesimin e ndonje mbeshtetesi per nje linje te tille;
- (c) zhytjen e sondave per t'u siguruar per natyren e tokes dhe instalimin e ndonje makinerie ose punishteje te nevojshme ne lidhje me sonda te tilla;
- (d) zgjerimi ose ndryshimi i ndertesave ne token ku operohet;
- (e) ngritja ne token ku operohet e ndertesave vetem per te mbrojtur nje makineri apo punishte;
- (f) cdo zhvillim tjeter qe kryhet ne, mbi ose nen token ne te cilen operohet.

Zhvillimi
nuk lejohet:

G.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa G ne qofte se—

- (a) ne rastin e zhvillimeve ne Klasen G(a) –
 - (i) konsiston ose perfshin instalimin ose zevendesimin e nje linje elektrike per te cilen aplikohet seksioni 37(1) i Aktit mbi Elektricitetin 1989^(a) (aprovim kerkohet per linjat mbi koke); ose
 - (ii) konsiston ose perfshin instalimin ose zevendesimin mbi nivelin e tokes ose nen nje autostrade te perdorur nga trafiku i automjeteve, te nje dhome per te vendosur aparatit e cila nuk kalon kapacitetin 29 meter kub;
- (b) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(b) –
 - (i) zhvillimet kryhen ne nje Park Kombetar, ne nje zone me bukuri te rralle natyrore, ose ne nje zone me interes te vecante shkencor;
 - (ii) lartesia e ndonje mbeshtetesi i kalon 15 metra; ose
 - (iii) linja e telekomunikimit i kalon 1,000 metra gjatesi;
- (c) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(d)—
 - (i) kalohet lartesia e nderteses origjinale;
 - (ii) madhesia kubike e nderteses origjinale kalohet me me teper se 25%, ose me 10% ne rastin e ndertesave ne tokat e nenit 1(5), ose
 - (iii) hapësira e dyshemese se nderteses origjinale kalohet me me shume se 1,000 metra katror, ose

me 500 metra katror ne rastin e ndertesave ne tokat e nenit 1(5);

- (d) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(e), ndertesa kalon 15 metrat lartesi, ose
- (e) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(f), konsiston ose perfshin—
 - (i) ngritjen e nje ndertese, ose rikonstrukcionin, ose ndryshimin e nje ndertese se ciles i ndryshohet materialisht pamja e jashtme apo projekti,
 - (ii) instalimin ose ngritjen me shtese ose zevendesim te nje makinerie qe kalon lartesine 15 metra, ose lartesine e makinerise qe ka zevendesuar, merret cilado lartesi te jete me e madhe.

Kushte:

G.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa G pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

- (a) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(a) qe konsistojne ne ose perfshijne zevendesimin e nje linje elektrike, keto zhvillime duhet t'i nenshtrohen kushteve qe permbahen ne lejen e planifikimit ne lidhje me lartesine, projektin ose pozicionin e linjes elektrike ekzistuese, qe mund te aplikohen ne linjen zevendesuese;
- (b) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(a) zhvillimet qe konsistojne ne ose perfshijne nje linje elektrike te perkoheshme qe perben nje diversion/shmangie nga linja elektrike ekzistuese, ne fund te diversionit/shmangien ose ne fund te periudhes 6 mujore nga perfundimi i instalimit (cilado periudhe qe te jete me e shkurter) linja e perkoheshme duhet te hiqet dhe toka ne te cilen jane kryer punimet per te instaluar linjen duhet te kthehet sa me shpejt te jete e mundur ne kushtet e mepareshme, perpara instalimit;
- (c) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(c), ne perfundim te zhvillimit, ose ne fund te periudhes 6 mujore nga fillimi i zhvillimit (cilado periudhe te jete me e shkurter) cdo makineri apo punishte e instaluar duhet te zhvendoset dhe toka duhet te kthehet sa me shpejt qe te jete e mundur ne kushtet e mepareshme, perpara fillimit te zhvillimit;
- (d) ne rastin e zhvillimeve te Klases G(e) duhet te merret aprovimi per detajet e projektit, dhe pamjen e jashtme, perpara se te filloje zhvillimi, dhe aprovimi merret nga –

^(a) 1989 c.29.

- (i) autoriteti i planifikimit lokal, ne Londren e Madhe ose ne qarqe metropolitane;
- (ii) autoriteti i planifikimit te qarkut, ne Parqet Kombetare, jashte qarqeve metropolitane,
- (iii) autoriteti i planifikimit te rrethit^(a), ne cdo rast tjeter.

Interpretime te Klases G:

G.3 Per qellime te Klases G(a), "linje elektrike" ka kuptimin sipas seksionit 64(1) te Aktit mbi Elektricitetin 1989 (interpretime, etj., te Pjeses 1).

G.4 Per qellime te Klases G(b), "punishte elektrike" ka kuptimin sipas seksionit 64(1) dhe "linje telekomunikimi" nenkupton nje tel ose kabell (qe perfshin veshjen ose mbeshtjelljen e tij) qe eshte pjese e aparatit telekomunikues sipas kuptimit qe i jepet ketij termi nga paragrafi 1 i Aneksit 2 te Aktit mbi Telekomunikimin 1984^(b) (kodet e telekomunikimit).

G.5 Per qellime te Klases G(d), (e) dhe (f), toka e licensuar sipas seksionit 6(2) te Aktit mbi Elektricitetin 1989 do te trajtohet si toke ne te cilen operohet sic percaktohet ne seksionin 263 te Aktit ^(c) (kuptimi i "tokes ne te cilen operohet") ne qofte se mbajtesit e kesaj toke jane sipermarres te licensuar per qellime te ketij seksioni.

Klasa H: Zhvillimi Lejohet

Sipermarrje ne tramvajet dhe transportin rrugor

H. Zhvillime te kerkuara per qellime te realizimit te transportit rrugor ose me tramvaj qe konsistojne ne -

- (a) instalimin e postave, telave mbi koke, kablllove nen toke, shtyllave ushqyese ose transformatoreve, ne, mbi, nen ose prane nje autostrade per qellime furnizimi me energji automjetet e sherbimit publik;**
- (b) instalimin e shinave te tramvajeve, kanaleve dhe tubave ne lidhje me keto shina qe duhen per te funksionuar transporti me tramvaj;**

^(a) Ne rastet kur funksionet jane transferuar nga keshilli I qarkut ne keshillin e rrethit ose anasjelltas shih rregullen 5 te Ndryshimeve ne Qeverine Lokale per Rrregulloren e Anglise 1994(S.I.1994/867) dhe seksionin I te Aktit.

^(b) 1984 c.12.

^(c) Seksioni 263 u shtua nga paragrafi 23 I Skedules 6 te Aktit mbi Planifikimin dhe Kompensimin 1991 (c.34).

- (c) instalimin e kablllove te telefonave dhe aparateve, shenjave dhe vendeve te ndalimit, te kerkuara ne lidhje me funksionimin e automjeteve te transportit publik;**
- (d) ngritja ose ndertimi, dhe mirembjatja, permiresimi, ose ndryshime te tjera te strehave per pasagjeret dhe pengesave per te kontrolluar njerezit qe presin per te udhetuar me automjetet publike;**
- (e) ndonje zhvillim tjeter ne token ne te cilen operohet.**

Zhvillimi nuk Lejohet:

H.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa H ne qofte se konsiston ne—

- (a) ne rastin e zhvillimeve ne Klasen H(a), instalime ose struktura qe kalojne kapacitetin 17 metra kub;
- (b) ne rastin e zhvillimeve ne Klases H(e) -
 - (i) ngritja e nje ndertese, ose rikonstruksioni apo ndryshimi i nje ndertese se ciles i ndryshohet projekti ose materialisht pamja e jashme;
 - (ii) instalimi ose ngritja me shtese ose zevendesim i nje makinerie apo punishte e cila i kalon 15 metra lartesi ose lartesine e makinerise qe zevendesohet, merret cilado lartesi te jete me e madhe,
 - (iii) zhvillime ne lidhje me legjislacionin mbi transportin, por qe nuk perfshihen teresisht ne nje stacion autobuzash apo tramvajesh.

Klasa I: Zhvillimi Lejohet

Sipermarrje ne lidhje me fanare

I. Zhvillime qe duhen per funksionimin e nje autoriteti te pergjithshem ose lokal mbi fanaret nen Aktin mbi Transportin Ujor Tregtar te Mallrave 1894 ^(a) dhe ndonje dipozite tjeter ligjore ne lidhje me fanaret, ose nen zbatimin e te drejtave, fuqive dhe detyrave te autoriteteve lokale te fanareve te fituara perpara Aktit te vitit 1894.

Zhvillimi nuk Lejohet:

I.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa I ne qofte se konsiston ne ose perfshin ngritjen e zyrave, ose rindertimin apo ndryshimin e zyrave, projekti ose pamja e jashtme e se cilave do ndryshohet materialisht.

^(a) 1894 c.60.

**Klasa J:
Zhvillimi
Lejohet****Sherbimi Postar****J. Zhvillime qe kerkohen per qellime te Zyrave Postare qe konsistojne ne -**

- (a) instalimin e kutive postare ose makinave vetesherbim,
- (b) cdo zhvillim tjeter qe kryhet ne, mbi ose nen token ne te cilen sipermarresi operon.

**Zhvillimi
nuk Lejohet****J.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa J ne qofte se—**

- (a) konsiston ne ose perfshin ngritjen e nje ndertese, ose rikonstrukcionin apo ndryshimin e nje ndertese ku projekti ose pamja e jashtme e se ciles ndryshohet materialisht, ose
- (b) konsiston ose perfshin instalimin ose ngritjen me shtese ose zevendesim te ndonje makinerie, ose punishteje qe i kalon 15 metra lartesi, ose lartesine e makinerive apo punishteve qe jane zevendesuar, cilado lartesi te jete me e madhe.

**Interpretime
te Pjeses 17:****K. Per qellime te Pjeses 17—**

"legjislacioni mbi transportin" do te thote seksioni 14(1)(d) i Aktit mbi Transportin 1962^(b) ose seksioni 10(1)(x) i Aktit mbi Transportet 1968^(c).

PJESA 18

ZHVILLIME AVIACIONI

Klasa A: Zhvillime ne nje aeroport**Zhvillime
te Lejuara**

A. Kryerja ne token e operimit nga operatore aeroporti te caktuar ose agjente te tyre, te zhvillimeve (duke perfshire ngritjen ose ndryshimin e nje ndertese funksionale) ne lidhje me dispozitat e sherbimeve ne nje aeroport.

^(b) 1962 c.46.^(c) 1968 c.73.**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se konsiston ne ose perfshin—

- (a) ndertimin ose zgjerimin e nje piste avionash;
- (b) ndertimin e nje terminali pasagjeresh me nje siperfaqe dyshemeje me te madhe se 500 meter katror;
- (c) zgjerimin ose ndryshimin e nje terminali pasagjeresh ku siperfaqja e dyshemese se nderteses se re kalon ate te nderteses sic ka qene me 5 Dhjetor 1988, me me teper se 15%;
- (d) ngritja e nje ndertese, qe nuk eshte funksionale;
- (e) ndryshimi ose rikonstrukcioni i nje ndertese qe nuk eshte funksionale, projekti dhe pamja e jashtme e se ciles ndryshohet materialisht.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i neneshtrohet kushtit qe operuesi perkates i aeroportit konsulton autoritetin e planifikimit lokal perpara zbatimit te zhvillimit, pervec rasteve kur zhvillimi perfshihen ne paragrafin A.4.

**Interpretime
te Klases A:**

A.3 Per qellime te paragrafit A.1, siperfaqja e dyshemese do te llogaritet me n permasat e jashtme dhe pa marre parasysh siperfaqen e antenave satelitore.

A.4 Zhvillimi perfshihet ne kete paragraf ne qofte se—

- (a) kerkohet urgjentisht for perdorimin me eficence te aeroportit, dhe
- (b) konsiston ne punime per te ngritur apo rikonstruktuar nje ndertese ndihmese, ose ne vendosjen ne toke te nje paisjeje, dhe kur ndertesa, struktura apo punimi nuk i kalon 4 metra lartesi, ose kapacitetin 200 meter kub.

**Klasa B:
Zhvillimi
Lejohet****Zhvillime per fluturimin ajror ne nje aeroport**

B. Kryerjen ne token e operimit brenda perimetrit te nje aeroporti nga nje operues aeroporti i caktuar ose nga agjente te tij i zhvillimeve ne lidhje me -

- (a) dispozitat e sherbimeve te kontrollit te trafikut ajror,
- (b) fluturimin e avioneve qe perdorin aeroportin,
- (c) kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin.

Klasa C:**Zhvillimi
Lejohet**

Zhvillime ne lidhje me fluturimin ajror prane nje aeroporti

C. Kryerjen ne tokat e operimit jashte aeroportit por brenda 8 kilometrave nga perimetri i tij, nga nje operues aeroporti i caktuar ose nga agjente te tij, i zhvillimeve ne lidhje me -

- (a) dispozitat e sherbimeve te kontrollit te trafikut ajror,
- (b) fluturimin e avioneve qe perdorin aeroportin,
- (c) kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin.

**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C ne qofte se—

- (a) ndonje ndertese e ngritur nuk do te perdorej per te mbajtur paisje te perdorura ne lidhje me dispozitat e sherbimit te kontrollit ajror, me asistencen e fluturimit te ndonje avioni, ose me kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin;
- (b) ndonje ndertese e ngritur kalon lartesine prej 4 metrave;
- (c) konsiston ne instalimin ose ngritjen e nje radari ose radioje, antene ose aparati tjetër qe kalon lartesine 15 metra ose ne rastin kur nje antene ose aparat eshte zevendesuar, kur kalon lartesine e atij te meparshem, cilado lartesi te jete me e madhe.

**Klasa D:
Zhvillimi
Lejohet**

Zhvillime nga Autoriteti i Aviacionit Civil brenda nje aeroporti

D. Zbatimi nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose agjente te tyre, brenda autoritetit te nje aeroporti ne te cilin Autoriteti kryen sherbime te kontrollit te trafikut, i zhvillimeve ne lidhje me -

- (a) dispozitat e sherbimeve te kontrollit te trafikut ajror,
- (b) fluturimin e avioneve qe perdorin aeroportin,
- (c) kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin.

**Klasa E:
Zhvillimi
Lejohet**

Zhvillime nga Autoriteti i Aviacionit Civil per kontrollin e trafikut ajror dhe fluturimeve

E. Zbatimi ne nje toke operimi te Autoritetit te Aviacionit Civil ose agjenteve te tyre i zhvillimeve ne lidhje me -

- (a) dispozitat e sherbimeve te kontrollit te trafikut ajror,
- (b) fluturimin e avioneve qe perdorin aeroportin,
- (c) kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin.

**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

E.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa E ne qofte se—

- (a) ndonje ndertese e ngritur nuk do te perdorej per te mbajtur paisje te perdorura ne lidhje me dispozitat e sherbimit te kontrollit ajror, me asistencen e fluturimit te ndonje avioni, ose me kontrollin e levizjeve te avioneve qe perdorin aeroportin;
- (b) ndonje ndertese e ngritur kalon lartesine prej 4 metrave;
- (c) konsiston ne instalimin ose ngritjen e nje radari ose radioje, antene ose aparati tjetër qe kalon lartesine 15 metra ose ne rastin kur nje antene ose aparat eshte zevendesuar, kur kalon lartesine e atij te meparshem, cilado lartesi te jete me e madhe.

**Klasa F:
Zhvillimi
Lejohet**

Zhvillime te Autoritetit te Aviacionit Civil ne raste emergjence

F. Perdorimi i tokes nga Autoriteti i Aviacionit Civil ne raste emergjente per te vendosur aparate te levizshme ne vend te aparateve qe nuk mund te riparohen.

Kushte:

F.1 Zhvillimi lejohet nga Klasa F me kushtin qe me skadimin e periudhes 6 mujore nga data e fillimit te perdorimit, perdorimi duhet te nderpritet, dhe aparati duhet te zhvendoset dhe toka duhet te kthehet ne kushtet perpara zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat zhvilluesi ka rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit lokal.

**Klasa G:
Zhvillimi
Lejohet**

Zhvillime nga Autoriteti i Aviacionit Civil per trafikun ajror, etj.

G. Perdorimi i tokes nga Autoriteti i Aviacionit Civil per te kryer sherbime ne lidhje me --

- (a) dispozitat e sherbimeve te kontrollit te trafikut ajror,
- (b) fluturimin e avioneve, ose
- (c) kontrollin e levizjeve te avioneve.

dhe ngritja ose vendosja e strukturave te levizshme ne toke per keto qellime.

Kusht:

G.1 Zhvillimi lejohet nga Klasa G 1 me kushtin qe me skadimin e periudhes 6 mujore nga data e fillimit te perdorimit, perdorimi duhet te nderpritet, dhe cdo strukture duhet te zhvendoset dhe toka duhet te kthehet ne kushtet perpara zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat zhvilluesi ka rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit lokal.

**Klasa H:
Zhvillimi
Lejohet****Perdorimi i tokes nga Autoriteti i Aviacionit Civil per studime etj.**

H. **Perdorimi i tokes nga Autoriteti i Aviacionit Civil per vendosjen dhe funksionimin e aparateve ne lidhje me kryerjen e studimeve ose investigimeve.**

Kusht:

H.1 Zhvillimi lejohet nga Klasa H me kushtin qe me skadimin e periudhes 6 mujore nga data e fillimit te perdorimit, perdorimi duhet te nderpritet, dhe cdo aparat duhet te zhvendoset dhe toka duhet te kthehet ne kushtet perpara zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat zhvilluesi ka rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit lokal.

**Klasa I:
Zhvillimi
Lejohet****Perdorimi i ndertesave te aeroportit te menaxhuara nga operator te nje aeroporti te caktuar**

I. **Perdorimi i ndertesave brenda perimetrit te nje aeroporti te menaxhuar nga nje operator aeroporti i caktuar per qellime ne lidhje me sherbimet e transportit ajror ose aktivite te tjera fluturimi ne ate aeroport.**

Interpretime
te Pjeses 18:

J. Per qellime te Pjeses 18—

- “ndertese operimi” do te thote nje ndertese, pervec hoteleve, qe kerkohet ne lidhje me levizjen ose mirembajtjen e avioneve, ose me ngarkimin, shkarkimin, e mallrave, bagetive apo pasagjereve, ne nje aeroport te caktuar;
- “aeroport i caktuar” do te thote nje aeroport per te cilin aplikohet Pjesa V e Aktit mbi Aeroportet

1986^(a) (statusi i disa aeroporteteve si sipermarres te autorizuar, etj.); dhe

- “operues i aeroporteteve te caktuar” do te thote nje operues ne aeroport te caktuar sipas kuptimit te seksionit 57 te Aktit mbi Aeroportet 1986.

PJESA 19**ZHVILLIME NDIHMESE TE PUNIMEVE MINERARE****Klasa A:
Zhvillime
me Leje**

A. Kryerja e punimeve per ngritjen, zgjerimin, instalimin, riorganizimin, zevendesimin, riparimin, ose ndryshimin e ndonje--
(a) makinerie apo punishteje,
(b) ndertese,
(c) rruge private ose hekurudhe private, ose
(d) kanalizime te ujrave te zeza, tubacioneve, ose
aparateve te ngjashme,
ne tokat e perdorura si miniera.

Zhvillimi
nuk Lejohet

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A—

- (a) per tokat e nje miniere nentokesore—
 (i) ne toka per te cilat nuk eshte marre aprovimi; ose
 (ii) ne toka te pershkruara ne paragrafin D.1(b), pervec rasteve kur plani i tokes eshte depozituar prane autoritetit te planifikimit te minierave perpara dates 5 Qershor 1989;
- (b) ne qofte qellimi i zhvillimit do jete i ndryshem nga sa me poshte—
 (i) qellime ne lidhje me nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve ne ate miniere ose minerale te sjella ne siperfaqe nga ajo miniere; ose
 (ii) trajtimin, magazinimin, ose zhvendosjen nga miniera te ketyre mineraleve, ose mbeturinave te nxjerra nga to;
- (c) ne qofte se pamja e jashtme e minieres ndryshohet materialisht;
- (d) ne qofte se lartesia e nje ndertese, makinerie, apo punishteje qe nuk perben eskavim do kaloje—

^(a) 1986 c.31.

- (i) 15 metra mbi nivelin e tokes; ose
- (ii) lartesine e ndertesës, makinerise apo punishtes, pasi është zevendesuar apo riparuar, ose ndryshuar ne menyre tjeter, merret cilado lartesi te jete me e madhe.
- (e) ne qofte se lartesia e nje ndertesë, makinerie, apo punishteje, ne nje ekskavim kalon—
 - (i) 15 metra mbi nivelin e eskavimit; ose
 - (ii) 15 metra mbi piken me te ulet te tokes se germuar fare prane eskavimit;
 - (iii) lartesine e ndertesës, makinerise apo punishtes, pasi është zevendesuar apo riparuar, ose ndryshuar ne ndonje menyre tjeter, merret cilado lartesi te jete me e madhe.
- (f) ne qofte se nje ndertesë e ngritur (pervec rasteve te zevendesimit te ndertesave) do te kete nje dysHEME me siperfaqe me te madhe se 1,000 meter katror; ose
- (g) ne qofte se madhesia kubike e ndonje ndertesë te zevendesuar, te zgjeruar apo te ndryshuar e kalon madhesine e ndertesës origjinale me me shume se 25%, ose kur siperfaqja e dyshemese e kalon me me shume se 1,000 metra katror ate te ndertesës origjinale.

Kusht:

- A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushtit qe perpara mbarimit te periudhes 24 mujore nga data e mbarimit te punimeve minerare, ose te ndonje periudhe me te gjate per te cilen ka rene dakord me shkrim autoriteti i planifikimit minerar -
- (a) te gjitha ndertesat, punishtet apo makinerite e lejuara nga Klasa A do te zhvendosen nga toka, pervec rasteve kur është rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar; dhe
 - (b) toka duhet te kthehet, kur është praktikisht e mundur, ne kushtet perpara fillimit te zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat është rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar.

Klasa B:
Zhvillimi
Lejohet

- B. Kryerja e punimeve ne tokat e perdorura si miniera ose tokat ndihmese per minierat, me aprovimin e autoritetit te planifikimit minerar, per ngritjen, instalimin, zgjerimin, riorganizimin, zevendesimin, riparimin e nje -**
- (a) makinerie apo punishteje;
 - (b) ndertesë; ose

(c) strukture.Zhvillimi
nuk Lejohet:

- B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B—
- (a) per tokat e nje miniere nentokesore—
 - (i) ne vende per te cilet nuk është marre aprovimi; ose
 - (ii) ne toka te cilat pershkruhen ne paragrafin D.1(b), pervec rasteve kur plani i tokes është depozituar prane autoritetit te planifikimit te minierave perpara dates 5 Qershor 1989; ose,
 - (b) ne qofte qellimi i zhvillimit do jete i ndryshem nga sa me poshte—
 - (i) qellime ne lidhje me punimet ne miniere,
 - (ii) trajtimi, pregatitja per shitje, konsumimi, ose perdorimi i minerale te nxjerra apo te sjella ne siperfaqen e kesaj miniere; ose
 - (iii) magazinimi ose zhvendosja nga miniera i mineraleve te tilla, produkteve ose mbeturinave te tyre.

B.2 Aprovimi paraprak nuk duhet te refuzohet ose kushtezohet pervec rasteve kur autoriteti është i bindur se—

- (a) zhvillimi i propozuar demton mireqenien e zones perreth dhe kur mund te behen modifikime ose te vihen kushte te aresyeshme per te shmangur ose reduktuar kete rrezik;
- (b) zhvillimi i propozuar duhet dhe ne menyre te aresyeshme mund te vendoset diku tjeter.

Kusht:

- B.3 Zhvillimi lejohet nga Klasa B pasi i nenshtrohet kushtit qe perpara mbarimit te periudhes 24 mujore nga data e mbarimit te punimeve minerare, ose te ndonje periudhe me te gjate per te cilen ka rene dakord me shkrim autoriteti i planifikimit minerar -
- (a) te gjitha ndertesat, punishtet apo makinerite e lejuara nga Klasa A do te zhvendosen nga toka, pervec rasteve kur është rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar; dhe
 - (b) toka duhet te kthehet, kur është praktikisht e mundur, ne kushtet perpara fillimit te zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat është rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar.

Klasa C:

**Zhvillimi
Lejohet**

C. Kryerja e punimeve me aprovimin e autoritetit të planifikimit minerar për mirembajtjen, apo sigurinë e një miniere ose miniere që nuk përdoret, ose për sigurinë e sipërfaqes së tokës së një miniere ose pranë një miniere të përdorur ose të përdorur.

**Zhvillimi
nuk Lejohet:**

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C në qofte se kryhet nga një Autoritet i Qymyrgurgurit ose nga ndonjë operues i licensuar sipas seksionit 65 të Aktit mbi Industrinë e Qymyrgurgurit 1994^(a).

**Aprovime
Paraprake:**

C.2(1) Nuk kërkohet aprovimi paraprak i autoritetit të planifikimit minerar për zhvillime të lejuara nga Klasa C, në qofte se—

- (a) minieres, minieres së përdorur ose pranë minieres ku kryhet zhvillimi, nuk i ndryshohet materialisht pamja e jashtme;
- (b) asnjë ndërtesë, makineri, punishte apo struktura —
 - (i) kalon lartësinë prej 15 metrave mbi nivelin e tokës, ose
 - (ii) kur ndërtesa, makineria, punishtja, ose struktura është zëvendësuar, riorganizuar ose riparuar, e kalon lartësinë 15 metra mbi nivelin e tokës ose lartësinë e asaj të mëparshme përpara zhvillimit, merret cilado lartësi të jetë me e madhe, dhe
- (c) zhvillimi konsiston në zgjerimin, ndryshimin, ose zëvendësimin e një ndërtese ekzistuese, brenda kufijve të vendosur në paragrafin (3).

(2) Aprovimi paraprak nuk duhet të refuzohet ose kushtëzohet përveç rasteve kur autoriteti është i bindur se—

- (a) zhvillimi i propozuar demton mireqenien e zonës përreth dhe kur mund të behen modifikime ose të vihen kushte të arsyeshme për të shmangur ose reduktuar këto rreziqe;
- (b) zhvillimi i propozuar duhet dhe në mënyrë të arsyeshme mund të vendoset diku tjetër.

(3) Kufijte së cilëve i referohet paragrafi C.2(1)(c) janë—

^(a) 1994c.21.

- (a) madhësia kubike e një ndërtese që është zgjeruar, ndryshuar apo zëvendësuar nuk është me e madhe se 25% e ndërtesës ekzistuese, dhe
- (b) sipërfaqja e dyshemese së ndërtesës së zgjeruar, ndryshuar, ose zëvendësuar, nuk është me e madhe se 1,000 metra katror.

**Interpretime
te Pjeses 19:**

D.1 Një pjesë të tokës quhet vend punimi i aprovuar për qëllime të Pjesës 19 në qofte se—

- (a) është e identifikuar në një leje planifikimi ose në ndonjë dokument tjetër në pritje të kësaj leje, si tokë që mund të përdoret për zhvillimet e përkrahura në këtë pjesë; ose
- (b) në çdo rast tjetër, është toka që i bashkëngjitet dhe ka rrugë hyrje direkte me një miniere nëntokësore e cila me 5 Dhjetor 1988 përdoret për qëllime të kësaj miniere, në lidhje me qëllimet e përkrahura në paragrafin A.1(b)(i) ose (ii) ose paragrafin B.1(b)(i) deri (iii) me sipër.

D.2 Për qëllime të Pjesës 19—

- “rrugë hyrje direkte” do të thotë një lidhje e sipërfaqes me punimet nëntokësore që përdoret normalisht për transportimin e mineraleve, materialeve, dheut dhe njerezve;
- “tokë minerare ndihmese” do të thotë tokë që i bashkëngjitet dhe e zënë nga një miniere në të cilën kryhen punime të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve sipas lejes së planifikimit të dhënë ose që do të jepet nën Pjesën III të Aktit;
- “minerale” nuk përfshin qymyrgurguri, përveç qymyrgurgurit të përfituar ose përpunuar gjatë punimeve që kryhen vetëm për qëllime të eksplorimit për qymyrgurguri, ose për germimin dhe heqjen e qymyrgurgurit të nevojshëm për t’u germuar ose hequr për qëllime që nuk përfshihen në nxjerrjen e mirefillte të qymyrgurgurit apo të produkteve të tij.
- “aprovim paraprak i autoritetit të planifikimit minerar” nënkupton aprovim paraprak me shkrim nga ky autoritet të një propozimi të detajuar për vendosjen, projektin, dhe pamjen e jashtme të një ndërtese, makinerie apo punishteje të propozuar për t’u ngritur, instaluar, zgjeruar, ose ndryshuar;

- “miniëre nentokesore” është një miniëre në të cilën mineralet nxirren kryesisht me metoda nentokesore.

PJESA 20

ZHVILLIME NE MINIERAT E QYMYRGURIT NGA AUTORITETI I QYMYRGURGURIT DHE SIPERMARRES TE LICENSUAR

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

A. Zhvillimi nga një sipermarrës i licensuar nga Autoriteti i Qymyrgurit, në një miniëre që ka filluar përpara 1 Korrikut 1948, që konsiston në—
(a) nxjerrjen dhe perpunimin nentokesor të qymyrgurgurit ose mineraleve të lidhur me qymyrgurin në një shtrat qymyrguri; kryerjen e zhvillimeve nentokesore të cilat duhet për të arritur dhe punuar qymyrgurin ose minerale të lidhur me qymyrgurin në një shtrat qymyrgur

Kushte:

A.1 Zhvillimi lejohet nga Klasa A me kushtet e mëposhtme—

(a) pasi i nënshtrohet paragrafit (b)

(i) zhvilluesi duhet të aplikojë tek autoriteti i planifikimit mineralar për aprovimin e skemave të restaurimit, përpara datës 31 Dhjetor 1995 ose përpara një date të mëvonshme për të cilën autoriteti i planifikimit mineralar ka rënë dakord me shkrim, përveç rasteve kur një aprovim për restaurim ekziston, ose punimet mineralare kanë mbaruar perfundimisht.

(ii) kur ekziston një skemë e aprovuar restaurimi, restaurimi dhe punimet perfunduese duhet të kryhen në përputhje me atë skemë;

(iii) në qoftë se një skemë restaurimi e aprovuar nuk përcakton periudhën brenda së cilës restaurimi, ose punimet perfunduese duhet të kryhen, i nënshtrohet kushteve më poshtë--

(aa) restaurimi duhet të kryhet përpara perfundimit të periudhës 24 mujore nga data kur punimet mineralare janë mbyllur perfundimisht, ose nga data kur aplikimi për aprovimin e skemës së restaurimit sipas nen-paragrafit (a)(i) është konfirmuar, cilado që të jetë me e vonshme, dhe

- (bb) punimet perfunduese, në qoftë se ka, në lidhje me një vend punimi, duhet të zbatohen gjatë një periudhe 5 vjeçare ose nga data kur restaurimi në lidhje me atë pjesë është perfunduar, ose nga data kur aplikimi për aprovimin i një skemë restaurimi sipas nen-paragrafit (a)(i) është konfirmuar, cilado që të jetë me e vonshme,
- (iv) kur nuk ka skemë restaurimi të aprovuar--
- (aa) të gjitha ndertesat, makineritë, punishtet dhe strukturat të përdorura në lidhje me punime në ndonjë miniëre qymyrguri duhet të zhvendosen nga vendi i autorizuar, përveç rasteve kur është rënë dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit mineralar, dhe
- (bb) toka duhet, në qoftë se është e mundur, të kthehet në kushtet përpara punimeve, ose në kushtet që është rënë dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit mineralar, përpara perfundimit të periudhës së specifikuar në paragrafin (v);
- (v) periudha së cilës i referohet nen-paragrafi (iv) është--
- (aa) periudha 24 mujore nga data kur punimet mineralare kanë perfunduar, ose në qoftë se është bërë një aplikim për per aprovim për restaurim sipas paragrafit (a)(i) përpara asaj date, 24 muaj nga data kur aplikimi është vendosur perfundimisht, cilado që të jetë me vonë, ose
- (bb) cdo periudhe tjetër me e gjatë për të cilën është rënë dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit mineralar;
- (vi) për qëllime të nen-paragrafit (a), një aplikim për aprovim për një skemë restaurimi është vendosur perfundimisht kur plotësohen kushtet e mëposhtme--
- (aa) është vendosur për cdo veprim në aplikim, duke përfshirë veprime mbi ose si rrjedhim të një aplikimi nën seksionin 288 të Aktit, dhe
- (bb) ka skaduar koha për apelim nën seksionin 78 (e drejta për të apeluar kundër vendimeve planifikuese dhe mosmarrjes së ketyre vendimeve), ose për aplikim ose riaplikim nën seksionin 288 të Aktit;
- (b) nen-paragrafi (a) nuk aplikohet tek toka në lidhje me të cilën ekziston leje planifikimi e cila—
- (i) është dhënë prej një aplikimi nën Pjesën III të Aktit, dhe

(ii) është zbatuar.

Interpretime te Klases A:

A.2 Per qellime te Klases A—

- “sipermarres i licensuar nga Autoriteti i Qymyrgurit” do te thote cdo person qe eshte autorizuar me licence sipas Pjeses II te Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994, per te kryer punime minerare te cilave i aplikohet seksioni 25 i Aktit;
- “skeme restaurimi e aprovuar” do te thote nje skeme restaurimi qe eshte aprovuar pasi aplikimi i bere sipas paragrafit A.1(a)(i) eshte vendosur perfundimisht, aprovuar (me ose pa kushte) ose ndryshuar me aprovim me shkrim nga autoriteti i planifikimit minerar (me ose pa kushte);
- “minerale ne lidhje me qymyrgurin” do te thote mineral qe nuk jane qymyrgur, por qe fitohen nga punimet ne minierat e qymyrgurit;
- “shtrat qymyrguri i caktuar” do te thote toke e identifikuar, ne lidhje me paragrafin (a) te perkufizimit te “shtrat qymyrguri”, ne nje plan per shtratin e qymyrgurit qe eshte depozituar me autoritetin e planifikimit minerar perpara 30 Shtatorit 1993;
- “punime te mepareshme ne miniera te qymyrgurit” ka te njejtin kuptim si ne seksionin 54(3) te Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994 (detyrime per te restauruar token e perdorur per punimeve minerare) dhe referenca ne Klasen A e perdorimit te cdo gjeje ne lidhje me punime te tilla, perfshin referenca per perdorimin e tyre ne lidhje me aktivite te kryera per qellime te ketyre punimeve;
- “skema restaurimi” do te thote skema qe permbajne dispozitat per rivendosjen, restaurimin e punimet perfundimtare te cdo vendi qe eshte i autorizuar dhe qe eshte perdorur ndonjehere ne lidhje me ndonje punim te meparshem ne miniere qymyrguri; dhe
- “Plan per shtratin e qymyrgurit” do te thote nje plan ose plane te nje shkalle jo me pak se 1 me 25,000 qe tregon—
 - (a) toka qe perfshijne zgjerimin maksimal te shtrateve te qymyrgurit apo shtrateve qe mund te jene punuar nga makineri qe kane ekszistuar ne miniere me 13 Nentor 1992, pa zhvillime te metejshme ne nje vend te autorizuar pervec

zhvillimeve te lejuara nga Klasa B e Pjeses 20 te Aneksit 2 te Urdhreses mbi Planifikimin e Zhvillimit te Pergjithshem ne Qytete e Fshatra 1988^(a), sic eshte miratuar fillimisht;

- (b) cdo rruge hyrje aktive e perdorur ne lidhje me token referuar ne paragrafin (a) te ketij perkufizimi;
- (c) Rrjeti nacional i vijave dhe numrat perkates qe tregohen ne kartat kartografike;
- (d) Nje kolone tipike te shtrat-grafit qe tregon thellesite mesatare te shtratit te qymyrgurit referuar ne paragrafin (a) te ketij perkufizimi.

Klasa B: Zhvillimi Lejohet

B. Zhvillime nga nje sipermarres i licensuar nga Korporata Britanike e Qymyrgurit, ne miniera qe kane filluar aktivitetin perpara dates 1 Korrik 1948, qe konsistojne ne —

- (a) nxjerrjen dhe perpunimin nentoke te qymyrgurit ose te mineraleve te lidhur me qymyrgurin ne nje shtrat qymyrguri te cakuar; ose
- (b) zbatimin e zhvillimeve nentoke qe kerkohen me qellime qe te arrihen qymyrguri dhe keto minerale dhe te perpunohen ne nje shtrat qymyrguri te caktuar;

Interpretime te Klases B

B.1 Per qellime te Klases B—

- “shtrat qymyrguri i caktuar” ka kuptimin si ne paragrafin A.2 me siper;
- “minerale te lidhur me qymyrgurin” do te thote minerale te ndryshme nga qymyrguri qe mund te punohen vetem ne lidhje me punimet me qymyrgurin, ose qe mund te sillen ne siperafe vetem duke perdorur nje miniere qymyrguri; dhe
- “sipermarres i licensuar nga Korporata Britanike e Qymyrgurit” do te thote cdo person i autorizuar per te kryer punime minerare nga seksioni 25(3) i Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994 (licenca mbi punimet minerare te qymyrgurit).

Klasa C: Zhvillimi

C. Cdo zhvillim qe kerkohet per qellime te nje

^(a) S.I. 1988/1813; Aneksi 2 e Urdhreses mbi Planifikimin e Zhvillimit te Pergjithshem ne Qytete e Fshatra 1988 eshte revokuar nga kjo Urdhrese.

Lejohet

miniere dhe qe zbatohet ne nje vend punimi te autorizuar ne ate miniere nga nje operator i licensuar, ne lidhje me punimet e nxjerrjes e perpunimit te qymyrgurit.

Zhvillimi
nuk Lejohet

C.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa C ne qofte se—

- (a) pamja e jashtme e minieres do te ndryshohet materialisht;
- (b) ndonje ndertese, punishte apo makineri, strukture ose ngritje ose cdo depozite mineralesh apo mbeturinash –
 - (i) kalon lartesine 15 metra mbi nivelin e tokes;
 - (ii) kur nje ndertese makineri apo punishte do te riorganizohet, zevendesohet, ose riparohet, zhvillimi qe rezulton kalon lartesine 15 metra nga niveli i tokes ose lartesine e ndertimit fillestar perpara zhvillimit, merret cilado lartesi te jete me e madhe;
- (c) siperfaqja e dyshemese se nje ndertese te ngritur (pervec zevendesimeve) kalon 1,000 metra katror;
- (d) madhesia kubike e nje ndertese te zevendesuar, zgjeruar apo ndryshuar kalon madhesine kubike te ndertesese origjinale me me shume se 25%, ose siperfaqja e dyshemese se ndertesese se re kalon me shume se 1,000 meter katror ate te ndertesese origjinale;
- (e) zhvillimi behet me qellim krijimi te nje rruge hyrje te re ne nentoke ose per te permiresuar nje rruge hyrje ekzistuese (qe nuk eshte aktive) te punimeve nentoke; ose
- (f) zbatohet ne token se ciles i aplikohet pershkrimi ne paragrafin F.2(1)(b), dhe plani i tokes nuk eshte depozituar prane autoritetit te planifikimit minerar perpara 5 Qershorit 1989.

Kushte:

C.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa C pasi i nenshtrohet kushtit qe perpara mbarimit te periudhes 24 mujore nga data e mbarimit te punimeve minerare, ose te ndonje periudhe me te gjate per te cilen ka rene dakord me shkrim autoriteti i planifikimit minerar –

- (a) te gjitha ndertesat, punishtet apo makinerite, strukturat dhe depozitimet e mineraleve ose mbeturinave te lejuara nga Klasa C do te zhvendosen nga toka, pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar; dhe

- (b) toka duhet te kthehet, kur eshte praktikisht e mundur, ne kushtet perpara fillimit te zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar.

**Klasa D:
Zhvillimi
Lejohet**

D. Cdo zhvillim qe kerkohet ne nje miniere qe zbatohet ne nje vend te autorizuar ne kete miniere nga nje operues i licensuar ne lidhje me punime te nxjerrjes dhe perpunimit te qymyrgurit dhe me aprovim paraprak nga autoriteti i planifikimit mineral.

Zhvillimi
nuk Lejohet

D.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa D ne qofte se—

- (a) zhvillimi behet me qellim krijimi te nje rruge hyrje te re ne nentoke ose per te permiresuar nje rruge hyrje ekzistuese (qe nuk eshte aktive) te punimeve nentoke; ose
- (b) zbatohet ne token se ciles i aplikohet pershkrimi ne paragrafin F.2(1)(b), dhe plani i tokes nuk eshte depozituar prane autoritetit te planifikimit minerar perpara 5 Qershorit 1989.

Kushte:

D.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa D pasi i nenshtrohet kushtit qe perpara mbarimit te periudhes 24 mujore nga data e mbarimit te punimeve minerare, ose te ndonje periudhe me te gjate per te cilen ka rene dakord me shkrim autoriteti i planifikimit minerar –

- (a) te gjitha ndertesat, punishtet apo makinerite, strukturat dhe depozitimet e mineraleve ose mbeturinave te lejuara nga Klasa D do te zhvendosen nga toka, pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar; dhe
- (b) toka duhet te kthehet, kur eshte praktikisht e mundur, ne kushtet perpara fillimit te zhvillimit, ose ne kushtet per te cilat eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar.

Interpretime
te Klases D:

D.3 Aprovimi paraprak i referuar ne Klasen D nuk duhet te refuzohet ose te kushtezohet pervec rasteve kur autoriteti eshte i bindur se duhet bere nje gje e tille sepse—

- (a) zhvillimi i propozuar demton mireqenien e zones perreth dhe mund te behen modifikime ose mund

te vihen kushte te aresyeshme per te shmangur ose reduktuar kete demtim;

- (b) zhvillimi i propozuar duhet dhe mund te zhvendoset ne menyre te aresyeshme diku tjeter.

**Klasa E:
Zhvillimi
Lejohet**

E. Zhvillime nga nje operues i licensuar nga Autoriteti i Qymyrgurit, me aprovim paraprak te autoritetit te planifikimit minerar, qe duhen per mirembajtjen ose sigurine e nje miniere ose miniere te paperdurur, ose per qellime te marrjes se masave te sigurise ne siperfaqen e tokes tek ose prane nje miniere ose miniere te paperdurur.

**Aprovime
pararake:**

E.1 Aprovimi paraprak i autoritetit te planifikimit minerar per zhvillime te lejuar nga Klasa E, nuk kerkohet ne qofte se -

- (a) pamja e jashtme e nje miniere ose nje miniere te paperdurur tek ose prane asaj ku do te kryhet zhvillimi nuk do te ndryshohet materialisht;
- (b) asnje ndertese, makineri apo punishte, strukture apo ngritje—
- (i) kalon lartesine 15 metra mbi siperfaqen e tokes, ose
- (ii) kur nje ndertese makineri apo punishte do te riorganizohet, zevendesohet, ose riparohet, zhvillimi qe rezulton kalon lartesine 15 metra nga niveli i tokes ose lartesine e ndertimit fillestar perpara zhvillimit, merret cilado lartesi te jete me e madhe, dhe
- (c) zhvillimi konsiston ne zgjerimin, ndryshimin, ose zevendesimin, e nje ndertese ekzistuese, brenda kufijve te caktuar ne paragrafin (3).

(2) Aprovimi i referuar ne Klasen E nuk do te refuzohet ose kushtezohet, pervec rasteve kur autoriteti eshte i bindur qe duhet bere nje gje e tille sepse—

- (a) zhvillimi i propozuar demton mireqenien e zones perreth dhe mund te behen modifikime ose mund te vihen kushte te aresyeshme per te shmangur ose reduktuar kete demtim; ose
- (b) zhvillimi i propozuar duhet dhe mund te zhvendoset ne menyre te aresyeshme diku tjeter.

(3) Kufijte e referuar ne paragrafin E.1(1)(c) jane—

(a) madhesia kubike e nje ndertese pasi eshte zgjeruar, ndryshuar apo zevendesuar nuk kalon madhesine e nderteses ekzistuese me me shume se 25%; dhe

(b) siperfaqja e dyshemese e nderteses se zgjeruar, ndryshuar apo zevendesuar nuk kalon ate te nderteses ekzistuese me me shume se 1000 metra katror.

**Interpretime
te Pjese 20:**

F.1 Per qellime te Pjeses 20 -

- "rruge hyrje aktive" do te thote nje rruge hyrje nga siperfaqja per tek punimet nentoke qe perdoret rregullisht dhe normalisht per te transportuar qymyrgurin, materialet, dheun dhe njerezit;
- "punime miniere" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 65 te Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994 dhe referenca qe i behen zhvillimeve ose perdorimeve ne lidhje me punimet ne miniere do te perfshijne referencat per zhvillime ose perdorime per qellime te kryerjes se ketyre punimeve;
- "operues te licensuar" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 65 te Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994;
- "aprovim paraprak nga autoriteti i planifikimit minerar" do te thote aprovim paraprak me shkrim nga ky autoritet te nje propozimi te detajuar per vendosjen, projektin, dhe pamjen e jashtme te nje ndertese, makinerie apo punishteje, strukture te propozuar per tu ndertuar, ngritur, instaluar apo ndryshuar.

F.2 (1) Duke ju nenshtruar paragrafit (2), toke eshte nje vend punimi i autorizuar per qellime te Pjeses 20 ne qofte se—

- (a) identifikohet ne nje leje te dhene planifikimi ose ne ndonje dokument tjeter qe tregon se leje do te jepet, si toke qe mund te perdoret per zhvillime te pershkruara ne kete Pjese; ose
- (b) ne cdo rast tjeter, eshte toke ngjitur nje rruge hyrje aktive e cila, me 5 Dhjetor 1988, perdorej per qellime te punimeve ne miniere.

(2) Per qellime te nen-paragrafit (1), toka nuk konsiderohet ne perdorim ne lidhje me punimet ne miniere ne qofte se—

- (a) perdoret si nje depozite e perhereshme e mbeturinave te dala nga nxjerrja dhe punimi i mineraleve; ose
- (b) eshte ne, mbi ose nen nje hekurudhe, konvenjer, rruge ajrore, linje elektrike ajrore, ose tubacion, qe nuk jane rrethuar me toke te perdorur per keto qellime.

PJESA 21

HEDHJA E MBETURINAVE NE NJE MINIERE

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

A. Depozitimi, ne vende te perdorura si miniere, ose toke ndihmese te minieres, i mbeturinave te rrjedhura nga nxjerrja dhe punimi i mineraleve ne miniere ose nga minerale te sjellura ne siperfaqe ne kete miniere, ose nga trajtimi dhe pregatitja per shitje, konsumimi, ose perdorimi i mineraleve nga miniera.

Zhvillimi nuk Lejohet

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—**
- (a) ne rastin e mbeturinave te depozituara ne nje ekskavim, mbeturinat duhet te depozitohen ne lartesine mbi nivelin e tokes ngjitur me ekskavimin, pervec rasteve kur caktohet ndryshe ne skemen e menaxhimit te mbeturinave ose nje skeme te caktuar;
- (b) ne cdo rast tjeter, zona e siperfaqes ose e lartesia e depozites (te matur me 21 Tetor 1988) rritet me me shume se 10%, pervec rasteve kur kjo rritje parashikohet ne nje skeme te menaxhimit te mbeturinave ose ne nje skeme te caktuar;

Kushte:

- A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—**
- (a) pervec rasteve te nje skeme te caktuar ose te nje skeme te menaxhimit te mbeturinave te aprovuar nga autoriteti i planifikimit minerar, zhvilluesi do te paraqese brenda 3 muajve ose brenda nje periudhe me te gjate te specifikuar nga autoriteti,

nje skeme te menaxhimit te mbeturinave per aprovim nga autoriteti, ne qofte se nje gje e tille kerkohet nga ky autoritet.

- (b) Kur nje skeme e menaxhimit te mbeturinave ose nje skeme e caktuar eshte aprovuar, depozitimi i mbeturinave dhe te gjithe aktivitetet qe lidhen me kete depozitim do te kryhen ne perputhje me skemen e aprovuar.

Interpretime te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A—

- “toke ndihmese e minieres” do te thote toke ngjitur me minieren ose e perfshire ne miniere ne te cilen kryhen punimet e nxjerrje dhe perpunimit te mineraleve ne perputhje me lejen e planifikimi te dhene ose qe do te jepet sipas Pjese III te Aktit (kontrolli mbi zhvillimet); dhe
- “skeme e menaxhimit te mbeturinave” do te thote nje skeme e kerkuar nga autoriteti i planifikimit minerar per tu paraqitur per aprovim ne perputhje me kushtet e paragrafit A.2(a), qe percakton dispozitat per –
 - (a) menyren e depozitimit te mbeturinave pas dates se aprovimit te kesaj skeme (pervec mbeturinave te depozituara ne toke per tu perdorur per mbushjen e eskavimeve minerare ne miniere ose ne ndonje toke ndihmese sipas kushteve te lejes se planifikimit te dhene ose per tu dhene nen Pjesen III te Aktit);
 - (b) kur eshte e pershtatshme, heqjen dhe ruajtjen e pjeses se siperme dhe te poshtme te dheut;
 - (c) restaurimin dhe kujdesin perfundimar per token.

Klasa B: Zhvillimi Lejohet

B. Depozitimi ne toke te perfshire ne nje vend punimi te derdhjes se mbeturinave qe rezultojne nga punime minerare te qymyrgurit me 1 Korrik 1948.

Zhvillimi nuk Lejohet:

- B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se nuk eshte ne perputhje me nje skeme te caktuar te aprovuar nga autoriteti i planifikimit minerar perpara dates 5 Dhjetor 1988.**

Interpretime

te Klases B:

B.2 Per qellime te Klases B—

- “punime minerare te qymyrgurit: ka te njejtin kuptim si ne seksionin 65 te Aktit mbi Industrine e Qymyrgurit 1994 ^(a) (interpretime).

Interpretime
te Pjeses 21:

C. Per qellime te Pjeses 21—

- “skeme e caktuar” eshte nje skeme, ndryshe nga skema e menaxhimit te mbeturinave, qe kerkon aprovimin e autoritetit te planifikimit minerar ne perputhje me kushtet apo kufizimet ne nje leje planifikimi e dhene ose qe do te jepet sipas Pjese III te Aktit (kontrolli mbi zhvillimet), per caktimin e dispozitave per menyren ne te cilen do depozitohen mbeturinat dhe dispozitat e aktiviteteve ne lidhje me kete depozitim.

PJESA 22**EXPLORIMI I MINERALEVE****Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet****A. Zhvillime ne cdo toke gjate nje periudhe 28 ditore qe konsistojne ne --****(a) shpimin e sondave;****(b) kryerjen e studimeve sizmike; ose****(c) kryerjen e germimeve,****per qellime te eksplorimit te mineraleve, dhe dispozitave te instalimit ne toke, ose ne tokat ngjitur te strukturave te duhura ne lidhje me keto zhvillime.**Zhvillimi
nuk Lejohet:

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—

(a) konsiston ne shpimin e sondave per kerkim te naftes;

(b) ndonje punim qe do zbatohet brenda 50 metrave te ndonje pjese te nje ndertese banimi ose te nje ndertese te perdorur si spital, ose shkollë;

(c) ndonje punim qe do te kryhet brenda nje Parku Kombetar, nje zone me bukuri te rralle natyrore,

^(a) 1994 c.21.

nje zone me interes te vecante arkeologjik ose me interes te vecante shkencor;

(d) do perdoret me shume se 1 kilogram eksploziv;

(e) cdo eskavim i referuar ne paragrafin A(c) i kalon 10 metra thellesi, ose 12 metra katror ne siperfaqe;

(f) ne rastin e pershkruar ne paragrafin A(c) do behen me shume se 10 eskavime ne nje zone prej 1 hektare gjate nje periudhe 24 mujore; ose

(g) cdo strukture e ngritur ose e sjelle kalon lartesine 12 metra, ose kur struktura eshte brenda 3 kilometrave largesi nga perimetri i nje aeroporti, kalon lartesine 3 metra.

Kushte

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A sipas kushteve te meposhtme—

(a) asnje punim mund te kryhet nga 6:00 pasdite deri ne 7:00 te mengjesit;

(b) asnje peme ne toke duhet te zhgulet, rrezohet, pritët apo shkurtohet dhe asnje nuk mund te behet ne vend qe mund te coje ne demtimin e nje peme, pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar;

(c) perpara se te behet eskavimi (pervec shpimit), pjesa e siperme dhe e poshtme e tokes duhet te hiqet vecmas nga toka e germuar dhe te ruhet vecmas materialeve te tjera te germuara;

(d) pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit minerar ka rene dakord ndryshe me shkrim, brenda nje periudhe 28 ditore nga perfundimi i punimeve—

(i) cdo strukture e lejuar nga Klasa A dhe cdo mbeturine e nxjerre nga zhvillimi duhet te zhvendoset nga toka;

(ii) cdo vrime nga shpimi duhet te mbyllet plotesisht,

(iii) cdo eskavim tjeter duhet te mbushet me materiale nga toka;

(iv) siperfaqja e tokes ne te cilen eshte kryer zhvillimi duhet te nivelohet dhe cdo pjese e siperme e dheut te rivendoset ne shtresen e siperfaqes, dhe

(v) kur eshte praktikisht e mundur, toka duhet te kthehet ne gjendjen e saj perpara se te fillonte zhvillimi, duke perfshire kryerjen e mbjelljeve dhe hedhjeve te farave te nevojshme.

**Klasa B:
Zhvillimi
Lejohet****B. Zhvillime ne cdo pjese toke qe konsistojne ne—**

- (a) shpimin e sondave;
 (b) kryerjen e studimeve sizmike; ose
 (c) kryerjen e germimeve,
 per qellime te eksplorimit te mineraleve, dhe dispozitave te instalimit ne toke, ose ne tokat ngjitur te strukturave te duhura ne lidhje me keto zhvillime.

Zhvillimi
 nuk lejohet:

- B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—
 (a) konsiston ne shpimin e sondave per kerkim te naftes;
 (b) zhvilluesi nuk e ka njoftuar paraprakisht me shkrim autoritetin e planifikimit minerar per qellimet e kryerjes se ketyre punimeve (duke specifikuar natyren dhe vendin e zhvillimit);
 (c) periudha e caktuar nuk ka mbaruar;
 (d) do perdoret me shume se 2 kilograme eksploziv;
 (e) ndonje eskavim i referuar ne paragrafin B(c) i kalon 10 metra thellesi ose i kalon 12 meter katror ne siperfaqe;
 (f) ndonje strukture e ngritur ose e sjelle ne vend kalon lartesine 12 metra.

Kushte:

- B.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa B pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—
 (a) zhvillimi do zbatohet ne perputhje me detajet e caktuara ne njoftimin derguar autoritetit te planifikimit minerar sic referohet ne paragrafin B.1.(a) me siper, pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit minerar ka rene dakord ndryshe me shkrim;
 (b) asnje peme ne toke duhet te zhgulet, rrezohet, pritset apo shkurtohet dhe asgje nuk mund te behet qe mund te coje ne demtimin e nje peme, pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar;
 (c) perpara se te behet eskavimi (pervec shpimit), pjesa e siperme dhe e poshtme e tokes duhet te hiqet vecmas nga toka e germuar dhe te ruhet vecmas materialeve te tjera te germuara;
 (d) pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit minerar ka rene dakord ndryshe me shkrim, brenda nje periudhe 28 ditore nga perfundimi i punimeve—
 (i) cdo strukture e lejuar nga Klasa B dhe cdo mbeturine e nxjerre nga zhvillimi duhet te zhvendoset nga toka;

- (ii) cdo vrime nga shpimi duhet te mbyllet plotesisht,
 (iii) cdo eskavim tjeter duhet te mbushet me materiale nga toka;
 (iv) siperfaqja e tokes ne te cilen eshte kryer zhvillimi duhet te nivelohet dhe cdo pjese e siperme e dheut te rivendoset ne shtresen e siperfaqes, dhe
 (v) kur eshte praktikisht e mundur, toka duhet te kthehet ne gjendjen e saj perpara se te fillonte zhvillimi, duke perfshire kryerjen e mbjelljeve dhe hedhjeve te farave te nevojshme,
 dhe
 (e) zhvillimi duhet te perfundoje jo me vone se 6 muaj nga data e perfundimit te periudhes te caktuar, pervec rasteve kur eshte rene dakord ndryshe me shkrim me autoritetin e planifikimit minerar.

Interpretime
 te Klases B:

- B.3 Per qellime te Klases B—
 "periudhe e caktuar" do te thote periudha
 (a) 28 ditore pas njoftimit te referuar ne paragrafin B.1(b), kur nje direktive nuk eshte nxjerre sipas artikullit 7, ose data ne te cilen autoriteti i planifikimit minerar njoftoi zhvilluesin me shkrim qe nuk do te nxjerrin direktive, cilado periudhe te jete me e shkurter;
 (b) kur nje direktive nxirret sipas artikullit 7, 28 dite nga data ne te cilen njoftimi mbi kete vendim i eshte derguar Sekretarit te Shtetit, ose data ne te cilen autoriteti i planifikimit minerar njoftoi zhvilluesin se Sekretari i Shtetit e ka anuluar direktiven, cilado periudhe te jete me e shkurter.

Interpretime
 te Pjese 22:

- C. Per qellime te Pjeses 22—
 • "explorime mineralesh" do te thote percaktimi i prezences, ndodhjes ose cilesise se depozitave te mineraleve me qellim shfrytezimi; dhe
 • "strukture" perfshin nje ndertese, makineri apo punishte.

PJESA 23

ZHVENDOSJA E MATERIALEVE NGA DEPOZITA MINERAL PUNUESE

**Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet****A. Zhvendosja e materialeve te cfaredolloji nga nje rezerve.****Klasa B:
Zhvillimi
Lejohet****B. Zhvendosja e materialeve te cfaredolloji nga nje depozite mineral-punuese e ndryshme nga rezervat.**Zhvillimi
nuk Lejohet:

B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—

(a) zhvilluesi nuk ka njoftuar paraprakisht me shkrim autoritetin e planifikimit minerar per qellimin qe ka te kryej kete zhvillim dhe nuk i ka pajisur ata me detajet e nevojshme;

(b) depozita shtrihet ne nje zone me te madhe se 2 hektare, pervec rasteve kur depozita nuk permban minerale ose materiale te tjera te depozituara ne toke me shume se 5 vite me pare nga fillimi i zhvillimit; ose

(c) depozita rrjedh nga kryerja e punimeve te lejuara nen Pjesen 6 te ketij Aneksi ose te cdo Klase ne nje zhvillim te meparshem.

Kushte:

B.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa B pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

(a) zhvillimi do zbatohet ne perputhje me detajet e caktuara ne njoftimin derguar autoritetit te planifikimit minerar sic referohet ne paragrafin B.1.(a) me siper, pervec rasteve kur autoriteti i planifikimit minerar ka rene dakord ndryshe me shkrim;

(b) ne qofte se kerkohet nga autoriteti i planifikimit minerar, zhvilluesi do te paraqese brenda 3 muajve (ose brenda nje periudhe me te gjate te specifikuar nga autoriteti), nje skeme per restaurimin e vendit te punimeve;

(c) kur kerkohet nje skeme e tille, vendi duhet te kthehet dhe te restaurohet ne perputhje me dispozitat e aprovuara ne skeme;

(d) zhvillimi nuk do te filloje derisa periudha e caktuar ka perfunduar.

Interpretime
te Klases B:

B.3 Per qellime te Klases B—

- “detaje te nevojshme” jan enatyra e zhvillimit, vendi i sakte i depozitimit te mineraleve nga i cili duhet te zhvendosen materialet, menytrat e propozuara te hyrjes se automjeteve te transportimit ne vendin ku do te kryhen punimet, dhe data me e afert ne te cilen u depozituan mineralet qe jane tashme ne depozite;
- “periudhe e caktuar” do te thote periudha
 - (a) 28 ditore pas njoftimit te referuar ne paragrafin B.1(b), kur nje direktive nuk eshte nxjerre sipas artikullit 7, ose data ne te cilen autoriteti i planifikimit minerar njoftoi zhvilluesin me shkrim qe nuk do te nxjerrin direktive, cilado periudhe te jete me e shkurter;
 - (b) kur nje direktive nxirret sipas artikullit 7, 28 dite nga data ne te cilen njoftimi mbi kete vendim i eshte derguar Sekretarit te Shtetit, ose data ne te cilen autoriteti i planifikimit minerar njoftoi zhvilluesin se Sekretari i Shtetit e ka anuluar direktiven, cilado periudhe te jete me e shkurter.

Interpretime
te Pjeses 23:

- C. Per qellime te Pjeses 23 –
- “rezerve” do te thote nje depozite mineral punuese qe konsiston kryesisht ne minerale te cilat jane depozituar per qellime te perpunimit ose te shitjes.

PJESA 24
ZHVILLIME NGA OPERUES
TE KODEVE TE SISTEMEVE TE TELEKOMUNIKIMIT

**Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet**

A. Zhvillimi nga ose ne emer te nje operuesi te kodeve te sistemit te telekomunikimit per qellime te funksionimit te telekomunikacionit ne, mbi, ose nen toke te kontrolluar nga ky operues ose ne perputhje me licencen e tij, qe konsiston ne --

(a) instalimin, ndryshimin, ose zevendesimin e aparateve te telekomunikacionit,

- (i) konsiston ne instalimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje sistemi aparatesh brenda kuptimit te seksionit 8(6) te Aktit mbi Trafikun Rrugor (Patentat e Makinave dhe Sistemet e Informimit) 1989^(a) (perkufizime te sistemeve te informimit per shoferet, etj.);
- (j) ne rastin e instalimit te nje shtylle, mbi nje ndertese ose strukture e cila eshte me pak se 15 metra e larte, dhe kjo shtylle eshte 20 metra larg nje autostrade;
- (k) ne rastin e instalimit, ndryshimit, ose zevendesimit te nje vendi strehimi per pajisjet e radios—
 - (i) zhvillimi nuk eshte ne ndihme te perdorimit ose te ndonje aparati tjeer telekomunikacioni;
 - (ii) i kalon 90 meter kub ose, ne qofte se vendoset ne catine e nje ndertese, kalon 30 meter kub;
 - (iii) ne tokat e nenit 1(5), kalon 2 metra kub, pervec rasteve emergjente; ose
- (l) konsiston ne instalimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje aparati telekomunikimi, mbi, ose brenda parcelse se nje shtepie banimi.

Kushte:

A.2 (1) Zhvillimet e Klases A(a) dhe Klases A(c) lejohen pasi i nenshtrohen kushtit qe antena ose aparati mbeshtetes, strehimi i aparateve te radios, te ndertuara, instaluar, te ndryshuara apo zevendesuara mbi nje ndertese ne perputhje me kete leje, duhet te vendosen, sa te jete praktikisht e mundur, ne menyre qe te minimizohet ndikimi ne pamjen e jashtme te nderteses.

(2) Zhvillimet e Klases A(a) dhe Klases A(c) lejohen pasi i nenshtrohen kushtit qe aparati apo struktura ne perputhje me kete leje duhet te zhvendoset nga toka, ndertesa apo struktura mbi te cilen eshte vendosur—

- (a) kur skadon periudha e caktuar, ne qofte se zhvillimi eshte zbatuar ne nje toke te perfshire ne nenin 1(5) ne rast emergjence, ose
- (b) ne cdo rast tjetër, sa me shpejt te jete praktikisht e mundur, pas momentit kur nuk nevojitet me per qellime te telekomunikacionit, dhe nje toke e tille, ndertese apo strukture duhet te kthehet ne gjendjen qe ishte perpara zhvillimit ose ne

^(a) 1989 c.22.

nje gjendje tjetër per te cilen eshte rene dakord me shkrim me autoritetin e planifikimit lokal.

(3) Zhvillimet e Klases A(b) lejohen pasi i nenshtrohen kushtit qe cdo aparat apo strukture ne lidhje me kete leje duhet te zhvendoset nga toka me mbarimin e periudhes se caktuar dhe toka duhet te kthehet ne gjendjen e mepareshme, perpara zhvillimit.

(4) Zhvillimet e Klases A ne —

- (a) tokat e nenit 1(5) (pervec ne raste emergjente), ose
- (b) ne ndonje toke tjetër qe konsistojne ne konstruksionin, instalimin, ndryshimin ose zevendesimin e nje shtylle ose nje kuti telefoni publik, ose per strehimin e nje aparati radioje me nje volum me te madh se 2 meter kub, ose zhvillime ndihmese te strehimit te aparateve, lejohen pasi i nenshtrohen kushteve sa me poshte—
 - (i) kur zhvillimi i propozuar konsiston ne instalimin e nje shtylle brenda 3 kilometrave larg nga nje aeroport, zhvilluesi duhet te njoftoje Autoritetin e Aviacionit Civil ose Sekretarin e Shtetit per Mbrojtjen, sipas rastit, per propozimin, perpara se te behet aplikimi i kerkuar ne nen-paragrafin (ii);
 - (ii) perpara fillimit te zhvillimit, zhvilluesi duhet te aplikojte tek autoriteti i planifikimit lokal per te vendosur nese duhet aprovimi paraprak i ketij autoriteti per vendin e punimeve dhe pamjen e jashtme te zhvillimit;
 - (iii) aplikimi duhet te shoqerohet me --
 - (aa) nje pershkrim me shkrim te zhvillimit te propozuar dhe nje plan qe tregon vendin e propozuar se bashku me nje pagese te kerkuar;
 - (bb) ne rastet kur aplikohet nen-paragrafi (i), me nje vertetim qe tregon se eshte njoftuar per propozimin Autoriteti Civil i Aviacionit ose Sekretari i Shtetit per Mbrojtjen.
 - (iv) zhvillimi nuk do te filloje perpara se te ndodhe nje nga pika me poshte--
 - (aa) aplikanti merr nga autoriteti i planifikimit lokal nje njoftim me shkrim per vendimin qe nuk kerkohet aprovimi paraprak;
 - (bb) kur autoriteti i planifikimit lokal i jep aplikuesit njoftimin qe duhet te merret aprovimi paraprak; dhenia e ketij aprovimi

aplikantit brenda 28 diteve nga data ne te cilen u mor aplikimi nga aplikuesi; ose

(cc) skadimi i periudhes 28 ditore nga data ne te cilen autoriteti i planifikimit lokal mori aplikimin, pa marre asnje vendim nese aprovimi kerkohet apo jo, pa njoftuar aplikantin per ndonje vendim, ose pa i dhene aprovimin ose refuzuar aprovimin per vendin ose pamjen e jashtme te zhvillimit;

(v) me perjashtim te rasteve kur vendoset ndryshe me shkrim nga autoriteti i planifikimit lokal, zhvillimi do te zbatohet--

(aa) kur eshte marre aprovimi paraprak sic permendet ne paragrafin (iv)(bb), ne perputhje me detajet e aprovuar;

(bb) ne cdo rast tjeter, ne perputhje me detajet e paraqitura se bashku me aplikimin; dhe

(vi) zhvillimi duhet te filloje--

(aa) kur eshte marre aprovimi paraprak sic permendet ne paragrafin (iv)(bb), jo me vone se 5 vite nga data kur eshte marre aprovimi;

(bb) ne cdo rast tjeter, jo me vone se 5 vite nga data kur autoriteti i planifikimit lokal mori informacionin e referuar ne nen-paragrafin (iii).

(5) Ne raste emergjente, zhvillimi ne tokat qe perfshihen ne nenin 1(5) lejohet nga Klasa A pasi i neneshtrohet kushtit qe operuesi duhet t'i jape nje njoftim me shkrim autoritetit te planifikimit lokal permbi zhvillimin sa me shpejt te jete e mundur pasi ka filluar gjendja emergjente.

Interpretime te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A -

- "sistem antenash" do te thote disa antena te instaluara mbi nje ndertese ose strukture dhe qe operohen nga nje operues i vetem telekomunikimi ne perputhje me licencen e tij;
- "zhvillime ne ndihme te nje strehimi te aparateve te radios" do te thote ndertimi, instalimi, ndryshimi, ose zevendesimi i nje strukture, apo paisjeje qe i vine ne ndihme dhe qe jane te nevojshme per qellime te strehimit te paisjeve;
- "zhvillime ne perputhje me nje licence" do te thote zhvillime te kryera nga nje operues ne lidhje me nje

te drejte te dhene sipas kodit te telekomunikacionit, dhe ne perputhje me ndonje kusht qe lidhet me aplikimin e atij kodi sipas licences se tij;

- "toke qe kontrollohet nga nje operues" do te thote toke e zene nga nje operues qe ka nje interes sipas nje qeraje te dhene per jo me pak se 10 vjet;
- "shtylle" do te thote nje shtylle apo kulle radioje;
- "periudhe e caktuar" do te thote nje periudhe qe skadon -
 - (i) 6 muaj nga fillimi i konstruksioneve, instalimeve, ndryshimeve, ose zevendesimeve, te ndonje aparati ose strukture te lejuar nga Klasa A(a) ose Klasa A(c) ose nga fillimi i perdorimit te lejuar nga Klasa A(b), sipas rastit, ose
 - (ii) kur nuk ka nevojte me per nje aparat te tille, strukture, apo perdorim, cilado qe ndodh me perpara;
- "aparat telekomunikacioni" do te thote cdo aparat qe bie brenda perkufizimit te atij termi ne paragrafin 1 te Aneksit 2 te Aktit mbi Telekomunikacionin 1984 dhe perfshin mbrojtje per paisjet e radios;
- "kodi i telekomunikacionit" do te thote kodi qe permbahet ne Aneksit 2 te Aktit te vitit 1984;
- "operues i sistemit te telekomunikacionit" do te thote nje person qe ka marre licencen sipas seksionit 7 te Aktit te vitit 1984 qe i aplikon atij kodin e telekomunikacionit ne perputhje me seksionin 10 te atij Akti; dhe
- "sistem telekomunikimi" ka kuptimin e dhene ketij termi nga seksioni 4(1) i Aktit te vitit 1984 (kuptimi i sistemit te telekomunikimit dhe shprehjeve te tjera ne lidhje me te).

PJESA 25

ZHVILLIME TE TJERA TELEKOMUNIKIMI

Klasa A: Zhvillimi Lejohet

A. Instalimi, ndryshimi, ose zevendesimi mbi ndertesa ose struktura te larta 15 metra e siper, i antenave mikrovale dhe cdo strukture qe ka per qellim mbeshtetjen e ketyre antenave.

Zhvillimi
nuk lejohet:

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—
- ndertesa eshte nje banese ose ndertese a strukture brenda parceles se nje banese;
 - konsiston ne zhvillime te pershkruara ne paragrafin A te Pjeses 24;
 - zhvillimi rezulton ne prezencen e dy ose me shume antenave mbi ndertese apo strukture;
 - ne rastin e nje antene satelitore, madhesia e antenes, duke perfshire strukturen mbeshtetese, por jo elemetet ushqyes, kalon 90 centimentra;
 - ne rastin e antenave me mikrovale tokesore—
 - madhesia e antenes, kur matet nga cdo dimension pa perfshire ushqyesin, kalon 1.3 metrat; dhe
 - pjesa me e larte e antenes ose te struktures mbeshtetese eshte me shume se 3 metra me e larte se pjesa me e larte e nderteses apo struktures mbi te cilen eshte instaluar apo do instalohet;
 - ne qofte se do zbatohet ne tokat e nenit 1(5); ose
 - konsiston ne instalimin, ndryshimin, ose zevendesimin e aparateve brenda kuptimit te seksionit 8(6) te Aktit mbi Trafikun Rrugor 1989^(a) (perkufizime te sistemit informativ te shofereve, etj.).

Kushte:

- A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—
- antena duhet te vendoset, sa te jete e mundur, ne menyre qe te minimizohet ndikimi ne pamjen e jashtme te nje ndertese apo strukture mbi te cilen instalohet;
 - antena qe nuk duhet me per marrjen ose transmetimin e mikrovaleve te radios duhet te zhvendoset nga ndertesa apo struktura sa me shpejt te jete praktikisht e mundur.

Klasa B:
Zhvillimi
i Lejuar

B. Instalimi, ndryshimi, ose zevendesimi mbi nje ndertese apo strukture me lartesi me te vogel se 15 metra te nje antene satelitore.

Zhvillimi
nuk lejohet:

- B.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa B ne qofte se—

^(a) 1989 c.22.

- ndertesa eshte nje banese ose ndertese a strukture brenda parceles se nje banese;
- konsiston ne zhvillime te pershkruara ne paragrafin A te Pjeses 24;
- konsiston ne instalimin, ndryshimin, ose zevendesimin e aparateve brenda kuptimit te seksionit 8(6) te Aktit mbi Trafikun Rrugor 1989 (perkufizime te sistemit informativ te shofereve, etj.).
- madhesia e antenes (duke perjashtuar cdo element ushqyes, perforcues, ose montues) kur matet nga te gjitha anet kalon—
 - 90 centimetra ne rastet ku antena instalohet mbi nje strukture ose ndertese ne tokat e nenit 1(4);
 - 70 centimetra ne cdo rast tjeter.
- pjesa me e larte e antenes per tu instaluar mbi cati, kur instalohet e kalon lartesine e pjese me te larte te larte te catise;
- ekziston nje antene satelitore tjeter mbi ndertesën ose strukturen ku do te instalohet antena;
- konsiston ne instalimin e nje antene mbi oxhak;
- konsiston ne instalimin e nje antene mbi nje mur apo cati qe eshte perballe nje rruge ujore ne Broads, ose autostrade kudo tjeter.

Kushte

B.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa B pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

- antena duhet te vendoset, sa te jete e mundur, ne menyre qe te minimizohet ndikimi ne pamjen e jashtme te nje ndertese apo strukture mbi te cilen instalohet;
- antena qe nuk duhet me per marrjen ose transmetimin e mikrovaleve te radios duhet te zhvendoset nga ndertesa apo struktura sa me shpejt te jete praktikisht e mundur.

PJESA 26
ZHVILLIME NGA KOMISIONI ANGLEZ
PER NDERTESAT HISTORIKE DHE MONUMENTET

Klasa A:
Zhvillimi

A. Zhvillime nga ose ne emer te Komisionit Anglez

Lejohet per Ndertesar Historike dhe Monumentet, qe konsistojne ne --

(a) mirembajtjen, riparimin, ose restaurimin e ndonje ndertese apo monumenti;

(b) ngritjen e rrjetave mbrojtese, rrethimeve, ose mbulesave te krijuara per te mbrojtur ndertesen, apo monumentin; ose

(c) kryerjen e punimeve per te stabilizuar token prane nje gremine, rrjedhje uji ose bregu; ku punime te tilla kerkohen per qellime te ruajtjes se ketyre ndertesave apo monumenteve.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A(a) ne qofte se punimet kane te bejne me zgjerimin e ndertesave ose monumentit.

Kushtet:

A.2 Pervec zhvillimeve te Klases A(a), dhe Klases A(b) zhvillimi lejohet pasi i nenshtrohet kushtit qe cdo strukture e ngitur ne perputhje me kete leje do te zhvendoset pasi mbaron periudha 6 mujore (ose ndonje periudhe me e gjate per te cilen ka rene dakord me shkrim autoriteti i planifikimit lokal) qe fillon nga data ne te cilen puna per ngritjen e strukture ka filluar.

Interpretime
te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A—

- “ndertese apo monument” do te thote nje ndertese apo monument qe mbrohet nga Komisioni Anglez per Monumentet dhe Ndertesar Historike, ose qe menaxhohet apo eshte prone e ketij Komisioni.

PJESA 27

PERDORIMI NGA PJESETARET E ORGANIZATAVE ARGETUESE

**Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet**

A. Perdorimi i tokes nga pjesetare te organizatave argetuese per qellime argetimi ose dhenie mesimi, dhe ngritje ose vendosje te cadrave mbi toke per keto qellime.

Zhvillimi

nuk Lejohet:

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa a ne qofte se toka eshte ne parcelen e nje ndertese qe perdoret si banese.

Interpretime
te Klases A:

A.2 Per qellime te Klases A—

- “organizate argetuese” do te thote nje organizate qe ka nje certifikate perjashtimi nen seksionin 269 te Aktit mbi Shendetin Publik 1936 (fuqia e autoritetit lokal per te kontrolluar perdorimin e banesave te levizshme).

PJESA 28

ZHVILLIME NE PARQET E LODRAVE

**Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet**

A. Zhvillime ne toka qe perdoren si parqe lodrash qe konsistojne ne --

- (a) ngritjen e barakave, tezgave, ose instalimin e makinerive per tu perdorur ne lidhje me argetimin e publikut ne ambientet e parkut te lodrave; ose
- (b) zgjerimi, ndryshimi, ose zevendesimi i ndonje barake apo tezge ekzistuese, apo makinerie ne perdorim.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—

- (a) makineria apo punishtja —
- (i) kalon lartesine 25 metra ose lartesine e strukture ekzistuese (cilado te jete me e vogel), ne qofte se toka eshte brenda 3 kilometrave larg nga nje aeroport, ose
- (ii) kalon lartesine 25 metra, ne cdo rast tjeter;
- (b) ne rastin kur kemi te bejme me zgjerimin e nje ndertese ose strukture ekzistuese, ndertesa apo struktura si rezultat i zhvillimit i kalon 5 metra nga niveli i tokes ose lartesine e catise se ndertesave ekzistuese, cilado te jete me e madhe, ose
- (c) ne cdo rast tjeter, lartesia e nje ndertese apo strukture te ngritur, zgjeruar, ndryshuar, ose zevendesuar kalon lartesine 5 metra nga niveli i tokes.

Interpretime
te Klases A:

A.2 Per qellime te Klases A—

- “park lodrash” do te thote nje pjese toke e rrethuar, ose nje pjese e bregut te detit, qe perdoret kryesisht (jo perkohesisht) si nje panair lodrash ose per qellime te argetimit publik me anen e lodrave mekanike apo shfaqjeve te ndryshme; por ne rastet kur vetem nje pjese e tokes se rrethuar perdoret si park lodrash per argetim publik, vetem ajo pjese do konsiderohet si park lodrash dhe jo krejt rrethimi; dhe
- “baraka apo tezga” perfshijne ndertesa apo struktura te ngjashme me baraka apo tezga.

PJESA 29

SISTEMI I INFORMIMIT TE SHOFERAVE

Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet

A. Instalimi, ndryshimi, ose zevendesimi i aparateve nga ose ne emer te nje operuesi per sistemin e informimit te shoferave.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—**
- (a) ne raste te instalimit, ndryshimit, ose zevendesimit te aparateve ne vende qe nuk jane ndertesa apo struktura—
- (i) siperfaqja e bazes tokesore te aparatit kalon 1.5 metra katror; ose
- (ii) aparati kalon lartesine 15 metra mbi nivelin e tokes;
- (b) ne rastin e instalimit, ndryshimit, ose zevendesimit te aparateve mbi nje ndertese ose strukture tjeter—
- (i) pjesa me e larte e aparatit pasi instalohet, ndryshohet, ose zevendesohet kalon lartesine e pjeses me te larte te nderteses apo struktures me me shume se 3 metra; ose
- (ii) zhvillimi rezulton ne prezencen e me shume se dy antenave mikrovale mbi ndertese apo strukture.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushteve—

- (a) cdo sistem aparatesh duhet te vendoset, sa te jete e mundur, ne menyre te tille qe te minimizojne ndikimet ne pamjen e jashtme te nderteses apo struktures mbi te cilen eshte instaluar;
- (b) cdo sistem aparatesh qe nuk duhet me per informimin e shoferave duhet te zhvendoset sa me shpejt te jete praktikisht e mundur.

Interpretime
te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A –

- “operues i sistemit te informimit te shoferave” nenkupton nje person me licence operuesi sipas seksionit 10 te Aktit mbi Trafikun Rrugor 1989 (Patentat e Shoferave dhe Sistemi i Informimit); dhe
- “sistem aparatesh” ka kuptimin si ne seksionin 8(6) te ketij Akti (perkufizime te sistemit te informimit te shoferave, etj.)

PJESA 30

MBLEDHJA E TAKSAVE TE RRUGES

Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet

A. Zhvillime qe konsistojne ne --

- (a) **ngritjen dhe mirembajtjen, permiresimin, ose ndryshimin e ambienteve per mbledhjen e takses;**
- (b) **dispozitat e siperfaqes qe do perdoret per parkimin e automjeteve qe perdoren ne lidhje me mbledhjen e takses.**

Zhvillimi
nuk Lejohet

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—**
- (a) nuk kryhet brenda distances 100 metra (te matur ne toke) me kufirin e nje rruge mbi te cilen mbledhet taksa;
- (b) lartesia e nje ndertese apo strukture kalon –
- (i) 7.5 metra pa perfshire ndonje strukture te ngritur mbi cati; ose

- (ii) 10 metra duke përfshirë ndonjë strukturë mbi cati;
- (c) shumica e sipërfaqeve në ose mbi nivelin e tokës të ndërtuesave brenda zonës së mbledhjes së taksës, duke përjashtuar sipërfaqen e kabinave të mbledhjes së parave, kalon 1,500 metra katror.

Kushte:

- A.2 Në rastet e tokave të përfshira në nenin 1(5), zhvillimi lejohet me kushtet e mëposhtme—
- (a) përpara fillimit të punimeve, zhvilluesi duhet të aplikojë pranë autoritetit të planifikimit lokal për të vendosur nëse duhet aprovimi paraprak i këtij autoriteti për vendosjen, projektin, dhe pamjen e jashtëme të ambienteve të mbledhjes së taksës;
- (b) aplikimi duhet të shoqërohet me një pershkrim, së bashku me planet dhe lartësinë, e zhvillimit të propozuar dhe me ndonjë pagëse që mund të kërkojë;
- (c) zhvillimi nuk duhet të fillojë pa u realizuar një nga pikat më poshtë—
- (i) aplikanti merr nga autoriteti i planifikimit lokal një njoftim me shkrim për vendimin që aprovimi paraprak nuk kërkojë;
- (ii) marrja e aprovimit, pasi autoriteti i planifikimit lokal i jep aplikantit njoftimin brenda 28 ditëve nga data e marrjes së aplikimit së kërkojë aprovimi paraprak;
- (iii) mbarimi i afatit 28 ditësh nga data e marrjes së aplikimit pa u marrë asnjë vendim nga autoriteti i planifikimit lokal nëse kërkojë apo jo aprovim paraprak, ose pa njoftuar aplikantin për ndonjë vendim;
- (d) zhvillimi do të kryhet, me përjashtim të rasteve kur autoriteti i planifikimit lokal nuk bie dakord—
- i) në rastin kur aprovimi paraprak kërkojë, zhvillimi do të bëhet në përputhje me detajet e aprovuara;
- (ii) në rastin kur aprovimi paraprak nuk kërkojë, zhvillimi bëhet në përputhje me detajet e paraqitura me aplikimin;
- dhe
- (e) zhvillimi do të kryhet—
- (i) në rastet ku aprovimi është dhënë nga autoriteti i planifikimit lokal, brenda një periudhe 5 vjeçare nga data e dhënies së këtij aprovimi;
- (ii) në rastet tjetër, brenda një periudhe 5 vjeçare nga data në të cilën autoriteti i planifikimit lokal

mori informacionin të cilit i referohet nën-paragrafi (b).

Interpretime
te Klases A:

A.3 Për qellime të Klases A—

- “ambjente për mbledhjen e taksës” do të thotë ndërtesa, struktura ose ambjente të tjera që duhen për mbledhjen e taksës rrugore në përputhje me legjislacionin mbi këto takse;
- “niveli i tokës” do të thotë niveli i sipërfaqes së tokës ngjitur me ndërtesën në fjalë, ose kur niveli i sipërfaqes së tokës ku është vendosur ndërtesa nuk është uniform, merret niveli i pjesës me të lartë të sipërfaqes së tokës ngjitur me ndërtesën;
- “struktura mbi cati” do të thotë cdo strukturë apo aparat që është e nevojshme të vendoset në cati, dhe është një aparat apo strukturë që—
 - (a) vendoset për të siguruar ngrohjen, ajrosjen, ajrin e kondicionuar, ujë, gazin apo elektricitetin;
 - (b) për të ngritur një makineri; ose
 - (c) në qoftë se duhet për qellime sigurie;
- “takse rrugore” do të thotë takse që mbledhet sipas një urdherese të caktuar;
- “zone për mbledhjen e taksës rrugore” do të thotë një pjesë të tokës ku taksat rrugore mbledhen në përputhje me një urdherese, dhe përfshin të gjithë ambientet për mbledhjen e kësaj takse;
- “kabine për mbledhjen e taksës rrugore” do të thotë cdo ndërtesë apo strukturë e ndërtuar për qellime të mbledhjes së taksës rrugore sipas një urdherese të caktuar;
- “urdherese mbi taksën rrugore” ka të njëjtin kuptim si në Pjesën I të Aktit mbi Punimet Rrugore 1991 (ruget e reja në Angli dhe Uells); dhe
- “rruge që taksohet” do të thotë një rrugë për të cilën aplikohet urdheresa mbi taksën rrugore;

PJESA 31
SHEMBJA E NDËRTESAVE

Klasa A:

**Zhvillimi
Lejohet**Zhvillimi
nuk Lejohet:**A. Cdo punim qe lidhet me rrezimin e nje ndertese.****A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A kur -**

- (a) ndertesa eshte bere e pasigurte ose e pabanueshme nga veprimet ose mungesa e veprimeve te nje personi qe ka interes ne token mbi te cilen ndodhet ndertesa; dhe
- (b) eshte praktikisht e mundur te behet me e sigurte me punime riparimi ose ndertimin e mbeshtetjeve te perkoheshme.

Kushte:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushteve te meposhtme—

- (a) kur shembja duhet te behet urgjentisht ne interes te sigurimit dhe kur duhet te merren masa te menjehereshme per shembjen, zhvilluesi sa me shpejt te jete e mundur, duhet ti paraqese autoritetit te planifikimit lokal nje justifikim me shkrim per shembjen;
- (b) kur shembja nuk eshte urgjente si ne paragrafin (a) dhe nuk perben shembje te perjashtuar—
 - (i) zhvilluesi, perpara se te filloje punimet, duhet te aplikojte tek autoriteti i planifikimit lokal per te percaktuar nese duhet aprovimi paraprak i ketij autoriteti per metoden e shembjes dhe ndonje restaurim i propozuar ne vend pas shembjes;
 - (ii) aplikimi duhet te shoqerohet me nje pershkrim te zhvillimit te propozuar, nje vertetim qe njoftimi eshte shpallur ne perputhje me nen-paragrafin (iii), dhe me nje pagese qe mund te kerkohet;
 - (iii) pasi i nenshtrohet nen-paragrafit (iv), aplikuesi duhet te vendose njoftimin mbi vendin e punimeve ne ose prane vendit ku ndodhet ndertesa qe do shembet dhe njoftimi duhet te shpallet per jo me pak se 21 dite brenda periudhes 28 ditore qe fillon nga data e paraqitjes se aplikimit tek autoriteti i planifikimit lokal;
 - (iv) kur njoftimi i shpallur eshte hequr, demtuar, ose bere i palexueshem, pa fajin ose qellimin e aplikantit, perpara mbarimit te periudhes 21 ditore se ciles i referohet nen-paragrafi (iii), aplikanti do te konsiderohet qe ka kryer detyrimet ne qofte se ai ka marre masa te arsyeshme per mbrojtjen e njoftimin, qofte edhe per zevendesimin e tij, kur ka nevojte;

(v) zhvillimi nuk mund te filloje pa u realizuar nje nga pikat me poshte—

- (aa) aplikanti merr njoftimin me shkrim nga autoriteti i planifikimit lokal qe nuk kerkohet aprovimi paraprak;
- (bb) aplikanti ka marre aprovimin, pasi autoriteti i planifikimit lokal i dha aplikantit njoftimin brenda 28 diteve nga data e aplikimit, qe nje aprovim i tille kerkohet;
- (cc) mbarimi i afatit 28 ditore nga data ne te cilen u mor aplikimi nga autoriteti i planifikimit lokal, pa u marre asnje vendim nese duhet apo jo aprovimi paraprak, ose pa u njoftuar aplikanti per kete vendim nga autoriteti i planifikimit lokal;
- (vi) me perjashtim te rasteve kur nuk bie dakord autoriteti i planifikimit lokal, zhvillimi do te kryhet—
 - (aa) ne perputhje me detajet e aprovuara, ne rastin kur kerkohet aprovimi paraprak;
 - (bb) ne perputhje me detajet e paraqitura me aplikimin, ne rastin kur aprovimi nuk kerkohet; dhe
- (vii) zhvillimi duhet te perfundoje—
 - (aa) kur eshte marre aprovimi nga autoriteti i planifikimit lokal, brenda nje periudhe 5 vjecare nga data e marrjes se aprovimit;
 - (bb) ne cdo rast tjeter, brenda nje periudhe 5 vjecare nga data kur autoriteti i planifikimit lokal mori informacionin e permendur ne nen-paragrafin (ii).

**Interpretime
te Klases A:****A.3 Per qellime te Klases A—**

- “shembje e perjashtuar” do te thote shembje—
 - (a) ne toke per te cilen ekziston nje leje planifikimi, per zhvillimin e vendit, qe eshte dhene pasi eshte aplikuar ose qe do te jepet sipas Pjeses III te Aktit (kontrolle mbi zhvillimet),
 - (b) qe kerkohet ose lejohet te kryhet nga nje legjislacion i caktuar, ose
 - (c) qe kerkohet te kryhet per arsye te nje detyrimi te caktuar;
- “detyrim i caktuar” do te thote—
 - (a) nje detyrim qe kerkohet sipas nje mareveshje te bere nen seksionin 106 te Aktit, sic eshte miratuar fillimisht (mareveshje per zhvillimin ose perdorimin e tokes);
 - (b) nje detyrim per planifikim sipas seksionit 106 te Aktit, sic zevendesohet nga seksioni 12 i Aktit mbi

Planifikimin dhe Kompensimin 1991, ose sipas seksionit 299A te Aktit (detyrime planifikimi);

- (c) nje detyrim qe kerkohet sipas nje mareveshje te bere sipas dispozitave te seksionit 106 te Aktit, sic eshte miratuar fillimisht, ose zevendesuar me Aktin mbi Planifikimin dhe Kompensimin 1991, ose sipas seksionit 299A te Aktit; dhe
- “njoftim mbi vendin e punimeve” do te thote nje njoftim qe perfshin—
 - (a) emrin e aplikantit,
 - (b) nje pershkrim, duke perfshire adresen, te ndertesave ose ndertesave qe propozohen te shemben,
 - (c) nje paragraf qe aplikanti ka aplikuar tek autoriteti i planifikimit lokal per te percaktuar ne se kerkohet aprovimi paraprak i ketij autoriteti per metodene shembjes dhe ndonje restaurim te duhur ne vend pas shembjes,
 - (d) daten ne te cilen aplikanti propozon te behet shembja, dhe
 - (e) nemrin dhe adresen e autoritetit te planifikimit lokal, dhe nenshkrimin nga aplikanti ose nga perfaqesuesi i aplikantit si dhe daten e ketij nenshkrimi.

**Klasa B:
Zhvillimi
Lejohet**

B. Cdo punim qe duhet per shembjen e nje porte, gardhi, muri rrethues, ose menyre tjeter rrethimi, pjeserisht apo teresisht.

PJESA 32

SHKOLLAT, KOLEGJET, UNIVERSITETET DHE SPITALET

**Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet**

A. Ngritja e shkollave, kolegjeve, universiteteve ose spitaleve, ose te cdo ndertese qe perdoret pjeserisht per keto qellime, dhe qe eshte ne perdorim nje shkolle, kolegj, universiteti ose spitali.

Zhvillimi

nuk Lejohet:

A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A—

- (a) pervec rasteve kur –
 - (i) ne rastin e nje ndertese shkolle, kolegji apo univesiteti, perdorimi kryesor i ndertesave ekzistuese eshte per qellime aresimimi, ose
 - (ii) ne rastin e nje ndertese spitalore, perdorimi kryesor i ndertesave ekzistuese eshte per sherbime mjekesore ose shendetesore;
- (b) kur shuma e siperfaqeve te dyshemeve te cdo ndertese te ngritur ne vendin e punimeve (perve ndertesave origjinale shkollore, universitare, apo spitalore) kalon 10% te shumës se siperfaqeve te ndertesave origjinale shkollore, kolegjit, universitare apo spitalore;
- (c) kur shuma e madhesive kubike te ndertesave te ngritura ne vendin e punimeve (pervec ndertesave origjinale shkollore, universitare, kolegjit apo spitalore) kalon 250 metra kub;
- (d) kur ndonje pjese e ndertesave se ngritur eshte me pak se 20 metra nga kufiri i vendit te punimeve;
- (e) kur si rezultat i zhvillimit, cdo toke, e perdorur si fushe loje perpara zhvillimit, nuk mund te perdoret me si e tille.

Kusht:

A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A pasi i nenshtrohet kushtit qe ne rastin e tokave qe perfshihen ne nenin 1(5), cdo material i perdorur per ndertim duhet te jete ne pamje i ngjashem me ato te perdorura per shkollen, kolegjin, universitetin, ose spitalin origjinal.

Interpretime
te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A –

- “shuma e siperfaqeve te dyshemeve” dhe “shuma e madhesive kubike” e ndertesave te ngritura, perfshin shumen totale te siperfaqes se dyshemesave ose shumen totale te madhesive kubike te ndertesave ekzistuese te ngritura me pare sipas kerkesave te Klases A; dhe
- “ndertese shkollore, kolegji, universitare dhe spitalore origjinale” do te thote cdo ndertese shkollore, kolegji, universitetare apo spitalore ekzistuese, e ndryshme nga ndertesat e ngritura sipas Klases A.

PJESA 33
KAMERA TELEVIZIVE ME QARK TE MBYLLUR

Klasa A:
Zhvillimi
Lejohet

A. Instalimi, ndryshimi, ose zevendesimi mbi nje ndertese i nje kamere televizive te perdorur per qellime sigurie.

Zhvillimi
nuk Lejohet:

- A.1 Zhvillimi nuk lejohet nga Klasa A ne qofte se—
- (a) ndertesa mbi te cilen do instalohet kamera eshte nje ndertese e listuar ose nje ndertese e shpallur monument;
 - (b) dimensionet e kameras duke perfshire edhe mbeshtetesin kalojne 75 centimentra, 25 cm me 25 cm;
 - (c) ndonje pjese e kameras kur instalohet, ndryshohet apo zevendesohet, eshte me poshte se 250 centimetra mbi nivelin e tokes;
 - (d) ndonje pjese e kameras kur instalohet, ndryshohet, apo zevendesohet, del nga siperfaqja e nderteses me me shume se 1 meter kur matet nga kjo siperfaqe;
 - (e) ndonje pjese e kameras kur instalohet, ndryshohet, apo zevendesohet, ne siperfaqen e nje ndertese eshte me teper se 1 meter larg nga nje pike tjeter kontakti;
 - (f) ndonje pjese e kameras eshte me pak se 10 metra larg nga nje kamera tjeter te instaluar ne nje ndertese;
 - (g) zhvillimi do rezultoje ne prezencen e me shume se 4 kamerave ne te njejten ane te nje ndertese; ose
 - (h) zhvillimi do rezultoje ne prezencen e me shume se 16 kamerave ne nje ndertese.


Kushte:

- A.2 Zhvillimi lejohet nga Klasa A me kushtet e meposhtme—
- (a) kamera, sa te jete e mundur, duhet te vendoset ne menyre qe te minimizohet ndikimi i saj ne pamjen e jashtme te nderteses mbi te cilen vendoset;
 - (b) kamera duhet te zhvendoset sa me shpejt te jete praktikisht e mundur, kur nuk eshte me e perdoreshme per qellime sigurie.

Interpretime
te Klases A:

A.3 Per qellime te Klases A—

- “kamera” pervec ne paragrafin A.1(b) perfshin mbeshtjetjen, vendosjen, montimin; dhe
- “nivel i tokes” do te thote niveli i siperfaqes se tokes ngjitur me ndertesen, ose kur niveli i tokes nuk eshte uniform, merret niveli i pjeses me te larte te siperfaqes se tokes ngjitur me kete ndertese.



Autoritete te
planifikimit lokal:
te pergjithshme

AKTI MBI PLANIFIKIMIN NE QYTET DHE FSHAT 1990 (Angli, Skoci dhe Uells)

1990 KAPITULLI 8

“Nje Akt qe konsolidon ligje te ndryshme ne lidhje me planifikimin ne qytete dhe fshatra (me perjashtim te kontrollit mbi ndertesat me interes te vecante historik dhe arkitekturor, dhe ne lidhje me substancat e rrezikshme) si dhe amendamente qe marrin ne konsiderate rekomandimet e Komisionit Ligjor.”

[24 Maj 1990]

PJESA I: AUTORITETET PLANIFIKUESE

- 1.—(1) Ne nje qark jo-metropolitan —
- (a) keshilli i qarkut eshte autoriteti planifikues per qarkun, dhe
 - (b) keshilli i rrethit eshte autoriteti planifikues per rrethin,

dhe referenca qe i behen ne Aktet e planifikimit, autoritetit te planifikimit lokal ne lidhje me zonat jo-metropolitane do te merren si referenca per te dyja: autoritetin e planifikimit te qarkut dhe autoritetin e planifikimit te rrethit.

(2) Keshilli i rrethit metropolitan eshte autoriteti i planifikimit lokal per rrethin dhe keshilli i zones se Londres eshte autoriteti i planifikimit lokal per kete zone.

Pjesa I (3) Ne Angli (vetem ne qarqet metropolitane, Londren e Madhe, dhe Ishujt e Scilly) dhe ne Uells, te gjithe funksionet e autoritetit te planifikimit lokal te percaktuar nen Aktet e planifikimit mund te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te qarkut dhe autoriteti i planifikimit te rrethit.

(4) Ne kete Akt "autoritet i planifikimit minerar" do te thote—

- (a) autoriteti i planifikimit te qarkut, ne qarqe jo-metropolitane; dhe
- (b) autoriteti i planifikimit lokal, ne qarqe metropolitane ose ne zonen e Londres.

(5) Ky seksion ka efekt pasi i nenshtrohet dispozitave te kunderta ne Aktet e planifikimit, dhe vecanarisht—

- (a) nen-seksionet (1) deri (4) kane efekt pasi i nenshtrohen seksioneve 5 deri 8 te ketij Akti dhe Pjeses i te Aneksit 17 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 (Parqet Kombetare);
- (b) nen-seksionet (1) dhe (2) kane efekt pasi i nenshtrohet seksioneve 2 dhe 9; dhe
- (c) nen-seksioni (3) ka efekt pasi i nenshtrohet seksionit 4 dhe Aneksit 1 (qe permban dispozitat per ushtrimin e disa funksioneve nen kete Akt nga autoritete te vecanta).

1972 c.70

Borde te
Perbashketa
Planifikimi

2.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e sheh te nevojshme krijimin e nje bordi te perbashket si autoritet i planifikimit qarkor per zona qe perfshihen ne dy ose me shume keshilla qarqesh ose si autoritet i planifikimit te rrethit per zona qe perfshihen ne dy ose me shume keshilla rrethi, ai mund te urdheroje—

- (a) bashkimin e ketyre zonave ne nje rreth te unifikuar per qellime te ketij Akti; dhe
- (b) krijimin e nje bordi te perbashket (ne kete Akt referohet si "bord planifikues i perbashket") si autoritet planifikimi qarkor ose, sipas rastit, autoritet i planifikimit per ate rreth te unifikuar.

(2) Sekretari i Shtetit nuk duhet te nxjerre nje urdher te tille ne qofte se pasi behet nje vleresim, konstatohet se te gjitha keshillat e perfshire jane dakord.

(3) Ne rastet e krijimit te nje bordi planifikues te perbashket per nje rreth te unifikuar, referenca ne Aktet planifikuese per zonen e autoritetit te planifikimit lokal—

- (a) ne lidhje me bordin, jane referenca per ate rreth;
- (b) ne lidhje me cdo autoritet te planifikimit lokal qe perben keshillin e qarkut apo te rrethit te pjeses (jo te te gjithes) se perfshire ne rrethin e unifikuar,

jane referenca te atyre pjeseve te rrethit apo qarkut qe jane te perfshira.

(4) Nje bord planifikues i perbashket i ngritur nga nje urdher sipas nen-seksionit (1) konsiston ne nje numer pjesetaresh te vendosur nga ky urdher dhe qe emerohen nga keshillat perkates.

(5) Nje bord planifikues i perbashket i ndertuar ne menyre te tille perben nje njesi me vete, te vazhdueshme dhe me nje vule te perbashket.

(6) Nje urdher qe krijon nje bord planifikues te perbashket dhe cdo urdher tjeter shtese ose qe revokon ndonje urdher per krijimin e bordit planifikues te perbashket —

- (a) mund te perfshije rregulla per emerimin e pjesetareve, kohes se sherbimit, dhe lejeve te zyrtareve te bordit, rregulla per mbledhjet dhe vendimet, dhe per pagesat e shpenzimeve te bordit per keshillat perberese, pa anashkaluar dispozitat e seksionit 241 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 (qe autorizon aplikimin e dispozitave te ketij Akti mbi bordet e perbashketa);
- (b) mund te perfshije rregulla per transferimin dhe kompensimin e zyrtareve, per transferimin e pasurise dhe detyrimeve; dhe per rregullimin e kontove dhe perpjesetimin e detyrimeve;
- (c) dispozita per aftesimin e bordit per te ushtruar funksionet e tij, qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme; dhe
- (d) mund te percaktoje, me ndryshime perkatese, qe bordi i nenshtrohet dispozitave te seksionit 102 dhe 103 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972.

(7) Ky seksion do te kete efekt pasi i nenshtrohet seksioneve 5 deri me 9 te ketij Akti dhe Pjeses I te Skedules 17 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 (borde planifikuese te perbashketa dhe borde planifikuese speciale per Parqet Kombetare).

3.—(1) komiteti planifikues i perbashket per Londren e Madhe i ngritur sipas seksionit 5 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1985 do te vazhdoje te kryeje funksionet e permendura ne nen-seksionin (2).

Komitete te
Perbashketa per
Londren e
Madhe.

- (2) Komiteti planifikues i perbashket do te -
- (a) konsideroje dhe keshilloje autoritetin e planifikimit lokal ne Londren e Madhe mbi ceshtjet me interes te perbashket qe lidhen me planifikimin dhe zhvillimin ne Londren e Madhe;
 - (b) informoje Sekretarin e Shtetit per pikepamjet e autoriteteve qe kane lidhje me keto ceshtje, duke perfshire ceshtje per te cilat ai ka kerkuar keshillat e tyre;
 - (c) informoje autoritetet e planifikimit lokal te zonave ne afersi te Londres se Madhe, ose cdo perfaqesues te ketyre autoriteteve dhe autoriteteve te planifikimit lokal ne Londren e Madhe, per pikepamjet e autoriteteve te planifikimit lokal ne Londren e Madhe ne lidhje me ceshtje te interesit te perbashket per planifikimin dhe zhvillimin e Londres se Madhe dhe te ketyre zonave;
- dhe kur e sheh te arsyeshme, komiteti mund te jape kontributin per shpenzimet e ketyre autoriteteve ne lidhje me paragrafin (c).
- (3) Shpenzimet e komitetit planifikues te perbashket qe jane aprovuar nga te pakten dy te tretat e autoriteteve te planifikimit lokal ne Londren e Madhe do mbulohen nga keto autoritete ne perpjestime te rena dakord, ose ne mungese te nje akordi, sipas vendimit te Sekretarit te Shtetit.
- (4) Referenca te bera ne kete seksion per autoritete te planifikimit lokal ne Londren e Madhe jane ne lidhje me autoritetet te cilat jane autoritete te planifikimit lokal per qellime te Pjeses II.

Parqet Kombetare 4. - (1) Funkcionet qe jane akorduar nga Aktet planifikuese autoriteteve te planifikimit lokal ose autoriteteve te planifikimit te rrethit, per zona qe ndodhen ne nje Park Kombetar jashte qarqeve metropolitane, do te jene funksione te autoritetit te planifikimit qarkor dhe asnje autoriteti tjeter, pasi i nenshtrohen nen-seksioneve (2) dhe (3), dhe referenca te bera ne keto Akte per nje autoritet te planifikimit lokal ne keto zona te Parqeve Kombetare do merret perkatesisht si me lart.

(2) Funkcionet qe i akordohen autoritetit te planifikimit

lokal nga seksionet 198 deri 201, 206 deri 209, dhe 211 deri 215 do ushtrohen ne ate Park Kombetar, jashte zonave metropolitane, nga autoriteti i planifikimit te rrethit qe mbulon keto zona njekohesisht me autoritetin e planifikimit te qarkut.

1949 c. 97

(3) Kur eshte dhene nje urdher sipas seksionit 7 te Aktit mbi Parqet Kombetare dhe Fshatrat 1949 qe cakton nje zone si Park Kombetar ose zgjeron nje Park Kombetar, funksionet e ushtruara nga autoriteti i planifikimit lokal perpara se te hyje ne fuqi ky urdher per cdo zone qe nen kete urdher behet pjese e Parkut do te vazhdojne te ushtrohen nga po ky autoritet, me perjashtim te rasteve kur krijohet nje bord planifikues i perbashket sipas seksionit 2 ose kur eshte zgjedhur nje Komitet i Parkut Kombetar sipas Pjese i te Skedules 17 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 per nje zone qe perfshin zonen ne fjale, ose qe autorizohet per te ushtruar keto funksione.

1972 c. 70

(4) Kur bordi i planifikimit te perbashket per nje Park Kombetar qe ndodhet pjeserisht ne nje ose me shume qarqe metropolitane, eshte autoriteti i planifikimit lokal per ato pjese qe ndodhen ne qark ose qarqe, ky bord do te vazhdoje te mbetet i tille.

Hapesirat e gjera
ujore. (Broads)

5. - (1) Per qellime te Kapitullit i te Pjeses VIII dhe seksionit 249, 250, 300, dhe 324 (1) (b) dhe (c) dhe (7) dhe ndonje dispozite tjeter te ketij Akti, "autoritet i planifikimit lokal" ne lidhje me tokat ne Hapesirat ujore (Broads), perfshin Autoritetin e Hapesirave Ujore (Broads).

(2) Per qellime te dispozitave te permendura ne nen-seksionin (3) Autoriteti i Broads do te jete autoriteti i vetem planifikues per rrethin e Broads.

(3) Dispozitat e referuara ne nen-seksionin (2) jane seksionet 36 deri 49, 50(6) deri (9), 51, 62, 64 deri 72, 76 deri 81, 91 deri 95, 97 deri 99, 102, 103, 106, 172, 173, 178, 183, 184, 188, 191 deri 197, 211 deri 215, 219 deri 221, 224, 294, 295, 297, 299, 301, 316(1) deri (3) dhe 324(1)(a).

Zonat e punimeve
1980 c. 65.

6. - (1) Nje urdher sipas paragrafit 5 te Skedules (Aneksit) 32 te Aktit mbi Token, Planifikimin dhe Qeverisjen Lokale 1980 (percaktimin e zonave te punimeve) mund te vendose qe autoriteti mbi zonat e punimeve te jete autoriteti i planifikimit lokal per zonen per qellime te percaktuar ne Aktet e Planifikimit dhe ne lidhje me zhvillime te percaktuara ne urdher.

(2) Pa cenuar paragrafin 15(1) te asaj Skedule (modifikime te urdhrave te Sekretarit te Shtetit), nje urdher nen ate paragraph mund te vendose qe autoriteti mbi zonat e punimeve te jete autoriteti i planifikimit lokal per zonen per qellime te Akteve te planifikimit ose ne lidhje me zhvillime te tipeve te ndryshme.

Pjesa I

(3) Kur dispozita te tilla si ato te permendura ne nen-seksionet (1) ose (2) behen nga nje urdher qe percakton nje zone punimesh ose, sipas rastit, nje urdher qe modifikon nje urdher te tille, autoriteti i zones se punimeve autoriteti i planifikimit lokal per zonen.

(4) Sekretari i Shtetit mund te vendose rregulla per krijimin e dispozitave te tranzicionit dhe suplementare ne lidhje me dispozitat e nje urdheri nen paragrafin 5 te asaj Skedule (Aneksi) te bere bazuar ne nen-seksionin (1).

(5) Keto rregulla mund te modifikojne cdo dispozite te Akteve te planifikimit ose cdo dokument ligjor te nxjerre nen to ose mund te aplikojne keto dokumente ligjore te miratuara (me ose pa modifikime) ne hartimin e ketyre dispozitave te tranzicionit ose suplementare.

Zonat e
zhvillimit
urban
1980 c. 65

7.—(1) Kur hartohet nje urdher sipas nen-seksionit (1) te seksionit 149 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 (korporatat e zhvillimit urban si autoritete planifikuese), korporata e zhvillimit urban e specifikuar ne kete urdher do te jete autoriteti i planifikimit lokal per zona qe i perkasin normalisht autoritetit te planifikimit lokal, per qellime dhe ne lidhje me zhvillime te caktuara.

(2) Kur nje urdher sipas nen-seksionit (3) (a) te atij seksioni percakton funksionet e nje korporate te zhvillimit urban ne lidhje me nje zone, korporata do t'i ushtroje keto funksione ne vend te cdo autoriteti (me perjashtim te Sekretarit te

Shtetit) qe mund t'i kishte keto funksione normalisht.

Zonat e veprimit
te strehimit

8.—(1) Kur nje urdher eshte bere sipas nen-seksionit (1) te seksionit 67 te Aktit mbi Strehimin 1988, grupi per veprimin mbi strehimin ne urdher do te jete autoriteti i planifikimit lokal per zona te tilla sic percaktohet ne urdher.

(2) Kur nje urdher sipas nen-seksionit (3)(a) i atij seksioni i jep funksione nje grupi per veprim mbi strehimin ne lidhje me nje zone, grupi do te kete ato funksione ne vend te ndonje autoriteti (pervec Sekretarit te Shtetit) qe ndryshe do ti kishte keto funksione ne zone.

Fuqia per te bere
dispozita
rrjedhimore dhe
suplementare

9. Ne qofte se Sekretari i Shteti e sheh te nevojshme ose te dobishme, rregullat ne kete Akt mund te nxjerrin dispozita te tilla qe jane rrjedhim ose suplementare te dispozitave te seksionit 1 dhe 2.

PJESA II **PLANET PER ZHVILLIM**

KAPITULLI I **PLANE TE NJEHSUARA TE ZHVILLIMIT:** **ZONA METROPOLITANE PERFSHI LONDREN**

Paraprake

Aplikimi i
Kapitullit I ne
Zonen e Londres
se Madhe dhe
zonat
metropolitane.

10. Ky Kapitull aplikohet ne zonat e cdo autoriteti te planifikimit lokal ne Londren e Madhe ose ne qarqet metropolitane (me perjashtim te zonave qe jane pjese e ndonje Parku Kombetar), pasi i nenshtrohet seksionit 28.

Studimi i zonave
te planit

Vleresimet, studimet (surveys) etj.

11. -(1) Autoriteti i planifikimit lokal—

- (a) duhet te mbaje nen mbikqyrje ceshtje qe mund te ndikojne ne zhvillimin e zones se tyre ose ne planifikimin per zhvillim; dhe
- (b) ne qofte se ata e shohin te aresyeshme, mund te bejne nje vleresim te zones ose nje pjese te saj per te ekzaminuar keto ceshtje.

(2) Pa demtuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit I, ceshtjet qe duhet te mbahen nen-mbikqyrje dhe te kontrollohen, perfshijne—

- (a) karakteristikat kryesore fizike dhe ekonomike te zones qe mbulohet nga autoriteti (duke perfshire qellimet kryesore per te cilat perdoret toka), dhe te ndonje zone fqinje ne qofte se do ndikohet;
- (b) madhesine, perberjen dhe shperndarjen e popullsise se zones;
- (c) pa cenuar paragrafin (a), komunikacionin, systemin e transportit dhe trafikun ne ate zone dhe te ndonje zone fqinje qe mund te ndikohet;
- (d) cdo gje tjeter qe nuk permendet ne paragrafet (a), (b), dhe (c) qe mund te ndikojne ne ceshtjet e permendura me siper;
- (e) ceshtje te cilave Sekretari i Shtetit i kushton vemendje te vecante;
- (f) cdo ndryshim qe ndikon ne ndonje nga ceshtjet e perfshira ne paragrafet (a) deri ne (e), dhe ndikimi qe keto ndryshime mund te kene ne zhvillimin ose planifikimin ne zonen ne fjale.

(3) Me qellim qe te kryeje funksionet te percaktuara nga ky seksion si mbikqyres dhe ekzaminues i ceshtjeve qe lidhen me zona qe bien nen nje autoritet tjeter, autoriteti i planifikimit lokal do te konsultohet me autoritetin tjeter per keto ceshtje.

Pregatitja dhe adoptimi i planeve te njehsuara zhvillimit

Pregatitja e

12.—(1) Brenda periudhes se caktuar nga Sekretari i Shtetit

planeve te
njehsuara te
zhvillimit

(ne qofte se eshte caktuar), autoriteti i planifikimit lokal duhet te pregatise per kete zone nje plan qe njihet si plan zhvillimi i njehsuar.

(2) Nje plan zhvillimi i njehsuar do kete dy pjese.

(3) Pjesa I e planit te zhvillimit te njehsuar konsiston ne nje dokument me shkrim qe formulon politikat e pergjithshme te autoritetit ne lidhje me zhvillimin dhe perdorime te tjera te tokes ne zonen e tyre (duke perfshire masa per permiresimin e mjedisit fizik dhe menaxhimit te trafikut).

(4) Pjesa II e planit te zhvillimit te njehsuar konsiston ne —

- (a) nje dokument me shkrim qe formulon me shkallen e detajeve qe autoriteti e sheh te pershtatshme (dhe qe eshte e dallueshme dukshem nga pjeset e tjera te planit) propozimin per zhvillim dhe per perdorime te tjera te tokes ne zonen e tyre ose per cdo pershkrim te zhvillimit ose perdorimeve te tjera te tokes;
- (b) nje harte qe tregon poziten gjeografike te ketyre propozimeve;
- (c) nje pershkrim te qellimit apo justifikim te politikave te pergjithshme ne Pjesen I te planit dhe te propozimeve ne Pjesen II te tij; dhe
- (d) diagrama, vizatime, ilustrime dhe materiale te tjera pershkrues dhe shpjegues te politikave te pergjithshme ne Pjesen I dhe propozimeve te Pjeses II, sic shihet e pershtatshme nga autoriteti apo sic mund te kerkohet.

(5) Nje plan zhvillimi njehsues do te permbaje gjithashtu ceshtje te tjera sic mund te kerkohen ose sic mund te urdheroje Sekretari i Shtetit ne raste te vecanta.

(6) Gjate formulimit te politikave te pergjithshme ne Pjesen I te nje plani zhvillimi te njehsuar autoriteti duhet te kete parasysh—

- (a) cdo udhezim strategjik te dhene nga Sekretari i Shtetit ne ndihme te pregatitjes se planit;
- (b) politikat aktuale kombetare dhe rajonale;
- (c) mjetet ndihmese qe mund te shfrytezohen; dhe
- (d) ceshtje te ndryshme per te cilat Sekretari i Shtetit ka udhezuar autoritetin t'i kushtojte vemendje.

(7) Propozimi ne Pjesen II te nje plani zhvillimi te njehsuar duhet te jete ne vija te pergjithshme konform me Pjesen I.

(8) Pjesa II e nje plani zhvillimi te njehsuar mund te caktoje nje pjese te zones qe mbulon autoriteti si zone veprimi, qe do te thote nje zone qe eshte zgjedhur per fillimin, ne nje periudhe kohe te caktuar, te punimeve per zhvillimin, rizhvillimin ose permiresimin dhe ne qofte se nje zone eshte caktuar si e tille, Pjesa e Planit duhet te permbaje nje pershkrim te punimeve te propozuara nga autoriteti.

(9) Gjate pregatitjes se nje plani zhvillimi te njehsuar autoriteti duket te kete parasysh dispozitat e cdo skeme sipas paragrafit 3 te Skedules (Aneksit) 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Plannifikimin dhe Token 1980 [1980 c. 65.] qe ka te beje me token ne zonen e tyre qe eshte caktuar sipas kesaj Skedule si zone sipermarrije.

Reklamimi ne lidhje me pregatitjen e planit te njehsuar te zhvillimit

13.—(1) Gjate pregatitjes se nje plani zhvillimi te njehsuar per zonen e tyre dhe perpara se te finalizohet permbajtja e tij, autoriteti i planifikimit lokal duhet te ndermarre hapat per te siguruar—

- (a) reklamimin e mjaftueshem ne zone te ceshtjeve qe propozohen te perfshihen ne plan;
- (b) qe persona qe mund te kene deshire tju jepet mundesia te thone fjalen e tyre perpara autoritetit per keto ceshtje, jane ne dijeni qe kane mundesi per te bere nje gje te tille; dhe
- (c) personave te tille i jepet mundesia per nje gje te tille.

(2) Autoriteti duhet te konsideroje cdo verejtje qe i behet brenda periudhes se caktuar.

(3) Pasi autoriteti i planifikimit lokal ka pregatitur nje plan zhvillimi te njehsuar, perpara se ta adoptoje duhet —

- (a) te lene kopje te tij ne zyre ose ne vende te tjera te caktuara, te gatshme per t'u inspektuar; dhe
- (b) t'i dergoje nje kopje Sekretarit te Shtetit.

(4) Cdo kopje e lene per inspektim sipas nen-seksionit (3) do te shoqerohet me nje deklarate per periudhen ne te cilen verejtjet per planin mund te behen perpara autoritetit.

(5) Kopja e planit te zhvillimit te njehsuar qe i dergohet

Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (3) do te shoqerohet me nje deklarate —

- (a) per hapat qe autoriteti ka marre per te zbatuar nen-seksionet (1) dhe (2); dhe
- (b) per konsultimet qe autoriteti ka bere me persona te tjere dhe qe ka marre parasysh verejtjet e tyre.

(6) Ne qofte se Sekretari i Shtetit, pasi konsideron deklaratat e paraqitura, ceshtjet qe permbahen ne nje plan zhvillimi te njehsuar, dhe ndonje informacion tjeter te paraqitur nga autoriteti i planifikimit lokal, nuk bindet qe jane permbushur kerkesat e paragrafeve (a) deri (c) te nen-seksionit (1) me hapat qe ka ndermarre autoriteti, ai mund te urdheroje autoritetin brenda 21 diteve te marrjes se deklaratave, te mos marre hapa te metejshem per zbatimin e planit pa kryer veprime qe permbushin keto kerkesa dhe pa bindur Sekretarin e Shtetit per permbushjen e tyre.

(7) Nje autoritet i planifikimit lokal qe ka marre urdher nga Sekretari i Shtetit sipas nen-paragrafit (6) duhet te —

- (a) terheqe menjehere kopjet e planit te zhvillimit te njehsuar qe jane vene per inspektim sic kerkohet nga nen-seksioni (3); dhe
- (b) njoftoje cdo person qe ka paraqitur verejtje ndaj planit prane autoritetit per urdherin e dhene nga Sekretari i Shtetit.

Terheqja e nje plani te zhvillimit te njehsuar

14.—(1) Nje plan zhvillimi i njehsuar mund te terhiqet nga autoriteti i planifikimit lokal ne cdo kohe perpara se te adoptohet nga autoriteti ose te aprovohet nga Sekretari i Shtetit dhe mund te terhiqet vetem ne qofte se urdherohet nga Sekretari i Shtetit.

(2) Kur nje plan zhvillimi i njehsuar eshte terhequr autoriteti do te —

- (a) terheqe kopje te nxjerra per inspektim dhe ti dergoje ato Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 13(3); dhe
- (b) ti jape lajmerimin qe plani eshte terhequr cdo personi qe ka paraqitur verejtje.

(3) Ne percaktimin e hapave per tu marre nga autoriteti i planifikimit lokal per te permbushur kerkesat e paragrafeve

(a) deri (c) te nen-seksionit (1) te seksionit 13, autoriteti dhe Sekretari i Shtetit mund te marrin parasysh hapa te ndermarre me pare per keto qellime per nje plan zhvillimi te njehsuar qe autoriteti mund te kete terhequr me perpara.

(4) Kur nje plan zhvillimi i njehsuar terhiqet kopjet duhet te trajtohen sikur nuk jane nxjerre asnjehere sipas seksionit 13(3).

Adoptimi i planit
te zhvillimi te
njehsuar nga
autoriteti i
planifikimit lokal

15.—(1) Pas perfundimit te periudhes se dhene per t'i bere verejtje nje plani zhvillimi te njehsuar ose, ne qofte se keto verejtje jane bere brenda kesaj periudhe, autoriteti i planifikimit lokal, duke i u permbajtur dispozitave te seksioneve 17 dhe 18, mund te adoptoje planin ose sic eshte origjinal ose sic modifikohet duke marre ne konsiderate—

- (a) keto verejtje;
- (b) ndonje verejtje tjeter qe mund t'i jete bere planit;
- (c) ndonje ceshtje tjeter qe autoriteti e konsideron te rendesishme.

(2) Nje plan zhvillimi i njehsuar nuk do te adoptohet ne qofte se Pjesa II e Planit eshte ne konform apo pajtim ne pergjithesi me Pjesen I.

(3) Kur Ministri i Bujqesise, Peshkimit dhe Ushqimit i ka bere verejtje planit te zhvillimit te njehsuar dhe autoriteti i planifikimit lokal nuk propozon te modifikohet plani sipas ketyre verejtjeve, autoriteti—

- (a) duhet t'i dergoje Sekretarit te Shtetit detajet e verejtjes dhe nje dokument ku pershkruhen arsytet per mosmarrjen parasysh te saj; dhe
- (b) nuk do te adoptoje planin nese nuk ka marre autorizimin nga Sekretari i Shtetit.

(4) Duke u bazuar ne dispozitat e ketij Kapitulli dhe te seksionit 287, nje plan zhvillimi i njehsuar do te filloje te operoje ne daten ne te cilen adoptohet.

Seanca e
shqyrtimit lokal

16.—(1) Me qellim qe te konsiderohen verejtjet e bera nje plani zhvillimi te njehsuar, autoriteti i planifikimit lokal ne rastet verejtjesh te bera ne perputhje me rregullat e ketij

Kapitulli, mund te organizoje nje hetim lokal ose seance shqyrtimi te mbajtura nga personi i emeruar nga Sekretari i Shtetit, ose sic percaktohet nga ky Kapitull i emeruar nga vete autoriteti.

(2) Nen-seksionet (2) dhe (3) te seksionit 250 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 [1972 c. 70] (fuqia per te caktuar dhe pyetur deshmitaret) do ti aplikohen cdo hetimi te mbajtur nen kete seksion sic aplikohen tek hetimet e mbajtura nen ate seksion.

(3) Akti mbi Hetimet dhe Gjyqet 1971 [1971 c. 62.] do aplikohet tek nje hetim lokal ose ndonje seance tjeter shqyrtimi te mbajtur nen kete seksion sic aplikohet ne nje hetim te autorizuar te mbajtur nga Sekretari i Shtetit, por ashtu si ne seksionin 12(1) te atij Akti (deklarata per arsyet e vendimeve) referencat e bera per cdo vendim te marre nga Sekretari i Shtetit jane referenca per vendime te marra nga autoriteti i planifikimit lokal.

- (4) Rregullat e nxjerra per qellime te ketij seksioni mund —
- (a) te perbejne dispozita ne lidhje me emerimin dhe kualifikimet per persona qe do emerohen per te mbajtur nje seance shqyrtuese, duke perfshire edhe dispozitat qe aftesojne Sekretarin e Shtetit te udhezaje autoritetin e planifikimit lokal te emeroje nje person te vecante ose te zgjedhe nga nje liste apo klase e vecante personash;
 - (b) perbejne dispozita ne lidhje me kompensimin dhe benefitet e personave qe emerohen per kete qellim.

(5) Asnje hetim apo seance shqyrtuese mbahet sipas ketij seksioni ne qofte se te gjithe personat qe kane bere verejtje kane njoftuar me shkrim qe nuk desherojne te marrin pjese.

Fuqite e Sekretarit te Shtetit ne lidhje me planet

Udhezime per te
ri-shqyrtuar
propozimet

17.—(1) Pasi Sekretari i Shteti ka marre nje kopje te planit te zhvillimit te njehsuarsipas seksionit 13(3) dhe perpara se ky plan te adoptohet nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit, ne qofte se e konsideron planin e

papershtatshem, mund te udhezoje autoritetin per modifikime te propozimit sic tregohet ne udhezim.

(2) Autoriteti te cilit i eshte dhene udhezimi nuk duhet te adoptoje planin pa bere modifikimet e nevojshme te parashtruara nga Sekretari i Shtetit ose pa u anuluar ky udhezim.

Aprovimi i Sekretarit te Shtetit per planin e zhvillimit unitar

18—(1) Pasi Sekretari i Shtetit ka marre nje kopje te nje plani zhvillimi te njehsuar sipas seksionit 13(3) dhe perpara se te adoptohet nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit mund te urdheroje qe nje pjese ose i gjithe plani te paraqitet per aprovimin e tij.

(2) Ne qofte se jepet nje urdher i tille -

(a) autoriteti nuk duhet te marre hapa te metejshem per adoptimin e planit deri sa Sekretari i Shtetit te kete marre vendimin per kete plan ose per nje pjese te planit; dhe

(b) plani pse pjese e tij nuk jane te vlefshme ne qofte se nuk jane aprovuar prej tij dhe nuk do te adoptohet sipas dispozitave te mepareshme te ketij Kapitulli.

(3) Kur Sekretari i Shteti ka marre detajet e verejtjeve te paraqitura per nje plan zhvillimi te njehsuar sipas seksionit 15(3), duhet te nxjerre nje udhezim ne lidhje me te sipas nenseksioni, pervec rasteve kur bindet se Ministri i Bujqesise, Peshkut dhe Ushqimit nuk ka me verejtje per kete plan.

(4) Nen-seksioni (2)(a) aplikohet ne vecanti per hetime apo seanca shqyrtimi ne lidhje me planin sipas seksionit 16; dhe ne cdo hetim apo seance te tille ne lidhje me planin qe mbahet ose mblidhet, nuk eshte e nevojshme qe autoriteti i planifikimit lokal ti jape te drejten e paraqitjes se verejtjeve nje personi qe e ka paraqitur kete verejtje ne nje seance lokale ose ne nje mbledhje tjeter sipas seksionit 20 ose per te cilen verejtje Sekretari i Shtetit ka deklaruar se e ka perfshire ne vendimin e tij.

Aprovime te planit te zhvillimit te

19—(1) Sipas seksionit 20, Sekretari i Shtetit, pasi konsideron nje plan ose nje pjese plani paraqitur atij nen seksionin 18(1), mund ose ta aprovoje (teresisht apo

njehsuar nga Sekretari i Shtetit.

pjeserisht, me ose pa modifikime) ose ta refuzoje.

(2) Gjate konsiderimit te nje plani ose pjese plani, Sekretari i Shtetit mund te marre parasysh ceshtje qe ai i konsideron te rendesishme, nese jane apo jo marre parasysh ne plan ose ne ate pjese te tij.

(3) Sekretari i Shtetit do i jape autoritetit te planifikimit lokal shpjegime qe i konsideron te nevojshme per aresyet e marrjes se vendimit per nje plan ose pjese plani qe i eshte paraqitur.

(4) Kur nje pjese ose e gjithe Pjesa i e nje plani zhvillimi te njehsuar eshte aprovuar nga Sekretari i Shtetit me modifikime, autoriteti i planifikimit lokal, perpara adoptimit te pjeses se planit qe mbetet, duhet te beje modifikimet perkatese ne Pjesen II sic udhezohen nga Sekretari i Shtetit per ta sjelle ne konform me Pjesen I, dhe ne mungese te nje udhezimi te tille, duhet te beje modifikime per kete qellim ne Pjesen II sic e sheh te aresyeshme autoriteti.

(5) Duke u mbeshtetur ne seksionin 287, nje plan ose pjese plani qe eshte aprovuar nga Sekretari i Shtetit nen kete seksion do te behet operativ ne diten qe ka caktuar ai.

Seancat e shqyrtimit lokale, shqyrtimet publike dhe konsultimet nga Sekretari i Shtetit

20—(1) Perpara se te merret vendimi nese nje plan ose pjese e tij paraqitur sipas seksionit 18(1) ai aprovohet ose jo, Sekretari i Shtetit duhet te konsideroje cdo verejtje te bere ne perputhje me rregullat e ketij Kapitulli.

(2) Kur nje pjese apo e gjithe Pjesa II e nje plani zhvillimi te njehsuar paraqitet tek Sekretari i Pergjithshem sipas seksionit 18(1) (pa marre parasysh nese Pjesa i e ketij plani perfshihet apo jo) dhe ne qofte se jane bere verejtje per kete plan ose pjese e planit sic permendet ne nen-seksionin (1), perpara se te vendose ta aprovoje apo jo, ai duhet te mbaje nje seance shqyrtimi per qellim konsiderimi te ketyre verejtjeve.

(3) Nuk eshte e nevojshme qe Sekretari i Shtetit sipas nenseksionit (1) te shqyrtoje verejtjet qe jane marre ne konsiderate nga autoriteti i planifikimit lokal dhe nuk eshte nevoja te mbledhe nje seance shqyrtimi sipas nenseksionit (2) ne qofte se autoriteti e ka mbajtur nje te tille per verejtjet sipas seksionit 16 ose kur Sekretari i Shtetit pasi ka

shqyrtuar planin ose nje pjese te tij ka vendosur ta refuzoje.

(4) Kur nje pjese ose e gjithe Pjesa I e nje plani zhvillimi te njehsuar (por jo pjese ose e gjithe Pjesa II) i dorezohet Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 18(1), ai mund te urdheroje nje person ose persona qe ka emeruar per qellime te mbajtjes se seancave lokale ose mbledhjeve te tjera te shqyrtimit, te mbajne nje ekzaminim publik per ceshtje qe Sekretari i Shtetit e konsideron te nevojshme per tu ekzaminuar.

(5) Sekretari i Shtetit, pas konsultimit me Kancelarin e Lordeve, mund te nxjerre rregulla ne lidhje me proceduren qe duhet te ndiqet ne cdo mbledhje ekzaminimi sipas nen-seksionit (4).

(6) Sekretari i Shtetit nuk eshte i detyruar t'i siguroje te drejten autoriteteve te planifikimit lokal ose ndonje personi tjetër te degjohet ne nje ekzaminim sipas nen-seksionit (4), dhe njesite dhe personat qe mund te marrin pjese perpara ose gjate ekzaminimit jane ftuar me vendimin e Sekretarit te Shtetit; por personi apo personat qe drejtojne ekzaminimin kane kompetenca, perpara ose gjate mbledhjes, te ftojne njesi ose persona te tjere per te marre pjese ne qofte se ai e sheh nevojshme.

(7) Nje ekzaminim sipas nen-seksionit (4) perben nje hetim te autorizuar per qellime te seksionit 1(1)(c) te [1971 c.62.] Akti mbi Hetimet dhe Gjyqet 1971 por nuk perben hetim per qellime te tjera.

(8) Gjate konsiderimit te nje plani ose nje pjese te nje plani, Sekretari i Shtetit mund te konsultohet me ose te marre ne konsiderate kendveshtrimet e autoritetit te planifikimit lokal ose personave te tjere, por nuk e ka per detyre te beje nje gje te tille, pervec rasteve te parashikuara ne kete seksion.

Ndryshimi i planeve

21—(1) Autoriteti i planifikimit lokal, ne qofte se udhezohet nga Sekretari i Shtetit, mundet te propozoje ne cdo kohe per te ndryshuar ose zevendesuar nje plan zhvillimi te njehsuar qe eshte adoptuar ose aprovuar per zonen e tyre sipas dispozitave te meparshme te ketij Kapitulli, por

Ndryshime ose zevendesime te planeve te zhvillimit te njehsuar

autoriteti i planifikimit lokal nuk mund te propozoje sipas ketij seksioni per ndonje plan ose pjese plani kur plani ose pjesa e tij eshte aprovuar nga Sekretari i Shtetit, pa marre pelqimin paraprak te tij.

(2) Mbeshtetur ne seksionet 22, seksionet 12 deri me 20 (pervec nen-seksionit (1) te seksionit 12) do te aplikohen ne lidhje me hartimin e propozimeve sipas ketij seksioni dhe per cdo ndryshim apo zevendesim qe propozohet ashtu sic aplikohen per pregatitjen e planit te zhvillimit te njehsuar sipas seksionit 12.

(3) Sa me shpejt te jete e mundur pasi—

(a) eshte dhene nje urdher sipas paragrafit 5 te Skedules 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 [1980 c. 65.] (caktimi i nje zone siperarrjese); ose

(b) eshte dhene nje njoftim sipas paragrafit 11(1) te kesaj Skedule (aprovim i modifikimeve te skemes se zones se siperarrjes),

autoriteti i planifikimit lokal per zonen te cilen mbulon pjeserisht apo teresisht duhet te shqyrtoje cdo plan zhvillimi te njehsuar per ate zone nga kendveshtrimi i dispozitave te kesaj skeme ose skeme te modifikuar sipas kesaj Skedule dhe te pregatise propozime sipas ketij seksioni per cdo ndryshim ne plan qe e konsideron te nevojshme.

Procedure e shkurter per ndryshime te caktuara dhe zevendesime

22.—(1) Kur autoriteti i planifikimit lokal propozon te ndryshoje ose te zevendesoje nje plan zhvillimi te njehsuar dhe ata nuk e shohin te nevojshme te zbatojne proceduren e plote te seksioneve 13(1) deri (14), ata mund te bejne nje gje te tille duke ju permbajtur ketij seksioni.

(2) Ata duhet te —

(a) pregatisin dokumentet perkatese (per ndryshimin apo zevendesimin qe propozohet ne plan),

(b) te nxjerrin nje kopje te tyre ne vend te dukshem per inspektim ne zyre dhe ne vende te tjera sic mund te jete vendosur, dhe

(c) t'i dergojne nje kopje Sekretarit te Shtetit.

(3) Cdo kopje e dokumentave e lene per inspektim duhet te shoqerohet me nje leter qe tregon kohën brenda se ciles mund te behen verejtjet dhe komentet.

(4) Pastaj ata duhet te marrin duhet te marrin hapa te nevojshem per -

(a) reklamimin e faktit qe dokumentet jane gati per inspektim dhe vendin dhe kohën kur mund te inspektohen, dhe

(b) ftesen per berjen e verejtjeve dhe komenteve ne perputhje me rregullat;

dhe duhet te marrin parasysh cdo verejtje te bere gjate kohes se caktuar.

(5) Dokumentet e derguara nga autoriteti i planifikimit lokal tek Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (2) do te shoqerohen me pershkrim te hapave qe do marre autoriteti per te zbatuar nen-seksionin (4).

(6) Ne qofte se pasi shqyrton pershkrimin dhe ceshtjet qe i dorezohen se bashku me dokumentat sipas nen-seksionit (2) dhe cdo informacion tjeter nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit nuk eshte i kenaqur me hapat e ndermarre nga autoriteti, ai mund te udhezaje autoritetin, brenda 21 diteve te marrjes se pershkrimeve, qe te ndermarre hapa te tjera per te adoptuar propozimet pa—

(a) vazhduar proceduren ne perputhje me seksionin 13(1) deri (4), ose

(b) marre hapa te tjere sic mund te specifikohet, dhe t'a binde Sekretarin qe kane zbatuar sa me siper.

(7) Kur autoritetit te planifikimit lokal i jepen udhezime nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (6) atehere ai duhet te -

(a) terheqe menjehere kopjet qe jane lene per inspektim sic kerkohet nga nen-seksioni (2); dhe

(b) njoftoje cdo person qe ka bere verejtje tek autoriteti, per udhezimin e Sekretarit te Shtetit.

(8) Kur autoriteti i planifikimit lokal ndjek proceduren sipas ketij seksioni, referencat qe i behen ne seksionet 14(2)(a) dhe (4) dhe 18(1) kopjeve te lena per inspektim apo atyre te derguara Sekretarit te Shtetit sipas 13(3) do te merren si referenca per kopjet e lena ose te derguara Sekretarit te

Shtetit sipas nen-seksionit (2).

Plane te Perbashketa

Plane te zhvillimit
te njehsuara te
perbashketa

23.—(1) Plan zhvillimi i njehsuar i perbashket ose propozim i perbashket per ndryshim ose zevendesim mund te pregatitet nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal ne Londren e Madhe ose nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal ne qarqe metropolitane; dhe dispozitat e meparshme ne kete Kapitull, ne lidhje me nje plan apo propozim te perbashket kane efekt bazuar ne dispozitat qe vijojne ne kete seksion.

(2) Nen-seksionet (3) dhe (4) aplikohen ne lidhje me nje plan te perbashket ne vend te nen-seksioneve (1) dhe (2) te seksionit 13, dhe referenca ne nen-seksionet (5) dhe (6) te ketij seksioni dhe ne seksionin 14(3) per seksionet (1) dhe (2) te seksionit 13 dhe qellimet e paragrafit (a) deri (c) te nen-seksionit (1) te ketij seksioni, do te perfshijne referenca per nen-seksionet (3) dhe (4) te ketij seksioni dhe qellimet e paragrafeve (a) deri (c) te nen-seksionit (3) perkatesisht.

(3) Autoritetet e planifikimit lokal duhet te marrin hapa te perbashket qe te sigurojne -

(a) reklamim te mjaftueshem ne zonat e tyre per ceshtjet qe propozohen te perfshihen ne plan;

(b) personat qe mund te kene deshire per nje mundesi per te bere verejtje cdo autoriteti, te jene njoftuar se ata e kane kete mundesi; dhe

(c) personave te tille u eshte dhene mundesi e mjaftueshme per te paraqitur verejtjet e tyre.

(4) Autoritetet e planifikimit lokal duhet te shqyrtojne cdo verejtje qe ju eshte bere brenda periudhes se caktuar.

(5) Secili autoritet i planifikimit lokal qe ka pregatitur nje plan zhvillimi te njehsuar te perbashket jane te detyruar nga nen-seksioni 3 i seksionit 13 te bejne kopje te planit dhe ta vendosin ne vend te dukshem per inspektim.

(6) Verejtje mund ti behen ketij plani prane cdonjerit nga keto autoritete dhe pershkrimet e kerkuara nga nen-seksioni (4) i seksionit 13 qe shoqerojne kopjet e planit

duhet te theksoje se mund te behen verejtje ne menyre te tille.

(7) Autoritetet e planifikimit lokal qe kane pregatitur nje plan zhvillimi te njehsuar te perbashket duhet te adoptojne planin sipas seksionit 15(1) dhe ata mund te bejne nje gje te tille per pjesen e planit qe bie ne zonen e tyre, por per cdo modifikim qe duhet per te adoptuar planin duhet te jete rene dakord nga te gjithë autoritetet.

(8) Kur nje plan zhvillimi i njehsuar eshte pregatitur bashkarisht, fuqia per te bere propozime ne lidhje me planin sipas seksionit 21 do te ushtrohet per zonat perkatese nga autoritetet te cilat e pregatiten dhe Sekretari i Shtetit sipas ketij seksioni mund t'i udhezoje ata te bejne propozime ne lidhje me zonen qe mbulojne.

(9) Ne lidhje me cdo propozim te bere bashkarisht sipas seksionit 21, referencat ne nen-seksionin (2) te ketij seksioni qe i behen seksioneve 12 deri 20 do te perfshijne referenca per nen-seksionet (3) dhe (4) te ketij seksioni.

(10) Ne lidhje me propozime te tilla te perbashketa—

(a) referencat ne seksionin 22(1) per seksionin 13(1) deri (4) do te perfshijen referenca per nen-seksionet (3) dhe (4) te ketij seksioni; dhe

(b) referenca ne seksionin 22 per autoritetin e planifikimit lokal do te merren si referenca per autoritete qe veprojne bashkarisht, pervec —

(a) secili prej autoriteteve duhet sipas nen-seksionit (2) te beje kopje te dokumentave perkates dhe ti vendose per inspektim, dhe

(b) komente apo verejtje mund ti behen cdo autoriteti, dhe pershkrimet e kerkuara nga nen-seksioni (3) i atij seksioni do te theksojne se mund te behen verejtje ne menyre te tille.

(11) Data e fillimit te punimeve te nje plani zhvillimi te njehsuar te pregatitur bashkarisht nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal ose per ndryshime ose zevendesime te ketij plani ne lidhje me propozime te pregatitura, do jete data per te cilen eshte rene dakord

bashkarisht nga keto autoritete.

Suplementare

Mos marrja
parasysh e
prezantimeve te
caktuara

24. Pavaresisht nga dispozitat e mepareshme ne kete Kapitull, as Sekretari i Shtetit as autoriteti i planifikimit lokal nuk jane te detyruar te shqyrtojne verejtje apo komente per nje plan zhvillimi te njehsuar ose per nje propozim per ndryshime apo zevendesime ne nje plan te tille, ne qofte se keto verejtje jane ne themel verejtje me lidhje me propozime te pune te bere ose qe do behet per te zbatuar ---

(a) nje urdher ose skeme nen seksionin 10, 14, 16, 18, 106(1) ose (3) ose 108(1) te Aktit mbi Autostradat 1980 [1980 c. 66.];

(b) nje urdher apo skeme sipas dispozitave te zevendesuara nga dispozitat e permendura ne paragrafin (a), do me thene, nje urdher ose skeme nen seksionin 7, 9, 11, 13, ose 20 te [1961 c.63]. Akti mbi Autostradat 1961 ose seksioni 1 ose 10 te Aktit mbi Autostradat 1971 [1971 c.41.]; ose

(c) nje urdher sipas seksionit 1 te Aktit mbi Qytetet e Reja 1981 [1981 c.64.].

Fuqite
zevendesuese

25.—(1) Kur sipas dispozitave te mepareshme te ketij Kapitulli, duhet te hartohet nje plan zhvillimi i njehsuar ose propozime per ndryshime apo zevendesime ne nje plan, ose duhet te ndermerren hapa per te adoptuar nje plan apo propozim, atehere —

(a) ne qofte se Sekretari i Shtetit eshte bindur, pas mbajtjes se nje seance shqyrtimi lokale, qe autoriteti i planifikimit lokal nuk ka marre hapat e duhur per tu aftesuar per te pregatitur apo adoptuar nje plan te tille ose propozim brenda nje periudhe te caktuar; ose

(b) ne qofte se propozimi apo plani nuk eshte pregatitur apo adoptuar nga autoriteti i planifikimit lokal brenda nje periudhe te caktuar me pare per pregatitjen apo adoptimin,

Sekretari i Shteti mund te pregatise planin ose nje pjese te tij apo ta ndryshoje ose zevendesoje sic e sheh ai te

aresyeshme.

(2) Dispozitat e mepareshme te ketij Kapitulli sa te jete e mundur duhet te aplikohen me modifikimet e duhura sipas ketij seksioni nga Sekretari i Shtetit.

(3) Autoriteti i permendur ne nen-seksionin (1) do kerkohet ti paguaje Sekretarit te Shtetit shpenzimet qe ka bere ne lidhje me veprimet qe duhet te kryheshin nga ata sic parashikohen qe te jene shpenzuar nga ai per kryerjen e funksioneve.

Rregulla dhe
udhezime

26.—(1) Pa shkelur dispozitat e mepareshme te ketij Kapitulli, Sekretari i Shtetit mund te nxjerre rregulla ne lidhje me formen dhe permbajtjen e nje plani zhvillimi te njehsuar dhe procedurat qe duhet te ndiqen ne lidhje me pregatitjen, terheqjen, adoptimin, dorezimin, aprovimin, zbatimin, ndryshimin, apo zevendesimin.

(2) Rregulla te tilla ne vecanti mund te —

- (a) pershkruaje reklamimin e rezultateve te nje vleresimi te kryer sipas seksionit 11;
- (b) pershkruaje njoftimin qe duhet ti jepet ose reklamimin per —
 - (i) ceshtje te perfshira ose te propozuara per tu perfshire ne nje plan zhvillimi te njehsuar;
 - (ii) aprovimin, adoptimin, ose zbatimin e nje plani te tille ose cdo ndryshimi apo zevendesimi ne nje plan, ose
 - (iii) cdo pershkrim tjeter te hapave procedurale,

dhe per reklamimin qe duhet ti behet procedures qe do ndiqet te permendur ne nen-seksionin (1);

- (c) nxjerrin dispozita ne lidhje me zbatimin dhe shqyrtimin e verejtjeve ne lidhje me ceshtje te perfshira ne nje plan ose propozim per ndryshimin apo zevendesimin e tij;
- (d) Pa shkeluar paragrafin (b), te beje rregulla per njoftime qe duhet ti jepen personave te vecante per aprovimin, adoptimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje plani, ne qofte se ato kane bere verejtje per kete plan dhe kane bere te ditur autoritetin e planifikimit lokal qe kane deshire te

njoftohen, pasi kane paguar nje pagese te aresyeshme;

- (e) Te autorizojte autoritetin e planifikimit lokal te konsultoje ose te konsiderojte pikepamjet e personave te tjere perpara se te merren hapat e pershkruar procedural;
- (f) Ti kerkoje nje autoriteti te planifikimit lokal, ne raste te vecanta kur Sekretari i Shtetit ka udhezuar, ti jape kopje te planit ose dokumenteve te cilat jane bere publike per qellimet e permendura ne seksionin 13(1)(a) ose 23(3)(a) ose qe jane lene per inspektim, personave qe kane bere nje kerkese te tille kundrejt nje pagese te aresyeshme;
- (g) Te marre masa per botimin dhe inspektimin e cdo plani zhvillimi te njehsuar qe eshte adoptuar, aprovuar ose ndryshuar apo zevendesuar, dhe per kopje qe duhet te nxirren ne shitje.

(3) Rregullat sipas ketij seksioni mund te krijojne dispoizita te ndryshme per raste te ndryshme.

(4) Sipas dispozitave te mepareshme ne kete Kapitull dhe cdo rregulle tjeter nen kete seksion, Sekretari i Shtetit mund te udhezojte cdo autoritet te planifikimit lokal ose autoritetet e planifikimit lokal ne pergjithesi—

- (a) per formulimin e procedures per kryerjen e funksioneve te tyre sipas ketij Kapitulli;
- (b) per ti kerkuar atyre qe ti japin informacionin e duhur sic mund te kerkoje ai per kryerjen e ketyre funksioneve sipas ketij Kapitulli.

Kuptimi i "planit
te zhvillimit" ne
Londren e Madhe
dhe qarqet
metropolitane

27. Per qellime te ketij Akti dhe ndonje dokumenti ligjor qe ka lidhje me planifikimin ne qytete dhe fshatra, Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961 [1961 c.33.] dhe Aktit mbi Autostradat 1980 [1980 c. 66.], planet zhvilluese per cdo rreth ne Londren e Madhe ose ne qarqe metropolitane do konsistojne ne—

- (a) dispozitat e planit te zhvillimit te njehsuar ne fuqi per kohen e tashme per ate zone ose pjese perkatese te saj, se bashku me nje kopje te rezolutes se adoptimit te planit te zhvillimit te njehsuar ose vertetimi per aprovimin nga Sekretari i Shtetit, ose kur

vetem nje pjese e planit eshte adoptuar kurse pjesa tjeter aprovuar, kopje te resolutes dhe te vertetimit; dhe

- (b) cdo ndryshim qe i behet planit, se bashku me nje kopje te rezolutes se adoptimit, ose vertetimit qe eshte aprovuar, ndryshuar ose nje pjese ndryshuar dhe pjesa tjeter aprovuar nga Sekretari i Shtetit.

Fillimi i Kapitullit I:
Dispozita te tranzicionit

28.—(1) Pasi i nenshtrohen nen-seksionit (2), dispozitat e ketij Kapitulli do te hyjne ne fuqi ne zonen e cdo autoriteti te planifikimit lokal ne Londren e Madhe ose ne nje qark metropolitan (me perjashtim te zonave ne ato qarqe qe jane pjese e nje Parku Kombetar) ne ate dite qe caktohet per ate zone ose ne ditën kur jep urdher Sekretari i Shtetit.

(2) Nen-seksioni (1) nuk aplikohet ne zonat per te cilat eshte dhene nje urdher perpara fillimit te ketij Akti sipas seksionit 4(1) te Aktit mbi Qeverine Lokale 1985 [1985 c.51] (fillimet e Pjeses se I te Skedules 1 te atij Akti) dhe ne zona te tilla dispozitat e ketij Kapitulli do te hyne ne fuqi kur fillon ky Akt ose, ne qofte se me vone, ne ditën e caktuar me urdher.

(3) Derisa te behet operativ nje plan zhvillimi i njehsuar sipas ketij Kapitulli per zona sic permenden ne nen-seksionin (1) (ose kur pjese te nje plani te tille behen operative ne data te ndryshme, derisa te gjithë pjesët te jene operative)—

- (a) ne qofte se zona e autoritetit te planifikimi lokal eshte ne nje qark metropolitan, do te aplikohet Pjesa I e Skedules (Aneksi) II (e cila siguron qe planet ekzistuese te vazhdojne te jene ne fuqi dhe aplikon disa dispozita te Kapitullit II);
- (b) ne qofte se zona e autoritetit te planifikimit lokal eshte ne Londren e Madhe, do te aplikohet Pjesa II e asaj Skedule (Aneksi) (qe ka dispozita te ngjashme); dhe
- (c) Pjesa III e asaj Skedule do te aplikohet ne lidhje me krijimin e dispozitave per ceshtje tranzicioni per te cilat dispozita jane bere perpara fillimit te ketij Akti nga Skedula (Aneksi) 7 e Aktit te 1971 (planet e vjetra te zhvillimit etj.).

(4) Fuqia per te dhene urdhra sipas ketij seksioni mund te ushtrohet edhe per te krijuar dispozita te ndryshme per raste te ndryshme, duke perfshire dispozita te ndryshme per zona te ndryshme.

KAPITULLI II STRUKTURA DHE PLANET LOKALE: ZONAT JO-METROPOLITANE

Hyrje

Aplikime te Kapitullit II tek zonat metropolitane

29. Duke u mbeshtetur ne dispozitat e tranzicionit ne Skedulen (Aneksin) 2, ky Kapitull aplikohet vetem ne zonat e nje autoriteti te planifikimit lokal jashte Londres se Madhe dhe qarqeve metropolitane dhe te ndonje pjese te Parqeve Kombetare ne qarqe te tilla.

Vleresime, etj.

Vleresime te zonave te planifikimit

30—(1) Autoriteti i planifikimit lokal—

- (a) duhet t'i mbaje nen mbikqyrje ceshtje qe mund te mendohen se ndikojne ne zhvillimin e zones se tyre ose ne planifikimin per zhvillim; dhe
- (b) ne qofte se e konsideron te pershtatshme, mund te organizoje nje vleresim te zones per te ekzaminuar keto ceshtje.

(2) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), ceshtjet qe duhet te mbahen nen mbikqyrje dhe ekzaminuar sipas ketij nen-seksioni do te perfshijne—

- (a) karakteristikat kryesore fizike dhe ekonomike te zones se autoritetit (duke perfshire qellimet kryesore per te cilat perdoret toka) dhe, te ndonje zone fqinje ne qofte se mendohet se ndikojne ne zone;
- (b) madhesine, perberjen dhe shperndarjen e popullsise ne kete zone (te rezidenteve ose jo);

- (c) pa cenuar paragrafin (a), komunikacioni, sistemi i transporteve, dhe trafiku i asaj zone dhe te zonave fqinje ne qofte se mendohet qe ndikojne ne zone;
- (d) cdo gje tjeter qe nuk permendet ne paragrafet (a), (b) ose (c) qe mund te ndikojne mbi ceshtjet e permendura;
- (e) ceshtje te tjera per te cilat vecanarisht mund te udhezoje Sekretari i Shtetit;
- (f) cdo ndryshim qe mund te behet ne ceshtjet e permendura ne paragrafet e mesiperme dhe ndikimi qe keto ndryshime mund te kene ne zhvillimin e kesaj zone ose ne planifikimin per zhvillim.

(3) Nje vleresim i bere sipas nen-seksionit (1)(b) mund te behet vetem per nje pjese te zones qe mbulon nje autoritet; dhe referenca qe i behen ne nen-seksionin (2) zones se nje autoriteti ose zones se autoritetit fqinje jane edhe referenca per nje pjese te zones kur eshte rasti.

(4) Autoriteti i planifikimit lokal, me qellim qe te kryeje funksionet sipas ketij seksioni per te mbikqyrur ose ekzaminuar ceshtje qe lidhen me zonen e nje autoriteti tjeter, duhet te konsultohet me kete autoritet per keto ceshtje.

Plane Strukturale

31.—(1) Cdo plan strukturor aprovohet nga Sekretari i Shtetit sipas Aktit te vitit 1971 ne lidhje me nje zonen e nje autoriteti te planifikimit lokal qe ka qene nen operim perpara fillimit te ketij Akti do te vazhdoje te jete ne fuqi pas fillimit te tij (duke konsideruar ndryshime gjate punimeve dhe ne baze te dispozitave te kesaj Pjese).

(2) Plani struktural per nje zone do te jete nje deklarate me shkrim—

- (a) qe formulon politikat e autoritetit te planifikimit lokal dhe propozime te pergjithshme ne lidhje me zhvillimin dhe perdorime te tjera te tokes ne ate zone (duke perfshire masa per permiresimin e mjedisit fizik dhe menaxhimit te trafikut); dhe
- (b) qe permban ceshtje te tjera sic mund te

Plane
strukturale:
vazhdimesia,
forma, dhe
permbajtja.

pershkruhen ose sic mund te udhezoje
Sekretari i Shtetit.

(3) Deklarate me shkrim duhet te shoqerohet me diagrama qe do merren si pjese perberese e ketij plani.

(4) Autoriteti i planifikimit lokal gjate formulimit te politikave te tyre dhe propozimeve te pergjithshme sipas seksionit (2), duhet te sigurohet qe keto politika dhe propozime justifikohen me rezultatet e vleresimet sipas seksionit 6 te Aktit te vitit 1971 ose me ndonje vleresim te fundit te bere nga ata sipas seksionit 30 dhe me cdo informacion tjeter qe mund te kene mbledhur dhe duhet te kete parasysh—

- (a) qe politikat e tanishme te hartohen ne menyre qe te bazohen ne planifikimin ekonomik dhe zhvillimin e rajonit ne teresi;
- (b) burimet qe mund te perdoren per te zbatuar propozimin e planit struktural; dhe
- (c) ceshtje te tjera per te cilat udhezohet Sekretari i Shtetit qe duhet te merren ne konsiderate.

(5) Kur Sekretari i Shtetit, sipas seksionit 7(7) te Aktit te vitit 1971, ka udhezuar per pregatitjen e nje plani struktural per nje pjese te zones se autoritetit te planifikimit lokal, referenca qe behen ne kete Pjese te ketij Akti per zonen qe mbulohet nga autoriteti, ne lidhje me nje plan struktural, do jene edhe referenca per nje pjese te zones.

Ndryshime dhe
zevendesime te
planeve
strukturale

32.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal mund ose duhet ne qofte se udhezohet nga Sekretari i Shtetit, t'i dorezoje atij brenda nje periudhe te caktuar propozime per ndryshime ne planin struktural per zonen e tij ne qofte se e shohin te nevojshme ose ne qofte se Sekretari i Shtetit ka urdheruar nje gje te tille.

(2) Propozime te tilla mund te kene te bejne me nje pjese ose me te gjithe zonen me te cilen lidhet plani.

(3) Autoriteti i planifikimit lokal ne cdo kohe mund te paraqese prane Sekretarit te Shtetit propozime per zevendesimin e planit struktural per zonen e tyre.

(4) Autoriteti qe ka paraqitur nje propozim sipas nen-seksionit (3) per zevendesimin e nje plani struktural duhet te paraqese prane Sekretarit te Shtetit nje plan struktural me te cilin mendojne te zevendesojne planit aktual.

(5) Propozimet sipas nen-seksionit (1) ose (3) duhet te shoqerohen me nje memorandum shpjegues qe permbledh—

- (a) ne rastin e propozimeve sipas nen-seksionit (1), aresyet qe sipas autoritetit lokal justifikojne ndryshimet qe ata propozojne; dhe
- (b) ne rastin e propozimeve sipas nen-seksionit (3), aresyet qe sipas autoritetit te planifikimit lokal justifikojne zevendesimin e planit strukturor.

(6) Memorandumi shpjegues duhet te perfshije gjithashtu lidhjen qe ekziston ndermjet propozimeve dhe propozimeve te pergjithshme per zhvillim ose perdorime te tjera te tokes ne zonat fqinje qe mund te ndikohen nga zona me te cilen lidhet propozimi.

(7) Memorandumi shpjegues—

- (a) duhet te permbaje gjithashtu cdo informacion mbi te cilin jane bazuar propozimet; dhe
- (b) mund te perfshije materiale ilustruese qe autoriteti i planifikimit lokal i konsideron te pershtatshme.

33.—(1) Gjate pregatitjes se propozimeve per ndryshime dhe zevendesime te nje plani struktural per zonen e tyre dhe perpara se te finalizohen per t'ju dorezuar Sekretarit te Shtetit, autoriteti i planifikimit lokal duhet te ndermarre hapa per te arritur —

- (a) reklamimin e mjaftueshem ne zonen e tyre te ceshtjeve qe propozohen per tu perfshire ne plan dhe te permbajtjes se memorandumit shpjegues ne lidhje me keto ceshtje;
- (b) qe personat qe mund te desherojne mundesi per te bere verejte apo komente prane autoritetit per ceshtjet ne fjale, te jene njoftuar per nje mundesi te tille;

Reklamim ne lidhje me propozime per ndryshim ose zevendesim te planeve strukturale.

(c) qe personave te tille u eshte dhene mundesi e mjaftueshme per te bere verejte.

(2) Autoriteti duhet te marre ne konsiderate cdo verejtje apo koment te bere brenda nje periudhe te caktuar.

(3) Menjehere pas dorezimit te propozimeve tek Sekretari i Shtetit, autoriteti i planifikimit lokal duhet te vendose kopje te propozimeve dhe memorandumit shpjegues ne zyre ose ne vende te tjera te caktuara per inspektim.

(4) Cdo kopje e propozimit dhe e memorandumit shpjegues duhet te shoqerohet me nje dokument ku caktohet periudha kohore brenda te ciles mund te behen verejte tek Sekretari i Shtetit.

(5) Propozimet qe dorezohen nga autoriteti i planifikimit lokal prane Sekretarit te Shtetit per te marre aprovimin e tij duhet te shoqerohen me nje leter qre permban sa me poshte —

- (a) hapa qe ka ndermarre autoriteti per te zbatuar seksionet (1) dhe (2); dhe
- (b) konsultimet qe ka bere autoriteti me persona te tjere per keto ceshtje dhe marrjen per baze te verejtjeve te tyre.

(6) Ne qofte se pasi ka shqyrtuar propozimet, dokumentet, dhe informacione te tjera te paraqitura nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit eshte bindur se jane arritur qellimet e parashtruara ne paragrafet (a) deri (c) te nen-seksionit (1) si rezultat i hapave te ndermarre nga autoriteti ne perputhje meate nen-seksion., atehere ai duhet te konsideroje nese t'i aprovoje apo jo propozimet.

(7) Ne qofte se Sekretari i Shtetit nuk eshte i bindur sic permendet ne nen-seksionin (6), atehere ai duhet t'ja ktheje propozimet autoritetit dhe t'i udhezoje ata per —

- (a) te marre masa te metejshme sic mund te specifikohen me urdher per te arritur keto qellime;
- (b) pasi jane kryer keto masa, per dorezimin e propozimit me modifikime, qe mund te konsiderohen te pershtatshme dhe ne qofte se kerkohen, dhe ky dorezim te behet brenda nje periudhe te caktuar.

(8) Kur Sekretari i Shtetit ia kthen propozimin autoritetit te planifikimit lokal, ai duhet te -

- (a) informoje autoritetin per aresyet e ketij kthimi, dhe
- (b) njoftoje per kthimin e propozimit cdo person qe mund te kete bere verejte apo komente, ne qofte se ka.

(9) Kur nje autoritet i planifikimit lokal ka marre udhezime sipas nen-seksionit (7) duhet te terheqe menjehere kopjet e vendosura per inspektim sic kerkohet nga nen-seksioni (3).

(10) Nen-seksionet (3) dhe (9) do te aplikohen me modifikimet e nevojshme ne lidhje me propozimet e paraqitura serisht prane Sekretarit te Shtetit ne perputhje me udhezimet e dhena sipas nen-seksionit (7) sic mund te aplikohen ne propozimet origjinale.

34.—(1) Propozimet per ndryshime dhe zevendesime te nje plani struktural te paraqitura Sekretarit te Shtetit per aprovim mund te terhiqen ne cdo kohe perpara se te jene aprovuar nga autoriteti i planifikimit lokal.

(2) Propozimet qe jane terhequr do te konsiderohen sikur nuk ishin paraqitur asnjehere.

(3) Me terheqjen e ketyre propozimeve autoriteti qe i ka pregatitur duhet te terheqe gjithashtu edhe kopjet e ketyre propozimeve qe jane nxjerre per inspektim ne perputhje me seksionin 33 (1), dhe duhet te lajmerojte cdo person qe ka bere verejte per kete terheqje.

(4) Per te vedosur masat qe duhen marre per te arritur qellimet ne paragrafet (a) deri (c) te seksionit 33(1), autoriteti i planifikimit lokal qe po pregatit propozimit mund te marre ne konsiderate hapa te ndermarre per te arritur keto qellime ne lidhje me propozime te tjera te meparshme te cilat mund te jene ose jo paraqitur per aprovim prqane Sekretarit te Shtetit, ose qe mund te jene paraqitur dhe terhequr me vone.

(5) Autoriteti qe paraqet prane Sekretarit te Shtetit propozime per aprovim dhe qe kane ndermarre hapa sipas nen-seksionit (4), duhet te jape detaje te ketyre hapave ne dokumente sipas nen-seksionit (5) te seksionit 33 dhe

Sekretari i Shtetit mund ti konsideroje keto hapa ne lidhje me keto propozime kur vendos sipas sipas nen-seksionit (6) nese eshte i bindur apo jo.

Aprovimi apo
hedhja poshte e
ndryshimeve ose
zevendesimeve te
planeve
strukturale

35.—(1) Sekretari i Shtetit, pasi shqyrton propozimet per ndryshime dhe zevendesime te nje plani struktural te paraqitur, ose i aprovon ata (pjeserisht ose teresisht, me ose pa modifikime ose rezerva) ose i refuzon ata.

(2) Gjate shqyrtimit te ketyre propozimeve Sekretari i Shtetit merr parasysh cdo ceshtje te cilen e konsideron te rendesishme, nese jane marre apo jo ne konsiderate ne propozim.

(3) Ne rastin kur Sekretari i Shtetit pasi ka marre ne konsiderate propozimet nuk i refuzon ato, perpara se te marre vendimin per ti aprovuar apo jo duhet te -

- (a) shqyrtoje cdo verejte qe i eshte bere propozimit ne perputhje me rregullat e ketij Kapitulli, dhe
- (b) sipas nen-seksionit (4), i udhezoi nje ose disa persona te emeruar nga ai qe te mbajne nje seance shqyrtuese per ceshtjet qe kane te bejne me propozimet sic e konsideron te aresyeshme.

(4) Ne qofte se Sekretari i Shtetit, gjate shqyrtimit te propozimeve, e gjykon qe nuk ka ceshtje per tu ekzaminuar ne lidhje me nje plan struktural, atehere nuk ka nevojte te behet nje seance e tille.

(5) Sekretari i Shtetit, pasi konsultohet me Kancelarin e Lordeve, mund te vendose rregulla ne lidhje me proceduren qe duhet te ndiqet ne keto seanca sipas nen-seksionit (3)(b).

(6) Sekretari i Shtetit nuk e ka te detyrueshme ti jape te drejten per te prezantuar ne ndonje seance ndonje autoriteti te planifikimit lokal apo ndonje personi tjetër, dhe sipas nen-seksionit (7), vetem njesi apo persona te tille qe mund te jene ftuar nga Sekretari i Shtetit perpara ose gjate shqyrtimit, mund te marrin pjese ne keto seanca.

(7) Personi ose personat qe mbajne nje seance shqyrtimi mund te ftojne njesi ose persona shtese perpara ose gjate seances per te marre pjese ne te, ne qofte se ato e shohin te

Terheqje te
propozimeve per
ndryshime dhe
zevendesime te
planeve
strukturale

nevojshme.

(8) Nje shqyrtim sipas nen-seksionit (3)(b) perben nje hetim ligjor per qellime te seksionit 1(1)(c) te Aktit mbi Hetimet dhe Gjyqet 1971, por nuk perben hetime per ndonje qellim tjeter te atij Akti.

(9) Gjate shqyrtimit te propozimeve Sekretari i Shtetit mund (por nuk detyrohet) te konsultohet ose te konsideroje pikepampjet e e autoritetit te planifikimit lokal dhe ndonje personi tjeter.

(10) Gjate ushtrimit te fuqive qe ka sipas nen-seksionit (1) ne lidhje me propozimet, Sekretari i Shtetit duhet te jape sqarime per aresyet e marrjes se nje vendimi.

Plane Lokale

Plane Lokale

36.—(1) Nje plan lokal duhet te perbehet nga —

(a) nje dokument te shkruar qe formulon ne nje nivel detajesh qe autoriteti i planifikimit lokal e sheh te aresyeshme, propozimet e tyre per zhvillimin ose perdorimin e tokes ne zonen e tyre, ose ndonje pershkrim te zhvillimeve ose perdorimeve te tokes, duke perfshire masa qe autoriteti i konsideron te pershtatshme per permiresimin e mjedisit dhe menaxhimin e trafikut;

(b) nje harte qe tregon keto propozime; dhe

(c) diagrama, ilustrime, ose materiale te tjera te cilat autoriteti i sheh te nevojshme per shpjegimin e propozimeve, ose te ndonje dokumenti tjeter qe mund te kerkohe.

(2) Plane lokale te ndryshme mund te pregatiten per qellime te ndryshme ne te njejten zone.

(3) Gjate hartimit te propozimeve, autoriteti i planifikimit lokal duhet te kete parasysh cdo informacion qe ata e konsiderojne te rendesishem, ose i cili mund te jete percaktuar si i rendesishem nga Sekretari i Shtetit ne raste te vecanta.

(4) Autoriteti i planifikimit lokal mund te pregatise nje plan lokal per nje pjese te zones se tyre ("zone veprime") qe mund

te kene zgjedhur per fillimin brenda nje periudhe te caktuar te punimeve te pergjithshme per zhvillimin, rizhvillimin ose permiresimin e gjithe pjeses se zgjedhur.

(5) Plan lokal i pregatitur per nje zone veprime duhet te tregoje menyren e punimeve per ate zone te zgjedhur.

(6) Me qellim kryerjen e funksioneve qe kane ne lidhje me planet lokale nje autoritet i planifikimit te rrethit, kur e konsideron te nevojshme, mund te marre parasysh vleresime te bera nga autoriteti i planifikimit qarkor sipas seksionit 6 te Aktit te vitit 1971 ose seksionit 30, dhe te shqyrtoje ceshtje te permendura ne nen-seksionet (1) dhe (2) te seksionit 30 ne qofte se jane te rendesishme per zonen e tyre.

(7) Gjate pregatitjes se nje plani lokal nje autoritet i planifikimit lokal duhet te marre parasysh dispozitat e cdo skeme sipas paragrafit 3 te Skedules 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 ne lidhje me token ne zonen e tyre qe caktuar nen ate Skedule si nje zone sipermarjeje.

Skema te planit lokal

37.—(1) Nje skeme plani lokal per cdo qark duhet te jete ne perputhje me kete seksion duke hartuar nje program per krijimin, ndryshimin ose zevendesimin e planeve lokale per zonat e qarkut, pervec rasteve kur nje pjese e qarkut eshte ne nje Park Kombetar.

(2) Skema, ne lidhje me secilin plan lokal duhet te —

(a) specifikoje titullin dhe natyren e planit dhe zonen ne te cilen do aplikohet, dhe te jape shpjegime per shprendarjen e tij,

(b) tregoje lidhjen, kur ekziston, me plane te tjera lokale, dhe

(c) caktojte autoritetin e planifikimit lokal pergjegjes per planin qofte ne qark ose ne rreth;

dhe mund te permbaje dispozita te ndryshme suplementare, te tranzicionit, te rastit, dhe rrjedhuese.

(3) Autoritetet e planifikimit te rrethit duhet te mbajne ne mbikqyrje nevojten qe mund te kete zona e tyre per plane lokale dhe mund t'i japin rekomandimet e tyre autoritetit te planifikimit te qarkut per t'u perfshire ne skemen e planit

lokal.

(4) Autoriteti i planifikimit te qarkut, pasi ka marre rekomandimet dhe eshte keshilluar me autortetin e planifikimit te rrethit, do te hartoje dhe t'a rishikojë vazhdimisht skemen e planit lokal.

(5) Sa me shpejt qe te jete praktikisht e mundur pas hartimit ose rishikimit te nje skeme plani lokal, autoriteti i planifikimit te qarkut duhet ti dergoje nje kopje te skemes, ose skemes se rishikuar, Sekretarit te Shtetit.

(6) Ne qofte se nje autoritet i planifikimit te rrethit ka bere verejtje aspo komente prane Sekretarit te Shtetit qe ata jane te pakenaqrur me skemen e planit lokal, Sekretari i Shtetit mund te rishikojë skemen.

(7) Autoriteti i planifikimit lokal mund te pregatise propozime per hartimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje plani lokal—

(a) vetem kur autorizohet per nje gje te tille nga skema e planit lokal, ne cdo rast, pervec kur propozimet kane te bejne me toka qe shtrihen ne Parqe Kombetare, dhe

(b) vetem me lejen e Sekretarit te Shtetit, kur propozimet per ndryshime, ose zevendesime ne planin lokal jane aprovuar nga Sekretari i Shtetit;

por duke zbatuar cdo udhzim te Sekretarit te Shtetit te parashtruar ne seksionin 38.

38—(1) Sekretari i Shtetit, pasi konsultohet me autoritetin e planifikimit lokal, mund t'i udhezoje te hartojne, ndryshojne, ose zevendesojne nje plan lokal ne lidhje me zonen e tyre ose me nje pjese te saj.

(2) Udhezimi per hartimin, ndryshimin ose zevendesimin e nje plani lokal duhet te specifikojë natyren e planit, ose sipas rastit antyren e ndryshimeve qe duhen bere.

(3) Autoriteti duhet t'i zbatoje udhezimet sa me shpejt te jete e mundur.

(4) Autoriteti i planifikimit te qarkut duhet te beje rregullimet e nevojshme ne planin lokal sic mendohet e

pershtatshme per te ju permbajtur udhezimeve.

Reklamimi dhe
konsultimet:
E pergjithshme

39.—(1) Nje autoritet i planifikimit lokal qe propozon per hartimin, ndryshimin ose zevendesimin e nje plani lokal duhet te operoje ne perputhje me kete seksion, pervec rasteve kur aplikohet seksioni 40.

(2) Ata duhet te marrin hapa per te bere te mundur —

(a) qe reklamim i mjaftueshem i eshte bere propozimit ne zonen e cila lidhet me planin;

(b) qe personat qe mund te deshirojne te bejen verejtjet e tyre per propozimet, te jene vene ne dijeni qe mund ta bejne nje gje te tille;

(c) qe ketyre personave i jepet mundesi e mjaftueshme per te bere verejtje te tilla.

(3) Ata duhet te marrin parasysh cdo verejtje qe u eshte bere brenda periudhes se caktuar me pare.

(4) Ata duhet te —

(a) konsultohen me autoritetin e planifikimit te qarkut, ose sipas ratit, me autoritetin e planifikimit te rrethit ne lidhje me propozimet;

(b) ti japin autoritetit mundesi te mjaftueshme te shprehim pikepamjet e tyre; dhe

(c) t'i marrin keto pikepamje ne konsiderate.

(5) Pasi kane pregatitur dokumentat e duhur, qe jane plani i propozuar, dhe sipas rastit ndryshimet ose zevendesimet ne plan, dhe pasi kane marre certifikaten e kerkuar nga seksioni 46, ata duhet te —

(a) nxjerrin kopje te dokumentave per inspektim ne zyre,

(b) dergojne nje kopje te tyre tek Sekretari i Shtetit, dhe

(c) dergojne nje kopje te tyre tek autoriteti i planifikimit te rrethit apo te qarkut, sipas rastit.

(6) Cdo kopje e dokumentave e nxjerre per inspektim duhet te shoqerohet me nje leter qe tregon periudhen kohore brenda se ciles mund te behen verejtje.

Pushteti i
Sekretarit te
Shtetit per te
udhezuar berje te
planeve lokale

Reklamimi dhe konsultimet: procedurat e shkurtra per ndryshime te caktuar

40—(1) Kur autoriteti i planifikimit lokal propozon per ndryshimin ose zevendesimin e nje plani lokal dhe ata nuk i konsiderojne ceshtjet me rendesi te madhe per te zbatuar proceduren ne seksionin 39 plotesisht, ata mund te procedojen ne perputhje me kete seksion.

(2) ata duhet te pregatisin dokumentat perkates, qe jane ndryshimet e propozuara, ose zevendesimin e planit, dhe pasi kane marre certifikaten e kerkuar qe parashtrohet ne seksionin 46, ata duhet te —

- (a) nxjerrin kopje te dokumentave per inspektim ne zyre,
- (b) dergojne nje kopje te tyre tek Sekretari i Shtetit, dhe
- (c) dergojne nje kopje te tyre tek autoriteti i planifikimit te rrethit apo te qarkut, sipas rastit.

(3) Cdo kopje e dokumentave e nxjerre per inspektim duhet te shoqerohet me nje leter qe tregon periudhen kohore brenda se ciles mund te behen verejtje.

(4) Ata duhet te ndermarrin hapa per te bere te mundur—
(a) reklamimin e faktit qe dokumentat jane gati per inspektim si dhe te vendeve ku mund te gjenden dhe intervalit kohor te pershtatshem per inspektim, dhe
(b) te ftohen njerezit per te bere verejte ne perputhje me rregullat.

(5) Ata duhet te marrin ne konsiderate cdo verejtje te bere brenda kohes se caktuar.

Pushteti i Sekretarit te Shtetit per te siguruar reklamim dhe konsultim te mjaftueshem

41—(1) Dokumentet qe autoriteti i planifikimit lokal i dergon Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 39 duhet te shoqerohen me nje leter ku specifikohen—

- (a) hapat qe jane marre nga autoriteti per te zbatuar nen-seksionet (2) dhe (3) te atij seksioni, dhe
- (b) konsultimet qe ka bere autoriteti me persona te tjere si dhe marrjen ne konsiderate te pikepamjeve te ketyre personave.

(2) Dokumentat qe autoriteti i planifikimit lokal i dergon

Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 40 duhet te shoqerohen me nje leter ku pershkruhen hapat qe ka ndermarre autoriteti per te zbatuar nen-seksionet (4) dhe (5) te atij seksioni.

(3) Ne qofte se Sekretari i Shtetit, pasi shqyrton propozimet dhe informacionin tjeter qe eshte paraqitur nga autoriteti i planifikimit lokal, nuk kenaqet me hapat qe ka marre autoriteti, ai mund te udhozoje, brenda 21 diteve, qe autoriteti te mos beje hapa te metejshme per adoptimin e propozimeve pa —

- (a) zbatuar kerkesat ne lidhje me seksionin 39, ne qofte se eshte proceduar ne lidhje me seksionin 40, ose
- (b) ne cdo rast tjeter, pa marre masa sic specifikohen, per te bindur Sekretarin e Shtetit.

Kundershtime ose verejtje: seancat e shqyrtimit lokal ose mbledhje te tjera

42—(1) Autoriteti i planifikimit lokal mund te mbledhe nje hetim lokal ose ndonje mkedhje tjeter me qellim qe te shqyrtohen verejtjet e bera propozimeve te tyre per hartimin, ndryshimin ose zevendesimin e nje plani lokal.

(2) Ata duhet te mbajne mbledhje te tilla kur ka verejtje, dhe mund ti anullojne keto mbledhje vetem ne rastin kur te gjithe personat qe kane bere verejte kane lajmeruar me shkrim se nuk desherojen te marrin pjese.

(3) Hetimi lokal ose mbledhje tjeter e ngjashme duhet te mbahen nga persona te caktuar te emeruar nga Sekretari i Shteti, ose sipas rastit, nga autoriteti vete.

(4) Rregullat e vendosura per kete ceshtje mund —

- (a) te permbajne dispozita ne lidhje me emerimin, dhe kualifikimet qe kerkohen per kete emerim, te personave per te mbajtur keto mbledhje;
- (b) te perfshijne dispozita qe aftesojen Sekretarin e Shtetit te urdheroje autoritetin e planifikimit lokal te emeroje nje person te caktuar, ose te zgjedhe nga nje liste apo klase personash;
- (c) te permbaje dispozita ne lidhje me pagesen dhe benefitet e personave te emeruar.

(5) Nen-seksionet (2) dhe (3) te seksionit 250 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 (fuqia per te gjetur dhe marre ne pyetje deshmitare) aplikohen ne cdo hetim te bere sipas ketij seksioni.

(6) Akti mbi Hetimet dhe Gjyqet 1971 do te aplikohet ne nje hetim lokal ose mbledhje tjeter e tille te mbajtur sipas ketij seksioni sic aplikohet ne nje séance shqyrtimi ligjore te mbajtur nga Sekretari i Shtetit, por ne seksionin 12(1) te atij Akti (aresyet e vendimeve) referenca qe i behen vendimeve te marra nga Sekretari i Shtetit, jane referenca per vendimet e marra nga autoriteti lokal.

Adopitimi i
propozimeve

43.—(1) Pas mbaron afati i caktuar per te bere verejtje ndaj propozimeve per hartimin, ndryshimin, apo zevendesimin e nje plani lokal, ne qofte se keto verejtje jane bere brenda kohes se caktuar, pasi i shqyrton keto verejtje autoriteti i planifikimit lokal mund te adoptoje planin pasi i nenshtrohet ketij seksioni dhe seksionit 44.

(2) Ata mund te adoptojne propozimet sic ishin pregatitur ne fillim, ose sic mund te jene modifikuar per te marre parasysh—

- (a) cdo verejte sic permendet ne nen-seksionin (1) ose cfaredo verejtje tjeter bere propozimeve, ose
- (b) cdo konsiderate tjeter qe autoriteti mund ta mendoje te rendesishme.

(3) Autoriteti nuk duhet te aprovoje modifikime qe nuk jane konform me planin struktural.

(4) Pasi Sekretari i Shtetit ka marre kopje te propozimeve dhe perpara se keto propozime te adoptohen nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit, ne qofte se i konsideron propozimet te pakenaqshme, mund te udhezoje autoriteti te beje modifikime sic percaktohen ne udhezim.

(5) Autoritetit te cilit i jepet nje udhezim nuk duhet te adoptoje propozimet, deri sa Sekretari i Shtetit te bindet qe ata kane bere modifikimet e duhura sipas udhezimeve, ose ne qofte se udhezimet terhiqen.

(6) Kur propozimit i behen verejtje nga Ministri i Bujqesise, Peshkimit, dhe Ushqimit, dhe kur autoriteti i planifikimit

lokal nuk propozon qe keto verejtje te marren parasysh, atehere —

- (a) autoriteti duhet t'i dergoje te vecantat e verejtjeve Sekretarit te Shtetit, se bashku me nje leter ku tregohen aresyet per te mos marre parasysh keto verejtje, dhe
- (b) ata nuk duhet te adoptojne propozimet pa marre autorizimin nga Sekretari i Shtetit.

Propozime per
aprovime nga
Sekretari i Shtetit

44.—(1) Pasi kopjet e propozimeve jane derguar Sekretarit te Shtetit dhe perpara se te jene adoptuar nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit mund te udhezoje qe propozimet kerkojne aprovimin e tij.

(2) Ne qofte se ai jep nje udhezim te tille —

- (a) autoriteti nuk duhet te beje hapa te metejshem per adoptimin e propozimeve dhe vecanarisht nuk duhet te mbaje nje hetim lokal ose mbledhje tjeter ne lidhje me propozimet sipas seksionit 42; dhe
- (b) propozimet nuk kane vlere ne qofte se nuk aprovohen nga Sekretari i Shtetit dhe nuk duhet te adoptohen nga autoriteti.

(3) Kur verejtjet e bera nga Ministri i Bujqesise, Peshkimit dhe Ushqimit jane derguar Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 43(6), atehere ai duhet te udhezoje qe te procedohet ne perputhje me kete seksion, pervec rastit kur Sekretari i Shtetit bindet qe Ministri i ka terhequr verejtjet.

Aprovime te
propozime nga
Sekretari i Shtetit

45.—(1) Sekretari i Shtetit pas shqyrton propozimet qe i jane paraqitur ne perputhje me seksionin 44, ose i aprovon ata (pjeserisht, teresisht, me ose pa modifikime ose rezervime) ose i refuzon.

(2) Gjate shqyrtimit te propozimeve ai mund te marre ne konsiderate cdo ceshtje qe e mendon te rendesishme, nese jane marre apo jo ne konsiderate ne propozim.

(3) Kur pasi ka shqyrtuar propozimet Sekretari i Shtetit nuk vendos per refuzimin e tyre, perpara se te vendose nese i aprovon ata apo jo, ai duhet te —

- (a) konsideroje cdo verejtje te bere ne perputhje me rregullat;

(b) t'i jape mundesine cdo personi qe ka bere verejtje dhe qe nuk e ka terhequr kete verejtje, per te paraqitur verejtjen perpara personit te emeruar nga Sekretari per kete qellim;

(c) ne qofte se mbahet nje hetim lokal apo mbledhje tjeter, gjithashtu t'i jepet mundesia per te paraqitur verejtje ketyre personave dhe personave te tjere sic mund te konsiderohet e pershtatshme,

pervec rasteve kur keto verejtje jane marre ne konsiderate, ose kur keto hetime dhe mbledhje jane mbajtur nga autoriteti.

(4) Gjate shqyrtimit te propozimeve, Sekretari i Shtetit mund te konsultohet me ose te marre ne konsiderate pikepamjet e autoritetit te planifikimit lokal ose te ndonje personi tjeter; por ai nuk eshte i detyruar te beje ne j gje te tille ose t'i jape mundesi personave te ndryshem per te paraqitur verejtje, apo te mbaje ne j hetim lokal, pervec rasteve kur percaktohet nga nen-seksioni (3).

Konformiteti midis planeve

Certifikate per perputhje

46.—(1) Propozimet ne nje plan lokal duhet te jene pergjithesisht ne konform me nje plan struktural.

(2) Autoriteti i planifikimit te rrethit qe kane pregatitur propozimet per hartimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje plani lokal nuk duhet te bejne hapa te permendur ne seksionet 39(5) ose 40(2), pa marre certifikaten ne perputhje me kete seksion qe veterton se propozimet jane pergjithesisht ne konform me planin struktural.

(3) Autoriteti i planifikimit te rrethit duhet t'i kerkoje autoritetit te planifikimit qarkor te vertetoje qe propozimet e tyre jane konform, dhe qe autoriteti, brenda nje muaji pasi ka marre kete kerkese ose brenda qe periudhe kohore tjeter qe eshte rene dakord ne mes te autoriteteve, te konsideroje ceshtjen dhe ne qofte se binden qe propozimet jane konform, ti jape certifikaten qe verteton nje gje te tille.

(4) Ne qofte se autoriteti i planifikimit te qarkut mendon se propozimet nuk jane ne konform, sa me shpejt te jete e

mundur pasi mbaron periudha e permendur, ata duhet t'ja paraqesin kete ceshtje Sekretarit te Shtetit per te vendosur ai nese propozimet jane apo jo konform.

(5) Sekretari i Shtetit kurdohere mund te udhezoje autoritetin e planifikimit te qarkut, qe ai vete rezervon te dretjen per te vendosur nese propozimet per hartimin, ndryshimin, apo zevendesimin e planit lokal jane pergjithesisht konform me planin struktural.

(6) Ne vendimin qe i referohet ose qe rezervon, Sekretari i Shtetit -

(a) ne qofte se mendon se propozimet jane konform planit struktural, ai mund te jape certifikaten ose te udhezoje autoritetin e planifikimit qarkor te jape kete certifikate, dhe

(b) ne qofte se mendon se propozimet nuk jane konform, atehere ai mund te udhezoje autoritetin e planifikimit te rrethit te rishikojne propozimet ne menyre qe te jene konform me planin struktural.

Ndryshime te planit struktural

47.—(1) Kur propozimet per ndryshime, ose zevendesime te nje plani struktural jane pregatitur dhe paraqitur Sekretarit te Shtetit, autoriteti i planifikimit lokal qe ka propozuar per te hartuar, ndryshuar ose zevendesuar nje plan lokal mund te aplikojte tek ai per nje udhezim sipas nen-seksionit (2).

(2) Me marrjen e nje aplikimi te tille Sekretari i Shtetit mund te udhezoje qe te konsiderohet per qellime te hartimit, ndryshimit, apo zevendesimit te nje plani lokal, qe propozimet e planit struktural jane aprovuar nga ai, kushtezuar nga modifikimet qe mund te behen dhe per te cilat njoftohet autoriteti i planifikimit te qarkut.

(3) Keto udhezime jane te pavlefshme ne qofte se Sekretari i Shtetit refuzon propozimet per ndryshimin ose zevendesimin e planit struktural.

(4) Perpara se te jape udhezime te tilla Sekretari i Shtetit duhet te konsultohet me -

(a) ne rastin kur aplikimi behet nga autoriteti i planifikimit qarkor—me cdo autoritet te planifikimit te rrethit zona e te cilit ndikohet

ose perfshihet ne propozimet per planin lokal;

- (b) ne rastin kur aplikimi behet nga autoriteti i planifikimit te rrethit -me autoritetin e planifikimit qarkor.

(5) Autoriteti i planifikimit qarkor, pasi merr aprovimin per ndryshimin ose zevendesimin e planit struktural, shqyrton nese planet lokale per zona qe ndikohen, jane pergjithesisht konform planit struktural pasi eshte ndryshuar apo planit te ri pasi eshte zevendesuar.

(6) Brenda nje muaji nga data qe autoriteti i planifikimit te qarkut merr aprovimin per propozimet, ata duhet t'i dergojne -

- (a) Sekretarit te Shtetit, dhe
(b) Cdo autoriteti te planifikimit te rrethit pergjegjes per planin lokal,

Nje liste te planeve lokale qe sipas tyre nuk jane ne konformitet.

Planet lokale ne raste konflikti me plane strukturale

48.—(1) Kur ekziston konflikt nepermjet dispozitave te nje plani lokal ne fuqi dhe dispozitave te nje plani struktural, dispozitat e planit lokal do te merren qe jane ne fuqi ne te gjitha rastet.

(2) Kur plani struktural eshte ndryshuar ose zevendesuar dhe plani lokal eshte ne listen e permendur ne seksionin 47(6) si plan qe nuk eshte konform me planin struktural pasi eshte ndryshuar apo zevendesuar, nen-seksioni (1) nuk aplikohet derisa eshte adoptuar ose aprovuar nga Sekretari i Shtetit nje propozim per ndryshime ose zevendesimin e tij, dhe keto ndryshime apo zevendesime kane hyre ne fuqi.

Suplementare

Mos marrja parasysh e prezantimeve ne lidhje me zhvillime te autorizuara nga ndonje miratim.

49.—Pavaresisht nga cdo gje qe parashtrohet ne dispozitat e meparshme te ketij Kapitulli, as Sekretari i Shtetit, as autoriteti i planifikimit lokal, e kane te nevojshme te marrin ne konsiderate verejtje ne lidhje me nje plan lokal ose me ndonje propozime per te ndryshuar ose zevendesuar nje plan struktural ose lokal, ne qofte se Sekretari i Shtetit ose

autoriteti mendojne qe keto verejtje jane ne themel verejtje ne lidhje me gjera te propozuara sipas

- (a) nje urdheri ose skeme sipas seksionit 10, 14, 16, 18, 106(1), ose (3) ose 108(1) te Aktit mbi Autostradat 1980;
- (b) nje urdher ose skeme sipas dispozitave te zevendesuara nga dispozitat dispozitat e Aktit mbi Autostradat 1980 te permendura ne paragrafin (a) (do te thote nje urdher apo skeme sipas seksionit 7, 9, 11, 13 ose 20 te Aktit mbi Autostradat 1959, seksioni 3 i Aktit mbi Autostradat 1961 ose seksioni 1 ose 10 te Aktit mbi Autostradat 1971);
- (c) nje urdher sipas seksionit 1 te Aktit mbi Qytetet e Reja 1981.

Plane strukturale te perbashketa

50.—(1) Kur nje plan struktural eshte pregatitur bashkarisht nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal, fuqia per te bere propozime sipas seksionit 32 per ndryshimin ose zevendesimin e nje plani mund te ushtrohet per ate pjese te planit qe eshte pregatitur nga autoriteti, dhe Sekretari i Shtetit sipas atij seksioni mund te udhezaje cilindo prej tyre te paraqesin propozime te tilla per zonat perkatese.

(2) Nen-seksioni (3) aplikohet ne vend te seksionit 33(1) (b) dhe (c) ne lidhje me nje propozim te perbashket per te ndryshuar dhe zevendesuar nje plan struktural, dhe referenca qe i behen ne seksionin 33, nen-seksionit (1) te ketij seksioni dhe qellimet e paragrafit (a) deri (c) te tij do te perfshijne referenca per nen-seksionin (3) dhe qellimet e paragrafit (a) dhe (b) perkatesisht te atij nen-seksioni.

(3) Autoriteti i planifikimit lokal duhet te ndermarre hapa qe ne opinionin e tyre sigurojne -

- (a) qe persona qe mund te desherojne nje mundesi per te bere verejtje apo komente prane cdo autoriteti, jane ne dijeni per mundesine per te bere nje gje te tille;
- (b) personave te tille u eshte dhene mundesi e mjaftueshme per te bere verejtje te tilla.

(4) Secili autoritet qe ka marre pjese ne pregatitjen e propozimeve per ndryshime dhe zevendesim te nje plani

struktural te perbashket, kane per detyre sic percaktohet ne seksionin 33(3) qe te vendosin kopje te propozimeve dhe memorandumit shpjegues ne vende te vecanta per inspektim.

(5) Kur propozimet per ndryshime dhe zevendesimin e nje plani struktural sipas ketij seksioni, pregatiten bashkarisht nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal, te gjitha ata ose secili prej tyre vecanarisht mund ti terheqin keto propozime sipas seksionit 34(1) dhe kur behet nje gje e tille te gjitha autoritetet duhet te zbatojne nen-seksionin (3) te atij seksioni.

(6) Kur dy ose me shume autoritete lokale pregatisin bashkarisht propozime per hartimin, ndryshimin, ose zevendesimin e nje plani lokal -

(a) autoritetet e planifikimit lokal jane bashkarisht pergjegjes per te ndermarre hapat e kerkuara nga seksioni 39 ose 40, pervec se secili nga ata kane per detyre sipas seksionit 39(5) (a) ose 40(2)(a) per te vendosur kopje te dokumenteve perkates ne vende te dukshme per inspektim, dhe verejtje per propozimet mund ti behen secilit nga keta autoritete, dhe letra qe kerkohet sipas seksionit 39(6) ose 40(3) per te shoqeruar dokumentet perkatese duhet te theksoje qe verejtjet mund te behen ne menyre te tille;

(b) eshte detyre e secilit nga autoritetet e planifikimit lokal qe te adoptoje propozimet sipas seksionit 43(1) dhe kjo gje mund te behet per pjesen e zones se tyre qe ndodhet ne propozim, por cdo modifikim qe duhet bere me qellim qe te adoptohen propozimet duhet te behet me marreveshjen e te gjitha autoriteteve.

(7) Aty ku -

(a) eshte pregatitur bashkarisht nje plan struktural nga dy ose me shume autoritete te planifikimit qarkor, ose

(b) eshte pregatitur bashkarisht nje plan lokal nga dy ose me shume autoritete te planifikimit te rrethit,

cdo autoritet i planifikimit te rrethit duhet t'i beje kerkese

autoritetit te planifikimit te qarkut per certificate sipas seksionit 46 qe plani lokal eshte konform planit struktural per pjesen qe perfshihet te zonen e autoritetit te planifikimit te rrethit dhe autoriteti i planifikimit te qarkut duhet te konsideroje kete kerkese.

(8) Kur nje plan lokal eshte hartuar bashkarisht, fuqia per te bere propozime per ndryshimin ose zevendesimin e tij, mund te ushtrohet ne lidhje me zonat perkatese qe mbulohen nga secilin nga keto autoritete, ne perputhje me dispozitat e skemes perkatese te planit lokal, dhe Sekretari i Shtetit sipas seksionit 38 mund t'i udhezaje ata per te bere propozime perkatesisht per zonat qe mbulojne ne plan.

(9) Per daten e caktuar siaps seksionit 53(5) per fillimin e operacioneve te nje plani lokal te pregatitur bashkarisht nga dy ose me shume autoritete, ose per ndryshimin apo zevendesimin e nje plani lokal ne perputhje me propozimet e perbashketa, duhet rene dakord bashkarisht nga gjitha keta autoritete dhe kjo daste duhet te specifikohet ne rezolutat perkatese per adoptimin e planit apo te propozimeve.

Fuqi
zevendesuese

51.—(1) Aty ku, ne baze te dispozitave te mepareshme te ketij Kapitulli, duhet te behet nje vleresim, kerkohet qe nje plan lokal, propozim per ndryshimin apo zevendesimit e tij te hartohet dhe paraqitet prane Sekretarit te Shtetit, ose kerkohen hapa per adoptimin e nje plani apo propozimi te tille, atehere -

(a) kur Sekretari i Shtetit eshte i bindur, pasi jane mbajtur hetimi dhe mbledhje lokale, qe autoriteti i planifikimit lokal perkates nuk ka bere vleresimin e kerkuar ose nuk ka marre masat e duhura per t'u aftesuar per te paraqitur apo adoptuar nje plan lokal apo propozime te tilla brenda nje periudhe te caktuar; ose

(b) ne rastin kur periudha eshte caktuar per paraqitjen apo adoptimin e nje plani lokal ose propozimeve te tilla, planet dhe propozimet nuk jane paraqitur ose adoptuar brenda kesaj periudhe.

(2) Ne rastin kur Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (1) mund te kryje cdo gje qe duhet te ishte bere nga nje

autoritet i planifikimit lokal (autoriteti perkates) , ai ne qofte se e sheh te pershtatshme, mund te autorizojte nje autoritet te planifikimit lokal tjetere qe mendon se ka interes ne planifikimin e zones se autoritetit qe e mbulon ate zone.

(3) Dispozitat e meparshme te ketij Kapitulli do te aplikohen me modifikimet e duhura ne lidhje me cdo gje qe ben nen kete Kapitull Sekretari i Shtetit ose cdo autoritet tjetere pervec autoritetit zevendesues.

(4) Autoriteti zevendesues--

(a) sipas kerkeses duhet t'i paguaje Sekretarit te Shtetit shpenzimet qe ka bere ne lidhje me cdo gje qe duhej te behej nga ata sic e verteton ai gjate ushtrimit te funksioneve; dhe

(b) do te paguaje cdo autoritet per ato qe ka bere ne vend te autoritetit, per shpenzimet e vertetuara nga Sekretari i Shtetit si te aresyeshme.

Rishikimi i
planeve ne zonat
e ndermarjeve

52.—(1) Sa me shpejt qe te jete praktikisht e mundur pasi eshte dhene nje urdher sipas paragrafit 5 te Skedules 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 (adoptimi i nje skeme te nje zone sipermarrjeje) ose kur eshte dhene nje njoftim sipas paragrafit 11 te asaj Skedule (Aneksi) (modifikime te skemes) -

(a) cdo autoritet i planifikimit te qarkut per nje zone ku zona e sipermarrjes eshte vendosur plotesisht apo pjeserisht duhet te rishikojte cdo plan struktural per zonen e tyre ose per ate pjese te zones se tyre e cila lidhet teresisht apo pjeserisht me zonen sipas dispozitave te skemes ose skemes se modifikuar; dhe

(b) cdo autoritet i planifikimit lokal per nje zone ku zona e sipermarrjes eshte vendosur plotesisht ose pjeserisht duhet te rishikojte cdo plan lokal qe kane pregatitur qe ka te beje me token ne ate zone.

(2) Autoriteti i planifikimit qarkor duhet t'i paraqese Sekretarit te Shtetit propozimet per ndonje ndryshim te planit struktural qe ata i konsiderojne te nevojshme per te marre parasysh skemen ose skemen e modifikuar.

(3) Autoriteti i planifikimit lokal duhet te beje propozime per

ndryshime te planeve lokale sic permendet ne ne-seksionin 1(b) qe ata e konsiderojne te nevojshme per te marre parasysh skemen ose skemen e modifikuar, ose per zevendesimin e nje plani te tille ne qofte se e konsiderojne te nevojshme.

Dispozita
suplementare per
plane strukturale
dhe lokale

53.—(1) Pa cenuar dispozitat e mepareshme te ketij Kapitulli, Sekretari i Shtetit mund te veje rregulla ne lidhje me formen dhe permbajtjen e planeve strukturale dhe lokale dhe per proceduren qe duhet te ndiqet ne lidhje me pregatitjen, terheqjen, adoptimin, paraqitjen, aprovimin, hartimin, ndryshimin, dhe zevendesimin.

(2) Ne vecanti rregulla te tilla mund te -

(a) vendosin per reklamimin qe duhet ti behet raportit te nje vleresimi qe eshte kryer nga autoriteti i planifikimit lokal sipas seksionit 30;

(b) vendosin per njoftimin ose reklamimin qe duhet t'i behet -

(i) ceshtjeve qe perfshihen ose propozohen te perfshihen ne nje plan;

(ii) aprovimit, adoptimit, ose hartimit te nje plani ose ndryshimeve apo zevendesimit te tij; ose

(iii) cdo hapi tjetere procedural,

dhe per reklamimin qe duhet t'i behet procedurave qe duhet te ndiqen sic permenden ne nen-seksionin (1);

(c) vendosin per dispozitat ne lidhje me berjen e verejtjeve per ceshtjet qe duhet te perfshihen, ose verejtje per cdo plan ose propozim per ndryshime apo zevendesim te tij;

(d) pa cenuar paragrafin (b), te vendosin per njoftimin e personave te vecante per aprovimin, adoptimin ose ndryshimin e cdo plani, ne qofte se ata kane pasur verejtje per planin dhe kane njoftuar autoritetin e planifikimit lokal qe desherojne te marrin nje njoftim te tille, pasi kane paguar nje shume te aresyeshme per t'a marre;

(e) kerkojne ose autorizojne autoritetin e planifikimit lokal te konsultohet me ose te marre ne konsiderate pikepamjet e

personave te tjere perpara se te marrin hapa te metejshme sipas procedures;

- (f) t'i kerkojne autoritetit te planifikimit lokal, sic mund te pershkruhet ne raste te vecanta, ne udhezimet e Sekretarit te Shtetit, t'i dergojne kopje te planit ose te dokumenteve qe jane bere publike sipas seksioneve 33(1)(a) ose 39(2)(a) ose qe jane lene per inspektim sipas seksioneve 33(3) ose 39(5)(a) ose 40(2)(a), personave qe kane kerkuar keto kopje, pasi kane bere nje pagese te aresyeshme;
- (g) te vendosin per reklamimin dhe inspektimin e cdo plani struktural apo lokal qe eshte aprovuar, adoptuar ose zbatuar, ose te ndonje dokumenti te aprovuar, adoptuar ose zevendesuar nje plan te tille dhe per kopjet qe duhet te nxirren per shitje.

(3) Rregullat sipas ketij seksioni mund te shtrihen ne gjithe Angline dhe Uellsin ose ne zona te vecanta, dhe mund te vendosin per dispozita te ndryshme ne zona te ndryshme.

(4) Ne varesi te dispozitave te mepareshme ne kete Kapitull dhe te ndonje rregulle nen kete seksion, Sekretari i Shtetit mund te udhezoje autoritetin e planifikimit lokal, ose autoritetet e planifikimit lokal ne pergjithesi -

- (a) per formulimin e procedures per zbatimin apo kryerjen e funksioneve te tyre sipas ketij Kapitulli;
- (b) t'i kerkoje atyre t'i japin kete informacion qe mund t'i duhet per kryerjen e funksioneve te tij sipas ketij Kapitulli.

(5) Ne varesi te dispozitave te seksionit 287, nje plan struktural ose lokal ose ndonje ndryshim apo zevendesim i tij do behet operativ ne daten e caktuar ne njoftimin e aprovimit, rezoluten e adoptimit per zbatimin, ndryshimin, ose zevendesimin e planit.

54.—(1) Ne varesi te nen-seksionit (4), per qellime te ketij Akti dhe te ndonje legjislacioni tjetër qe lidhet me planifikimin ne qytet dhe fshat, Akti mbi Kompensimin e Tokes 1961 dhe Akti mbi Autostradat 1980, planet e zhvillimit per rrethe jashte Londres se Madhe dhe zonave

Kuptimi i "planit te zhvillimit" jashte Londres se Madhe dhe qarqeve

metropolitane

metropolitane do te merren qe konsistojne ne -

- (a) dispozitat e nje plani struktural per kohen prezente qe jane ne fuqi per nje zone ose pjese te nje zone, se bashku me njoftimin nga Sekretari i Shtetit per aprovimin e planit;
- (b) cdo ndryshim te atij plani, se bashku me njoftimin nga Sekretari i Shtetit per aprovimin e ketij plani;
- (c) dispozitat per kohen prezente te nje plani lokal qe aplikohet ne rreth, se bashku me nje kopje te rezolutes se autoritetit per adoptimin e planit, ose si pas rastit njoftimi nga Sekretari i Shtetit per aprovimin e planit lokal; dhe
- (d) cdo ndryshim te bere planit, se bashku me nje kopje te rezolutes se autoritetit per adoptim, ose sic mund te jete rasti, njoftimin e Sekretarit te Shtetit per aprovimin e tyre.

(2) Referencat qe i behen ne nen-seksionin (1) dispozitave te cdo plani, njoftimit per aprovim, ndryshimeve, dhe rezolutes per adoptim, per nje rreth qe perben nje pjese te zones ne te cilen aplikohet, do te jene referenca te dispozitave te njoftimeve, ndryshimeve, dhe rezolutave sic aplikohen per rrethin.

(3) Referencat ne nen-seksionin (1) per njoftimet e aprovimit per nje plan ose ndryshim te tij te bera nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 51, do merren si referenca te njoftimeve per zbatimin ose ndryshimin e planit.

(4) Ky seksion ka efekt ne varesi te Pjeses III te Skedules (Aneksit) 2 (plane te vjetra zhvillimi).

(5) Cdo reference qe i behet ne Aktin mbi Kompensimin e Tokes 1961, nje zone te perkufizuar ne nje plan zhvillimi si zone e zhvillimit te pergjithshem do te merren si referenca te nje zone veprimi per te cilen eshte ne fuqi nje plan lokal.

PJESA III

KONTROLLI MBI ZHVILLIMET

Kuptimi i Zhvillimit

55.—(1) Ne kete Akt, ne varesi te dispozitave me poshte te ketij seksioni, pervec rasteve kur sugjeron ndryshe konteksti, me "zhvillim" nenkuptohet ndertimi i ndertesave, punimet inxhinierike, punimet minerare, ose punime te tjera ne, mbi ose nen toke, ose punime per ndryshimin e perdorimit te ndertesave ose te tokes.

(2) Per qellim te ketij Akti, punimet ose perdorimet e meposhtme te tokes nuk do te merren si zhvillime te tokes —

(a) kryerja e punimeve per mirembajtjen, permiresimin, ose per ndryshime te tjera ne nje ndertese, kur keto punime —

(i) ndikojne vetem ne ambientet e brendshme te nderteses, ose

(ii) nuk ndryshojne pamjen e jashtme te nderteses,

dhe punime per te shtuar nje ndertese me zgjerimin nen toke, kane filluar perpara 5 Dhjetorit 1968;

(b) kryerja e punimeve per mirembajtjen apo aprovimin e rrugeve, ne nje toke brenda kufijve te rruges, nga autoriteti lokal i autostradave;

(c) kryerja nga nje autoritet lokal ose nga sipermarres te autorizuar te punimeve me qellim inspektimin, riparimin, ose renovimin e tubacioneve te ujrave te zeza, nyjeve qendrore, tubave, kablove ose te ndonje aparati tjetër, qe perfshin germimin ne rruge ose ne toke per kete qellim;

(d) perdorimin e ndonje ndertese ose te tokes brenda parceles se nje ndertese qe eshte shtepi banimi per qellime argetimi;

(e) perdorimin e cdo toke per qellime bujqesore ose pylltare (duke perfshire pyllzimet) dhe perdorimin per keto qellime te cdo ndertese ne kete pjese toke;

(f) ne rastet kur ndertesat ose pjesa e tokes qe perdoret per qellime te cdo klase te specifikuar ne nje urdher te nxjerre nga Sekretari i Shtetit sipas ketij seksioni

Kuptimi i
"zhvillimit" dhe
"zhvillimit te ri"

Sekretari i Shtetit sipas ketij seksioni, perdorimi i nderteses ose i tokes sipas dispozitave te urdherit, te nje pjese te nderteses ose tokes, per qellime te te njejtës klase.

(3) Per te shmangur dyshimet deklarohet se per qellime te ketij seksioni —

(a) perdorimi per dy ose me shume banesa te cdo ndertese te perdorur me perpara si shtepi e vetme banimi perben ndryshim material ne perdorimin e nderteses dhe cdo pjese te saj qe perdoret per kete qellim;

(b) depozitimi i mbeturinave ose plehrave ne toke perben ndryshim material ne perdorimin e tokes, pa marre parasysh qe toka ne ate vend perdorej me pare per ate qellim, ne qofte se—

(i) eshte zgjeruar siperfaqja e depozitimit, ose
(ii) eshte rritur lartesia e depozitimit dhe eshte me e madhe se niveli i tokes ngjitur.

(4) Per qellime te ketij Akti punimet minerare perfshijne:

(a) zhvendosjen e materialeve te percaktuara—

(i) nga nje depozite mineral — punuese;

(ii) nga nje depozite hiri pas djegjes se karburantit ose nga nje lloj tjetër furre; ose
(iii) nga nje depozite hekuri, celiku, ose metalesh te tjera; dhe

(b) nxjerrjes e mineraleve nga nje hekurudhe e paperdorur.

(5) Pa cenuar rregullat nen dispozitat e ketij Akti qe lidhen me kontrollin e reklamave, perdorimi i pjeseve te jashtme te nje ndertese per te afishuar reklama, qe nuk perdoren normalisht per nje gje te tille, do te konsiderohet si ndryshim material ne perdorimin e asaj pjese te nderteses, per qellime te ketij seksioni.

(6) Ne kete Akt me "zhvillim te ri" nenkuptohet cdo zhvillim, pervec zhvillimeve te nje klase te caktuar ne Pjesen I ose Pjesen II te Skedules (Aneksit) 3; dhe Pjesa III e asaj Skedule (Aneksi) ka efekt ne qellimet e Pjeses I dhe II.

Koha kur filloi
zhvillimi

56.—(1) Ne varesi te dispozitave ne vijim ne kete seksion, per qellim te ketij Akti zhvillimi i tokes konsiderohet qe

fillon -

- (a) ne kohen kur fillojne punimet, per rastet kur zhvillimi konsiston ne zbatim te disa punimeve;
- (b) ne kohen kur fillon perdorimi, per rastet kur zhvillimi konsiston ne ndryshim perdorimi;
- (c) ne momentin me te afert nga koha ne (a) dhe (b), kur zhvillimi konsiston ne te dyja: kryerjen e punimeve dhe ndryshimin e perdorimit.

(2) Per qellime te dispozitave te kesaj Pjese te permendur ne nen-seksionin (3), zhvillimi duhet te merret qe ka filluar ne daten me te afert ne te cilen ka filluar cdo punim material per kete zhvillim.

(3) Dispozitat e referuara ne nen-seksionin (2) jane seksionet 85(2), 86(6), 87(4), 91, 92, dhe 94.

(4) "punim material" ne nen-seksionin (2) do te thote—

- (a) cdo punim ndertimi per ngritjen e nje ndertese;
- (b) germimi i nje kanali apo grope qe perben themelet, ose pjese te themeleve te nje ndertese;
- (c) shtrirja a cdo tubi nentokesor ne themele ose pjese te themeleve, ose ne nje germim sic permendet ne paragrafin (b);
- (d) cdo punim ne lidhje me ndertimin e nje rruge ose pjese te nje rruge;
- (e) cdo ndryshim ne perdorimin e tokes qe perben zhvillim material.

(5) Ne nen-seksionin 4(e) me "zhvillim material" nenkuptohet cdo zhvillim pervec—

- (a) zhvillimeve per te cilat leja e planifikimit eshte dhene nga nje urdherese zhvillimi te pergjithshem qe eshte konkretisht ne fuqi dhe qe zbatohet duke ju permbajtur kushteve dhe kufizimeve te parashikuara ne lejen e planifikimit;
- (b) zhvillime qe perfshihen ne nje nga paragrafet 1,2,3, dhe 5 deri 8 te Skedules 3 (se bashku me Pjesen III te kesaj Skedule); dhe
- (c) zhvillime te ndonje klase te pershkruar ne

kete nen-seksion.

(6) Ne nen-seksionin (5) "urdherese zhvillimi te pergjithshem" nenkupton nje urdher zhvillimi (sipas seksionit 59) te nxjerre si zhvillim te pergjithshem (ne varesi te disa perjashtimeve te perfshira ne te) per te gjithe tokat e Anglise dhe Uellsit.

Kerkesat per leje planifikimi

Leje planifikimi e
kerkuar per
zhvillime

57.—(1) Ne varesi te dispozitave me poshte ne kete seksion, duhet te merret leja e planifikimit per kryerjen e cdo zhvillimi ne toke.

(2) Kur eshte marre leja e planifikimit per nje zhvillim te tokes per nje periudhe te kufizuar, nuk duhet leje planifikimi per te filluar perdorimin e tokes, ne fund te periudhes, per qellime normale te njejta me ato perpara se te jepej leja.

(3) Kur leja e planifikimit per te zhvilluar nje pjese toke eshte dhene ne nje urdherese zhvillimi me kufizime te caktuara, leja per planifikim nuk kerkohet per perdorimin e tokes sic eshte perdorur normalisht (pervec perdorimeve qe parashikohen ne leje).

(4) Kur eshte nxjerre nje njoftim zbatimi per nje zhvillim ne nje toke te caktuar, leja per planifikim nuk kerkohet per perdorimin e tokes per qellime (ne perputhje me e kesaj Pjese te ketij Akti) qe do ishte perdorur ligjerisht ne qofte se nuk do ishte kryer zhvillimi.

(5) Ne percaktimin se cfare ishte ose eshte perdorimi normal i tokes te permendur ne nen-seksioneve (2) dhe (3), nuk do te merret parasysh ndonje perdorim qe ka filluar ne kundershtrim me kete Pjese ose me planin kontrollues te meparshem.

(6) Per qellime te ketij seksioni perdorimi i tokes ka filluar ne kundershtrim me planin kontrollues te meparshem, ne qofte se ka filluar ne kundershtrim me Pjesen III te Aktit te vitit 1947, Pjesen III te Aktit te vitit 1962 ose Pjesen III te Aktit te vitit 1971.

(7) Nen-seksioni (1) ka efekt ne varesi te Skedules (Aneksit) 4 (qe nxjerr dispozita te vecanta per perdorimin e tokes me 1 Korrik 1948).

Dhenia e lejes se planifikimit: e pergjithshme

58.—(1) Leja per planifikim mund te jepet -
(a) nga nje urdherese per zhvillim;
(b) nga nje autoriteti i planifikimit lokal (ose ne rastet qe permenden ne kete Pjese nga Sekretari i Shtetit) pas aplikimit te bere tek autoriteti ne perputhje me nje urdherese per zhvillim;
(c) pas adoptimit apo aprovimit te nje plani te thjeshtezuar zone ne perputhje me seksionin 82, ose sipas rastit seksionin 86; ose
(d) pas caktimit te nje zone sipermarrjeje ose aprovimit te nje skeme te modifikuar sipas Skedules 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 ne perputhje me seksionin 88 te ketij Akti.

(2) Leja per planifikim mund te caktohet per tu dhene sipas seksionit 90 (zhvillime me autorizimin e qeverise).

(3) Ky seksion nuk cenon ndonje dispozite tjeter te ketij Akti qe merret me lejet per planifikim.

Urdheresat per zhvillime

Urdheresa per zhvillime

59.—(1) Sekretari i Shtetit me ane te nje urdherese (ne kete Akt e quajtur "urdherese zhvillimi" mund te percaktoje menytrat e dhenies se lejes se planifikimit.

(2) Nje urdherese zhvillimi mund ose te -
(a) jape leje planifikimi per zhvillim te specifikuar ne urdherese, ose per zhvillime qe i perkasin nje klase te caktuar; ose
(b) ne rastet kur urdheresa nuk perben leje planifikimi, mund te udhezaje autoritetin e planifikimit lokal te jape leje planifikimi me shqyrtimin e aplikimit ne perputhje me cfare parashikon urdheresa.

(3) Nje urdherese zhvillimi mund te behet ose--

- (a) si nje urdherese e pergjithshme qe aplikohet ne te gjitha tokat, pervec rasteve qe perjashtohen ne vete urdheresen; ose
- (b) si nje urdherese e vecante qe aplikohet vetem ne toka te vecanta, sic prashtrohet ne urdherese.

Leje te dhena nga urdheresa zhvillimi

60.—(1) Leja per planifikim e dhene ne nje urdher mund te jepet ose pa kushte ose ne varesi te kushteve apo kufizimeve te parashtruara ne vete urdheresen.

(2) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), kur leja per planifikim jepet nga nje urdherese zhvillimi per ngritjen, ndryshimin apo zgjerimin e ndertesave, urdheresa mund te kerkoje aprovimin e autoritetit te planifikimit lokal ne lidhje me projektin ose pamjen e jashtme te nderteses.

(3) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), kur leja per planifikim eshte dhene nga nje urdherese zhvillimi per zhvillime te nje klase te caktuar, urdheresa mund te aftesoje Sekretarin e Shtetit ose autoritetin e planifikimit lokal te urdheroje qe leja nuk do aplikohet as --
(a) ne lidhje me zhvillimin ne nje zone te vecante, as
(b) ne lidhje me nje zhvillim te vecante.

(4) Cdo gje qe prashtrohet ne nje urdherese zhvillimi nga e cila jepet leja per perdorimin e tokes per cdo qellim per nje numer te caktuar ditesh brenda nje periudhe te caktuar (pa cenuar karakterin e pergjithshem te referencave qe i behen kufizimeve ne kete Akt) do te merren si dispozita per perdorimin e tokes per cdo qellim ne varesi te kushtit qe toka nuk duhet te perdoret per keto qellimi pas mbarimit te diteve brenda periudhes kohore.

Urdheresat per zhvillim: dispozita suplementare

61.—(1) Nje urdherese per zhvillim te pergjithshme mund te permbaje dispozita te ndryshme per toka te ndryshme.

(2) Me qellim qe te lehtesohet kryerja e zhvillimeve ne perputhje me lejen e planifikimit, ose perndryshe me qellim qe te promovohen zhvillime te mira ne perputhje planin e

zhvillimit, urdheresa per zhvillim mund te udhezoje qe cdo legjislacion para Aktit te vitit 1947, ose cdo rregullore, urdherese, ose ligj i miratuar ne cdo kohe bazuar ne keto legjislacione -

- (a) nuk do aplikohen per te gjithë zhvillimet e perfshira ne urdherese, ose
- (b) do te aplikohen ne varesi te modifikimeve sic mund te percaktohen.

(3) Ne nen-seksionin (2) "legjislacione para Aktit te vitit 1947 do te thote --

- (a) cdo gje miratuar perpara 6 Gusht 1947 (dates se miratimit te Aktit te vitit 1947), dhe
- (b) cdo gje e miratuar qe permbahet ne Aktin e Autostradave 1980 i cili -
 - (i) eshte miratuar bazuar ne Aktin mbi Autostradat 1959, dhe
 - (ii) ri-miratime te miratimeve sic permendet ne paragrafin (a).

Aplikime per leje planifikimi

62. Cdo aplikim prane autoritetit te planifikimit lokal per leje planifikimi -

- (a) duhet te behet ne menyre te tille sic pershkruhet nga rregullat e ketij Aktit; dhe
- (b) duhet te perfshije dokumenta te vecante dhe te mbeshtetet nga prova sic mund te kerkohen nga rregullat ose nga udhezimet e autoritetit te planifikimit lokal.

63.—(1) Aplikimi per leje planifikimi mund te lidhet me punime te kryera, ose me perdorime te filluara, perpara dates se aplikimit.

(2) Aplikime te tilla mund te jene -

- (a) ne lidhje me punime te kryera ose perdorime te filluara; pa lejen e planifikimit ose ne perputhje me nje leje planifikimi te dhene per nje periudhe kohore te kufizuar; ose
- (b) mund te jene per leje per te mbajtur nje ndertese ose punimet, ose per te vazhduar perdorimin e tokes, pa zbatuar nje leje planifikimi te mepareshme.

(3) Fuqia per te dhene leje planifikimi per te zhvilluar token sipas ketij Akti duhet te perfshije fuqine per te dhene leje planifikimi per te mbajtur ne toke te ndertesave ose punimeve te kryera, ose per vazhdimin e perdorimit te tokes, sic permendet ne nen-seksionin (2); dhe referenca qe i behen ne Aktet e planifikimit, lejeve te planifikimit per zhvillimin e tokes ose te kryerjes se zhvillimeve ne toke, si dhe aplikimet per to do merren perkatesisht.

(4) Cdo leje planifikimi e dhene ne perputhje me nen-seksionin (3) mund te jepet—

- (a) ne menyre qe te kete efekt ne daten ne te cilen ndertesat jane ndertuar ose punimet jane kryer, ose kur perdorimi ka filluar;
- (b) ne rastin kur ndertesat ose punimet e kryera ose perdorimi i filluar ne perputhje me lejen e planifikimit te dhene per nje periudhe te kufizuar, leja mund te jepet ne menyre qe te kete efekt ne fund te kesaj periudhe.

(5) Nen-seksioni (3) nuk ndikon ne seksionet 65, 71(1) ose 197 ose Pjesen V.

64.—(1) Ne qofte se nje person qe propozon per te kryer cfaredo punimesh ne toke, ose per te bere ndryshime ne perdorimin e tokes—

- (a) desheron te percaktoje nese kryerja e ketyre punimeve, ose berja e ndryshimeve perben zhvillim te tokes, dhe
- (b) ne qofte se po, nese kerkohet aplikim per leje planifikimi sipas kesaj Pjese (duke mbajtur parasysh dispozitat e ndonje urdherese per zhvillim, skeme zone sipermarrije, skeme te nje plani te thjeshtezuar per nje zone),

ai mund te aplikojë tek autoriteti i planifikimit lokal per te qartesuar keto pyetje.

(2) Aplikimi sipas nen-seksionit (1) mund te behet ose si pjese e nje aplikimi per leje planifikimi ose ne vecanti.

(3) Dispozitat e seksioneve 59, 69 (1), (2) dhe (5), 70, 74, 77,

Forma dhe permbajtja e aplikimeve per leje planifikimi

Aplikime ne lidhje me ndertesa ekzistuese dhe perdorimet

Aplikime per te percaktuar nese kerkohet leje planifikimi

78 dhe 79, ne varesi te nodifikimeve do aplikohen ne lidhje me cdo aplikim sipas ketij seksioni, sic aplikohen per aplikime per leje planifikimi.

Reklamimi per aplikimet

65.—(1) Nje urdherese per zhvillim mund te caktoje cdo klase zhvillimi si zhvillime per te cilat aplikohet ky seksion; dhe nje klase zhvillimi qe eshte tashme caktuar e tille, ky seksion i referohet si "zhvillime ne ne j klase te caktuar".

(2) Nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime te nje klase te caktuar nuk do te shqyrtohen nga autoriteti i planifikimit lokal pervec ne qofte se shoqerohet me -

(a) nje kopje te njoftimit per aplikim, sic mund te jete pershkruar ne nje urdherese per zhvillim, ne menyre qe te kuptohen se njoftimi eshte botuar ne nje gazete lokale qe qarkullon ne zonen ne te cilen eshte perfshire toka per zhvillim; dhe

(b) nga nje vertetim te nenshkruar nga aplikanti qe permban -

(i) thenien qe aplikanti ka permbushur kerkesat e nen-seksionit (3) dhe kur e ka bere nje gje te tille; ose

(ii) qe aplikanti nuk ka mundur t'i permbushe keto kerkesa sepse nuk ka te drejta ne lidhje me token qe mund t'a aftesojne per te bere nje gje te tille, dhe qe ai ka ndermarre hapa te aresyeshem (duke permendur hapat) per te fituar keto te drejta dhe qe ka qene i pasuksesshem ne kete drejtim.

(3) qellim qe te permbushe kerkesat e ketij nen-seksioni nje person duhet te -

(a) afishoje njoftimin, ne menyre te tille sic pershkruhet ne urdheresen per zhvillim, duke theksuar qe do behet nje aplikim per leje planifikimi; dhe

(b) t'a leje njoftimin te afishuar per jo me pak se 7 dite Brenda nje periudhe jo me te gjate se nje muaj nga dorezimi i aplikimit tek autoriteti i planifikimit lokal.

Botimet e njoftimeve te aplikimeve per leje planifikimi per zhvillime te caktuara.

(4) Njoftimi i permendur ne nen-seksionin (3) -

(a) duhet te vendoset me afishim te forte mbi nje object, dhe

(b) duhet te vendoset ne menyre te tille qe te jete e lexueshme dhe e dukshme nga publiku pa u dashur te shkojne ne vendin e zhvillimit per te bere nje gje te tille.

(5) Nuk do te merret qe aplikanti nuk e ka zbatuar nen-seksionin (3), ne qofte se lajmerimi, pa patur asnje faj aplikanti, eshte hequr apo bere i palexueshem perpara se te kene perfunduar 7 ditet e referuara ne nen-seksionin (3)(b), ne qofte se ai ka marre masat e nevojshme per t'a mbrojtur qofte edhe zevendesuar po qe nevoja.

(6) Ne qofte se aplikantii i duhet te mbeshtetet ne nen-seksionin (5), atehere ne vertetimin qe permendet ne nen-seksionin (2)(b) ai duhet te permende rrethanat e mesiperme te krijuara.

(7) Njoftimi i permendur ne nen-seksionin (2)(a) ose i kerkuar nga nen-seksioni (3) duhet te permbaje (pervec ceshtjeve te tjera qe mund te kerkohen) vendin ku mund te gjendet nje kopje e aplikimit per leje planifikimi, dhe e te gjitha planeve ose dokumenteve te tjera qe jane dorezuar me aplikimin, per t'u inspektuar nga publiku ne orare kohore te aresyeshme brenda nje periudhe sic permendet ne njoftim.

(8) Kjo periudhe nuk duhet te jete me pak se 21 dite duke filluar nga data ne te cilen njoftimi u publikua per here te pare.

(9) Vendimi per nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime te nje klase te caktuar nuk do te merret perpara periudhes 21 ditore qe fillon nga data e aplikimit.

Njoftimi per aplikimet i pronareve dhe qeramarrësve bujqesore

66.—(1) Pa cenuar seksionin 65, autoriteti i planifikimit lokal nuk do shqyrtoje aplikime per leje planifikimi ne qofte se nuk shoqerohen me nje nga vertetimet me poshte te nenshkruara nga aplikanti ose ne emer te tij—

(a) nje vertetim qe verteton se, ne fillim te periudhes 21 ditore qe mbaron me daten e

aplikimit, asnje person tjetër (pervec aplikantit) nuk eshte pronar i tokave per te cilat behet aplikimi;

(b) nje vertetim qe verteton se aplikanti u ka dhene njoftimin per aplikim te gjithë personave te tjere qe ne fillim te periudhes ishin pronare te tokave per te cilat behet aplikimi, dhe ku perfshihet -

(i) emri i ketyre personave,
(ii) adresat ne te cilat njoftimi per aplikim eshte derguar,
(iii) data kur eshte derguar secili prej ketyre njoftimeve;

(c) nje vertetim qe tregon -

(i) qe aplikanti nuk mund te jape nje vertetim ne perputhje me paragrafet (a) dhe (b),

(ii) qe ai i ka derguar njoftimin per aplikim ketyre personave te permendur ne paragrafin (b) sic specifikohen ne vertetim (emrat, adresat ne te cilat eshte derguar njoftimi, dhe data e dergimit), dhe

(iii) qe ai ka marre masat e mundeshme (permenden masat) per te gjetur emrat dhe adresat e personave qe mbesin, por nuk ka arritur t'i gjeje ato;

(d) nje vertetim qe tregon -

(i) qe aplikanti nuk mund te jape nje vertetim ne perputhje me paragrafin (a), dhe

(ii) qe ai ka marre masat e mundeshme (permenden masat) per te gjetur emrat dhe adresat e personave qe specifikohen ne paragrafin (b), por nuk ka arritur t'i gjeje ato;

(2) Cdo vertetim i tille sipas paragrafeve (c) dhe (d) te nen-seksionit (1) duhet te permbaje gjithashtu nje paragraf qe tregon se njoftimi i aplikimit, sic tregohet ne vertetim, eshte botuar ne nje date te vendosur ne njoftim ne nje gazete lokal qe qarkullon ne zonen ku perfshihet vendi i zhvillimit;

(3) Data qe vendoset ne vertetim sipas nen-seksionit (2) nuk mund te jete me perpara se fillimi i periudhes se permendur ne nen-seksionin (1) (a).

(4) Pervec gjerave te tjera qe permenden ne kete seksion, nje vertetim duhet te permbaje edhe -

(a) nje thenie qe asnje pjese e tokes se perfshire ne aplikim eshte ose eshte pjese e nje toke bujqesore ose prone bujqesore; ose

(b) qe aplikanti i ka dhene njoftimin per aplikim cdo personi tjetër, i cili, ne fillim te periudhes se permendur ne nen-seksionin (1)(a), ka qene qiramarres e nje toke bujqesore qe perfshihet ne token e aplikimit.

(5) Thenie te tilla sic permenden ne nen-seksionin (4)(b) duhet te perfshijne -

(a) emrit e secilit person qe aplikanti i ka dhene njoftimin per aplikimin,

(b) adresa ne te cilen eshte derguar njoftimi, dhe

(c) data ne te cilen eshte derguar.

(6) Kur aplikimi per leje planifikimi shoqerohet me nje vertetim te tille sic permendet ne nen-seksionet (1)(b), (c), ose (d), ose nga nje vertetim qe permban thenie ne perputhje me nen-seksionin 4(b) dhe (5), autoriteti i planifikimit lokal, nuk do vendose per aplikimin perpara se te mbaroje periudha 21 ditore qe fillon me daten ne vertetim qe duket se eshte me e vona nga datat ne te cilat njoftimet jane derguar sic permendet ne vertetim, ose nga data e afishimit te njoftimit, cilado te jete me e vona.

(7) Ne kete seksion---

"pronar" ne lidhje me nje toke, do te thote nje person qe per kohen prezente eshte -

(a) pronari i prone ose tokes,

(b) qiramarres i ligjshem i tokes i lejuar per disa vite, dhe ku jo me pak se 7 vite mbesin per kete leje; dhe

"prone bujqesore" ka te njejtin kuptim si ne Aktin mbi Ndermarrjet Bujqesore 1986.

Njoftime per aplikime per leje planifikimi per punime minerare.

67.—(1) Ne rastin e aplikimeve per leje planifikimi per zhvillime qe konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve seksionin 66 do te aplikohet me modifikimet e meposhtme.

(2) Nen-seksioni (1) i atij seksioni dhe dispozitat e meposhtme te ketij seksioni do te jene ne fuqi ne qofte se personat qe kane interes me mineralet perkatese ne nje

pjese toke e cila perfshihet ne aplikim, jane pronar te tokes.

(3) Ne rastet kur aplikimet per leje planifikimi per zhvillime konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve me anen a punimeve nentokesore, atehere autoriteti i planifikimit lokal mund te shqyrtoje aplikimin ne qofte se ne vend qe te shoqerohet me nje nga vertetimet e permendura ne nen-seksionin (1) te atij seksioni, shoqerohet me nje vertetim te nenshkruar nga aplikanti ose ne emer te tij--

- (a) qe tregon se eshte dhene njoftimi i aplikimit personave te specifikuar ne vertetim, te cilet ne fillim te periudhes 21 ditore qe mbaron me daten e aplikimit, kane qene pronare (sipas kuptimit ne seksionin 66) te ndonje toke me te cilen lidhet aplikimi, ose kane interes ligjerisht ne mineralet e vecanta te asaj toke;
- (b) qe tregon emrat e ketyre personave, adresat ne te cilat u derguan njoftimet per aplikim, dhe datat perkatese kur u derguan keto njoftime;
- (c) qe tregon se nuk ekziston nje person i tille sic permendet ne paragrafin (a) per te cilin aplikanti eshte ne dijeni, dhe qe ja di emrin dhe adresen dhe qe nuk ja ka derguar njoftimin; dhe
- (d) qe tregon se aplikanti ka pertmbushur kerkesat e nen-seksionit (7) dhe daten ku e ka bere nje gje te tille.

(4) Ne kete nen-seksion "minerale te vecanta" jane minerale te tjera pervec naftes, gazit, qymyrgurit, arit ose argjendit.

(5) Vertetimet sipas nen-seksionit (3) duhet te permbajne gjithashtu nje thenie qe njoftimi per aplikim, sic percaktohet ne vertetim, ka nje date ne te cilen njoftimi eshte botuar ne nje gazete lokal qe qarkullon ne zonen ku ndodhet toka ne aplikim.

(6) Data e caktuar sipas nen-seksionit (5) nuk mund te jete perpara fillimit te periudhes te permendur ne paragrafin (a) te nen-seksionit (3).

(7) Me qellim qe te zbatohet ato qe parashtrohen ne kete nen-seksion aplikanti duhet--

- (a) te vendose njoftimin per aplikim ne nje vend

te dukshem, qe lexohet lehte nga publiku, ne te pakten nje vend ne cdo famulli te komunitetit ne zonat qe perfshihen ne aplikim; dhe

- (b) njoftimi duhet te lihet per jo me pak se 7 dite, brenda nje periudhe 21 ditore, menjehere pas paraqitjes se aplikimit tek autoriteti i planifikimit lokal.

(8) Aplikanti nuk do te konsiderohet se ka shkeluar nen-seksionin (7) ne qofte se, pa patur faj ai, njoftimi eshte hequr, demtuar apo bere i palexueshem perpara periudhes 7 ditore ne nen-seksionin 7(b), dhe aplikanti ka marre masa te aresyeshme per mbrojtjen, apo kur eshte nevoja zevendesimin e njoftimit.

(9) Ne qofte se aplikantit i duhet te mbeshtetet ne nen-seksionin (8), atehere ai duhet ti shpjegoje rrethanat perkatese ne vertetim.

(10) Njoftimi qe kerkohet nga nen-seksioni (7) (se bashku me ceshtjet e tjera) do te permbaje emrin e nje vendi brenda zones se autoritetit te planifikimit lokal, ku mund te gjenden per inspektim kopje te aplikimit per leje planifikimi, dhe te te gjitha planeve dhe dokumenteve te tjera qe jane dorezuar se bashku me aplikimin, si dhe oret ne te cilat mund te behet ky inspektim brenda nje periudhe te caktuar ne vertetim (kjo periudhe nuk duhet te jete me e vogel se 21 dite nga data kur njoftimi u vendos per here te pare).

(11) Nen-seksionet (4), (5) dhe (6) te seksionit 66 do aplikohen te vertetimet e nen-seksionit (3) sic aplikohen ne vertetimet ne nen-seksionin (1)(b) te atij seksioni por do merret sikur ne fund te nen-seksionit (6) jane shtuar fjalet "ose nga data e afishimit te njoftimit, cilado te jete me e vona, sic permendet ne nen-seksionin (7)(a) te seksionit 67".

Dispozita te
metejshme per
certifikaten sipas
seksionit 65 deri
67.

68.—(1) Ne qofte se ndonje person --

- (a) ka leshuar nje vertetim ne perputhje me kerkesat e nen-seksionit (2)(b) te seksionit 65 ose te seksionit 66 ose 67 dhe permban thenie qe ai e di qe nuk jane te verteta ose te shtremberuara, ose
- (b) ka leshuar nje vertetim pa kujdes ne

perputhje me keto kerkesa por qe permban thenie jo te vertea ose te shtremberuara, ai do konsiderohet fajtor.

(2) Nje person fajtor sipas nen-seksionit (1) do denohet me nje demshperblim qe nuk e kalon nivelin e trete te shkalles standarde.

(3) Nje vertetim i leshuar per qellime te seksioneve 65, 66, ose 67, duhet t'i permbahet kerkesave te parashtruara ne nje urdherese zhvillimi per vertetime sipas atij seksioni.

(4) Cdo reference ne dispozitat e seksioneve 66 ose 67 per njoftime, ku jepet nje format njoftimi nga nje urdherese zhvillimi per qellime te ketyre dispozitave, do merret si reference per nje njoftim me ate format te caktuar.

Rregjistrat e aplikimeve, etj.

69.—(1) Cdo autoriteti i planifikimit lokal duhet te mbaje nje rregjister, sic mund te pershkruhet ne nje urdherese zhvillimi, qe permban informacion ne lidhje me aplikimet per leje planifikimi qe jane bere prane autoritetit.

(2) Rregjistri duhet te permbaje -

- (a) informacion per menyren ne te cilen jane marre ne shqyrtim aplikimet, dhe
- (b) informacione ne lidhje me skema te planifikimit te zones qe lidhen me zona qe mbulohen nga ky autoritet, sic mund te pershkruhen ne urdheresen per zhvillim.

(3) Nje urdherese zhvillimi mund te vendose rregulla per mbajtjen e rregjistrat, ne dy ose me shume pjese, ku secila pjese permban informacion ne lidhje me aplikimin per leje planifikimi te bere prane autoritetit.

(4) Nje urdherese zhvillimi mund te permbaje gjithashtu edhe -

- (a) rregulla qe nje pjese te caktuar te rregjistrat te permbaje kopje te aplikimeve dhe cdo plan ose vizatim ne lidhje me to; dhe
- (b) te hiqen nga ajo pjese rregjistri informacione qe jane futur per nje aplikim te vecante, kur aplikimi ka rene poshte (duke perfshire cdo apelim ne lidhje me te), (pa cenuar perfshirjen e informacioneve ne pjese te tjera

te rregjistrat).

(5) Cdo rregjister i mbajtur sipas ektij seksioni duhet te jete i gatshem per inspektim nga publiku ne oret e aresyeshme te dites.

Vendimet mbi aplikimet

Vendimet mbi aplikimet: ceshtje te pergjithshme

70.—(1) Kur behet nje aplikim per leje planifikimi prane autoritetit te planifikimit lokal -

- (a) ne varesi te seksioneve 91 dhe 92, ata mund te japin leje planifikimi, ose pa kushte ose me kushte qe ata i konsiderojne te pershtatshme; ose
- (b) ata mund ta refuzojne lejen e planifikimit.

(2) Gjate shqyrtimit te aplikimeve autoriteti duhet te kete parasysh dispozitat e planeve te zhvillimit, qe mund te ndikojne aplikimin, dhe cdo konsiderate tjeter.

(3) Nen-seksioni (1) ka efekt ne varesi te seksioneve 65, 66, dhe 67 dhe te dispozitave vijuese te ketij Akti, te seksioneve 66, 67, 72, dhe 73 te Aktit mbi Planifikimet (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) 1990 dhe te seksionit 15 te Aktit mbi Sherbimet Shendetesore 1976.

Konsultime ne lidhje me vendimet

71.—(1) Gjate vendimit per nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime te nje klase te caktuar nen seksionin 65, autoriteti i planifikimit lokal duhet te mbaje parasysh cdo verejtje qe kane marre perpara periudhes 21 ditore duke filluar nga data e aplikimit, ne lidhje me kete aplikim.

(2) Kur aplikimi per leje planifikimi shoqerohet me nje vertetim sipas nen-seksionit (1)(b), (c) ose (d) te seksionit 66 ose nen-seksionit (3) te seksionit 67, ose me nje vertetim qe permban thenie ne perputhje me nen-seksionet (4)(b) dhe (5) te seksionit, autoriteti i planifikimit lokal -

- (a) ne marrjen e vendimit per aplikimin, duhet te marre parasysh verejtje ne lidhje me to te bera brenda periudhes se permendur ne nen-seksionin (6) te seksionit 66, nga cdo person qe eshte pronar i ndonje pjese toke me te cilen lidhet aplikimi, ose qe eshte

qeramarrës i një prone bujqësore që mund të ketë një pjesë përfshirë në aplikim; dhe
(b) duhet të njoftojnë për vendimin çdo person që ka bërë vërejtje të cilat janë marrë parasysh sipas paragrafit (a);

dhe në rastet e aplikimeve për të cilat aplikohet seksioni 67, referencat e bëra në paragrafin (a) të seksionit 66(6) janë referenca për atë seksion siç aplikohet sipas seksionit 67(11).

(3) Përpara se autoriteti i planifikimit lokal të japë lejen e planifikimit për një vend karvanesh, ata duhet të konsultohen me autoritetin e planifikimit lokal që ka një fuqi të tillë, përveç rasteve kur ata janë të autorizuar për të dhënë licenca për këto vende.

(4) Në këtë seksion --

- "prone bujqësore" ka të njëjtin kuptim si në seksionin 66;
- "pronar" ka të njëjtin kuptim si në seksionin 66, ose sipas rastit në seksionin 67; dhe
- "licence për vendin" do të thotë një licence sipas

Pjesë i të Aktit mbi Vendet e Karvaneve dhe Kontrolli mbi Zhvillimet 1960 që autorizon përdorimin e tokës si vend për vendosjen e karvaneve.

Leje planifikimi
me kushte

72.—(1) Pa cenuar karakterin e përgjithshëm të seksionit 70(1), kushte mund të vendoset për dhenien e lejes së planifikimit nga ai seksion --

- (a) për zhvillimin e tokës ose përdorimin e tokës që kontrollohet nga aplikanti (nese është apo jo toke për të cilën është bërë aplikimi), ose për kryerjen e punimeve në atë toke, kur autoriteti i planifikimit lokal është i bindur që këto kushte janë të nevojshme për zhvillimin e autorizuar me leje;
- (b) për kërkesat për rrezimin e ndërtesave ose punimeve të autorizuar me leje, ose për mospërdorimin e metejshëm të tokës sipas autorizimit, pas mbarimit të një periudhe të caktuar me pare, dhe për çdo punim që duhet për ta kthyer token në gjendjen e mëparëshme.

(2) Leja e planifikimit e dhënë me kushtet e përmendura në nen-sksionin (1)(b) në këtë Akt quhet "leje planifikimi e dhënë për një periudhë të kufizuar".

(3) Kur --

(a) leja e planifikimit jepet për zhvillime që konsistojnë ose që përfshijnë ndertimin e ndërtesave ose punime të tjera në varesi të kushtit që punimet nuk duhet të fillojnë më vonë se një datë e caktuar; dhe

(b) ndonjë ndërtesë apo punim tjetër ka filluar të ndërtohet pas kësaj date të vendosur,

atëherë kryerja e këtyre punimeve nuk përben zhvillime për të cilat është dhënë leja.

(4) Nen-sksioni (3)(a) nuk aplikohet në një kusht që i bashkëngjitet lejes së planifikimit sipas seksioneve 91 ose 92.

(5) Pjesa i e Skedules (Aneksit) 5 ka efekt për qëllime të nxjerrjes së dispozitave të vecanta në lidhje me kushtet që mund të vendosen për dhenien e lejes së planifikimit për zhvillime që lidhen me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, dhe nen-sksioni (2) ka efekt në varesi të paragrafit 1(6)(a) të asaj Skedule.

Vendime mbi
aplikimet për të
zhvilluar token
pa i përmbushur
kushtet e vena
me pare

73.—(1) Ky seksion, në varesi të nen-sksionit (4), aplikohet tek të gjithë aplikimet për leje planifikimi për zhvillime pa zbatuar kushtet e vendosura në një leje planifikimi të mëparëshme.

(2) Për aplikime të tilla, autoriteti i planifikimit lokal duhet të konsiderojë vetëm problemin e kushteve me të cilat duhet dhënë leja e planifikimit, dhe --

(a) në qoftë se ata vendosin që leja për planifikim duhet dhënë me kushte të ndryshme nga ata të cilat janë vënë në lejet e planifikimit të mëparëshme, ose që leja duhet të jepet pa kushte, atëherë ata duhet të japin këto leje në mënyrë të tillë, dhe

(b) në qoftë se vendosin që leja për planifikim duhet dhënë me të njëjtat kushte si ato të vendosura në lejen e mëparëshme, atëherë ata duhet t'a refuzojnë aplikimin.

- (3) Dispozita te vecanta mund te behen per keto aplikime -
- (a) me vendosjen e rregullave sipas seksionit 62 ne lidhje me formen dhe permbajtjen e aplikimit, dhe
 - (b) me anen e nje urdherese zhvillimi per proceduren qe duhet te ndiqet ne lidhje me aplikimin.

(4) Ky seksion nuk aplikohet ne qofte se leja e planifikimit e mepareshme eshte dhene me kusht qe vendos kohen kur zhvillimi duhet te filloje dhe kur kjo kohe ka mbaruar perpara fillimit te punes.

Udhezime, etj., si metoda per te shqyrtuar aplikimet

74.—(1) Nje urdherese zhvillimi mund te beje dispozita per te vendosur rregulla per shqyrtimin e aplikimeve per leje planifikimi per zhvillime, nga autoriteti i planifikimit lokal, dhe ne vecanti -

- (a) per te aftesuar Sekretarin e Shtetit te jape udhezime qe kufizojne dhenien e lejeve per planifikim nga autoriteti i planifikimit lokal ose pa percaktim ose sic parashikon ne udhezime, ne lidhje me zhvillime ne pergjithesi, ose zhvillime qe i perkasin nje klase te caktuar;
- (b) per te autorizuar autoritetin e planifikimit lokal per te dhene leje planifikimi per zhvillime qe nuk perputhen me dispozitat e planeve te zhvillimit, ne varesi te kushteve qe mund te vendosen ne nje urdherese ose ne udhezimet e dhena nga Sekretari i Shtetit;
- (c) per t'i kerkuar autoritetit te planifikimit lokal, perpara se te jape nje leje per planifikim per nje zhvillim, sipas nje urdherese ose udhezimeve te Sekretarit te Shtetit, te konsultohet me autoritete ose persona te tjere sic udhezohet;
- (d) per t'i kerkuar autoritetit te planifikimit lokal t'i jape cdo aplikanti per leje planifikimi, brenda nje kohe te caktuar ne urdherese, njoftimin per menyren se si u shqyrtua aplikimi i tij;
- (e) per t'i kerkuar autoritetit te planifikimit lokal te njoftoje aplikantin per cdo

- mareveshje ose aprovim qe kerkohet sipas nje kushti te vene ne dhenien e lejes se planifikimit, brenda nje kohe te caktuar;
- (f) per t'i kerkuar autoritetit te planifikimit lokal t'i jape Sekretarit te Shtetit dhe personave te tjere sic mund te percaktohet ne nje urdherese, informacione ne lidhje me aplikime per leje planifikimi, duke perfshire informacione per menytrat e shqyrtimit te ketyre aplikimeve.

(2) Nen-sekioni (1) i nenshtrohet dispozitave te seksionit 71 te ketij Akti dhe seksioneve 67(7) dhe 73(1) te Aktit mbi Planifikimin 1990 (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura).

Efektet e lejes se planifikimit

75.—(1) Pa cenuar dispozitat e kesaj Pjese per kohen, revokimin, ose modifikimin e lejes se planifikimit, cdo leje planifikimi per zhvillim e dhene duhet te jete per permiresimin e tokes dhe perfitimin e te gjitha njerezve qe kane interesa ne te.

(2) Ne rastet kur leja e planifikimit jepet per ndertimin e ndertesave, leja mund te specifikojte qellimet per te cilat do te perdoret ndertesa.

(3) Ne qofte se asnje qellim nuk eshte specifikuar, atehere leja do merret sikur perfshin leje per perdorimin e nderteses sipas projektimit te saj.

Dispozita ne perfitim te te paafteve

76.—(1) Ky seksion aplikohet kur leja e planifikimit jepet per cdo zhvillimi qe rezulton ne -

- (a) nje ndertese ose ndertesa per te cilat aplikohet seksioni 4 i Aktit mbi Njerezit me Aftesi te Kufizuar dhe te Semuret Kronik 1970 (ndertesa per publikun me pagese apo jo);
- (b) nje nga sa me poshte (qe jane ndertesa ku njerezit jane punesuar) -
 - (i) ndertesa me zyre, dyqane, dhe per hekurudha tek te cilat aplikohet Akti mbi Zyrat, Dyqanet, dhe Ambjentet e Hekurudhave 1963;
 - (ii) ndertesa qe do te perdoren per qellimet

- ne ate Akt;
- (iii) fabrika sic perkufizohen nga seksioni 175 i Aktit mbi Fabbrikat 1961;
- (c) ndertesa per t'u perdorur si universitete, kolegje, shkolla, ose salla leksionesh;
- (d) ndertesa per t'u perdorur si institucione brenda fondit te PCFC; ose
- (e) ndertesa per t'u perdorur si shkolla ose institucione qe japin arsim te mesem ose arsim te metejshem (ose te dyja) dhe qe ndihmohen ose mbeshteten nga autoriteti i arsimit lokal.

(2) Autoriteti i planifikimit lokal qe jep leje planifikimi per zhvillime duhet t'i terheqe vemendjen personave qe u jep leje, per—

- (a) ne rastin e ndertesave te permendura ne nen-seksionin (1)(a) —
- (i) per seksionin 4 dhe 7 te Aktit mbi Personat me Aftesi te Kufizuara dhe te Semuret Kronik 1970; dhe
- (ii) per Kodin per Levizjen ne Ndertesa te Personave me Aftesi te Kufizuar (kodi mbi Standardet Britanike te Institucioneve BS 5810:1979) ose per ndonje dokument tjetër qe zevendeson ate kod;
- (b) ne rastin e ndertesave te permendura ne nen-seksionin (1)(b), per seksionet 7 dhe 8A te atij Akti dhe per kodin ose cdo dokument tjetër qe zevendeson ate kod;
- (c) ne rastin e ndertesave te permendura ne nen-seksionin (1)(c), (d) ose (e), per seksionet 7 dhe 8 te atij Akti dhe te Shenimit 18 te "Perdorimi i Ndertesave Arsimore nga Persona me Aftesi te Kufizuar" te botuar me 1984 ne emer te Sekretarit te Shtetit, ose per cdo dokument tjetër qe e zevendeson.

(3) Shprehjet e perdorura ne nen-seksionin (1)(d) dhe (e) dhe ne Aktin mbi Arsimin 1944 kane te njejtin kuptim si ne ate Akt.

Pushteti i Sekretarit te Shtetit ne lidhje me aplikimet per planifikim dhe me vendimet per to.

Referimi i aplikimeve tek Sekretari i Shtetit

77.—(1) Sekretari i Shtetit mund te udhezaje qe aplikimet per leje planifikimi te bera prane nje autoriteti planifikimi lokal sipas nje urdherese per zhvillim, ti kalojne atij per shqyrtim ne vend qe te shqyrtohen nga autoriteti i planifikimit lokal.

(2) Udhezime sipas ketij seksioni —

- (a) mund te jipen per nje autoritet te planifikimit lokal te vecante ose ne pergjithesi per autoritete planifikimi ne pergjithesi; dhe
- (b) mund te kene te bejne me nje aplikim te vecante ose me nje klase te tere aplikimesh sic percaktohet ne udhezim.

(3) Cdo aplikim per te cilin eshte dhene nje udhezim i tille duhet te referohet tek Sekretari i Shtetit perkatesisht.

(4) Ne varesi te nen-seksionit (5), kur nje aplikim per leje planifikimi referohet tek Sekretari i Shtetit sipas ketij seksioni, atehere do te aplikohet seksionet 65(2) dhe (9), 66, 67, 70, 71(1) dhe (2), 72(1) dhe (5) dhe 73, me modifikime te nevojshme, ashtu sic aplikohen per nje aplikim qe shqyrtohet dhe vendoset nga autoriteti i planifikimit lokal.

(5) Perpara se te marre vendimin per nje aplikim qe i kalohet sipas ketij seksioni, Sekretari i Shtetit duhet ti jape mundesi autoritetit te planifikimit lokal dhe aplikantit ne qofte se desherojne, te paraqesin mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit.

(6) Nen-seksioni (5) nuk aplikohet per nje aplikim per leje planifikimi qe i referohet Komisionit per Hetime mbi Planifikimet sipas seksionit 101.

(7) Vendimi i Sekretarit te shtetit per cdo aplikim qe i referohet sipas ketij seksioni do te jete final.

78.—(1) Ne rastet kur autoriteti i planifikimit lokal —

- (a) refuzon nje aplikim per leje planifikimi ose jep leje me kushte;
- (b) refuzon nje aplikim per mareveshje ose aprovim qe parashikohen ne nje kusht te vene ne nje leje planifikimi te dhene, ose vendos kushte per kete;

E drejta per te apeluar kunder vendimit te planifikimit dhe deshtimi per te marre vendim

- (c) refuzon nje aplikim per aprovim te kerkuar ne nje urdherese zhvillimi, ose e jep ate me kushte,

aplikanti mund te apeloje tek Sekretari i Shtetit.

(2) Personi qe ka bere nje aplikim mund te apeloje gjithashtu tek Sekretari i Shtetit ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal ose nuk ka -

(a) njoftuar aplikantin per vendimin mbi aplikimin, ose

(b) nuk ka njoftuar aplikantin se aplikimi i tij eshte referuar tek Sekretari i Shtetit per te marre vendimin ne perputhje me udhezime te dhena sipas seksionit 77,

brenda nje periudhe te caktuar ne urdheresen per zhvillim ose brenda nje periudhe per te cilen eshte rene dakord me shkrim ne mes te aplikantit dhe autoritetit.

(3) Cdo apelim sipas ketij seksioni duhet te behet me njoftim brenda nje kohe te caktuar dhe ne menyre te caktuar ne urdheresen per zhvillim.

(4) Koha qe vendoset per te derguar kete njoftim nuk duhet te jete me e shkurter se --

(a) 28 dite nga data e marrjes se vendimit per aplikimin; ose

(b) ne rastin e apelimeve sipas nen-seksionit (2), 28 dite nga perfundimi i periudhes se permendur ne nen-seksionin (2), ose siaps rastit, periudhes shtese sic permendet ne ate nen-seksion.

(5) Per qellime te aplikimeve te seksioneve 79(1), 253(2)(c), 266(1)(b) dhe 288(10)(b) ne lidhje me nje apelim sipas nen-seksionit (2), do te merret sikur autoriteti ka vendosur te refuzoje aplikimin ne fjale.

Vendime mbi
apelim

79.—(1) Kur behet nje apelim sipas seksionit 78, Sekretari i Shtetit mund te -

(a) lejoje ose anulloje apelimin, ose

(b) hedhe poshte ose te ndryshoje nje pjese te vendimit te autoritetit te planifikimit lokal (nese apelimit lidhet apo jo me ate pjese), dhe

mund te shqyrtoje aplikimin nga e para sikur te ishte

paraqitur tek ai qe ne fillim.

(2) Perpara se te marre vendimin per nje apelim sipas seksionit 78, Sekretari i Shtetit duhet t'i jape mundesi autoritetit te planifikimit lokal dhe apeluesit te shprehin mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar per kete qellim nga Sekretari i Shtetit, ne qofte se autoriteti apo apeluesi desherojne nje gje te tille.

(3) Nen-seksioni (2) nuk aplikohet per nje apelim te referuar tek Komisioni per Hetime Planifikimi sipas seksionit 101.

(4) Ne varesi te seksionit (2), dispozitat e seksioneve 66, 67, 70, 71(2) dhe (5), 73 dhe Pjesa i e Skedules 5 do te aplikohen me modifikimet e duhura, tek nje apelim te bere Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 78 ashtu sic aplikohen tek aplikimet per leje planifikimi qe vendoset nga autoriteti i planifikimit lokal.

(5) Vendimi i Sekretarit te Shtetit per keto apelime do te jete final.

(6) Ne qofte se, perpara ose gjate marrjes se vendimit per nje apelim ne lidhje me nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime te tokes, Sekretari i Shtetit formon opinionin qe duke pasur parasysh dispozitat e seksioneve 70 dhe 72(1), urdheresen per zhvillim, dhe ndonje udhezim te dhene sipas asaj urdherese, leja e planifikimit per ate zhvillim—

(a) nuk mund te jepej nga autoriteti i planifikimit lokal; ose

(b) nuk mund te jepej pa ju nenshtuar kushteve te vena,

ai mund te mos e marre ne shqyrtim apelimin ose mund te vazhdoje me marrjen e vendimit.

(7) Skedula (Aneksi) 6 aplikohet per apelime sipas seksionit 78, duke perfshire apelime per te cilat aplikohen dispozita te tjera ne kete Akt.

Rishikime te
vendimeve te
planifikimit kur
kerkohet
kompensim

80.—(1) Ky seksion dhe seksioni 81 aplikohen atehere kur, ne perputhje me dispozitat e Pjeses V, Sekretari i Shtetit ka marre nje ose me shume kerkesa per kompensime ne lidhje me vendimin per planifikim, dhe kerkesa ose kerkesat (ne qofte se ka me shume se nje) nuk jane terhequr.

(2) Ne qofte se, ne rastet kur ka nje vendim per planifikim te marre nga autoriteti i planifikimit lokal, ne qofte se aplikimi per leje zhvillimi i eshte referuar atij per vendim, Sekretari i Shtetit nxjerr konkluzionin qe ai mund te kishte marre nje vendim me te favorshem per aplikantin, Sekretari i Shtetit mund te udhezaje te zevendesohet me te vendimi i autoritetit te planifikimit lokal.

(3) Referencat ne nen-seksionin (2) per vendime me te favorshme per aplikantin do te merren --

- (a) ne lidhje me nje refuzim te lejes, si referenca per vendime te dhenies se lejes, ose pa kushte ose me kushte, dhe ose per te gjithë token qe perfshihet ne aplikimin per leje ose per nje pjese te saj; dhe
- (b) ne lidhje me nje leje te dhene me kushte, si referenca per vendime qe japin leje pa kushte ose me kushte me te lehtesuara.

(4) Ne qofte se Sekretari i Shtetit nxjerr konkluzionin qe leja mund te jepet (pa kushte ose me kushte) per disa zhvillime te tokes ne fjale, pervec zhvillimeve qe perfshihen ne aplikim per leje planifikimi, Sekretari i Shtetit mund te udhezaje qe ky Akt ka efekt ne lidhje me ate aplikim dhe vendim per planifikim--

- (a) sikur aplikimi te ishte perfshire ne nje aplikim per leje planifikimi per zhvillimin tjeter, dhe sikur vendimi te kishte perfshire lejen e planifikimit (pa kushte ose sipas rastit me kushte) per ate zhvillim; ose
- (b) sikur vendimi te ishte marre nga ai dhe te kishte perfshire nje leje planifikimi per ate zhvillim (me ose pa kushte),

sic mund te specifikohet ne udhezime.

81.—(1) Perpara se te jape nje udhezim sipas seksionit 80, Sekretari i Shtetit duhet te njoftoje me shkrim per udhezimin e tij te propozuar --

- (a) autoritetin e planifikimit lokal me vendimin e te cileve lidhet udhezimi, dhe
- (b) cdo personi qe ka bere kerkese per kompensime ne lidhje me vendimin, dhe qe nuk e ka terhequr kete kerkese.

(2) Sekretari i Shtetit duhet t'i jape mundesi te shprehin

Dispozita
suplementare te
s.80

mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga ai, autoritetit te planifikimit lokal dhe personave me siper, ne qofte se keta te fundit desherojne nje gje te tille.

(3) Gjate dhenies se udhezimeve sipas nen-seksionit 80, Sekretari i Shtetit duhet te mbaje parasysh --

- (a) dispozitat e planit te zhvillimit per zonen ne te cilen ndodhet toka ne fjale (ne qofte se keto dispozita ndikojne ne zhvillimin e kesaj toke); dhe
- (b) rrethanat lokale qe ndikojne ne zhvillimin e propozuar, duke perfshire perdorimin e tokave fqinje ose ngjitur me token ne fjale; dhe
- (c) cdo material qe mund te jete i konsiderueshem.

(4) Kur Sekretari i Shtetit jep nje udhezim sipas seksioni 80, ai duhet te njoftoje per kete udhezim--

- (a) autoritetin e planifikimit lokal me vendimin e te cileve lidhet udhezimi, dhe
- (b) cdo person qe ka bere kerkese per kompensime ne lidhje me vendimin, dhe qe nuk e ka terhequr kete kerkese.

Zona planifikimi te thjeshtezuara

Zona planifikimi
te thjeshtezuara

82.—(1) Zone planifikimi e thjeshtezuar eshte nje zone ne lidhje me te cilen eshte ne fuqi nje skeme per nje zone planifikimi te thjeshtezuar.

(2) Adoptimi ose aprovimi i nje skeme per zone planifikimi te thjeshtezuar ka efekt per dhenie ne ate zone ose pjese te saj te lejes se planifikimit --

- (a) per zhvillime te specifikuara ne skeme; ose
- (b) per zhvillime te nje klase te caktuar.

(3) Leja per planifikim ne nje zone planifikimi te thjeshtezuar mund te jete pa kushte, ose ne varesi te disa kushteve, kufizimeve ose perjashtimeve sic mund te specifikohen ne skeme.

Hartimi i

83.—(1) Cdo autoritet i planifikimit lokal duhet te marre ne

skemave te
zonave te
planifikimit te
thjeshtezuara

konsiderate, sa me shpejt te jete e mundur pas 2 Nentorit 1987, se per cilen pjese ose cilat pjese te zones se tyre eshte i desherueshem nje skeme per zone planifikimi te thjeshtezuar, dhe duhet ta mbaje kete ceshtje nen shqyrtim.

(2) Ne qofte se si rezultat i nje konsiderate te tille ose te shqyrtimeve te bera, autoriteti i planifikimit lokal vendos qe eshte e desherueshme te pregatitet nje skeme per ndonje pjese ne zonen e tyre ata duhet ta bejne nje gje te tille; dhe autoriteti i planifikimit lokal mund te vendose ne cdo kohe—

- (a) te hartoje nje skeme te zones se planifikimit te thjeshtezuar, ose
- (b) te ndryshoje nje skeme qe eshte adoptuar, ose
- (c) me pelqimin e Sekretarit te Shtetit, te ndryshojne nje skeme te aprovuar nga ai.

(3) Skedula (Aneksi) 7 ka efekt ne lidhje me hartimin, dhe ndryshimin e nje skeme per zone planifikimi te thjeshtezuar dhe per ceshtje te tjera qe lidhen me te.

Skema te zonave
te planifikimit te
thjeshtezuara:
kushte dhe
kufizime ne lejet
e planifikimit

84.—(1) Kushtet dhe kufizimet ne lejen e planifikimit qe mund te specifikohen ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar mund te perfshijne —

- (a) kushte ose kufizime ne lidhje me te gjithë zhvillimet e lejuara nga skema ose ne lidhje me zhvillime te vecanta te lejuara, dhe
- (b) kushte ose kufizime qe kerkojne pelqimin, renien dakord ose aprovimin e autoritetit te planifikimit lokal ne lidhje me zhvillime te vecanta.

(2) Kushte ose kufizime te ndryshme mund te specifikohen ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar per raste te ndryshme ose klasa te ndryshme.

(3) Asgje ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar nuk mund te ndikojne ne te drejten e cdo personi per--

- (a) per te bere cdo gje qe nuk perben zhvillim, ose
- (b) per te kryer zhvillime per te cilat nuk kerkohet leja e planifikimit ose per te cilat leja eshte dhene nga skema.

(4) Asnje kufizim ne varesi te se cilit eshte dhene leja, mund te ndikojne ne te drejten e cdo personi per te kryer zhvillime per te cilat leja eshte dhene ne skeme.

Zgjatja e nje
skeme te nje zone
planifikimi te
thjeshtezuar

85.—(1) Nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar hyn ne fuqi ne daten e adoptimit ose aprovimit te saj dhe nuk do te kete me efekt ne fund te periudhes 10 vjecare qe fillon me ate date.

(2) Kur skema nuk eshte me ne fuqi, edhe lejet e planifikimit te dhena nga ajo nuk do te jene me ne fuqi, pervec rasteve kur zhvillimi i autorizuar nga ajo ka filluar te zbatohet.

Ndryshime te
skemes se zones
se planifikimit te
thjeshtezuar

86.—(1) Ky seksion aplikohet kur ndryshimet ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar jane adoptuar ose aprovuar.

(2) Adoptimi ose aprovimi i ndryshimeve qe kane te bejne me perfshirjen e tokes ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar ka fuqi per te dhene leje planifikimi per zhvillime sic specifikohen ose qe i perkasin nje klase, ne ate toke ose pjese te saj.

(3) Adoptimi ose aprovimi i ndryshimeve qe kane te bejne me dhenien e lejes se planifikimit ka fuqi per dhenien e nje leje te tille ne lidhje me nje zone planifikimi te thjeshtezuar, ose nje pjese te saj sic specifikohet ne skeme, per zhvillime te vecanta ose per klasa zhvillimi.

(4) Adoptimi ose aprovimi i ndryshimeve qe kane te bejne me heqjen ose lehtesimin e kushteve apo kufizimeve ne lejen e planifikimit sic parashikohen ne skeme, ka fuqi per te hequr ose lehtesuar menjehere kushtet ose kufizimet.

(5) Adoptimi ose aprovimi i ndryshimeve qe kane te bejne me —

- (a) perjashtimin e nje toke nga zona e planifikimit te thjeshtezuar,
- (b) terheqjen e nje leje planifikimi, ose
- (c) vendosjen e kushteve apo kufizimeve te reja me te shtrenguara qe leja e planifikimit i nenshtrohet sipas skemes,

kane fuqi per te terhequr lejen ose per te vene kushte apo kufizime qe hyne ne fuqi nga fundi i periudhes 12 mujore qe fillon me daten e adoptimit apo aprovimit.

(6) Adoptimi ose aprovimi i ndryshimeve te nje skeme nuk ndikon ne lejen e planifikimit sipas kesaj skeme ne rastet kur zhvillimet e autorizuarane kane filluar zbatimin.

87.—(1) Tokat e pershkruara me poshte nuk mund te perfshihen ne nje zone planifikimi te thjeshtezuar—

- (a) toke ne nje Park Kombetar;
- (b) toke ne nje zone te mbrojtur;
- (c) toke brenda Broads;
- (d) toke ne zone e caktuar sipas seksionit 87 te Aktit mbi Parqet Kombetare dhe Shfrytezimi i Fshatrave 1949 si nje zone me bukuri te rralle natyrore;
- (e) toke e identifikuar ne planin e zhvillimit te rrethit si pjese e rripit te gjelber;
- (f) toke ne lidhje me nje njoftim ose urdherese ne fuqi sipas seksionit 28 ose 29 te Aktit mbi Fshatrat dhe Fauna 1981 (zona me interes te vecante).

(2) Kur nje toke e perfshire ne nje zone planifikimi te thjeshtezuar behet toke qe perfshihet ne nen-seksionin (1), ky nen-seksion nuk vepron per ta perjashtuar nga zona.

(3) Sekretari i Shtetit me urdherese mund te vendose qe asnje skeme zone planifikimi e thjeshtezuar mund te kete fuqi per te dhene leje planifikimi--

- (a) ne lidhje me nje zone, tokat e se ciles specifikohen ne urdherese, ose
- (b) per zhvillime qe specifikohen ne urdherese.

(4) Nje urdherese sipas nen-seksionit (3) ka fuqi te terheqe leje te tilla planifikimi te dhena ne nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar qe eshte ne fuqi nga data ne te cilin urdheresa hyri ne fuqi, pervec rasteve kur zhvillimi i autorizuar ka filluar te zbatohet.

Skema te zonave te sipermarrjeve

Leje planifikimi
per zhvillime te
zonat e
sipermarrjeve

88.—(1) Urdheresa qe cakton nje zone sipermarrjeje sipas Skedules (Aneksit) 32 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Token 1980 do te hyje ne fuqi ne daten ne te cilen urdheresa ka fuqi per te dhene leje planifikimi per zhvillime te specifikuara ne skeme ose per zhvillime te nje klase te caktuar.

(2) Aprovimi i nje skeme te modifikuar sipas paragrafit 11 te asaj Skedule (Aneksi) do te hyje ne fuqi ne daten ne te cilen modifikimet kane fuqi per te dhene leje planifikimi per zhvillime te specifikuara ne skemen e modifikuar ose te nje klase te caktuar.

(3) Leja e planifikimit e dhene ne menyre te tille, do t'i nenshtrohet kushteve ose kufizimeve sic specifikohen ne skeme ose ne skemen e modifikuar, dhe ne qofte se asgje nuk eshte specifikuar do te jete pa kushte.

(4) Ne varesi te nen-seksionit (5), kur leja per planifikim eshte dhene per nje zhvillim ose klase zhvillimesh autoriteti i zones se sipermarrjes mund te udhezaje qe leja nuk aplikohet ne lidhje me--

- (a) nje zhvillim te caktuar; ose
- (b) nje klase zhvillimesh te caktuar; ose
- (c) nje klase te caktuar zhvillimesh ne nje zone te caktuar brenda zones se sipermarrjes.

(5) Autoriteti i zones se sipermarrjes nuk duhet te jape udhezim sipas nen-seksionit 4 pervec rasteve—

- (a) kur ata e kane paraqitur perpara Sekretarit te Shtetit, dhe
- (b) ai ka aprovuar qe ata mund te japin nje udhezim te tille.

(6) Ne qofte se skema ose skema e modifikuar percakton ne lidhje me nje zhvillim qe ka lejuar, ceshtje qe kerkojne aprovimin e autoritetit te zones se sipermarrjes, leja do kete fuqi pasi merret parasysh kjo gje.

(7) Sekretari i Shtetit me rregullore mund te vendosi per --

- (a) proceduren e dhenies se udhezimeve sipas nen-seksionit (4); dhe
- (b) metoden dhe proceduren ne lidhje me aprovimin e ceshtjeve te specifikuara ne skeme ose ne skeme te modifikuar sic permenden ne nen-seksionin (6).

(8) Rregulla te tilla mund te modifikojne dispozitat e Akteve te planifikimit ose te ndonje instrumenti tjeter te nxjerre bazuar ne to (me ose pa modifikime) gjate vendosjes se procedurave ne nen-seksionin (7).

(9) Asgje ne kete seksion ndalon dhenien e lejes se planifikimit ne lidhje me nje toke ne nje zone sipermarrjeje (pa marre parasysh nese leja jepet nga nje aplikim i bere sipas kesaj Pjese ose nga nje urdherese per zhvillim), pervec kur parashikohet ne seksion.

(10) Asgje ne kete seksion perk te drejten e nje personi per te kryer nje zhvillim pervec kur parashikohet ne kete seksion.

Efekte ne leje planifikimi te modifikimeve ose te pefundimit te skemave

89.—(1) Modifikimet e nje skeme per zone sipermarrjeje nuk ndikojne ne lejet e planifikimit ne kete skeme ne cdo rast kur zhvillimi i autorizuar ka filluar te zbatohet perpara se te kene hyre ne fuqi modifikimet.

(2) Kur nje zone nuk eshte me zone sipermarrjeje, lejet e planifikimit ne kete skeme nuk do te jene me ne fuqi, pervec rasteve kur zhvillimet e autorizuarane kane filluar te zbatohen.

Leje planifikimi te vendosura per tu dhene

Zhvillime me autorizim te qeverise

90.—(1) Kur kerkohet autorizimi i nje departamenti te qeverise ne lidhje me nje zhvillim qe do zbatohet nga autoriteti lokal, ose nga sipermarres te autorizuar qe nuk jane autoriteti lokal, departamenti mund, gjate dhenies se autorizimit, te udhezoje qe leja e planifikimit per ate zhvillim do te jepet, ne varesi te disa kushteve sic mund te specifikohen ne udhezim.

(2) Gjate dhenies se pelqimit sipas seksioneve 36 ose 37 te Aktit mbi Elektricitetin 1989 ne lidhje me punime ose ndryshime perdorimi qe perben zhvillim, Sekretari i Shtetit mund te udhezoje qe leja e planifikimit per ate zhvillim dhe per zhvillime ndihmese do te jepet, ne varesi te kushteve sic mund te specifikohen ne udhezim.

(3) Dispozitat e ketij Akti (Pervec pjeseve V dhe XII) do te aplikohen tek nje leje planifikimi per tu dhene ne lidhje me udhezime sipas ketij seksioni sikur te jete dhene nga Sekretari i Shtetit pasi aplikimi i referohet atij sipas seksionit 77.

(4) Per qellime te ketij seksioni zhvillimi autorizohet nga nje departament qeverie ne qofte se--

- (a) cdo pelqim, autoritet, apo aprovim per zhvillimin jepet nga departamenti ne zbatim te nje legjislacioni;
- (b) konfirmohet nje urdher blerjeje qe autorizon blerjen e tokes nga departamenti per qellime zhvillimi;
- (c) departamenti jep pelqimin per marrjen e tokes per qellime zhvillimi ose blerjen e tokes me marreveshje per ate qellim;
- (d) departamenti jep autoritet --
 - (i) per te marre para hua per qellime te zhvillimit, ose
 - (ii) per impenjimin e parave per ate qellim qe nuk mund te imenjohen ndryshe; ose
- (e) nje sipermarrje paguan nje grant ne lidhje me zhvillimin caktuar nga departamenti sipas ligjit;

dhe referenca ne kete seksion per autorizime te departamentit te qeverise do te merren perkatesish.

(5) Ne nen-seksionin (2) "zhvillim ndihmes", ne lidhje me zhvillime qe konsistojne ne zgjerimin e nje stacioni gjenerator, nuk perfshin zhvillime qe nuk lidhen direkt me prodhimin e elektricitetit nga ky stacion; dhe ne kete nen-seksion "zgjerim" dhe "stacion gjenerator" kane te njejtin kuptim si ne Pjesen i te Aktit mbi Elektricitetin 1989.

Kohezgjatja e nje leje planifikimi

Kushte te pergjithshme qe kufizojne kohezgjatjen e lejes se planifikimit

91.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, cdo leje planifikimi e dhene ose qe do te jepet, duhet te jepet ne varesi te kushtit qe zhvillimi duhet te filloje jo me vone se me mbarimin e --

- (a) pese viteve qe fillojne me daten ne te cilen u dha leja, ose qe u caktua per tu dhene; ose
- (b) nje periudhe tjeter (me e gjate ose me e

suplementare te
s.91 dhe 92

92(4) eshte -

- (a) autoriteti i planifikimit lokal ose Sekretari i Shtetit, kur ata kane dhene lejen,
- (b) ne rastin kur leja e planifikimit eshte caktuar per tu dhene sipas nen-seksioni 90(1), departamenti i cili ka caktuar te jepet leja, dhe
- (c) ne rastet kur leja e planifikimit eshte caktuar per t'u dhene sipas seksionin 90(2), Sekretari i Shtetit.

(2) Per qellime te seksionit 92, nje ceshtje e rezervuar do te merret qe eshte aprovuar perfundimisht -

- (a) kur jepet aplikimi per aprovim, ose
- (b) ne rastin kur aplikimi i behet autoritetit te planifikimit lokal dhe eshte apeluar tek Sekretari i Shtetit kunder vendimit te autoritetit, dhe Sekretari i Shtetit jep aprovimin.

(3) Kur autoriteti i planifikimit lokal jep leje planifikimi, fakti qe ndonje nga kushtet e vena nga dispozitat e seksioneve 91 ose 92, ose jane caktuar per tu vene nga keto dispozita, nuk pengon qe kushtet te apelohe sipas seksionit 78 kunder vendimit te autoritetit.

(4) Ne rastin kur leja e planifikimit (skice ose jo) qe i neneshtrohet kushteve sipas seksioneve 91 ose 92—

- (a) zhvillime te kryera pas dates se vene ne kusht per tu mbaruar do te konsiderohen si te paautorizuara; dhe
- (b) aplikimi per aprovim te nje ceshtjeje te rezervuar, ne qofte se behet pas dates se vene ne kusht, do te konsiderohet qe nnuk eshte bere ne perputhje me rregullat e lejes.

Perfundime te
lejeve te
planifikimit me
afat kohor te
kufizuar: njoftime
te perfundimit

94.—(1) Ky seksion aplikohet ne rastet kur -

- (a) bazuar ne seksionet 91 ose 92, leja e planifikimit varet nga kushti qe zhvillimi me te cilin lidhet leja duhet te filloje perpara mbarimit te nje periudhe te caktuar, por kur periudha ka mbaruar perpara se te perfundoje zhvillimi; ose
- (b) zhvillimi ka filluar ne perputhje me lejen e planifikimit sipas nje skeme zone planifikimi

te thjeshtezuar, por nuk ka perfunduar ne kohen kur zona nuk eshte me zone e thjeshtezuar; ose

- (c) zhvillimi ka filluar ne perputhje me lejen e planifikimit sipas nje skeme zone sipermarrjeje por nuk ka perfunduar kur zona nu eshte me zone sipermarrjeje.

(2) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal nxjerr konkluzionin qe zhvillimi nuk eshte perfunduar brenda nje periudhe te arsyeshme, ata mund te japin njoftim ("njoftim perfundimi") qe thekson qe leja e planifikimit do perfundoje se qeni ne fuqi me mbarimin e nje periudhe te percaktuar ne njoftim.

(3) Periudha qe percaktohet nuk duhet te jete me e shkurter se 12 muaj pasi njoftimi hyn ne fuqi.

(4) Nje njoftim perfundimi duhet ti jepet --

- (a) pronarit te tokes,
- (b) perdoruesit te tokes, dhe
- (c) cdo personi tjeter qe autoriteti i planifikimit lokal mendon se eshte e nevojshme.

(5) Autoriteti i planifikimit lokal mund te terheqe nje njoftim perfundimi ne cdo kohe perpara mbarimit te periudhes se percaktuar si periudha ne fund te se ciles nuk ka me fuqi leja e planifikimit.

(6) Ne qofte se bejne nje gje te tille, duhet te japin menjehere njoftimin per terheqjen cdo personi qe ka marre njoftimin e perfundimit.

Efekte te njoftimit
per perfundim

95.—(1) Njoftimi i perfundimit nuk do hyje ne fuqi pa u konfirmuar nga Sekretari i Shtetit.

(2) Gjate konfirmimit te nje njoftimi perfundimi Sekretari i Shtetit mund te zevendesoje me nje periudhe me te gjate ate te percaktuar ne njoftim si periudhe ne mbarim te se ciles leja e planifikimit nuk ka me fuqi.

(3) Ne qofte se, brenda periudhes se percaktuar ne njoftimin e perfundimit (qe nuk mund te jete me e shkurter se 28 dite nga dhenia e njoftimit) ndonje person qe ka marre njoftimin kerkon mundesi per te shprehur mendimet e tij, Sekretari i

Shtetit, perpara se te konfirmoje njoftimin duhet ti jape mundesi te prezantojne mendimet perpara nje personi te emeruar nga ai, personave dhe autoritetit te planifikimit lokal.

(4) Ne qofte se njoftimi per perfundim hyn ne fuqi, leja e planifikimit behet e pavlefshme me mbarimin e periudhes se caktuar ne njoftim (nese eshte periudha fillesta e specifikuar ne seksionin 94(2) ose nje periudhe me e gjate e zevendesuar nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (2).

(5) Nen-seksioni (4) nuk cenon leje planifikimi ne qofte se zhvillimet jane kryer perpara mbarimit te periudhes se permendur ne ate nen-seksion.

Fuqia e Sekretarit te Shtetit per te dhene njoftime perfundimi

96.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e sheh te nevojshme te jape njoftimin e perfundimit per nje toke, ai vete mund te beje nje gje te tille.

(2) Njoftimi i perfundimit i dhene nga Sekretari i Shtetit ka te njejtin efekt sikur te jepej nga autoriteti i planifikimit lokal.

(3) Sekretari i Shtetit nuk mund te jape nje njoftim te tille pa u konsultuar me pare me autoritetin e planifikimit lokal.

Revokimi dhe modifikime ne lejen e planifikimit

Fuqia per te revokuar ose modifikuar lejen e planifikimit

97.—(1) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal e konsideron te nevojshme per te revokuar ose modifikuar nje leje per te zhvilluar nje toke qe eshte dhene pasi eshte bere aplikimi sipas kesaj Pjese, autoriteti mund te urdheroje revokimin ose modifikimi e saj vetem kur eshte e nevojshme.

(2) Autoriteti gjate ushtrimit te funksioneve sipas nen-seksioni (1), duhet te kete parasysh planin e zhvillimit dhe ndonje material tjeter me vlere.

(3) Fuqia qe jepet nga ky seksion mund te ushtrohet –
(a) kur leja lidhet me punimet per ngritjen e nje ndertese ose punime te tjera, ne cdo kohe perpara se te perfundojne punimet;

(b) kur leja lidhet me ndryshim te perdorimit te tokes, ne cdo kohe perpara zbatimit te ndryshimit.

(4) Revokimi ose modifikimi i lejeve per ndertimin e ndertesave ose punimeve te tjera nuk do ndikojne punime qe jane kryer me pare.

(5) Referencat e bera ne kete seksion per autoritetin e planifikimit lokal, ne lidhje me zhvillime qe konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e miineraleve do te merren si referenca per autoritetin e planifikimit mineral, dhe Pjesa II e Skedules 5 do kete efekt per nxjerrjen e dispozitave te vecanta ne lidhje me kushtet qe mund te vihen nga nje urdher sipas ketij seksioni per revokim ose modifikim te lejes per zhvillime te tilla.

Procedura per urdherat e seksionit 97: rastet e kundershthuara

98.—(1) Pavec rasteve te mbuluara nga seksioni 99, nje urdher sipas seksionit 97 nuk do te kete efekt pa u konfirmuar nga Sekretari i Shtetit.

(2) Kur autoriteti i planifikimit lokal paraqet nje urdher te tille per konfirmim nga Sekretari i Shtetit, ata duhet te njoftojne –

- (a) pronarin e tokes;
- (b) perdoruesin e tokes, dhe
- (c) cdo person tjeter qe sipas mendimit te tyre ndikohet nga urdheri.

(3) Njoftimi duhet te permbaje periudhen brenda se ciles cdo person qe mori njoftimin mund t'i kerkoje Sekretarit te Shtetit mundesi per te shprehur mendimet e tyre dhe kur mund te priten nga personi i emeruar nga Sekretari i Shtetit.

(4) Ne qofte se brenda kesaj periudhe persona te tille kerkojne te shprehin mendimet e tyre perpara se Sekretari i Shtetit ka dhene konfirmimin, atehere Sekretari i Shtetit duhet ti jape mundesi gjithashtu edhe autoritetit te planifikimit lokal per te shprehur mendimet e tyre.

(5) Periudha e referuar ne nen-seksionin (3) nuk duhet te jete me e shkurter se 28 dite nga dhenia e njoftimit.

(6) Sekretari i Shtetit mund te konfirmoje urdherin qe i

paraqitet sipas ketij seksioni, ose pa modifikime ose me modifikime qe ai i konsideron te nevojshme.

Procedura per
urdherat e
seksionit 97:
rastet e pa-
kundershtuara

99.—(1) Ky seksion aplikohet kur—

- (a) autoriteti i planifikimit lokal ka dhene nje urdher sipas seksionit 97; dhe
- (b) pronari ose perdoruesi i tokes dhe te gjithë personat qe sipas autortetit te planifikimit lokal ndikohen nga urdheri, kane njoftuar autoritetin me shkrim qe nuk kane ndermend te kundershtojne urdherin.

(2) Kur ky seksion aplikohet, atehere ne vend qe ti paraqese urdherin Sekretarit te Shtetit per konfirmim, autoriteti duhet te reklamaje faktin qe urdheri eshte dhene, dhe ky reklamim duhet te permbaje —

- (a) periudhen brenda se ciles persona nje ndikohen nga ky urdher mund te njoftojne Sekretarin e Shtetit qe desherojne ti jepet mundesia per te shprehur mendimet e tyre nje personi te caktuar nga Sekretari i Shtetit; dhe
- (b) periudhen qe ne mbarimin e se ciles, ne qofte se nje njoftim i tille eshte dhene Sekretarit te Shtetit, urdheri mund te hyje ne fuqi ne baze te ketij seksioni pa u konfirmuar nga Sekretari i Shtetit.

(3) Autoriteti duhet t'i jape njoftimin per kete personave te permendur ne nen-seksionin (1)(b).

(4) Periudha e referuar ne nen-seksionin (2)(a) nuk duhet te jete me e shkurter se 28 dite nga data kur reklamimi behet per here te pare.

(5) Periudha e referuar ne nen-seksionin (2)(b) nuk duhet te jete me e shkurter se 14 dite nga data e mbarimit te periudhes se referuar ne nen-seksionin (2)(a).

(6) Autoriteti duhet ti dergoje nje kopje te njoftimit te reklamuar siaps nen-seksionit (2) Sekretarit te Shtetit jo me vone se 3 dite pas nxjerrjes.

(7) Ne qofte se —

- (a) asnje person qe ndikohet nga urdheri nuk ka

njoftuar Sekretarin e Shtetit sipas nen-seksionit (2)(a) brenda periudhes se referuar ne ate nen-seksion, dhe

- (b) Sekretari i Shtetit nuk ka udhezuar brenda kesaj periudhe qe urdheri ti paraqitet atij per konfirmim,

Urdheri do hyje ne fuqi me mbarimin e periudhes se referuar ne nen-seksionin (2)(b), pa konfirmimin e Sekretarit te Shtetit sic kerkohet nga seksioni 98(1).

(8) Ky seksion nuk aplikohet ne --

- (a) nje urdher qe revokon ose modifikon nje leje planifikimi te dhene ose te caktuar per tu dhene nga Sekretari i Shtetit sipas kesaj Pjese ose Pjeses VII, ose
- (b) nje urdher qe modifikon kushtet te cilave i nenshtrohet leja e planifikimit ne baze te seksioneve 91 ose 92.

Revokimi dhe
modifikimi i lejeve
te planifikimit
nga Sekretarit i
Shtetit

100.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e konsideron te nevojshme qe nje urdher duhet te behet sipas seksionit 97, ai mund te beje vete nje urdher te tille.

(2) Nje urdher i tille i dhene nga Sekretari i Shtetit ka te njejten fuqi sikuar te ishte dhene nga autoriteti i planifikimit lokal dhe konfirmuar nga Sekretari i Shtetit.

(3) Sekretari i Shtetit nuk duhet te jape nje urdher te tille pas u konsultuar me autoritetin e planifikimit lokal.

(4) Kur Sekretari i Shtetit propozon per nje urdher te tille atehere ai duhet te njoftojne autortetin e planifikimit lokal.

(5) Njoftimi duhet te permbaje periudhen (qe nuk duhet te jete me e shkurter se 28 dite nga data e dhenies se njoftimit) brenda se ciles autoriteti mund te kerkoje mundesi per te paraqitur mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit.

(6) Ne qofte se autoriteti kerkon nje gje te tille brenda asaj periudhe, Sekretari i Shtetit duhet t'i jape nje mundesine perpara se te jape urdherin.

(7) Dispozitat e kesaj pjese dhe cdo rregull ne kete Akt per proceduren qe duhet ndjekur ne lidhje me paraqitjen e nje

urdheri nga autoriteti i planifikimit lokal sipas seksioni 97 dhe per konfirmimin nga Sekretari i Shtetit do kene efekt, ne varesi te modifikimeve te duhura, ne lidhje me cdo propozim te bere nga Sekretari i Shtetit per te dhene urdherin dhe dhenia e urdherit.

(8) Nen-seksioni (5) i seksionit 97 aplikohet per qellime te ketij seksioni sic aplikohet per ate seksion.

Referime Komisionit per Hetimin e Planeve

101.—(1) Sekretari i Shtetit mund te ngreje nje Komision per Hetimin e Planeve per te hetuar dhe raportuar per ceshtje ne nen-seksionin (2) ne rrethana te permendura ne nen-seksionin (3).

(2) Ceshtjet qe mund te referohen tek Komisioni per Hetimin e Planifikimeve jane —

- (a) aplikime per leje planifikimi te cilat Sekretari i Shtetit ka udhezuar sipas seksionit 77 t'i referohen atij ne vend qe te shqyrtohen nga autoriteti i planifikimit lokal;
- (b) apelime sipas seksionit 78;
- (c) propozime qe nje departament qeveritar duhet te jape udhezim sipas seksionin 90(1) qe leja e planifikimit do caktohet te jepet per zhvillime nga autoriteti i planifikimit lokal ose sipermarres te autorizuar qe kerkohen me ligj te autorizohet nga departamenti;
- (d) propozime qe zhvillimi duhet te zbatohet nga ose ne emer te departamentit te qeverise.

(3) Secila nga keto ceshtje mund te referohet te cdo komision i tille sipas ketij seksioni ne qofte se konsiderohet e nevojshme nga Ministri ose Ministrat pergjegjes per te vendosur nese zhvillimi i propozuar duhet ti neneshtrohet nje hetimi te vecante per sa me poshte —

- (a) qe ekzistojne probleme te rendesise rajonale ose kombetare qe kerkojen vleresim, por vleresim i pershtatshem nuk mund te behet pervec se kur behet nga nje komision i vecante;
- (b) aspektet teknike ose shkencore te

propozuara ne zhvillim jane te aq te panjohura sa mund te demtojne vendimin ne qofte se nuk behet nje hetim i vecante per to.

(4) Pjesa i e Skedules 8 ka fuqi ne lidhje me perberjen e nje komisioni te tille, funksioneve te tij, dhe proceduren per referimet qe i behen sipas ketij seksioni, dhe referenca te bera ne nen-seksionin (3) dhe ne ate Skedule per "Minister apo Ministra pergjegjes" do merren ne perputhje me Pjesen II te asaj Skedule.

(5) Ne lidhje me ceshtje qe ndikojne ne Angline dhe Uellsin se bashku, funksionet e Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (1) do te ushtrohen nga Sekretari i Shtetit per ate kohe qe ka pergjegjesi te pergjithshme ne ceshtjet e planifikimit per Angline dhe per Uellsin duke vepruar bashkarisht.

Kontrolle te tjera mbi zhvillimet

102.—(1) Ne qofte se, duke patur parasysh nje plan zhvillimi, autoriteti i planifikimit lokal nxjerr konkluzionin qe eshte e nevojshme qe ne interes te nje planifikimi cilesor per zonen e tyre —

- (a) qe cdo perdorim i tokes duhet te perfundoje ose qe duhen vene kushte per vazhdimin e perdorimit te tokes; ose
- (b) ose qe nje ndertese apo punim duhet te ndryshohet ose rrezohet, ata mund te nxjerrin urdher per —
 - (i) ndalimin e atij perdorimi, ose
 - (ii) vendosjen e kushteve per vazhdimin e perdorimit sic mund te specifikohet ne urdher, ose
 - (iii) marrjen e masave per ndryshimin ose rrezimin e nje ndertese sic mund te specifikohet ne urdher, sipas rastit.

(2) Nje urdher sipas ketij seksioni mund te jape leje planifikimi per zhvillime te tokes me te cilat lidhet urdheri, ne varesi te kushteve qe specifikohen ne urdher.

(3) Seksioni 97 aplikohet ne lidhje me nje leje te dhene nga

Fuqia per te referuar ceshtje te caktuara planifikimi Komisionit te Hetimeve mbi Planifikimin

nje urdher sipas ketij seksioni sic aplikohet ne lidhje me leje planifikimi te dhena nga autoriteti i planifikimit lokal ne nje aplikim te bere sipas kesaj Pjese.

(4) Fuqia qe jepet nga nen-seksioni (2) perfshin fuqi per te dhene leje planifikimi me ane te nje urdheri sipas kushteve te specifikuara ne kete urdher--

- (a) per mbajtjen e ndertesave, ose punimeve, ne token me te cilen lidhet urdheri, te perfunduara perpara dates ne te cilen urdheri u paraqit perpara Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 103; se
- (b) per vazhdimin e perdorimit te tokes te filluar perpara asaj date.

(5) Cdo leje planifikimi e dhene ne perputhje me seksionin (4) mund te jepet--

- (a) ne menyre qe te hyje ne fuqi ne daten ne te cilen ndertesat apo punimet u ndertuar, ose kur filloj perdorimi i tokes, ose
- (b) ne rastin e ndertesave ose punimeve te kryera ose te perdorimeve ne perputhje me lejen e planifikimit te dhene per nje periudhe te caktuar, te hyje ne fuqi ne fund te kesaj periudhe.

(6) Kur kerkesat e nje urdheri perfshijne zhvendojesen e personave qe jetojne ne keto ndertesat, autoriteti i planifikimit lokal ka per detyre t'i siguroje akomodim ketyre personave, ne qofte se nuk gjendet vend banimi tjeter i aresyeshem per keto persona.

(7) Ne varesi te seksionit 103(8), ne rastin e dhenies se lejes se planifikimit nga nje urdher nen kete seksion, autoriteti i referuar ne seksionet 91(1)(b) dhe 92(4) eshte autoriteti i planifikimit lokal qe ka nxjerre urdherin.

(8) Dispozitat e mepareshme te ketij seksioni nuk aplikohen ne perdorimin e nje toke per zhvillime qe konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve, me perjashtim te parashtrimeve ne Skedulen (Aneksin) 9, dhe ajo Skedule (Aneks) do kete fuqi per hartimin e dispozitave ne lidhje me token qe perdoret ose qe eshte perdorur per keto qellime.

Konfirmime nga Sekretari i Shtetit 103.—(1) Urdheri sipas seksionit 102 nuk do hyje ne fuqi ne qofte se nuk eshte konfirmuar nga Sekretari i Shtetit,

te urdhrave te s.
102.

ose pa modifikime ose me modifikime qe konsiderohen te nevojshme.

(2) Fuqia e Sekretarit te Shtetit sipas ketij seksioni per te konfirmuar nje urdher ne varesi te modifikimeve perfshin fuqi per te --

- (a) modifikuar dispozita te nje urdheri qe jep leje planifikimi sic permendet ne nen-seksionet (2) deri ne (5) te seksionit 102;
- (b) perfshire ne urdher cdo leje planifikimi qe mund te jene perfshire ne urdher kur jane praraqitur tek ai.

(3) Kur autoriteti i planifikimit lokal paraqet perpara Sekretarit te Shtetit nje urdher per tu konfirmuar sipas ketij seksioni, ata dueht te njoftojne --

- (a) pronarin e tokes se perfshire,
- (b) perdoruesin e kesaj toke, dhe
- (c) cdo person tjeter qe sipas tyre do ndikohet nga ky urdher.

(4) Njoftimi duhet te specifikojte periudhen brenda se ciles cdo person qe ka marre njoftimin mund t'i kerkoje Sekretarit te Shtetit mundesine per te paraqitur mendimet e tija perpara nje personi te emeruar per kete pune nga Sekretari i Shtetit.

(5) Ne qofte se brenda kesaj periudhe ka persona qe kerkojne kete mundesi, perpara se te jape konfirmimin, Sekretari i Shtetit duhet t'i krijojte nje mundesi te tille personit ose personave dhe njekohesisht autoritetit te planifikimit lokal.

(6) Periudha e referuar ne nen-seksionin (4) nuk duhet te jete me e shkurter se 28 dite nga dhenia e njoftimit.

(7) Kur eshte konfirmuar nje urdher sipas seksionit 102 nga Sekretari i Shtetit, autoriteti i planifikimit lokal duhet t'i jape nje kopje urdherit pronarit, dhe perdoruesit te tokes me te cilen lidhet urdheri.

(8) Ku Sekretari i Shtetit ushtron fuqine e tij sipas nen-seksionit (2) per te konfirmuar nje urdher qe jep leje planifikimi, ai eshte autoriteti qe permendet ne seksionet 91(1)(b) dhe 92(4).

Fuqia e Sekretarit te Shtetit per te nxjerre urdhera sipas s. 102

104.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e konsideron te nevojshme qe duhet te nxirret urdher sipas seksionit 102, ai mund ta nxjerre vete nje urdher te tille.

(2) Nje urdher i tille i nxjerre nga Sekretari i Shtetit ka te njejtin efekt sikur te ishte bere nga autoriteti i planifikimit loka dhe te ishte konfirmuar nga Sekretari i Shtetit.

(3) Sekretari i Shtetit nuk mund te nxjerre nje urdher te tille pa u konsultuar me autoritetin e planifikimit lokal.

(4) Kur Sekretari i Shtetit propozon per nje urdher te tille ai duhet te njoftoje autoritetin e planifikimit lokal.

(5) Njoftimi duhet te specifikoje periudhen brenda se ciles autoriteti mund te kerkoje mundesi per te paraqitur mendimet perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit.

(6) Ne qofte se autoriteti kerkon nje gje te tille brenda kesaj periudhe, Sekretari i Shtetit duhet t'ja jape kete mundesi perpara nxjerrjes se urdherit.

(7) Periudha e referuar ne nen-seksionin (5) nuk duhet te jete me e shkurter se 28 dite nga data e dhenies se njoftimit.

(8) Dispozitat e kesaj Pjese dhe te cdo rregulle ne kete Akt ne lidhje me proceduren qe duhet te ndiqet per paraqitjen e nje urdheri sipas seksionit 102 nga autoriteti i planifikimit lokal, konfirmimin e tij nga Sekretari i Shtetit dhe dergimin e kopjeve te tij pas konfirmimit, kane efekt ne varesi te modifikimeve, ne lidhje me cdo propozim te bere nga Sekretari i Shtetit per te bere nje urdher te tille dhe per dergimin e kopjeve te tij.

Detyrat e autoriteteve te planifikimit minerar per te rinovuar punimet minerare

105.—(1) Eshte detyra e cdo autoriteti te planifikimit minerar—

(a) te rishikoje here pas here, ne intervale qe mendohen te pershtatshme, cdo vend ne zonen e tyre ku ne, mbi ose nen te cilin punimet per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve —

(i) po kryhen; ose

(ii) jane kryer ne cdo kohe gjate nje

periudhe te caktuar; ose

(iii) jane autorizuar me leje planifikimi por nuk kane filluar akoma; dhe

(b) te nxjerre ne lidhje me vende te tilla cfaredo urdheri sipas seksionit 97 ose paragrafeve 1, 3, 5, ose 6 te Skedules (Aneksit) 9, qe ata e konsiderojne te pershtatshem.

(2) Ne nen-seksionin (1), "periudhe e caktuar" ne lidhje me nje rishikim do te thote periudha 5 vjecare menjehere perpara dates se rishikimit ose ndonje periudhe tjeter qe mund te vendoset.

Mareveshje per zhvillime ose perdorim te tokes

106.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal mund te arrije mareveshje me cdo person me interes ne token ne zonen e tyre per qellime te vendosjes se kufizimeve ose rregullave per zhvillimin ose perdorimin e tokes se tyre ose pergjithmone ose per nje periudhe te caktuar te rene dakord ne mareveshje.

(2) Nje mareveshje e tille mund te permbaje dispozita rrjedhuese (duke perfshire ato finale) qe autoriteti i konsideron te nevojshme per qellimet e mareveshjes.

(3) Mareveshja e bere sipas ketij seksioni me persona me interes ne token, mund te imponohet nga autoriteti i planifikimit lokal kunder personave qe pretendojne tituj nen kete person ne lidhje me token, sikur autoriteti i planifikimit lokal te kishte token ngjitur, dhe sikur mareveshja te jete bere per kete toke.

(4) Asgje ne kete seksion ose ne nje mareveshje te bere sipas tij do merret qe—

(a) kufizon ushtrimin e fuqive, ne lidhje me nje toke per te cilen eshte bere mareveshje, te ndonje Ministri ose autoriteti ne kete Akt, perderisa keto fuqi ushtrohen ne perputhje me dispozitat e planit te zhvillimit, ose ne perputhje me udhezime qe mund te jene dhene nga Sekretari i Shtetit per dispozitat qe duhen perfshire ne plane te tilla; ose

(b) kerkon ushtrimin e ketyre fuqive per raste pervec atyre te permendur ne paragrafin (a).

**PJESA IV:
KOMPENSIMI NE LIDHJE ME
DISA URDHHERA, NJOFTIME, ETJ.**

Kompensime per revokimin e lejes se planifikimit, etj.

107.—(1) Ne varesi te seksionit 116, kur leja e planifikimit revokohet ose modifikohet me urdher sipas seksionit 97, atehere ne qofte se ne nje kerkese drejtuar autoritetit te planifikimit lokal brenda nje periudhe te caktuar dhe ne nje menyre te caktuar, tregohet qe nje person me interes ne token ose ne mineralet nen te—

- (a) ka patur shpenzime per kryerjen e punimeve qe jane bere te pavlefshme nga revokimi ose modifikimi; ose
- (b) ka patur humbje ose demtime qe lidhen direkt me revokimin ose modifikimin,

autoriteti i planifikimit lokal duhet te kompensoje kete person sipas shpenzimeve, humbjeve ose demtimeve.

(2) Per qellime te ketij seksioni, cdo shpenzim i bere ne pregatitjen e planeve per punime, ose per ceshtje te tjera pregatitore, do te perfshihen ne shpenzimet e bera per kryerjen e punimeve.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (2), asnje kompensim duhet paguar sipas ketij seksioni ne lidhje me —

- (a) punime te kryera perpara dhenies se lejes qe revokohet ose modifikohet, ose
- (b) humbje ose demtime te bera perpara dhenies se lejes (pervec humbjeve ose demtimeve te pesuara nga renia e vleres se tokes).

(4) Per te llogaritur shumen e humbjes apo demtimeve sipas ketij seksioni qe rezultojne ne renien e vleres se tokes, do merret sikur leja per planifikim jepet per zhvillime te tokes qe perfshihen ne ndonje klases ne Skedulen 3.

(5) Ne kete Pjese cdo reference e bere per nje urdher nen seksionin 97 perfshin referenca per urdhera sipas dispozitave te atij seksioni sic aplikohen nga seksioni 102(3) (ose, ne varesi te seksionit 116, nga paragrafi 1(2) i Skedules (Aneksi 9)).

Kompensime
kur leja e
planifikimit
revokohet ose
modifikohet

108.—(1) Kur —

- (a) leja e planifikimit e dhene nga nje urdherese zhvillimi terhiqet (me revokim ose amendament te urdhereses ose me udhezime sic parashikohen ne urdherese); dhe
- (b) ne nje aplikim te bere sipas Pjeses III leja e planifikimit per zhvillime te lejuara me pare nga nje urdherese refuzohet ose jepet me kushte te tjera pervec atyre te vendosura nga urdheresa,

seksioni 107 do te aplikohet sikur leja e planifikimit e dhene nga urdheresa per zhvillime —

- (i) jepet nga autoriteti i planifikimit lokal sipas Pjeses III; dhe
- (ii) eshte revokuar ose modifikuar me nje urdher sipas seksionit 97.

(2) Kur leja e planifikimit e dhene ne nje urdherese zhvillimi terhiqet me revokimin ose shtesen e urdhereses, ky seksion aplikohet vetem ne qofte se aplikimi i referuar ne nen-seksionin (1)(b) behet perpara mbarimit te periudhes 12 mujore qe fillon me daten ne te cilen revokimi ose shtesa hyri ne fuqi.

(3) Ky seksion nuk aplikohet ne lidhje me leje planifikimi per zhvillime ne toka operative te sipermarresve ligjore.

Kojmpensime
per refuzimin
ose dhenien e
lejes se
planifikimit me
kushte qe eshte
dhene me para
nga nje urdher
zhvillimi

109.—(1) Kur behet kompensimi sipas 107 qe perfshin kompensime per zhvleresimin e tokes me nje shume qe kalon 20 paund, autoriteti i planifikimit lokal—

- (a) ne qofte se e konsideron praktikisht te mundur, duhet te ndaje ne menyre propocionale shumen ne mes te pjeseve te ndryshme te tokes me te cilat lidhet kerkesa per kompensim; dhe
- (b) duhet te jape detaje per ndarje te tilla kerkuessit dhe cdo personi tjetër qe ka interes ne toke dhe qe autoriteti mendon se ndikohet ne menyre te konsiderueshme.

(2) Gjate ndarjes propocionale sipas nen-seksionit (1), autoriteti i planifikimit lokal duhet te ndaje token ne pjese, dhe duhet te shperndaje kompensimin ndermjet ketyre pjeseve, sipas menyres qe autoriteti mendon qe pjese te

ndryshme jane ndikuar nga urdheri, ose ne rastet brenda seksionit 108, nga vendimi mbi planifikimi qe ka bere te mundur kompensimin.

Perpjestime per zhvleresim (3) Rregullat ne kete seksion, do krijojne dispozita, ne varesi te nene-seksionit (4), per -

(a) per te aftesuar personin qe ka bere kerkesen ose ndonje person tjetër te cilit jane dhene detajet te perpjestimit sipas nen-seksionit (1), ose i cili ka interes ne token qe ndikohet nga nje perpjetim i tille, ne qofte se ai desheron te kundershotoje perpjestimin, t'i referohet Gjykates te Tokave;

(b) per te aftesuar personin qe ka bere kerkesen apo cdo person tjetër qe i jane dhene detajet e perpjestimit sipas nen-seksionit (1), per tu degjuar nga kjo Gjykate per cdo problem lidhur me ate perpjestim; dhe

(c) per t'i kerkuar Gjykates, ose te konfirmojne ndarjen propocionale ose ta ndryshojne ate dhe te njoftojne palet e ndryshme per kete vendim.

(4) Kur pas drejtimit tek Gjykata e Tokave sipas ketij seksioni vertetohet se ndarja propocionale ose perpjestimi-

(a) ka lidhje teresisht ose pjeserisht me te njejtat ceshtje si nje perpjestim i meparshem, dhe

(b) eshte ne perputhje me perpjestimin e meparshem ne lidhje me keto ceshtje,

Gjykata nuk duhet ta ndryshoje perpjestimin ne menyre qe te mos jete ne perputhje me perpjestimin e meparshem per keto ceshtje.

(5) Kur i referohet Gjykates se Tokave sipas nen-seksionin (3), nen-seksionet (1) dhe (2), ne masen qe lidhen me nje perpjestim, do te aplikohen me zevendesimin e referencave te Gjykates se Tokave me referencat e autoritetit te planifikimit lokal.

(6) Ne kete seksion dhe ne seksionet 110 dhe 113—

- “kompensim per zhvleresim” do te thote nje kompensim qe paguhet sipas seksionit 107, ne lidhje me humbjen ose demtimet qe rrjedhin nga zhvleresimi i vleres se interesit ne toke,

- “interes” (kur i referohet interesit te tokes) do te thote pagesa per qirane e tokes dhe nuk perfshin ndonje interes mbi te, dhe
- “vendime planifikimi te caktuara” do te thote vendime planifikimi nga te cilat leja e planifikimit eshte refuzuar, ose eshte dhene me kushte te tjera pervec atyre te vena ne nje urdherese per zhvillime.

110.—(1) Kur duhet te behet kompensim sipas seksionit 107, qe perfshin kompensim per zhvleresim per nje shume me te madhe se 20 paunda, autoriteti i planifikimit lokal duhet te njoftoje Sekretarin e Shtetit per kete kompensim, duke detajuar shumen e kompensimit per zhvleresim, ose per perpjestime sipas seksionit 109.

(2) Kur Sekretari i Shtetit merr nje njoftim te tille ai duhet te siguroje qe ky njoftim te rregjistrohet ne -

(a) keshillin e rrethit ose Londres ku ndodhet toka; dhe

(b) ne qofte se ai keshill nuk eshte autoriteti i planifikimit lokal, tek autoriteti i planifikimit lokal.

Rregjistrime te kompensimeve per zhvleresim

(3) Njoftimi i rregjistruar sipas ketij seksioni duhet te permbaje—

(a) urdherin, ose ne rastin e zbatimit te seksionit 108, vendimin e planifikimit te caktuar, dhe token me te cilen lidhet kerkesa per kompensim; dhe

(b) shumen e kompensimit si dhe ndarjet propocionale qe mund te jene bere sipas seksionit 109.

(4) Njoftimet e rregjistruara sipas ketij seksioni do kene lidhje me pagesat e tokes lokale, dhe per qellime te Aktit mbi Pagesat per Token Lokale 1975 keshilli me te cilin jane rregjistruar do te merret si autoriteti qe respekton pagesen.

(5) Ne lidhje me kompensimet e detajuara ne nje njoftim te rregjistruar sipas ketij seksioni, referenca te bera ne kete Pjese per kompensimet per nje pjese te tokes me te cilen lidhet njoftimi do te merren si me poshte—

(a) ne qofte se njoftimi nuk perfshin ndarje propocionale sipas seksionit 109, shuma e kompensimit do te merret si e shperndare niesoi ne zonen ku ndodhet toka e perfshire ne

njesoj ne zonen ku ndodhet toka e perfshire ne njoftim;

- (b) ne qofte se njoftimi perfshin ndarje propocionale -
- (i) kompensimi do merret si i shperndare ne perputhje me ndarjen propocionale ndermjet pjeseve te ndryshme te tokes;
 - (ii) kompensimi per nje pjese te tokes qe ben pjese ne ndarjen propocionale do te merret si i shperndare njesoj ne kete pjese te tokes.

Marrja e kompensimeve sipas s. 107 ne zhvillimet pasuese

111.—(1) Askush nuk mund te kryeje zhvillime te reja te cilave i aplikohet ky seksion, ne token ne lidhje me te cilen eshte rregjistruar nje njoftim kompensimi sipas seksionit 110, derisa pagesa ne perputhje me seksionin 112 ne lidhje me kompensimin ne njoftim, eshte bere ose paguar me pelqimin e Sekretarit te Shtetit.

(2) Ne varesi te nen-seksioneve (3) dhe (4), ky seksion aplikohet tek zhvillimet e reja—

- (a) qe perbejne zhvillime te karakterit rezidencial, tregtar, apo industrial dhe qe konsistojne teresisht ose kryesisht ne ndertimin e shtepive, apartamenteve, dyqaneve, zyrave, ose ndertesave industriale (duke perfshire magazinat), ose nje kombinim te tyre; ose
- (b) qe perbejne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve; ose
- (c) ose te te cilat Sekretari i Shtetit mendon se seksioni duhet te aplikohet, duke patur parasysh vleren e zhvillimit.

(3) Ky seksion nuk aplikohet per zhvillime bazuar ne nen-seksionin (2)(c), ne qofte se Sekretari i Shtetit, pasi i eshte bere nje aplikim, ka vendosur, duke marre parasysh vleren e zhvillimeve, qe nuk eshte e pershtatshme te aplikohet ky seksion per keto zhvillime.

(4) Kur duhet te behet nje kompensim sipas seksionit 107 i detajuar ne nje njoftim per kompensim i rregjistruar sipas seksionit 110, per shkak te nje urdheri qe modifikon lejen e planifikimit, ose ne rastet ne seksionin 108, te nje vendimi planifikimi te caktuar qe jep leje planifikimi me kushte, ky seksion nuk do aplikohet per zhvillime ne perputhje me ate

leje sic modifikohet nga urdheri ose ne perputhje me ato kushte.

(5) Per qellime te ketij seksioni dhe te seksionit 112 "zhvillime te reja" perfshijne -

- (a) cdo zhvillim te nje klase te caktuar ne paragrafin 1 ose 3 te Skedules 3 qe kryhet pa ju nenshtuar kushteve te Skedules (Aneksit) 10; dhe
- (b) cdo zhvillim qe perjashtohet nga paragrafi 14 i Skedules 3 nga ajo Skedule (Aneks) per aplikime per vendime tek te cilat aplikohet seksioni 326(1).

Shuma e rekuperueshme sipas s.111 dhe dispozitat per pagesen e saj

112.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, shuma qe mund te merret sipas seksionit 111 ne lidhje me kompensime te detajuara ne nje njoftim per kompensim sipas seksionit 110—

- (a) ne qofte se toka ku kryhet zhvillimi ("zona e zhvillimit") eshte identike, ose perfshin te gjitha token ne njoftim per kompensim, atehere kjo shume do te jete ajo qe detajohet ne njoftim;
- (b) ne qofte se zona e zhvillimit perben pjese te tokes ne njoftim, ose perfshin pjese te asaj toke se bashku me toka te tjera qe nuk jane ne njoftim, do jete shuma e percaktuar ne njoftim per ate pjese te tokes ne njoftim qe perfshihet ne zonen e zhvillimit.

(2) Kur, pasi njoftimi per kompensim eshte rregjistruar per nje toke, Sekretari i Shtetit eshte bindur, duke pase parasysh vleren e nje zhvillimi ne ate toke, qe nuk do te behet zhvillim ne kete toke, pervec ne qofte se ai ushtron fuqine e tij sipas ketij nen-seksioni, ai, ne raste te ndonje zhvillimi te vecante, mund te anulloje shumen teresisht ose pjeserisht qe do paguhej sipas seksionit 111.

(3) Kur vetem nje pjese e nje shume te tille eshte anuluar per nje toke, Sekretari i Shtetit duhet te beje te mundur qe njoftimi te kete amendament qe reflekton shumen e kompensimit qe u anulua sipas nen-seksionit (2).

(4) Kur do paguhet nje shume sipas seksionit 111 e percaktuar ne nje njoftim kompensimi, per nje zhvillim te

tokes, atehere, kur pagesa e kesaj shume eshte anuluar nga nen-seksioni (2), shuma nuk mund te behet e pagueshme ne lidhje me kompensimin, per ate toke dhe per ate zhvillim.

(5) Asnje shume do behet e rikuperueshme sipas seksionit 111 ne lidhje me kompensime, ne referim te te cilave nje shume eshte bere e rekuperueshme nga Sekretari i Shtetit sipas seksioni 308.

(6) Nje shume e rikuperueshme sipas seksionit 111 ne lidhje me nje kompensim do i paguhet Sekretarit te Shtetit ose si -

- (a) nje pagese e vetme e madhe, ose
- (b) ne seri pagesash kombinuar me interes, ose
- (c) ne seri pagesash vjetore ose periodike, ne kohe te vecanta sic mund te udhezoje Sekretari i Shtetit.

(7) Perpara se te jape nje udhezim sipas (6)(c), Sekretari i Shtetit duhet te marre parasysh cdo verejtje te bere nga personi qe kryen zhvillimin.

(8) Pervec kur shuma e pagueshme sipas nen-seksionit (6) paguhet me nje pagese te vetme, shuma duhet te sigurohet nga personi qe do kryeje zhvillimin (me hipoteke, etj.), sic mund te udhezoje Sekretari i Shtetit.

(9) Ne qofte se nje person fillon nje zhvillim te ri per te cilin aplikohet seksioni 111 ne mosperputhje me nen-seksionin (1) te atij seksioni, Sekretari i Shtetit mund t'i dergoje nje njoftim ku -

- (a) detajon shumen qe Sekretari i Shtetit e mendon te rikuperueshme sipas atij seksioni ne lidhje me kompensimin ne fjale, dhe
- (b) I kerkon te paguaje shumen Sekretarit te Shtetit brenda nje periudhe qe caktohet ne njoftim.

(10) Periudha e permendur ne nen-seksionin (9)(b) nuk duhet te jete me e shkurter se 3 muaj pas dhenies se njoftimit.

(11) Ne varesi te nen-seksionit (12), cdo shume e rikuperuar nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 111 duhet t'i paguhet autoritetit te planifikimit lokal i cili ka dhene kompensimin me te cilin lidhet shuma.

(12) Ne varesi te nen-seksionit (13), per t'i paguar nje shume

te tille autoritetit te planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit duhet te zbrese nga kjo shume—

- (a) shumen e ndonje kontributi te paguar nga ai sipas seksionit 113 ne lidhje me kompensime me te cilat lidhet shuma;
- (b) shuma e ndonje granti te paguar nga ai sipas Pjeses XIV ne lidhje me ate kompensim.

(13) Ne qofte se shuma e rikuperuar nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 111—

- (a) eshte nje pjese e shumes totale te rikuperueshme, ose
- (b) eshte rikuperuar ne lidhje me nje zhvillim te nje pjese te tokes ne lidhje me te cilen eshte i pagueshem kompensimi,

cdo zbritje qe behet sipas paragrafit (a) ose paragrafit (b) te nen-seksionit (12), duhet te zbritet nga ajo shume qe percaktohet nga Sekretari i Shtetit si perpjestimi i pershtatshem i shumes se referuar ne ate paragraf.

113.—(1) Kur -

- (a) njoftimi sipas seksionit 110 i jipet Sekretarit te Shtetit si rrjedhim i nje urdheri sipas seksionit 97 qe revokon ose modifikon lejen e planifikimit, ose ne rastin kur bien ne seksionin 108, te vendimeve te planifikimit qe refuzojne lejen e planifikimit ose qe e japin ate me kushte, dhe
- (b) ne qofte se ajo leje eshte refuzuar, ose, sipas rastit, eshte dhene e modifikuar ose me kushte, ne kohen kur u dha leja, mund te ishte kerkuar kompensimi ne Pjesen V dhe do te ishte i pagueshme nga Sekretari i Shtetit,

Sekretari i Shtetit mund t'i paguaje autoritetit te planifikimit lokal nje shume kontribut qe ai mendon se eshte shuma e kompensimit qe do ishte paguar sipas Pjeses V.

(2) Shuma e nje kontributi te tille nuk duhet te kaloje -

- (a) shumen e kompensimit per zhvileresimin e paguar nga autoriteti i planifikimit lokal; ose
- (b) shumen e vendosur per vleren e zhvillimit ne lidhje me te cilen u pagua kompensimi ne daten e urdherit ose ne rastet e seksionit 108, te vendimit te planifikimit perkates.

Kontribute nga
Sekretari i
Shtetit per
kompensime ne
raste te vecanta

(3) Regullat e nxjerra nga ky seksion perbejne dispozita, ne lidhje me raste te propozuara nga Sekretari i Shtetit, per te paguar kontribute sipas ketij seksioni -

- (a) per t'i kerkuar Sekretarit te Shtetit te jape njoftimin per propozimin e tij—
 - (i) personave qe kane interes ne token me te cilen lidhet propozimi sic mund te percaktohet, dhe
 - (ii) personave te tjere (ne qofte se ka) sic mund te caktohen ne perputhje me rregullat e propozimit;
- (b) per te aftesuar personat qe moren njoftimin per te kundershuar propozimin per ceshtjet qe—
 - (i) kompensimi nuk do ishte i pagueshem sic permendet ne nen-seksionin (1), ose
 - (ii) shumava e kompensimit te pagueshem duhet te ishte me e vogel se ajo e kontributit te propozuar;
- (c) per te aftesuar personat qe kane bere kundershime te tilla te kerkojne qe mosmarreveshja ti kaloje Gjykates se Tokave per vendim; dhe
- (d) kur paguhet nje kontribut sipas ketij seksioni, per aplikimin (me modifikimet e nevojshme) te dispozitave te Pjeses V per reduktimin ose zhdukjen e balancave te paparashikuara te vleres se caktuar te tokes se zhvillimit, sikur kontributi te ishte paguar si kompensim ne kete Pjese.

Kompensime per vendime te tjera planifikimi

Kompensime per vendime planifikimi qe kufizojne zhvillime pervec zhvillimeve te reja

114.—(1) Ky seksion aplikohet atehere kur, pasi behet nje aplikim per leje planifikimi per kryerjen e nje zhvillimi qe perfshihet ne nje klase ne Pjesen II te Skedules (Aneksit) III, Sekretari i Shtetit, ose pas apelimit, ose kur shqyrton vete aplikimin, e refuzon lejen ose e jep me kushte.

(2) Ne qofte se, ne nje kerkese te bere autoritetit te planifikimit lokal ne menyre te caktuar dhe brenda nje kohe te caktuar tregohet qe vlera e interesit te nje personi ne token ishte me e vogel se e interesit qe do kishte patur ne qofte se do ishte dhene leja, ose sipas rastit, do ishte dhene pa

kushte, autoriteti i planifikimit lokal duhet t'i paguaje personit kompensim te barabarte me kete vlere.

(3) Ne marrjen e vendimit, per qellime te nen-seksionit (2), nese vlera e interesit ne token ishte me e vogel dhe sa me e vogel se ajo qe mund te kishte qene ne qofte se do ishte dhene leja, ose do ishte dhene pa kushte -

- (a) do te supozohet qe vendimi per aplikimin e ardhshem per nje leje planifikimi te ngjashme do te merret ne tte njejten menyre; por
- (b) ne qofte se, ne rastin e refuzimit te nje leje planifikimi, Sekretari i Shtetit, gjate refuzimit te lejes, dha leje planifikimi per disa zhvillime te tjera ne token ne qofte se ishte bere aplikimi per to, keto leje duhet te merren parasysh; dhe
- (c) nuk duhet te merren per baze perdorime qe bien ne kundershim me kushtet ne Skedulen (Aneksi) 10.

(4) Kur, ne nje aplikim te permendur ne nen-sesionin (1), leja e planifikimit jepet nga Sekretari i Shtetit me kushte te vena per projektin dhe pamjen e jashtme, ose madhesine ose lartesine e ndertesave, Sekretari i Shtetit mund te udhezaje qe keto kushte te mos merren per baze, ose te gjitha ose sic mund te specifikohet ne udhezim, per vendosjen e kompensimit te pagueshem sipas ketij seksioni (ne qofte se ka).

(5) Sekretari i Shtetit nuk duhet te jape udhezim sipas nen-seksionit (4) ne qofte se e sheh te arsyeshme ne rrethanat lokale.

(6) Per qellime te nen-seksionit (1) -

- (a) paragrafi (3) i Skedules (3) do te merret sikur nuk shtrihet per zmadhimin e nje ndertese qe ka ekzistuar me 1 Korrik 1948 ne qofte se—
 - (i) ndertesa permban dy ose me shume banesa te ndara horizontalisht nga njera tjetra ose nga disa pjese te tjera te nderteses; dhe
 - (ii) zmadhimi rezulton ose ne rritjen e numrit te ketyre banesave ne ndertese ose ne rritjen e madhesise kobike te nderteses me me shume se nje-te dhjeten e madhesise kubike te ndonje banese qe ndodhet ne ndertese;
- (b) ai paragraf do merret sikur nuk shtrihet per

punime ne lidhje me zmadhimin e nje ndertese te ngritur pas asaj date (duke perfshire ndertesa qe rezultojne nga punimet e pershkruara ne paragrafin 1 te Skedules (Aneksit) 3); dhe

- (c) paragrafi 7 i asaj Skedule (Aneksi) nuk do aplikohet per ndertesa te permendura ne paragrafin (b).

(7) Per qellime te ketij seksioni kushtet e referuara ne seksionet 91 dhe 92 nuk do te merren parasysh.

(8) Asnje kompensim do behet i pagueshem sipas ketij seksioni ne lidhje me interesin ne token per te cilin eshte marre nje njoftim per blerje.

Kompensime ne lidhje me urdhera sipas s.102, etj.

115.—(1) Ky seksion ka efek kur eshte dhene nje urdher sipas seksionit 102 -

- (a) qe kerkon qe perdorimi i tokes te ndalohe,
(b) qe vendos kushte per vazhdimin e perdorimit, ose
(c) qe kerkon qe ndonje ndertese ose punim ne toke te ndryshohet ose te hiqet ose shembet.

(2) Ne qofte se, ne nje kerkese te bere autoritetit te planifikimit lokal brenda nje kohe te caktuar, ne menyren e caktuar, tregohet qe nje person ka pesuar demtime si rrjedhim i nje urdheri -

- (a) pasi vlere e interesit te tokes se tij ose te mineraleve ne ose nen te, ka rene, ose
(b) pasi eshte ndikuar shfrytezimi i tokes ose i mineraleve ne te,

autoriteti duhet t'i paguaje atij personi kompensim per keto demtime.

(3) Pa cenuar seksionin (2), cdo person qe kryen punime ne perputhje me nje urdher ka te drejte, pasi ka bere kerkesen e permendur ne kete nen-seksion, te rekuperoje kompensimin ne lidhje me shpenzimet qe ka bere, nga autoriteti i planifikimit lokal.

(4) Cdo kompensim i pagueshem nje personi sipas ketij seksioni per nje urdher sic permendet ne nen-seksionin (1) do te reduktohet me vleren e ndonje druri apo shtylle, aparati ose materiali tjetër qe eshte zhvendosur sipas kerkesave te

urdherit.

(5) Ne varesi te seksionit 116, ky seksion aplikohet kur nje urdher i permendur ne nen-seksionin (6) eshte bere sikur eshte urdher per te cilin aplikohet seksioni 102.

(6) Urdherat e referuara ne nen-seksionin (5) jane urdhera te dhena sipas paragrafit 1 te Skedules (Aneksi) 9—

- (a) qe kerkojne te perfundoje perdorimi i tokes, ose
(b) vendosin kushte per perdorimin e saj; ose
(c) kerkojne qe cdo ndertese, punim, makineri apo fabrike ne toke te ndryshohet apo te zhvendoset apo rrezohet,

ose jane urdhera sipas paragrafit 3, 5, ose 6 te kesaj Skedule (Aneksi).

Baza te vecanta per kompensime ne lidhje me urdhera qe kane te bejne me punimet minerare

116. Skedula (Aneksi) 11 do kete efekt per qellime te hartimit te dispozitave te vecanta ne lidhje me pagesat e kompensimeve ne rrethana te vecanta ku nje urdher sipas seksionit 97 modifikon lejen e planifikimit per zhvillime qe konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve, ose urdheri behet sipas paragrafit 1, 3, 5, ose 6 te Skedules (Aneksit) 9.

Dispozita te pergjithshme dhe suplementare

Dispozita te pergjithshme per kompensime per zhvleresimin sipas Pjeses IV.

117.—(1) Per qellime te caktimit te nje kompensimi per te cilin aplikohet ky seksion, rregullat e vena ne seksionin 5 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961, do te kene efekt, ne varesi te ndonje modifikimi ose ne qofte se aplikohen, ashtu sic kane efet per caktimin e kompensimeve per blerje te detyrueshme te interesit per token.

(2) Ne varesi te rregullave te paragrafit 1 te Skedules (Aneksit) 11, ky seksion aplikohet per cdo kompensim qe sipas dispozitave te kesaj Pjese eshte i pagueshem ne lidhje me zhvleresimin e vleres se interesit ne toke.

(3) Kur interesi ne toke varet nga nje hipotekim—

- (a) cdo kompensim te cilit i aplikohet ky seksion, i pagueshem ne lidhje me zhvleresimin e vleres se interesit, do te caktohet sikur interesi nuk

- varet nga nje hipotekim;
- (b) kerkese per kompensim mund te beje pengmarresi i ketij interesi, por pa cenuar berjen e kerkeses nga personi qe ka interesin;
 - (c) asnje kompensim per te cilin aplikohet ky seksion do paguhet ne lidhje me interesin e pengmarresit (ndryshe nga interesi qe eshte hipotekuar); dhe
 - (d) kompensim per te cilin aplikohet ky seksion i pagueshem ne lidhje me interesin e hipotekuar do i paguhet pengmarresit, ose ne qofte se ka me shume se nje, pengmarresit te pare, dhe do aplikohet nga ai sikur te ishin te ardhura nga shitja.

Vendime per
kerkesat per
kompensim

118.—(1) Cdo ceshtje e komensimeve e kundershuar sipas kesaj Pjese do te referohet per tu zgjidhur tek Gjykata e Tokave, pervec rasteve ku parashikohet ndryshe nga rregullat e ketij Akti.

(2) Ne lidhje me zgjidhjen e mosmarreshjeve te tilla, do aplikohen dispozitat e seksioneve 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961, ne varesi te modifikimeve te nevojshme dhe te dispozitave te rregullave te ketij Akti.

PJESA V: KOMPENSIME PER KUFIZIME TE VENA PER ZHVILLIMET E REJA

Parathenie

Shtirja e Pjeses
V

119.—(1) Kjo Pjese ka efekt per te bere te mundur kerkesat per kompensime ne lidhje me vendimet e planifikimit per te cilat leja per te kryer zhvillime te reja eshte refuzuar ose eshte dhene me kushte, ne rastet kur gjate dhenies se lejes toka, ka nje balance te vleres se vendosur te zhvillimit.

(2) Skedula (Aneksi) 12 do te kete efekt per qellime te percaktimit nese toka ka nje balance te pashpenzuar te vleres se vendosur te zhvillimit per qellime te kesaj Pjese dhe, ne

qofte se po, sa eshte shuma e kesaj balance dhe per hartimin e dispozitave ne lidhje me keto ceshtje.

(3) Ne perputhje me nen-seksionin (5) te seksionit 63, nen-seksioni (3) i atij seksioni nuk aplikohet ne kete Pjese.

(4) Ne kete Pjese—

- (a) "interes" (kur i referohet interesit per token) do te thote pagesa ose qeraja e tokes dhe nuk perfshin interes mbi te; dhe
- (b) "autoritet i planifikimit lokal" ne lidhje me vendime te planifikimit, do te thote autoriteti qe merr keto vendime.

E drejta per kompensim

E drejta per
kompensim:
parime te
pergithshme

120. -- Ne varesi te diaspozitave te kesaj Pjese, nje person do kete te drejte kompensimi ne kete Pjese ne lidhje me nje vendim planifikimi nga i cili leja e planifikimit per nje zhvillim te ri ne toke eshte refuzuar ose dhene me kushte, ne qofte se -

- (a) ne kohen e vendimit ai merr interes ne ndonje toke me te cilen lidhet vendimi e cila ka nje balance te pashpenzuar te vleres se vendosur te zhvillimit; dhe
- (b) vlera e interesit, ose ne rastin e interesit qe shtrihet ne nje toke tjeter, e vlera e interesit qe lidhet me token ne paragrafin (a), zhvleresohet nga vendimi.

121.—(1) Kompensimi sipas kesaj Pjese nuk do te behet i pagueshem -

Vendimet e
planifikimit qe
nuk kerkojne
kompensim

- (a) ne lidhje me refuzimin e nje e lejes se planifikimit per cdo zhvillim qe konsiston ose perfshin ndryshime materiale ne perdorimin e ndertesave ose te tokes; dhe
- (b) ne lidhje me vendime te marra pas aplikimit sipas seksionit 220 per miratim te nxjerrjes se reklamave.

(2) Kompensimi sipas kesaj Pjese nuk eshte i pagueshem ne lidhje me imponimin, ne dhenien e lejes se planifikimit per zhvillim te tokes, te kushteve qe lidhen me -

- (a) numrin e ndertesave ne toke;
- (b) dimensionet, projektet, strukturen, ose pamjet e jashtme te nje ndertesave, ose materialet qe do te perdoren ne ndertim;

- (c) menyren e vendosjes ne toke sipas zhvillimit, duke perfshire dispozita per parkim, ngarkim, shkarkim ose furnizim me nafte te automjeteve ne ate toke;
- (d) perdorimin e ndertesave ose te pjeses tjeter te tokes; ose
- (e) vendosjen dhe projektin e lidhjeve me autostradat ose te materialeve qe do perdoren ne konstruksionin e ketyre lidhjeve,

ose ne lidhje me kushte qe vendosen per leje punimesh per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve.

(3) Ne nen-seksionin (2) "lidhje me autostraden" nuk perfshin rruge sherbimi.

(4) Kompensimi sipas kesaj Pjese nuk eshte i pagueshem ne lidhje me aplikime per leje planifikimi per kushte te cilave i referohen seksionet 91 dhe 92.

(5) Ne varesi te nen-seksionit (6), kompensimi sipas kesaj pjese nuk eshte i pagueshem ne lidhje me refuzimin e lejes per zhvillime, ne qofte se arsyeja ose arsyet e refuzimit jane qe zhvillimi i propozuar eshte i parakohshem ne lidhje me njeren ose te dyja nga ceshtjet me poshte, --

- (a) prioritetin e dhene ne nje plan zhvillimi per zonen ne te cilen ndodhet toka per zhvillim;
- (b) ndonje problem ekzistues ne furnizimin me uje ose me ujrat e zeza, dhe periudha brenda se ciles mendohet te zgjidhen keto probleme.

(6) Nen-seksioni (5) nuk aplikohet ne qofte se --

- (a) arsyeja ose njera nga arsyet e permendura ne nen-seksion eshte qe zhvillimi do jete i parakohshem ne lidhje me ceshtjet e permendura ne paragrafin (a) te atij nen-seksioni, dhe
- (b) vendimi per te refuzuar lejen eshte dhene kur aplikimi eshte bere me shume se 7 vite me vone nga vendimi i meparshem i cili ka refuzuar lejen per te zhvilluar token per te njejten arsye, ose per arsye qe perfshihen ne ate arsye.

(7) Kompensimi sipas kesaj Pjese nuk eshte i pagueshme ne lidhje me refuzimin e nje leje zhvillimi ne qofte se arsyeja ose njera nga arsyet per refuzim eshte qe toka eshte e

papershtatshme per propozimin per zhvillim per arsye te permbytjeve ose rreshqitjeve.

(8) Per qellime te ketij seksioni nje vendim planifikimi ku jepet leja e planifikimit per zhvillim me kushte qe ndalojne zhvillimin ne nje pjese te caktuar te tokes, do te konsiderohet si vendim qe refuzopn zhvillime ne ate pjese te tokes.

Jo kompensim
ne qofte se
lejohet zhvillim
tjeter i caktuar

122.—(1) Ne varesi te nen-seksionit (2), kompensimi sipas kesaj Pjese nuk eshte i pagueshem ne lidhje me vendime per refuzim te lejes per zhvillime te tokes, ne qofte se, pavaresisht nga refuzimi, ekziston ne lidhje me ate toke leja e planifikimit per zhvillim e se ciles i aplikohet ky seksion.

(2) Kur ekziston nje leje e tille vetem per nje pjese te tokes, ky seksion ka efekt vetem per interesin e asaj pjese ose qe lidhet me ate pjese.

(3) Kur behet nje kerkese per kompensim sipas kesaj Pjese ne lidhje me interesin e tokes, leja e planifikimit per zhvillime te cilave i aplikohet ky seksion, do konsiderohet qe ekziston ne lidhje me ate toke ose pjese toke, ne qofte se menjehere pasi Sekretari i Shtetit jep njoftimin e vendimeve te tij per kete kerkese, eshte ne fuqi ne lidhje me ate toke ose pjese toke, dhenia e lejes se planifikimit per disa nga keto zhvillime, pa kushte te tjera pervec atyre ne seksionin 121(2).

(4) Ky seksion aplikohet per cdo zhvillim qe --

- (a) ka karakter rezidencial, tregtar, apo industrial, dhe
- (b) konsiston teresisht apo pjeserisht ne ndertimin, e shtepiave te banimit, apartamenteve, dyqaneve ose zyrave, ose ndertesave industriale (perfshire magazinat) ose cdo kombinim i tyre.

Perjashtime nga
kompensimi te
metejshme

123.—(1) Kur interesi i nje toke (perpara ose pasi ka hyre ne fuqi ky Akt) eshte blere ose shitur nje autoriteti qe ka fuqi blerjeje te detyrueshme (pervec sipermarresve ligjore te Korporates Britanike te Qymyrgurit), ai autoritet dhe ndonje person tjeter i caktuar nga ai autoritet me ose pas 1 Korrikut 1948, do kete te drejten e kompensimit sipas kesaj pjese ne lidhje me vendimet e planifikimit te bera pas dhenies se njoftimit ose pas berjes se kontrates se shitjes per arsye se

vlera e atij interesi ka rene nga ky vendim.

(2) Nen-seksioni (1) aplikohet per toke qe me ose pas dates 1 Korrik 1948 eshte marre nga autoriteti lokal per nje qellim per te cilin autoritetit i eshte autorizuar te bleje token detyrimisht, sic aplikohet ne toka per te cilat eshte blere interesi sic permendet ne ate nen-seksion, dhe referencat per dhenien e njoftimit do te zevendesohen me referenca per marrjen e tokes.

(3) Kur ne nje date te caktuar nje toke ishte apo eshte toke veprimi per sipermarres te ligjshem, ose toke e Korporates Britanike te Qymyrgurit te nje klase te caktuar ne rregullat e seksionit 90 te Aktit te vitit 1947 ose sipas seksionit 273 te Aktit te vitit 1971 ose sipas seksionit 317 te ketij Akti, sipermarresit e ligjshem, ose Korporata Britanike e Qymyrgurit dhe ndonje person tjetër i emruar nga ata nuk do kete te drejte kompensimi sipas kesaj Pjese, ne lidhje me nje vendim planifikimi te bere ne daten e caktuar, per zhvleresimin e interesit te tokes nga vendimi.

(4) Ne nen-seksionin (3) "date e caktuar"-

(a) kur toka ishte toke veprimi ose toke e Korporates Britanike te Qymyrgurit sic permendet ne nen-seksion me 1 Janar 1955, eshte ajo date, dhe

(b) ne lidhje me toka te cilat (perpara ose pas hyrjes ne fuqi te ketij Akti) u bene toka veprimi ose toka te Korporates Britanike te Qymyrgurit ne daten qe vijon pas 1 Janarit 1955, eshte ajo date vijuese.

(5) Nje person nuk ka te drejte kompensimi sipas kesaj Pjese ne lidhje me zhvleresimin e vleres se interesit te tokes nga nje vendim planifikimi, ne qofte se ai ka te drejte kompensimi ne baze te seksionit 108 ne lidhje me zhvleresimet nga ai vendim.

Dhenie e lejes se
planifikimit ne
varesi te
kushteve

124.—(1) Ky seksion ka efekt kur—

(a) per nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime te reja ne toke, eshte marre vendimi qe leja te jepet ose pa kushte ose ne varesi te kushteve; dhe

(b) Sekretari i Shtetit verteton se ai eshte i bindur qe ndertesa ose punime te vecanta me te cilat lidhet aplikimi jane perfshire ne te vetem sepse

aplikanti ka aresye te mendoje qe leja per zhvillime te tjera me te cilat lidhet aplikimi (ne kete seksion quhet "zhvillime kryesore") nuk do jepej pervec se me kushtet qe kerkojne ngritjen ose konstruksionin e ketyre ndertesave ose punimeve.

(2) Kur aplikohet nen-seksioni (1), atehere per qellime te kesaj Pjese -

(a) aplikimi duhet te konsiderohet qe ka perfshire, ne vend te ketyre ndertesave ose punimeve, zhvillime te tjera te tokes mbi te cilen do ndertohen ndertesat ose punimet sikur jane perfshire ne zhvillimet kryesore; dhe

(b) leja do merret qe eshte dhene per zhvillime kryesore me kushtin qe kerkon ngritjen ose konstruksionin e ketyre ndertesave ose punimeve.

Shuma e kompensimit

Dispozita te
pergjithshme per
shumen e komp.

125.—(1) Kur nje person ka te drejte te marre kompensim sipas kesaj Pjese ne lidhje me zhvleresimin nga vendime planifikimi te vleres se interesit te tokes, shuma e kompensimit, ne varesi te dispozitave te meposhtme, do te jete -

(a) shuma me te cilen vlera e interesit, ne ate toke per te cilen aplikohet ky seksion, eshte zhvleresuar nga vendimi; ose

(b) ne qofte se me e vogel, shuma e balances se vleres se pashpenzuar se zhvillimit te caktuar me pare, menjehere pas vendimit, per ate toke qe ky seksion aplikohet.

(2) Toka per te cilen aplikohet ky seksion ne lidhje me nje vendim planifikimi, eshte toka e cila -

(a) perben ose eshte pjese e zones se vendimit; dhe

(b) ne kohen e vendimit ka nje balance vlere te pashpenzuar te zhvillimit.

(3) Ne qofte se per toka ne te cilat ky seksion aplikohet -

(a) kompensimi eshte i pagueshem sipas kesaj Pjese ne lidhje me dy ose me shume interese

ne ate toke, per aresye te te njejtit vendim, dhe
(b) shuma e kompensimit ne lidhje me keto
interesa kalon shumen e permendur ne
paragrafin (b) te nen-seksionit (1),

shuma e permendur ne ate paragraf do te shperndahet ne
mes te dy intereseve ne perputhje me zhvleresimin e vleres se
seciles prej tyre, dhe shuma e kompensimit e pagueshme ne
lidhje me secilin nga keto interese do jete shuma e caktuar
per pjesen e atij interesi.

(4) Kur toka qe perben zone vendimi, e marre ne teresi, nuk i
permbush te dy kushtet e meposhtme -

(a) qe ne kohen e vendimit ekzistonte nje balance
e vleres se pashpenzuar te zhvillimit te
vendosur me pare; dhe

(b) cdo interes i saj, vlera e te cilit ka rene nga
vendimi, ka te beje me te gjithë token ne
teresi,

nen-seksioni (5) ka efekt per qellime te caktimit te
kompensimit qe paguhet sipas kesaj Pjese ne lidhje me
interese te kesaj toke ose te cfaredo pjese te saj.

(5) Kur ky nen-seksion aplikohet ne lidhje me interesin e nje
toke -

(a) zhvleresimi i vleres se interesit nga vendimi per
planifikim, duhet fillimisht te percaktohet ne
lidhje me te token ne teresi qe perben ose eshte
pjesë e zones se vendimit dhe eshte toke ku
perfshihet ky interes;

(b) toka e referuar ne paragrafin (a) do merret si e
ndare ne aq pjese sa eshte e mundur per te
siguruar qe secila pjese konsiston ne toke qe ose

(i) ploteson te dy kushtet e seksionit (4), ose
(ii) nuk eshte toke, qe ne kohen e vendimit, ka
balance te pashpenzuar te vleres se zhvillimit te
vendosur me pare; dhe

(c) zhvleresimi i vleres se interesit e percaktuar ne
perputhje me paragrafin (a), do te ndahet ne
menyre propocionale ndermjet pjeseve, ne
perputhje me natyren e pjeseve dhe ndikimet e
vendimit te planifikimit ne secilen prej tyre; dhe

(d) shuma e kompensimit do te jete mbledhja e
shumave te pagueshme sipas dispozitave te ketij
seksioni sikur vendimi i planifikimit te ishte
marre ne vecanti per secilen pjese.

(6) Ne kete seksion "zone te vendimit" ne lidhje me nje vendim
planifikimi do te thote te gjithë tokat me te cilat lidhet
vendimi.

Vleresimi i
zhvleresimit

126.—(1) Per qellime te kesaj Pjese, vlera e nje interesi te
tokes, ose te nje interesi qe rrjedh nga nje toke e vecante, do
te merren qe jane zhvleresuar nga vendimi i planifikimit (ne
kete seksion i quajtur "vendimi i caktuar") ne qofte se, vlera, e
llogaritur ne perputhje me kete seksion, eshte me e vogel se
vlera e llogaritur ne qofte se vendimi do kishte efektin e
kundert nga vendimi i marre.

(2) Ne varesi te dispozitave qe vijojne ne kete seksion, vlera e
tille per qellime te ketij seksioni, do llogaritet -

(a) ne kohen e vendimit; por

(b) ashtu sic ndikohet nga ky vendim, nga dhenia
e lejes se planifikimit te bere pas atij vendimi
dhe qe hyn ne fuqi menjehere pasi Sekretari i
Shtetit ka dhene njoftimin per konkluzionet e
tij per kerkesen per kompensim ne lidhje me
ate vendim, dhe nga leja e planifikimit ne fuqi;
dhe

(c) me marrjen si te qene, qe pas vendimit dhe pa
u ndikuar nga nje leje e tille sic permendet ne
paragrafin (b), leja e planifikimit nuk do jepet
per ndonje zhvillim te ri ne token ne fjale, por
per zhvillime te tjera.

(3) Ne qofte se si rrjedhim i nje vendimi planifikimi tjeter ose
te nje urdheri te dhene—

(a) perpara vendimit te caktuar; dhe

(b) ose ne lidhje me token ne teresi ose nje pjese
te saj, me te cilen ka te beje vendimi i caktuar,
ose ne lidhje me zonen qe permban nje pjese
ose te gjithë kete toke,

kompensimi per te cilin aplikohet ky nen-seksion eshte bere i
pagueshem ne lidhje me ate vendim tjeter ose ate urdher,
llogaritjet e bera sipas ketij seksioni do te behen per vendimin
tjeter, sikur vendimi tjeter te kishte efektin e kundert nga
vendimit te caktuar.

(4) Nen-seksioni (3) aplikohet -

(a) per kompensime te pagueshme sipas kesaj
Pjese ose Pjeses II ose Pjeses V te Aktit te vitit

- 1954 ose Pjeses VI te Aktit te vitit 1962 ose Pjeses VII te Aktit te vitit 1971; dhe
- (b) aq sa nje kompensim eshte i pagueshem sipas seksionit 107 te ketij Akti, ose seksionit 164 te Aktit te vitit 1971, ose seksionit 118 te Aktit te vitit 1962, ose sipas dispozitave te ketyre seksioneve sic aplikohen nga seksioni 108 i ketij Akti, ose seksioni 165 i Aktit te vitit 1971 ose seksioni 119 i Aktit te vitit 1962, dhe aq sa kompensimit i aplikohet Pjesa IV e Aktit te vitit 1954, ishte ose eshte e pagueshme ne lidhje me humbje ose demtime te pesuara nga zhvleresimi i interesit te tokes.

- (5) Ne kete seksion "vendim me efekt te kundert"—
- (a) ne lidhje me nje vendim qe refuzon lejen, do te thote vendim qe jep lejen sipas kushteve (ne qofte se ka) brenda seksionit 121(2) qe mund te ishin vendosur nga autoriteti sikur vendimi te mos ishte refuzuar; dhe
- (b) ne lidhje me vendime qe japin leje me kushte, do te thote nje vendim qe aplikohet vetem per ata kushte.

Kerkesa per pagimin e kompensimeve

Dispozita te pergjithshme per kerkesa per kompensim

- 127.—(1) Kompensimi sipas kesaj Pjese nuk do te jete i pagueshem ne qofte se kerkesa nuk eshte bere ne perputhje me kete seksion.
- (2) Ne varesi te nen-seksionit (3), kerkesa per kompensim sipas kesaj Pjese nuk do te kete efekt ne qofte se nuk behet perpara mbarimit te peridhes 6 mujore qe fillon me daten e vendimit te planifikimit.
- (3) Sekretari i Shtetit ne raste te vecanta (ose perpara ose pas dates ne te cilen mbaron afati i kerkeses) mund te lejoje zgjatimin e periudhes per berjen e kerkesave te tilla.
- (4) Rregullat e vena nga ky seksion mund te—
- (a) kerkojne qe nje kerkesa per kompensim te behet ne nje forme te caktuar nga rregullat;
- (b) t'i kerkojne personit qe ka bere kerkesen te

siguroje materiale ne mbeshtetje te kerkeses, dhe informacione per interesin e kerkuesit ne toke, dhe per interesat e personave te tjere sic njihen nga kerkuesi.

- (5) Cdo kerkesa per kompensim ne lidhje me njue vendim planifikimi duhet t'i dergohet autoritetit te planifikimit lokal.
- (6) Ky autoritet duhet t'ja kaloje kerkesen Sekretarit te Shtetit sa me shpejt te jete e mundur dhe ta pajise ate me —
- (a) materiale dhe informacione te dhena nga kerkuesi ne perputhje me rregullat e ketij seksioni; dhe
- (b) informacione te tjera (ne qofte se ka) qe mund te kerkohen sipas rregullave te ketij seksioni, qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme per te ushtruar fuqine e tij sipas dispozitave te Pjeses III qe lidhen me shqyrtimin e vendimit te planifikimit me te cilin lidhet kerkesa per kompensim.
- (7) Kur nje kerkesa i kalohet Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (6) dhe Sekretari i Shtetit eshte i bindur se —
- (a) qe zhvillimi me te cilin lidhet vendimi per planifikim nuk eshte zhvillim i ri, ose
- (b) qe ne kohen e marrjes se vendimit, asnje pjese e tokes me te cilin lidhet kerkesa ka pasur nje balance te pashpenzuar te vleres se zhvillimit, ose
- (c) qe kompensimi eshte perjashtuar nga seksioni 121 ose 122,
- ai duhet njoftoje kerkuesin perkatesisht, per ato ceshtje per te cilat kompensimi nuk paguhet, dhe t'a ftojte kerkuesin per te terhequr kerkesen.
- (8) Pervec rasteve kur nje kerkesa transmetuar Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (6) eshte terhequr, Sekretari i Shtetit duhet te njoftoje per kerkesen cdo person, ose persona, qe per mendimin e tij kane interes ne token qe lidhet me vendimin.

Ndikimet ne kerkesa te udhezimeve sipas s. 80.

- 128.—(1) Kur, ne perputhje me seksionin 81(4), Sekretari i Shtetit jep njoftimin per nje udhezim sipas seksionit 80, nje personi qe ka bere nje kerkesa per kompensim ne lidhje me nje vendim per planifikim me te cilin lidhet udhezimi, ai

person, ne qofte se nuk e terheq kerkesen, mundet qe brenda 30 diteve pas marrjes se njoftimit, t'i dergoje Sekretarit te Shtetit modifikime per kerkesen e tij.

(2) Ne varesi te ketyre modifikimeve, kur Sekretari i Shtetit jep udhezim ne baze te seksionit 80 ne lidhje me nje vendim te autoritetit te planifikimit lokal, cdo kerkese e bere ne lidhje me ate vendim do kete efekt sikur te jete bere ne lidhje me vendimin, i cili bazuar ne udhezimin, zevendeson vendimin e autoritetit, ose sikur te ishte bere ne lidhje me vendimin e autoritetit te modifikuar nga udhezimi.

Vendimi per kerkesa 129.—(1) Rregullat e ketij seksioni duhet te hartojne dispozitat -

- (a) qe kerkesat per kompensim sipas kesaj Pjese qe do merren ne shqyrtim nga Sekretari i Shtetit te behen ne nje forme te caktuar;
- (b) per vendosjen e rregullave per praktiken dhe proceduren qe duhet ndjekur per te shqyrtuar keto kerkesa;
- (c) per t'i kerkuar Sekretarit te Shtetit qe kur merr vendimin per kerkesa te tilla -
 - (i) te njoftoje per konkluzionet e tij personin qe ka bere kerkesen dhe ndonje person tjeter qe ka bere kerkese ne lidhje me te njejtin vendim, dhe
 - (ii) ne qofte se keto kokluzione perfshijne ndarje propocionale, te jape detajet e kesaj ndarje cdo personi tjeter qe ka interes ne tokes, ose qe Sekretari i Shtetit mendon se interesi i tij ndikohet ne menyre te konsiderueshme.

(2) Ne varesi te nen-seksionit (3), duhet te hartohen dispozita per -

- (a) te aftesuar personin qe ben kerkesen ose ndonje person tjeter qe ka marre konkluzionet e Sekretarit te Shtetit ne perputhje me nen-seksionin (1), ne qofte se ai desheron te kundershroje konkluzionet, te kerkoje qe ceshtja te kaloje ne Gjykaten e Tokave;
- (b) per te aftesuar personin qe ben kerkesen dhe persona te tjere qe kane marre detajet e ndarjes propocionale nga Sekretari i Shtetit, ose ne qofte se pretendon se ka interes ne nje

toke qe ndikohet nga nje perpjestim i tille, ne qofte se desheron te kundershroje ndarjen propocionale, te kerkoje qe ceshtja te kaloje ne Gjykaten e Tokave;

- (c) per te aftesuar personin qe ben kerkesen ose ndonje person tjeter qe ka marre njoftimin per konkluzionet ose ndarjet propocionale sic permendet ne paragrafin (a) dhe (b) te degjohet perpara Gjykates ne lidhje me keto konkluzione apo ndarje propocionale; dhe
- (d) per t'i kerkuar Gjykates, ose te konfirmoje ose te ndryshoje konkluzionet e Sekretarit te Shtetit dhe te njoftoje per kete palet e ndryshme.

(3) Kur pasi i referohet Gjykates se Tokes sipas ketij seksioni vertetohet qe nje ndarje propocionale—

- (a) lidhet teresisht ose pjeserisht me te njejtat ceshtje te ndarjes se mepareshme, dhe
- (b) eshte konsistente me ndarjen e mepareshme ne lidhje me keto ceshtje,

Gjykata nuk duhet ta ndryshoje ndarjen ne menyre qe te mos perputhet ose te mos jete konsistente me ndarjen e mepareshme ne lidhje me keto ceshtje.

Pagesa e kompensimeve

130. -- Kur merret vendim per kompensim sipas seksionit 129, Sekretari i Shtetit duhet te paguaje kompensimin personave qe i takon ne perputhje me dispozitat e mesiperme te kesaj Pjese.

Nxjerrja e kompensimeve

Perpjestimet e kompensimeve

131.—(1) Kur, per nje kerkese per kompensim, Sekretari i Shtetit vendos qe kompensimi te paguhet dhe shuma e kompensimit kalon 20 Paund, Sekretari i Shtetit duhet te -

- (a) ne qofte se e konsideron praktike, ndaje shumen e kompensimit ndermjet pjeseve te ndryshme te tokes me te cilen lidhet kompensimi, dhe
- (b) te perfshije detaje te ndarjes propocionale ne njoftimin e tij sipas seksionit 129.

(2) Gjate ndarjes propocionale Sekretari i Shtetit duhet te

ndaje token ne pjese dhe te shperndaje kompensimin ndermjet tyre ne perputhje me menyren ne te cilen sipas mendimit te tij pjese te ndryshme jane ndikuar nga vendimi i planifikimit.

(3) Nen-seksionet (1) dhe (2) do aplikohen kur ju eshte referuar Gjykates se Tokave sipas seksionit 129, me zevendesimin e referencave per Sekretarin e Shtetit me referenca per Gjykatën e Tokave (pervec se kur vendimi i Gjykates nuk e prek shumën e kompensimit ose ndarjen qe ka bere Sekretari i Shtetit).

Rregjistrimi i kompensimeve

132.—(1) Kur per nje kerkese kompensimi te bere sipas kesaj Pjese, ne lidhje me nje vendim planifikimi, kompensimi do paguhet me nje shume qe i kalon 20 Paund, Sekretari i Shtetit duhet te beje te mundur qe njoftimi per kete fakt te rregjistrohet me -

- (a) keshillin e rrethit ose te Londres, ne te cilin ndodhet toka, dhe
- (b) ne qofte se ai keshill nuk eshte autoriteti i planifikimit lokal, me autoritetin e planifikimit lokal.

(2) Njoftimet e rregjistruara sipas ketij seksioni duhet te detajojne -

- (a) vendimin e planifikimit dhe token ne lidhje me te cilen lidhet kerkesa per kompensim,
- (b) shumën e kompensimit, dhe
- (c) cdo ndarje propocionale te tij sipas seksionit 131.

(3) Njoftime te rregjistruara sipas ketij seksioni do te jene detyrime te tokave lokale dhe per qellime te Aktit mbi Detyrimet e Tokave Lokale 1975 keshilli me te cilin u rregjistrua njoftimi do te merret si autoriteti ne lidhje me kete detyrim.

(4) Ne lidhje me kompensime te pershkruara ne nje njoftim te rregjistruar sipas ketij seksioni, referencat qe behen ne kete Pjese per kompensimin e nje pjese te tokes me te cilen lidhet njoftimi do te merren si me poshte -

- (a) ne qofte se njoftimi nuk perfshin nje ndarje propocionale sipas seksionit 131, shumën e kompensimit do te merret si e shperndare njesoj ne zonen ku ndodhet toka me te cilen

lidhet njoftimi;

- (b) ne qofte se njoftimi perban nje ndarje te tille -
 - (i) kompensimi do te merret si i shperndare ne perputhje me ndarjen propocionale ndermjet pjeseve te ndryshme te tokes e cila eshte ndare; dhe
 - (ii) kompensimi qe i takon nje pjese te tokes te rezultuar nga ndarja do merret si i shperndare njesoj ne te gjithe zonen e kesaj pjese.

Rekuperimi i kompensimeve ne nje zhvillim te metejshem

133.—(1) Asnjeri do kryeje zhvillime te reja per te cilat aplikohet ky seksion, ne nje toke per te cilen eshte rregjistruar nje njoftim ("njoftim kompensimi") sipas seksionit 132, ne qofte se nuk eshte paguar cdo shume, e pagueshme ne perputhje me seksionin 134 te ketij kompensimi dhe Sekretari i Shtetit eshte i bindur per kete.

(2) Ne varesi te nen-seksioneve (3) dhe (4), ky seksion aplikohet per cdo zhvillim te ri -

- (a) I cili eshte zhvillim me karakter rezidencial, tregtar, ose industrial dhe konsiston teresisht ose kryesisht ne ndertimin e shtepiave te banimin, apartamenteve, dyqaneve, ose zyrove, ose ndertesave industriale (duke perfshire magazinat), ose ne ndonje kombinim te tyre; ose
- (b) qe konsiston ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve; ose
- (c) te cilit, sipas mendimit te Sekretarit te Shtetit, i aplikohet ky seksion, duke patur parasysh vleren e zhvillimit.

(3) Ky seksion nuk aplikohet per zhvillime ne baze te nen-seksionit (2)(c) ne qofte se, ne aplikimin e bere per kete qellim, Sekretari i Shtetit eshte bindur, duker mbajtur parasysh zhvillimin, qe nuk eshte e aresyeshme te aplikohet ky seksion.

(4) Kur kompensimi i detajuar ne njoftimin e kompensimit eshte i pagueshem ne lidhje me vendosjen e kushteve per lejen e zhvillimit, ky seksion nuk aplikohet per zhvillime per te cilat eshte dhene nje leje e tille.

Shuma e

134.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij

rikuperueshme
dhe dispozitat
per pagesa

seksioni shuma e rikuperuar sipas seksionit 133 ne lidhje me kompensimin e detajuar ne njoftimin e kompensimit—

- (a) ne qofte se toka mbi te cilen kryhet zhvillimi ("zona e zhvillimit") eshte identike me ose perfshin te gjithë token ne njoftimin per kompensim, do te jete shuma e kompensimit te detajuar ne ate njoftim;
- (b) ne qofte se zona e zhvillimit perben pjese te tokes se perfshire ne njoftimin per kompensim, ose perfshin pjese te tokes se bashku me toka te tjera qe nuk perfshihen ne njoftim, do te jete shuma e kompensimit te detajuar ne njoftim per ate toke te caktuar ne njoftim brenda zones se zhvillimit.

(2) Kur, ne rastin e tokes ne nje njoftim per kompensim te rregjistruar, Sekretari i Shtetit bindet, duke patur parasysh vleren e zhvillimit te tokes, qe zhvillimi nuk do te kryhet pa ushtruar fuqine e tije sipas ketij nen-seksioni, ai, ne raste te vecante, mund te anulloje te gjithë ose nje pjese te shumen qe mund te ishte rikuperuar sipas seksionit 133.

(3) Kur nje pjese e kesaj shume eshte anuluar per nje toke, Sekretari i Shtetit duhet te beje te mundur qe njoftimi per kompensim te zenvendesohet ose te amendohet, qe te reflektoje shumen e kompensimit qe eshte anuluar sipas nen-seksionit (2).

(4) Kur, ne lidhje me zhvillimin e nje toke, nje shume eshte e pagueshme sipas seksionit 133 ne lidhje me nje kompensim te detajuar ne nje njoftim per kompensim, atehere, pervec kur pagesa eshte anuluar sipas nen-seksionit (2), asnje shume duhet te jete e pagueshme sipas seksionit 133 ne lidhje me ate kompensim, per ate toke ne lidhje me zhvillime te metejshme ne te.

(5) Asnje shume do jete e rikuperueshme sipas seksionit 133 ne lidhje me kompensime per te cilat nje shume eshte e rikuperueshme nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 308.

(6) Shuma e rikuperueshme sipas seksionit 133 ne lidhje me nje kompensim do behet e pagueshme nga Sekretari i Shtetit ose —

- (a) me nje pagese te vetme, ose
- (b) si seri pagesash te kombinuara me interes, ose
- (c) si seri pagesash vjetore ose peridike, ku

shumat dhe periudhat kohore vendosen nga Sekretari i Shtetit me udhezim.

(7) Perpara se te jape nje udhezim sipas nen-seksionit (6)(c), Sekretari i Shtetit duhet te kete parasysh cdo verejtje te bere nga persona te cilet kryejn zhvillimin.

(8) Pervec rasteve kur shuma e permendur ne nen-seksionin (6) eshte e pagueshme me nje pagese te vetme, pagesa duhet te sigurohet nga personi qe po kryen zhvillimin sic udhezoi Sekretari i Shtetit (me hipoteke, etj.)

(9) Ne qofte se ndonje person fillon te zbatoje nje zhvillim te ri te cilit i aplikohet seksioni 133, ne mosperputhje me nen-seksionin (1) te atij seksioni, Sekretari i Shtetit mund ti jape njoftimin —

- (a) qe detajon shumen e rikuperueshme sipas ketij seksioni ne lidhje me kompensimin, dhe
- (b) qe i kerkon atij te paguaje shumen Sekretarit te Shtetit brenda nje periudhe te caktuar ne njoftim.

(10) Kjo periudhe e specifikuar sipas nen-seksionit (9)(b) nuk duhet te jete me e vogel se 3 muaj pas dhenies se njoftimit.

Dispozita suplementare

Hipoteka,
qeramarrje, dhe
vendosje.

135.—(1) Rregullat e bera sipas ketij seksioni mund te hartojne dispozita —

- (a) per ushtrimin e te drejtes per kerkesa kompensimi sipas kesaj Pjese,
- (b) per caktimin e personave te cileve duhet t'i paguhet kompensimi, dhe
- (c) per aplikimin e ketij kompensimi ose te nje pjese te tij,

ne rastet kur, pervec ketij seksioni, e drejta e kerkeses per kompensim ushtrohet ne lidhje me interesa ne token qe eshte e varur nga hipoteka, ose qeramarrja, ose qe ishte ne varesi ne nje kohe te caktuar.

(2) Ne lidhje me rastet qe bazuar ne keto rregulla, kompensimi ose nje pjese e tij duhet t'i paguhet pronarit qe ka dhene token me qera, atehere rregullat mund te —

- (a) te hartojne dispozita te ngjashme me ato te

seksionit 25 te Aktit mbi Demtimet e Luftes 1943 (e drejta e pronareve te qiravenes per pagesa per demtimet e luftes) por me ndryshime dhe modifikime sic mund te pershkruhet, dhe

- (b) vendosin per rruge per tu ndjekur kur ka mosmarreveshje, per t'i paraqitur perpara Gjykates se Tokave per marrjen e vendimit.

- 136.—(1) Ne llogaritjen e vleres per cdo qellim ne kete Pjese –
(a) ne varesi te nen-seksionit (2), rregullat (2) dhe (4) te vena ne seksionin 5 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961 do te aplikohen me modifikimet e nevojshme; dhe
(b) cdo hipoteke qe duhet t'i vleresohet interesi sipas ketij Akti nuk do te merret parasysh.

(2) Regulla (3) e ketyre rregullave nuk aplikohet per qellime te paragrafit 15 te Skedules (Aneksit) 12.

- (3) Kur per qellime te dispozitave te kesaj Pjese –
(a) vlera duhet te llogaritet ne lidhje me kohezgjatjen e qerases, dhe
(b) kur data e skadimit te qerases nuk eshte e qarte, per arsye te ndonje mundesie apo te drejte kontraktuale per ta renovuar qerane, ajo date do merret si date qe duket e mundshme apo e aresyeshme duke patur parasysh interesin e pales qe ka kete te drejte, dhe duke pase parasysh cdo material te rendesishem ne kohen kur behet llogaritja e vleres.

**PJESA VI:
TE DREJTAT E PRONARIT
TE KERKOJE BLERJEN E INTERESIT**

**KAPITULLI I
INTERESA QE NDIKOHEN NGA VENDIMET E
PLANIFIKIMIT OSE URDHERAT**

Dhenia e njoftimit per blerje

137.—(1) Ky seksion aplikohet kur—

Rrethanat ne te cilat mund te jipet njoftimi per blerje

- (a) me berjen e nje aplikimi pr leje planifikimi per te zhvilluar nje toke, leja refuzohet ose jepet me kushte; ose
(b) me nje urdher sipas seksionit 97 leja e planifikimit ne lidhje me nje toke eshte revokuar, ose modifikuar me vendosjen e kushteve; ose
(c) nje urdher eshte nxjerre sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules (Aneksit) 9 ne lidhje me ate toke.

(2) Ne qofte se –

- (a) ne rastet e permenduara ne nen-seksionin (1)(a) dhe (b), pronari i tokes pretendon qe kushtet e permendura ne nen-seksionin (3) jane permbushur, ose
(b) ne rastet e permendura ne nen-seksionin (1)(c), cdo person qe ka te drejten e interesit ne toke ne lidhje me te cilen eshte nxjerre nje urdher pretendon qe kushtet e permendura ne nen-seksionin (4) jane permbushur,

ai mund, brenda nje kohe te caktuar dhe ne nje menyre te caktuar, t'i jape keshillit te rrethit ose te Londres ku toka vendoset nje njoftim (ne kete Akt quhet "njoftim blerjeje") qe i kerkon keshillit te bleje interesin e tij ne toke ne perputhje me kete Kapitull.

(3) Kushtet e permendura ne nen-seksionin (2)(a) jane –

- (a) qe toka eshte bere e pamundur te perdoret per qellime perfitimi ne gjendjen ekzistuese; dhe
(b) ne rastin kur leja e planifikimit u dha me kushte ose u modifikua me vendosjen e kushteve, ajo toke nuk mund te behet e mundur per perdorim te vlefshem me kryerjen e zhvillimit te lejuar ne perputhje me keto kushte; dhe
(c) ne cdo rast, qe toka nuk behet e mundur per perdorime perfitimi ose te vlefshme me kryerjen e ndonje zhvillimi tjetër per te cilin eshte dhene leja e planifikimit ose per te cilin autoriteti i planifikimit lokal ose Sekretari i Shtetit do i japin lejen e planifikimit.

- (4) Kushtet e permendura ne nen-seksionin (2)(b) jane -
- (a) qe per aresye te urdherit toka ne gjendjen ekzistuese nuk mund te perdoret per qellime perfitimi ose per perdorim te vlefshem; dhe
 - (b) nuk mund te behet e tille me kryerjen e ndonje zhvillimi per te cilin eshte dhene leja, nga ky urdher ose nga ndonje vendim tjetër.

(5) Per qellime te nen-seksionit (1)(a) cdo kerkese e bere ne rrethanat e permendura ne ate nen-seksion, kushtet e vendosura nga seksionet 91 dhe 92 nuk do te merren per baze.

- (6) Personi qe ka marre njoftim per riparime sipas seksionit 48 te Aktit me Planifikimin 1990 (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) nuk ka te drejte te beje nje njoftim sipas ketij seksioni ne rrethanat e permendura ne nen-seksionin (1)(a) ne lidhje me nje ndertese ne fjale -
- (a) ne qofte se ka mbaruar koha 3 mujore nga data e marrjes se njoftimit per riparime; dhe
 - (b) ne qofte se gjate asaj periudhe ka filluar blerja e detyrueshme e nderteses sipas seksionit 47 te atij Akti, ne qofte se blerja eshte ndaluar.

- (7) Per qellime te nen-seksionit (6) nje blerje e detyrueshme -
- (a) ka filluar kur njoftimi i kerkuar nga seksioni 12 i Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981 eshte dhene, ose sipas rastit aplikohet paragrafi 3 i Skedules (Aneksit) 1 te Aktit; dhe
 - (b) eshte ndaluar -
 - (i) ne rastin e blerjes nga Sekretari i Shtetit, kur ai nuk vendos te beje urdherin e blerjes; dhe
 - (ii) ne raste te tjera, kur urdheri terhiqet ose Sekretari i Shtetit vendos te mos e konfirmoje.

138.—(1) Kur, per qellime te vendosjes nese kushtet e detajuara ne seksionin 137(3) ose (4) jane permbushur ne lidhje me nje toke, per ceshtje qe ngrihen ne lidhje me rrethana te vecanta qe toka mund te kete perdorim me vlere, atehere ne percaktimin e ketyre ceshtjeve nuk do merret parasysh perdorime te mundshme te paaautorizuara te tokes.

(2) Perdorim i mundshem i paaautorizuar i tokes do te merret

Rrethana ne te cilat toka eshte e paafte per t'u perdorur

- si i paaautorizuar per qellime te nen-seksionit (1)—
- (a) ne qofte se ka te beje me kryerjen e zhvillimeve te reja, ose
 - (b) ne rastin e njoftimeve per blerje te bera si rrjedhim i nje leje planifikimi te refuzuar ose te dhene me kushte, do kundershtoj kushtin e vendosur ne Skedulen 10.

Detyrat e autoriteteve kur jepet njoftimi per blerje

139.—(1) Keshilli te cilit i jepet nje njoftim per blerje do i ktheje pergjigje pronarit i cili paraqiti njoftimin per blerje, me ane te nje "pergjigje njoftimi"—

Veprime nga keshilli i cili more njoftim per blerje

- (a) qe keshilli eshte dakord te zbatoje njoftimin per blerje; ose
- (b) qe nje autoritet tjetër lokal ose sipermarres ligjor ka rene dakord te zbatoje njoftimin, ose
- (c) qe per aresye te vecanta, keshilli nuk bie dakord te zbatoje njoftimin dhe nuk kane gjetur asnje autoritet tjetër lokal apo sipermarres ligjor qe bie dakord ne vend te tyre, dhe qe ja kane derguar nje kopje te njoftimit per blerje dhe te pergjigjes se njoftimit Sekretarit te Shtetit.

(2) Pergjegja e njoftimit mund te jepet perpara mbarimit te periudhes 3 mujore qe fillon me daten e marrjes se njoftimit per blerje.

(3) Kur keshilli i cili ka marre njoftimin per blerje nga pronari, ka dhene nje pergjigje njoftimi ne perputhje me nen-seksionin (1)(a) ose (b), keshilli, ose sipas rastit autoriteti i planifikimit lokal ose sipermarresi ligjor, te perfshire ne pergjigje do te konsiderohen si -

- (a) te autorizuar per te blere interesin e pronarit ne perputhje me dispozitat perkatese, dhe
- (b) qe kane dhene njoftimin per te filluar nje gje te tille ne daten e dhenies se pergjigjes.

(4) Kur keshilli propozon nje pergjigje njoftimi sipas nen-seksionit (1)(c), ata duhet me pare t'i dergoje Sekretarit te Shtetit—

- (a) nje kopje te pergjegjes se njoftimit te

propozuar, dhe
(b) nje kopje te njoftimit te blerjes.

(5) Nje njoftim sipas nen-seksionit (3)(b) nuk mund te terhiqet sipas seksionit 31 te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961.

140.—(1) Kur nje kopje te njoftimit te blerjes i dergohet Sekretarit te Shtetit sipas seksionit 139(4), ai duhet te vendose nese e konfirmon njoftimin ose te veproje ndryshe ne lidhje me te perputhje me seksionin 141.

(2) Perpara se te konfirmoje nje njoftim per blerje ose te veproje ndryshe, Sekretari i Shtetit duhet te njoftoje per veprimet qe propozon -

- (a) personin qe ka nxjerre njoftimin per blerje;
- (b) keshillin te cilit ju dorezua;
- (c) kur behet fjale per jashte Londres se Madhe -
 - (i) autoritetin e planifikimit te qarkut dhe gjithashtu, keshillin e qarkut kur autoriteti eshte nje bord i perbashket planifikimi; dhe
 - (ii) bordin, ne qofte se Keshilli i Rrethit te cilit ju dorezua njoftimi per blerje eshte pjesetar i nje bordi planifikimi te perbashket; dhe
- (d) ne qofte se Sekretari i Shtetit propozon te zevendesoje keshillin me nje autoritet planifikimi lokal tjeter ose me nje sipermarres ligjor, ti jape njoftimin ketyre te fundit.

(3) Njoftimi sipas nen-seksionit (2) duhet te specifikojë periudhen (qe nuk duhet te jete me e shkurter se 21 dite nga data e dhehnies se njoftimit) brenda se ciles cdo person cili mori njoftimin qe mund te kerkoje nga Sekretari i Shtetit nje mundesi per te shfaqur mendimet e veta perpara nje personi te emeruar nga Sekretarit.

(4) Ne qofte se brenda asaj periudhe persona te tille kerkojne kete, perpara se Sekretari i Shtetit te konfirmoje njoftimin e blerjes ose te veproje sipas seksionit 141, ai duhet t'i jape kete mundesi ketyre personave.

(5) Ne qofte se, pasi te gjithe personat kane shprehur mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit, ai nxjerr konkluzionin eshte e nevojshme te veprohet ne perputhje me seksionin 141, Sekretari i Shtetit mund te veproje perkatesisht.

Veprime nga
Sekretari i
Shtetit ne lidhje
me njoftim per
blerje

141.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni dhe te seksionit 142(3), Sekretari i Shtetit bindet qe kushtet e specifikuar ne nen-seksionin (3), ose sipas rastit ne nen-seksionin (4) te seksionit 137 jane permbushur ne lidhje me njoftimin per blerje, atehere ai duhet te konfirmoje njoftimin.

(2) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e konsideron te nevojshme, ne vend te konfirmimit te njoftimit per blerje, ai mund -

- (a) ne rastet kur njoftimi eshte bere bazuar ne refuzimin e lejes se planifikimit, te jape lejen e planifikimit per zhvillimin ne fjale;
- (b) ne rastet kur njoftimi eshte bazuar ne dhenien e lejes se planifikimit me kushte, te revokojë ose te amendojë keto kushte sic e mendon te mjaftueshme per te bere token te vlefshme per perdorim me ane te ketij zhvillimi;
- (c) ne rastet kur njoftimi bazohet ne nje leje planifikimi te revokuar nga nje urdher sipas seksionit 97, te anullojë urdherin;
- (d) ne rastet kur njoftimi eshte bazuar ne nje modifikim te nje leje planifikimi me ane te nje urdheri qe vendos kushte, te revokojë ose te ndryshojë kushtet ne menyre qe sipas mendimit te tij toka te kthehet ne toke me vlere perdorimi; ose
- (e) ne rastet kur njoftimi bazohet ne nje urdher sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules 9, te revokojë urdherin ose te amendojë urdherin ne menyre qe sipas mendimit te tij e parandalon qe toka te behet e pavlefshme.

(3) Ne qofte se Sekretari i Shtetit konkludon qe toka, ose nje pjese e saj, mund te behet e vlefshme ne perdorim brenda nje kohe te arsyeshme, me kryerjen e zhvillimeve te tjera per te cilat duhet te merret leja e planifikimit, ai, ne vend qe te konfirmoje njoftimin e blerjes, mund te udhezojë qe te jepet leja ne qofte se eshte bere aplikimi per nje leje te tille.

(4) Ne qofte se Sekretari i Shtetit konkludon qe eshte e nevojshme, duke patur parasysh perdorimin e mundshem te tokes, ai mund, ne qofte se e konfirmon njoftimin, t'a modifikojë ate, ose ne lidhje me te gjithe token ose nje pjese te

saj, duke zevendesuar keshillin i cili ka marre njoftimin, me nje autoritet lokal tjeter ose me nje sipermarres ligjor.

(5) Cdo reference ne kete seksion per veprime te Sekretari te Shtetit perfshin referenca per vendimet e tij per te mos konfirmuar njoftimin e blerjes, ose per aresye qe kushtet e vendosura ne nen-seksionin (1) nuk jane te kenaqshme, ose ne baze te seksionit 142.

142.—(1) Ky seksion aplikohet kur njoftimi per blerje jepet ne lidhje me nje toke e cila ose nje pjese e se ciles ka perdorim te kufizuar ne baze te nje leje planifikimi ekzistuese.

(2) Per qellime te ketij seksioni, toka do nenkuptohet qe ka perdorim te kufizuar ne baze te nje leje planifikimi ekzistuese ne qofte se eshte pjese e nje zone me te madhe ne lidhje me te cilen eshte dhene leja e planifikimit (dhe nuk eshte revokuar) dhe ose -

- (a) mbetet nje kufizim i lejes se planifikimit qe ajo pjese duhet te lihet e pazhvilluar ose te ruhet ne nje menyre te caktuar; ose
- (b) leja e planifikimit eshte dhene ne baze te nje aplikimi i cili ka parashikuar qe ajo pjese te mos perfshihet ne zhvillim per te cilin kerkohet leja, ose te ruhet sic pershkruhet ne paragrafin (a).

(3) Kur Sekretari i Shtetit merr nje kopje te njoftimit per blerje sipas seksionit 139(4), nuk ka nevojte te konfirmoje njoftimin sipas seksionit 141(1) ne qofte se nxjerr konkluzionin qe toka ka perdorim te kufizuar ne baze te nje leje planifikimi ekzistuese, duhet te mbese e pazhvilluar ose sipas rastit duhet te mbrohet kundrejt pjeses tjeter te zones se zhvillimit.

143.—(1) Kur Sekretari i Shtetit konfirmon nje njoftim blerjeje -

- (a) keshilli i cili mori njoftimin per blerje, ose
- (b) ose ne qofte se sipas seksionit 141(4) Sekretari i Shtetit modifikon njoftimin per blerje me zevendesimin e keshillit me autortete te planifikimit lokal te tjera ose me sipermarres ligjor, keto autoritete ose sipermarres ligjor,

do te merren si te autorizuar per te blere interesin nga pronari ne perputhje me dispozitat e caktuara, dhe qe japin njoftimin se do te bejne nje gje te tille brenda nje date te caktuar nga

Fuqia per te refuzuar konfirmimin e njoftimit per blerje kur toka ka kufizime perdorimi si rezultat i nje leje planifikimi te mepareshme

Efektet e veprimeve te Sekretarit te Shtetit ne lidhje me njoftimin per blerje

Sekretari i Shtetit.

(2) Ne qofte se, perpara mbarimit te periudhes se caktuar, Sekretari i Shtetit, as -

- (a) nuk e ka konfirmuar njoftimin, as
- (b) nuk ka vepruar ne lidhje me te sic permendet ne seksionet 141(2) ose (3), as
- (c) nuk ka njoftuar pronarin qe nuk ka ndermend te propozoje per konfirmimin e njoftimit,

njoftimi do te konsiderohet qe eshte i konfirmuar ne fund te asaj periudhe, dhe keshilli qe ka marre njoftimin, do te konsiderohet i autorizuar sic permendet ne nen-seksionin (1) dhe qe jep njoftimin se do te bejne nje gje te tille brenda asaj periudhe.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), per qellime te nen-seksionit (2) periudha e caktuar eshte -

- (a) periudha prej nente muajve qe fillon me daten e dhenies se njoftimit per blerje; ose
- (b) ne qofte se mbaron me perpara, periudha 6 mujore qe fillon me daten ne te cilen nje kopje te njoftimit per blerje ju dergua Sekretarit te Shtetit.

(4) Koha e caktuar nuk vazhdon ne qofte se Sekretari i Shtetit ka perpara tij ne te njejten kohe -

- (a) nje kopje te njoftimit per blerje te derguar sipas seksionit 139(4); dhe
- (b) nje apelim sipas seksionit 78, 174, ose 195 te ketij Akti ose sipas seksionit 20 ose 39 te Aktit mbi Planifikimin 1990 (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) (apelime kundra renies dakord per ndertesa te listuara, etj., dhe apelime kundra njoftimeve mbi ndertesat e listuara) ose sipas seksionit 21 te Aktit mbi Planifikimin 1990 (substancat e rrezikshme) (apelime kundra vendimeve dhe deshtimit per marrjen e vendimeve ne lidhje me substancat e rrezikshme) ne lidhje me token per te cilen eshte dhene njoftimi per blerje.

(5) Kur -

- (a) Sekretari i Shtetit ka njoftuar pronarin i cili ka paraqitur njoftimin per blerje, per vendimin e tij per te konfirmuar njoftimin, ose per te mos e konfirmuar; dhe

(b) Ai vendim eshte hedhur poshte sipas Pjeses XII,
njoftimi i blerjes do te merret si i anuluar, por pronari mund te paraqese nje njoftim tjetër ne vend te tij.

(6) Referencat qe i behen ne nen-seksionin (5) per vendime per konfirmim, ose jo konfirmimin e njoftimit per blerje perfshin--

(a) cdo vendim per te mos konfirmuar njoftimin ne lidhje me nje pjese te tokes, dhe

(b) cdo vendim per te dhene leje, ose udhezim, ne vend te konfirmimit te njoftimit, teresisht apo pjeserisht.

(7) Me qellim qe te percaktohet nese eshte bere nje njoftim i metejshem per blerje sipas nen-seksionit (5) brenda periudhes se caktuar per te bere kete njoftim, vendimi i planifikimit si rrjedhim i te cilit u dha njoftimi, do te merret sikur eshte bere ne daten ne te cilen vendimi i Sekretarit te Shtetit eshte hedhur poshte.

(8) Nje njoftim qe merret si i dhene ne baze te nen-seksionit (1) ose (2) nuk mund te terhiqet sipas seksionit 31 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961.

Kompensimi

144.—(1) Kur kompensimi eshte i pagueshem sipas seksionit 107 ne lidhje me shpenzimet e bera per kryerjen e punimeve ne toke, kompensime te pagueshme ne lidhje me blerjen e interesit ne toke per zbatimin e nje njoftimi per blerje duhet te kufizohet ne vleres se ketyre punimeve.

(2) Kur --

(a) Sekretari i Shtetit jep udhezim sipas seksionit 141(3) qe, mund te jepet leja e planifikimit per zhvillimin e nje toke, pas eshte bere aplikimi, dhe

(b) Ne kerkesen e bere autoritetit te planifikimit lokal brenda periudhes se caktuar, ne menyren e caktuar, tregohet vlera e zhvillimit te lejuar e interesit ne toke ne lidhje me te cilin eshte bere njoftimi per blerje, eshte me e vogel se vlera e perdorimit ekzistues,

Ky autoritet duhet t'i paguaje personi qe i tokon interesit i

Dispozita te vecanta per kompensime kur eshte dhene njoftim per blerje

tokes shumen e barabarte me kete diference.

(3) Ne qofte se leja e planifikimit e permendur ne nen-seksionin (2)(a) jepet me kushte qe lidhen me projektin ose pamjen e jashtme, ose madhesine apo lartesine e ndertesave, ose per numrin e ndertesave qe mund te ngrihet ne toke, Sekretari i Shtetit mund te udhezoje qe keto kushte te mos merren parasysh ne vleresimin e kompensimit te pagueshem sipas ketij nen-seksioni (2), ose teresisht ose ne masen qe percaktohet ne udhezim.

(4) Sekretari i Shtetit mund te jape udhezim sipas nen-seksionit (3), vetem ne qofte se ai e konsideron te nevojshme ne rrethanat lokale.

(5) Seksionet 117 dhe 118 do te kene efekt ne lidhje me kompensime sipas nen-seksionit (2), sic kane efekt ne lidhje me kompensime te cilave i aplikohen.

(6) Ne kete seksion --

(a) "vlere e zhvillimit te lejuar", ne lidhje me nje interes te tokes per te cilin eshte dhene nje udhezim sipas seksionit 141(3), do te thote vlera e interesit e llogaritur duke marre per baze ate udhezim, por duke konsideruar qe nuk do ishte dhene leja e planifikimit ne raste te tjera pervec se ne perputhje me udhezimin, dhe

(b) "vlere ekzistuese e perdorimit", ne lidhje me intere te tille, do te thote vlera e atij interesi sikur te ishte llogaritur ne perputhje me dispozitat e Aktit mbi Blerjen e Tokes (Vleresime te Kompensimit) 1919, sic modifikohet nga dispozitat e seksioneve 51 deri 54, te Aktit te vitit 1947, ne qofte se nuk eshte miratuar pas Aktit te vitit 1947 ndonje dokument qe modifikon, ose zevendeson cilindo nga keto dispozita.

(7) Kur nje njoftim per blerje ne lidhje me nje interes ne toke behet si rrjedhim i nje urdheri sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules (Aneksit) 9, atehere ne qofte se --

(a) interesi eshte blere ne perputhje me kete Kapitull; ose

(b) kompensimi eshte i pagueshem sipas nen-seksionit (2),

asnje kompensim duhet te paguhet ne lidhje me ate urdher sipas seksionit 115.

Dispozita te vecanta per kerkesa per blerje te nje njesie bujqesore teresisht apo pjeserisht

145.—(1) Ky seksion aplikohet kur -

Kunder-njoftime
qe kerkojne
blerjen e pjeses
qe mbetet nga
njesia bujqesore

- (a) nje autoritet bleres sipas ketij Kapitull qe ka dhene njoftimin per zbartimin e blerjes se nje toke bujqesore nga nje person qe ka interes ("kerkuesi") me te madh ne toke se nje qiramarres per nje vit, ose nga viti ne vit (nese eshte apo jo perdorues i tokes), dhe
- (b) kerkuesi ka interes ne toke bujqesore tjeter ("zona e paprekur") qe perfshihet ne te njejten njesi bujqesore me ate te cilen lidhet njoftimi.

(2) Kur aplikohet ky seksion kerkuesi mund t'i paraqese autoritetit bleres nje kunder-njoftim—

- (a) qe pretendon se zona e paprekur nuk eshte e pershtatshme per bujqesi, ose ne vecanti ose ne lidhje me toke tjeter te caktuar, si nje njesi bujqesore me vete; dhe
- (b) qe i kerkon autoritetit bleres te bleje interesin per te gjithë zonen e paprekur.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), "toke tjeter e caktuar" ne nen-seksionin (2) do te thote -

- (a) toke qe perfshihet ne te njejten njesi bujqesore si toke qe lidhet me njoftimin e bleresit dhe qe kerkuesi nuk ka interes sic permendet ne nen-seksionin (1); dhe
- (b) toke qe perfshihet ne njesi bujqesore tjeter te perdorur nga kerkuesi ne daten e dhenies se njoftimit nga bleresi dhe ne lidhje me te cilen ai ka interes me te madh se nje qiramarres per nje vit ose nga viti ne vit.

(4) Kur njoftimi nga bleresi eshte dhene sipas ketij Kapitulli ose sipas Pjeses III te Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1981, ne lidhje me nje zone te paprekur ose ne lidhje me nje toke tjeter te caktuar sic perkufizohet ne nen-seksionin (3), atehere, ne qofte se njoftimi per blerje nuk eshte terhequr, ky seksion dhe seksioni 146 do kene efekt sikur ajo toke te mos

jete pjese e tokes se paprekur, ose sipas rastit te tokes se vecante.

(5) Kur jepet nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (2) kerkuesi duhet ti jape nje kopje cdo personi tjeter qe ka interes ne zonen e paprekur (por ne qofte se nuk e ben nje gje te tille nuk do anulohet kunder-njoftimi).

6) Nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (2) dhe cdo kopje e tij sipas nen-seksionit (5) duhet te dorezohen brenda nje periudhe 2 mujore qe fillon me daten ne te cilen u dha njoftimi.

(7) Ky seksion nuk cenon te drejten e dhene nga seksionet 93 dhe 94 te Aktit mbi Klauzolat e Tokes 1845 ose seksioni 8(2) dhe (3) i Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1965 (dispozita per ndarjen e tokes).

Efektet e
kunder-njoftimit
sipas s. 145

146.—(1) Ne qofte se autoriteti bleres brenda periudhes 2 mujore qe fillon me daten e dhenies se kunder-njoftimit sipas seksionit 145, nuk bie dakord me shkrim qe ka pranuar kunder-njoftimin si te vlefshem, kerkuesi ose autoriteti brenda 2 muajve pas mbarimit te asaj periudhe, duhet ta kalojne ceshtjen Gjykates se Tokave.

(2) Pas marrjes se ceshtjes Gjykata duhet te percaktoje nese kunder-njoftimi eshte i justifikuar dhe e deklaronte ate perkatesisht te vlefshem ose te pavlefshem.

(3) Kur nje kunder-njoftim pranohet si i vlefshem sipas nen-seksionit (1) ose deklarohet i vlefshem sipas nen-seksionit (2), autoriteti bleres do te konsiderohet si -

- (a) I autorizuar per te blere interesin e kerkuesit per token qe lidhet me kunder-njoftimin sipas te njejtës dispozita te ketij Kapitulli qe e autorizon per te blere pjesen tjeter te tokes bujqesore; dhe
- (b) Ka dhene njoftimin ne lidhje me te ne daten ne te cilen ka dhene njoftimin sipas kesaj dispozite.

(4) Kerkuesi mund te terheqe kunder-njoftimin ne cdo kohe perpara se vendimi per kompensim ne lidhje me blerjen e detyruar te percaktuar ne kunder-njoftim te jete marre nga Gjykata e Tokave ose ne cdo kohe perpara perfundimit te

periudhes 6 javore nga data e vendimit.

(5) Kur kunder-njoftimi terhiqet sipas nen-seksionit (4), cdo njoftim per blerje do te konsiderohet i terhequr.

(6) Pa cenuar nen-seksionin (5), njoftimi per blerje qe eshte bere ne baze te ketij seksioni, nuk mund te terhiqet sipas seksionit 31 te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961.

(7) Kompensimi per tu paguar per blerjen e interesit ne toke ne zbatim te nje njoftimi per blerje ne baze te ketij seksioni do te vleresohet me supozimet e permendura ne seksionin 5(2), (3) dhe (4) te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1973.

(8) Kur ne baze te ketij seksioni autoriteti bleres do te marre te drejten e nje qeraje por jo te interesit te qeradhenesit --

(a) autoriteti do ja leje qerane, qeradhenesit me kushte te tilla te cilat autoriteti i konsideron te aresyeshme;

(b) ceshtja se cfare eshte e aresyeshme mund t'i kaloje Gjykates se Tokave nga autoriteti ose qeramarresi, dhe ne qofte se ne fund te periudhes 3 mujore pasi u be oferta e permendur ne paragrafin (a) autoriteti dhe qeramarresi nuk kane rene dakord dhe qeramarresi nuk e ka kaluar ceshtjen tek Gjykata e Tokave, do te merren oferta e autoritetit;

(c) ne qofte se ceshtje eshte kaluar Gjykates se Tokave, qeramarresi do te konsiderohet qe --

(i) ka pranuar te dorezoje qerane brenda nje muaji nga data e vendimit te Gjykates, ose brenda nje date tjeter te caktuar nga Gjykata, dhe

(ii) ka rene dakord me autoritetin per kushtet e dorezimit qe Gjykata i konsideron te aresyeshme.

(9) Per qellime te nen-seksionit (8) cdo kusht per dorezim qe permbahet ne kontraten e qerases do te hidhet poshte.

(10) Kur qeradhenesi --

(a) refuzon te pranoje shumen qe do i paguhet sipas nen-seksionit (8), ose

(b) refuzon apo nuk i permbahet pjeses se tij te kushteve,

autoriteti mund t'i paguaje Gjykates shumen e pagueshme per qeradhenesin dhe seksioni 9(2) dhe (5) i Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1965 aplikohet per ate shume me modifikimet e nevojshme.

(11) Kur nje autoritet bleres qe merr te drejten e nje qeraje per nje toke sic permendet ne nen-seksionin (8), eshte nje grup i miratuar me ligj, fuqite e tij sipas miratimit do perfshine fuqi per te perdorur token si toke bujqesore.

Dispozita
suplementare te
s. 145 dhe 146.

147.—(1) Seksionet 145 dhe 146 aplikohen ne lidhje me blerje te interesave te tokes nga departamente te qeverise qe kane fuqi blerjeje te detyrueshme sic aplikohen per blerje interesi nga autoritete qe nuk jane departamente te qeverise.

(2) Ne seksionet 145 dhe 146 dhe ne kete seksion --

- "bujqesore" dhe "toke bujqesore" kane kuptimin e dhene ne seksionin 109 te Aktit mbi Bujqesine 1947 dhe referenca qe i behen punimit te tokes bujqesore perfshijne referenca per cdo aktivitet bujqesor;
- "njesi bujqesore" ka kuptimin e dhene nga seksioni 171(1);
- "autoritet bleres" ka te njejtin kuptim si ne Aktin mbi Kompensimin e Tokave 1961; dhe
- "departamente te qeverise qe kane fuqi blerese te detyrueshme" do te thote departamente te qeverise qe kane fuqi blerese sipas atij Akti.

Suplementare

Interpretime te
Kapitullit I

148.—(1) Ne kete Kapitull --

- "dispozitat e caktuara" do te thote --
 - (a) dispozitat e Pjeses IX, ose
 - (b) ne rastin e sipermarresve ligjor, cdo dispozite ligjore sipas se ciles ata kane fuqi ose mund te autorizohen, te blejne tokes me detyrim per qellime te sipermarrjes se tyre; dhe
- "sipermarres te ligjshem" perfshijne operator te telekomunikacionit publik.

(2) Ne rastin e njoftimeve per blerje te dhena nga persona te tilla te permendur ne nen-seksionin (2)(b) te Seksionit 127

tille te permendur ne nen-seksionin (2)(b) te Seksionit 137, referencat qe i behen ne kete Kapitull pronarit te tokes perfshijen referenca per keto personave.

KAPITULLI II:
INTERESA QE NDIKOHEN
NGA PROPOZIME PER PLANIFIKIM: DEMTIMI
(NGA PARAZITET BIMEVE, VRUGU APO URTHI)

Parathenie

Shtrirja
Kapitullit II

e 149.—(1) Ky Kapitull ka efekt ne lidhje me toke qe perfshihet ne te gjitha paragrafet e Skedules 13 (toke e ndikuar nga propozimet e planifikimit te autoriteteve publike etj.); dhe qe ne kete kapitull referohet si “toke e demtuar”.

(2) Sipas dispozitave te seksioneve 161 dhe 162, nje interes kualifikohet per mbrojtje sipas ketij Kapitulli ne qofte se —

(a) eshte nje interes ne nje trashegimi ose pjese e nje trashegimije dhe ne nje date te caktuar permbush nje nga kushtet e permendura ne nen-seksionin (3); ose

(b) eshte nje interes per nje njesi bujqesore ose pjese e nje njesie bujqesore dhe ne nje date te caktuar eshte interesi i nje pronari — perdoruesi te njesise;

dhe ne kete Kapitull ky interes quhet “interes i kualifikuar”.

(3) Kushtet e permendura ne nen-seksionin (2)(a) jane—

(a) qe vlera vjetore e trashegimit nuk kalon shumen e percaktuar per qellime te ketij paragrafi ne nje urdher te bere nga Sekretari i Shtetit, dhe interesi eshte i nje pronari-perdoruesi te trashegimise, ose

(b) ky interes eshte interesi i nje rezidenti pronar-perdorues te trashegimise.

(4) Ne kete seksion “date e caktuar” ne lidhje me nje interes, do te thote data e dhenies se njoftimit sipas seksionit 150.

(5) Ne kete Kapitull “njoftime demtimi” do te thote njoftime qe jepen sipas seksioneve 150, 161, ose 162.

Njoftime Demtimi

Njoftime qe
kerkojne blerjen
e tokes se
demtuar

150.—(1) Kur nje pjese apo e gjitha trashegimia ose njesia bujqesore pefshihet ne nje toke te demtuaar dhe nje person pretendon qe—

(a) ka te drejte per nje interes te kualifikuar per trashegimine ose njesine;

(b) ka bere perpjekje te aresyeshme ta shese kete interes; dhe

(c) si rrjedhim i faktit qe trashegimia ose njesia ose pjese e saj, ishte ose do te perfshihet ne token e demtuar, ai nuk ka mundur ta shese interesin, pervec se me nje cmim shume me te ulet qe mund te ishte shitur ne qofte se pjesa e trashegimise ose e njesise nuk do ishte perfshire ne kete toke,

ai mund t'i jape nje njoftim autoritetit perkates ne lidhje me interesin e nje pjese te trashegimise ose te njesise ne perputhje me kete Kapitull.

(2) Ne varesi te nen-seksionit (3), nen-seksioni (1) do te aplikohet ne lidhje me interesa ne nje pjese te trashegimise ose te njesise, sic aplikohet ne lidhje me interesin ne te gjitha trashegimise ose njesine.

(3) Nen-seksioni (2) nuk mund te aftesoje personin —

(a) qe ka interesin per te gjitha trashegimine ose njesine bujqesore, per te bere kerkese ose njoftim sipas ketij seksioni ne lidhje me interesin e tij; ose

(b) ne qofte se ka interes vetem per nje pjese te trashegimise ose njesise bujqesore, per te bere nje kerkese te tille ose njoftim ne lidhje me interesin qe eshte me pak se ai i gjitha pjeses.

(4) Ne kete Kapitull —

(a) ne varesi te seksionit 161(1), “kerkuesi”, ne lidhje me nje njoftim demtimi, eshte personi qe e dha ate njoftim, dhe

(b) cdo reference per interesin e kerkuesit, ne lidhje me nje njoftimin e demtimit eshte reference per interesin qe njoftimi kerkon te blihet nga autoriteti perkates sic permendet ne nen-seksionin (1).

Kunder-njoftime
qe
kundershtojne
njoftimet e
demtimit

151.—(1) Kur eshte dhene nje njoftim demtimi ne lidhje me nje trashegimiose njesi bujqesore, autoriteti perkates mund t'i jape kerkuesit nje kunder-njoftim ne nje format te caktuar qe kundershton njoftimin.

(2) Kundra-njoftimi sipas nen-seksionit (1) mund te jepet perpara mbarimit te periudhes 2 mujore nga data e dhenies se njoftimit.

(3) Nje kunder-njoftim i tille duhet te detajoje aresyet per te cilat autoriteti perkates kundershton njoftimin (nje ose me shume nga aresyet e detajuara ne nen-seksionin (4), ose ne seksionet 159(1), 161(5) ose 162(5)).

(4) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij Aktit, aresyet per kundershtimin e nje njoftimi te parashtruara ne nje kunder-njoftim sipas seksionit 150 jane —

(a) qe asnje pjese e trashegimise ose njesise bujqesore me te cilen lidhet njoftimi eshte perfshire ne token e demtuar;

(b) qe autoriteti perkates (pervec rasteve kur e ka te detyrueshme nga ky Kapitull) nuk propozon per blerjen e ndonje pjese te trashegimise, ose ne rastin e njesise bujqesore, ndonje pjese te zones se ndikuar, ne ushtrim te fuqive te tij;

(c) qe autoriteti perkates propozon te bleje nje pjese te trashegimise, ose ne rastin e njesise bujqesore, nje pjese te zones se ndikuar te detajuar ne kunder-njoftim, por (pervec rasteve kur e ka te detyrueshme nga ky Kapitull), nuk propozon te bleje ndonje pjese tjeter te asaj trashegimie, ose zone;

(d) ne rastin e tokes ne paragrafet 1, 3, ose 13, por jo 14, 15 ose 16 te Skedules (Aneksit) 13 autoriteti perkates nuk propozon te bleje ndonje pjese tetrashegimise, ose ne rastin e njesise bujqesore, ndonje pjese te zones se ndikuar gjate nje periudhe 15 vjecare nga data e dhenies se kunder-njoftimit ose per nje periudhe me te gjate qe fillon me daten e percaktuar ne kunder-njoftim;

(e) qe, ne daten e dhenies se njoftimit sipas seksionit 150, kerkuesi nuk zoteronte interesin per ate pjese te trashegimi ose njesie bujqesore te perfshire ne njoftim;

(f) qe (per aresye te dhena ne kunder-njoftim) interesi i kerkuesit nuk ishte interes i kualifikuar;

(g) qe kushtet e detajuara ne paragrafet (b) dhe (c) te seksionit 150(1) nuk jane permbushur.

(5) Kur nje miratim perkates jep fuqi per te blere te drejtat mbi token, nen-seksioni (4) do te kete efekt sikur —

(a) ne paragrafin (b) pas fjales “blerje” te vendosen fjale “ose blerje e te drejtave mbi”;

(b) fjale “nuk propozon per bjerje” zevendesohen nga fjale “nuk propozon as per blerje, as per blerjen e te drejtave mbi te”;

(c) ne paragrafin (d) pas fjaleve “zone e ndikuar” te vendosen fjale “ose te bleje te drejten mbi ndonje pjese te saj”.

(6) Kundershtim nuk mund te behet ne baze te paragrafit (d) te nen-seksionit (4), ne qofte se mund te behet per aresyen e permendur ne paragrafin (b) te atij nen-seksioni.

(7) Aresyet ne baze te te cilave mund te behet nje kundershtim ne nje kunder-njoftim ne baze te paragrafit 19 te Skedules 13, nuk perfshin ata te permendura ne nen-seksionin (4)(b) ose (c).

(8) Ne kete seksion “fuqi perkatese”, ne lidhje me nje zone te demtuar qe ben pjese ne secilin nga paragrafet e Skedules 13, do te thote fuqi sipas se cilen autoriteti perkates eshte ose mund te autorizohet per —

(a) blerjen e tokes ose blerjen e te drejtave mbi token, per toka brenda paragrafit; ose

(b) per blerjen e tokes ose blerjen e te drejtave mbi token, per qellime te caktuara;

dhe “qellime te caktuara”, ne lidhje me nje toke te tille, do te thote qellime, per te cilat, ne perputhje me rrethanat ne baze te te cilave toka perfshihet ne kete paragraf ne fjale, toka eshte caktuar te blihet.

152.—(1) Kur —

Kunder-njoftime
te metejsme ku
propozime te
vecanta kane
hyre ne fuqi

(a) nje autoritet perkates ka dhene nje kunder-njoftim qe kundershton nje njoftim demtimi ne lidhje me nje toke brenda paragrafeve 1, 2, 3, 4 ose 14 te Skedules (Aneksit) 13 ne baze te shenimit (1) te atij paragrafi, dhe

(b) plani perkates ose sipas rastit, urdheri perkates ose skema hyn ne fuqi (original ose me modifikime),

autoriteti perkates mund t'i jape kerkuesit nje kunder-njoftim te metejshe ne vend te kunder-njoftimit qe detajon aresyet e kundershimit.

(2) Nje kunder-njoftim te metejshe nuk duhet te behet -

(a) pas mbarimit te periudhes 2 mujore nga data kur plani perkates apo ndryshimet e tij kane hyre ne fuqi; ose

(b) ne qofte se kunder-njoftimi i dhene eshte terhequr, ose kur Gjykata e Tokave ka vendosur te mos marre parasysh kundershimit.

Kalime te kundershimeve ne Gjykatën e Tokave: e pergjithshme

153.—(1) Kur eshte bere nje kunder-njoftim sipas seksionit 151 qe kundershon nje njoftim demtimi, kerkuesi mund te kerkoje qe kundershimi te kalohet tek Gjykata e Tokave.

(2) Kjo gje, sipas nen-seksionit (1), mund te kerkohet ne cdo kohe brenda periudhes 2 mujore qe fillon me datën e dhenies se kunder-njoftimit.

(3) Kur i referohet Gjykates, ne qofte se kundershimi nuk terhiqet, Gjykata e Tokave duhet te shqyrtoje -

(a) ceshtjet e paraqitura ne njoftim nga kerkuesi; dhe

(b) aresyet e kundershimit te paraqitura ne kunder-njoftim;

dhe ne varesi te nen-seksionit (4), Gjykata do te mbeshtese kundershimit, me perjashtim te rasteve kur tregohet qe kundershimi nuk ka baza te mjaftueshme.

(4) Nje kundershim per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(b), (c) ose (d) nuk mund te mbeshtetet nga Gjykata ne qofte se, Gjykata nuk bindet qe kundershimi ka baza te mjaftueshme.

(5) Ne qofte se Gjykata vendos te mos e mbeshtese kundershimin, Gjykata duhet te nxjerre nje deklarate qe tregon se njoftimi qe u kundershua nga kunder-njoftimi eshte i vlefshem.

(6) Ne qofte se Gjykata e mbeshtet kundershimin, por vetem

per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), Gjykata duhet te deklaroje qe njoftimi eshte i vlefshem ne lidhje me pjesen e trashegimise, ose ne rastin e njesise bujqesore, me pjesen e saj te ndikuar, te specifikuar ne kunder-njoftim si pjese qe autoriteti perkates propozon per t'i blere, por jo ne lidhje me ndonje pjese tjeter te trashegimise ose te njesise.

(7) Ne nje rast sipas nen-seksioneve (5) ose (6), Gjykata duhet te udhezaje per datën ne te cilen do te zbatohet njoftimi.

(8) Ky seksion ka efekt me lidhje me nje kunder-njoftim te metejshe te bere ne baze te seksionit 152(1) sic ka efekt ne lidhje me kunder-njoftimin qe ka zevendesuar.

Efekte te njoftimeve te demtimit te vlefshme

154.—(1) Nen-seksioni (2) aplikohet kur eshte dhene nje njoftim demtimi dhe ose -

(a) nuk jepet asnje kunder-njoftim per ate njoftim ne perputhje me kete Kapitull; ose

(b) kur jepet nje kunder-njoftim i tille, kundershimi terhiqet ose pasi i kalohet Gjykates, hidhet poshte nga kjo Gjykate.

(2) Kur ky nen-seksion aplikohet, autoriteti perkates do te konsiderohet qe -

(a) eshte i autorizuar per blerje te detyrueshme sipas ligjit te interesit te kerkuesit per trashegimine, ose ne rastin e njesise bujqesore interesin e kerkuesit per zonen e ndikuar, dhe

(b) ka dhene njoftimin per zbatimin e tij ne datën e permendur ne nen-seksionin (3).

(3) Data e referuar ne nen-seksionin (2) -

(a) ne rastin kur pasi i kalohet Gjykates, Gjykata vendos te mos e mbeshtese kundershimin, eshte data e vendosur ne udhezimin e dhene nga Gjykata ne perputhje me seksionin 153(7);

(b) ne cdo rast tjeter, eshte data kur mbaron periudha 2 mujore nga data e njoftimit.

(4) Nen-seksioni (5) aplikohet kur autoriteti perkates ka bere nje kunder-njoftim qe kundershon njoftimin e demtimit per aresyet e permendura ne nen-seksionin 151(4)(c) dhe ose -

(a) kerkuesi, pa i kaluar kundershimin Gjykates se Tokave, dhe perpara mbarimit te kohes per te bere nje kalim te tille -

- (i) njofton autoritetin perkates qe pranon propozimin e autoritetit per te blere pjese te trashegimise ose te nje zone te ndikuar sipas kunder-njoftimit, dhe
 - (ii) terheq kerkesen e tij per pjesen qe mbetet nga trashegimise ose zones se ndikuar; ose
- (b) pasi i kalon Gjykates se Tokave, Gjykata deklaron ne perputhje me seksionin 153(6) per ate pjese te trashegimise ose te zones se ndikuar.

(5) Kur aplikohet ky nen-seksion, autoriteti perkates do te konsiderohet qe—

- (a) eshte i autorizuar ne baze te ligjit per te blere interesin e kerkuesit per pjesen e trashegimise ose zones se ndikuar qe perfshihet ne kunder-njoftim, dhe
- (b) qe kane dhene njoftimin qe do zbatojne nje gje te tille ne daten e permendur ne nen-seksionin (6).

(6) Data qe i referohet nen-seksioni (5) eshte —

- (a) per rastet e paragrafit (a) te nen-seksionit (4), data ne te cilen jepet njoftimi ne perputhje me ate paragraf; dhe
- (b) per rastet e paragrafit (b) te atij nen-seksioni, eshte data e percaktuar ne udhezimin e dhene nga Gjykata e Tokave ne perputhje me seksionin 153(7).

Ndikimi ne fuqite e blerjeve detyrueshme te kunder-njoftimit qe hedh poshte qellimin per te blere.

155.—(1) Nen-seksioni (2) do te kete efekt kur aresyet e kundershimit ne nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit 151 konsistojne ne ose perfshijne aresyet e permendura ne paragrafin (b) ose (d) te nen-seksionit (4) te atij seksioni dhe ose —

- (a) kundershimi per aresyet e permendura ne ate paragraf eshte kaluar tek Gjykata, dhe mbeshtetur nga ajo; ose
- (b) ka mbaruar koha e mundshme per te kaluar kundershimit tek Gjykata e Tokave per shqyrtim dhe vendim.

(2) Ne qofte se —

- (a) nje urdher blerje te detyrueshme eshte bere sipas ligjit ne lidhje me token qe konsiston ose

- perfshihet teresisht apo pjeserisht ne nje trashegimi ose njesi bujqesore, me te cilen lidhet nje kunder-njoftim, ose
- (b) toka ne fjale bie ne paragrafin 21 te Skedules (Aneksit) 13,

cdo fuqi e dhene nga ky urdher, ose sipas rastit nga nje ligj i vecante per blerjen e detyruar te interesit te kerkuesit nuk do te kete me efekt.

(3) Nen-seksioni (4) do te kete efekt kur aresyet e kundershimit te detajuara ne kunder-njoftim sipas seksionit 151 konsistojne ne ose perfshijne aresyet e permendura ne paragrafin (c) te nen-seksionit (4) te atij seksioni dhe ose —

- (a) kundershimi per aresyet e permendura ne ate paragraf eshte kaluar ne Gjykate dhe ajo e ka mbeshtetur, ose
- (b) ka mbaruar koha brenda se ciles kalimi i kundershimit ne Gjykate eshte i mundur;

dhe ne nen-seksionin (4) me poshte, cdo reference per “pjesen e trashegimise ose te zones se ndikuar qe nuk kerkohet” eshte reference per te gjitha trashegimise ose zonen pervec pjeses se detajuar ne kunder-njoftim si pjese te cilen autoriteti perkates propozon per te blere ne kunder-njoftim.

(4) Ne qofte se—

- (a) nje urdher blerje e detyrueshme eshte bere sipas miratimit perkates ne lidhje me token qe konsiston ne ose perfshin ndonje pjese te trashegimise ose zones se ndikuar qe nuk kerkohet, ose
- (b) toka ne fjale perfshihet ne paragrafin 21 te Skedules (Aneksi) 13,

cdo fuqi e dhene nga ky urdher, ose nga nje miratim i vecante per blerjen e detyrueshme te interesit te kerkuesit per ate toke qe perfshihet ne pjesen e trashegimise ose zones se ndikuar qe nuk kerkohet, nuk do te kete me efekt.

Terheqje e njoftimeve te demtimit

156.—(1) Ne varesi te nen-seksionit (3), personi qe ka bere nje njoftim demtimi, mund ta terheqe njoftimin ne cdo kohe perpara se kompensimi te behet i pagueshem ne lidhje me nje blerje te detyrueshme sipas nje njoftimi qe eshte vendosur nga Gjykata e Tokave ose, ne qofte se eshte marre nje vendim i tille perpara mbarimit te periudhes 6 mujore nga data e vendimit.

(2) Kur nje njoftim terhiqet ne baze te nen-seksionit (1) cdo njoftim per ta zbatuar i bere si rrjedhim i tij do te konsiderohet si i terhequr.

(3) Nje person ka te drejte ne baze te nen-seksionit (1) te terheqe njoftimin pasi autoriteti perkates ka ushtruar te drejten e marrjes ne pronesi te tokes sipas njoftimit te zbatimit te dhene si rrjedhim i ketij njoftimi.

(4) Nuk paguhet kompensim ne lidhje me terheqjen e njoftimit per zbatim qe duhet te terhiqej sipas nen-seksionit (2).

Kompensimi

157.—(1) Kur -

- (a) blihet nje interes i tokes sipas nje njoftim demtimi, dhe
- (b) interesi lidhet me nje urdher per blerje te detyrueshme ne fuqi sipas seksionit 1 te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981, sic aplikohet nga seksioni 47, i Aktit mbi Planifikimin 1990, qe permban nje udhezim per nje kompensim minimal sipas seksionit 50 te Aktit te vitit 1990,

kompensimi i pagueshem per blerje do te caktohet ne perputhje me ate udhezim dhe sikur njoftimi per ta zbatuar blerjen qe duhej te ishte dhene ne lidhje me interesin sipas seksionit 154 eshte dhene ne perputhje me urdherin e blerjes se detyrueshme.

(2) Kur -

- (a) eshte blere nje interes mbi token ne zbatim te nje njoftimi demtimi, dhe
- (b) interesi lidhet me nje urdher blerjeje te detyrueshme sipas seksionit 209 te Aktit mbi Strehimin 1985;

kompensimi i pagueshem per blerje do te caktohet ne perputhje me ate Akt dhe sikur njoftimi per ta zbatuar blerjen qe duhej te ishte dhene ne lidhje me interesin sipas seksionit 154 eshte dhene ne perputhje me urdherin e blerjes se detyrueshme.

(3) Kompensimi i pagueshem ne lidhje me nje blerje sipas

Dispozita te vecanta per kompensime per blerje ne perputhje me njoftimet e demtimit.

seksionit 160 te interesit te tokes qe pershihet ne -

- (a) zone te pandikuar te nje njesie bujqesore; ose
- (b) ne qofte se autoriteti perkates ka dhene nje kunder-njoftim qe kundershton nje njoftim demtimi per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), per zonen e ndikuar sic specifikohet ne kunder-njoftim,

do te percaktohet me supozimet e permendura ne seksionin 5(2), (3), dhe (4) te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1973.

(4) Ne nen-seksionin (3) kur i referohet "autoritetit perkates" do te merret sikur zona e pandikuar e nje njesie bujqesore eshte pjese e zones se ndikuar.

Dispozita te vecanta per te kerkuar blerjen pjeserisht apo teresisht te zones se ndikuar te nje njesie bujqesore

Perfshirje ne njoftime demtimi te kerkesave per blerje te pjeseve te pandikuara nga demtimi te njesive bujqesore.

158.—(1) Ky seksion aplikohet kur -

- (a) eshte bere nje njoftim demtimi ne lidhje me interesin e nje pjese apo te gjithe njesise bujqesore, dhe
- (b) ne daten e dhenies se njoftimit ajo njesi ose pjese a saj permbanin toke ("zone e pandikuar") qe nuk ishte demtuar, si dhe toke ("zona e ndikuar") te tille.

(2) Kur aplikohet ky seksion kerkuesi mund te perfshije ne njoftimin e demtimit -

- (a) nje deklarate qe tregon se zona e pandikuar nuk eshte e mire per t'u punuar, ose me vete ose ne lidhje me toke tjeter, si nje njesi bujqesore e ndare; dhe
- (b) nje kerkese qe autoriteti perkates te bleje interesin e tij per te gjithe njesine, ose sipas rastit per te gjithe pjesen me te cilen lidhet njoftimi.

(3) Ne varesi te nen-seksionit 159(4), "toke tjeter e caktuar" ne nen-seksionin (2) do te thote -

- (a) pjesa qe mbetet e njesise, ne qofte se eshte dhene njoftim demtimi ne lidhje me nje pjese te tokes se perfshire ne njesine bujqesore, dhe
- (b) toke qe permbahet ne nje njesi bujqesore tjeter te perdorur nga kerkuesi ne daten e dhenies

se njoftimit dhe ne lidhje me te cilen ai ka te drejten e interesit te pronarit sic perkufizohet ne seksionin 168(4).

Kundershtimi
njoftimeve te s.
158.

159.—(1) Aresyet mbi te cilat mbeshtetet kundeshkrimi ne nje kunder-njoftim te nje njoftimi demtimi te bere ne baze te seksionit 158 do te perfshije aresye per te cilat kerkesa ne njoftim nuk justifikohet.

(2) Nuk duhet te kundershkrohet nje njoftim demtimi i bere sipas seksionit 158 per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), pervec rasteve kur eshte bere gjithashtu per aresyet e permendura ne nen-seksionin (1).

(3) Gjykata e Tokave nuk duhet te mbeshtese nje kundeshkrim per nje njoftim te bere ne baze te seksionit 158 per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), pervec rasteve kur mbeshtet kundeshkrimin gjithashtu per aresyet e permendura ne nen-seksionin (1).

(4) Kur eshte bere kundeshkrim per nje njoftim demtimi sipas seksionit 158 per aresyet e permendura ne nen-seksionin (1) dhe gjithashtu per ata te permendura ne 151(4)(c), Gjykata e Tokave, gjate marrjes se vendimit per te mbeshtetur ose hedhur poshte kundeshkrimin, do ta konsideroje ate pjese te zones qe nuk eshte perfshire ne kunder-njoftim si te perfshire ne "toke tjeter te caktuar" sic perkufizohet ne seksionin 158(3).

(5) Ne qofte se Gjykata e Tokave mbeshtet kundeshkrimin, por vetem per aresye te permendura ne nen-seksionin (1), Gjykata do te deklaraje qe njoftimi demtimit eshte i vlefshem ne lidhje me zonen e ndikuar por jo ne lidhje me zonen e pandikuar.

(6) Ne qofte se Gjykata e mbeshtet kundeshkrimin per aresye te permendura ne nen-seksionin (1) dhe gjithashtu per aresye te permendura ne seksionin 151(4)(c) (por jo per aresye te tjera), Gjykata duhet te deklaraje qe njoftim eshte i vlefshem me pjesen e ndikuar te zones qe specifikohet ne kundernjoftim si pjese qe autoriteti perkates propozon te bleje sic permendet ne ate njoftim, por jo ne lidhje me ndonje pjese tjeter te zones se ndikuar ose ne lidhje me zonen e pandikuar.

(7) Ne rastet e nen-seksioneve (5) ose (6), Gjykata duhet te udhezaje per daten ne te cilen duhet dhene njoftimi per

zbatim sic permendet ne seksionet 154 dhe 160.

(8) Seksioni 153(6) nuk do te aplikohet per ndonje njoftim demtimi te dhene ne baze te seksionit 158.

Ndikime te
njoftimit te
dhene ne baze te
s. 158

160.—(1) Ne lidhje me nje njoftim demtimi te bere ne baze te seksionit 158 –

(a) nen-seksioni (2) i seksionit 154 do te kete efekt sikur fjaltet "ose ne rastin e njesise bujqesore interesi i kerkesit per zonen e ndikuar" te zevendesohen me fjaltet "ose njesia bujqesore"; dhe

(b) nen-seksionet (4) dhe (5) te atij seksioni nuk aplikohen ne nje njoftim demtimi te tille.

(2) Kur autoriteti perkates ka dhene nje kunder-njoftim qe kundershkon nje njoftim demtimi per aresyet e permendura ne seksionin 159(1), atehere ne qofte se, ose –

(a) kerkesi, pa e kaluar kundeshkrimin tek Gjykata e Tokave dhe perpara se te mbaroje koha per t'a kaluar, njofton autoritetin perkates qe e terheq kerkesen e tij per zonen e pandikuar; ose
(b) pasi i kalohet Gjykates, Gjykata ben deklaraten ne perputhje me seksionin 159(5),

autoriteti perkates duhet te konsiderohet –

(i) i autorizuar per blerje te detyrueshme te tokes sipas miratimeve perkatese, te interesit te kerkesit per zonen e ndikuar (por jo per zonen e pandikuar), dhe

(ii) qe ka dhene njoftimin per te zbatuar njoftimin ne daten e permendur ne nen-seksionin (3).

(3) Data e referuar ne nen-seksionin (2) –

(a) ne rastet qe perfshihen ne paragrafin (a) te nen-seksionit (2), eshte data ne te cilen eshte dhene njoftimi ne perputhje me ate paragraf; dhe

(b) ne rastet qe perfshihen ne paragrafin (b) te atij nen-seksioni, eshte data e dhene ne udhezimet e Gjykates ne perputhje me seksionin 159(7).

(4) Kur autoriteti perkates ka dhene nje kunder-njoftim qe kundershkon nje njoftim demtimi per aresyet e permendura ne 159(1) dhe gjithashtu per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), atehere ne qofte se, ose

- (a) kerkuesi, pa ja kaluar ceshtjen Gjykates se Tokave dhe perpara se te mbaroje koha per te bere nje gje te tille—
- (i) njofton autoritetin perkates qe e pranon propozimin e autoritetit per blerjen e pjeses se ndikuar te specifikuar ne kunder-njoftim, dhe
- (ii) terheq kerkesen e tij per pjesen qe mbetet te zones, apo zones se pandikuar; ose
- (b) pasi i kalohet ceshtja Gjykates, Gjykata ben deklarate ne perputhje me seksionin 159(6) ne lidhje me ate pjese te zones se ndikuar,
- autoriteti perkates do te konsiderohet si i autorizuar per te blere sipas miratimeve perkates interesin e kerkuesit per pjesen e ndikuar te zones te specifikuar ne kunder-njoftim (por jo per ndonje pjese tjeter ose per zonen e pandikuar) dhe qe jep njoftimin per zbatim te saj ne daten e permendur ne nen-seksionin (5).

(5) Data e referuar ne nen-seksionin (4) –

- (a) ne rastet qe perfshihen ne paragrafin (a) te atij nen-seksioni, eshte data ne te cilen eshte bere njoftimi ne perputhje me ate paragraf; dhe
- (b) ne rastet qe perfshihen ne paragrafin (b) te atij nen-seksioni, eshte data e specifikuar ne udhezime te dhena nga Gjykata ne perputhje me seksionin 159(7).

(6) Ne lidhje me nje njoftim demtimi te dhene ne baze te seksionit 158 referenca qe i behen "autoritetit perkates" dhe: miratimeve perkatese" do te merren sikur zona e pandikuar e njesise bujqesore eshte pjese e zones se ndikuar.

Perfaqesues personal, hipoteka dhe partneritete

Fuqite e perfaqesuesve personale ne lidhje me njoftime demtimi

161.—(1) Ne lidhje me cdo kohe pas vdekjes se nje personi i cili ka bere nje njoftim demtimi, seksionet 151(1), 152(1), 153(1), 154(4) dhe (5), 156(1) dhe 160(2) dhe (4) do te aplikohen ne lidhje me perfaqesuesin personal te kerkuesit, njesoj si me kerkuesin vete.

(2) Kur e gjithë ose nje pjese e nje trashegimie ose njesie bujqesore eshte perfshire ne nje zone te demtuar dhe nje person deklaron qe –

- (a) ai eshte perfaqesues personal in nje personi

- ("te vdekur") qe ne daten e vdekjes kishte te drejten e interesit mbi ate trashegimi apo njesi;
- (b) interesi do ishte interes i kualifikuar ne qofte se do ishte bere nje njoftim sipas seksionit 150 ne lidhje me te ne ate date;
- (c) ai ka bere perpjekje te aresyeshme per te shitur interesin;
- (d) si rrjedhim i faktit qe trashegimia ose njesia ose nje pjese e saj, ishte perfshire ne nje zone te demtuar, ai e kishte te pamundur te shese interesin pervec se me nje cmim shume me te ulet si cmimi qe kishte menduar ta shese ne qofte se asnje pjese e trashegimise ose e njesise do perfshihej ne ate zone; dhe
- (e) nje ose me shume individe kane te drejten mbi interesin,

ai mund te njoftoje autoritetin perkates me nje njoftim ne nje format te caktuar, qe i kerkon autoritetit te bleje interesin ne perputhje me kete Kapitull.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), nen-seksioni (2) aplikohet ne lidhje me nje interes ne nje pjese te trashegimise ose njesise bujqesore sic aplikohet ne lidhje me nje interes ne te gjithë trashegimine ose njesine bujqesore.

(4) Nen-seksioni (3) nuk do t'a aftesoje personin per –

- (a) ne rastet kur i vdekuri zoteronte interes per te gjithë trashegimine ose njesin bujqesore, per te kerkuar ose dhene nje njoftim sipas ketij seksioni ne lidhje me interesin e te vdekurit per nje pjese te trashegimise ose njesise; ose
- (b) ne qofte se i vdekuri zoteronte interes vetem per nje pjese te trashegimise ose te njesise bujqesore, per te kerkuar ose dhene nje njoftim sipas ketij seksioni ne lidhje me interesin e te vdekurit per nje pjese me te vogel se pjesa qe ka zoteruar.

(5) Ne varesi te seksioneve 151(7) dhe 159(2) dhe (3), aresyet ne baze te te cilave behen kundershkrimet sipas seksionit 151 per nje njoftim sipas ketij seksioni jane ata te specifikuara ne paragrafet (a) deri me (c) te nen-seksionit (4) te atij seksioni dhe, ne rastin per te cilin aplikohet, aresyet e specifikuara ne paragrafin (d) te atij nen-seksioni dhe gjithashtu per aresyet e meposhtme –

- (a) qe kerkuesi nuk eshte perfaqesuesi personal i te vdekurit, ose qe ne daten e vdekjes, i vdekuri nuk zoteronte interes ne ndonje pjese te trashegimiose njesise bujqesore me te cilen lidhet njoftimi;
- (b) qe (per aresye te dhena ne kunder-njoftim) interesi i te vdekurit nuk eshte i tille sic eshte specifikuar ne nen-seksionin (2)(b);
- (c) qe kushtet e specifikuara ne nen-seksionin (2)(c), (d) ose (e) nuk jane permbushur.

Fuqia e penlensesy per te dhene njoftim demtimi

162.—(1) Kur e gjitha ose nje pjese e trashegimiose njesise bujqesore perfshihet ne nje zone demtimied dhe nje person deklaron qe -

- (a) ai ka te drejte si penglenes te shese interesin qe ka ne nje trashegimiose njesi, meqe toka nuk ka pronar;
- (b) ai ka bere perpjekje te aresyeshme per te shitur interesin; dhe
- (c) si rrjedhim i faktit qe hereditamenti ose njesia, ose nje pjese e saj eshte perfshire ne nje zone demtimied, ai nuk ka mundur ta shese interesin, pervec se me nje cmim shume me te ulet se cmimi me te cilin ai mendonte ta shiste sikur asnje pjese e tokes nuk do te ishte e perfshire ne nje zone te tille,

atehere, ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, ai mund t'i jape autoritetit perkates njoftimin ne nje forme te caktuar, qe kerkon autoritetin te bleje interesin ne perputhje me kete Kapitull.

(2) Ne varesi te nen-seksionit (3), nen-seksioni (1) do te aplikohet ne lidhje me nje interes per nje pjese te trashegimiose njesise bujqesore, sic aplikohet ne lidhje me interesin per te gjitha trashegimiose njesine.

(3) Nen-seksioni (2) nuk mund te aftesoje nje person -

- (a) ne qofte se interesi i tij si penglenes eshte per te gjitha trashegimie apo njesine bujqesore, per te bere kerkese apo njoftim sipas ketij seksioni ne lidhje vetem me nje pjese te trashegimise ose njesise; ose
- (b) ne qofte se interesi i tij si penglenes eshte per nje pjese te trashegimise ose njesise; per te bere kerkesen ose njoftim sipas ketij seksioni

ne lidhje me nje pjese me te vogel se e gjithe pjesa e tij.

(4) Njoftimi sipas ketij seksioni nuk duhet te behet, pervec ne qofte se interesi qe penglenesi deklaron ka autorizim ta shese-

- (a) mund te jete varur nga nje njoftim i dhene sipas seksionit 150 nga personi qe ka interesin ne daten e dhenies se njoftimit; ose
- (b) mund te varet nga nje njoftim te bere nga ky person ne nje date jo me shume se 6 muaj perpara dates se dhenies se njoftimit sipas ketij seksioni.

(5) Ne varesi te seksioneve 151(7) dhe 159(2) dhe (3), aresyet mbi te cilat mund te behen kundershime ne nje kunder-njoftim sipas seksionit 151, nje njoftimi sipas ketij seksioni jane ato te specifikuara ne paragrafet (a) deri (c) te nen-seksionit (4) te atij seksioni dhe, ne rastet per te cilat aplikohet, aresyet e specifikuara ne paragrafin (d) te atij nen-seksioni, si dhe aresyet e meposhtme -

- (a) qe, ne daten e dhenies se njoftimit sipas ketij seksioni, kerkuesi nuk kishte interes si penglenes ne ndonje pjese te trashegimise ose njesise bujqesore me te cilen lidhet njoftimi;
- (b) qe (per aresye te specifikuara ne kunder-njoftim) kerkuesi nuk kishte ne ate date fuqine e permundur ne nen-seksionin (1)(a);
- (c) qe kushtet e specifikuara ne nen-seksionin (1)(b) dhe (c) nuk jane permbushur;
- (d) qe (per aresye te specifikuara ne kunder-njoftim) asnjeri nga kushtet e specifikuara ne nen-seksionin (4) ishte permbushur ne daten e njoftimit, ne lidhje me interesin e referuar ne ate nen-seksion.

Ndalimi i dhenies se njekoheshme te njoftimeve sipas ss. 150, 161 dhe 162.

163.—(1) Asnje njoftim duhet te behet sipas seksionit 150 ose 161 ne lidhje me nje trashegimi ose njesi bujqesore, ose nje pjese te saj, kur eshte bere perpara nje njoftim sipas seksionit 162, dhe asnje njoftim duhet te behet sipas seksionit 162 kur ekziston nje njoftim sipas seksioneve 150 ose 161 ne lidhje me nje trashegimi perkatese apo njesi.

(2) Per qellime te nen-seksionit (1), njoftimi per zbatim do te merret si ekzistues ne lidhje me nje trashegimi, njesi ose pjese—

- (a) derisa te terhiqet ne lidhje me trashegimine, njesine, ose pjesen; ose
- (b) ne rastin kur eshte bere nje kundershkrim ne lidhje me njoftimin sipas seksionit 151, derisa ose -
 - (i) ka mbaruar periudha 2 mujore e specifikuar ne seksionin 153 dhe kerkuesi qe ka bere kundershkrimin nuk e ka kaluar ceshtjen ne Gjykaten e Tokave; ose
 - (ii) kundershkrim, pasi eshte kaluar ne Gjykate, eshte mbeshetur nga Gjykata ne lidhje me trashegimine ose njesine.

Dispozita te vecanta per partneritetet

164.—(1) Ky seksion ka efekt per qellime te aplikimeve te ketij Kapitulli ne trashegimine ose njesi bujqesore te perdorura per qellime te nje firme partneriteti.

(2) Perdorime per qellime te firmes do te merren si perdorime nga firma, dhe jo perdorime nga nje ose me shume partnere ne vecanti, dhe perkufizimi i "pronar-perdorues" ne seksionin 168(1) dhe (2) do te aplikohet ne lidhje me firmen perkatesisht.

(3) Ne qofte se, pasi firma jep nje njoftim demtimi, ndodh ndonje ndryshim ne perberjen e firmes (me vdekjen ose per ndonje arsye tjeter), cdo e drejte, detyrim, per njoftimin do te ushtrohet nga partneret qe ne ate moment perbejne firmen.

(4) Ne kete Kapitull, asgje nuk duhet te merret si veprim per te perjashtuar perkufizimin e "personit" ne Skedulen 1 te Aktit mbi Interpretimet 1978 [1978 c.30] (nga i cili "person" perfshin nje trup ose grup personash te mbledhur ne korporate ose jo) ne lidhje me ndonje dispozite te ketij Kapitulli.

(5) Nen-seksioni (2) nuk duhet te ndikojte perkufizimin e "rezident pronar-perdorues" ne seksionin 168(3).

Dispozita suplementare dhe te perziera

Fuqia e Sekretarit te Shtetit te bleje

165.—(1) Kur eshte dhene nje njoftim demtimi ne lidhje me toke brenda paragrafeve 7, 8, pse 9 te Skedules 13, atehere derisa te krijohet korporata e zhvillimit per qytetin e ri, ose

toke te ndikuar nga urdhera qe lidhen me qytetet e reja etj., kur eshte dhene njoftimi per demtim.

korporata e zhvillimit urban per nje zone urbane zhvillimi, Sekretari i Shtetit do te kete fuqine blerese te detyrueshme per ndonje interes toke ne zbatim te nje njoftimi demtimi te bere ne baze te atij paragrafi.

(2) Kur Sekretari i Shtetit blen nje interes sipas nen-seksionit (1), atehere -

(a) ne qofte se toka eshte ose behet toke brenda paragrafit 8 ose paragrafit 9(b) te Skedules (Aneksi) 13, interesi duhet ti kalohet korporates se zhvillimit per qytetin e ri ose korporates se zhvillimit urban per zonen urbane te zhvillimit; dhe

(b) ne cdo rast tjeter, interesi mund te kalohet ne cfaredo menyre qe ai e konsideron te pershtatshme.

(3) Akti mbi Kompensimin e Tokave 1961 do kete efekt ne lidhje me kompensimet e pagueshme ne lidhje me blerjen e nje interesi nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (1), sikur -

(a) blerja te jete bere nga nje korporate zhvillimi sipas Aktit te Qyteteve te Reja 1981, ose nga nje korporate e zhvillimit urban sipas Pjeses XVI te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Tokat 1980;

(b) ne rastin e tokes brenda paragrafit 7 te Skedules 13, toka te ishte pjese e nje zone e caktuar si zone per ndertimin e nje qyteti te ri me nje urdher qe ka hyre ne fuqi sipas seksionit 1 te Aktit mbi Qytetet e Reja 1981; dhe

(c) ne rastin e tokes brenda paragrafit 9(a) te Skedules 13, toka te ishte pjese e nje zone te caktuar si zone e zhvillimit urban me nje urdher sipas seksionit 134 te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Tokat 1980 qe ka hyre ne fuqi.

Ruajtja e te drejtave te kerkuesit per te shitur te gjitha trashegimine

166.—(1) Dispozitat e seksioneve 151(4)(c), 153(6), 154(4) dhe (5) dhe 155(3) dhe (4) qe lidhen me trashegimi nuk do ndikojne ne -

(a) te drejten e kerkuesit sipas seksionit 92 te Aktit mbi Konsolidimin e Klauzolave te Tokes 1845, per te shitur te gjitha trashegimine ose ne rastin e njesise bujqesore te gjitha token e ndikuar, te cilen i ka kerkuar autoritetit te ja

bleje; ose

- (b) te drejten e kerkuessit sipas seksionit 8 te Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1965 per te shitur (pervec rasteve kur vendos ndryshe Gjykata) te gjithë trashëgimie ose ne rastin e njesise bujqesore te gjithë token e ndikuar, te cilen ja ka kerkuar autoritetit te ja bleje.

(2) Ne perputhje me nen-seksionin (1)(b), per marrjen e vendimit nese te mbeshtese apo te hedhe poshte nje kundershtrim ne lidhje me nje trashëgimi per aresyet e permendura ne seksionin 151(4)(c), Gjykata e Tokave duhet te marre parasysh (pervec ceshtjeve qe ka per detyre te marre parasysh) nese—

- (a) ne rastin e nje shtepie, ndertese ose fabrike, pjese e propozuar per t'u blere mund te merret pa demtuar shtepine, ndertesën, ose fabriken; ose
- (b) ne rastin e nje parku ose kopeshti qe i perket nje shtepie, pjese e propozuar per tu blere mund te merret pa ndikuar ne rehatin e shtepise.

167. Pa cenuar dispozitat e seksioni 156(1) dhe (2), njoftimi per te zbatuar qe mund te ishte dhene ne baze te ketij Kapitulli, nuk mund te terhiqet sipas seksionit 31 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961.

168.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, ne kete Kapitull "pronar-perdorues", ne lidhje me nje trashëgimi, do te thote—

- (a) nje person qe perdor te gjithë apo nje pjese te madhe te trashëgimise me te drejten e dhene nga pronari, dhe e ka perdorur trashëgimie ose ate pjese te saj gjate gjithë periudhes 6 mujore perpara dhenies se njoftimit; ose
- (b) ne qofte se nje pjese e madhe ose e gjithë trashëgimia, eshte perdorur per nje periudhe jo me te gjate se 12 muaj perpara asaj date, nje person qe perdori trashëgimie, ose nje pjese te saj gjate periudhes 6 mujore qe mbaron menjehere kur fillon periudha qe nuk perdorej.

(2) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni,

Kuptimi i
"pronar-
perdorues" dhe
"rezident
pronar-
perdorues"

"pronar-perdorues" ne lidhje me nje njesi bujqesore, do te thote nje person qe —

- (a) perdor te gjithë ate njesi ose qe e ka perdorur gjate te gjithë periudhes 6 mujore perpara dates se dhenies se njoftimit; ose
- (b) perdori te gjithë njesine gjate te gjithë periudhes 6 mujore qe mbaron me jo me vone se 12 muaj nga data e njoftimit,

dhe, gjate gjithë kohes se duhur per qellimet e paragrafeve (a) ose (b) ka patur te drejten e interesit te pronarit ne te gjithë ose nje pjese te njesise.

(3) Ne kete Kapitull "rezident pronar-perdorues", ne lidhje me nje trashëgimi, do te thote —

- (a) nje individ qe perdor te gjithë ose nje pjese te madhe te trashëgimise si banese private dhe qe e perdor trashëgimie ose nje pjese te saj gjate te gjithë periudhes 6 mujore perpara dates se dhenies se njoftimit; ose
- (b) ne qofte se e gjithë ose nje pjese e konsiderueshme e trashëgimise nuk perdorej per nje periudhe jo me te gjate se 12 muaj perpara dates se njoftimit, individi qe e ka perdorur kete trashëgimi ose, gjate nje periudhe te plote 6 mujore perpara periudhes qe nuk u perdor.

(4) Ne kete seksion —

- "interesi i pronarit" ne lidhje me nje trashëgimi ose njesi bujqesore, do te thote interesi ne te ose nje qeramarrje e dhene ose e zgjatur per vite te tera, dhe jo me pak se tre vite mbesin ne kohen e dhenies se njoftimit; dhe
- "date e njoftimit", ne lidhje me nje trashëgimi ose njesi bujqesore, eshte data e dhenies se njoftimit ne lidhje me seksionin 150.

"Autoriteti
perkates" per
qellime te
Kapitullit II.

169.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, ne kete Kapitull "autoritet perkates", ne lidhje me nje toke, do te thote departamenti i qeverise, autoriteti lokal ose ndonje grup tjetër ose person, i cili, ne perputhje me rrethanat ne te cilat toka perfshihet ne Skedulen 13, eshte pergjegjes per blerjen e tokes qe do shitet ose qe propozohet te shitet, ose sipas rastit, per blerjen e ndonje te drejte mbi token.

token.

(2) Ne qofte se ngrihen ceshtjet e meposhtme -

- (a) nese autoriteti perkates ne lidhje me ndonje toke per qellime te ketij Kapitulli, eshte Sekretari i Shtetit apo autoriteti lokal i autostradave; ose
- (b) cili nga dy ose me shume autoritete lokale te autostradave ne lidhje me nje toke eshte autoriteti perkates; ose
- (c) cili nga dy ose me shume autoritetet lokale eshte autoriteti perkates ne lidhje me nje toke,

keto ceshtje duhet t'i kalohen Sekretarit te Shtetit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar.

(3) Ne qofte se ngrihen ceshtje se kush eshte autoriteti perkates per qellime te ketij Kapitulli -

- (a) seksioni 151(2) do te kete efekt sikur referenca per daten e njoftimit te demtimit te jete reference per ate date ose ne qofte se me vone, per daten ku vendoset ceshtja;
- (b) seksioni 162(4)(b) do te aplikohet me zevendesimi e nje periudhe 6 mujore ne reference per nje periudhe me te gjate derisa te zgjidhet ceshtja ne fjale; dhe
- (c) seksioni 168(1)(b), (2)(b) dhe (3)(b) do te aplikohet me zevendesimin e nje periudhe 12 mujore perpara dates se dhenies se njoftimit me nje periudhe me te gjate derisa te vendoset ceshtje ne fjale.

(4) Ne lidhje me toke qe bie ne paragrafet 7, 8, ose 9 te Sekdules 13, derisa te formohet korporata e zhvillimit per nje qytet te ri, ose, sipas rastit, korporata e zhvillimit urban per nje zone zhvillimi urbane, ky Kapitull do kete efekt sikur "autoriteti perkates" te ishte Sekretari i Shtetit.

(5) Ne lidhje me toke qe bie ne paragrafet 19 te Skedules (Aneksit) 13, "autoriteti perkates" do te jete autoriteti i autostradave per autostrada ne lidhje me te cilat eshte dhene nje urdher i permendur ne ate paragraf.

"Miratime perkatese" per qellime te

170.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, ne kete Kapitull "miratim perkates", ne lidhje me nje toke qe bie ne paragrafet e Skedules (Aneksi) 13, do te thote

Kapitulit II.

nje miratim i cili siguron blerjen e detyrueshme te tokes si toke ne ata paragrafe, ose ne lidhje me paragrafin 22(b), miratimi sipas se cilave eshte bere nje urdher per blerje te detyrueshme.

(2) Per toka qe bien brenda paragrafeve 2, 3, ose 4 te asaj Skedule, miratimi per qellime te nen-seksionit (1) do te merret si miratim qe siguron blerje te detyrueshme te tokes si toke ne keto paragrafe ne qofte se -

- (a) miratimi ben te mundur blerjen e detyrueshme te tokes per qellime te funksioneve qe tregohen ne nje plan zhvillimi, si funksione per qellime per te cilat toka propozohet te zhvillohet; ose
- (b) kur nuk ka funksione te tilla te permendura ne planin e zhvillimit, miratimi ben te mundur blerjen e detyrueshme te tokes per qellime te funksioneve te departamenteve te qeverise, autoritetit lokal ose ndonje grupi tjetër per qellime te te cileve toka eshte caktuar si vend per tu zhvilluar.

(3) Ne lidhje me toka qe bien brenda paragrafeve 2, 3, ose 4 te asaj Skedule (Aneksi) ne baze te Shenimit (1) te atij paragraf, "miratim perkates" do te merret ne perputhje me nene-seksionin (2), sikur referencat per planin e zhvillimit ne ate nen-seksion, te ishin referenca per cdo plan, propozime, ose modifikime sic permenden ne paragrafet (a), (b), ose (c) te atij Shenimi.

(4) Ne lidhje me token brenda paragrafeve 5 ose 6 te asaj Skedule (Aneksi), "miratim perkates" do te caktohet ne perputhje me nene-seksionin (2), sikur referenca ne ate nen-seksion per planin e zhvillimit te ishin referenca per udhezimin ne fjale.

(5) Ne lidhje me toke qe bie brenda paragrafeve 7, 8 ose 9 te asaj Skedule, derisa korporata e zhvillimit te jete formuar per nje qytet te ri, ose sipas rastit, korporata e zhvillimi urban per nje zone urbane zhvillimi, ky Kapitull do kete efekt sikur "miratimi perkates" te jete seksioni 165(1).

(6) Ne lidhje me toke qe bie ne paragrafet 10 ose 11 te asaj Skedule (Aneksi) "miratimi perkates" do te jete seksioni 290 i Aktit mbi Strehimin 1985.

(7) Ne lidhje me toke qe bie ne paragrafin 19 te asaj Skedule

(Aneksi), "miratimi perkates" do te jete seksioni 239(6) i Aktit mbi Autostradat 1980.

(8) Ne lidhje me toke qe bie ne paragrafin 22 te asaj Skedule (Aneksi) ne baze te Shenimit (1) te atij paragrafi, "miratimi perkates" do te jete miratimi qe ben te mundur blerjen e detyrueshme te tokes ose te drejtave mbi token ne qofte se urdheri per blerje eshte konfirmuar.

(9) Kur, ne perputhje me rrethanat mbi bazen e te cilave toka bie ne ndonje paragraf te Skedules (Aneksit) 13, tregohet qe toka eshte propozuar te blihet per qellime te autostradave, cdo miratim qe autorizon (me plotesimin e kushteve perkates) autoritetin e autostradave te bleje token per qellime autostradash, per qellime te nen-seksionit (1), do te merret si miratim qe ben te mundur blerjen e tokes si toke qe bie ne ata paragrafe.

(10) Ne nen-seksionin (9) referenca per plotesimin e kushteve perkates eshte reference per nje ose me shume nga sa me poshte sic aplikohen ne rrethanat ne fjale -

- (a) hyrja ne fuqi e ndonje urdheri te nevojshem ose skeme, sipas dispozitave te Pjeses II te Aktit mbi Autostradat 1980;
- (b) hyrja ne fuqi e ndonje skeme te nevojshme, sipas seksionit 106(3) te atij Akti;
- (c) aprovimet e planeve te kerkuara.

(11) Ne qofte se, dy ose me shume miratime do perbenim miratimin perkates ne lidhje me nje toke per qellime te ketij Kapitulli, miratimi perkates per keto qellime do te merret ai, qe ne rrethanat konkrete, ne baze te te cilit eshte me e mundur qe toka te jete blere nga autoriteti perkates.

(12) Ne qofte se del ndonje ceshtje nese nje miratim eshte miratimi perkates ne lidhje me nje toke per qellime te ketij Kapitulli, ajo ceshtje duhet t'i kalohet-

- (a) kur autoriteti perkates jane departamentet qeveritare, Ministrit qe mbulon ate departament;
- (b) kur autoriteti perkates jane sipermarres ligjore, Ministrit perkates; dhe
- (c) ne cdo rast tjeter, Sekretarit te Shtetit,

dhe vendimi i Ministrit ose i Sekretarit te Shtetit sipas rastit, do te jete final.

Interpretime
pergjithshme
te
Kapitullit II

171.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme ne kete seksion, ne kete Kapitull -

- "zone e ndikuar", ne lidhje me nje njesi bujqesore, do te thote toke qe ne daten e dhenies se njoftimit, bie brenda ndonje paragrafi te Skedules (Aneksit) 13;
- "bujqesore" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 109 te Aktit mbi Bujqesin 1947 dhe referenca per punimin e tokes perfshijne referenca per kryerjen e aktiviteteve bujqesore ne toke;
- "njesi bujqesore" do te thote toke e perdorur si njesi per qellime bujqesore, qe perfshin banesa ose ndertesa te tjera te zena nga i njejti person per qellime te punimit te tokes;
- "vleres vjetore" do te thote -
 - (a) ne rastin e nje trashegimije qe tregohet ne nje liste te vleresimeve jo-shtepiake lokale dhe qe nuk perben prone shtepiake ose prone te perjashtuar nga lista lokale e vleresimit, eshte vlera e treguar ne liste si vlera e trashegimise ne daten e dhenies se njoftimit;
 - (b) ne rastin e nje trashegimie qe tregohet ne nje liste te vleresimeve jo-shtepiake lokale dhe qe perfshin prone shtepiake ose prone te perjashtuar nga lista lokale e vleresimit, eshte shuma e -
 - (i) vleres se treguar ne ate liste si vleres e trashegimise ne daten e dhenies se njoftimit; dhe
 - (ii) vlera e atribueshme per pjesen e trashegimise ne perputhje me nen-seksionet (2) dhe (3);
 - (c) ne rastet e cdo trashegimie tjeter, vlera e atribueshme e asaj trashegimie ne perputhje me nen-seksionet (2) dhe (3);
- "njoftim demtimi" ka kuptimin e dhene ne seksionin 149(5);
- "kerkuesi" ka kuptimin e dhene ne seksionin 150(4);
- "trashegimi" do te thote nje trashegimi perkatese sipas kuptimit te dhene ne seksionin 64(4)(a) deri (c) te Aktit mbi Financat e Qeverise Lokale 1988;
- "miratim i vecante" do te thote nje miratim lokal, ose nje dispozite ne nje Akt pervec Akteve lokale

ose private, qe autorizon blerjen e detyrueshme te tokes; dhe ne kete perkufizim "miratim lokal" do te thote nje Akt lokal ose privat, ose nje urdher i konfirmuar nga Parlamenti ne perputhje me proceduren parlamentare.

(2) Vlera e atribueshme nje trashegimie, ne lidhje me nje prone shtepiake do te jete vlera e vertetuar nga nje zyrtar vleresues si 5 perqind e kompensimit qe do jete i pagueshem ne lidhje me vleren e asaj prone ne qofte se do ishte blere sipas statutit per mungese te perdoruesit, dhe kompensimi i pagueshme eshte llogaritur ne perputhje me Pjesen II te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961.

(3) Vlera e atribueshme nje trashegimie, ne lidhje me nje prone te perjashtuar nga vleresimi lokale jo-shtepiak, do te jete vlera e vertetuar nga nje zyrtar vleresues, si vlera e asaj prone ne daten e dhenies se njoftimit sikur te ishte nje trashegimi perkatese jo-shtepiake, jo e perjashtuar nga vleresimi lokal jo-shtepiak.

(4) Toka e cila perben trashegimi te ndara vetem per aresye te ndarjes se kufijve ne mes te zonave te vleresuara do te merret si perkufizimi i "trashegimise" ne nen-seksionin (1) sikur nuk eshte i ndare.

(5) Ne kete seksion -

- "date e dhenies se njoftimit" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 168;
- "zyrtar vleresimi perkates" do te thote nje zyrtar vleresimi qe vendos per vleren e nje trashegimie per qellime te Pjeses III te Aktit mbi Financat e Qeverise Lokale 1988 ne qofte se trashegimia ka permbushur kushtet e vendosura ne seksionin 42(1)(b) deri (d) te atij Akti;
- "date e caktuar" eshte data kur eshte marre vendimi i tille;

dhe shprehjet e perdorura ne perkufizimin e "vleres vjetore" ne nen-seksionin (1) ose ne nen-seksionet (2) dhe (3) qe jane te perdorur gjithashtu ne Pjesen III te atij Akti kane te njejtin kuptim si ne ate Pjese.

PJESA VII **ZBATIME**

Njoftime per zbatim

Fuqia per te
dhene njoftime
zbatimi

172.—(1) Kur -

- (a) autoriteti i planifikimit lokal verteton se ka patur shkelje te kontrollit te planifikimit pas vitit 1963; dhe
- (b) kur autoriteti e sheh te nevojshme, duke patur parasysh dispozitat e planit te zhvillimit dhe ndonje material tjetere,

ata mund te nxjerrin nje njoftim qe kerkon qe shkelja te rregullohet.

(2) Kur flitet per "njoftim" ne kete seksion, behet fjale per "njoftim zbatimi".

(3) Kemi te bejme me shkelje te kontrollit te planifikimit—

- (a) ne qofte se zhvillimi eshte kryer, perpara ose pas hyrjes ne fuqi te ketij Akti, pa marre lejen e planifikimit te duhur per ate zhvillim ne perputhje me Pjesen III (ose, sipas rastit, Pjesen III te Aktit te vitit 1962 ose Pjesen III te Aktit te vitit 1971); ose
- (b) ne qofte se kushtet ose kufizimet e vena ne lejen e planifikimit nuk jane zbatuar.

(4) Nje njoftim zbatimi qe lidhet me shkeljen e kontrollit te planifikimit qe konsiston ne -

- (a) ndertimin pa leje planifikimi te ndertesave, punimeve inxhinierike, minerare ose punimeve te tjera ne, mbi ose nen toke; ose
- (b) mos zbatimin e kushteve ose kufizimeve te vendosura ne kryerjen e punimeve te tilla, me te cilat eshte dhene leja e planifikimit per zhvillimin e tokes; ose
- (c) berja pa leje planifikimi te ndryshimeve ne perdorimin e cdo ndertese te perdorur si banese e veteme; ose
- (d) mos zbatimi i kushteve qe ndalojne ose parandalojne ndryshimet e perdorimit te nje ndertese te perdorur si banese e vetme,

mund te jepet vetem brenda periudhes 4 vjecare nga data e shkeljes.

(5) Ne varesi te seksionit 175(4), nje njoftim zbatimi do kete efekt ne daten e specifikuar ne te (ne kete Pjese e quajtur "date e specifikuar").

(6) Nje kopje te njoftimit per zbatim duhet ti dergohet jo me vone se 28 dite pas nxjerrjes se saj dhe jo me vone se 28 dite perpara dates se specifikuar -

- (a) pronarit dhe perdoruesit te tokes me te cilen lidhet njoftimi; dhe
- (b) cdo personi tjetër qe ka interes ne ate toke, qe ne opinionin e autoritetit ndikohet nga njoftimi.

(7) Autoriteti i planifikimit lokal mund te terheqe njoftimin per zbatim (pa cenuar fuqine per te bere njoftime te tjera) ne cdo kohe perpara se te hyje ne fuqi.

(8) Ne qofte se e bejne nje gje te tille, ata duhet te njoftojne menjehere cdo person qe kane marre nje kopje te njoftimit.

173.—(1) Nje njoftim per zbatim duhet te detajoje ceshtjet qe perbejne shkelje te kontrollit te planifikimit.

(2) Nje njoftim per zbatim duhet gjithashtu te permbaje -

- (a) hapat qe autoriteti kerkon te realizohen per te rregulluar shkeljen; dhe
- (b) cdo hap tjetër qe permendet ne nen-seksionin (4) qe kerkohet nga autoriteti.

(3) Ne kete seksion "hapat qe kerkohen per te rregulluar shkeljen" do te thote (sipas rrethanave te vecanta te shkeljes) hapa me qellim qe -

- (a) te restaurohet toka ne gjendjen qe ishte perpara se te kryhet zhvillimi; ose
- (b) te plotesohen kushtet ose kufizimet ne baze te te cilave u dha leja e planifikimit, duke perfshire -
 - (i) shembjen ose ndryshimin e nje ndertese ose punimi;
 - (ii) ndalimin e perdorimit te tokes per nje qellim te caktuar;
 - (iii) kryerjen ne toke te konstruksionit te ndertesave.

Permbajtja e njoftimeve te zbatimit

(4) Hapat te cilave i referohet nen-seksioni (2)(b) jane hapa me qellim qe—

- (a) zhvillimi te jete ne perputhje me lejen e planifikimit qe eshte dhene ne lidhje me token; ose
- (b) per rregullimin e cdo demtimi qe eshte shkaktuar nga zhvillimi.

(5) Nje njoftim zbatimi duhet te detajoje periudhen brenda se ciles duhet te merren hapat e permendur ne nen-seksionin (2) dhe mund te detajoje periudha te vecanta per hapa te vecante.

(6) Kur ceshtjet per te cilat njoftimi per zbatim deklarohet se jane shkelje perfshijne zhvillime per ndertimin e depozitave per mbeturina apo plehra ne toke, njoftimi mund te kerkoje qe depozita te modifikohet ne menyre qe anat e saj t'i permbahen kushteve te vendosura ne njoftim.

(7) Sekretari i Shtetit me ane te rregullave mund te udhezohet -

- (a) qe njoftimet per zbatime duhet te detajojne ceshtje shtese pervec atyre qe permbahen ne kete seksion; dhe
- (b) qe cdo kopje e nje njoftimi per zbatim te bere sipas seksionit 172 te shoqerohet me nje leter shpjeguese me informacione qe kerkohen ne rregulla ne lidhje me te drejten per apelim sipas seksionit 174.

(8) Kur--

- (a) nje njoftim zbatimi eshte bere ne lidhje me zhvillime qe konsistojne ne ngritjen e nje ndertese ose kryerjen e punimeve pa leje planifikimi; dhe
- (b) njoftimi kerkon qe te merren hapa te caktuar per qellimet e permendura ne nen-seksionin (4)(b); dhe
- (c) hapat jane marre,

per qellime e Akteve te planifikimit, leja e planifikimit per vazhdimin e punimeve per ngritjen e ndertesave apo punime te tjera, qe kerkohet sipas njoftimit, do te jepet pasi eshte bere aplikimi tek autoriteti i planifikimit lokal per nje leje te tille.

Apelime kundra njoftimeve te

174.—(1) Nje person qe ka interes ne token me te cilen lidhet njoftimi ose nje perdorues i caktuar mund te apeloje tek

zbatimit

Sekretari i Shtetit kunder njoftimit, nese ka marre apo jo nje kopje te tij.

(2) Apelimi mund te behet per ndonjeren nga aresyet me poshte -

- (a) leja e planifikimit duhej te jepej per zhvillime ne njoftim, ose kushtet apo kufizimet e vena ne njoftimin per zbatim nuk duhet te ishin vene;
- (b) ceshtjet ne njoftim per zbatim nuk perbejne shkelje te kontrollit te planifikimit;
- (c) shkelja e kontrollit te planifikimit ne njoftim nuk ka ndodhur;
- (d) ne rastin e nje njoftimi per te cilin aplikohet seksioni 172(4), periudha 4 vjecare nga data e shkeljes ka mbaruar perpara dates se dhenies se njoftimit;
- (e) ne rastin e njoftimeve qe nuk bien ne paragrafin (d), shkelja e permendur ne njoftim ndodhi perpara fillimit te vitit 1964;
- (f) kopjet e njoftimit te zbatimit nuk ishin dhene sic kerkohet nga seksioni 172(6);
- (g) qe hapat e kerkuar nga njoftimi nuk jane te nevojshem per rregullimin e shkeljes ose per te arritur qellimet ne seksionin 173(4);
- (h) qe periudha e specifikuar ne njoftim si periudha brenda se ciles duhet te merren hapat eshte e paarsyeshme.

(3) Apelimi sipas ketij seksioni duhet te behet me njoftim me shkrim dhe ti paraqitet Sekretarit te Shtetit perpara nje date te caktuar.

(4) Personi qe ben njoftim sipas nen-seksionit(3) duhet ta paraqese tek Sekretari i Shtetit, ose kur jep njoftimin ose brenda nje periudhe te caktuar, me shkrim -

- (a) detajet e aresyeve mbi te cilat bazohet apelimi kunder njoftimit te zbatimit; dhe
- (b) informacione te metejshme sic mund te pershkruhen.

(5) Ne qofte se, eshte vene me shume se nje aresye, dhe apeluesi nuk jep informacion sipas nen-seksionit (4)(b) ne lidhje me secilen nga keto aresye brenda kohes se caktuar, Sekretari i Shtetit mund te vendosi qe apelimi nuk ka paraqitur informacionin ne kohen e duhur, pa shqyrtuar

aresyet e apelimit.

Apelime:
dispozita
suplementare

(6) Ne kete seksion "perdorues i caktuar" do te thote nje person i cili—

- (a) ne daten e dhenies se njoftimit per zbatim eshte perdoruesi i tokes me te cilen lidhet njoftimi mbi bazen e nje license te dhene me shkrim; dhe
- (b) qe vazhdon te perdore token ne daten e berjes se apelimit.

175.—(1) Sekretari i Shtetit mund te vendose proceduren qe duhet te ndiqet per apelime sipas seksionit 174 dhe, ne vecanti, por pa cenuar karakterin e pergjithshem te ketij nen-seksioni, mund te -

- (a) kerkoje qe autoriteti i planifikimit lokal te paraqese, brenda nje kohe te caktuar, nje thenie qe tregon se per cfare do apelojne;
- (b) detajoje ceshtje qe perfshihen ne nje thenie te tille;
- (c) kerkoje qe autoriteti ose apeluesi te jape njoftimin e nje apelimi te tille brenda nje periudhe te caktuar;
- (d) kerkoje qe autoriteti t'i dergoje Sekretarit te Shtetit, brenda nje periudhe te tille nga data e apelimit, nje kopje te njoftimit per zbatim dhe nje liste te personave qe kane marre kopje te tij.

(2) Njoftimi i bere sipas nen-seksionit (1)(c) do jete i tille qe sipas opinionit te Sekretarit te Shtetit, apelimi i shkon personave ne vendin me te cilin lidhet njoftimi i zbatimit.

(3) Ne varesi te seksionit 176(4), Sekretari i Shtetit, ne qofte se desheron apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal, duhet te jape secilit prej tyre mundesi per te paraqitur mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit.

(4) Kur behet apelim sipas seksionit 174, njoftimi per zbatim nuk do te hyje ne fuqi pa u marre vendimi perfundimtar per apelimin ose pa u terhequr apelimi.

(5) Kur ndonje person i ka apeluar Sekretarit te Shtetit kunder nje njoftimi per zbatim, asnjeri ka te drejte per te pretenduar pas berjes se apelimit, qe njoftimi nuk u be ne

menyre te rregullt personit qe apeloj.

(6) Skedula (Aneksi) 6 aplikohet per apelime sipas seksionit 174, qe perfshin apelime sipas atij seksioni sic aplikohen sipas dispozitave te tjera ne kete Akt.

Dispozita te
pergjithshme ne
lidhje me
vendime per
apelime

176.—(1) Ne marrjen e vendimit per nje apelim sipas seksionit 174, Sekretari i Shtetit duhet te jape udhezime per hyrjen ne fuqj te vendimit, ose sipas rastit per hedhjen poshte te njoftimit te zbatimit ose per ndryshimin e tij.

(2) Kur behet apelimi, ne qofte se Sekretari i Shtetit eshte i bindur qe nuk perben padrejtesi ndaj autoritetit te planifikimit lokal ose apeluesit, ai mund te -

- (a) korigjoke ndonje gabim apo difekt ne njoftimin per zbatim; ose
- (b) te jape udhezime per tandryshuar ate.

(3) Sekretari i Shtetit -

- (a) mund te hedhe poshte nje apelim ne qofte apeluesi nuk i permbahet seksionit 174(4) brenda kohes se caktuar; dhe
- (b) mund te lejoje nje apelim dhe te hedhe poshte njoftimin per zbatim ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal nuk i permbahet rregullave te bera ne baze te paragrafeve (a), (b) ose (d) te seksionit 175(1) brenda nje periudhe te caktuar.

(4) Ne qofte se Sekretari i Shtetit propozon te hedhe poshte nje apelim sipas paragrafit (a) te nen-seksionit (3) ose te lejoje nje apelim dhe te hedhe poshte njoftimin per zbatim sipas paragrafit (b) te atij nen-seksioni, ai nuk ka nevojte t'i permbahet seksionit 175 (3).

(5) Ne qofte se, nje person qe eshte dashur te marre nje njoftim per zbatim nuk e ka marre nje njoftim te tille, dhe normalisht kjo perben nje zgjidhje te apelimit te bere sipas seksionit 174 ne favor te apeluesit, Sekretari i Shtetit mund te mos e marre parasysh nje gje te tille ne qofte se as apeluesi as personi nuk jane ndikuar nga ky fakt.

Dhenia ose
modifikimi i
lejeve te

177.—(1) Ne marrjen e vendimit per nje apelim sipas seksionit 174, Sekretari i Shtetit mund te -

- (a) jape leje planifikimi per zhvillime me te cilat

planifikimit pasi
eshte apeluar
per njoftimet e
zbatimit

lidhet njoftimi per zbatim ose per nje pjese te atij zhvillimi ose per zhvillime te pjeses se tokes me te cilen lidhet njoftimi per zbatim;

- (b) heqe ndonje kusht apo kufizim me te cilat eshte dhene leja e planifikimit;
- (c) vendose qellimet per te cilat toka, ne rrethanat e kohes se marrjes se vendimit, te perdoret ligjerisht duke patur parasysh perdorimin e meparshem dhe ndonje leje planifikimi e dhene.

(2) Ne marrjen e vendimit nese duhet dhene leja e planifikimit apo jo sipas nen-seksionit (1), Sekretari i Shtetit duhet te kete parasysh dispozitat e planit te zhvillimit qe ka te beje me ceshtje te perfshira ne njoftim per zbatim dhe ndonje material tjetër.

(3) Cdo leje planifikimi e dhene nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (1) mund -

- (a) te perfshije leje per te vazhduar ose perfunduar ndertimin e nje ndertese ose punimi tjetër ne toke, ose te beje nje gje te tille pa ju permbajtur kushteve te vendosura ne lejen e mepareshme te planifikimit;
- (b) te jepet me kushte qe Sekretari i Shtetit i konsideron te pershtatshme;

dhe seksioni 72(1) dhe (5) aplikohet me modifikimet e nevojshme ne lidhje me dhenien e lejes sipas nen-seksionit (1) sic aplikohet ne nje leje sipas seksionit 70(1).

(4) Kur sipas nen-seksionit (1) Sekretari i Shtetit hedh poshte nje kusht apo kufizim, ai mund ta zevendesoje ate me kusht apo kufizim tjetër, me pak ose me te shtrenguar.

(5) Kur behet nje apelim kunder nje njoftimi per zbatim sipas seksionit 174, do te merret sikur apeluesi ka bere nje aplikim per leje planifikimi per zhvillime me te cilat lidhet njoftimi.

(6) Cdo leje planifikimi e dhene sipas nen-seksionit (1) pas nje apelimi do te merret si e dhene pas nje aplikimi te bere nga apeluesi.

(7) Ne lidhje me dhenien e nje leje planifikimi ose ne marrjen e vendimit sipas nen-seksionit (1), vendimi i Sekretarit te Shtetit do te jete final.

(8) Per qellime te seksionit 69, vendimi i Sekretarit te Shtetit do te merret sikur eshte dhene pas nje aplikimi te bere autoritetit te planifikimit lokal per leje planifikimi.

Kryerja dhe kostoja e punimeve te kerkuara nga njoftimi per zbatim

178.—(1) Ne qofte se kerkohen te ndermarren hapa ne baze te seksionit 173(2)(a) nga nje njoftim per zbatim (pervec rasteve kur kerkohet perfundimi i perdorimit te tokes) dhe keto hapa nuk jane bere brenda periudhes se caktuar, autoriteti i planifikimit lokal mund te —

- (a) hyje ne toke dhe te ndermarre keto hapa, dhe
- (b) t'i marre nga personi qe eshte pronar i tokes cdo shpenzim te bere nga ata.

(2) Kur eshte dhene nje kopje e njoftimit per zbatim si rrjedhim i shkeljeve te kontrollit te planifikimit (sic perkufizohet ne seksionin 172(3))—

- (a) cdo shpenzim i bere nga pronari ose perdoruesi i tokes per te zbatuar njoftimin, dhe
- (b) cdo shume e paguar nga pronari i tokes sipas nen-seksionit (1) ne lidhje me shpenzimet qe ka bere autoriteti i planifikimit lokal gjate marrjes se masave te kerkuara ne njoftim,

do te merret qe jane paguar nga personi qe ka bere shkeljen.

(3) Rregullat e bera sipas ketij Akti mund te perfshijne qe —

- (a) seksioni 276 i Aktit mbi Shendetin Publik 1936, (fuqia e autoriteteve lokale per te shitur materiale te hequra gjate punimeve sipas ketij Akti);
- (b) seksioni 289 i atij Akti (fuqia per ti kerkuar perdoruesit te ndertesave te lejoje punime nga pronari i nderteses),
- (c) seksioni 294 i atij Akti (kufizime ne detyrimet e personave qe kane ndertesat si agjente ne lidhje me shpenzimet e rekuperueshme sipas atij Akti),

do te aplikohen, ne varesi te adaptimeve apo modifikimeve sic percaktohen ne rregulla, ne lidhje me hapat qe duhen bere sic kerkohet ne nje njoftim zbatimi.

(4) Rregullat sipas nen-seksionit (3) qe bejne te mundur aplikimin e seksionit 289 te Aktit mbi Shendetin Publik 1936 mund te perfshijne adaptime ose modifikime per qellime te dhenies se te drejtes per te zbatuar kerkesat e njoftimit te

zbatimit, proanrit te tokes, kundrejt personave te tjere te interesuar ne toke.

(5) Rregullat sipas nen-seksionit (3) mund te bejne te mundur gjithashtu ngarkimin e shpenzimeve ne toke, te rekuperueshme nga autoriteti i planifikimit lokal sipas nen-seksionit (1).

(6) Kur ne baze te ketij seksioni cdo shpenzim eshte i rekuperueshem nga autoriteti i planifikimit lokal, keto shpenzime do te rikuperohen si nje borxh kontraktual ne ndonje gjykate ose juridiksion perkates.

(7) Ne kete seksion dhe ne seksionet 179, 183, dhe 184 cdo reference per periudhen e zbatimit, eshte reference per periudhen e specifikuar ne nje njoftim zbatimi, per zbatimin e tij, ose nje periudhe e zgjatur sic percakton autoriteti i planifikimit lokal.

Ndeshkimet per mos-perputhje me njoftimin e zbatimit

179.—(1) Kur —

- (a) kopje te njoftimin per zbatim i eshte dhene personit i cili ne kohen e dhenies se njoftimit ishte pronari i tokes me te cilen lidhet njoftimi, dhe
- (b) hapat e kerkuara nga njoftimi (pervec ndalimit te perdorimit te tokes) nuk jane bere brenda periudhes se caktuar,

atehere, ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, ai person eshte fajtor.

(2) Nje person qe eshte fajtor sipas nen-seksionit (1) detyrohet—

- (a) ne marrjen e denimit, per nje gjobe qe nuk e kalon maksimumin e ligjshem, ose
- (b) ne marrjen e denimit pas nje padije, me gjobe.

(3) Kur sipas nen-seksionit (1), padija eshte bere ndaj nje personi (pronari fillestar) i cili ne nje kohe perpara mbarimit te periudhes se zbatimit, nuk eshte me pronari, ne qofte se ai—

- (a) paraqet informacionin per kete padi, dhe
- (b) i jep gjyqit jo me pak se tre dite perpara njoftimin per qellimet e tij,

ai mund te autorizohet qe t'ja kaloje personit qe u be pronari i tokes detyren e paraqitjes ne gjyq.

(4) Kur gjate seances gjyqesore -

- (a) eshte provuar qe hapat e detyrueshme per tu kryer nga njoftimi per zbatim nuk jane bere brenda periudhes se caktuar, dhe
- (b) pronari fillestar provon qe deshtimi i berjes se ketyre hapave eshte faji i pronarit te ri, atehere
 - (i) pronari i ri mund te denohet per fajin; dhe;
 - (ii) ne qofte se pronari fillestar provon gjithashtu qe ka bere hapat e duhura per te zbatuar njoftimin, ai do te quhet i pafajshem.

(5) Ne qofte se, pasi nje person eshte denuar ne baze te dispozitave te mepareshme te ketij seksioni, ai nuk ben gjithcka qe duhet te te permbushur kerkesat e njoftimit per zbatim, ai do te jete fajtor per faj te metejshem dhe i detyruar—

- (a) te paguaje nje gjobe jo me te madhe se 200 Paunde per cdo dite pas denimit te pare, per te cilat kerkesat e njoftimit mbeten te papermbushura; ose
- (b) kur denohet pas nje padije, me gjobe.

(6) Kur ne baze te nje njoftimi per zbatim—

- (a) nje perdorim i tokes kerkohet qe te ndalohet, ose
- (b) kushte apo kufizime kerkohen qe te permbushen per perdorimin e tokes ne nje menyre te caktuar,

atehere, ne qofte se nje person perdor token ose lejon te perdoret ne mosperputhje me njoftimin, ai eshte fajtor.

(7) Personi qe eshte fajtor sipas nen-seksionit (6) detyrohet te—

- (a) paguaje nje gjobe qe nuk e kalon maksimumin e ligjshem, ose
- (b) kur denohet me padi, te paguaje gjobe.

(8) Kur personi denohet sipas nen-seksionit (6) ne lidhje me perdorimin e nje toke dhe perdorimi vazhdohet pasi eshte dhene denimi, atehere ai eshte fajtor per faj te metejshem dhe detyrohet --

- (a) te paguaje nje gjobe jo me te madhe se 200 Paunde per cdo dite pas denimit te pare, per te cilat kerkesat e njoftimit mbeten te papermbushura; ose
- (b) kur denohet pas nje padije, me gjobe.

Ndikimet e lejes
se planifikimit
ne njoftime
zbatimi

180.—(1) Ne qofte se, dhenies se nje kopje te nje njoftimi per zbatim, leja e planifikimit jepet per -

- (a) vazhdimin e punimeve ne nje ndertese apo punim, ose
- (b) per vazhdimin e perdorimit te tokes, me te cilen lidhet njoftimi,

njoftimi per zbatim nuk do te jete me ne fuqi per ate pjese qe kerkon te behen hapa per priishjen e ndertesave apo punimit, ose per ndalimin e perdorimit te tokes.

(2) Ne qofte se jepet leja e planifikimit sic pershkruhet ne nen-seksionin (1) per vazhdimin e punimeve ne ndertese apo punim, ose per vazhdimin e perdorimit te tokes, pa zbatuar kushtet me te cilat eshte dhene nje leje planifikimi e mepareshme, njoftimi per zbatim nuk do te jete me ne fuqi per pjesen qe kerkon te marren masa per zbatimin e atyre kushteve.

(3) Fakti qe nje njoftim per zbatim nuk eshte me ne fuqi pjeserisht apo teresisht, nuk ndikon ne detyrimet qe kane personat per ndonje denim ne lidhje me mosperputhje te mepareshme me njoftimin.

Njoftimet per
zbatim kunder
zhvillimeve te
metejshme

181.—(1) Zbatimi i nje njoftimi zbatimi, nese ne lidhje me -

- (a) perfundimin, shembjen ose ndryshimin e nje ndertese;
- (b) perfundimin e perdorimit te nje toke; ose
- (c) me ndonje kerkese tjeter ne njoftim,

nuk duhet te hedhe poshte ose shlyeje njoftimin.

(2) Pa cenuar nen-seksionin (1), cdo dispozite te nje njoftimi per zbatim qe kerkon qe perdorimi i tokes te perfundoje do te merret si kerkese dhe duhet te perfundoje ne menyre permanente, ne qofte se nuk bie ndesh me Pjesen III; dhe ne perkatesisht rifillimi i perdorimit ne cdo kohe pasi eshte ndaluar ne perputhje me njoftimin do te jete shkelje e njoftimit.

(3) Pa cenuar nen-seksionin (1), ne qofte se nje zhvillim eshte kryer ne toke per restaurimin e ndertesave ose punimeve qe jane rrezuar ose ndryshuar ne perputhje me nje njoftim per zbatim, njoftimi, pa marre parasysh se nuk eshte bere per kete qellim, do te marret qe aplikohet ne lidhje me ndertesa

ose punime qe po restaurohen, ashtu sic aplikohet perpara se keto ndertesa ose punime jane prishur ose shembur; dhe, ne varesi te nen-seksionit (4), dispozitat e seksionit 178(1) dhe (2) do te aplikohen perkatesisht.

- (4) Kur, ne cdo kohe pasi hyn ne fuqi nje njoftim per zbatime-
- (a) jane bere zhvillime ne toke qe kane te bejne me restaurimin ose rivendosjen e ndertesave ose punimeve qe jane rrezuar apo ndryshuar ne perputhje me njoftimin; dhe
 - (b) autoriteti i planifikimit lokal propozon, sipas seksionit 178(1), qe te beje hapa e kerkuar ne njoftimin e zbatimit per rrezimin apo ndryshimin e ndertesave ose punimeve qe jane bere me pas,

autoriteti i planifikimit lokal, brenda 28 diteve perpara berjes se ketyre hapave, duhet te njoftoje per kete pronarin apo perdoruesin e tokes.

(5) Kur pa patur leje planifikimi, nje person ben punime ne toke per restaurimin ose ngritjen e ndertesave ose punimeve te cilat jane rrezuar ose ndryshuar ne perputhje me nje njoftim zbatimi -

- (a) ai do konsiderohet fajtor dhe do te jete i detyruar te paguaje nje gjobe qe nuk e kalon nivelin 5 te shkalles standarde, dhe
- (b) asnje person eshte i detyruar sipas dispozitave te seksionit 179(1) deri (5) per berjen e hapave te kerkuar per zbatimin e njoftimit me rrezimin ose ndryshimin e asaj qe u restaurua.

Detyrime per
zbatim nga
Sekretari i
Shtetit

182.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e sheh te nevojshme qe duhet te behet nje njoftim per zbatim ne lidhje me nje toke, ai mund te beje nje njoftim te tille.

(2) Sekretari i Shtetit nuk duhet te nxjerri nje njoftim te tille pa i konsultuar me autoritetin e planifikimit lokal.

(3) Njoftimi per zbatime i dhene nga Sekretari i Shtetit do te kete te njejtin efekt si ai i dhene nga autoriteti i planifikimit lokal.

(4) Ne lidhje me nje njoftim per zbatime te dhene nga Sekretari i Shtetit, seksioni 178 dhe 181 aplikohen sikur referencat qe i behen ne ato seksione autoritetit te planifikimit

lokal te zevendesohen me referenca per Sekretarin e Shtetit.

Njoftim ndalimi

Njoftime ndalimi 183.—(1) Kur autoriteti i planifikimit lokal ne lidhje me nje toke -

- (a) ka bere nje njoftim zbatimi qe kerkon te rregullohet nje shkelje; por
- (b) e konsideron te nevojshme te ndaloje, perpara mbarimit te periudhes se zbatimit, kryerjen e aktiviteve per te zbatuar rregullimin e shkeljes,

ata, ne cdo kohe perpara se njoftimi te hyje ne fuqi, mund te japin nje njoftim per ndalimin e kryerjes se aktiviteve ne toke, ose nje pjese te tyre.

(2) Nje njoftim sipas nen-seksionit (1) quhet ne kete Akt, "njoftim ndalimi".

(3) Nje njoftim ndalimi nuk mund te ndaloje -

- (a) perdorimin e nderteses si shtepi banimi, ose
- (b) perdorimin e tokes si vend ndalimi per karvanet, qe eshte zene nga nje person si rezidenca e tij e vetme, ose.
- (c) marrjen e masave te detajuara ne njoftimin per zbatime per rregullimin e shkeljes.

(4) Per qellime te nen-seksionit (3), karvan ka te njejtin kuptim si ne Pjesen i te Aktit mbi Vendet e Karvaneve dhe Kontrolli mbi Zhvillimet 1960.

(5) Kur periudha gjate se cilen nje aktivitet eshte zbatuar ne toke, ka filluar me shume se 12 muaj me heret, nje njoftim ndalimi nuk do ndaloje aktivitetin ne toke, pervec se kur eshte ndertese, punime inxhinierike, minierare ose punime per depozitim e plehrave ose mbeturinave.

(6) Nje njoftim ndalimi mund te behet nga autoriteti i planifikimit lokal per cdo person qe mendohet se ka nje interes ne toke ose qe mund te merret me ndonje aktivitet te ndaluar nga njoftimi.

(7) Autoriteti i planifikimit lokal mund te terheqe ne cdo kohe nje njoftim ndalimi (pa cenuar fuqine e tyre te bejne nje tjeter)

me ane te nje njoftimi per kete personave qe ju dha njoftimi per ndalim.

Njoftime ndalimi: dispozita suplementare

184.—(1) Nje njoftim ndalimi duhet t'i referohet njoftimit per zbatim me te cilen lidhet dhe te kete nje kopje te bashkangjitur.

(2) Nje njoftim per ndalim mund te tregojte daten ne te cilen hyn ne fuqi (dhe nuk mund te kundershohet perpara asaj date).

(3) Data nuk duhet te jete me heret se tre dite e jo me vone se 28 dite nga data ne te cilen njoftim eshte dhene per here te pare.

(4) Nje njoftim per ndalim nuk do jete me ne fuqi kur—
(a) njoftimi per zbatim me te cilin lidhet eshte terhequr ose hedhur poshte; ose
(b) periudha e caktuar per permbushjen se tij ka mbaruar; ose
(c) njoftimi per terheqje te njoftimit per ndalim jepet ne fillimi sipas seksionit 183(7).

(5) Nje njoftim ndalimi nuk do jete me ne fuqi gjithashtu ne qofte se aktivitetet e ndaluara nga njoftimi, me ndryshim te njoftimit per zbatim, nuk jane me te perfshira ne njoftimin per zbatim, pra nuk perbejne shkelje.

(6) Kur eshte dhene nje njoftim ndalimi ne lidhje me nje toke, autoriteti i planifikimit lokal mund ta afishoje njoftimin (ne kete seksion dhe ne seksionin 187 do te quhet "njoftim me afishim") —

- (a) qe thote se njoftimi per ndalim eshte dhene dhe cdo person qe e kundershton ate mund te denohet sipas seksionit 187,
- (b) qe jep daten kur njoftimi per ndalim hyn ne fuqi, dhe
- (c) qe tregon kerkesat e tij.

(7) Ne qofte se sipas seksionit 183(7) autoriteti i planifikimit lokal terheq njoftimin per ndalim ne lidhje me te cilin eshte afishuar nje njoftim, ata duhet te terheqin kete te fundit gjithashtu.

(8) Nje njoftim per ndalim nuk do te jete i' pavlefshem per

sresye te mos dhenies se njoftimit per zbatim sic kerkohet ne seksionin 172(6), ne qofte se vertetohet qe autoriteti i planifikimit lokal i ka marre masat e duhura per te bere nje gje te tille.

Dhenie te njoftimeve per ndalim nga Sekretari i Shtetit

185.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit e sheh te nevojshme te jape nje njoftim ndalimi ne lidhje me nje toke, atehere ai mund te beje nje gje te tille.

(2) Njoftimi i dhene nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (1) do kete te njejtin efekt sikur te jete dhene nga autoriteti i planifikimit lokal.

(3) Sekretari i Shtetit nuk mund te jape nje njoftim te tille pa u konsultuar me pare me autoritetin e planifikimit lokal.

Kompensimeper humbje si rezultat i njoftimeve per ndalim

186.—(1) Kur jepet nje njoftim per ndalim sipas seksionit 183 kompensim mund te paguhet sipas ketij seksioni ne lidhje me nje ndalim qe permbahet ne njoftim ne qofte se—

- (a) njoftimi per zbatim eshte hedhur poshte per arsye te tjera, jashte atyre te permendura ne paragrafin (a) te seksionit 174(2);
- (b) njoftimi per zbatim ndryshohet ne menyre qe ceshtjet qe perbejne shkelje nuk permbajne me aktivitetet e ndaluara me njoftimin per ndalim;
- (c) njoftimi per zbatim terhiqet nga autoriteti i planifikimit lokal, per arsye te ndryshme, pervec se kur eshte dhene leja e planifikimit per zhvillimet me te cilat lidhet njoftimi ose per vazhdimin e punimeve pa ju permbajtur kushteve apo kufizimeve te vena ne nje leje planifikimi te mepareshme; ose
- (d) njoftimi per ndalim eshte terhequr.

(2) Personi i cili, kur njoftimi per ndalim eshte dhene, ka interes ose e perdor token me te cilen lidhet njoftimi ka te drejte per tu kompensuar nga autoriteti i planifikimit lokal per humbje ose demtime qe lidhen direkt me ndalime te aktiviteteve qe permbahen ne njoftim.

(3) Kerkesa per kompensim sipas ketij seksioni duhet ti behet autoritetit te planifikimit lokal brenda nje periudhe te caktuar, ne nje menyre te caktuar.

(4) Humbja ose demtimet per te cilat behet kompensimi sipas ketij seksioni ne lidhje me nje ndalim veprimesh duhet te perfshije ndonje shume te pagueshme ne lidhje me shkeljen e kontrates qe shkaktohet nga veprimet per te ju permbajtur njoftimit per ndalim.

(5) Gjate vleresimit te kompensimit sipas ketij seksioni, duhet te marren parasysh -

- (a) rastet kur kerkuesi nuk k azbatuar njoftimin sipas seksionit 330, ose
- (b) cdo thenie te tij ne kundershtrim te ketij njoftimi.

(6) Cdo ceshtje apo mosmarreveshje ne kete Pjese duhet ti kalohet per vendim Gjykates se Tokave, pervec rasteve kur percaktohet ndryshe nga rregulla te bera ne perputhje me kete Akt.

(7) Ne lidhje me vendime per ceshtje te tilla, aplikohen dispozitat e seksionit 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961, ne varesi te modifikimeve te nevojshme dhe te dispozitave te ketij Akti.

Ndershtime per mosperputhje me njoftimet per ndalim

187.—(1) Ne qofte se nje person shkel ose lejon shkelje te nje njoftimi per ndalim -

- (a) pasi eshte afishuar nje njoftim, ose
- (b) ne qofte se njoftimi me afishim nuk eshte vene, me shume se dy dite pas dhenies atij te njoftimit per ndalim,

atehere, ne varesi te nen-seksionit (3), ai eshte fajtor per fyerje.

(2) Nje person qe eshte fajtor per fyerje sipas nen-seksionit (1) detyrohet te -

- (a) paguaje nje gjobe jo me te madhe se maksimumi ligjor; ose
- (b) kur eshte denuar me padi, nje gjobe,

dhe ne qofte se fyerja vazhdohet pas denimit ai do jete fajtor per fyerje te metejshme dhe detyrohet -

- (i) te paguaje nje gjobe qe nuk kalon 200 Paunde per cdo dite qe vazhdohet fyerja, ose
- (ii) kur eshte denuar me padi, me gjobe.

(3) Gjate gjyqit do jete ne mbrojtje te te akuzuarit qe te kete

prova per -

- (a) njoftimi per ndalim nuk i esht edhene; dhe
- (b) ai nuk e dinte, dhe nuk mund ta dinte per ekzistencen e tij.

Rregjistrat

Rregjistrat per njoftime zbatimi dhe ndalimi

188.—(1) Cdo autoriteti i planifikimit te rrethit dhe keshilli i cdo rrethi metropolitan ose Londres duhet te mbaje nje rregjister, ne menyren qe vendoset ne nje urdher zhvillimi, qe permban informacion ne lidhje me -

- (a) njoftime per zbatime; dhe
- (b) njoftime per ndalime,

ne zonen e tyre.

(2) Nje urdher zhvillimi mund te permbaje dispozita per -

- (a) per te rregjistruar te gjitha njoftimet per zbatime ose per ndalime, dhe cdo gje qe lidhet me keto njoftime, dhe te hiqen rregjistrime sic mund te detajohen ne urdher; dhe
- (b) per t'i kerkuar autoritetit te planifikimit lokal ti jape autoritetit te planifikimit te rrethit informacione qe percaktohen ne lidhje me njoftimet per zbatime ose per ndalime te dhena nga ai autoritet planifikimi lokal.

(3) Cdo rregjister i mbajtur sipas ketij seksioni duhet te lihet per inspektim nga publiku ne oret e caktuara te dites.

Zbatim urdherash per nderprerje te perdorimeve, etj.

Ndeshkimet per kundershtrim te urdherave sipas s. 102 dhe Skedules 9.

189.—(1) Cdo person qe pa leje planifikimi -

- (a) perdor token, ose lejon perdorimin e saj -
 - (i) per qellime qe nga nje urdher sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules 9 kerkohet te mos perdoret me; ose
 - (ii) me shkelje te kushteve te vendosura nga nje urdher i tille ne baze te nen-seksionit (1) te atij nen-seksioni ose, nen-paragrafit (1) te atij paragrafi; ose
- (b) rifillon ose lejon te rifillohen zhvillime qe konsistojne ne nxjerrjen dhe perpunimin e

mineraleve, rifillimi i te cilave eshte ndaluar nga paragrafi 3 i asaj Skedule (Aneksi); ose
(c) shkel, ose lejon te shkelen, kerkesa te specifikuara ne nen-paragrafet (3) ose (4) te atij paragrafi,

do jete fajtor per fyerje.

(2) Cdo person qe shkel kerkesat e nje urdheri sipas paragrafit 5 dhe 6 te asaj Skedule (Aneksi) ose qe lejon nje shkelje te tille do jete fajtor per fyerje.

(3) Cdo person qe eshte fajtor sipas ketij seksioni do detyrohet-

- (a) te paguaje gjobe jo me te madhe se maximumi i ligjshem; dhe
- (b) ne qofte se denohet me padi, te paguaje gjobe.

(4) Do jete ne mbrojtje te personit te akuzuar me fyerje sipas ketij seksioni te jape prova qe ai i ka marre te gjitha masat per te evituar cdo fyerje nga ana e tij ose nga persona qe kontrollon.

(5) Ne qofte se mbrojtja e bere sipas nen-seksionit (4), permaban akuzime per te cilat komisioni i fyerjeve duhet te vepronte ose nje person tjeter, ose per shkak te mbeshtetjes ne informacionin e dhene nga personi tjeter, personi akuzuar, pa lene gjyqin, ka te drejte te mbeshtetet ne nje mbrojtje te tille, pervec se kur, brenda 7 diteve perpara gjyqit, ai i ka dorezuar prokurorit nje njoftim me shkrim qe jep informacionin qe identifikon personin tjeter.

Certifikata per perdorimin e vendosur

191. Per qellime te kesaj Pjese perdorimi i tokes eshte vendosur ne qofte se -

- (a) ka filluar perpara vitit 1964 pa leje planifikimi dhe ka vazhduar qe nga fundi i vitit 1963;
- (b) ka filluar perpara vitit 1964 me leje planifikimi te dhene me kushte apo kufizime te cilat ose nuk jane permbushur asnjehere ose nuk jane permbushur qe nga fundi i vitit 1963; ose
- (c) ka filluar pas fundit te vitit 1963, si rezultat i nderyshimeve te perdorimit qe nuk kerkojne leje planifikimi dhe qe nga fundi i vitit 1963

Kuptimi i "perdorimit te vendosur"

nuk ka patur ndryshim te perdorimit per te cilin duhet leje planifikimi.

Aplikime per certifikatat e perdorimit

192.—(1) ne varesi te nen-seksionit (3), kur nje person qe ka interes ne toke kerkon qe nje perdorim i vecante eshte vendosur, ai mund te aplikojte tek autoriteti i planifikimit lokal per nje certifikate qe tregon nje gje te tille.

(2) Certifikata e tille ne kete Akt quhet "certifikate perdorimi".

(3) Aplikime nuk mund te behen sipas nen-seksionit (1)—

- (a) ne lidhje me perdorimin e tokes per shtepi banimi te vetme, ose
- (b) ne lidhje me perdorime qe nuk ekzistojne ne kohen e aplikimit.

(4) Nje certifikate perdorimi do te jete perfundimtare ne lidhje me ceshtje qe perfshihen ne te, per qellime apelimi tek Sekretari i Shtetit kundrejt nje njoftimi per zbatim per token me te cilen lidhet certifikata, ne qofte se njoftimi eshte dhene pas dates se aplikimit ne baze te te cilit u dha certifikata.

(5) Sekretari i Shtetit mund te udhezaje qe aplikimet e kerkuara per certifikaten e perdorimit ti kalohen atij ne vend qe te shqyrtohen nga autoriteti i planifikimit lokal.

(6) Ne seksionin 69 referenca qe i behen aplikimeve per leje planifikimi do te perfshijne edhe referenca per aplikime per certifikata perdorimi.

Dispozita suplementare per aplikime

193.—(1) Aplikimi per certifikate perdorimi do te behet ne menyre te tille sic pershkruhet nga nje urdher zhvillimi dhe do te perfshijte detaje dhe evidence sic kerkohet ne nje urdher apo udhezim te dhene ose nga autoriteti i planifikimit lokal ose nga Sekretari i Shtetit.

(2) Nje urdher zhvillimi mund te beje te mundur qe aplikimi per nje certifikate perdorimi nuk do merret parasysht ne qofte se nuk shoqerohet me nje vertetim qe pershkruhet ne urdher sipas njeres nga seksionet 66(1) ose 67(3).

(3) Cdo urdher i tille gjithashtu mund te -

- (a) perfshije kerkesa qe permbahen ne seksionet 66(2) deri (6) (ose sipas rastit seksionet 67(5),

- (6) dhe (11)) dhe seksioni 71(2); dhe
(b) te nxjerre dispozita se kush merret si pronari i tokes per qellime te dispozitave te urhderit te bere ne baze te nen-seksionit (2) ose te ketij nen-seksioni.

(4) Ne qofte se nje person -

- (a) jep nje vertetim ne kundersiztim me dispozitat e nje urdheri per zhvillim te bere ne baze te nen-seksionit (2) ose (3) dhe qe permban thenie qe ai e di qe jane false ose te shtremberuara, ose
(b) jep nje vertetim pa kujdes qe nuk perputhet me dispozitat e permendura ose qe perman thenie falso ose te shtremberuara,

atehere ai eshte fajtor per fyerje.

(5) Personi qe eshte fajtor per nje fyerje te tille do te detyrohet te paguaje gjobe qe nuk eshte me e madhe se niveli i trete i shalles standarde.

(6) Ne qofte se, per qellime te sigurimit te nje vendimi per marrjen e certifikates se perdorimit -

- (a) me dijeni ose pa kujdes jep deklarata falso me nje material te caktuar; ose
(b) me qellim mashtrimi, jep, dergon ose ben dokumente falso; ose
(c) me qellim mashtrimi nuk jep informacione te vecanta,

ai eshte fajtor per fyerje.

(7) Personi qe eshte fajtor per fyerje te tille do te detyrohet -

- (a) te paguaje gjobe jo me te madhe se maksimumi ligjor, ose
(b) kur denohet me padi, me burg jo me shume se dy vjet ose me gjobe, ose te dyja.

Vendime mbi aplikimet

194.—(1) Pasi merr aplikomin sipas seksionit 192 autoriteti i planifikimit lokal, ose kur i kalohet Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (5) te atij seksioni, autoriteti ose Sekretari i Shtetit duhet te -

- (a) ne qofte se ai eshte bindur se aplikimi eshte i drejte, te jape certifikaten perkatese te perdorimit; dhe
(b) ne qofte se ai ose ata nuk jane te bindur per

ketë, te refuzoje aplikimin.

(2) Certifikata e perdorimit mund te jepet -

- (a) ose per te gjithë token e paraqitur ne aplikim, ose per nje pjese te saj;
(b) ne qofte se nje aplikim permban kerkese per dy ose me shume perdorime te ndryshme, ose per te gjithë perdorimet ose per disa prej tyre.

(3) Certifikata e perdorimit duhet te jete ne nje format te percaktuar ne urdher zhvillimi dhe duhet te permbaje -

- (a) token me te cilen lidhet certifikata dhe perdorimet per te cilat kerkohet ajo;
(b) ne baze te paragrafeve te seksionit 191, aresyet e ketij perdorimi; dhe
(c) daten ne te cilen behet aplikimi per certifikate.

(4) Data e permendur ne nen-seksionin (3)(c) do te jete data ne te cilen perdorimi eshte certifikuar.

(5) Dispozitat e nje urdheri zhvillimi per menyren ne te cilen duhet te behet aplikimi jane kompetenca te autoritetit te planifikimit lokal.

(6) Nje urdher i tille ben te mundur qe autoriteti -

- (a) ti jape aplikantit brenda nje kohe te caktuar ne urdher njoftimin sipas nje formati te caktuar se aplikimi i tij po shqyrtohet;
(b) t'i jape Sekretarit te Shtetit dhe personave te tjere sic percaqtohen ne urdher, informacione ne lidhje me kete aplikim sic percaktohet ne urdher, duke perfshire informacione per menyre se si shqyrtohen aplikimet.

Apelime kunder refuzimit ose deshtimit te dhenies se udhezimeve per aplikimin

195.—(1) Kur eshte bere nje aplikim tek autoriteti i planifikimit lokla per nje certifikate perdorimi dhe -

- (a) aplikimi eshte refuzuar ose refuzuar pjeserisht, ose
(b) autoriteti nuk njofton aplikantin per vendimin e tyre brenda kohes se caktuar ne urdher ose brenda nje kohe per te cilen eshte rene dakord me shkrim ne mes te aplikantit dhe autoritetit, aplikanti mund te apeloje me njoftim tek Sekretari i Shtetit.

(2) Me berjen e nje apelimi te tille, kur Sekretari i Shtetit eshte

bindur se -

- (a) ne rastet e apelimeve sipas nen-seksionit (1)(a), qe refuzimi i autoritetit nuk ka baza, ose
- (b) ne rastet e apelimeve sipas nen-seksionit (1)(b), qe ne qofte se autoriteti ka refuzuar aplikimin, ai refuzim nuk ka baza,

ai do t'i jape certifikaten e perdorimit aplikuesit sipas kerkeses se tij, ose ne rastin e nje refuzimi te pjesshem te ndryshoje certifikaten e dhene nga autoriteti.

(3) Ne qofte se Sekretari i Shtetit bindet qe refuzimi i autoritetit eshte bere mbi baza te shendosha atehere ai e hedh poshte apelimin.

(4) Ne seksionin 193(2) dhe (6) referenca per aplikime per dhenien e certifikates se perdorimit perfshijne referenca per apelime qe lidhen me keto aplikime.

(5) Per qellime te aplikimeve te seksionit 288(10)(b) ne lidhje me nje apelim sipas nen-seksionit (1)(b) do te merret qe autoriteti refuzoi aplikimin ne fjale.

(6) Skedula (Aneksi) 6 aplikohet per apelime te bera sipas ketij seksioni.

Dispozita te
metejshtme per
referimet dhe
apelimet tek
Sekretari i
Shtetit

196.—(1) Perpara marrjes s evendimit per nje aplikim te bere sipas seksioni 192(5), Sekretari i Shtetit, ne qofte se aplikanti, apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal desherojne, duhet t'i jape mundesi per te shprehur mendimet e tyre tek nje person i emeruar nga Sekretari i Shtetit per kete qellim.

(2) Kur Sekretari i Shtetit jep certifikaten e kerkuar nga nje aplikim ose apelim, ai duhet te njoftoje autoritetin e planifikimit lokal per kete fakt.

(3) Vendimi i Sekretarit te Shtetit per aplikime ose apelime te tilla eshte final.

(4) Informacioni qe mund te kerkohet per tu rregjistruar sipas seksionit 69 duhet te perfshije informacion ne lidhje me certifikatat e perdorimit te dhena nga Sekretari i Shtetit.

(5) Me aplikime ose apelime te tilla, Sekretari i Shtetit, ne lidhje me perdorimin e tokes per te cilen nuk jepet certifikata, mund te jape leje planifikimi per ate perdorim, os eper

vazhdimin e perdorimit pa kushtet me te cilat eshte dhene nje leje e mepareshme.

(6) Ne rastet e perdorimit te tokes per te cilen Sekretari i Shtetit ka fuqi te jape leje planifikimi sipas ketij seksioni, aplikanti ose apeluesi do te konsiderohen sikur kane aplikuar per nje leje te tilel.

(7) Cdo leje e dhene ne menyre te tille do konsiderohet qe eshte bazuar ne nje aplikim.

PJESA VIII: **KONTROLLE TE VECANTA**

KAPITULLI I **PEMET**

Detyrat e autoriteteve planifikuese ne lidhje me pemet

Leje planifikimi
qe perfshijne
dispozita per
ruajtjen dhe
mjelljen e
pemeve.

- 197.—(1) Do te jete detyre e autoritetit te planifikimit lokal -
- (a) te siguroje, kudo qe eshte e pershtatshme, qe me dhenien e lejes se planifikimit per zhvillime, ka dispozita te mjaftueshme, qe me ane te venies se kushteve te mbrohen pemet dhe bimesia; dhe
 - (b) te nxjerre urdhera sipas seksionit 198 qe autoriteti i konsideron te nevojshme per dhenien e lejes, me kushte ose pa kushte.

Urdhera per mbrojtjen e pemeve

Fuqia per te
nxjerre urdhera
per mbrojtjen e
pemeve

198.—(1) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal e sheh te nevojshme krijimin e dispozitave per mbrojtjen e pemeve ose pyjeve ne zonen e tyre, ata mund te pregatisin nje urdher ne lidhje me te cilin pemet, grupet e pemeve, ose pyjet ne zonen e tyre.

(2) Nje urdher sipas nen-seksionit (1) ne kete Akt do te quhet "urdher per mbrojtjen e pemeve".

(3) Urdheri per mbrojtjen e pemeve mund te permbaje dispozita per -

- (a) ndalimin (pervec kur perjashtohet nga urdheri) e prerjes, heqjes se pjese se siperme, crrenjosjen ose demtimin me qellim te pemeve pervec me leje nga autoriteti i planifikimit lokal, dhe per te aftesuar autoritetin te jape kete leje me kushte;
- (b) per te bere te mundur ri-mbjelljen, ne menyre te caktuar ne urdher, te cdo pjese te vendosur me urdher;
- (c) per te aplikuar, ne lidhje me leje te dhena, dispozitat e ketij Akti te permendura ne nen-seksionin (4), ne varesi te modifikimeve dhe ndryshimeve te duhura.

(4) Dispozitat e permendura ne nen-seksionin (3)(c) jane—

- (a) dispozitat e Pjeses III ne lidhje me lejen e planifikimit dhe me aplikime per leje planifikimi, pervec seksioneve 56, 62, 65, deri 68, 69(3) dhe (4), 71, 80, 81, 91 deri 96, 100 dhe 101 te Skedules 8; dhe
- (b) seksionet 137 deri 141, 143 dhe 144 (pervec kur kane te bejne me njoftime per blerje te permendura ne seksionin 137(1)(b) ose (c));
- (c) seksioni 316.

(5) Nje urdher per mbrojtjen e pemeve mund te behet ne menyre te tille qe te aplikohet per pemet qe duhet te mbillen ne baze te nje kushti te permendur ne seksionin 197(a).

(6) Pa cenuar perjashtime qe mund te behen ne nje urdher per mbrojtjen e pemeve, asnje urdher do aplikohet per -

- (a) prerjen, crrenjosjen, copetimin e pemeve qe po vyshken ose qe jane bere te rrezikshme, ose
- (b) prerjen, crrenjosjen, copetimin e pemeve ne lidhje me detyrimet e vena nga nje Akt i Parlamentit.

(7) Ky seksion do kete efekt ne varesi te -

- (a) seksionit 39(2) te Aktit mbi Strehimin dhe Planifikimin 1986 (pervec rasteve ne seksionin 2(4) te Aktit te Qymyrgurit 1958 ne tokat qe mbulohen nga nje urdher per mbrojtjen e pemeve); dhe
- (b) seksioni 15 i Aktit mbi Pyjet 1967 (licenca

sipas Aktit per te rezuar peme qe perfshihen ne nje urdher per mbrojtjen e pemeve).

Forma dhe
procedura qe i
aplikohet
urdherave

199.—(1) Urdheri per mbrojtjen e pemeve nuk do hyje ne fuqi pa u konfirmuar nga autoriteti i planifikimit lokal dhe autoriteti i planifikimit lokal mund te konfirmoje urdherin me ose pa modifikime sic mendohet te jete e nevojshme.

(2) Me rregulla te bazuara ne kete Akti mund te behen dispozita ne lidhje me -

- (a) formatin e urdherave per mbrojtjen e pemeve, dhe
- (b) proceduren qe duhet te ndiqet ne lidhje me konfirmimin e ketyre urdherave.

(3) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (2), rregullat mund te bejne dispozita--

- (a) qe, perpara se te konfirmohet nje urdher per mbrojtjen e pemeve nga autoriteti i planifikimit lokal, njoftimi per nje urdher te tille duhet ti jepet pronareve ose perdoruesve te tokes qe ndikohet nga ky urdher dhe personave te tjere sic mund te caktohen ne rregulla;
- (b) qe verejtjet dhe komentet ne lidhje me urdherin, ne qofte se behen ne perputhje me rregullat, duhet te shqyrtohen perpara se te konfirmohet urdheri nga autoriteti i planifikimit lokal; dhe
- (c) kopje te urdherit, pas konfirmimit, duhet t'i dergohen personave qe tregohen ne rregulla.

Urdhera ne toke
me interes nga
Komisioneret e
Pyjeve

200.—(1) Ne lidhje me toka per te cilat ka interes Komisioneret e Pyjeve, urdher per mbrojtje te pemeve mund te behet vetem ne qofte se—

- (a) nuk ka fuqi ne lidhje me token e nje plani te veprimeve ose ndonje plan pune tjeter te aprovuar nga Komisioneret, dhe
- (b) Komisioneret bien dakord per dhenien e ketij urdheri.

(2) Per qellime te nen-seksionit (1), Komisioneret e Pyjeve konsiderohen vetem qe kane interes ne toke ne qofte se—

- (a) kane dhene nje kredi sipas seksionit 1 te Aktit mbi Pyjet 1979 ne lidhje me te, ose
- (b) ekziston nje mareveshje per dedikimin e

pyjeve ne fuqi ne lidhje me te.

(3) Nje urdher mbrojtjeje te pemeve ne lidhje me nje toke te tille, nuk do kete efekt per ndalimin ose per te kerkuar aprovimin, per prerjen e pemeve ne perputhje me nje plan veprimesh te aprovuar nga Komisioneret e Pyjeve, dhe sipas nje mareveshje pyjesh ose kushteve per dhenien e kredise sipas seksionit 1 te Aktit mbi Pyjet 1979.

(4) Ne kete seksion -

(a) "nje mareveshje pyjesh" do te thote nje mareveshje e bere me Komisioneret sipas seksionit 5 te Aktit mbi Pyjet 1967; dhe

(b) referencat per dispozitat e Aktit mbi Pyjet 1967 dhe Aktit mbi Pyjet 1979, perfshijne dispozita qe jane zevendesuar nga keto dispozita ose nga dispozita te mepareshme.

Dispozita te urdhrave per mbrojtjen e pemeve

201.—(1) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal e sheh te aresyeshme qe nje urdher per mbrojtjen e pemeve duhet te hyje ne fuqi menjehere pa konfirmim, ata mund te perfshine ne urdher qe ky seksion aplikohet.

(2) Pa marre parasysh seksionin 199(1), urdheri qe permban nje udhezim te tille -

(a) do hyje ne fuqi provizorisht ne daten qe caktohet ne te, dhe

(b) do vazhdoje te jete ne fuqi ne baze te ketij seksioni deri-

(i) te mbaroje periudha 6 mujore nga data e berjes se urdherit; ose

(ii) ne daten e konfirmimit,

cilado te ndodhe me perpara.

Fuqia e Sekretarit te Shtetit per te bere urdhera per mbrojtjen e pemeve

202.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit, pas konsultimit me autoritetin e planifikimit lokal, e sheh te nevojshme te behet nje urdher per mbrojtjen e pemeve, ose nje urdher qe revokon ose ndryshon nje urdher te tille, ai vete mund ta beje kete.

(2) Cdo urdher i bere nga Sekretari i Shtetit do kete te njejtin efekt sikur te ishte bere nga autoriteti i planifikimit lokal dhe i konfirmuar nga ai sipas ketij Kapitulli.

(3) Dispozitat e ketij Kapitulli dhe te ndonje rregulle te bere per proceduren qe duhet te ndiqet ne lidhje me berjen dhe

konfirmimin e nje urdheri te cilit i aplikohet nen-seksioni (1), do kene efekt ne varesi te ndonje modifikimi te nevojshem -

(a) ne lidhje me propozime nga Sekretari i Shtetit per te bere nje urdher te tille,

(b) ne lidhje me dhenien e urdherit nga Sekretari i Shtetit, dhe

(c) ne lidhje ne dergimin e kopjeve pasi eshte dhene urdheri.

Kompensime per humbje ose demtime te shkaktuara nga urdhera, etj.

Kompensime ne lidhje me nje urdher per mbrojtjen e pemeve

203.-- Urdheri per mbrojtjen e pemeve mund te permbaje dispozita per pagesa nga autoriteti i planifikimit lokal, ne varesi te perjashtimeve dhe kushteve qe vendosen ne urdher, per kompensime ne lidhje me humbje ose demtime per shkak te -

(a) refuzimeve te ndonje aprovimi qe kerkohet sipas ketij urdheri, ose

(b) dhenies se aprovimit me kushte.

Kompensime ne lidhje me kerkesat per mbjellje te pemeve

204.—(1) Ky seksion aplikohet kur -

(a) gjate zbatimit te dispozitave te bere ne nje urdher per mbrojtjen e pemeve, eshte dhene udhezimi nga autoriteti i planifikimit lokal ose nga Sekretari i Shtetit per te ri-mbjellur te gjitha ose nje pjese te zones pyjore qe jane prere gjate punimeve te lejuara ne urdher; dhe

(b) Komisioneret e Pyjeve vendosin te mos japin kredi sipas seksionit 1 te Aktit mbi Pyjet 1979 ne lidhje me ri-mbjelljen per aresye se udhezimi nderhyn ne perdorimin e zones per rritjen e drureve ose produkteve te tjera per perdorime tregtare, ose per aresye te rregullave per pyllezim.

(2) Kur ky seksion aplikohet, autoriteti i planifikimit lokal qe ushtron funksionet sipas urdherit per mbrojtjen e pemeve ka per detyre qe, me berjen e nje kerkese en perputhje me kete seksion, te paguaje kompensim per humbje ose demtime qe mund te kene ndodhur si rezultat i permbushjes se kerkesave ne udhezim.

(3) Komisioneret e Pyjeve, me kerkesen e nje personi qe duhet te zbatoje nje udhezim te permendur ne nen-seksionin (1)(a),

mund te japin nje certifikate qe permban -

- (a) nese kane vendosur apo jo per te dhene nje kredi sic permendet ne nen-seksionin (1)(b), dhe
- (b) ne qofte se po, aresyet e vendimit.

(4) Kerkesa per kompensim sipas ketij seksioni duhet ti jepet autoritetit te planifikimit lokal—

- (a) brenda 12 muajve nga data e dhenies se udhezimit, ose
- (b) kur eshte bere apelim tek Sekretari i Shtetit kunder vendimit te autoritetit te planifikimit lokal, brenda 12 muajve nga data e vendimit te Sekretarit te Shtetit per apelimin,

por ne varesi te ndonje periudhe te zgjatur sic mund te vendose autoriteti i planifikimit lokal.

Vendime ne lidhje me kerketat per kompensim

205.—(1) Cdo ceshtje ose mosmarreveshje me lidhje me kompensimet sipas seksioneve 203, ose 204 do ti kalohen per vendim Gjykates se Tokave, me perjashtim te rasteve kur vete urdheri ose rregulla ne baze te ketij Akti vendosin ndryshe.

(2) Ne lidhje me vendime per ceshtje te tilla, do aplikohen dispozitat e seksioneve 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961 me modifikimet e nevojshme dhe dispozitat e ketij Akti gjithashtu.

Rrjedhimet e zhgulyes se pemeve, etj.

Zevendesimi i pemeve

206.—(1) Ne qofte se nje peme, me te cilen lidhet urdheri per mbrojtjen e pemeve ne fuqi -

- (a) zhgulet, crrenjoset, ose shkaterrohet ne kundersizim me urdherin, ose
- (b) pervec rasteve kur pema eshte pjese e nje pylli, zhgulet, crrenjoset apo shkaterrohet autorizohet vetem nga seksioni 198(6)(a),

pronari i tokes do kete pergjegjesi per mbjelljen e nje peme tjeter te llojit dhe te permasave te njejta sa me shpejt te jete e mundur.

(2) Pergjegjësia e vene sipas nen-seksionit (1) nuk aplikohet per nje pronar kur pas aplikimit, autoriteti i planifikimit lokal ka hequr dore nga nje kusht i tille.

(3) Ne lidhje me pemet qe ndodhet ne nje pyll, per qellime te ketij seksioni, do mjaftoje zevendesimi i pemeve te hequra, ose te shakterruara me mbjelljen e nje numri te njejte pemesh -

- (a) ne nje toke prane asaj ku u hoqen pemet, ose
- (b) ne nje toke tjeter per te cilen eshte rene dakord me autoritetin e planifikimit lokal,

dhe ne toke per te cilen vendos autoriteti i planifikimit lokal.

(4) Ne lidhje me pemet e mbjellura sipas ketij seksioni, urdheri perkates per mbrojtjen e pemeve aplikohet sic aplikohet per pemet origjinale.

(5) Pergjegjësia e vene sipas nen-seksionit (1), pronarit te tokes, do jete pergjegjësia e pronarit te perkohshem te tokes.

Zbatimi i detyrave per zevendesimin e pemeve

207.—(1) Ne qofte se autoriteti i planifikimit lokal nxjerr konkluzionin qe -

- (a) dispozitat e seksionit 206, ose
- (b) kushtet e aprovimit te dhene ne nje urdher per mbrojtjen e pemeve, qe kerkon zevendesimin e pemeve,

nuk jane permbushur ne rastin e nje peme ose pemeve, autoriteti mund ti jape pronarit nje njoftim ku kerkohet qe brenda nje periudhe te caktuar, te mbjelle pemet ose pemet te atij lloji dhe te atyre permasave qe detajohen ne njoftim.

(2) Njoftimi sipas nen-seksionit (1) mund te jepet brenda 4 viteve nga data e mospermbushjes se kushteve apo dispozitave.

(3) ne varesi te seksionit 208, njoftimi sipas ketij seksioni do hyje ne fuqi ne fund te periudhes se caktuar ne te.

(4) Periudha e caktuar nuk mund te jete me e shkurter se 28 dite pas dhenies se njoftimit.

(5) Pergjegjësia e vene nga seksioni 206(1) mund te imponohet vetem ne baze te ketij seksioni dhe jo ndryshe.

Apelime kundra njoftimeve te s. 207

208.—(1) Personi i cili ka marre nje njoftim sipas seksionit 207(1) mund te apeloje tek Sekretari i Shtetit kunder njoftimit sipas nje nga aresyete te meposhtme—

- (a) qe dispozitat e seksionit 206 ose kushtet e permendura ne 207(1)(b) nuk aplikohen ose

- jane zbatuar;
- (b) qe kerkesat e njoftimit jane te paaresyeshme ne lidhje me periudhen ose me madhesine ose me llojet e pemeve;
 - (c) qe mbjellja e pemes ose e pemeve ne perputhje me njoftimin, nuk eshte ne interes ose eshte kunder praktikave te pyllzimit;
 - (d) qe vendi ku do mbillet pema ose pemet eshte i papershtatshem.
- (2) Nje apelim sipas nen-seksionit (1) mund te behet ne cdo kohe brenda periudhes se specifikuar ne njoftim si periudha perpara se te hyje ne fuqi njoftimi.
- (3) Apelimi duhet te behet me njoftim me shkrim tek Sekretari i Shtetit.
- (4) Njoftimi duhet te permbaje aresyet e apelimit dhe faktet mbi te cilat mbeshtetet.
- (5) Me nje apelim te tille, Sekretari i Shtetit, ne qofte se apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal desherojne, duhet t'i jape mundesi te paraqesin mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga ai per kete qellim.
- (6) Kur eshte bere apelim, njoftimi sipas seksionit 207(1) nuk duhet te hyje ne fuqi pa u marre vendimi ne lidhje me apelin ose pa u terhequr apeli.
- (7) Me marrjen e vendimit ne lidhje me apelin, Sekretari i Shtetit do jape udhezime per hyrjen ne fuqi te vendimit, qe perfshijne, sipas rastit, udhezime per hedhjen poshte te njoftimit sipas seksionit 207(1) ose per te ndryshuar ate.
- (8) Kur behet nje apelim i tille, Sekretari i Shtetit mund te --
- (a) korigjoke gabime apo difekte ne njoftimin e dhene sipas seksionit 207(1), ose
 - (b) jape udhezime per ndryshimin e kushteve,
- ne qofte se ai bindet se keto korigjime apo ndryshime nuk perbejne padrejtesi ndaj apeluesit apo autoritetit te planifikimit lokal.
- (9) Skedula (Aneksi) 6 aplikohet ne apelime te bera sipas ketij seksioni.
- (10) Kur nje person ka apeluar tek Sekretari i Shtetit kunder

nje njoftimi, as ai person as ndonje tjeter, ka te drejte te pretendoje qe njoftimi nuk eshte dhene si duhet personit qe apelon, pasi eshte bere apelimi.

Kryerja dhe kostoja e punimeve te kerkuara nga njoftime te s. 207.

209.—(1) Ne qofte se brenda nje periudhe te caktuar ne njoftim te bere sipas seksionit 207(1), per t'a zbatuar ate, ose brenda nje periudhe me te gjate te rene dakord me autoritetin e planifikimit lokal, pemet qe duhesh te mbillen nuk jane mbjellur, autoriteti mund te --

- (a) hyje ne toke dhe te mbjelle pemet, dhe
- (b) te marre nga personi qe eshte pronari shpenzimet qe ka bere per kete.

(2) Kur eshte dhene nje njoftim i tille—

- (a) cdo shpenzim i bere nga pronari i tokes per te zbatuar njoftimin, dhe
- (b) cdo shume e paguar nga pronari i tokes sipas nen-seksionit (1) ne lidhje me shpenzimet e bera nga autoriteti i planifikimit lokal per mbjelljen e pemeve,

do te konsiderohet si detyrim ose e paguar nga cdo person tjeter, pervec pronarit, qe eshte pergjegjes per prerjen, shkaterrimin ose heqjen e pemeve-originale.

(3) Rregullat e bera sipas ketij Akti mund te bejne te mundur qe --

- (a) seksioni 276 i Aktit mbi Shendetin Publik 1936 (fuqia e autoriteteve lokale per te shitur materiale qe zhvendosen gjate kryerjes se punimeve);
- (b) seksioni 289 i atij Akti (fuqia per ti kerkuar perdoruesit te cdo ndertese, qe te lejoje pronarin te beje punime); ose
- (c) seksioni 294 i atij Akti (kufizimi per detyrimet e personave qe jane agjente te ndertesave),

te aplikohen, ne varesi te modifikimeve te duhura sic mund te specifikohen ne rregulla, ne lidhje me masat qe duhen marre per nje njoftim sipas seksionit 207(1).

(4) Rregullat sipas nen-seksionit (3) qe aplikojne seksionin 289 te Aktit mbi Shendetin Publik 1936 mund te perfshijne modifikime per qellime te dhenies se te drejtes pronarit te tokes me te cilen lidhet njoftimi, kundrejt personave te tjere qe kane interes ne toke, t'i permbushen kerkesat e njoftimit.

(5) Rregullat sipas nen-seksionit (3) mund gjithashtu te bejne te mundur qe shpenzimet e nxjerra nga autorteti i planifikimit lokal sipas nen-seksionit (1) te ngarkohen ne toke.

(6) Kur ne baze te ketij seksioni ka shpenzime te rekuperueshme nga autoriteti i planifikimit lokal, keto shpenzime do te rekuperohen si borxh me kontrate, ose me ane te gjyqit.

Ndeshkime per
mos-perputhje
me urdhera per
mbrojtjen e
pemeve

210.—(1) Ne qofte se nje person, ne kundërshtim me nje urdher per mbrojtjen e pemeve—

(a) pret, crrenjos apo shkatërron me dijeni nje peme, ose

(b) demton me dijeni pjesen e siperme, deget e pemes ne nje menyre qe si rrjedhim do te vyshket,

ai do jete fajtor per nje fyerje.

(2) Personi qe eshte fajtor sipas nen-seksionit (1) do te jete i detyruar —

(a) te paguaje gjobe jo me te madhe se maksimumi ligjor, ose nje shume dy here me te madhe se vlera e percaktuar nga gjyqi per nje peme, cilado te jete me e madhe;

(b) kur denohet me padi, te paguaje gjobe.

(3) Ne percaktimin e shumes se gjobes se vene nje personi qe eshte denuar per fyerje me padi sipas nen-seksionit (1), gjyqi duhet te kete parasysh ndonje perfitim financiar si rezultat i fyerjes.

(4) Ne qofte se personi qe shkel dispozitat e nje urdherit per mbrojtjen e pemeve ne menyra te tjera pervec atyre te permendura ne nen-seksionin (1), ai do jete fajtor per fyerje dhe do detyrohet te paguaje gjobe qe nuk kalon nivelin 4 te shalles standarde.

(5) Ne qofte se, fyerja vazhdon sipas ketij seksioni, pasi eshte dhene denimi, personi do konsiderohet fajtor per fyerje te metejshme dhe do detyrohet te paguaje nje gjobe jo me te madhe se 5 Paunde ne dite, per cdo dite qe fyerja vazhdon.

Ruajtja e
pemeve ne zonat
e mbrojtura

Pemet ne zonat e mbrojtura

211.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni dhe seksionit 212, cdo person i cili, vepron ne lidhje me nje peme, ne menyre te ndaluar ne baze te seksionit 198(3)(a) nga nje urdher per mbrojtjen e pemeve, do jete fajtor per nje fyerje.

(2) Ne varesi te nen-seksionit 212, ky seksion aplikohet peer cdo peme ne nje zone te mbrojtur ne lidhje me te cilen nuk ekziston nje urdher per mbrojtjen e pemeve.

(3) Konsiderohet ne mbrojtje te personit te akuzuar per fyerje sipas nen-seksionit (1) ne qofte se ai provon qe —

(a) qe ai ka njoftuar per kete veprim (me detaje per identifikimin e pemes) autoritetin e planifikimit lokal ne zonen e te cilit ndodhet pema; dhe

(b) qe ai e beri veprimin ne fjale —

(i) me pelqimin e autoritetit te planifikimit lokal ne zonen e te cilit ndodhet pema, ose

(ii) pasi mbaroi periudha 6 mujore nga data e njoftimit por perpara mbarimit te periudhes dy vjecare nga ajo date.

(4) Seksioni 210 aplikohet per nje fyerje sipas ketij seksioni sic aplikohet per shkelje te nje urdheri te mbrojtjes se pemeve.

Fuqia per mos
aplikim

212.—(1) Sekretari i Shtetit me ane te rregullave mund te udhezroje qe seksioni 211 nuk aplikohet ne disa raste te detajuara ne rregulla.

(2) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), rregulat mund te bejen te mundur perjashtojne nga aplikimi i seksionit 211 raste ne lidhje me ceshtjet e meposhtme —

(a) veprime te bera ne rrethana ose me kushte qe tregohen ne rregulla;

(b) peme ne zona te mbrojtura sic percaktohet ne rregulla;

(c) peme te madhesise ose te llojit te caktuar; ose

(d) peme qe i takojne personave ose grupeve te caktuar.

(3) Rregullat, ne lidhje me ceshtjet per te cilat behet perjashtimi, perbejne dispozita te ndryshme per rrethana te ndryshme.

(4) Rregullat sipas nen-seksionit (1) ne vecanti, por pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit, mund te perjashtojne nga aplikimi i seksionit 211 raste te perjashtuara nga seksion 198 sipas seksionit (6) te atij seksioni.

Zbatime te kontroleve ne lidhje me pemet ne zonat e mbrojtura

213.—(1) Ne qofte se ndonje peme per te cilen aplikohet seksioni 211—

(a) eshte hequr, ose shkaterruar ne kundersizim me ate seksion; ose

(b) eshte hequr, crrenjosur apo vyshkur ne kohen kur prerja ose crrenjosja eshte autorizuar vetem ne baze te dispozitave te rregullave e nen-seksionit (1) te seksionit 212 sic permendet ne nen-seksionin (4) te atij seksioni,

pronari i tokes ka per detyre te mbjelle nje peme tjeter te llojin dhe permaseve te pershtatshme ne te njejtin vend sa me shpejt te jete e mundur.

(2) Keto detyra ne nen-seksionin (1) qe i vihen perpara pronarit nuk do te aplikohen kur jane hedhur poshte nga autoriteti i planifikimit lokal.

(3) Detyrat e nen-seksionit (1) qe ka pronari i tokes mund ti kalojne nje personi qe eshte pronar i perkohshem dhe mund te urdherohen vetem sipas seksionit 207.

Rregjistrimi i njoftimeve s.211.

214. - Eshte detyra e autoritetit te planifikimit lokal te hartoje dhe te mbaje gati per inspektimin e publikut pa pagese ne ore te caktuara dhe ne vend te pershtatshem, rregjistrin qe permban detaje te njoftimeve sipas nen-seksionit 211 qe kane lidhje me pemet e zones, sic percakton Sekretari i Shtetit.

KAPITULLI II

Toka qe demtojne komoditetin e vendeve te banimit

Fuqia per te kerkuar mirembajtje te tokes

215. —(1) Ne qofte se, autoriteti i planifikimit lokal konkludon qe komoditeti i nje pjese te zones se tyre, ose te nje zone ngjitur, demtohet nga gjendja e tokes ne zonen e tyre, ata mund t'i japin nje njoftim pronarit ose perdoruesit te tokes

sipas ketij seksioni.

(2) Njoftimi permban masa qe duhen marre per te rregulluar gjendjen e tokessic percaktohet ne njoftim, brenda nje periudhe te caktuar.

(3) Ne varesi te dispozitave te meposhtme ne kete Kapitull, njoftimi do hyje ne fuqi ne fund te nje periudhe e cila vendoset ne njoftim.

(4) Kjo periudhe nuk eshte me e shkurter se 28 dite nga data e dhenies se njoftimit.

Ndeshkime per mos-perputhje me njoftimet e s. 215.

216.—(1) Dispozitat e ketij seksioni do kene efekt kur njoftimi eshte bere sipas seksionit 215.

(2) Ne qofte se ndonje pronar apo perdorues i tokes qe ka marre njoftimin nuk merr masat e kerkuara nga njoftimi brenda periudhes se caktuar, ai do jete fajtor per fyerje dhe do detyrohet te paguaje gjobe qe nuk e kalon nivelin e trete te shkalles standarte.

(3) Kur jane bere akuzimet sipas nen-seksionit (2) kunder nje personi qe eshte pronar i tokes dhe kur ai perpara mbarimit te periudhes se caktuar per te marre masa, nuk eshte me pronari, ne qofte se ai —

(a) paraqet informacion te mjaftueshem per kete, dhe

(b) i jep prokurorit, jo me pak se tre dite perpara, njoftimin per nderrimin e proneses,

Atehere personi qe eshte bere pronar ka per detyre te dale ne gjyq ne vend te tij.

(4) Kur jane bere akuza sipas nen-seksionit (2) kunder nje personi qe eshte perdorues i tokes dhe kur ai perpara mbarimit te periudhes se caktuar per te marre masa, nuk eshte me perdorues, ne qofte se ai —

(c) paraqet informacion te mjaftueshem per kete, dhe

(d) i jep prokurorit, jo me pak se tre dite perpara, njoftimin per kete gje,

Atehere personi qe eshte bere perdorues ka per detyre te dale ne gjyq ne vend te tij, ose ne qofte se nuk ka perdorues, personi qe eshte pronari i tokes ne daten e dhenies se

njoftimit.

(5) Kur gjate akuzimeve te tilla -

- (a) ka prova e nuk jane marre masat sipas seksionit 215 brenda periudhes se caktuar, dhe
- (b) i akuzuari fillestar provon qe faji per keto probleme eshte i personit sipas nen-seksionit (3) ose (4),

Atehere:

- (i) ai person mund te denohet per fyerje; dhe
- (ii) ne qofte se i akuzuari fillestar provon gjithashtu se ai i ka marre te gjitha masat e kerkuara nga njoftimi, ai konsiderohet i pafajshem.

(6) Ne qofte se, pasi nje person eshte denuar nga dispozitat e mesiperme te ketij seksioni, ai nuk ben c'eshte e mundur per te permbushur kerkesat e njoftimit, sa me shpejt te jete e mundur, atehere ai eshte fajtor per fyerje te metejshme dhe detyrohet te paguaje nje gjobe qe nuk i kalon 40 Paunde ne dite, per cdo dite qe pas dhenies se denimit te pare, nuk permbushen kerkesat e njoftimit.

(7) Cdo reference qe i behet ne kete seksion periudhes se permbushjes se kerkesave te nje njoftimi, eshte reference per periudhen qe jepet ne njoftim per permbushjen e ketyre kerkesave, ose per nje periudhe me te zgjatur me pelqimin e autoritetit te planifikimit lokal.

Apelime ne gjykate kunder njoftimeve te s. 215.

217.—(1) Personi i cili ka marre nje njoftim sipas seksionit 215, ose persona te tjere qe kane interes ne token me te cilen lidhet njoftimi, ne cdo kohe brenda periudhes se dhene ne njoftim si periudhe ne fund te se ciles njoftimi hyn ne fuqi, mund te apeloje kunder njoftimit per aresyet e meposhtme—

- (a) qe gjendja e tokes me te cilen lidhet njoftimi nuk demton komoditetin e ndonje pjese te zones se autoritetit te planifikimit lokal qe ka bere njoftimin ose te ndonje zone fqinje;
- (b) qe gjendja e tokes me te cilen lidhet njoftimi eshte si rezultat i punimeve ose perdorimi qe nuk eshte ne kundërshtim me Pjesen III;
- (c) qe kerkesat e njoftimit jane te teperta per parandalimin e gjendjes qe ndikon ne prishjen e komoditetit te ndonje pjese te zones se

autoritetit te planifikimit lokal, ose te ndonje zone fqinje;

- (d) qe periudha e vendosur ne njoftim si periudha brenda se cilen duhet te marren masat eshte me e shkurter se duhet per te kryer dicka te tille.

(2) Cdo apelim sipas ketij seksioni do te behet ne nje gjykate magjistrale qe vepron per nje zone ne te cilen perfshihet toka ne fjale.

(3) Kur behet nje apelim i tille, njoftimi me te cilin lidhet nuk do te hyje ne fuqi derisa te merret vendimi perfundimtar ne lidhje me te, apo derisa te terhiqet apelimi.

(4) Kur behet nje apelim i tille, gjykata magjistrale mund te korigjoe gabimet apo difektet kur keto gabime ose difekte nuk jane vendimtare.

(5) Kur merret vendimi per nje apelim te tille, gjykata duhet te jape udhezime per fuqizimin e ketij vendimi, duke perfshire sipas rastit, udhezime per hedhjen poshte te njoftimit, ose per te ndryshuar ate ne favor te apeluesit.

(6) Kur nje person ka apeluar ne gjykate kunder nje njoftimi, as ai as ndonje person tjetër ka te drejte te pretendoje qe njoftimi nuk i eshte dhene si duhet, pas berjes se aplikimit.

Apelime te metejshme ne Gjykatën Penale

218. - Kur eshte bere nje apelim sipas seksionit 217, apelim kunder vendimit te gjykates magjistrale mund te behet ne Gjykatën Penale nga apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal qe ka bere njoftimin ne fjale sipas seksionit 215.

Kryerja dhe kostoja e punimeve te kerkuara nga njoftime te s. 215

219.—(1) Ne qofte se, brenda periudhes se specifikuar ne njoftim sipas seksionit 215 ne perputhje me nen-seksionin (2) te atij seksioni, ose brenda nje periudhe me te gjate te lejuar nga autoriteti i planifikimit lokal qe ka bere njoftimin, nuk jane marre masat e duhura per te zbatuar kerkesat e njoftimit, autoriteti i planifikimit lokal qe ka dhene njoftimin mund -

- (a) hyje ne toke dhe te marre masat e duhura, dhe
- (b) te rekuperoje shpenzimet e bera per kete gje nga personi qe eshte pronar i tokes.

(2) Kur eshte dhene nje njoftim sipas seksionit 215 -
(a) shpenzimet e bera nga pronari ose perdoruesi i tokes me qellim qe t'i permbahet njoftimit, dhe
(b) cdo shume e paguar nga pronari i tokes sipas nen-seksionit (1) ne lidhje me shpenzimet e bera nga autoriteti i planifikimit lokal ne lidhje me masat e kerkuara nga njoftimi,
do te konsiderohet si detyre ose e paguar nga ose me kerkesen e personit qe ka shkaktuar gjendjen e tokes per te cilen eshte dhene njoftimi.

(3) Rregullat e bera sipas ketij Akti mund te bejne te mundur qe-

- (a) seksioni 276 i Aktit mbi Shendetin Publik 1936 (fuqia e autoriteteve lokale per te shitur materiale qe zhvendosen gjate kryerjes se punimeve);
- (b) seksioni 289 i atij Akti (fuqia per ti kerkuar perdoruesit te cdo ndertese, qe te lejoje pronarin te beje punime); ose
- (c) seksioni 294 i atij Akti (kufizimi per detyrimet e personave qe jane agjente te ndertesave), te aplikohen, ne varesi te modifikimeve te duhura sic mund te specifikohen ne rregulla, ne lidhje me masat qe duhen marre per nje njoftim sipas seksionit 215.

(4) Rregullat sipas nen-seksionit (3) qe aplikojne seksionin 289 te Aktit mbi Shendetin Publik 1936 mund te perfshijne modifikime per qellime te dhenies se te drejtes pronarit te tokes me te cilen lidhet njoftimi sipas seksionit 215, kundrejt personave te tjere qe kane interes ne toke, t'i permbushe kerkesat e njoftimit.

(5) Rregullat sipas nen-seksionit (3) mund gjithashtu te bejne te mundur qe shpenzimet e nxjerra nga autorteti i planifikimit lokal sipas nen-seksionit (1) te ngarkohen ne toke.

(6) Kur ne baze te ketij seksioni ka shpenzime te rekuperueshme nga autoriteti i planifikimit lokal, keto shpenzime do te rekuperohen si borxh me kontrate, ose me ane te gjyqit.

KAPITULLI III: REKLAMIME

Rregulla mbi Reklamimet

Rregulla qe 220.—(1) Rregullat sipas ketij Akti perbejne dispozita per te kontrollojne kufizuar ose vene rregulla ne vendosjen e reklamave qe Sekretari i vendosjen e Shtetit i konsideron te nevojshme per mireqenien apo sigurine e reklamave e publikut.

(2) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), rregulla te tilla mund te bejne te mundur -

- (a) venien e rregullave per dimensionet, pamjen dhe pozicionin e reklamave qe mund te vendosen, dhe per vendet ku mund te vendosen si dhe per menyren e varjes apo vendosjes ne toke;
- (b) per te kerkuar aprovimin e autoritetit te planifikimit lokal per vendosjen e reklamave, ose te reklamave te nje klase te caktuar te treguar ne rregulla;
- (c) per te aplikuar, ne lidhje me nje aprovim te tille, ndonje dispozite te permendur ne nen-seksionin (3), ne varesi te modifikimeve qe tregohen ne rregulla;
- (d) per formimin, per qellime te zbatimit te ketyre rregullave, te komiteteve keshillimor, sic mund te percaktohen ne rregulla, dhe per te vendosur per menyren e mbulimit te shpenzimeve te tyre.

(3) Dispozitat te cilave i referohet nen-seksioni (2)(c) jane --

- (a) dispozitat e Pjeses III ne lidhje me lejen e planifikimit dhe me aplikime per leje planifikimi, pervec seksioneve 56, 62, 65, deri 68, 69(3) dhe (4), 71, 80, 81, 91 deri 96, 100 dhe 101 te Skedules (Aneksit) 8;
- (b) seksionet 137 deri 141, 143 dhe 144 (pervec kur kane te bejne me njoftime per blerje te permendura ne seksionin 137(1)(b) ose (c));
- (c) seksioni 316.

(4) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te fuqise te dhene nga ky seksion, rregullat e bera per qellime te ketij seksioni mund te bejne te mundur qe cdo apelim ndaj vendimit te autoritetit te planifikimit lokal ne lidhje me nje aplikim per aprovimin e tyre sipas rregullave, duhet te behet ne nje gjykate te pavarur te ngritur ne perputhje me rregullat, ne vend qe te behet tek

Sekretari i Shtetit.

(5) Ne qofte se eshte formuar nje gjykate e tille, Sekretari i Shtetit mund t'i paguaje Kryetarit apo anetareve te gjykates shperblime, si rroga ose pagesa, dhe pagesa ne lidhje me shpenzimet qe mund te behen gjate kryerjes se detyres, sic mund te vendoset me aprovimin e tij.

Fuqia per te bere rregulla per reklama te ndryshme ne zona te ndryshme

221.—(1) Rregullat e bera per qellime te seksionit 220 mund te perbejne dispozita te ndryshme ne lidhje me zona te ndryshme, dhe ne vecanti mund te perbejen dispozita te vecanta -

- (a) ne lidhje me zonat e mbrojtura;
- (b) ne lidhje me zona te percaktuara ne rregulla si zona eksperimentale, dhe
- (c) ne lidhje me zona te percaktuara ne rregulla si zona nen kontroll te vecante.

(2) Nje zone mund te perkufizohet si zone eksperimentale per nj periudhe te caktuar per qellime te vleresimit te ndikimit te reklamave ne komoditetin apo sigurine e publikut.

(3) Nje zone mund te perkufizohet si zone nen kontroll te vecante ne qofte se eshte -

- (a) zone rurale, ose
- (b) zone per te cilen Sekretari i Shtetit kerkon mbrojtje te vecante per aresye te komoditetit.

(4) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (1), rregullat mund te ndalojne vendosjen e reklamave ne nje zone nen kontroll te vecante, pervec reklamave te klasave te caktuara.

(5) Zona nen kontroll te vecante sipas ketij seksioni mund te percaktohen me urdher te bere ose te aprovuar nga Sekretari i Shtetit ne perputhje me dispozitat e rregullave.

(6) Kur Sekretari i Shtetit eshte autorizuar nga keto rregulla qe te jape ose te autorizojte nje urdher te tille sic permendet ne nen-seksionin (5), rregullat mund te bejne te mundur -

- (a) dhenien e njoftimeve per propozimin e nje urdheri ne nje format te caktuar,
- (b) per marrjen parasysh te verejtjeve ndaj tij, dhe
- (c) per te bere hetime ose seanca shqyrtimi sic mund te percaktohen,

perpara aprovimit te urdherit.

(7) Ne varesi te nen-seksionit (8), rregullat e bera sipas seksionit 220 mund te behen ne ate menyre qe te aplikohen -

- (a) tek reklama qe jane vene ne daten e hyrjes ne fuqi te rregullave, ose
- (b) per perdorimin per vendosjen e reklamave te vendeve qe jane perdorur per ate qellim ne ate date.

(8) Cdo rregull e bere ne perputhje me nen-seksionin (7) do te perfshije perjashtime per -

- (a) vazhdimin e vendosjes se ketyre reklamave sic permendet; dhe
- (b) vazhdimin e perdorimit per reklama te nje vendi sic permendet,

gjate nje periudhe te caktuar.

(9) Periudha te ndryshme mund te caktohen sipas nen-seksionit (8) per qellime te qellime te dispozitave te ndryshme.

Leje planifikimi nuk duhet per reklamime qe zbatojne rregullat

222.—(1) Kur reklamimet qe vendosen ne perputhje me rregullat e bera sipas seksionit 220, perfshijne zhvillime ne toke -

- (a) leja e planifikimit per keto zhvillime do te merret ne baze te ketij seksioni, dhe
- (b) nuk eshte nevoja e aplikimeve per zhvillime te tilla sipas Pjeses III.

Pagesa e shpenzimeve per heqjen e reklamave te ndaluara

Ripagimi i shpenzimeve per heqjen e reklamave te ndaluara

223.—(1) Kur, per qellime te zbatimit te rregullave te permendura ne seksionin 220, kryhen punime nga nje person -

- (a) per heqjen e reklamave te vena me daten 1 Gusht 1948; ose
- (b) per ndalimin e perdorimit te tokes per reklama qe deri me ate date eshte perdorur per nje gje te tille,

ai person, me nje kerkese te bere autoritetit te planifikimit lokal brenda nje periudhe te caktuar dhe ne nje menyre te caktuar, ka te drejte te marre nga autoriteti kompensim per shpenzimet e bera per kryejten e ketyre punimeve.

(2) Cdo mosmarreveshje ose ceshtje qe ngrihet duhet ti kalohet Gjykates se Tokave, pervec rasteve kur rregullat percaktojne ndryshe.

(3) Ne lidhje me marrjen e vendimit per nje ceshtje te tille, aplikohen dispozitat e seksionit 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin

e Tokes 1961, me modifikime te nevojshme dhe ne varesi te dispozitave te ketij Akti.

Ushtrimi i kontrollit mbi reklamamat

Zbatime te
kontrollit per
reklamamat

224.—(1) Rregullat sipas seksionit 220 perbejne dispozita qe mundesojne autoritetin e planifikimit lokal te kerkoje –
(a) heqjen e reklamave te cilat jane vene ne kundershkrim me rregullat, ose
(b) ndalimin e perdorimit te nje vendi per reklama qe eshte ne kundershkrim me rregullat.

(2) Per qellime te rregullave cdo dispozite sipas Pjeses VII ne lidhje me njoftimet e zbatimit ose dispozitat e seksionit 186, mund te aplikohen me modifikime te nevojshme.

(3) Pa cenuar dispozitat e perfshira ne rregulla te tilla ne baze te nen-seksioneve (1) ose (2), ne qofte se nje person vendos nje reklame ne kundershkrim me rregullat, ai eshte fajtor per fyerje dhe detyrohet te paguaje gjobe me nje shume te caktuar qe nuk e kalon nivelin e trete te shkalles standarde dhe, ne rastin kur fyerja vazhdon, 40 Paunde per cdo dite te vazhdimit te fyerjes pas denimit.

(4) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (3), personi mund te vendose nje reklame per qellime te atij nen-seksioni ne qofte se –

- (a) ai eshte pronari ose perdoruesi i tokes ne te cilen vihet reklama; ose
- (b) ajo reklamon biznesin, mallrat, tregetine, etj., te tij.

(5) Nje person nuk eshte fajtor per fyerje sipas nen-seksionit (3) vetem per aresye –

- (a) ai eshte pronari ose perdoruesi i tokes mbi te cilen eshte vendosur reklama, ose
- (b) reklamohen biznesi, mallrat, tregesia, etj., e tij, ne qofte se provon qe reklama eshte vendosur pa dijenine e tij.

Fuqia per te
hequr pllaka
dhe postera

225.—(1) Ne varesi te nen-seksioneve (2) dhe (3), autoriteti i planifikimit lokal mund te heqe nje pllake ose poster –
(a) te vene ne zonen e tyre; dhe
(b) qe per mendimin e tyre eshte vene ne kundershkrim me rregullat e bera sipas seksionit 220.

(2) Nen-seksioni (1) nuk autorizon heqjen e pllakave ose posterave te vene brenda ndertesave qe nuk jane publike.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), kur nje pllake apo poster identifikon personin qe e ka vene, autoriteti i planifikimit lokal nuk duhet te ushtroje veperiem sipas nen-seksionit (1) perpara se te japin nje njoftim me shkrim –

- (a) qe sipas tyre ajo cfare eshte afishur eshte ne kundershkrim me rregullat sipas seksionit 220; dhe
- (b) ata kane per qellim heqjen e saj pas nje periudhe te caktuar ne njoftim.

(4) Nen-seksioni (3) nuk aplikohet ne qofte se –

- (a) pllaka apo posteti nuk ka adresen, dhe
- (b) autoriteti nuk e di dhe nuk e gjen pas nje kerkimi te aresyeshem.

(5) Periudha e perfshire ne njoftim sipas nen-seksionit (3) nuk duhet te jete me e shkurter se 2 dite nga data e dhenies se njoftimit.

**PJESA IX:
BLERJE DHE MARRJE TE TOKES
PER QELLIME PLANIFIKIMI, ETJ.**

Blerje per planifikime dhe qellime publike

Blerje te
detyruar te
tokes per
zhvillime dhe
qellime te
tjera

226.—(1) Nje autoritet i planifikimit lokal per te cilin aplikohet ky seksion, autorizohet nga Sekretari i Shtetit per blerje te detyrueshme te cdo toke ne zonen e tyre e cila –

- (a) eshte e pershtatshme per kryerjen e zhvillimeve, ri-zhvillimeve, ose permiresimeve; ose
- (b) kerkohet per qellime te cilat eshte e nevojshme te permbushen per interes te planifikimit te pershtatshem ne zonen ku ndodhet toka.

(2) Autoriteti i planifikimit lokal dhe Sekretari i Shtetit gjate marrjes se vendimeve ne (1)(a) nese toka eshte e pershtatshme per zhvillime, ri-zhvillime ose permiresime duhet te kene parasysh –

- (a) dispozitat e planeve te zhvillimit, ne qofte se kane te bejne me token;
- (b) nese eshte ne fuqi leja e planifikimit per ndonje zhvillim ne ate toke; dhe

(c) ndonje konsiderate tjeter qe mund te jete e rendesishme per te shqyrtuar aplikime per leje planifikimi per zhvillime ne toke.

(3) Kur autoriteti i planifikimit lokal ushtron fuqine e tij sipas nen-seksionit (1) per nje toke, atehere ata pasi jane autorizuar nga Sekretari i Shtetit do kene fuqine te blejne me detyrim -

(a) cdo toke ngjitur tokes qe kerkohet per qellime te punimeve per te lehtesuar zhvillimin ose perdorimin; ose

(b) kur toka eshte pjese e nje hapësire te perbashket ose kopeshiti, ose lulishte, cdo toke qe kerkohet per qellime te shkembimit me token qe blihet.

(4) Nuk eshte i rendesishem fakti se kush caktohet nga autoriteti i planifikimit lokal per zbatimin ose kryerjen e aktiviteteve ose qellimeve te permendura ne nen-seksionin (1) ose (3)(a) (dhe autoriteti i planifikimit lokal nuk ka nevojte te propozoje per marrjen persiper te aktivitetit ose per te arritur qellimet).

(5) Kur sipas nen-seksionit (1) Sekretari i Shtetit ka fuqi te autorizojte autoritetin e planifikimit lokal te cilit i aplikohet ky seksion te bleje token, ai, pasi konsultohet, te autorizojte blerjen e tokes nga nje autoritet tjeter lokal sipas ketij Akti.

(6) Perpara se te jape autorizimin e permendur ne nen-seksionin (5), Sekretari i Shtetit duhet -

(a) ne qofte se toka eshte ne nje qark jo-metropolitan, te konsultohet me keshillin e qarkut dhe te rrethit;

(b) ne qofte se toka eshte ne nje rreth metropolitan, te konsultohet me keshillin e rrethit; dhe

(c) ne qofte se toka eshte ne zonen e Londres, te konsultohet me keshillin e zones.

(7) Akti mbi Blerjen e Tokes 1981 aplikohet per blerje te detyrueshme te tokes sipas ketij seksioni.

(8) Autoritetet lokale te cilave i aplikohet ky seksion jane keshillat e qarqeve, rretheve, dhe zones se Londres.

Blerje e tokes
me
mareveshje

227.—(1) Keshilli i nje qarku, rrethi ose i zones se Londres mund te bleje me mareveshje nje toke qe duhet per qellime per te cilat eshte autorizuar sipas seksionit 226.

(2) Dispozitat e Pjese i te Aktit mbi Blerjen e Detyrueshme 1965,

pervec seksioneve 4 deri 8, seksionit 10 dhe seksionit 31, do te aplikohen ne lidhje me blerje sipas ketij seksioni.

Blerje e tokes nga Sekretari i Shtetit per Mjedisin mund te bleje me detyrim—

(a) cdo toke te nevojshme per sherbime publike; dhe
(b) cdo toke qe propozohet jo vetem per sherbime publike, por gjithashtu—

(i) per interesa te planifikimit te pershtatshem ne zone, ose

(ii) per te siguruar zhvillimin ekonomik maksimal, ose perdorimin me te mire te tokes,

pervec sherbimeve publike.

(2) Kur Sekretari i Shtetit blen, ose propozon te bleje nje toke sipas nen-seksionit (1) ("toke kryesore") dhe e sheh te arsyeshme blerjen e nje toke tjeter se bashku me token kryesore -

(a) ne interes te planifikimit te duhur per zonen ne fjale; ose

(b) per qellime qe toka kryesore te perdoret apo te shfrytezohet mire dhe ne menyre sa me ekonomike (se bashku me token tjeter); ose

(c) per qellime te shkembimit te tokes, kur toka kryesore ose cdo toke e blere, ose qe propozohet te blihet, ne baze te paragrafeve (a) ose (b) te ketij nen-seksioni ose te seksionit 122(1)(a) ose (b) te Aktit mbi Qeverine Lokale, Planifikimin dhe Tokat 1980, perben pjese te nje hapësire te perbashket, lulishteje, ose zone karburanti,

ai mund te bleje token me detyrim.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), fuqia per blerjen e detyrueshme te tokes sipas ketij seksioni, perfshin fuqi per te blere te drejten mbi token.

(4) Nen-seksioni (3) nuk do te aplikohet per te drejten mbi toka qe per qellime te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981 eshte pjese e perbashket, hapësire, lulishte, ose zone karburanti.

(5) Referenca qe i behen ne kete seksion sherbimeve publike perfshijen sherbime ne Mbreterine e Bashkuar—

(a) te ndonje organizate nderkombetare ose instituti nese eshte apo jo anetare Mbreteria e Bashkuar ose Qeveria ne Mbreterine e Bashkuar do behet ose jo anetare;

- (b) te ndonje zyre ose agjensie te krijuar nga keto organizata ose institucione, ose te ngritura ne lidhje me nje traktat (nese eshte apo jo Mbreteria e Bashkuar pjese e traktatit);
- (c) te sherbimeve te Qeverive apo Fuqive te huaja.

(6) Per qellime te nen-seksionit (5)(b) "traktat" perfshin mareveshje nderkombetare dhe ndonje protokoll ose aneks te nje traktati ose mareveshjeje nderkombetare.

(7) Akti mbi Blerjen e Tokes 1981 do aplikohet per blerje te detyruar nga Sekretari i Shtetit per Mjedisin sipas ketij seksioni.

Pervetesimi i tokes qe eshte e perbashket

229.—(1) Cdo autoritet i planifikimit lokal mund te autorizohet, me urdher te bere nga autoriteti dhe te konfirmuar nga Sekretari i Shtetit, te pervetesojte per qellime te cilat mund te autorizohet per te blere toke se cilen i aplikohet ky nen-seksion qe mbahet nga autoriteti per qellime te tjera.

(2) Nen-seksioni (1) aplikohet per toke qe eshte pjese e nje zone te perbashket, lulishte ose zone karburanti (qe perfshin toke publike, lokale, apo private, qe lidhet me nje miratim), pervec tokave qe ndodhen ne Brezin (Rripin) e Gjelber, sipas kuptimit te Aktit mbi Brezin e Gjelber 1938.

(3) Seksioni 19 i Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981 (dispozita te vecanta ne lidhje me urdherat e blerjeve te detyrueshme sipas atij Akti qe lidhen me hapesirat e perbashketa, lulishtet, etj.) do aplikohet per urdhera sipas ketij seksioni qe autorizojne pervetesimin e tokes sic aplikohen me blerjet e detyrueshme ne ate Akt.

(4) Kur toka e pervetesuar sipas ketij seksioni ishte blere sipas nje miratimi bazuar ne Aktin mbi Klauzolat e Tokes, cdo punim i bere ne toke pas pervetesimit per qellime te seksionit 68 te Aktit mbi Konsolidimin e Klauzolave te Tokes 1845 dhe seksionit 10 te Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1965, do te konsiderohet i autorizuar nga miratimi ne baze te cilit toka u ble.

(5) Gjate pervetesimit te tokes nga autoriteti i planifikimit lokal sipas ketij seksioni—

- (a) autoriteti nuk eshte autoriteti te cilit i aplikohet Pjesa II e Aktit te Vitit 1959;

- (b) toka perpara pervetesimit mbahej nga autoriteti per qellime te funksioneve te ndihmes (sipas kuptimit te atij Akti); ose
- (c) toka eshte pervetesuar nga autoriteti me qellim kryerjen e ketyre funksioneve,

mund te behen rregullime apo pershtatje ne lidhje me autoritetin lokal sic udhezohet Sekretari i Shtetit.

(6) Me pervetesimin sipas ketij seksioni qe nuk bie ne nen-seksionin (5), rregullime apo pershtatje te tilla duhet te behen sic kerkohet nga seksioni 24(1) i Aktit te vitit 1959.

Blerja e tokes me qellim shkembimi

230.—(1) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te te fuqive te dhena nga seksionet 226 dhe 227, cdo fuqi qe ka autoriteti lokal per te blere token sipas ketyre seksioneve, me detyrim ose me mareveshje, do te perfshije fuqi per te blere token e kerkuar per ta shkember —

- (a) me toke te pervetesuar sipas seksionit 229; ose
- (b) me toke ne Rripin e Gjelber ne perputhje me Aktin mbi Rripin e Gjelber 1938 per qellime te detajuara ne planin e zhvillimi.

(2) Ne nen-seksionin (1) "toke ne Brezin e Gjelber" ka te njejtin kuptim si ne ate Akt.

Fuqite e Sekretarit te Shtetit per te kerkuar blerjen ose zhvillimin e tokes

231.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit eshte i bindur, pas kryerjes se nje hetimi qe keshilli i qarkut, rrethit ose zones se Londres nuk kane marre masa per blerjen e ndonje toke qe per mendimin e tij duhet te ishte blere sipas seksionit 226 per qellime ne interes te nje planifikimi te mire ne zonen ku ndodhet toka, ai mund te kerkoje me urdher qe keshilli te marre masat e detajuara ne urdher.

(2) Ne qofte se Sekretari i Shtetit eshte i bindur, pas kryerjes se nje hetimi, qe autoriteti lokal, ne nje toke te blere sipas seksionit 226 (ose seksionit 68 te Aktit te vitit 1962 ose seksionit 112 te Aktit te vitit 1971) ose te pervetesuar sipas seksionit 229, nuk ka kryer zhvillime qe duheshin kryer, ai me urdher mund te kerkoje qe autoriteti te marre masa per kryerjen e zhvillimit.

(3) Urdherat e dhene sipas ketij seksioni do te fuqizohen me nje mandat nga Sekretari i Shtetit.

Pervetesime, dhe zhvillime ne toke te mbajtur per qellime planifikimi, etj.

Pervetesime
te tokes se
mbajtur per
qellime
planifikimi

232.—(1) Kur nje toke eshte blere apo pervetesuar nga nje autoritet lokal per qellime planifikimi dhe tashme mbahet nga ata per qellime te cilat u ble ose u pervetesua, autoriteti mund te pervetesoje token per qellime per te cilat jane te autorizuar per te blere token ne baze te ndonje miratimi qe nuk permbahet ne kete Pjese ose ne Kapitullin V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990.

(2) Toka qe konsiston ose perben pjese te nje vendi te perbashket, ose qe ishte e tille me perpara, dhe qe mbahet ose menaxhohet nga autoriteti lokal ne perputhje me nje Akt lokal nuk mund te pervetesohet sipas ketij seksionin pa aprovimin e Sekretarit te Shtetit.

(3) Aprovim i tille mund te jepet –

- (a) ose ne lidhje me nje pervetesim te vecante ose me nje klase pervetesimesh, dhe
- (b) me ose pas kushte ose kufizime.

(4) Perpara se te pervetesohet toka sipas ketij seksioni cdo toke qe konsiston ne ose perben pjese te nje hapesire, nje autoritet lokal –

- (a) duhet te nxjerre nje njoftim per kete qellim per te pakten dy jave ne nje gazete qe qarkullon ne ate zone; dhe
- (b) duhet te kete parasysh cdo verejtje te bere per pervetesimin e propozuar.

(5) Ne lidhje me nje pervetesim sipas ketij seksioni –

- (a) nen-seksioni (4) i seksionit 122 i Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 (qe lidhet me veprime te seksionit 68 te Aktit mbi Konsolidimin e Klauzolave te Tokes 1845 dhe seksionin 10 te Aktit mbi Blerjet e Detyruara 1965) ka efekt, sic ka efekt ne lidhje me pervetesime sipas seksionit 122 te Aktit te vitit 1972; dhe
- (b) nen-seksioni (5) dhe (6) i seksionit 229 te ketij Akti ka efekt, sic ka efekt ne lidhje me pervetesimet ne ate seksion.

(6) Ne lidhje me nje toke te tille te permendur ne nen-seksionin (1), ky seksion do kete efekt ne perjashtimin e dispozitave te seksionit 122(1) te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972.

Dhenia nga
autoriteti
lokal te tokes
se mbajtur
per qellime
planifikimi

233.—(1) Kur nje toke qe eshte blere ose pervetesuar nga autoriteti lokal per qellime planifikimi, dhe ne kete kohe mbahet nga ata per qellime per te cilat u ble apo u pervetesua, autoriteti mund te ja jape token personave te tille, ne varesi te kushteve qe konsiderohen te nevojshme me qellim qe –

- (a) te arrihet perdorimi me i mire i asaj toke, ose toke tjeter dhe i ndertesave ose punimeve qe jane ndertuar, po ndertohen ose do ndertohen ne te (nga personi ose nga ata vete), ose
- (b) per ngritjen, konstruksionin, ose kryerjen ne te, te ndertesave apo punimeve te duhura per nje planifikim te mire te zones se autoritetit.

(2) Toka qe konsiston ne ose eshte pjese e nje vendi te perbashket, dhe qe mbahet ose menaxhohet nga autoriteti lokal ne perputhje me nje Akt lokal nuk do te jepet sipas ketij seksioni pa aprovimin e Sekretarit te Shtetit.

(3) Aprovimi i Sekretarit te Shtetit kerkohet gjithashtu kur dhenia e tokes, mendohet se mund te behet per aresye me perfituese dhe nuk eshte –

- (a) dhene per nje kohe 7 vjecare ose me te vogel; ose
- (b) dhene per disa vite prej te cilat 7 vite nga data e dhenies nuk kane perfunduar.

(4) Perpara se te jepet toka qe konsiston ose perben nje vend te hapur apo hapesire sipas ketij seksioni, autoriteti lokal –

- (a) duhet te botoje nje njoftim per kete qellim per te pakten dy jave njera pas tjeters ne nje gazete qe qarkullon ne zonen e tyre; dhe
- (b) do te kete parasysh cdo verejtje te bere ne lidhje me propozimin per te dhene token.

(5) Ne lidhje me token e blere ose te pervetesuar per qellime planifikimi per aresye te permendura ne seksionin 226(1)(a) ose (3) fuqite e dhena nga ky seksion autoritetit lokal, dhe Sekretarit te Shtetit ne lidhje me aprovimin per dhenie te tokes sipas ketij seksioni, do te ushtrohen per t'i gjetur perdoruesve te tokes akomodim te aresyeshem.

(6) Nje person eshte perdoruesi perkates per qellime te nen-seksionit (5) ne qofte se –

- (a) ai banonte ose kryente nje biznes apo aktivitet tjeter ne ndonje toke qe permendet ne ate nen-seksion te cilen e ka blere autoriteti sipas nen-seksionit (1),

(b) ai desheron te vendoset ne ate toke, dhe
(c) eshte i gatshem te zbatoje kerkesat e autoritetit ne lidhje me zhvillimin dhe perdorimin e tokes; dhe ne kete nen-seksion "zhvillim" perfshin ri-zhvillimin.

(7) Ne nen-seksionin (5) akomodim i aresyeshem, ne lidhje me nje person, do te thote mundesi per tu vendosur ne ate toke qe i pershtatet kerkesave te aresyeshme te tij ne lidhje me kushtet dhe cmimin qe toka eshte blere nga ai.

(8) Ne lidhje m enje toke te tille te permendur ne nen-seksionin (1), ky seksion do kete efekt me perjashtim te seksionit 123 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972.

Dhenia nga Sekretari i Shtetit i tokes se blere sipas s. 228.

234.—(1) Sekretari i Shtetit mund te jape nje toke qe mbahet nga ai dhe te blere nga ai ose ndonje Minister tjeter sipas seksionit 228 nje personi te tille, ne nje menyre dhe ne baze te kushteve qe ai i konsideron te nevojshme.

(2) Ne vecanti Sekretari i Shtetit, sipas nen-seksionit (1), mund te jape nje toke qe mbahet nga ai per cfaredo qellime, per te siguruar perdorimin e tokes per keto qellime.

Zhvillime te tokes se mbajtur per qellime planifikimi

235.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal mund te --
(a) ndertoje, ose kryeje, ne toka per te cilat aplikohet ky seksion, ndertesa ose punime, pervec ndertesave ose punimeve per ngritjen ose kryerjen e te cilave, nga autoriteti lokal apo ndonje person, ekziston fuqi ligjore ne baze te nje miratimi alternativ; dhe
(b) riparoje, mirembaje dhe siguroje cdo ndertese apo punim ne ate toke dhe ne pergjithesi te merret me token per qellime te tilla.

(2) Ky seksion aplikohet per cdo toke e cila --
(a) eshte blere ose pervetesuar nga nje autoritet lokal per qellime planifikimi, dhe
(b) mbahet gjete kesaj kohe nga autoriteti per qellimet qe u ble ose u pervetesua.

(3) Nje autoritet lokal mund te ushtroje fuqite e dhena nga nen-seksioni (1) pavaresisht nga ndonje kufizim i vendosur me ligj per kapacitetin ne lidhje me perberjen e tyre.

(4) Nje autoritet lokal mund te hyje ne mareveshje me nje shoqate te autorizuar, qe shoqata te erylje punime, qe autoriteti ka fuqine ne baze te ketij seksion ti kryeje, me kushte te vecanta te vendosura ne marreveshje (duke perfshire pagesa apo kredi qe autoriteti i jep shoqates).

(5) Asgje ne kete seksion do merret --
(a) qe autorizon ndonje veprim nga autoriteti lokal, qe duhet te kryer nga nje person me perjashtim te kufizimeve te permendura ne nen-seksionin (3); ose
(b) qe autorizon qe shoqate te autorizuar per te bere punime qe nuk kane autorizim per ti bere nga nen-seksioni (4).

(6) Ne kete seksion --
• "miratim alternativ" do te thote cdo miratim i cili nuk permbahet ne kete Pjese, ne seksionin 2, 5 ose 6 te Aktit mbi Autoritetet Lokale 1963, ne seksionin 14(1) ose (4) ose 17(3) te Aktit mbi Zhvillimet Industriale 1982 ose ne Kapittullin V te Pjese i te Aktit mbi Planifikimin 1990; dhe
• "shoqate e autorizuar" do te thote cdo shoqate, komani, se grup personash--
(a) objektivat e te ciles perfshijne formimin, menaxhimin, rregullimin, e kopshteve dhe lulishteve ne qytete, periferi ose fshatra dhe ngritjen, permiresimin dhe menaxhimin e ndertesave per punetoret dhe te tjere, dhe
(b) te cilet jane jo-fitimprurese ose qe statuti i te cilave ndalon nxjerrjen e aksioneve ose kapitaleve me interes ose dividend me te madh se ai i vendosur nga Thesari i shtetit.

Heqje e te drejtave mbi token te blere detyrimisht

Heqja e disa te drejtave qe ndikojne ne token e blere ose te pervetesuar

236.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, me perfundimin e blerjes se detyruar sipas seksioneve 226, 228 ose 230 --
(a) te gjitha te drejtat private per te mbajtur, ngritur ndonje aparat ne, mbi ose nen toke do te hiqen, dhe
(b) nje aparat i tille mbetet me autoritetit bleses.

(2) Nen-seksioni (1) nuk aplikohet --

- (a) per te drejtat e sipermarresve ligjor, per aparate qe i takojne dhe per qellime te kryerjes se detyrave te tyre, ose
- (b) per te drejtat e dhena operuesit te nje sistemi telekomunikacioni ne perputhje me kodin e telekomunikacionit, ose
- (c) per aparate telekomunikacioni te instaluar per keto qellime.

(3) Ne lidhje me te drejtat ose aparatet qe nuk perfshihen ne nen-seksionin (2), nen-seksioni (1) do te kete efekt ne varesi te -

- (a) ndonje udhezimi te dhene nga autoriteti bleres perpara perfundimit te blerjes, qe nen-seksioni (1) nuk aplikohet per nje te drejte ose aparat qe specifikohet ne udhezim; dhe
- (b) te ndonje mareveshje te bere (pas ose perpara blerjes) ndermjet autoritetit lokal dhe personit per te drejtat ose aparatet ne fjale.

(4) Cdo person qe peson humbje nga heqja e te drejtave ose te ndonje aparati sipas ketij seksioni ka te drejten e kompensimit nga autoriteti lokal.

(5) Cdo kompensim sipas ketij seksioni do te percaktohet ne perputhje me Aktin mbi Kompensimin e Tokes 1961.

Fuqia per te mos marre parasysh te drejtat

237.—(1) Ne varesi te nen-seksionit (3), ngritja, konstruksioni, ose mirembajtja e ndonje ndertese ose punimi ne token qe eshte blere ose pervetesuar nga autoriteti lokal per qellime planifikimi (nese behet nga autoriteti apo nga nje person i caktuar nga ata) autorizohet ne baze te ketij seksioni ne qofte se behet ne perputhje me lejen e planifikimit, pavaresisht se perfshin -

- (a) nderhyrje ne nje interes apo e drejte per te cilen aplikohet ky seksion, ose
- (b) shkelje te kufizimeve te perdoruesit te toke ne baze te nje kontrate.

(2) Ne varesi te nen-seksionit (3), interesat dhe te drejtat qe ky seksion aplikon jane te drejtat, privilegjet, lirite ose avantazhet e bashkangjitura tokes dhe qe ndikojne ne nje toke tjeter, duke perfshire te drejtat natyrore.

(3) Asgje ne kete seksion autorizon nderhyrje ne te drejtat per ngritjen, mirembajtjen dhe vazhdimin e perdorimit te nje aparati mbi, ne, ose nen toke, e cila -

- (a) eshte e drejte qe i takon sipermarresve ligjor per qellime te kryerjes se detyrave te tyre, ose
- (b) eshte e drejte e dhene ne perputhje me kodin e telekomunikimit e nje operuesi te sistemit te telekomunikimit.

(4) Ne lidhje me nderhyrje apo shkelje sipas nen-seksionit (1), kompensime -

- (a) do paguhet sipas seksionit 63 ose 68 te Aktit mbi Konsolidimin e Klausolave te Tokes 1845 ose sipas seksionit 7 ose 10 te Aktit mbi Blerjet e Detyrueshme 1965, dhe
- (b) do te percaktohet ne te njejten menyre dhe ne varesi te te njejtave rregulla si ne rastin e kompensimeve te tjera, kur -
 - (i) kompensimi vleresohet ne lidhje me blerjet sipas atyre Akteve, ose
 - (ii) demtimi shkaktohet nga punimet ne token e blere sipas ketyre Akteve.

(5) Kur nje person qe i eshte dhene nje e drejte nga autoriteti lokal nga i cili eshte blere ose pervetesuar toka -

- (a) ka per detyre te paguaje kompensim ne baze te nen-seksionit (4), dhe
- (b) nuk e permbush detyrimin,

atehere detyrimi bie mbi autoritetin lokal.

(6) Asgje ne nen-seksionin (5) nuk ndikon ne ndonje marreveshje ndermjet autoritetit lokal dhe ndonje personi tjeter qe cliron autoritetin lokal nga cdo detyrim sipas atij nen-seksioni.

(7) Asgje ne kete seksion autorizon ndonje veprim nga ana e nje personi, qe duhet te behen nga nje person tjeter, pervec atyre qe permenden ne nen-seksionin (1).

Perdorimi dhe zhvillimi i tokes se shenjte

238.—(1) Pavaresisht nga ndonje detyrim apo kufizim i vendosur nga ligji klerikal ose ne lidhje me nje toke te shejte, cdo toke e tille qe eshte blere apo pervetesuar mund te varet nga dispozitat e meposhtme te ktij seksioni—

- (a) ne qofte se eshte blere nga nje Minister, te perdoret ne menyre te tille nga ai ose ne emer te tij per qellimet per te cilat eshte blere; dhe
- (b) ne cdo rast tjeter, te perdoret nga nje person ne perputhje me lejen e planifikimit.

(2) Nen-seksioni (1) nese toka perfshin ndertese apo jo, por nuk aplikohet per toka qe jane perdorur per varreza.

(3) Perdorime te tokave te shenjta sic permendet ne nen-seksionin (1) do te jene ne varesi te -

- (a) zbatimit te kerkesave te duhura ne lidhje me—
 - (i) heqjen dhe levizjen e eshtrave, dhe
 - (ii) zhvendosjen e monumenteve dhe mobiljeve; dhe
- (b) dispozitave te tilla sic mund te caktohen per ndalimin ose kufizimin e perdorimit te tokes, ose absolutisht ose derisa te merret nje aprovim i caktuar, perderisa nje kishe ose ndertesa te tjera te perdorura me pare per ceshtje fetare, ose nje pjese e tyre, mbesin ne toke.

(4) Perdorime te tokave te tjera pervec atyre te shenjta te cilat -

- (a) jane blere apo pervetesuar, dhe
- (b) ne kohen e blerjes apo pervetesimit perfshihej nje kishe ose ndertesa te tjera qe jane perdorur me pare per qellime fetare, ose toka e kishes apo ndertesave te tilla,

do te jene ne varesi te zbatimit te kerkesave qe permenden ne (3)(a).

(5) Cdo rregull e bere per qellime te nen-seksioneve (3) ose (4)—

- (a) duhet te permbaje dispozita te tilla te cilat Sekretari i Shtetit i konsideron te rendesishme per te siguruar qe perdorimi i tokes te jete ne varesi te te njejtit kontroll te vendosur me ligj ne rastet e perdorimit te ngjashem te autorizuar nga miratime qe nuk permbahen ne kete Akt;
- (b) te permbaje kerkesa ne lidhje me dhenien e nje toke te tille te permendur ne nen-seksionin (3) ose (4), qe Sekretari i Shtetit i konsideron te rendesishme per te bere te mundur qe dispozitat e ketyre nen-seksioneve te zbatohen ne lidhje me perdorimin e tokes; dhe
- (c) mund te permbaje dispozita rrjedhimore (duke perfshire dispozita per mbylljen e rregjistrave) qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme per qellimet e rregullave.

(6) Asgje ne kete seksion do merret qe autorizon ndonje veprim nga ana e ndonje personi per hir te nje personi tjeter per cfaredo aresye ,pervec me qellim te kundeshtimeve te detyrimeve,

kufizimeve ose miratimeve sic permendet ne nen-seksionin (1).

Perdorimi
dhe zhvillimi
i varrezave

239.—(1). Pavaresisht nga ndonje miratim ne lidhje me tokat e varrezave ose nga nje detyrim apo kufizim i vene nga ligji klerik, cdo toke qe eshte varreze qe eshte blere apo pervetesuar, mund -

- (a) ne qofte se eshte blere nga nje Minister, te perdoret ne cdo menyre nga ai ose nga persona ne emer te tij, per qellimet per te cilat eshte blere; dhe
- (b) ne cdo rast tjeter, te perdoret ne perputhje me lejen e planifikimit.

(2) Ky seksion nuk aplikohet per toka qe jane perdorur si varreza, perderisa te plotesohen kerkesat per zhvendosjen e eshtrave, dhe monumenteve, ne ate toke.

(3) Asgje ne kete seksion do merret qe autorizon ndonje veprim nga ana e ndonje personi per hir te nje personi tjeter per cfaredo aresye ,pervec me qellim te kundeshtimeve te detyrimeve, kufizimeve ose miratimeve sic permendet ne nen-seksionin (1).

Dispozita
suplementar
e per s. 238
dhe 239.

240.—(1) Dispozita duhet te krijohen nga rregulla per qellime te seksioneve 238(3) dhe (4) dhe 239(2)—

- (a) per te kerkuar nga persona qe kane token te botojne njoftime per qellimet qe kane ne lidhje levizjen e eshtrave ose per heqjen e monumenteve;
- (b) per te aftesuar familjaret ose perfaqesuesit e te vdekurve te -
 - (i) te levizin eshtrat e te vdekurve, dhe
 - (ii) te heqin monumente apo pllaka perkujtimore per te vdekurit,

dhe per te kerkuar qe personat qe kane token te mbulojne shpenzimet per zhvarrimin, levizjen dhe heqjen e monumenteve (pa kaluar nje shume te caktuar);

- (c) per te kerkuar zbatimin e -
 - (i) kushteve te aresyeshme qe mund te vendosen ne lidhje me nje toke te shenjte, nga ipeshkevi i famullise, ne lidhje me menyren e zhvarrosjes dhe me menyren dhe vendin e rivarrosjes te eshtrave dhe te monumenteve perkujtimore, dhe
 - (ii) udhezimeve te dhena nga Sekretari i Shtetit ne lidhje me zhvarrosjen e eshtrave.

(2) Ne varesi te ketyre dispozitave, nuk kerkohet aftesi e vecante -

- (a) per zhvarrosjen dhe rivarrosjen e eshtrave ne

perputhje me rregullat, ose
(b) per heqjen dhe zhvendosjen e monumenteve perkujtimore,
dhe seksioni 25 i Aktit mbi Varrimet 1857 (ndalimi i zhvendosjes se eshtrave te njerezve pa licence nga Sekretari i Shtetit pervec ne raste te vecanta) nuk aplikohet per zhvarrime ne perputhje me keto rregulla.

(3) Ne seksionet 238 dhe 239 dhe ne kete seksion -

- "vend varrimi" perfshin cdo oborr kishe, varreze, ose vend tjeter, i shenjte ose jo, qe eshte caktuar per varrim,
- "monument" perfshin guret e varreve, pllakat ose perkujtimore te tjera, dhe
- "blerje ose pervetesim perkates" do te thote blerje e bere nga nje Minister, autoritet lokal, apo sipermarres ligjor sipas kesaj Pjese ose Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990 ose ne baze te ndonje ligji tjeter, ose pervetesim nga autoriteti lokal per qellime planifikimi.

Perdorime dhe zhvillimeve te hapësirave

241.—(1) Pavaresisht nga miratime ne lidhje me toke qe eshte teresish apo pjeserisht toke e perbashket, vend i hapur, lulishte, etj., ose nga ndonje miratim sipas se cilit tokes i aplikohen rregulla te vecanta, toka qe eshte blere nga nje Minister, autoritet lokal, ose sipermarres ligjor, sipas kesaj Pjese ose sipas Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990, ose qe eshte pervetesuar nga autoriteti lokal per qellime planifikimi -

- (a) ne qofte se eshte blere nga nje Minister, mund te perdoret nga ai ose ne emer te tij, oer qellime per te cilat eshte blere; dhe
- (b) ne cdo rast tjeter, mund te perdoret ne perputhje me lejen e planifikimit.

(2) Asgje ne kete seksion do merret qe autorizon ndonje veprim nga ana e ndonje personi per hir te nje personi tjeter per cfaredo arsye ,pervec me qellim te kundeshtimeve te detyrimeve, kufizimeve ose miratimeve sic permendet ne nen-seksionin (1).

Moszbatimi i te drejtave

242.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit verteton qe marrja e nje shtepie e cila -

- (a) eshte blere ose pervetesuar nga autoriteti lokal per qellime planifikimi, dhe

(b) ne kete kohe mbahet nga autoriteti per qellime per te cilat eshte blere apo pervetesuar,
kerkohet menjehere per keto qellime, asgje me Aktin mbi Qerane 1977 ose ne Pjesen i te Aktit mbi Stehimin 1988 ndalon autoritetin bleres apo pervetesuar per te marre shtepine.

Perberja e nje grupi te perbashket qe mban toke per qellime planifikimi

Perberja e nje grupi te perbashket qe mban toke per qellime planifikimi

243.—(1) Ne qofte se Sekretari i Shtetit, pasi konultohet me autoritetet lokale pekatese, e sheh te nevojshme qe toka e blere nga nje autoritet lokal per qellime planifikimi duhet te mbahet nga nje grup i perbashket, qe konsiston ne perfaqesues te atij autoriteti dhe te ndonje autoriteti tjeter, ai ma ane te nje urdheri mund te vendose per krijimin e nje grupi te tille te perbashket dhe per transferimin e tokes se blere atij grupi.

(2) Cdo urdher sipas ketij seksioni qe vendos per krijimin e nje grupi te tille mund te nxjerre dispozita, qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme, per permbajtjen dhe funksionet e grupit.

(3) Dispozitat sipas nen-seksionit (2) perfshijne dispozita -

- (a) per inkorporimin e grupit te perbashket;
- (b) per ti dhene atyre, ne lidhje me token e transferuar sic permendet ne nen-seksionin (1), cdo fuqi qe ka autoriteti lokal nga kjo Pjese ose nga Kapitulli V i Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990 ne lidhje me token qe mbahet nga keto autoritete per qellime te kesaj Pjese ose te atij Kapitulli;
- (c) per te caktuar menyren e mbulimit te shpenzimeve te tyre.

(4) Rregullat sipas ketij Akti mund te krijojne dispozita rrjedhimore ose suplementare dispozitave te ketij seksioni, ne qofte se Sekretari i Shtetit e konsideron te nevojshme.

Dispozita te pergjithshme dhe suplementare

Fuqite e bordeve te perbashketa

244.—(1) Nje bord planifikimi i perbashket i krijuar sipas Skedules 17 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972, pasi eshte autorizuar nga Sekretari i Shtetit, ka te njejten fuqi per blerje te detyruara si autoritetet lokale te cilave i aplikohet seksioni 226.

(2) Nje bord i tille ka te njejten fuqi per te blere toke me

marreveshje sic kane autoritetet lokale te dhene ne nen-seksionin (1) te seksionit 227.

(3) Seksionet 226(1) dhe (7), 227, 229, 230, 232, 233 dhe 235 deri 242 aplikohen me modifikimet e nevojshme sikur keto borde te ishin autoritete lokale te cilave u aplikohen keto seksione.

(4) Pasi autorizohet nga Sekretari i Shtetit, nje bord i tille, per qellime qe ne baze te ketij seksioni kane blere toke, do kene fuqine qe u jep autoriteteve lokale seksioni 13 i Aktit mbi Qeverine Lokale 1976 te cilave i aplikohet nen-seksioni (1) i atij seksioni per te blere te drejtat mbi token qe nuk ekzistonin kur u autorizuar blerja, dhe nen-seksionet (2) deri (5) te atij seksioni aplikohen perkatesisht per blerjen e te drejtave sipas ketij nen-seksioni sic aplikohen per blerjen e te drejtave sipas nen-seksionit (1) te atij seksioni.

Modifikime te miratimeve per qellime te kesaj Pjese

245.—(1) Kur—

- (a) propozohet qe toka te blihet sipas seksioneve 226 dhe 228, dhe
- (b) nje urdher per blerje te detyruar eshte paraqitur tek autoriteti konfirmues ne perputhje me Pjesen II te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981 ose, sipas rastit, eshte bere nga Sekretari i Shtetit per Mjedisin ne perputhje me Skedulen i te atij Akti,

autoriteti konfirmues, ose sipas rastit Sekretari i Shtetit, mund te hedhe poshte per qellime te asaj Pjese apo te asaj Skedule, ndonje kundarshtim qe i behet urdherit qe per mendimin e autoritetit apo Sekretarit te Shtetit, perben nje kundarshtim te dispozitave te planit te zhvillimit duke mos respektuar perdorimin e propozuar te tokes.

(2) Kur nje urdher per blerje te detyrueshme qe autorizon blerjen e tokes sipas seksionit 226 i paraqitet Sekretarit te Shtetit ne perputhje me Pjesen II te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981, atehere ne qofte se Sekretari i Shtetit —

- (a) eshte i bindur qe urdheri do te konfirmohet ne lidhje me nje pjese te tokes se perfshire ne te; por
- (b) por deri tani nuk eshte percaktuar nese duhet te konfirmohet ose jo per pjesen tjeter te tokes,

ai mund te konfirmoje urdherin ne lidhje me token e permendur ne paragrafin (a) dhe te udhezaje shtyrjen e shqyrtimit te urdherit, ne lidhje me pjesen e tokes sipas udhezimeve te tij, derisa te percaktohet.

(3) Kur Sekretari i Shtetit udhezon sipas nen-seksionit (2), njoftimi qe kerkohet nga seksioni 15 i Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981 per tu botuar duhet te permbaje shpjegime per kete udhezim.

(4) Gjate zbatimit te Aktit mbi Blerje te Detyrueshme 1965 ne lidhje me dispozitat e kesaj Pjese —

- (a) referencat per punime, do te merren si referenca qe perfshijne ngritjen apo konstruksionin e ndertesave apo punimeve te tjera te autorizuar nga seksioni 237;
- (b) ne lidhje me ngritjen, konstruksionin e ndertesave apo punimeve te tjera te autorizuar, referenca ne seksionin 10 te atij Akti per autoritetin bleres, do te merren si referenca per personat te cilet po ngrajne apo konstruktojne ndertesave apo punime; dhe
- (c) referenca per punime, do te merren si referenca qe perfshijne ngritjen apo konstruksionin e ndertesave ose punimeve ne emer te Ministrit ose te sipermarresve ligjore ne token e blere nga ky Minister apo sipermarres, kur ndertesat apo punimet qe po kryhet, behen per qellime per te cilat eshte blere toka.

Interpretime te Pjeses IX

246.—(1) Ne kete Pjese —

- (a) cdo reference per blerje te tokes per qellime planifikimi eshte reference per blerjen e saj sipas seksionit 226 ose 227 te ketij Akti apo seksionit 52 te Aktit mbi Planifikimin (ose sipas rastit, sipas seksionit 112 ose 119 te Aktit te vitit 1971 ose te seksionit 68 ose 71 te Aktit te vitit 1962); dhe
- (b) cdo reference per pervetesim te tokes per qellime planifikimi eshte reference per pervetesime te saj per qellime toka eshte blere (ose mund te ishte blere) sipas atyre seksioneve.

(2) Asgje ne seksionet 237 deri 241 merret qe autorizon pjeserisht autoritetin lokal apo nje grup per veprime ne kundarshtim me kufizimet e vendosura me ligj.

(3) Cdo fuqi e dhene nga seksioni 238, 239 ose 241 per te perdorur token ne menyren e permendur ne keto seksione do te merret si fuqi per te perdorur token ne menyre te tille, nese ka te beje apo jo me ngritjen, konstruksionin, e ndertesave ose punimeve te tjera, ose per mirembajtjen e ndertesave apo punimeve.

PJESA X: AUTOSTRADAT

Urdhera nga Sekretari i Shtetit

Autostradat e ndikuara nga zhvillimi" me urdhera te Sekretarit te Shtetit

247.—(1) Sekretari i Shtetit me urdher mund te autorizoje ndalimin ose devijimin e nje autostrade ne qofte se eshte i bindur se eshte e nevojshme per zhvillime -

- (a) ne perputhje me lejen e planifikimit te dhene sipas Pjeses III, ose
- (b) nga nje departament qeverie.

(2) Nje urdher i tille mund te nxjerri dispozita qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme ose te domosdoshme per dispozitat ose permiresimin e ndonje autostrade tjeter.

(3) Nje urdher i tille mund te udhezaje -

- (a) qe autostrada e bere apo e permiresuar ne baze te tij te jete per qellime te Aktit mbi Autostradat 1980, nje autostrade qe mbahet me shpenzime publike;
- (b) qe Sekretari i Shtetit, ose ndonje keshill qarku, keshill rrethi metropolitan, dhe keshill per zonen e Londres, do jete autoriteti i autostrades per ate autostrade;
- (c) ne rastin kur autostrada per te cilen Sekretari i Shtetit eshte autoriteti i autostradave, autostrada, ne daten e percaktuar ne urdher, do te behet rruge nacionale sipas kuptimit te Aktit mbi Autostradat 1980.

(4) Nje urdher i bere sipas ketij seksioni mund te permbaje dispozita rrjedhimore qe Sekretari i Shtetit i konsideron te nevojshme ose te domosdoshme, qe perfshijne ne vecanti --

- (a) dispozita per te autorizuar Sekretarin e Shtetit, ose per t'i kerkuar nje autoriteti tjeter apo personi te caktuar ne urdher -
 - (i) te paguaje, ose te kontribuojne ne lidhje me koston e punimeve te bera sipas ketij urdheri ose te nje shpenzimi te bere ne lidhje me keto punime; ose
 - (ii) te paguaje, ose te kontribuojne ne lidhje me kompensime te paguara nga autoriteti i autostradave ne lidhje me kufizimet e vena

sipas seksionit 1 ose 2 te Aktit mbi Kufizimet mbi Zhvillimet 1935 ne lidhje me nje autostrade qe eshte ndaluar apo devijuar sipas ketij urdheri;

- (b) dispozita per te mbrojtur te drejtat e sipermarresve te autorizuar ne lidhje me aparate te tyre qe perpara dates se urdherit jane ne, mbi ose nen toke, gjate ose pingul me autostraden me te cilen lidhet urdheri.

(3) Nje urdher mund te behet sipas ketij seksioni qe autorizon ndalimin apo devijimin e autostrades qe eshte ndaluar apo devijuar perkohesisht nga nje miratim tjeter.

(4) Dispozitat e ketij seksioni do kene efekt pa cenuar -

- (a) fuqite qe ka Sekretari i Shtetit te autorizojne ndalimin ose devijimin e autostradave;
- (b) dispozitat e Pjeses VI te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981; ose
- (c) dispozitat e seksionit 251(1).

Autostrada qe kryqezohen ose hyjen ne nje autostrade e re e propozuar

248.—(1) Ky seksion aplikohet kur -

- (a) leja e planifikimit eshte dhene sipas Pjeses III per te ndertuar ose permiresuar nje autostrade, ose kur Sekretari i Shtetit propozon per te ndertuar ose permiresuar nje autostrade ("autostrada kryesore"); dhe
- (b) nje autostrade tjeter kryqezohet ose hyn ne rrugen e autostrades kryesore ose ndikohet ose do te ndikohet nga konstruksioni apo permiresimet e autostrades kryesore.

(2) Kur ky seksion aplikohet, ne qofte se Sekretari i Shtetit e sheh te nevojshme -

- (a) ne interes te sigurise se perdoruesve te autostrades kryesore; ose
- (b) per te lehtesuar levizjen e trafikut ne autostraden kryesore,

ai mund te autorizojne me urdher ndalimin ose devijimin e autostrades tjeter.

(3) Nen-seksioni (2) deri (6) i seksionit 247 aplikohet tek nje urdher i dhene sipas ketij seksioni, duke marre referenca ne nen-seksionin (2) te atij seksioni per autostrada, si referenca per cdo autostrade tjeter qe ndalohet ose devijohet sipas ketij seksioni, dhe

referenca ne nen-seksionin (3) per autostrada te ndertuara ose te permiresuara si rrjedhim i nje urdheri si referenca qe perfshijne autostraden kryesore.

Urdhera per te hequr te drejtat e perdorimit te automjeteve ne autostrade

249.—(1) Ky seksion aplikohet kur —

- (a) nje autoritet i planifikimit lokal adopton me resolute nje propozim per permiresimin e komoditetit apo mireqenies ne zonen e tyre, dhe
- (b) kur propozimi ka te beje me humbjen e te drejtes se publikut per perdorimin e nje rruge automjetesh mbi nje autostrade ne ate zone, e cila nuk eshte rruge nacionale, rruge e klasifikuar apo rruge kryesore.

(2) Sekretari i Shtetit mund, pasi merr aplikimin nga autoriteti i planifikimit lokal, te urdheroje heqjen e cdo te drejte qe mund te kene personat per perdorimin e automjeteve ne ate autostrade.

(3) Nje urdher sipas nen-seksionit (2) mund te perfshije dispozita qe Sekretari i Shtetit (pas konsultimit me cdo autoritet qe perben autoritet te planifikimit lokal ne ate zone dhe me autoritetin e autostradave) i mendon te pershtatshme per te lejuar perdorimin e autostradave ne raste te vecanta te percaktuara ne urdher, pavaresisht nga heqja e te drejtave sic permendet ne ate nen-seksion.

(4) Dispozita te tilla sic permenden ne nen-seksionin (3) mund te behen per —

- (a) tipe ose pershkrime te vecanta te automjeteve, ose
- (b) persona te vecante te cilet mund te perdorin automjetet, ose
- (c) rrethanat ne te cilat automjetet mund te perdoren per qellime te vecanta.

(5) Asnje dispozite qe ndalon ose kufizon perdorimin e trotuareve, kalimeve anesore do ndikojne ne perdorimin e automjeteve ne autostrade ne lidhje me te cilat eshte ne fuqi nje urdher sipas nen-seksionit (2), kur perdorimi lejohet ne perputhje me dispozitat e urdherit te perfshira ne nen-seksionin (3).

(6) Ne qofte se nje autoritet qe eshte autoriteti i planifikimit lokal per zonen ne te cilen eshte nje autostrade se ciles i aplikohet nje urdher sipas nen-seksionit (2), aplikon tek Sekretari i Shtetit, ky i fundit mund te urdheroje revokimin e atij urdheri, dhe ne qofte se e ben nje gje te tille, cdo e drejte per perdorimin automjeteve ne

autostrade qe u hoq nga ai urdher do te jepet perseri.

(3) Nje urdher sipas nen-seksionit (6) mund te nxjerre dispozita qe kerkojne heqjen e ndonje pengese ne autostrade qe rrjedh nga ushtrimi i fuqise se dhene nga Pjesa VIIA e Aktit mbi Autostradat 1980.

(4) Perpara berjes se nje aplikimi sipas nen-seksionit (2) ose (6) autoriteti i planifikimit lokal duhet te konsultohet me autoritetin e autostradave (ne qofte se nuk eshte i njejti autoritet) dhe ndonje autoritet tjeter qe eshte autoritet planifikimi lokal ne ate zone.

(5) Nen-seksionet (2), (3) (4) dhe (6) te seksionit 247 aplikohen per urdhera sipas ketij seksioni sic aplikohen per urdhera sipas atij seksioni.

Kompensime per urdhera sipas s. 249

250.—(1) Cdo person i cili ne kohen e hyrjes ne fuqi te nje urdheri sipas seksionit 249 (2), ka interes ne token qe ka hyrje te ligjshme n e autostraden me te cilen lidhet urdheri ka te drejte te marre kompensim nga autoriteti i planifikimit lokal i cili ka bere aplikimin per urdher, ne lidhje me —

- (a) zhvleresimin e vleres se interesit mbi token qe lidhet direkt me urdherin; dhe
- (b) cdo humbje apo demtim tjeter qe behet si rezultat i urdherit.

(2) Ne nen-seksionin (1), "hyrje e ligjshme" do te thote hyrje a autorizuar me leje planifikimi ose hyrje per te cilen nuk duhet leja e planifikimit.

(3) Kerkese per kompensim sipas ketij seksioni duhet bere tek autoriteti i planifikimit lokal i cili ka bere aplikimin per urdher, brenda kohes se caktuar dhe ne menyren e caktuar.

(4) Per qellime te percaktimit te nje kompensimi rregullat e vendosura ne seksionin (5) te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961 do te kene efekt, me modifikimet e duhura, sic kane efekt per percaktime te kompensimeve per blerje te detyrueshme te nje interesi.

(5) Kur interesi i tokes varet nga nje hipoteke —

- (a) cdo kompensim te cilit i aplikohet ky seksion i pagueshem ne lidhje me zhvleresimin e vleres se atij interesi do te vleresohet sikur interesi te mos varej nga nje hipoteke;

- (b) kerkesa per nje kompensim te tille mund te behet nga nje penglenes interesi, por pa cenuar berjen e kerkeses se personit qe ka te drejten mbi interesin;
- (c) asnje kompensim te cilit i aplikohet ky seksion do behet i pagueshem ne lidhje me interesin e nje penglenesi (ne dallim nga interesi qe eshte varur nga hipoteka); dhe
- (d) cdo kompensim te cilit i aplikohet ky seksion i pagueshem ne lidhje me nje interes qe varet nga nje hipoteke, do ti paguhet penglenesit.

(6) Cdo ceshtje ose mosmarreveshje qe ngrihet nga ky seksion do te kalohet per vendim tek Gjykata e Tokave, pervec rasteve kur percaktohet ndryshme nga rregullat e ketij Akti.

(7) Ne lidhje me vendime te tilla, aplikohen dispozitat e seksionit 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961 ne varesi te modifikimeve te duhura dhe te dispozitave nga ky Akt.

Heqja e te drejtave publike te nje rruge te mbajtur per qellime planifikimi

251.—(1) Kur nje toke eshte blere ose pervetesuar per qellime planifikimi dhe mbahet nga autoriteti lokal per qellimet per te cilat u pervetesua ose u ble, Sekretari i Shtetit me urdher mund te heqe cdo te drejte publike mbi nje rruge ne nje toke, ne qofte se ai bindet -

- (a) qe do jepet ose eshte dhene nje e drejte alternative; ose
- (b) qe nje e drejte alternative per ate rruge nuk kerkohet.

(2) Ne kete seksion cdo reference per blerje ose pervetesim e tokes per qellime planifikimi do te merret ne perputhje me seksionin 246(1) sikur ky seksion te ishte ne Pjesen IX.

(3) Nen-seksioni (1) do aplikohet gjithashtu (me zevendesimin e autoritetit lokal me Autoritetin e Siperfaqeve Ujore) ne lidhje me ndonje toke brenda siperfaqeve ujore e cila mbahet nga autoriteti i siperfaqeve ujore dhe qe eshte blere ose marre nga Autoriteti per qellime ne lidhje me zbatimin e funksioneve te tij.

Procedura per nxjerrjen e urdherave

52.—(1) Perpara se te behet nje urdher sipas seksionit 247, 248, 249, ose 251, Sekretari i Shtetit duhet te botoje ne te pakten nje gazete lokale qe qarkullon ne zonen perkatese, dhe ne "London Gazette", nje njoftim -

- (a) qe tregon per urdherin ne pergjithesi;
- (b) percakton vendin ne zonen e caktuar ku nje kopje e urdherit dhe harta perkatese mund te rishikohen pa pagese ne te gjitha oret e aresyeshme te dites gjate nje periudhe 28 ditor nga data e botimit te njoftimit ("dita e botimit"); dhe
- (c) qe tregon qe persona te interesuar mund te bejne verejtje per urdherin tek Sekretari i Shtetit brenda asaj periudhe.

(2) Jo me vone se data e botimit, Sekretari i Shtetit duhet t'i jape nje kopje te urdherit te propozuar dhe te hartave perkatese -

- (a) cdo autoriteti lokal qe toka e zones se tyre, ose autostrada ne zonen e tyre lidhet me urdherin, dhe
- (b) cdo sipermarresi te ujesjellsave, ujrave te zeza, elektricitetit, ose furnizuesi te gazit qe kane kablllo, tuba, tela, pergjate ose pingul me autostraden qe eshte propozuar te ndalohet ose te devijohet, ose sipas rastit kur e drejta e perdorimit te rruges eshte propozuar te hiqet nga urdheri.

(3) Jo me vone se data e botimit, Sekretari i Shtetit do te beje te mundur qe nje kopje e njoftimit te afishohet ne nje vend te dukshem ne fillim ose fund te autostrades qe propozohet per tu ndaluar apo devijuar, ose te rruges qe i hiqet e drejta e perdorimit sipas ketij urdheri.

(4) Ne qofte se perpara perfundimit te periudhes 28 ditore te permendur ne nen-seksionin (1)(b) Sekretari i Shtetit merr verejtje apo kundersiztim nga autoriteti lokal ose nga sipermarres apo furnizues te gazit se cileve u eshte dhene kopje e njoftimit sipas nen-seksionit (2), ose nga persona te tjere qe sipas mendimit te tij ndikohen nga urdheri, dhe kundersiztimi nuk eshte terhequr, atehere, pervec rasteve kur aplikohet seksioni (5), Sekretari i Shtetit duhet te mbledhe nje seance shqyrtuese.

(5) Ne qofte se, ne rastin kur eshte bere verejtje nga nje person i ndryshem nga autoriteti lokal apo sipermarresit, Sekretari i Shtetit bindet qe ne rrethana te vecanta, mbajtja e nje seance te tille eshte e panevojshme, ai mund te hedhe poshte shqyrtimin.

(6) Nen-seksionet (2) deri (5) te seksionit 250 te Aktit mbi Qeverine Lokale 1972 do aplikohen ne lidhje me nje seance shqyrtimi apo hetimi te bere nga Sekretari i Shtetit sipas nen-seksionit (4).

(7) Kur behet botimi i njoftimit te permendur ne nen-seksioni (1)

per me teper se 1 dite, referencat ne kete seksion per daten e botimit jane referenca per daten e fundit te botimit.

(8) Pas marrjes ne shqyrtim te ndonje verejtjeje ndaj nje urdheri qe nuk eshte terhequr, dhe kur mbahet seanca e hetimit apo shqyrtimit, te raportit te personit qe mbajti mbledhjen apo seancen, Sekretari i Shtetit, mund, ne varesi te nen-seksionit (9), te jape nje urdher ose pa modifikime ose me modifikimet qe mendon se jane te nevojshme.

(9) Kur --

- (a) urdheri permban dispozita qe kerkojne apgesa, ripagesa apo kontribute te permendura ne seksionin 247(4)(a); dhe
- (b) kundershimet apo verejtjet kundrejt dispozites jane bere nga nje autoritet ose person, qe do paguante nje pagese te tille apo kontribut; dhe
- (c) verejta nuk eshte terhequr,

urdheri do te varet nga procedura te vecanta parlamentare.

(6) Menjehere pas berjes se urdherit, Sekretari i Shtetit duhet te botoje, ne menyren e treguar ne nen-seksionin (1), njoftimin qe urdheri eshte bere dhe qe tregon vendin ku mund te shikohet urdheri brenda oreve te aresyeshme te dites.

(7) Nen-seksionet (2), (3), dhe (7) do kene efekt ne lidhje me nje njoftim sipas nen-seksionit (10) sic kane efekt ne lidhje me nje njoftim sipas nen-seksionit (1).

(8) Ne kete seksion --

- "zone perkatese" ne lidhje me nje urdher do te thote zona ne te cilen ndodhet toka apo autostrada per te cilen eshte bere urdheri;
- "autoritet lokal" do te thote keshilli i nje qarku, rrethi, famullije, ose zones se Londres, nje autoritet i perbashket i ngritur nga Pjesa IV e Aktit mbi Qeverine Lokale 1985, nje agjent veprimi per nje shtepi sipas Pjeses III te Aktit mbi Strehimin 1988 dhe nje mbledhje famullije ne zone rurale qe nuk ka keshill famullije;

dhe ne nen-seksionin (2) --

- (i) referenca per sipermarres te ujesjellesit do merren si referenca qe perfshijne Autoritetin Kombetar te Lumejve, dhe
- (ii) referenca per sipermarres te elektricitetit do merren si referenca per persona te licensuar

merren si referenca per persona te licensuar sipas seksionit 6 te Aktit mbi Elektricitetin 1989 qe kane te drejte te ushtrojne fuqine e dhene nga paragrafi 1 i Skedules 4 te atij Akti.

Procedura
perpara lejes
se
planifikimit

253.—(1) Kur --

- (a) Sekretari i Shtetit, ne qofte se eshte dhene leja e planifikimit per nje zhvillim sipas Pjeses III, ka fuqi per te bere nje urdher sipas seksionit 247 ose 248 qe autorizon ndalimin ose devijimin e nje autostrade me qellim te kryerjes se nje zhvillimi, dhe

(b) Nen-seksioni (2), (3) ose (4) aplikohet,

Atehere pavaresisht qe leja e tille nuk eshte dhene, Sekretari i Shtetit mund te botoje njoftimin e urdherit te paperfunduar ne perputhje me seksionin 252.

(2) Ky nen-seksion aplikohet kur zhvillimi perkates varet nga nje aplikim per leje planifikimi dhe ose --

- (a) ai aplikim eshte bere nga nje autoritet lokal ose sipermarres ligjor ose nga Korporata Britanike e Qymyrgurit; ose
- (b) aplikimi i kalohet Sekretarit te Shtetit ne perputhje me nje udhezim sipas seksionit 77; ose
- (c) aplikuesi ka apeluar tek Sekretari i Shtetit sipas seksionit 78 kunder refuzimit te lejes se planifikimit ose te aprovimit te kerkuar sipas nje urdheri per zhvillim ose kunder nje kushti te vene ne leje.

(3) Ky nen-seksion aplikohet kur --

- (a) zhvillimi perkates do kryhet nga nje autoritet lokal ose sipermarres ligjor dhe kerkon, ne baze te nje miratimi, autorizimin e nje departamenti te qeverise; dhe
- (b) zhvilluesit kane bere aplikimin tek departamenti per autorizim dhe kane kerkuar gjithashtu udhezim sipas seksionit 90(1) qe leja e planifikimit te quhet e dhene per ate zhvillim.

(4) Ky nen-seksion aplikohet kur keshilli i nje qarku, rrethi metropolitan, ose zone te Londres, ose te nje bordi planifikimi te perbashket vertetojne qe kane filluar te marrin masa ne perputhje me rregullat e bera ne baze te seksionit 316, sic kerkohej per t'i

aftesuar per te marre lejen e planifikimit per nje zhvillim te caktuar.

(5) Seksioni 252(8) nuk do te konsiderohet qe autorizon Sekretarin e Shtetit per te bere nje urdher sipas seksionit 247 apo 248 njoftimi i te cilit eshte botuar ne baze te nen-seksionit (1), derisa te leja e planifikimit per zhvillime qe pengonin dhenien e urdherit.

Blerje te detyrueshme te tokes ne lidhje me autostrada

254.—(1) Sekretari i Shtetit, ose autoriteti lokal i autostradave pasi eshte autorizuar nga Sekretari i Shtetit, mund te blejne toke ne menyre te detyrueshme -

- (a) per qellime te ndertimit apo permiresimit te autostradave qe do ndertohen apo permiresohen ne baze te nje urdheri te bere sipas seksionit 247, 248 ose 249 ose per qellime te tjera per te cilat toka eshte kerkuar ne urdher; ose
- (b) per qellime te sigurimit publikut te se drejtes mbi nje rruge qe do sigurohet me ane te nje te drejte alternative ndaj asaj qe eshte hequr nga nje urdher sipas seksionit 251.

(2) Akti mbi Blerjen e Tokes 1981 do aplikohet per blerje te tokes sipas ketij seksioni.

Procese ne lidhje me autostradat

255.—(1) Ne lidhje me urdhera sipas seksioneve 247, 248, dhe 249, rregullat e bera sipas ketij Akti nxjerrin dispozita per te bere te mundur qe ndonje proces qe kerkohet per qellime te blerjes se tokes sipas seksionit 254 (sic permendet ne nen-seksionin (1)(a) te atij seksioni) mund te behet ne te njejten kohe me procesin e kerkuar per qellime te urdherit.

(2) Ne lidhje me urdhera sipas seksionit 251, rregullat e bera sipas ketij Akti mund te bejne dispozita per te bere te mundur -

- (a) qe cdo proces i kerkuar per qellime te nje urdheri mund te behet ne te njejten kohe me procese te kerkuara per blerjen e tokes, te drejta mbi rrugen e te ciles do te hiqet; ose
- (b) qe cdo proces i kerkuar me qellim te blerjes se cdo toke tjeter sipas seksionit 254 (sic permendet ne nen-seksionin (1)(b) te atij seksioni) mund te behet njekohesisht me ose te dyja ose me njereren nga proceset e permendura ne paragrafin (a).

Aparate telekomunikacioni: urdhera nga Sekretari i Shtetit

256.—(1) Kur -

- (a) ne zbatim te nje urdheri sipas seksionit 247, 248, ose 249, nje autostrade eshte ndaluar apo devijuar, ose sipas rastit, jane hequr te drejtat e perdorimit te nje rruge nga automjetet; dhe
- (b) menjehere perpara dates ne te cilen urdheri hyri ne fuqi ka patur nje aparat telekomunikimi mbi, nen, ne, pergjate ose pingul me autostraden te mbajtur apo te instaluar per qellime telekomunikimi,

operatori i atij sistemi ka te njejtat fuqi ne lidhje me aparatit sikur perpara se te kishte hyre ne fuqi urdheri.

(2) Pavaresisht nga nen-seksioni (1), cdo person qe ka te drejta mbi token ne te cilen ndodhet autostrada, ka te drejte te kerkoje ndryshimin e aparatit.

(3) Kur -

- (a) nje urdher i tille siguron permiresimin e nje autostrade, pervec rrugeve nacionale, dhe
- (b) menjehere perpara dates se hyrjes ne fuqi te urdherit ka patur nje aparat telekomunikimi mbi, nen, ne, pergjate ose pingul me autostraden te mbajtur apo te instaluar per qellime telekomunikimi,

autoriteti lokal i autostradave do kete te drejten te kerkoje ndryshimin e aparatit.

(4) Nen-seksioni (3) nuk ka efekt per ndryshime te ndonje aparatit per qellime te puneve te autoritetit sic perkufizohet ne Pjesen II te Aktit mbi Punimet Rrugore dhe Facilitet Publike 1950.

(5) Paragrafi 1(2) i kodit te telekomunikimit aplikohet per qellime te ketij seksioni sic aplikohet per qellime te atij kodi (per ndryshimin e ndonje aparatit qe perfshin levizjen, heqjen ose zevendesimin e tij).

(6) Paragrafi 21 i kodit te telekomunikacionit (kufizime per heqjen e aparateve te telekomunikacionit) aplikohet ne lidhje me te drejta te dhena nga ky seksion per te kerkuar ndryshimin, levizjen ose zevendesimin e ndonje aparatit te telekomunikacionit sic aplikohet ne lidhje me te drejtat per te kerkuar heqjen e nje aparatit te tille.

Urdhera nga autoritete te tjera

Trotuaret

257.—(1) Ne varesi te seksionit 259, nje autoritet kompetent mund

dhe rrugët e kembesoreve te ndikuara nga zhvillimi: udhera nga autoritete te tjera

te autorizojë me urdher ndalimin ose devijimin e ndonjë trotuari, ose kalimi kembesoresh, ne qofte se ata jane te bindur qe eshte e nevojshme me qellim qe te kryhen zhvillime -

- (a) ne perputhje me lejen e planifikimit te dhene sipas Pjeses III, ose
- (b) nga nje departament i qeverise.

(2) Urdheri sipas ketij seksioni, ne qofte se autoriteti kompetent eshte bindur, mund te beje te mundur -

- (a) per te krijuar nje autostrade alternative per perdorim si zevendesim i asaj te autorizuar me urdher te mbyllet apo te devijojë, ose per permiresimin e nje autostrade ekzistuese per perdorim te tille;
- (b) per te autorizuar kryerje te punimeve ne lidhje me nje trotuar qe eshte mbyllur apo devijuar, krijuar apo permiresuar me urdher;
- (c) per mbrojtjen e te drejtave te sipermarresve ligjore ne lidhje me aparatet e tyre qe perpara dates se urdherit ishin ne, mbi, nen, pergjate ose pingul me trotuarin;
- (d) per t'i kerkuar cdo personi te permendur ne urdher te paguaje ose te kontribuojë per koston e kryerjes se ketyre punimeve.

(3) Nje urdher i bere sipas ketij seksioni qe autorizon mbylljen apo devijimin e nje trotuari apo rruge kembesoresh qe eshte mbyllur apo devijuar perkohesisht nga nje miratim tjetër.

(4) Ne kete seksion "autoritet kompetent" do te thote -

- (a) ne rastin e zhvillimeve te autorizuar nga leja e planifikimit, autoriteti i planifikimit lokal qe dha lejen, ose ne rastin e lejeve te dhena nga Sekretari i Shtetit, kushdo qe do kishte patur fuqine per ta dhene kete leje; dhe
- (b) ne rastet e zhvillimeve te kryera nga nje departament i qeverise, autoriteti i planifikimit lokal qe do kishte patur fuqine per te dhene leje planifikimi per nje aplikim ne lidhje me zhvillimin ne fjale ne qofte se do ishte bere nje aplikim i tille.

Heqja e te drejtave publike per toke te

258.—(1) Kur eshte blere ose pervetesuar nje toke per qellime planifikimi dhe tani per tani mbahet nga autoriteti lokal per qellimet e te cilit u ble apo u pervetesua, atehere ne varesi te seksionit 259, autoriteti lokal mund te urdherojë heqjen e te

mbajtur per qellime planifikimi

drejtave te publikut ne lidhje me token, qe eshte trotuar apo vend kembesoresh, ne qofte se eshte i bindur -

- (a) qe do jepet nje e drejte alternative ndaj se drejtes se hequr; ose
- (b) qe e drejta alternative nuk kerkohet.

(2) Ne kete seksion cdo reference per blerjen apo pervetesimin e tokes per qellime planifikimi do te merret ne perputhje me seksionin 246(1) sikur ky seksion te ishte ne Pjesen IX.

(3) Nen-seksioni (1) do te aplikohet gjithashtu (me zevendesim te autoritetit lokal me Autoritetin e Broads) ne lidhje me toka brenda Broads qe mbahen nga Autoriteti i Broads dhe qe eshte blere nga Autoriteti per qellime te kryerjes se funksioneve te tij.

Konfirmimi i urdherave te bere nga autoritete te tjera

259.—(1) Nje urdher i bere sipas seksionit 257 ose 258 nuk do hyje ne fuqi pa u konfirmuar nga Sekretari i Shtetit, ose pa u konfirmuar ng aautoriteti qe e beri si urdher i pakundershutar.

(2) Sekretari i Shtetit nuk duhet te konfirmojë nje urdher te tille pa u bindur per cdo ceshtje qe kerkohet te zbatohet nga autoriteti qe ka nxjerre urdherin sipas seksionit 257, ose sipas rastit, seksionit 258.

(3) Koha e percaktuar—

- (a) ne nje urdher sipas seksionit 257 si kohe ne te cilen u mbyll apo u devijuar nje trotuar apo rruge kembesoresh; ose
- (b) ne nje urdher sipas seksionit 258 nga koha kur u hoq e drejta mbi nje rruge, nuk do jete me heret se koha e konfirmimit te urdherit.

(4) Skedula (Aneksi) 14 do kete efekt ne lidhje me konfirmimin e urdherit sipas seksionit 258 ose 257 dhe per afishimin e nje urdheri te tille pasi eshte konfirmuar.

Aparatet e telekomunikimit: urdherat nga autoritetet e tjera

260.—(1) Ky seksion aplikohet kur -

- (a) cdo urdher i bere nga autoriteti lokal sipas seksionit 258(1), ose mre aplikim tek autoriteti lokal sipas seksionit 251(1), i cili hoqi te drejten mbi nje rruge; ose
- (b) cdo urdher i bere nga nje autoritet kompetent sipas seksionit 257 qe autorizon ndalimin, ose devijimin

e nje trotuari apo rruge kombesoresh,
dhe ne kohet e botimit te njoftimit te kerkuar sipas 252(1), ose sipas rastit, nga paragrafi i Skedules (Aneksit) 14 cdo aparat telekomunikimi eshte mbajtur per qellime telekomunikimi nen, mbi, ne, pergjate ose pingul me token se ciles ju hoq e drejta e perdorimit.

(2) Ne nen-seksionin (1) "autoritet kompetent" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 257 dhe ne dispozitat qe vijojne ne kete seksion referenca per autoritetin jane referenca per autoritetin qe ka dhene urdherin, ose autoritetit te cilit ju dha aplikimi.

(3) Fuqia e operuesit te sistemit te telekomunikimit per te hequr aparatet -

- (a) do ushtrohet, pavaresisht nga urdheri, ne cdo kohe jo me vone se 3 muaj nga data kur ju hoq e drejta e perdorimit ose e autorizimit per mbyllje apo devijim; dhe
- (b) ne qofte se perpara mbarimit te asaj periudhe operuesi i sistemit i dha nje njoftim autoritetit per qellimet e tij per heqjen e aparatit ose nje pjese te tij, do ushtrohet ne lidhje me te gjitha ose ate pjese te aparatit pas mbarimit te periudhes.

(4) Operuesi i sistemit mund qe me ane te njoftimit te dhene per ate qellim autoritetit jo me vone se fundi i periudhes te braktise aparatit ose nje pjese te tij.

(5) Ne varesi te nen-seksionit (4), operuesi i sistemit ne fund te periudhes do e konsiderohet qe e ka braktisur ate pjese te aparatit te cilin as nuk e ka hequr dhe as nuk ka dhene njoftim qe do ta heqe.

(6) Operuesi i sistemit do kete te drejte te rekuperoje nga autoriteti shpenzimet e zevendesimit te aparatit dhe te cdo aparati telekomunikimi tjeter te lidhur me te qe u be i paperdorshem si rrjedhim i heqjes ose i braktisjes se aparatit kryesor, me cdo aparat telekomunikimi ne nje vend tjeter sic kerkon operuesi.

(7) Kur sipas dispozitave te mepareshme te ketij seksioni operuesi i sistemit ka braktisur te gjitha ose nje pjese te aparatit te telekomunikacionit, aparati ose ajo pjese e tij do mbetet me autoritetin dhe do konsiderohet, pasi braktiset, si i paperdorshem ne lidhje me sistemin e telekomunikimit.

(8) Sa me shpejt te jete e mundur pas dhenies se nje urdheri sipas

paragrafit (a) ose (b) te nen-seksionit (1) ne rrethana per te cilat aplikohet ai nen-seksion ne lidhje me operuesin e telekomunikimit, personi i cili dha urdherin duhet ti jape njoftimin operuesit per kete urdher.

(9) Nen-seksionet (5) dhe (6) te seksionit 256 aplikohen per qellime te ketij seksioni sic aplikohen per qellime te atij seksioni.

Urdhera te perkohshem per autostradat: punime minerare

Ndalimi i
perkohshem
i
autostradave
per qellime te
punimeve
minerare

261.—(1) Kur Sekretari i Shtetit bindet -

- (a) qe nje urdher i dhene nga ai sipas seksionit 247 per ndalimin apo devijimin e nje autostrade kerkohe per perpunime te mineraleve; dhe
- (b) ajo autostrade mund te restaurohet, pasi mineralet jane punuar, ne kushte jo me pak te pershtatshme per publikun;

urdheri mund te ndaloje apo devijoje autostraden gjate nje periudhe te caktuar te dhene ne urdher dhe per restaurimin e saj ne fund te periudhes.

(2) Kur nje autoriteti kompetent sipas kuptimit te seksionit 257 eshte i bindur -

- (a) qe nje urdher i dhene nga ai sipas seksionit 247 per ndalimin apo devijimin e nje trotuari apo rruge kombesoresh kerkohe per perpunime te mineraleve; dhe
- (b) ai trotuar apo rruge kombesoresh mund te restaurohet, pasi mineralet jane punuar, ne kushte jo me pak te pershtatshme per publikun;

urdheri mund te ndaloje apo devijoje trotuarin apo rrugen e kombesoreve gjate nje periudhe te caktuar te dhene ne urdher dhe per restaurimin e saj ne fund te periudhes.

(3) Pa cenuar dispozitat e seksionit 247 ose 257, cdo urdher i tille i autorizuar nga nen-seksioni (1) ose (2) mund te permbaje dispozita qe Sekretari i Shtetit apo autoriteti perkates i konsiderojne te nevojshme -

- (a) per te imponuar mbi persona te cilet, pavaresisht nga urdheri, do kene detyrime ne lidhje me riparimin e autostrades origjinale gjate periudhes se caktuar ne urdher, detyrime ne lidhje me cdo autostrade qe lidhet me urdherin;
- (b) per mbylljen ne fund te periudhes te cdo autostrade ne urdher dhe per rikonstruksionin dhe mirembajtjen e autostrades origjinale;

dhe cdo dispozite qe perfshihet ne urdher ne perputhje me nen-seksionin (4) te seksionit 247 ose nen-seksionin (2) te seksionit 257 qe kerkojne berjen e pagesave ne lidhje me koston apo shpenzimet qe behen sipas urdherit.

(5) Ne lidhje me nje autostrade qe eshte mbyllyr apo devijuar, ne baze te nje urdheri sipas seksionit 247 ose 248, seksionet 271 dhe 272 do kene efekt --

(a) sikur ne vend te referencave per token e blere dhe te autortetit bleres apo pervetesues te zevendesohen me referenca per toke mbi te cilen eshte nje autostrade dhe me persona qe kane te drejte mbi ate toke; dhe

(b) sikur ne vend te referencave ne nen-seksionin (5) per ato seksione per autoritetin lokal dhe sipermarres ligjor te perfshijne referenca per cdo person i cili ka te drejte mbi token, dhe seksionet 275 deri 278 do kene efekt perkatesisht.

(5) Nen-seksioni (4) nuk aplikohet per toke qe perben vendin e nje autostrade ne lidhje me te cilen eshte dhene nje leje planifikimi e siperfaqeshme (sipas kuptimit te seksionit 51 te Aktit mbi Qymyrgurin ne Siperfaqe 1958).

PJESA XI

SIPERMARRES TE AUTORIZUAR

Parathenie

Kuptimi i
"sipermarres
ve ligjore"

262.—(1) Ne varesi te dispozitave vijuese ne kete seksion, ne kete Akt "sipermarres ligjore" do te thote persona te autorizuar nga nje miratim per te kryer punime ne nje hekurudhe, tramvaj, rruge transporti, transport uxor, kanal, lundrim te brendshem, port, skele, apo fanar, punime ne hidrocentrale, dhe operues te caktuar ne aeroporte (sipas kuptimit ne Pjesen V te Aktit mbi Aeroportet 1986).

(2) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, ne kete Akt, "sipermarres ligjore" do merret ne perputhje me nen-seksionin (1) dhe, operues i caktuar aeroportit do te thote nje aeroport te cilit i aplikohet ajo Pjese e atij Akti.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (5), per qellime te dispozitave te permendura ne nen-seksionin (4) cdo furnizues gazi publik, sipermarres ujesjellesi, Autoriteti Kombetar i Lumenjve, Sherbimi Postar dhe Autoriteti i Aviacionit Civil do te konsiderohen sipermarres ligjore dhe veprimet e tyre, sipermarres ligjore.

(4) Dispozitat e referuara ne nen-seksionin (3) jane seksionet 55, 90, 101, 108(3), 123, 139, deri 141, 143, 148, 170(12)(b), 236(2)(a), 237, deri 241, 245, 247(4)(b), 253, 257(2), 263(1) dhe (2), 264, 266, deri 283, 288(10)(a), 306, 325(9), 336(2) dhe (3), paragrafi 18 i Skedules (Aneksit) 1 dhe Skedules (Aneksit) 8, 13, dhe 14.

(5) Nen-seksionin (4) do aplikohet --

(a) ne lidhje me Sherbimin Postar, sikur te perfshihen referenca per seksionet 55, 247(4)(b), 253, dhe 257(2); dhe

(b) ne lidhje me Sherbimin Postar dhe Autoritetin e Aviacionit Civil sikur --

(i) te perfshiheshin referencat seksioneve 245, 263(1) dhe (2) dhe 336(2) dhe (3); dhe

(ii) pas fjaleve "266 deri 283" te perfshiheshin fjalet "(pervec seksionit 271 sic aplikohet nga seksioni 13 i Aktit mbi Qymyrgurin e Siperfaqshem 1958)".

(6) Cdo mbajtes i licences sipas seksionit 6 te Aktit mbi Elekricitetin 1989 do konsiderohet si sipermarres ligjor dhe aktivitetet e tij, sipermarres ligjore--

(a) per qellime te dispozitave te permendura ne nen-seksionin (7)(a), ne qofte se ai ka nje licence sipas nen-seksionit (1) te atij seksioni;

(b) per qellime te dispozitave te permendura ne nen-seksionin (7)(b), ne qofte se ai ka te drejte te ushtroje fuqine e dhene nga Skedula (Aneksi) 3 e atij Akti; dhe

(c) per qellime te dispozitave te permendura ne nen-seksionin (7)(c), ne qofte se ai ka te drejte te ushtroje fuqine e dhene nga paragrafi 1 i Skedules (Aneksi) 4 te atij Akti.

(7) Dispozitat e referuara ne nen-seksionin (6) jane --

(a) seksionet 55, 108(3), 123, 139, deri 141, 143, 148, 236(2)(a), 237, 245, 253, 263(1) dhe (2), 264, 266, deri 283, 288(10)(a), 306, 325(9), dhe 336(2) dhe (3), paragrafi 18 i Skedules (Aneksi) 1 dhe Skedula

Kuptimi i
tokes se
veprimit

(Aneksi) 13.

- (b) Seksionet 170(12)(b) dhe 238 deri 241; dhe
- (c) Seksionet 247(4) dhe 257(2) dhe Skedula (Aneksi) 14.

263.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni dhe seksionit 264, ne kete Akt, "toke veprimi" ne lidhje me sipermarres ligjore, do te thote—

- (a) toke qe perdoret per qellime te zbatimit te sipermarrjeve te tyre; dhe
- (b) toke qe eshte me interes per keto qellime.

(2) Paragrafet (a) dhe (b) te nen-seksionit (1) nuk perfshijne toke e cila, ne lidhje me natyren dhe vendosjen e saj, eshte e krahasueshme me toke ne pergjithesi me shume se me toke qe mbahet per qellime te sipermarresve ligjor.

(3) Ne seksionet 108(3), 123(3) dhe (4), 266 deri 283 dhe Pjesen II te Skedules (Aneksit) 8, "toke veprimi" ne lidhje me Sherbimin Postar dhe Autoritetin e Aviacionit Civil, do te thote toke e Sherbimin Postar ose e Autoritetit sipas nje klase te percaktuar me rregulla.

(4) Rregulla te tilla—

- (a) do te behen -
 - (i) ne rastin e Sherbimit Postar nga Ministri perkates dhe Sekretari i Shtetit duke veperuar bashkarisht; dhe
 - (ii) ne rastin e Autortetit te Aviacionit Civil, nga Ministri perkates;
- (b) mund te caktojne nje klase toke ne lidhje me ndonje rrethane te vecante, dhe
- (c) ne rastin e Autoritetit te Aviacionit Civil, mund te bejne dispozita per rrethana te ndryshme, duke perfshire klase te ndryshme te tokes per qellime te dispozitave te ndryshme.

264.—(1) Ky seksion aplikohet kur mbahet nje interes mbi token nga nje sipermarres ligjor per qellime te zbatimit te sipermarrjeve te tyre dhe -

- (a) interesi eshte blere me ose pas 6 Dhjetorit 1968; ose
- (b) mbahej nga ata perpara asaj date, por rrethanat e vecanta benin qe toka te mos ishte toke veprimi per qellime te Aktit te vitit 1962.

Raste ne te
cilat toka do
te merret qe
nuk eshte
toke veprimi

(2) Kur ky seksion aplikohet ne lidhje me nje toke, atehere pavaresisht nga dispozitat e seksionit 263, toka nuk do te konsiderohet si toke veprimi per qellime te ketij Akti, pervec kur perfshihet ne nen-seksionet (3) dhe (4).

(3) Toka bie brenda ketij nen-seksioni ne qofte se -

- (a) eshte, ose ka qene ne fuqi, nje leje planifikimi e vecante ne lidhje me te, per zhvillimin e saj; dhe
- (b) qe zhvillimi, ne qofte se eshte kryer, perfshin ose ka perfshire perdorimin e tij per qellime te kryerjes se veprimeve te sipermarresve ligjore.

(4) Toka bie brenda ketij nen-seksioni ne qofte se -

- (a) interesi i sipermarresve ne token qe ishte blere nga ata si rezultat i nje transferimi sipas dispozitave te Aktit mbi Transportin 1969, Aktit mbi Gazin 1986, Aktin mbi Aeroportet 1986 ose Aktin mbi Ujrat 1989, nga sipermarres te tjere ligjore; dhe
- (b) menjehere pas transferimit toka ishte toke veprimi per keto sipermarres.

(5) Leje planifikimi e vecante per qellime te nen-seksionit (3)(a) eshte nje leje planifikimi -

- (a) e dhene pas nje aplikimi te bere sipas Pjeses III; ose
- (b) e dhene nga dispozitat e nje urdher zhvillimi qe jep leje planifikimi ne pergjithesi per zhvillime qe kane marre aprovim nga parlamenti; ose
- (c) e dhene nga nje urdher i vecante ne lidhje me zhvillimi te vecanta te percaktuar ne urdher; ose
- (d) i caktuar per tu dhene ne baze te nje udhezimi te nje departamenti qeveritar sipas seksionit 90(1).

(6) Ne nen-seksionin (5) -

- (a) referenca ne paragrafin (a) per Pjesen III perfshijne referenca per Pjesen III te Aktit te vitit 1971 dhe miratime ne fuqi perpara fillimit te atij Akti qe eshte zevendesuar me Pjesen III te tij; dhe
- (b) referencat ne paragrafin (b) per zhvillime te cilat kane marre aprovim te vecante nga parlamenti jane referenca per zhvillime te autorizuar -
 - (i) nga nje Akt Parlamenti lokal apo privat,
 - (ii) nga nje urdher i aprovuar nga te sy Dhomat e Parlamentit; ose
 - (iii) nga nje urdher qe ka hyre ne veprim ne perputhje me dispozitat e Aktit mbi Urdherat Ligjore 1945,

duke qene nje Akt ose urdher qe cakton natyren e zhvillimit qe autorizon dhe token mbi te cilen mund te zbatohet;

- (c) referenca ne paragrafin (d) per seksionin 90(1) perfshijne referenca per seksionin 40 te Aktit te vitit 1971, seksionin 41 te Aktit te vitit 1962 dhe seksionin 35 te Aktit te vitit 1947.

(7) Ky seksion nuk do aplikohet per toke interesi i se ciles i eshte dhene Sherbimit Postar nga Postmasteri i Pergjithshem ne baze te seksionit 16 te Aktit mbi Sherbimin Postar 1969.

(8) Kur interesi mbi token mbahet nga Autoriteti i Aviacionit Civil ky seksion nuk do te aplikohet per qellime te percaktimit nese toka eshte toke veprimi ne lidhje me Autoritetin per qellime te ketij Akti.

Koncepti i
"Ministrit
perkates"

265.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, ne kete Akt, "Minister perkates" do te thote -

- (a) Sekretari i Shtetit per Transportin, ne lidhje me sipermarres te autorizuar qe kryejne sipermarrje ne hekurudhe, tramvaj, rruge transporti, port, skele, ose fanar, Autoriteti i Aviacionit Civil ose operues aeroporti te caktuar (sipas kuptimit te Aktit mbi Aeroportet 1986);
- (b) Sekretari i Shtetit per Energjine, ne lidhje me sipermarres te autorizuar qe punojne per hidrocentrale;
- (c) Sekretari i Shtetit per Tregtine dhe Industrine, ne lidhje me Sherbimin Postar; dhe
- (d) Sekretari i Shtetit per Mjedisin, ne lidhje me cdo sipermarres tjeter ligjor.

(2) Per qellime te seksioneve 170(12), 266 deri 280, 325(9) dhe 336(2) dhe (3) dhe Pjesa II e Skedules 8 "Minister perkates" ne lidhje me nje furnizues gazi publik ose person qe ka licence sipas seksionit 6 te Aktit mbi Elektricitetin 1989, do te thote Sekretari i Shtetit per Energjine.

(3) Per qellime te seksioneve 170(12), 266 deri 280, 325(9) dhe 336(2) dhe (3) dhe Pjesa II e Skedules (Aneksit) 8 dhe Skedules (Aneksit) 14, "Minister perkates"—

- (a) do te thote Sekretari i Shtetit ose Ministri i Bujqesise, Peshkimit, dhe Ushqimit, ne lidhje me Autoritetin Kombetar te Lumenjve; dhe

- (b) Sekretari i Shtetit, ne lidhje me sipermarres te ujesjellesve apo ujrave te zeza.

(4) Referenca ne kete Akt per Sekretarit e Shtetit dhe Ministrin perkates -

- (a) ne qofte se Ministri perkates nuk eshte Sekretari i Shtetit, do te merren si referenca per Sekretarin e Shtetit dhe Ministrin perkates; dhe
- (b) ne qofte se Sekretari i Shtetit eshte gjithashtu Ministri perkates, do merren si referenca vetem per ate.

Aplikime per
leje
planiikimi
nga
sipermarres
ligjore

Aplikime te Pjeses III per sipermarresit ligjore

266.—(1) Kur -

- (a) nje aplikim per leje planifikimi per te zhvilluar nje toke se ciles i aplikohet ky nen-seksion eshte bere nga sipermarres ligjore dhe i eshte dorezuar Sekretarit te Shtetit sipas Pjeses III; ose
- (b) eshte bere nje apelim tek Sekretari i Shtetit sipas asaj Pjese per vendimin mbi aplikimin; ose
- (c) nje aplikim i tille eshte bere sipas nen-seksionit (5) te seksionit 177 pas nje apelimi sipas seksionit 174 nga sipermarres ligjore,

aplikimi ose apelimi do te shqyrtohen nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates.

(2) Nen-seksioni (1) aplikohet -

- (a) per toke veprimi; dhe
- (b) per toke qe mbahet nga sipermarres ligjore ose qe propozohet te blihet nga ata per qellime te sipermarrjeve te tyre, kur leja e planifikimit, ne qofte se jepet pas aplikimit apo apelimit, do jete per zhvillime qe perfshijne perdorimin e tokes per ate qellime.

(3) Nje aplikim per leje planifikimi qe konsiderohet qe eshte bere ne baze te seksionit 196(6) do te shqyrtohet nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates.

(4) Ne varesi te dispozitave te kesaj Pjese per sa i perket kompensimeve, dispozitat e ketij Akti aplikohen per aplikime qe sipas ketij seksioni shqyrtohen nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates, sikur te ishin shqyrtuar nga Sekretari i Shtetit.

(5) Nen-seksionet (2)(b) do kene efekt ne lidhje me Autoritetin e Aviacionit Civil sikur referencat per zhvillimin qe perfshin perdorimin e tokes per qellime te kryerjes se sipermarrjeve te Autoritetit, te zevendesonin referenca per zhvillime qe kane te bejne me perdorimin e tokes per qellime te sipermarrjeve sic caktohen nga Ministri perkates.

Leje
planifikimi e
dhene me
kushte

267.—(1) Pavaresisht nga Pjesa III, leja e planifikimit per te zhvilluar toke veprimi te sipermarresve ligjore nuk do te jepet, pervec me aprovimin e tyre, me kushte qe kerkojne –
(a) qe ndonje ndertese apo punim te autorizuar nga leja te shembet apo te hiqet, ose
(b) qe perdorimi i autorizuar i tokes te ndalohet ne fund te nje periudhe te caktuar.

Zhvillime qe
kerkojne
autorizim
nga nje
departament
i qeverise

268.—(1) Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates nuk kerkohen nga skesioni 266(1) te shqyrtojne aplikime per leje planifikimi per zhvillime te tokes se veprimit ne qofte se kerkohet autorizimi i nje departamenti te qeverise ne lidhje me ate zhvillim,

(2) Nen-seksioni (1) nuk aplikohet kur nje autorizim perkates eshte dhene pa udhezim per dhenien e lejes se planifikimit.

(3) Per qellime te ketij seksioni zhvillimet do te konsiderohen te autorizuar nga nje departament i qeverise ne qofte se –

- (a) eshte dhene nga nje departament, sipas nje miratimi, nje autorizim, apo pelqim per zhvillime;
- (b) eshte konfirmuar nje urdher per blerje te detyrueshme nga departament, per blerje te tokes per qellime te realizimit te zhvillimit;
- (c) eshte dhene pelqimi nga departamenti per pervetesimin e tokes per qellime te zhvillimit, ose te blerjes se tokes me marreveshje per ate qellim;
- (d) jepet autoritet nga departamenti per marrje hua te parave per qellime te zhvillimit, ose per perdorimin e parave per ate qellim te cilat nuk mund te perdoren ndryshe; ose
- (e) departamenti jep mundesi per te paguar nje grant ne lidhje me zhvillimin ne perputhje me ndonje miratim qe autorizon pagesen e ketij granti,

dhe referenca ne kete seksion per departamentin e qeverise do te merren perkatesisht.

Revokime ose
modifikime te
lejes per te
zhvilluar
token e
veprimit

269.—(1) Ne lidhje me nje leje planifikimi te dhene pas aplikimit te sipermarresve ligjore per zhvillime te tokes se veprimit, dispozitat e Pjeses III ne lidhje me revokimin dhe modifikimin e lejes se planifikimit do te kene efekt sikur cdo reference per Sekretarin e Shtetit te zevendesohet me referenca per Sekretarin e Shtetit dhe Ministrin perkates.

Urdhera qe
kerkojne
ndalimin e
perdorimit te
tokes se
veprimit

270.—(1) Dispozitat e Pjeses III ne lidhje me berjen e urdherave –
(a) qe kerkojne ndalimin e perdorimit te tokes;
(b) qe vene kushte per vazhdimin e perdorimit te saj;
ose
(c) qe kerkojne qe ndertesa apo punime ne toke te shemben ose te hiqen,

dhe dispozitat e Skedules (Aneksit) 9 ne lidhje me berjen e ketyre urdherave sipas asaj Skedule (Aneksi) kane efekt ne lidhje me token e veprimit te sipermarresve ligjore sikur referencat per Sekretarin e Shtetit te zevendesohen me referenca per Sekretarin e Shtetit dhe Ministrin perkates.

Heqja e te drejtave te sipermarresve ligjore

Heqja e te
drejtave te
sipermarres-
ve ligjore

271.—(1) Ky seksion aplikohet kur eshte blere nje toke nga nje Minister, nje autoritet lokal, ose sipermarres ligjor sipas Pjeses IX te ketij Akti ose Kapitullit V te Aktit mbi Planifikimin 1990 (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) apo ndonje miratimi tjeter, ose eshte pervetesuar nga nje autoritet lokal per qellime planifikimi, dhe –

- (a) ekziston e drejta mbi token per sipermarresit ligjore per qellime te sipermarrjeve te tyre, e drejte per ngritjen, mbajtjen e nje aparati mbi, ne ose nen toke; ose
- (b) ekzistojne mbi, ne, ose nen toke, aparate te sipermarresve ligjore per qellime te zbatimit te sipermarrjeve te tyre.

(2) Ne qofte se autoriteti blesues ose pervetesues eshte i bindur qe heqja e te drejtave, ose sipas rastit heqja e nje aparati, eshte e nevojshme per qellime te kryerjes se zhvillimeve per te cilat toka eshte blere apo pervetesuar, ata mund t'i japin sipermarresve ligjore nje njoftim—

- (a) qe tregon se e drejta do te hiqet ne fund te nje periudhe te caktuar; ose
- (b) qe kerkon qe perpara mbarimit te kesaj periudhe aparati te zhvendoset.

(3) Sipermarresit ligjore te cilet moren nje njoftim sipas nen-seksionit (2), perpara perfundimit te nje periudhe 28 ditore nga data e njoftimit, mund t'i jape nje kunder-njoftim autoritetit bleres apo pervetesues--

- (a) qe tregon se ata kundershtojne te gjithë ose disa dispozita te njoftimit; dhe
- (b) qe tregon aresyet e kundershimit.

(4) Ne qofte se jepet nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3)—

- (a) cdo e drejte qe lidhet me njoftimin do te hiqet ne fund te periudhes se caktuar; dhe
- (b) ne qofte se ne fund te asaj periudhe ndonje kerkese e njoftimit per heqjen e ndonje aparati nuk eshte zbatuar, autoriteti bleres apo pervetesues mund te heqe aparatin dhe te beje me te cfaredo qe autoriteti mendon te pershtatshme.

(5) Ne qofte se eshte dhene nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3) tek nje autoriteti lokale ose sipermarres ligjore, autoriteti ose sipermarresit mund ose -

- (a) te terheqin njoftimin (pa cenuar te drejten e nje njoftimi te metejshem); ose
- (b) te aplikojne tek Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates per nje urdher sipas ketij seksioni qe perfshin dispozitat e ketij njoftimi, me ose pa modifikime.

(6) Ne qofte se eshte dhene nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3) ne nje Minister -

- (a) ai mund te terheqe njoftimin (pa cenuar dhenien e nje njoftimi te metejshem); ose
- (b) ai dhe Ministri perkates mund te bejne nje urdher sipas ketij seksioni qe perfshin dispozitat e njoftimit, me ose pa modifikime.

(7) Ne kete seksion cdo reference per pervetesimin e tokes per qellime planifikimi do te merret ne perputhje me seksionin 246(1) sikur ky seksion te jete ne Pjesen IX.

(8) Per qellime te ketij seksioni periudha e caktuar, ne lidhje me nje njoftim te dhene ne lidhje me nje te drejte apo aparat, eshte periudha 28 ditore nga data e dhenies se njoftimit ose nje periudhe me e gjate sic mund te specifikohet ne lidhje me ate aparat apo te drejte.

Heqja e te drejtave te operuesve te telekomunikacionit

272.—(1) Ky seksion aplikohet kur toka eshte blere nga nje Minister, nje autoritet lokal, apo sipermarres ligjore sipas Pjeses IX te ketij Akti ose sipas Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990, ose qe eshte pervetesuar nga autoriteti lokal per qellime te planifikimit, dhe -

- (a) ekziston nje e drejte mbi token e dhene ne perputhje me kodin e telekomunikacionit, qe eshte e drejte per ngritjen, apo mbajtjen e aparatit mbi, nen, ose ne toke; ose
- (b) ekziston ne, mbi, nen toke nje aparat telekomunikacioni i instaluar per keto qellime.

(2) Ne qofte se autoriteti bleres apo pervetesues eshte i bindur qe eshte e nevojshme per kryerjen e zhvillimit per te cilin toka u ble apo u pervetesua heqja e te drejtave apo zhvendosja e aparatit, ata mund t'i japin operuesit te telekomunikacionit nje njoftim—

- (a) qe tregon se do te hiqet e drejta me mbarimin e nje periudhe te caktuar;
- (b) qe kerkon qe perpara perfundimit te kesaj periudhe te zhvendoset aparati.

(3) Operuesi i telekomunikimit i cili merr njoftimin sipas nen-seksionit (2), perpara mbarimit te nje periudhe 28 ditore nga data e njoftimit, mund t'i jape nje kunder-njoftim autoritetit bleres apo pervetesues—

- (a) qe tregon se ai kundershton disa ose te gjithë dispozitat e njoftimit; dhe
- (b) jep aresyet e kundershimit.

(4) Ne qofte se nuk eshte bere kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3)—

- (a) cdo e drejte per te cilen flet njoftimi do te hiqet ne fund te periudhes se caktuar; dhe
- (b) ne qofte se ne fund te periudhes ndonje kerkese e njoftimit per heqje aparatesh nuk eshte permbushur, autoriteti bleres apo pervetesues mund te heqe aparatin dhe te beje me te cfaredo qe t'i duket e pershtatshme.

(5) Ne qofte se nje kunder-njoftim i eshte dhene sipas nen-seksionit (3) autoritetit lokal ose sipermarresit ligjor, autoriteti ose sipermarresit mund ose -

- (a) te terheqin njoftimin (pa cenuar dhenien e nje njoftimi te metejshem); ose
- (b) te aplikojne tek Sekretari i Shtetit dhe Sekretari i

Shtetit per Tregtine dhe Industrine per nje urdher sipas ketij seksioni qe perfshin dispozitat e njoftimit me ose pa modifikime.

(6) Ne qofte se i eshte dhene nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3) nje Ministri -

(a) ai mund te terheqe njoftimin (pa cenuar dhenien e nje njoftimi te metejshem); ose

(b) ai dhe Sekretari i Shtetit per Tregtine dhe Industrine mund te nxjerrin nje urdher sipas ketij seksioni qe perfshin dispozitat e njoftimit me ose pa modifikime.

(7) Ne kete seksion cdo reference per pervetesimin e tokes per qellime planifikimi do te merret ne perputhje me seksionin 246(1) sikur ky seksion te ishte ne Pjesen IX.

(8) Per qellime te ketij seksioni periudhe e caktuar, ne lidhje me nje njoftim te dhene ne lidhje me nje te drejte apo aparat, eshte periudha 28 ditore qe fillon me daten e njoftimit ose ndonje periudhe me e gjate e caktuar ne lidhje me ate te drejte apo aparat.

Njoftime per te njejtat qellime si ne ss. 271 dhe 272

273.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, kur toka eshte blere apo pervetesuar sic permendet ne 271(1), dhe -

(a) ekziston ndonje aparat mbi, nen, ose ne toke qe i perket nje sipermarresi ligjor; dhe

(b) sipermarresit deklarojne qe zhvillimi qe do behet ne toke kerkon ne lidhje me sipermarrije, heqjen ose rivendosjen e aparatit,

sipermarresit mund t'i japin njoftim autoritetit bleres apo pervetesues per te kerkuar te drejten e hyrjes ne toke per punime ne lidhje me heqjen, ose ri-vendosjen e aparatit ose nje pjese te tij, sic percaktohet ne njoftim.

(2) Asnje njoftim sipas ketij seksioni mund te jepet me vone se 21 dite pas fillimit te zhvillimit te tokes qe eshte blere apo pervetesuar sipas seksionit 271(1).

(3) Kur jepet nje njoftim sipas ketij seksioni, autoriteti te cilit i jepet, perpara mbarimit te periudhes 28 ditore nga data e njoftimit, mund ti jape sipermarresve ligjore kunder-njoftim duke treguar aresyet e kundershimit te tyre.

(4) Ne qofte se nuk eshte dhene kunder-njoftim sipas nen-

seksionit (3), sipermarresit ligjore, ne fund te periudhes, kane te drejtat te cilat i kane kerkuar ne njoftim.

(5) Ne qofte se eshte dhene nje kunder-njoftim sipas nen-seksionit (3), sipermarresit ligjore qe kane dhene njoftimin sipas ketij seksioni mund ta terheqin ate ose mund te aplikojne tek Sekretari i Shtetit ose Ministri perkates per urdher qe sipas ketij seksioni u jep sipermarresve te drejtat qe kerkojne ne njoftim ose te drejta te modifikuara sic e shohin te aresyeshme Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates.

(6) Kur, ne baze te ketij seksioni ose te nje urdheri nga Ministrat, sipermarresit ligjore kane te drejte te kryejne punimet per zhvendosjen apo ri-vendosjen e aparatit, ata mund te bien dakord me autoritetin bleres apo pervetesues qe punimet te kryhen nga ai autoritet ne vend te sipermarresve, me mbikqyrjen e tyre.

(7) Ne nen-seksionin (1)(a), referenca per aparate qe jane prone e sipermarresve ligjore perfshijne referenca per aparate te telekomunikacionit te mbajtur te instaluar per qellime te sistemit te telekomunikacionit.

(8) Per qellime te nen-seksionit (7), ne kete seksion --

(a) referenca (pervec ne nen-seksionin (1)(a)) per sipermarres ligjore kane te njejtin efekt si referenca per operues te sistemeve te tilla; dhe

(b) referenca per Ministrin perkates kane te njejtin efekt si referenca per Sekretarin e Shtetit per Tregtine dhe Industrine.

Urdhera sipas ss. 271 dhe 272

274.—(1) Kur nje Minister dhe Ministri perkates propozojne per nxjerrjen e nje urdheri sipas seksionit 271(6) ose 272(6), ata do te pregatisin nje urdher skice.

(2) Perpara se te bejne nje urdher sipas nen-seksioneve (5) dhe (6) te seksionit 271, ose sipas nen-seksionit (5) ose (6) te seksionit 272, Ministri qe propozon per urdherin duhet ti jape sipermarresve ligjore, ose operuesve te telekomunikacionit te cileve ju dha njoftimi sipas nen-seksionit (2) te seksionit 272 nje mundesi per te kundershmtuar aplikimin apo propozimin per te nxjerre urdherin.

(3) Ne qofte se behet nje kundershmtim i tille, perpara se te japin urdherin Ministrat duhet te marrin ne konsiderate kundershmtimin dhe t'i japin sipermarresve ligjore ose sipas rastit operuesve te telekomunikacionit (dhe per rastet qe bien ne nen-seksionin (5) te

secilit prej atyre seksioneve, autoriteti lokal ose sipermarresi ligjor te cilet moren kunder-njoftim) mundesi per te paraqitur mendimet e tyre perpara nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates.

(4) Pas zbatimit te nen-seksioneve (2) dhe (3) Ministrat, ne qofte se e konsiderojne te pershtatshme, mund te nxjerrin urdherin ne perputhje me aplikimin, ose ne perputhje me skicen e aplikimit, me ose pa modifikime.

(5) Kur behet nje urdher sipas seksionit 271 ose 272 -
(a) cdo e drejte me te cilen lidhet urdheri do te hiqet ne fund te periudhes qe tregohet ne urdher; dhe
(b) ne qofte se, ne fund te periudhes se dhene ne lidhje me nje aparat, nuk jane permbushur kerkesat e urdherit, autoriteti bleres apo pervetesues mund te heqe aparatin dhe te beje me te cfaredo qe mendon te pershtatshme.

(6) Ne kete seksion referenca per Ministrin perkates ne ratin e nje urdheri sipas seksionit 272 do te merren si referenca per Sekretarin e Shtetit per Tregetine dhe Industrine.

Zgjerime ose modifikime te funksioneve te sipermarresve ligjore

Heqja ose modifikimi i funksioneve te sipermarresve e ligjore

275.—(1) Fuqite e dhena nga ky seksion do te ushtrohen kur, pasi eshte bere nje paraqitje apo prezantim i nje sipermarresi ligjor, Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates e shohin te nevojshme qe fuqite dhe detyrat e ketyre sipermarresve te zgjerohet ose te modifikohen, me qellim qe -

(a) te sigurojne dispozitat e sherbimeve qe nuk mund te sigurohen ndryshe, per qellime ne lidhje me te cilat nje autoritet lokal apo Minister mund te autorizohen sipas Pjeses IX te ketij Akti ose sipas Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990 (Ndertesa te Listuara dhe Zona te Mbrojtura) per te blere toke ose ne lidhje me te cilen cdo person mund te bleje toke sipas ndonje miratimi; ose

(b) te lehtesoje kryerjen e sipermarresve te nevojshme per aresye te ndonje veprimi apo ngjarje te permendur ne nen-seksionin (2).

(2) Aktet dhe ngjarjet jane -

(a) blerja sipas Pjeses IX te ketij Akti ose te atij

Kapitulli ose e detyruar sipas ndonje miratimi tjeter e tokes per te cilen eshte mbajtur interesi, ose e cila eshte perdorur per qellime te kryerjes se sipermarresve nga sipermarres te autorizuar ne fjale;

(b) heqja e te drejtave ose vendosja e kerkesave ne baze te seksioneve 271 ose 272;

(c) nje vendim ne lidhje me nje aplikim te bere nga sipermarres ligjore per leje planifikimi per te zhvilluar ate toke sic permendet ne paragrafin (a);

(d) revokimi apo modifikimi i lejes se planifikimit te dhene ne baze te nje aplikimi te tille;

(e) nxjerrja e nje urdheri sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules (Aneksit) 9 ne lidhje me toke te tille.

(3) Fuqite e dhena nga ky seksion do te ushtrohen gjithashtu, kur pasi eshte bere prezantim apo paraqitje e mendimeve nga autoriteti lokal apo Ministri, Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates e shohin te nevojshme qe fuqite dhe detyrat e sipermarresve ligjore duhet te zgjerohen ose modifikohen me qellim qe te sigurohen dispozitat e sherbimeve te reja, ose zgjerimi i sherbimeve ekzistuese, per qellime ne lidhje me te cilat autoriteti lokal ose Ministri qe kane bere prezantimin mund te jene te autorizuar sipas Pjeses IX te ketij Akti apo Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990 (Ndertesat e Listuara dhe Zonat e Mbrojtura) per blerjen e tokes ose ne lidhje me te cilen autoriteti apo Ministri mund te blejne toke sipas ndonje miratimi tjeter.

(4) Kur ushtrohen fuqite e dhena nga ky seksion, Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates, ne qofte se e shohin te pershtatshme, me urdher mund te bejne te mundur zgjerimin ose modifikimin e fuqive dhe detyrave te sipermarresve ligjore sic percaktohet ne urdher -

(a) per te bere te mundur sherbimet ne fjale, sic permenden ne nen-seksionin (1)(a) ose (3), ose

(b) per te bere te mundur lehtesimet ne fjale sic permenden ne nen-seksionin (1)(b), sipas rastit.

(5) Pa cenuar karakterin e pergjithshem te nen-seksionit (4), nje urdher sipas ketij seksioni mund te beje dispozita -

(a) per ti dhene fuqi sipermarresve ligjore -

(i) per te blere (me detyrim apo me marreveshje) cdo toke te percaktuar ne urdher, dhe

(ii) per te ngritur apo konstruktuar ndertesa apo

punime te percaktuara;

- (b) per te zbatuar ne lidhje me blerjen e kesaj toke ose konstruksionin apo punimet, miratime qe lidhjen me blerjen e tokes dhe me konstruksionin;
- (c) kur eshte e qarte qe nje urdher eshte i nevojshme per qellime te permendura ne nen-seksionin (1)(a) ose (3), per ti dhene fuqi mareveshjeve financiare te bera ndermjet autoritetit lokal ose Ministrit dhe sipermarresve ligjore, mund te percaktohet e barabarte ne menyre te tille nga nje gjykate sic mund te specifikohet ne urdher;
- (d) per ceshtje suplementare qe mund ti duken te nevojshme Sekretarit te Shtetit dhe Ministrit perkates per qellime te urdherit.

Procedura ne lidhje me urdhera sipas s. 275

276.—(1) Sa me shpejt te jete e mundur pas berjes se nje prezantimi te tille sic permendet ne nen-seksionin (1) ose nen-seksionin (3) te seksionit 275 sipermarresit ligjore, autoriteti lokal ose Ministri qe kane bere prezantimin duhet -

- (a) te botojne nje njoftim per prezantimin; dhe
- (b) ne qofte se Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates udhezojne, ti japin nje njoftim te ngjashem personave, ose personave te klasave te vecanta, sic mund te udhezohet.

(2) Nje njoftim sipas nen-seksionit (1)—

- (a) do te botohet ne format dhe ne menyre te atille sipas udhezimeve te Sekretarit te Shtetit dhe Ministrit perkates;
- (b) do te jape detaje me te cilat lidhet prezantimi; dhe
- (c) duhet te caktoj kohen brenda se ciles dhe menyren per berjen e verejtjeve apo kundershimeve.

(3) Urdhera sipas seksionit 275 do te varen nga nje procedure e vecante parlamentare.

Clirimi i sipermarresve e ligjore nga detyrimet

277.—(1) Kur, pas nje prezantimi te bere nga sipermarresit e autorizuar, Ministri perkates eshte i bindur qe permbushja e detyrimeve nga sipermarresit ne lidhje me kryerjen e sipermarresve te tyre eshte bere jo praktike nga nje veprim apo ngjarje se ciles i aplikohet ky nen-seksion, Ministri perkates, ne qofte se e shoh pershtatshme, me urdher mund te udhezaje qe sipermarresit i autorizuar do te clirohen nga keto detyrim, ose teresisht, ose sic

specifikohet ne urdher.

(2) Nen-seksioni (1) aplikohet per veprimet dhe ngjarjet e meposhtme—

- (a) blerja e detyruar sipas Pjeses IX te ketij Akti ose sipas Kapitullit V te Pjeses i te Aktit mbi Planifikimin 1990 ose sipas ndonje miratimi tjetër per ndonje toke interesi i se ciles eshte mbajtur, ose e cila eshte perdorur per qellime te kryerjes se sipermarresve te sipermarresve ligjore; dhe
- (b) veprime dhe ngjarje te percaktuara ne seksionin 275(2)(b) deri (e).

(3) Ministri perkates mund te udhezaje sipermarresit ligjore te cilet kane bere nje prezantim sipas nen-seksionit (1), ta botojne ate ne njerën ose ne te dyja menytrat e meposhtme ---

- (a) me botimin ne nje format apo menyre sic mund te udhezohet te nje njoftimi, qe jep detaje sic mund te udhezaje ai per ceshtje qe lidhen me prezantimin dhe qe percakton kohen Brenda se ciles dhe menyren ne te cilen mund te jene bere kundershimet apo verejtjet per udherin;
- (b) me dhenien e nje njoftimi personave, ose klasave te personave sic mund te udhezaje ai.

(4) Sipermarresit ligjore duhet te zbatojne udhezimet e dhena sipas nen-seksionit (3) sa me shpejt te jete e mundur pas berjes se prezantimit sipas nen-seksionit (1).

(5) Ne qofte se eshte bere nje kundershim apo verejtje sipas ketij seksioni dhe nuk eshte terhequr perpara nxjerrjes se urdherit, urdheri do ti nenshtrohet procedure se vecante parlamentare.

(6) Menjehere pasi eshte bere nje urdher sipas ketij seksioni nga Ministri perkates, ai duhet -

- (a) te botoje nje njoftim qe tregon qe urdheri eshte bere dhe emrin e vendit ku mund te shikohet nje kopje e tij gjate oreve te aresyeshme te dites; dhe
- (b) te jape nje njoftim te ngjashem -
 - (i) cdo personi qe ka bere nje verejtje apo kundershim urdherit dhe ka derguar tek Ministri perkates nje kerkese me shkrim ti jape njoftimin e kerkuar nga ky nen-seksion, duke dhene adresen per dergimin e njoftimit; dhe
 - (ii) personave te tjere (ne qofte se ka) qe Ministri perkates mendon se eshte e pershtatshme.

(7) Ne varesi te nen-seksionit (8), dhe te dispozitave te Pjeses XII, nje urdher sipas ketij seksioni do hyje ne fuqi ne daten ne te cilen u botua per here te pare njoftimi i kerkuar nga nen-seksioni (6).

(8) Kur ne perputhje me nen-seksionin (5) urdheri i nenshtrohet procedurave te vecanta parlamentare, nen-seksioni (7) nuk do te aplikohet.

Kundershtim
e te
urdherave
sipas ss. 275
dhe 277.

278.—(1) Per qellime te seksioneve 275 deri 277, nje kundershtim apo verejtje per nje urdher nuk do te konsiderohet i rregullt ne qofte se nuk jane plotesuar —

- (a) kundershtimi eshte bere brenda kohes dhe ne menyren e percaktuar ne njoftimin e kerkuar nga seksioni 276, ose sipas rastit seksioni 277; dhe
- (b) jane hartuar dhe paraqitur me shkrim aresyet e kundershtimit.

(2) Kur nje kundershtim per nje urdher te tille eshte bere ne menyre te rregullt ne perputhje me nen-seksionin (1) dhe nuk eshte terhequr, do te kene efekt dispozitat e meposhtme te ketij seksioni.

(3) Pervec rasteve kur Ministri perkates vendos pa marre parasysh kundershtimin te mos e nxjerre urdherin, ose vendos te beje modifikime per te cilat ka rene dakord me personin qe ka bere kundershtime, perpara se te marre vendimin perfundimtar ai —

- (a) duhet te marre ne considerate aresyet e kundershtimit sic paraqiten me shkrim; dhe
- (b) ne qofte se e mendon te pershtatshme, ti kerkoje personit qe ka bere kundershtimin te paraqese Brenda nje kohe te caktuar nje leter te metejshme per ceshtje ne lidhje me aresyet e kundershtimit.

(4) Aq sa Ministri perkates eshte i bindur, pasi merr ne considerate aresyet e kundershtimit sic jane dhene ne letren fillestare dhe te metejshme, qe kundershtimi lidhet me ceshtje qe mund te shqyrtohet ne caktimin e kompensimit, Ministri perkates mund ta trajtoje kundershtimin si te pavlefshem per qellime te marrjes se vendimit finale.

(5) Ne qofte se —

- (a) pas konsideron aresyet e kundershtimit te paraqitura, Ministri perkates eshte i bindur qe, per qellime te marrjes se vendimit final, eshte i

informuar plotesisht per ceshtjet me te cilat lidhet kundershtimi; ose

- (b) ne rastin kur eshte kerkuar nje leter e metejshme, nuk eshte paraqitur Brenda kohes se percaktuar,

Ministri perkates mund te marre vendimin final pa shqyrtime te metejshme te ceshtjeve.

(6) Ne varesi te nen-seksioneve (4) dhe (5), perpara se te marre vendimin final Ministri duhet ti jape kundershtuesit mundesi per te shprehur mendimet e veta perpara nje personi te emeruar per ate qellime nga Ministri perkates.

(7) Ne qofte se kundershtuesi e shfrytezon kete mundesi, Ministri perkates duhet ti jape mundesi te tille ne te njejten kohe edhe sipermarresit ligjore, autoritetit lokal ose Ministrin mbi bazat e prezantimit te te cileve eshte propozuar te behet urdheri, dhe ndonje personi tjetër qe i duket e pershtatshme.

(8) Pavaresisht nga dispozitat e mepareshme te ketij seksioni, ne qofte se Ministri perkates e sheh te aresyeshme qe ceshtjet me te cilat lidhet kundershtimi kerkojne shqyrtim te metejshem ne nje seance locale publike, atehere ai duhet te beje te mundur nje seance te tille.

(4) Kur Ministri perkates vendos te mbledhe nje séance te tille, cdo kerkese e nen-seksioneve (3) deri (7) qe nuk u eshte dhene fuqia deri ne ate kohe, nuk do te merren parasysh.

(10) Ne kete seksion cdo reference per marrjen e vendimit final apo perfundimtar eshte reference per vendimin per nxjerrjen e urdherit apo jo, apo te modifikimeve qe duhen bere.

(11) Kur i aplikohet ky seksion urdherave sipas seksionit 275, cdo reference per Ministrin perkates do te merret si reference per Sekretarin e Shtetit dhe Ministrin perkates.

Kompensime

E drejta e
kompensimit
ne lidhje me
disa
kompensime
dhe udhera

279.—(1) Sipermarresit ligjore, ne varesi te dispozitave te meposhtme te kesaj Pjese, do te kene te drejte te kompensohen nga autoriteti i planifikimit lokal—

- (a) ne lidhje me vendime te marra ne perputhje me seksionin 266 nga te cilat leja e planifikimit per zhvillime ne token e veprimit te ketyre sipermarresve eshte refuzuar ose eshte dhene ne

varesi te kushteve kur -

- (i) leja e planifikimit per ate zhvillim duhet te ishte dhene nga nje urdher zhvillimi por per nje udhezim te dhene sipas ketij urdheri leja e planifikimit nuk aplikohet per zhvillimin; dhe
- (ii) nuk eshte zhvillim qe ka marre aprovim te vecante nga parlamenti (Brenda kuptimit te seksionit 264(6));

(b) ne lidhje me ndonje urdher sipas seksionit 97, sic modifikohet nga seksioni 269, nga i cili leja e planifikimit qe u dha pas aplikimit te sipermarresve per zhvillime te tokes u revokua ose u modifikua.

(2) Kur ne baze te seksionit 271—

(a) ndonje e drejte qe i takon sipermarresve ligjore eshte hequr; ose

(b) ndonje kerkese eshte bere per sipermarresit ligjore, keta sipermarres do kene te drejte te kompensohen nga autoriteti bleres ose pervetesues per te drejten e hequr apo per kerkesen e imponuar.

(3) Kur ne baze te seksionit 272 -

(a) ndonje e drejte qe i takon operuesve te telekomunikacionit eshte hequr; ose

(b) imponohet ndonje kerkese ndaj ketyre operuesve, operuesi do te kete te drejte per komensim nga autoriteti bleres apo pervetesues per te drejten e hequr apo kerkesen e imponuar.

(4) Kur -

(a) jane kryer punime per heqjen ose ri-vendosjen e nje aparati te sipermarresve ligjore; dhe

(b) sipermarresit kane te drejte te kryejn keta punime ne baze te seksionit 273 ose ne baze te nje urdheri Ministri sipas atij seksioni,

sipermarresit do kene te drejten e kompensimit nga autoriteti bleres apo pervetesues.

(5) Nen-seksioni (1) nuk aplikohet ne lidhje me nje vendim ose urdher ne qofte se -

(a) lidhet me toke te blere nga sipermarres ligjore pas 7 Janarit 1947; dhe

(b) Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates perfshijne ne vendim ose urdher, nje udhezim qe nen-seksioni (1) nuk aplikohet.

(6) Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates mund te japin

udhezime sipas nen-seksionit (5) vetem ne qofte se ata jane te bindur, duke pase parasysh natyren, situaten dhe zhvillimin ekzistues te tokes dhe te ndonje toke fqinje, dhe te ndonje konsiderate tjeter, qe eshte e paarsyeshme qe kompensimi te mbulohet ne lidhje me vendimin ose urdherin ne fjale.

(7) Per qellime te ketij seksioni kushtet e referuara ne seksionet 91 dhe 92 nuk do te merren parasysh.

Matja e kompensimeve per sipermarresit ligjore

280.—(1) Kur sipermarres ligjore kane te drejten e kompensimit -

(a) sic permendet ne nen-seksionin (1), (2) ose (4) te seksionit 279;

(b) sipas dispozitave te seksionit 115 ne lidhje me nje urdher te bere sipas seksionit 102 ose paragrafit 1, 3, 5, ose 6 te Skedules (Aneksi) 9, sic modifikohen nga seksioni 270; ose

(c) ne lidhje me nje blerje te detyruar te tokes qe eshte blere nga keto sipermarres per qellime te sipermarrjeve te tyre, kur blerja e pare ndikohet nga nje urdher per blerje e detyruar te konfirmuar ose te bere pa certifikaten e Ministrit perkates,

ose operuesi i telekomunikacionit ka te drejten e kompensimit sic permendet ne seksionin 279(3), shuma e kompensimit do te jete shuma e llogaritur ne perputhje me kete seksion.

(2) Ne varesi te nen-seksioneve (4) deri (6), shuma do jete mbledhja e -

(a) shumes se shpenzimeve te kryera ne blerjen e tokes, vendosjen e nje aparati, ngritjen e ndertesave apo kryerjen e punimeve per qellime te ndonje rregullimi te kryerjes se sipermarrjeve, ose per qellime te funksionimeve te aparateve te telekomunikacionit (rregullim biznesi);

(b) shumes perkatese te humbjes se fitimit; dhe

(c) kur kompensimi behet sipas seksionit 279(2) ose (3), dhe eshte ne lidhje me imponimin e kerkesave per te hequr aparatet, shuma e shpenzimeve te bera nga sipermarres ligjore apo nga operues ne perputhje me kerkesat, e reduktuar nga vlera pas heqjes se aparatit.

(3) Ne nen-seksioni (2) "shuma perkatese per humbje te fitimit" do te thote—

(a) kur behet nje rregullim biznesi, mbledha apo shuma e -

- (i) shuma e perafert e nje renie te fitimeve neto nga kryerja e siper marrjeve, ose sipas rastit, funksionimi i telekomunikacionit, perpara rregullimit, kur renia eshte direkt e lidhur me ceshtjet qe sollen kompensimin; dhe
- (ii) nje shume e tille si kompensim i aresyeshem per cdo vleresim te renies se fitimeve nga kryerja e siper marrjeve ose sipas rastit, funksionimi i telekomunikacionit, pas rregullimit, kur renia eshte direkt e lidhur me ceshtjet qe sollen kompensimin;
- (c) kur nuk eshte bere nje rregullim biznesi, shuma qe eshte kompensim i aresyeshem per cdo renie ne fitimet neto bga kryerja e siper marrjeve ose, sipas rastit, funksionimi i telekomunikacionit qe jane te lidhura direkt me ceshtjet qe sollen kompensimin.

(4) Kur behet nje rregullim biznesi, shuma e pergjithshme e permendur ne nen-seksionin (2) do te reduktohet me nje shume qe sipas Gjykates se Tokave mbulon --

- (a) vleren e perafert te ndonje prone (te tundshme apo te patundshme) qe i takon siper marresve ligjore ose operuesve dhe e perdorur per kryerjen e siper marrjeve te tyre, ose sipas rastit per funksionimin e telekomunikimit, qe si rrjedhim i ndalimin te perdorimit te rregullimit, kur vlera e prone nuk eshte marre parasysh sipas paragrafit (c) te atij nen-seksioni; dhe
- (b) vleren e perafert te rritjeve ne te ardhura neto nga kryerja e siper marrjeve ose nga funksionimi i telekomunikacionit pasi eshte bere rregullimi, kur shuma nuk eshte marre parasysh ne percaktimin e shumes se permendur ne paragrafin (b) te atij nen-seksioni dhe qe lidhet direkt me rregullimin.

(5) Kur behet nje rregullim biznesi shuma e pergjithshme e permendur ne nen-seksionin (2) do te reduktohet me tej me nje shume qe Gjykata e Tokave e konsideron te pershtatshme, duke patur parasysh cdo rritje ne vleren e kapitalit te prone se patundshme qe i takon siper marresve ligjore ose operuesve qe eshte lidhur direkt me rregullimin, ne qofte se eshte bere kompensim per ndonje reduktim sipas nen-seksionit (4)(b).

(6) Kur --

- (a) kompensimin eshte sipas seksionit 297(4); dhe

(b) autoriteti bleres apo pervetesues kryen punimet, atehere, si shtese e reduktimit te bere sipas nen-seksionit (4) ose (5) shuma e pergjithshme e permendur ne nen-seksionin (2) do te reduktohet me koston aktuale te autoritetit te kryerjes se punimeve.

(7) Referencat ne kete seksion per uljen ne te ardhurat neto do te merret si referenca per --

- (a) per shumen me te cilen balanca e te ardhurave mbi shpenzimeve ulet;
- (b) per shumen me te cilen balanca e shpenzimeve mbi te ardhurat eshte rritur; ose
- (c) kur nje balance e te ardhurave mbi shpenzimet eshte shnderruar ne nje balance te shpenzimeve mbi te ardhurat, shumen e dy balancave;

dhe referenca per uljen ne te ardhurat neto do te merret perkatesisht.

(8) Ne kete seksion --

- "qe lidhet direkt me kompensimit" do te thote--
 - (a) pervec se ne lidhje me kompensime sipas seksioni 279(4), veprimi i vecante (qe do te thote vendimi, urdheri, heqja e te drejtave, imponimi i kerkesave ose blerja) ne lidhje me te cilen kompensimi mund te vleresohet, sic dallohet nga zhvillimi ose projekti ne lidhje me te cilin ky veprim mund te jete marre;
 - (b) ne lidhje me kompensimin sipas seksionit 297(4), rrethanat per te cilat eshte e nevojshme per aparatin ne fjale te hiqet ose te ri-vendoset;
- "certifikata e Ministrit perkates" do te thote nje certifikate e tille sic permendet ne seksionin 16 ose paragrafin 3 te Skedules (Aneksit) 3 te Aktit mbi Blerjen e Tokes 1981.

Perjashtimi i s.280 nga siper marresit ligjore

281.—(1) Kur siper marresit ligjore kane te drejte te kompensohen ne lidhje me blerje sic permendet ne seksionin 280(1)(c), siper marresit ligjore mund te japin njoftim me shkrim sipas ketij seksioni qe kompensimi te percaktohet ne perputhje me miratimet (pervec rregulles 5 te rregullave ne seksionin 5 te Aktit mbi Kompensimin e Tokave 1961) qe mund te aplikohet pervec nga seksioni 280.

(2) Ne qofte se siper marresit ligjore e zgjedhin kompensimin e tille, ata duhet te kompensohet perkatesisht.

(3) Nje zgjedhje sipas ketij seksioni mund te jete ose ne lidhje me te gjithë token e perfshire ne blerje te detyrueshme ose ne lidhje me nje pjese te saj.

(4) Cdo njoftim sipas ketij seksioni do ti jepet autoritetit bleres perpara mbarimit te periudhes 2 mujore nga data e dhenies se njoftimit per interesin e sipermarresve ligjore.

Procedura
per
vleresimin e
kompensimit

282.—(1) Kur shuma e nje kompensimi sic permendet ne nen-seksionin (1) te seksionit 280 do te percaktohet ne perputhje me dispozitat e atij seksioni, kompensimi do te vleresohet nga Gjykata e Tokave, ne qofte se pervec ketij seksioni nuk do te vleresohej ndryshme ne kete menyre.

(2) Per qellime te proceseve qe dalin perpara Gjykates se Tokave ne perputhje me kompensime te permendura ne nen-seksionin (1), dispozitat e seksionit 2 dhe 4 te Aktit mbi Kompensimin e Tokes 1961 aplikohen, sic aplikohen per procese ne fjale qe i jane kaluar Gjykates se Tokave sipas seksionit 1 te atij Akti, por me zevendesimin ne seksionin 4 te atij Akti, per referenca ne lidhje me autoritetin bleres, te referencave per personin i cili ka kerkuar kompensimin.

Reklamime

Vendosja e
reklamave e
toke veprimi

283. - Seksionet 266 deri 270 dhe 279(1), (5) dhe (6) nuk aplikohen ne lidhje me afishimin e reklamave ne toka te veprimit te sipermarresve ligjore.

PJESA XII: Vlefshmeria

Vlefshmeria e
planeve te
zhvillimeve
dhe disa
urdherave,
vendimeve
dhe
udhezimeve

284.—(1) Pervec ne qofte se vendoset ndryshe nga kjo Pjese, vlefshmeria e —

- (a) nje plani struktural, plani lokal ose plani te zhvillimit te njehsuar ose ndonje ndryshim, apo zevendesim i cdo plani te tille, nese perpara apo pas aprovimit apo adoptimit te planit, ndryshim apo zevendesimit; ose
- (b) nje skeme te zone planifikimi te thjeshtezuar ose ndryshimit te nje skeme te tille; ose

ndryshimit te nje skeme te tille; ose

- (c) nje urdheri sipas dispozitave te Pjeses X pervec seksionit 251(1), nese perpara ose pase eshte dhene urdheri; ose
- (d) nje urdheri sipas seksionit 277, perpara apo pasi eshte dhene urdheri; ose
- (e) cdo urdheri i tille sic permendet ne nen-seksionin (2), perpara ose pasi eshte konfirmuar; ose
- (f) cdo veprimi nga ana e Sekretarit te Shtetit sic permendet ne nen-seksionin (3),

nuk do te diskutohet ne ndonje proces ligjor.

(2) Urdherat e referuar ne nen-seksionin (1)(e) jane —

- (a) cdo urdher sipas seksionit 97 ose sipas dispozitave te atij seksioni sic aplikohen nga ose sipas dispozitave te ketij Akti;
- (b) cdo urdher sipas seksionit 102;
- (c) cdo urdher per mbrojtjen e pemeve;
- (d) cdo urdher i bere ne perputhje me seksionin 221(5);
- (e) cdo urdher sipas paragrafeve 1, 3, 5, ose 6 te Skedules (Aneksit) 9.

(3) Veprimet e referuara ne nen-seksionin (1)(f) jane veprime nga ana e Sekretarit te Shtetit qe pershkruhet nga nje nga sa me poshte —

- (a) cdo vendim per nje aplikim per leje planifikimi te referuar atij sipas seksionit 77;
- (b) cdo vendim per nje apelim sipas seksionit 78;
- (c) dhenia e udhezimeve sipas seksionit 80;
- (d) cdo vendim per konfirmimin e nje njoftimi sipas seksionit 95;
- (e) cdo vendim per dhenie te lejes se planifikimit sipas paragrafit (a) te seksionit 177(1) ose per venien e kushteve ose kufizimeve sipas paragrafit (b) te atij seksioni;
- (f) cdo vendim per te konfirmuar ose jo konfirmuar nje njoftim per blerje qe perfshin —
 - (i) cdo vendim per te mos konfirmuar nje njoftim ne lidhje me nje pjese te tokes me te cilen lidhet, ose
 - (ii) cdo vendim per te dhene leje, ose udhezime, ne vend te konfirmimit te nje njoftimi, ose teresisht ose pjeserisht;
- (g) cdo vendim per nje aplikim per certifikate te vendosur perdorimi qe i kalohet Sekretarit te Shtetit sipas nen-seksionit (5) te seksionit 192 ose

per nje apelim sipas seksionit 195(1);

(h) cdo vendim ne lidhje me -

(i) nje aplikim per aprovim sipas nje urdheri per mbrojtjen e pemeve,

(ii) nje aplikim per aprovim sipas rregullave te bera ne perputhje me seksionet 220 ose 221, ose

(iii) nje certifikate ose udhezim sipas cdo urdheri te tille ose rregullave, nese vendimi per apelimin ose vendimi per aplikimin kalohet tek Sekretari i Shtetit per te marre vendim qe ne fillim.

(4) Asgje ne kete seksion nuk duhet te ndikojte ushtrimin e ndonje juridiksioni te ndonje gjykate ne lidhje me refuzimin ose deshtimin e pjesshem nga ana e Sekretarit te Shtetit per te marre nje vendim te tille sic permendet ne nen-seksionin (3).

Vlefshmeria e njoftimeve te zbatimit dhe njoftimeve te ngjashme

285.—(1) Ne varesi te dispozitave te ketij seksioni, vlefshmeria e nje njoftimi zbatues, pervec me ane te nje apelimi sipas Pjeses VII, nuk do te diskutohet ne asnje proces per asnje arsye mbi bazen e te cilave mund te behet apelimi.

(2) Nen-seksioni (1) nuk do te aplikohet per procese sipas seksioneve 179(6) deri (8) kunder nje personi i cili -

(a) ka mbajtur nje interes mbi token qe perpara njoftimit per zbatim sipas asaj Pjese;

(b) nuk ka marre nje kopje te njoftimit per zbatim sipas asaj Pjese; dhe

(c) e bind gjykatën -

(i) qe ai nuk e dinte dhe nuk mund ta dinte qe eshte nxjerre njoftimi per zbatim; dhe

(ii) qe interesi i tij eshte demtuar nga deshtimi per dhenien e nje kopje te tij.

(3) Ne varesi te nen-seksionit (4), vlefshmeria e njoftimit qe eshte bere sipas seksionit 215 per pronarin apo perdoruesin e tokes, pervec rasteve me apelim sipas Kapitullit II te Pjeses VIII, nuk do te diskutohet ne ndonje proces per asnje nga aresyet e detajuara ne seksionin 217(1)(a) ose (b).

(4) Nen-seksioni (3) nuk do ndaloje vlefshmerine e nje njoftimi te tille te diskutohet ne baze te aresyeve sipas seksionit 216 kunder nje personi i cili nuk ka marre njoftimin, por qe ka mbajtur nje inters mbi token qe perpara se njoftimi t'i jepej pronarit ose perdoruesit te tokes, ne qofte se ai nuk apelon kunder njoftimit sipas atij Kapitulli.

(5) Vlefshmeria e nje njoftimi qe pretendon te jete njoftim per zbatim nuk varet nese ndonje mos-zbatim me te cilin lidhet njoftimi eshte mos-zbatim me kushte, ose me kufizime, ose me te dyja.

(6) Cdo reference ne nje njoftim te tille per mos-zbatim te kushteve ose kufizimeve (nese te dyja apo njera nga shprehjet perdoren ne njoftim) do te merret si reference per mos-zbatimin e kushteve, ose kufizimeve, ose te dyjave kushteve dhe kufizimeve, sipas rastit.

Sfide vlefshmerise ne baze te fuqive te autoritetit

286.—(1) Vlefshmeria e cdo leje, vendimi ose certifikate te dhene, te bere, ose te nxjerre nga autoriteti i planifikimit lokal ne lidhje me -

(a) nje aplikim per leje planifikimi;

(b) nje aplikim per te vendosur sipas seksionit 64 nese aplikimi kerkohet apo jo;

(c) nje aplikim per te marre certifikate perdorimi sipas seksionit 192;

(d) nje aplikim per aprovim per te afishuar reklama sipas seksionit 220; ose

(e) nje vendim sipas seksionit 302 ose Skedules (Aneksit) 15,

nuk do te diskutohet ne proces gjyqesor, ose ne ndonje proces sipas ketij Akti qe nuk jane procese gjyqesore, mbi bazat ne te cilat leja, vendimi, apo certifikata, duhet te ishte dhene, eshte dhene, apo bere nga nje autoritet planifikimi tjetër.

(2) Vlefshmeria e nje urdheri sipas seksionit 97 qe revokon ose modifikon lejen e planifikimit, e nje urdheri sipas seksionit 102 ose paragrafit 1 te Skedules (Aneksit) 9 qe kerkon nderprerjen e perdorimit, ose qe vendos kushte per vazhdimin e perdorimit ose qe kerkon ndryshimin ose heqjen e ndertesave ose punimeve, ose nje njoftim zbatimi sipas seksionit 172 ose njoftim ndalimi sipas seksionit 183, duke qene urdher ose njoftim qe pretendon te jete bere, nxjerre ose dhene nga autoriteti i planifikimit lokal, nuk do te diskutohet ne procese te tilla mbi bazen e -

(a) ne rastin e nje urdheri apo njoftimi qe eshte bere nga autoriteti i planifikimit te qarkut, mbi bazat e deshtimit per te permbushuyr kerkesat e paragrafit 11(2) te Skedules (Aneksit)1;

(b) ne rastin kur nje urdher apo njoftim eshte bere nga autoriteti i planifikimit qarkor, qe nuk kishte fuqi t'a bente, per arsye se nuk lidhet me nje ceshtje te qarkut qe perfshihet ne ate Skedule (Aneks).

Procese per
venien ne
diskutim te
vlefshmerise
te planeve te
zhvillimit,
skemave dhe
urdherave.

287.—(1) Ne qofte se nje person i prekur nga nje plan zhvillimi te njehsuar ose nga nje plan lokal ose ndryshim, apo zevendesim te ndonje plani te tille apo strukture, deshiron te diskutoje vlefshmerine e planit ose sipas rastit ndryshimit apo zevendesimit mbi baza -

- (a) qe nuk eshte brenda fuqie te dhena nga Pjesa II, ose
- (b) qe ndonje kerkese e asaj Pjese ose te ndonje rregulle te bere sipas saj, nuk eshte permbushur ne lidhje me aprovimin ose adoptimin e planit, apo sipas rastit ndryshimin ose zevendesimin,

ai mund te beje nje aplikim tek Gjykata e Larte sipas ketij seksioni.

(2) Me aplikimin sipas ketij seksioni, Gjykata e Larte -

- (a) mund me nje urdher te perkohshem te ndaloje pjeserisht apo teresisht punimet per planin ose sipas rastit ndryshimet apo zevendesimet, ose ne pergjithesi ose per sa ndikon ne pronen e aplikuesit, deri ne vendimin final te procesit;
- (b) ne qofte se bindet qe plani, ndryshimi ose zevendesimi eshte teresisht apo pjeserisht jashte fuqive te dhena nga Pjesa II, ose qe interesat e aplikuesit jane demtuar ne mase te konsiderueshme nga mos-zbatimi i kerkesave te asaj Pjese ose te ndonje rregulle te bere sipas saj, mund qe te hedhe poshte planin, ndryshimin apo zevendesimin, pjeserisht apo teresisht, ose ne pergjithesi ose ne masen qe ndokin ne pronen e aplikantit.

(3) Nen-seksionet (1) dhe (2) do te aplikohen, ne varesi te modifikimeve te duhura, ne nje skeme zone planifikimi ose ne nje ndryshim te kesaj skeme, ose per nje urdher sipas seksionit 247, 248, 249, 251, 257, 258, ose 277, sic mund te aplikohen ne nje plan ose ndryshim apo zevendesim te tij.

(4) Nje aplikim sipas ketij seksioni duhet te behet brenda 6 javeve nga data e caktuar.

(5) Per qellime te nen-seksionit (4) data e cakuar eshte -

- (a) ne rastin e aplikimeve ne lidhje me nje plan te tille sic permendet ne nen-seksionin (1), data e botimit per here te pare te aprovimit apo adoptimit te

planit, ndryshimit apo zevendesimit qe kerkohet nga rregullat sipas seksionit 26, ose sipas rastit seksionit 53,

- (b) ne rastin e aplikimeve ne baze te nen-seksionit (3) ne lidhje me nje skeme zone planifikimi te thjeshtezuar ose me ndryshimin e skemes, data e botimit te njoftimit per here te pare te aprovimit ose adoptimit te skemes ose ndryshimit te kerkuar nga rregullat sipas paragrafit 13 te Skedules (Aneksit) 7,
- (c) ne rastin e aplikimit ne baze te seksionit (3) ne lidhje me nje urdher sipas seksionit 247, 248, 249, ose 251, data e botimit per here te pare te njoftimit te kerkuar nga seksioni 252(10),
- (d) ne rastin e aplikimit ne baze te seksionit (3) ne lidhje me nje urdher sipas seksionit 257 ose 258, data ne te cilen njoftimi i kerkuar nga paragrafi 7 i Skedules (Aneksit) 14 botohet per here te pare ne perputhje me ate paragraf,
- (e) ne rastin e aplikimit ne baze te seksionit (3) ne lidhje me nje urdher sipas seksionit 277, data ne te cilen njoftimi i kerkuar nga nen-seksioni (6) i atij seksioni eshte botuar per here te pare;

por ne varesi te seksionit 292, ne rastin e urdherave te permendura ne paragrafet (c) dhe (e) te cilave i aplikohet seksioni 292.

(6) Ne aplikimin per skeme zone planifikimi te thjeshtezuar, nen-seksionet (1) dhe (2) kanë efekt sikur te ishin referuar Pjeses III ne vend te Pjeses II.

Procese per
te diskutuar
vlefshmerine
e
vendimeve,ur
dherave dhe
udhezimeve
te tjera.

288.—(1) Ne qofte se nje person -

- (a) eshte prekur nga nje urdher te cilit i aplikohet ky seksion dhe ai desheron te veje ne diskutim vlefshmerine e atij urdheri mbi bazat -
 - (i) qe urdheri nuk eshte bere brenda fuqive te ketij Akti, ose
 - (ii) qe ndonje kerkese tjeter e caktuar nuk eshte permbushur ne lidhje me ate urdher; ose
- (b) eshte prekur nga nje veprim nga ana e Sekretarit te Shtetit te cilit i aplikohet ky seksion dhe desheron te veje ne diskutim vlefshmerine e atij veprimi mbi bazat—
 - (i) qe veprimi nuk eshte brenda fuqive te ketij Akti, ose

(ii) qe ndonje kerkese tjeter e caktuar nuk eshte permbushur ne lidhje me ate veprim, ai mund te aplikojte tek Gjykata e Larte sipas ketij seksioni.

(2) Pa cenuar nen-seksionin (1), ne qofte se autoriteti qe lidhet direkt me nje urdher te cilit i aplikohet ky seksion, ose me ndonje veprim nga ana e Sekretarit te Shtetit te cilit i aplikohet ky seksion, desheron te veje ne diskutim vlefshmerine e atij urdheri apo veprimi mbi baza te permendura ne nen-seksionin (1), autoriteti mund te aplikojte tek Gjykata e Larte sipas ketij seksioni.

(3) Nje aplikim sipas ketij seksioni duhet te behet brenda 6 javeve nga data ne te cilen urdheri eshte konfirmuar (ose ne rastin e nje urdheri sipas seksionit 97 qe hyn ne fuqi sipas seksionit 99 pa konfirmim, data e hyrjes ne fuqi) ose sipas rastit data e kryerjes se veprimit.

(4) Ky seksion aplikohet per urdhera te tille te permendur ne nen-seksionin (2) te seksionit 284 dhe per veprime nga ana e Sekretarit te Shtetit sic permenden ne nen-seksionin (3) te atij seksioni.

(5) Pas berjes se aplikimit sipas ketij seksioni, Gjykata e Larte -

(a) ne varesi te nen-seksionit (6), mund qe me nje urdher te perkohshem te ndaloje punimet ne lidhje me urdherin ose veprimin, vlefshmeria e te cileve eshte ne diskutim, derisa te merret nje vendim perfundimtar;

(b) ne qofte se bindet qe urdheri ose veprimi ne fjale nuk eshte brenda fuqive te ketij Akti, ose qe interesat e aplikuesit jane cenuar ne menyre te konsiderueshme nga mos-zbatimi i kerkeseve te caktuara ne lidhje me te, Gjykata mund te hedhe poshte urdherin apo veprimin.

(6) Paragrafi (a) i nen-seksionit (5) nuk aplikohet per aplikime qe vene ne diskutim vlefshmerine e nje urdheri per mbrojtjen e pemeve.

(7) Ne lidhje me nje urdher per mbrojtjen e pemeve, ose nje urdher te bere ne perputhje me seksionin 221(5), fuqite e dhene Gjykates se Larte nga nen-seksioni (5) do te ushtrohen me hedhjen poshte ose ndalimin e punimeve te urdherit teresisht ose pjeserisht, sic vendos Gjykata.

(8) Referenca ne kete seksion per konfirmimin e nje urdheri perfshine konfirmime te nje urdheri ne varesi te modifikimeve, si

dhe konfirmime te nje urdheri ashtu sic eshte bere.

(9) Ne kete seksion "kerkesa te caktuara", ne lidhje me nje urdher ose veprim te cileve i aplikohet ky seksion, do te thote kerkesa te ketij Akti ose te Aktit mbi Gjykatat dhe Hetimet 1971, ose te nje urdheri, rregulle, te bere sipas ketij Akti ose sipas atij Akti qe i aplikohet urdherit apo veprimit.

(10) Cdo reference ne kete seksion per autoritetin qe lidhet direkt me nje urdher apo veprim per te cilin aplikohet ky seksion --

(a) ne lidhje me vendime te permendura ne seksionin 284(3)(f), eshte reference per keshillin i cili mori njoftimin ne fjale, dhe ne rastin kur Sekretari i Shtetit ka modifikuar pjeserisht apo teresisht nje njoftim te tille, me zevendesimin e keshillit me autoritetin lokal apo sipermarres te autorizuar, perfshin referenca per autoritetin lokal apo sipermarresit e autorizuar;

(b) ne cdo rast tjeter, eshte reference per autoritetin qe ka bere urdherin ne fjale ose qe ka marre vendimin ose dhene njoftimin me te cilin lidhet procesi, ose i cili i kaloi ceshtjen Sekretarit te Shtetit, ose kur urdheri ose njoftimi ne fjale i jepet atij, autoriteti i permendur ne njoftim apo urdher.

Apelime tek
Gjykata e
Larte per
njoftimet e
zbatimit dhe
njoftimet
sipas s. 207

289.—(1) Kur Sekretari i Shtetit jep nje vendim pas nje apelimi sipas Pjeses VII kunder nje njoftimi per zbatim, apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal ose ndonje person tjeter qe ka interes ne token me te cilen lidhet njoftimi mund ose te apeloje tek Gjykata e Larte kunder vendimit ose ti kerkoje Sekretarit te Shtetit te deklaraje dhe te nenshkruaje ne opinionin e Gjykates se Larte.

(2) Kur Sekretari i Shtetit jep nje vendim per apelimin sipas Pjeses VIII kunder nje njoftimi sipas seksionit 207, apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal ose ndonje person (pervec apeluesit) qe mori njoftimin, ne perputhje me rregullat e gjykates mund ose te apeloje Gjykates se Larte kunder vendimit ose ti kerkoje Sekretarit te Shtetit te deklaraje dhe te nenshkruaje ne opinionin e Gjykates se Larte.

(3) Ne cdo faze te procesit per cdo apelim sic permendet ne nen-seksionin (1), Sekretari i Shtetit mund vecoje ndonje ceshtje qe del gjate procesit per vendim nga Gjykata e Larte.

(4) Nje vendim i Gjykates se Larte qe kalohet sipas nen-seksionit

(3) do te merret qe eshte gjykim i gjykates brenda kuptimit te seksionit 16 te Aktit mbi Gjykatën Supreme 1981.

(5) Ne lidhje me procese ne Gjykates e Larte ose Gjykatën e Apelit te kaluara ne baze te ketij seksioni fuqia per te bere rregulla ne gjyq do te perfshije fuqi per te bere rregulla -

- (a) qe pershkruajne fuqite e Gjykates se Larte ose Gjykates se Apelit ne lidhje me ceshtje per tu rishqyrtuar dhe vendosur nga Sekretari i Shtetit; dhe
- (b) bejne te mundur qe Sekretari i Shtetit, ne rrethana te caktuara, te merren si pale ne nje proces te tille dhe te thirret ne gjyq per tu degjuar perkatesisht.

(6) Asnje apelim tek Gjykata e Apelit do te paraqitet ne baze te ketij seksioni.

(7) Ne kete seksion "vendim" perfshin nje udhezim apo urdher, dhe referenca per marrjen e nje vendimi do te behen perkatesisht.

Apelime ne
Gjykatën e
Larte kunder
vendimeve
sipas s. 64

290.—(1) Ne qofte se, ne rastin e nje vendimi per te cilin aplikohet ky seksion, personi qe ka bere aplikimin me te cilin lidhet vendimi ose autoriteti i planifikimit lokal eshte i kenaqur me vendimin ne flaje, personi ose sipas rastit autoriteti i planifikimit lokal, ne perputhje me rregullat, mund ose te apeloje kunder vendimit te Gjykates se Larte ose te kerkoje qe Sekretari i Shtetit te nenshkruaje si rast per opinionin e Gjykates se Larte.

(2) Ky seksion aplikohet per vendime te Sekretarit te Shtetit -

- (a) per nje aplikim sipas seksionit 64 qe i kalohet Sekretarit te Shtetit sipas dispozitave te seksionit 77 sic aplikohet nga ai seksion; ose
- (b) per nje apelim te bere sipas dispozitave te seksionit 78 sic aplikohet nga seksioni 64.

(3) Kur behet aplikimi sipas seksionit 64 si pjese e nje aplikimi per leje planifikimi, nen-seksioni (1) dhe (2) do kene efekt ne lidhje me ate aplikim ne masesn qe perben aplikim sipas seksionit 64, por jo per aplikim per leje planifikimi.

(4) Ne lidhje me nje proces ne Gjykatën e Larte ose Gjykatën e Apelit ne baze te ketij seksioni, fuqia per te vendosur rregulla ne gjyq perfshin fuqine per te bere rregulla qe pershkruajne fuqite e Gjykates se Larte ose Gjykates se Apelit ne lidhje me --

- (a) dhenien e nje vendimi qe mund te ishte dhene nga Sekretari i Shtetit;

- (b) ri-sjelljen e ceshtjes me udhezime per tu rishqyrtuar dhe vendosur nga Sekretari i Shtetit;
- (c) dhenia e udhezimeve Sekretarit te Shtetit.

(5) Asnje apelim per Gjykatën e Apelit do te behet ne baze te ketij seksioni.

(6) Pa cenuar dispozitat e mepershme te ketij seksioni, rregullat e gjyqit ne lidhje me procese ne Gjykatën e Larte ose Gjykatën e Apelit ne baze te ketij seksioni, mund te bejne te mundur qe Sekretari i Shtetit ne rrethana te caktuara, te merret si pale ne kete proces dhe te kete te drejte te degjohet perkatesisht.

291. Ne lidhje me ndonje veprim i cili -

- (a) pervec dispozitave te Pjeses XI kryhet nga Sekretari i Shtetit dhe qe bie brenda seksionit 284(3); por
- (b) ne baze te kesaj Pjese, kerkohet te kryhet nga Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates,

dispozitat e seksionit 284 dhe 288 do kene efekt (ne varesi te seksionit 292) sikur referencat ne keto dispozita per Sekretarin e Shtetit te jene referenca per Sekretarin e Shtetit dhe Ministrin perkates.

Dispozita te
vecanta per
vendime ne
lidhje me
sipermarresit
ligjore

292.—(1) Kur nje urdher sipas seksionit 247, 248, 249, ose 277 eshte ne varesi te nje procedure te vecante parlamentare, atehere -

- (a) ne qofte se urdheri eshte konfirmuar nga Akti i Parlamentit sipas seksionit 6 te Aktit mbi Urdherat Ligjore 1945, seksionet 284 dhe 287 nuk do aplikohen ne urdher;
- (b) ne cdo rast tjeter, seksioni 287 ka efekt ne lidhje me nje urdher, sikur ne nen-seksionin (4) te atij nen-seksioni sikur referenca per daten e permendur aty te merren si referenca per daten ne te cilen urdheri hyri ne fuqi sipas seksionit 6 te atij Akti ("data operuese").

(2) Kur ne baze te Pjeses XI cdo veprim i tille sic permendet ne seksionin 291 kerkohet per tu perfshire ne nje urdher, dhe ai urdher eshte ne varesi te nje procedure parlamentare, atehere -

- (a) ne qofte se urdheri qe perfshin veprimin eshte konfirmuar nga nje Akt i parlamentit sipas seksionit 6 te atij Aktit, seksionet 284 dhe 288 nuk aplikohen;
- (b) ne cdo rast tjeter, seksionin 288 aplikohet me zevendesimin e referencave per daten operuese me

daten ne te cilen kryhet veprimi.

PJESA XIII:
Aplikime te Aktit mbi Token e Mbreterise

Parathenie

Dispozita te vecanta per urdhera ne varesi te procedurave te vecanta te parlamentit

293.—(1) Ne kete Pjese –

- “toke e Mbreterise do te thote toke ne te cilen Mbreteria apo Dukati ka interes;
- “interes i Mbreterise” do te thote interes qe i takon Madherise se Saj si e drejte e Mbreterise ose qe i takon nje departamenti te qeverise ose i mbajtur per Madherine e Saj per qellime te departamentit te qeverise;
- “interes i Dukatit” do te thote interes qe i takon Madherise se Saj si e drejte e Dukatit te Lankasterit ose qe i takon Dukatit te Cornwall-it;
- “interes privat” do te thote interes qe nuk eshte as i Mbreterise as i Dukatit.

Perkufizime

(2) Per qellime te kesaj Pjese “autoriteti perkates”, ne lidhje me nje toke –

- (a) ne rastin e tokave qe i takojen Madherise se Saj si e drejte e Mbreterise dhe qe perbejne pjese te Prones se Mbreterise, do te thote Komisioneret e Prones se Mbreterise;
- (b) ne lidhje me ndonje toke tjeter qe i takon Madherise se Saj si e drejte e Mbreterise, do te thote departamenti i qeverise qe e menaxhon ate toke;
- (c) ne lidhje me toke qe i takon Madherise se Saj si e drejte e Dukatit te Lankasterit, do te thote Kancelari i Dukatit;
- (d) ne lidhje me toke qe i takon Dukatit te Cornwall-it, do te thote nje person i emruar nga Duka i Cornwall-it, ose perfaqesuesi i tij;
- (e) ne rastet kur toka i takon nje departamenti te qeverise ose qe mbahet per Madherine e Saj per qellime te departamentit te qeverise, do te thote ai departament.

(3) Ne qofte se ka dyshime se kush eshte autoriteti perkates, ne lidhje me nje toke, keto dyshime duhet te kalohen tek Thesari, vendimi i te cilit eshte perfundimtar.

(4) Nje person qe ka te drejte te perdore token e Mbreterise ne baze te nje license me shkrim, do te merret per qellime te seksionit 296(1)(c), as sa aplikohet Pjesa III, VII, dhe VIII, dhe seksionet 294(2) deri (7), 295, 299 dhe 300, sikur ka interes ne toke dhe referenca ne seksionin 299 per dhenien e nje interesi ne Token e Mbreterise, dhe te interesit privat ne ate seksion dhe ne seksionet 294(2) dhe 300, do te merren perkatesisht.

Kontrolli mbi zhvillimet ne tokat e Mbreterise: njoftime per zbatim te vecanta

294.—(1) Asnje njoftim per zbatim do te jepet sipas seksionit 172 ne lidhje me zhvillime qe kryhen ne emer te Mbreterise pas 1 Korrikut 1948 ne toka qe ishine toka te Mbreterise ne ate kohe kur zhvillimi po kryhej.

(2) Dispozitat e meposhtme te ketij seksioni aplikohen per zhvillime ne toke te Mbreterise te kryera ne emer te Mbreterise ne kohet kur asnje person ka te drejte te perdore token ne baze te nje interesi privat.

(3) Kur –

- (a) autoriteti i planifikimit lokal e shah te aresyeshme qe zhvillimi per te cilin aplikohet ky nen-seksion eshte kryer ne zonen e tyre, dhe
- (b) ata e shohin te nevojshme nje gje te tille per te marre parasysh dispozitat e planit te zhvillimit,

ata mund te japin nje njoftim sipas ketij seksioni (nje “njoftim zbatimi i vecante”).

(4) Nuk duhet te jepet njoftim zbatimi i vecante pa aprovimin e autoritetit perkates.

(5) Nje njoftim zbatimi i vecante duhet te permbaje –

- (a) ceshtjet qe mendohet se perbejen zhvillimin te cilit i aplikohet ky seksion; dhe
- (b) masat qe kerkon autoriteti qe jep njoftimin qe duhen marre per te kthyer token ne gjendjen e mepareshme perpara zhvillimit, ose per nderprerjen e perdorimit te tokes si rezultat i zhvillimit.

(6) Nje njoftim zbatimi i vecante duhet te permbaje –

- (a) daten ne te cilen do hyje ne fuqi (“date e caktuar”),

dhe

(b) periudhen brenda se ciles do te merren masat sipas nen-seksionit (5)(b).

(7) Nje njoftim zbatimi i vecante mund te specifikojte periudha te ndryshme per masa te ndryshme.

Dispozita
suplementar
e per
njoftime te
vecanta te
zbatimit

295.—(1) Jo me vone se 28 dite nga dhenia e njoftimit te zbatimit te vecante dhe jo me vone se 28 dite perpara dates se specifikuar autoriteti i planifikimit lokal qe e nxorri duhet ti jape nje kopje te tij—

- (a) personave qe po kryejne zhvillimin ne njoftim;
- (b) ndonje personi qe po e perdor token ne kohen e njoftimit; dhe
- (c) autoritetit perkates.

(2) Autoriteti i planifikimit lokal nuk ka nevoje te jape nje kopje te njoftimit personave te permendur ne nen-seksionin (1)(a) ne qofte se ata e kane te pamundur t'i lokalizojne apo gjejne ata.

(3) Cdo person i permendur ne nen-seksionin (1)(a) ose (b) mund te apeloje kunder njoftimit te Sekretarit te Shtetit mbi bazen qe ceshtjet e perfshira ne njoftim —

- (a) nuk jane kryer, ose
- (b) ata nuk perbejne zhvillim per te cilin aplikohet seksioni 294.

(4) Nje person mund te apeloje kunder nje njoftimi zbatimi te vecante sipas nen-seksionit (3) nese apo jo ka marre kopje te tij.

(5) Dispozitat qe kane efekt sipas seksionit 174(3) deri (5), 175(1) deri (4) dhe 176(1) deri (4) do te aplikohen per njoftime zbatimi te vecante te dhena nga autoritete te planifikimit lokal dhe per apelime kunder tyre sipas nen-seksionit (3) sic aplikohen per njoftime te zbatimit dhe per apelime sipas seksionit 174.

(6) Sekretari i Shtetit me ane te rregullave mund te aplikojte tek njoftime zbatimi te vecanta dhe apelime sipas nen-seksionit (3) dispozita te tjera te ketij Akti (me modifikime qe i mendon te pershtatshme) sic i sheh te nevojshme.

Ushtrimi i
fuqive ne
lidhje me

296.—(1) Pavaresisht nga nje interes te Mbreterise ne Token e Mbreterise, por ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni —

token e
Mbreterise

- (a) nje plan i aprovuar, adoptuar, ose bere sipas Pjeses II te ketij Akti ose Pjeses II te Aktit te vitit 1971 mund te perfshije propozime qe lidhen me perdorimin e tokes se Mbreterise;
- (b) cdo fuqi per te blere detyrimisht toke sipas Pjeses IX mund te ushtrohet ne lidhje me interese te tokes se Mbreterise qe mbahet ne emer te Mbreterise;
- (c) cdo kufizim i vene ose fuqi e dhene sipas Pjeses III, VII ose VIII, nga dispozitat e Pjeses VI ne lidhje me njoftimet per blerje, ose nga ndonje dispozite e seksioneve 266 deri 270, do te aplikohen ne lidhje me token e Mbreterise, interesi i se ciles mbahet ne emer te Mbreterise.

(2) Pervec se me aprovimin e autoritetit perkates—

- (a) nuk duhet te behet urdher apo nxirret njoftim sipas cilesdo nga dispozitat e seksioneve 102, 103, 172, 198, 199, ose 215 ose nga Skedula 9 ose sipas atyre dispozitave sic aplikohen nga nje urdher ose rregull e bere sipas Pjeses VIII, ne lidhje me toke e cila ne kete kohe eshte toke e Mbreterise;
- (b) nuk duhet te blihet interes mbi token qe eshte toke Mbreteror sipas Pjeses IX.

(3) Nuk duhet te nxirret njoftim per blerje ne lidhje me nje toke Mbreterore pervec kur —

- (a) nje oferte eshte bere me perpara nga pronari i atij interesi per te ja kaluar autoritetit perkates me kushte te njejta, dhe
- (b) oferta eshte refuzuar nga autoriteti perkates.

(4) Ne nen-seksionin (3), "kushte te njejta" do te thote qe cmimi per interesin do te jete i njejte me kompensimin qe mund te paguhej ne lidhje me te ne qofte se kerkohet ne lidhje me nje njoftim blerje.

(5) E drejta e dhene nga dispozita te Kapitullit II te Pjeses VI do te ushtrohet nga nje person i cili (sipas kuptimit te ketyre dispozitave) eshte pronar-perdorues i nje hereditament ose njesie bujqesore qe eshte toke e Mbreterise, ne te njejten menyre sic ushtrohen ne lidhje me nje hereditamet apo njesi bujqesore qe nuk eshte toke Mbreterore, dhe keto dispozita do te aplikohen perkatesisht.

Mareveshje
me lidhje me

297.—(1) Autoriteti perkates dhe autoriteti i planifikimit lokal per zonen ne te cilen ndodhet toka e Mbreterise mund te bien ne

token e Mbretise e mareveshje per perdorimin e tokes, sic mund te pershkruset ne mareveshje, ne perputhje me dispozitat e planit te zhvillimit i cili i aplikohet.

(2) Nje mareveshje e tille mund te permbaje dispozita rrjedhuese, qe perfshijne dispozita te karakterit financiar, sic mund te jene te nevojshme ose te domosdoshme per qellimet e mareveshjes.

(3) Nje mareveshje e bere sipas ketij seksioni nga nje departament i qeverise nuk do kete efekt ne qofte se nuk eshte aprovuar nga Thesari.

(4) Gjate marrjes se vendimit nese te aprovoje apo jo nje mareveshje te bere sipas ketij seksioni -

(a) per toke qe i takon nje departamenti te qeverise, ose

(b) per toke qe mbahet ne emer te Madherise se Saj per qellime te nje departament qeveritar,

departamenti dhe Thesari duhet te kene parasysh qellimet per te cilat toka mbahet nga departamenti ose per departamentin.

Dispozita suplementar e per interesat e Mbretise ose Dukatit

298.—(1) Ne varesi te dispozitave te meposhtme te ketij seksioni -

(a) kur ekziston nje interes i Mbretise ne toke, dispozitat e seksionit 109 deri 113 te Pjeses V dhe dispozitat e Skedukes 3-te Aktit mbi Planifikimin 1990 aq sa lidhen me seksionet e asaj Pjese, ose Pjeses VII ose seksionet 166 deri 168 te Aktit te vitit 1971, do kene efekt ne lidhje me interes privat ose interes Dukati sikur interesi i Mbretise te jete interes privat; dhe

(b) kur ekziston nje interes Dukati mbi token, keto dispozita do te kene efekt ne lidhje me ate interes, sikur interesi i Dukatit te ishte interes privat.

(2) Referencat ne kete Akt per kerkesa te bera siaps Pjeses VI te Aktit te vitit 1947 perfshijne referenca ne perputhje me mareveshje te bera sipas seksionit 88(2) te atij Akti (qe beri te mundur aplikimin e Pjeses VI te atij Akti tek interesi i Dukatit dhe per pagesen e shumes per aresye te zhvillimeve ne lidhje me kete interes); referencat per pagesat e zhvillimeve perfshijne referenca per shuma te caktuara ne perputhje me mareveshje te tilla qe jane zevendesime per pagesat e zhvillimeve; dhe referenca per shumen e nje kerkese ose per pagese zhvillimi do te merren perkatesisht.

(3) Kur, ne perputhje me nje mareveshje sipas seksionit 297,

kerkohet aprovimi i autoritetit te planifikimit lokal ne lidhje me nje zhvillim te tokes mbi te cilen ka nje interes Dukati, dispozitat e ketij Akti te referuara ne nen-seksionin (1)(a) do kene efekt ne lidhje me pezullimin e aprovimit, ose dhenien e tij ne varesi te kushteve, sikur te ishte refuzim leje planifikimi ose dhenie leje planifikimi me kushte.

Dispozita ne lidhje me parashikimin per dhenien e tokes se Mbretise

Aplikimi per leje ne lidhje me parashikimin per dhenie te tokes Mbretore

299.—(1) Ky seksion ka efekt per qellime te berjes se mundur qe toka e Mbretise, apo interesi mbi te, te jepet ne perfitim te lejes se planifikimit ose te vendimit sipas seksionit 64.

(2) Pavaresisht nga interesi i Mbretise ne token ne fjale, nje aplikim per nje leje te tille ose vendim mund te behet nga -

(a) autoriteti perkates; ose

(b) cdo person i autorizuar nga autoriteti me shkrim;

dhe, ne varesi te nen-seksioneve (3) deri (5), te gjitha dispozitat ligjore ne lidhje me berjen dhe marrjen e vendimit per kete aplikim do te aplikohen perkatesisht sikur toka te mos ishte toke e Mbretise.

(3) Cdo leje planifikimi e dhene sipas ketij seksioni do te aplikohet vetem -

(a) per zhvillime te kryera pasi toka ne fjale nuk eshte me toke e Mbretise; dhe

(b) kur toka vazhdon te jete toke e Mbretise, per zhvillime te kryera ne baze te nje interesi privat mbi token.

(4) Ne lidhje me ndonje aplikim te bere ne baze te ketij seksioni per vendime sipas seksionit 64, nen-seksioni (1) i atij seksioni do kete efekt sikur per referenca te nje aplikimi per leje planifikimi te zevendesohen me referenca per alikime te kerkuara ne raste te punimeve te propozuara ose ndryshim te perdorimit te kryer ne emer te Mbretise.

(5) Sekretari i Shtetit mund te nxjerre rregulla -

(a) qe modifikojne ose perjashtojne cdo dispozite ligjore te referuar ne nen-seksionin (2) ne aplikimet e tyre ne baze te atij nen-seksioni ose te ndonje dispozite tjeter per leje ose aplikime te dhena sipas ketij seksioni;

(b) te beje dispozita per t'ikerkuar autoritetit te

planifikimit lokal qe te njoftoje per dhenie ose dhenie te interesit te nje toke Mbreterore ne lidhje me aplikimin e bere ne baze te ketij seksioni; dhe

(c) te beje dispozita ne lidhje me hartimin dhe marrjen e vendimit per aplikime ne baze te ketij seksioni qe ai i mendon te nevojshme ose te domosdoshme.

(6) Ky seksion nuk do te merret qe ndikon mbi te drejttat per te aplikuar per nje leje apo vendim te tille sic permendet ne nen-seksionin (1) ne lidhje me nje toke te Mbreterise ne rastet kur aplikimi mund te behet ne baze te nje interesi privat mbi token.

(7) Ne kete seksion "dispozita ligjore" do te thote dispozita qe permbahen ose qe kane efekt ne baze te nje miratimi.

Urdhera per mbrojtjen e pemeve ne parashikimin per dhenie te tokes se Mbreterise

300.—(1) Nje autoritet planifikimi lokal mund te nxjerre urdher per mbrojtjen e pemeve ne lidhje me nje toke te Mbreterise qe per kete kohe nuk ekziston interes tjetër përveç atij ne emer te Mbreterise, ne qofte se ata e konsiderojne te nevojshme per qellime te ruajtjes se pemeve ose pyjeve ne toke ne rastin kur toka nuk do jete me toke e Mbreterise ose kur behet toke me interes privat.

(2) Asnje urdher per mbrojtjen e pemeve do behet mbi bazen e ketij seksioni përveç kur aprovohet nga autoriteti perkates.

(3) Nje urdher per mbrojtjen e pemeve i bere mbi baze te ketij seksioni nuk do te hyje ne fuqi pa ndodhur ngjarje perkatese.

(4) Per qellime te nen-seksionit (3), nje ngjarje perkatese ndodh ne lidhje me nje toke, ne qofte se nuk eshte me toke e Mbreterise, ose behet toke me interes privat.

(5) Nje urdher per mbrojtjen e pemeve i bere sipas ketij seksioni –
(a) nuk kerkon konfirmimin sipas seksionit 199 derisa pas ndodhjes se ngjarjes ne baze te te ciles ka efekt; dhe
(b) do te vazhdoje te jete ne fuqi derisa –
(i) te mbaroje periudha 6 mujore qe fillon me ndodhjen e asaj ngjarjeje; ose
(ii) ne daten ne te cilen urdheri u konfirmua, cilado qe ndodh me perpara.

(6) Kur hyn ne fuqi nje urdher per mbrojtjen e pemeve ne perputhje me nen-seksionin (3), autoriteti perkates duhet qe sa me shpejt te jete e mundur ti jape autoritetit qe beri urdherin nje

njoftim me shkrim per emrin dhe adresen e personit qe ka te drejten mbi token ne fjale ose qe ka interes privat mbi kete toke.

(7) Procedura e pershkruar ne seksionin 199 ne lidhje me konfirmimin e nje urdheri per mbrojtjen e pemeve do te aplikohet ne lidhje me nje urdher te bere ne baze te ketij seksioni, sikur urdheri te jete bere ne daten ne te cilen u mor njoftimi sipas nen-seksionit (6) nga autoriteti qe e beri ate.

Kerkesat e lejes se planifikimit
per vazhdimin e perdorimit
e nxjerre nga Mbreteria

301.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal ne te cilin ndodhet toka e Mbreterise mund te bjere dakort me autoritetin e duhur per zbatimin e nenseksioni (2) per kete perdorim te tokes sikurse percaktohet ne marveshje, dhe ky eshte nje perdorim qe rezulton nga nje ndryshim material i kryer ose qe propozohet te kryhet nga Mbreteria gjate perdorimit te kesaj toke.

2) Kur behet nje marveshje sipas nenseksionit (1) per toke te Mbreterise, ate here, nese toka pushon se qeni nen perdorimin e Mbreterise per qellimet e percaktuara ne marveshje, ky Akt do te kete fuqi ndaj cdo perdorimi privat pasardhes te tokes njelloj sikur—

- (a) perdorimi i percaktuar nga Mbreteria te kishte leje planifikimi, dhe
- (b) ai perdorim te ishte autorizuar nga leja e planifikimit te dhene me kushtin qe kerkonte nderprerjen e tij ne ate kohe.

(3) Kushti i permendur ne nenseksionin (2) nuk do te jete i detyruar te zbatohet ndaj nje personi qe kishte interes privat ne ate toke ne kohen kur u be marveshja, vec rastit kur autoriteti i planifikimit lokal i cili beri marveshjen, e ka njoftuar kete person per realizimin e marveshjes si dhe per efektet e atij nenseksioni.

(4) Marveshja e bere ne baze te nenseksionit (1) nga autoriteti i planifikimit lokal do te jete shpenzim per token lokale, dhe per qellimet e Aktit te Shpenzimeve per Token Lokale te 1975 [1975 c.76], autoriteti i planifikimit lokal qe beri kete marveshje do te quhet si autoriteti fillestar ne lidhje me shpenzimin te lindur nga marveshja.

(5) Ne kete seksion "perdorim privat" eshte nje perdorim qe nuk behet nga Mbreteria ose ne emer te saj dhe permendja e perdorimit te tokes nga Mbreteria perfshin perdorimin e tokes ne emer te Mbreterise.

Zbatime ne lidhje me shkelje gjate kohes se luftes te kontrollit te planifikimit nga Mbreteria

Zbatime ne lidhje me shkeljet
gjate kohes se luftes te kontrollit

302.—(1) Ky seksion zbatohet kur gjate periudhes se luftes--

te planifikimit nga Mbreteria (a) ne toke u kryen punime qe nuk perputheshin me kontrollin e planifikimit, ose

- (b) nga Mbreteria ose ne emer te saj, filloi perdorimi i tokes i cili nuk ishte ne perputhje me kontrollin e planifikimit.

(2) Me kusht zbatimin e nenseksionit (4), nese gjate cdo momenti pas perfundimit te luftes, ne toke ekziston nje interes i perhershem ose afatgjate i cili nuk eshte as i Mbreterise ose ne emer te saj dhe as ne te cilin nuk pretendohet pronesi e interesit ose e tokes nga Mbreteria, kontrolli i planifikimit, per aq kohe sa ky inters ekziston ne toke, eshte i zbatueshem ne lidhje me ato punime ose ate perdorim, pavaresisht—

- (a) se punimet u kryen ose toka u perdor nga Mbreteria ose ne emer te saj, ose
- (b) ekzistences ne ate toke te nje interesi te mbajtur nga Mbreteria ose ne emer te saj, i cili eshte ne kthim (te menjehershem ose jo) ne pritje te mbarimit te atij intersi te perhershme ose afatgjate.

(3) Personi qe ka te drejte te beje nje aplikim sipas ketij nenseksioni ne lidhje me cdo toke mund te aplikojte ne cdo kohe para dates perkatese tek autoriteti qe eshte pergjegjes per te zbatuar kontrollin e planifikimit per te percaktuar—

- (a) nese punimet ne toke ose perdorimi i tokes qe filloi gjate luftes perputhen ose jo me kontrollin e planifikimit, zbatimin e te cilit duhet ta siguroje ky autoritet, dhe
- (b) dhe nese eshte keshtu, nese punimet ose perdorime do te konsiderohen se perputhen me kontrollin.

(4) Kur punimet ose perdorimi te cilat filluan gjate luftes mbeten ose vazhdojne pas dates perkatese dhe vendimi per to si me siper nuk eshte marre akoma, punimet ose perdorimi si rrjedhim i ketij nenseksioni do te trajtohen per te gjitha qellimet se perputhen me ate kontroll, vec rastit kur hapat per zbatimin e kontrollit kane filluar para asaj date.

(5) Aneksi 15 do te kete efekt per qellimet e nxjerrjes se dispozitave plotesuese qe lidhen me zbatimin e thyerjes se kontrollit te planifikimit ne te cilat zbatohet ky seksion dhe per pergatitjen dhe vendsojen e aplikimeve te bera sipas nenseksionit (3).

(6) Ne kete seksion dhe kete Aneksi—

- "autoriteti pergjegjes per zbatimin e kontrollit te planifikimit", ne lidhje me cdo punim ne toke ose perdorim te

saj, eshte autoriteti qe ka keto kompetenca si rrjedhim i zbatimit te seksionit 75 te Aktit te 1947 ose paragrafit 34 te Aneksit 24 te Aktit te 1971 (perfshire ate paragraf ndersa ai vazhdon te kete fuqi si rrjedhim i Aneksit 3 te Aktit te Planifikimit (Dispozita shtese) te 1990 [1990 c.9.] per te nxjerre nje njoftim zbatimi ne lidhje me te ose autoriteti qe do te kishte keto kompetenca nese punimet ose perdorimi nuk do te ishin ne perputhje me kontrollin e planifikimit;

- "data perkatese" ne lidhje me cdo toke, eshte data ne te cilen perfundon periudha pese vjecare qe filloi pas mbarimit te luftes, por per qellimet e ketij percaktimi, nuk do te merret parasysh cdo kohe gjate te ciles, pavaresisht nga nenseksioni (2), nuk zbatohet kontrolli i planifikimit per arsye te ekzistences ne ose mbi toke te ndonje interesi ose te drejte pronesia nga Mbreteria ose ne emer te saj;
- "pronar" ka te njejtin kuptim si ne Aktin e Banimit 1985 [1985 c.68.] dhe kuptimi i 'i zoteruar' do te interpretohet ne perputhje me te;
- "interes i perhershem ose afatgjate", ne lidhje me cdo toke eshte pronesia ndaj tokes, dhena me qera per nje periudhe me shume se 10 vjet dhe qe nuk eshte subjekt i te drejtes ekzistuese te pronarit te tokes per te nderprere qerane ne ose para perfundimit te dhjetevjetshis prej fillimit te periudhes se qerese, ose nje dhene me qera per nje periudhe dhjetevjecare ose me te vogel me te drejte rinovimi e cila do ti jape mundesi qeramaresit te zgjase periudhen e kontrates mbas dhjete vjetshis.
- "qeramarrja" perfshin nje qeramarrje me nenkontrate dhe nje qeramarrje sipas nje marveshje per kontrate ose nenkontrate por nuk perfshin marrje qeraje dhe nuk perfshin nje hipotekim;
- "periudha e luftes" eshte periudha nga 3 shtatori 1039 deri 26 mars 1946;
- "punimet" perfshijne cdo ndertese, strukture, germim ose punim tjeter ne toke.

(7) Permendja ne kete seksion dhe ne ate Skedule e mosperputhjes me kontrollin e planifikimit do te thote—

(a) ne lidhje me punime ne toke ose fillim te perdorimit te saj qe ndodhin ne kohe kur ne toke po zbatohet nje rezolute per te pergatitur nje skeme nen Aktin e Planifikimit te Qytetit dhe Vendit 1932 [1932 c.48], se punimet dhe perdorimi nuk ishin ne perputhje me kushtet e nje urdheri zhvillimi te ndermjetem ose lejeje te dhene ne baze te ketij urdheri;

(b) ne lidhje me punime ose perdorim ne kohe kur ndaj tokes po zbatohet nje skeme e tille, se punimet ose perdorimi nuk ishin ne perputhje me dispozitat e skemes; dhe permendja ne kete Akt e perputhjes me kontrollin e planifikimit do te behet si duhet.

(8) Permendja ne kete seksion dhe ate Skedule e zbatimit te kontrollit te planifikimit do te interpretohet si permendje e ushtrimit te kompetencave te dhena nga seksioni 75 i Aktit te 1947 ose nga paragrafi 34 i Aneksit 24 te Aktit te 1971 (perfshire ate paragraf ndersa ai vazhdon te jete ne fuqi si rrjedhim i Aneksit 3 te Aktit te Planifikimit (Dispozitat shtese) te 1990 [1990 c.9.].

Pjesa XIV: Dispozita financiare

Tarifat per aplikimet per planifikim, etj.

303.—(1) Sekretari i Shtetit mundet qe nepermejt rregullave te nxjerre dispozita te tilla qe ai i quan te pershtatshme per pagesen e nje tarife te caktuar tek autoriteti i planifikimit lokal ne lidhje me aplikimin e drejtuar atyre ne baze te Akteve te planifikimit ose te ndonje urdheri ose rregullash te nxjerra ne baze te tyre per leje, miratim, marrje vendimi ose certifikim.

(2) Rregullat ne baze te nenseksionit (1) mund te sigurojne transferimin e tarifes te caktuar qe merret ne lidhje me pershkrimin e aplikimit, nga nje autoritet tek i cili dorezohet aplikimin tek autoriteti i cili do te merret me aplikimin qe i perket atij pershkrimi.

(3) Sekretari i Shtetit mundet, qe nepermjet rregullave te nxjerre dispozita qe ai i mendon te pershtatshme per ti paguar atij tarifen e e sasise se caktuar ne lidhje me nje aplikim per leje planifikimi qe konsiderohet se i eshte drejtuar atij ne baze te ketij Akti ose urdheri ose rregullimi te bere ne baze te tij.

(4) Rregullimet sipas nenseksionit (1) ose (3) mund te sigurojne per anullimin ose kthimin e tarifes se caktuar (te gjithes sasine ose pjese te saj) ne rrethana te caktuara.

(5) Asnje rregull e tille nuk do te nxirret nese nje draft i ketyre rregullave nuk eshte cuar dhe aprovuar me rezolute nga cdo Dhome e Parlamentit.

(6) Permendja e Aktit te planifikimit ne nenseksioni (1) nuk perfshin permendje te seksionit 302 te ketij Akti.

304. Sekretari i Shtetit mundet, me pelqimin e Thesarit, te jape grante per te ndihmuar njesi te perfshira ne promovimin ose dhenien e ndihmes per kerkime dhe edukim qe lidhen me planifikimin dhe projektimin e ambientit fizik.

305.—(1) Kur—

(a) kompensimi eshte i pagueshem nga autoriteti lokal ne baze te ketij Akti si rrjedhim i nje vendimi ose urdheri ndaj te cilit zbatohet ky seksion, dhe

(b) ai urdher ose vendim ishte dhene ose bere pjeserisht ose plotesisht ne interes te nje sherbimi qe kryhet nga nje departament qeveritar dhe kostoja e te cilit mbulohet me fonde te dhena nga parlamenti,

Ministri pergjegjes per administrimin e atij sherbimi mund ti paguaje atij autoriteti nje kontribut, shumen e te cilit ai mund ta percaktoje me pelqimin e Thesarit.

(2) Ky seksion zbatohet ndaj cdo vendimi ose urdheri te dhene ose te bere ne baze te Pjeses III, te dispozitave te Pjeses VI qe lidhen me njoftime blerje, Pjeses VII, ose Aneksit 5, 6 ose 9.

Kontributi nga autoriteti lokal dhe sipermaresit ligjore

306.—(1) Pa cenuar seksionin 274 te Aktit te Autostradave 1980 [1980 c.66] (kontributet e autoriteteve lokale ndaj shpenzimeve te autoriteteve te autostradave) cdo autoritet lokal mund te kontriboje ndaj shpenzimeve te bera nga nje autoritet autostradash—

(a) per shpronесimet e tokave ne baze te Pjeses IX te ketij Akti ose Kapitullit V te Pjeses I te Aktit te Planifikimit (Ndertesarat e listuara dhe Zonat e mbrojtura) 1990 [1990 c.9],

(b) per ndertimin ose permiresimin e rrugeve ne tokat qe u shpronесuan si me siper, ose

(c) ne lidhje me zhvillime qe kerkohen te behen ne interes te planifikimit te duhur te zones te autoritetit lokal.

(2) Cdo autoritet lokal dhe sipermares ligjor mund te kontriboje per—

(a) cdo shpenzim te bere nga nje autoritet lokal per ose ne lidhje me kryerjen e studimit te tokes ose pergatitjen e nje plani te vetem zhvillimi ose nje plani lokal ose alternimin, anulimin ose zvendesimin e nje plani te tille ose nje plani strukture ne baze te Pjeses II;

(b) cdo shpenzim te bere nga autoriteti i planifikimit lokal ose autoriteti i planifikimit te mineraleve per ose ne lidhje me kryerjen e funksioneve qe rrejdhin nga Pjesa III, dispozitat e Pjeses VI qe lidhen me njoftimet per blerje, Pjeses VII, Pjeses VIII (me perjashtim te seksionit 207), Pjeses IX ose Aneksi 5 e 9.

(3) Kur autoriteti lokal ben shpenzime per pagesen e kompensimit te pagueshem si rrjedhim i cdo veprimi te kryer ne baze te Pjeses III, dispozitave te Pjeses VI qe lidhen me njoftimet e blerjes, Pjeses VII, Pjeses VIII, ose Aneksit 9, Sekretari i Shtetit, nese e sheh te pershtatshme, mund ti kerkoje cdo autoriteti tjetër lokal te kontriboje per ato shpenzime me nje shume qe ai e quan te arsyeshme, duke marre parasysh cdo perfitim qe ai autoritet ka krijuar si rezultat i veprimeve qe sjellin kompensimin.

(4) Nenseksioni (3) do te zbatohet ne lidhje me pagesa te bera nga nje autoritet lokal tek sipermarrësit ligjore ne perputhje me marveshjet financiare te cilat kane fuqi ne baze te seksionit 275(5)(c), sikurse ai zbatohet ne lidhje me kompensimin e pagueshem nga nje autoritet i tille si rrjedhim i cdo veprimi te kryer ne baze te Pjeses III, Pjeses VIII ose Aneksit 5 ose 9, dhe do te interpretohet si duhet permendja, ne ate nenseksion e veprimeve qe sjellin kompensimin.

(5) Per qellimet e ketij seksioni, kontributet e bera nga autoriteti i planifikimit lokal ndaj shpenzimeve te nje komiteti keshillimor te perbashket, do te konsiderohen si shpenzime te bera nga ai autoritet per qellimet per te cilat ai shpenzim u be nga komiteti.

Ndihme per shpronесimin e prones kur ajo eshte ne raste te vecanta subjekt i nje njoftimi demtimi

307.—(1) Keshilli i nje qarku, rrethi ose lagje te Londres mund t'i jape fonde cdo personi me qellim qe ai te marre nje njesi toke ose njesi bujqesore ne lidhje me te cilat eshte nxjerre nje kunder-njoftim ne baze te seksionit 151 qe specifikon bazat e permendura ne nenseksionin (4)(d) te atij seksioni si baze ose si nje nga bazat per kundërshtim.

(2) Asnje dhenie fondesh nuk do te behet ne baze te nenseksionit (1) ne rastin e nje pjese toke nese vera e saj vjetore

kalon nje shume e cila mund te percaktohet per qellimet e seksioni 149(3)(a).

(3) Dhenia e fondeve ne baze te nenseksionit (1) mund te behet ne baze te disa kushteve per te cilat keshilli mendon se jane te pershtatshme.

308.—(1) Ky seksion zbatohet kur--

- (a) interesi ne toke blihet me detyrim ose i shitet nje autoriteti qe ka fuqi per blerje te detyrueshme, dhe
- (b) ne baze te seksionit 110(2) eshte rregjistruar nje njoftim ne lidhje me toke te blere ose te shitur (para ose mbas perfundimit te blerjes ose shitjes) si rrjedhim i nje vendimi ose urdher planifikimi te bere para nxjerjes se njoftimit per te trajtuar, ose pergatitjes se kontrates, zbatimi i te cilave ndikon ne blerjen ose shitjen.

(2) Kur zbatohet ky seksion, Sekretari i Shtetit, me kusht zbatimin e dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, do te kete kompetencat te marre nga autoriteti bleres nje shume te barabarte me ate pjese te shumes se kompensimit te specifikuar ne njoftim (ne perputhje me seksionin 110(5) ose sipas rastit me seksionin 132(4)) qe i atribohet asaj toke.

(3) Nese menjehere pas perfundimit te blerjes ose shitjes, ne token e shitur ose te blere ka interes gjendje dhe te drejten e te cilit e ka nje person tjeter dhe jo autoriteti bleres, shuma e permendur ne nenseksionin (2) nuk do te paguhet derisa ai interes te pushoje se ekzistuar ose t'i vishet autoritetit bleres.

(4) Asnje shume nuk do te merret ne baze te ketij seksioni ne rastin e nje blerje ose shitje te detyruar kur Sekretari i Shtetit bindet qe interesi ne fjale eshte blere per qellimet e perdorimit te tokes si hapshire e hapur per publikun.

(4) Kur Sekretari i Shtetit merr nje shume ne baze te ketij seksioni ne lidhje me cdo toke me arsyen se ajo eshte nje toke ne lidhje me te cilen eshte rregjistruar nje njoftim ne baze te dispozitave te seksionit 110, atehere seksioni 112(11) deri (13) do te zbatohet ne lidhje me ate shume sikur ajo te ishte nje shume e marre ne menyren qe permendet ne seksionin 112(11).

(6) Ne kete seksion dhe ne seksionin 309, "interes" (kur referimi behet ndaj nje interese ne toke) eshte pronesia ose qeraja ne ate toke dhe nuk perfshin asnje interes tjeter.

Marrja nga autoriteti bleres i shumave te paguara ne lidhje me toke te demtuar nga lufta

309.—(1) Kur nje interes ne toke blihet nga, ose i shitet me detyrim autoritetit qe ka fuqi per blerje te detyrueshme, cdo pagese qe kalon 20£ dhe ishte ose behet e pagueshme ne baze te seksionit 59 te Aktit te 1947 ne lidhje me ate interes, Sekretari i Shtetit, me kusht zbatimin e dispozitave te meposhtme te ketij seksioni, do te kete te drejten te marre shumen e pageses nga autoriteti bleres.

(2) Nese para 18 nentorit 1952, ne, mbi, siper ose nen toke kishin filluar punime ose u lejua perdorimi i tokes, dhe—

- (a) nje shpenzim zhvillimi eshte percaktuar si i pagueshem ne lidhje me punimet ose perdorimin, ose u vendos se asnje shpenzim zhvillimi nuk ishte i pagueshem; ose
- (b) punimet ose perdorimi ishin perfshire ne nje skeme zhvillimi te perjashtuar nga shpenzimet e zhvillimit, nenseksioni (1) nuk do te zbatohet per ate pjese te pageses qe permendet ne ate nenseksion dhe qe i ishte atribuar tokes per te cilen ishte bere percaktimi ose, sipas rastit, e cila perfshihet ne ate skeme zhvillimi.

(3) Asnje shume nuk do te merret ne baze te ketij seksioni per toke ne lidhje me te cilen nje shume eshte marre nga Sekretari i Shtetit ne baze te dispozitave te seksionit 133 qe zbatohen nga seksioni 327.

(4) Nese blerja ose shitja ne fjale nuk shtrihet ne te gjitha token me te cilen lidhet nje pagese sipas seksionit 59 te Aktit te 1947, shuma qe merret ne baze te ketij seksioni do te jete ajo pjese e asaj pagese e cila ne perputhje me nenseksionin (5) do te trajtohet se i takon tokes ne te cilin ekziston interesi qe u ble ose shit.

(5) Per qellimet e ketij seksioni, nje pagese ne baze te seksionit 59 te Aktit te 1947 do te trajtohet si e ndare midis dy pjeseve te ndryshme te tokes me te cilen ajo lidhet, ne ate menyre qe kjo pagese mund te ndahej nese ne baze te skemes te pergatitur sipas atij seksioni, autoritetit qe percakton shumen qe do te paguhet do t'i ishte kerkuar (ne perputhje me te njejtat parime qe u perdoren per percaktimin e kesaj shume) t'a ndante shumen midis pjeseve te ndryshme te tokes.

Mbulimi i shpenzimeve te autoritetit bleres nepermjet kompensimit

(6) Ne kete seksion permendja e nje skeme zhvillimi te perjashtuar nga shpenzimi i zhvillimit eshte nje skeme zhvillimi e cila, nese punimet dhe perdorimet e tokes te perfshira ne skeme do te kishin filluar te gjitha para 18 nentorit 1952, te gjitha keto punime ose perdorime do te ishin perjashtuar nga dispozitat e Pjeses VII te Aktit te 1947 si rrjedhim i rregullave te nxjerra ne baze te saj.

(7) Permendja ne kete seksion e shumes se pageses do te interpretohet se perfshin cdo interes te pagueshem ne principalin e pageses.

Marrja nga autoritetit bleres i shumave te llogaritura per qellimet e grantit

310. Kur--

- (a) nje shume merret nga ndonje autoritet ne baze te seksionit 308 ose 309 duke iu referuar nje blerje ose marrje te interesit ne toke, dhe
- (b) nje grant ishte ose behet i pagueshem ndaj atij autoriteti ose ndonje autoriteti tjetër ne baze te nje vendimi ne lidhje me ate blerje ose ndarje pasardhese te tokes, kompetencat e dhena nga ai vendim per te paguar grantin do te perfshijne dhe do te konsiderohet se gjithmone kane perfshire kompetenca per te paguar nje grant ne lidhje me ate shume njelloj sikur ai te ishte nje shpenzim i bere nga autoriteti bleres ne lidhje me blerjen.

Shpenzimet e departamenteve qeveritare

311. --(1) Shpenzimet e meposhtme te Sekretarit te Shtetit do te paguhet nga fonde te dhena nga Parlamenti--

- (a) cdo shpenzim i bere nga Sekretari i Shtetit ne baze te nenseksionit (5) te seksionit 220 ose per pagesen e shpenzimeve te ndonje komiteti te krijuar ne baze te atij seksioni;
- (b) cdo shume e nevojshme qe lejon Sekretarin e Shtetit te beje pagesa qe behen te pagueshme nga ai ne baze te Pjeses IV ose V;
- (c) cdo shpenzim i bere nga Sekretari i Shtetit ne baze te Pjeses X;
- (d) cdo shpenzim i bere nga Sekretari i Shtetit ne pergatitjen e granteve ne baze te seksionit 304;
- (e) cdo shpenzim administrativ i bere nga Sekretari i Shtetit per qellimet e ketij Akti.

(2) Nga fonde te dhena nga Parlamenti do te paguhet cdo shpenzim i bere nga cdo departament qeveritar (perfshire Sekretarin e Shtetit)--

- (a) ne blerjen e tokes ne baze te Pjeses IX;
- (b) ne pagesen e kompesimeve ne baze te seksionit 236(4), 279(2) ose 325;

- (c) ne baze te seksionit 240(1)(b) ose
- (d) ne baze te seksionit 305.

Pagesat sipas s. 59 te Aktit te 1947 dhe Pjeses I dhe V te Aktit te 1954

312. --(1) Sekretari i Shtetit do te paguaje nga fondet e dhena nga Parlamenti cdo pagese qe duhet te behet prej tij në ose pas 1 prillit 1968 ne baze te--

- (a) seksionit 59 te Aktit te 1947 (toke e demtuar nga lufta); ose
- (b) dispozitave te Pjeses I ose Pjeses V te Aktit te 1954.

(2) Cdo shume e marre nga Sekretari i Shtetit si rrjedhim i--

- (a) dispozitave te seksionit 133, qe zbatohen si rrjedhim i Aneksit 24 te Aktit te 1971 dhe Aneksit 3 te Aktit te Planifikimit (Dispozita Shtese) te 1990 [1990 c.9.] ndaj kompensimeve te paguara ne baze te Pjeses V te Aktit te 1954; ose
- (b) dispozitave te seksionit 308 qe zbatohen ne kete menyre, do te paguhet ne Fondin e Konsoliduar.

Dispozita te pergjithshme per parate e marra nga Sekretari i Shtetit

313. --Pa cenuar seksionin 312, dhe me kusht zbatimin e seksionit 112 cdo shume e marre nga Sekretari i Shtetit ne baze te dispozitave te ketij Akti do te paguhet ne Fondin e Konsoliduar.

Shpenzimet e keshillave te qarqeve

314. -- Keshilli i nje qarku mund te udhezaje se cdo shpenzim i bere nga ai ne baze te dispozitave te specifikuara ne Pjeset I dhe II te Aneksit 16 do te trajtohen si shpenzime te vecanta te keshillit te qarkut qe i ngarkohen asaj pjese te qarkut sikurse mund te jete specifikuar ne udhezime.

Zbatimet e Aktit ne raste te vecanta

Kompetencat per te modifikuar Aktin ne lidhje me mineralet

315. -- (1) Ne lidhje me nje zhvillim qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve, dispozitat e specifikuara ne Pjeset I dhe II te Aneksit 16 do te kene efekt me kusht berjen e adoptimeve

dhe modifikimeve qe mund te percaktohen.

(2) Ne lidhje me interes ne toke qe perbehet nga ose perfshin minerale (qofte ky interes ose pronesi e tokes ose qeramarje) dhe ne lidhje me nje kerkese te percaktuar (sipas asaj qe permendet ne paragrafin 1(2) te Aneksit 12) plotesisht ose pjeseresisht ne kete toke, dispozitat e specifikuara ne Pjesen III te Aneksit 16 do te zbatohen me kusht berjen e adoptimeve ose modifikimeve qe mund te percaktohen.

(3) Rregullat e nxjerra per qellimet e ketij seksioni mund te nxirren vetem me pelqimin e Thesarit dhe nuk do te kene efekt ne rast se nuk jane miratuar me rezolute nga cdo Dhome e Parlamentit.

(4) Cdo rregull i nxjerre si rrjedhim i nenseksionit (1) nuk do te zbatohet—

(a) ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve ne nje toke qe perdoret per qellime bujqesore dhe kur keto jane minerale qe kerkohen per qellimet e ketij perdorimi perfshire pleherimin e tokes dhe mirembajtjen e saj, permiresimin ose alternimin e godinave ose punimeve ne kete toke, te cilat keto godina ose punime perdoren/behen per ato qellime; ose

(b) ne zhvillimin qe perbehet nga nxjerrja dhe punimi i mineraleve te Korporates Britanike te Qymyrgureve, i cili eshte nje zhvillim ne te cilin zbatohen dispozitat a Akteve te planifikimit qe lidhen me token e sipermaresve ligjore, si rrjedhim i rregullave te nxjerra ne baze te seksionit 317.

(5) Asgje ne nenseksionet (1) ose (4) nuk do te interpretohet se prek te drejten prerogative te Madherise se Saj (ose si e drejte e Mbretetise ose e Dukes se Lankasterit) ose te Dukes se Kornwoll per minierat e arit ose argjendit.

Zbatimi i dispozitave
te vecanta ndaj autoriteteve
te planifikimit lokal

316. – (1) Ne lidhje me toke te autoriteteve te planifikimit lokal ose zhvillimi nga autoritetet lokale te tokes per te cilen ato jane autoritete te planifikimit lokal, dispozitat e percaktuara ne Pjesen V te Aneksi 16 do te kene efekt me kusht zbatimin e perjashtimeve ose modifikimeve qe mund te behen per kete qellim.

(2) Me kusht zbatimin e seksionit 90, cdo rregull i tille mund te siguroje—

(a) se cdo aplikim i bere nga nje autoritet i tille per leje planifikimi per te zhvilluar nje toke te tille, ose ndonje leje

tjeter qe kerkohet per nje toke te tille ne baze te atyre dispozitave, do ti dergohet Sekretarit te Shtetit dhe jo autoritetit te planifikimit lokal.

(b) se cdo urdher ose njoftim qe autorizohet te pergatitet, nxirret ose dergohet ne baze te atyre dispozitave ne lidhje me nje toke te tille, do te behet ose dergohet nga Sekretari i Shtetit dhe nga autoriteti i planifikimit lokal.

(3) Seksionet 65 deri 68 dhe 71(1) dhe (2) do te zbatohen, me modifikimet e nevojshme, ne lidhje me aplikimet e derguara tek Sekretari i Shtetit ne vazhdim te rregullave te nxjerra per qellimet e nenseksionit (1), ashtu sikurse ato zbatohen ndaj aplikimeve per leje planifikimi per te cilat duhet te vendose autoriteti i planifikimit lokal.

(4) Ne lidhje me sipermarresit ligjore qe jane autoritete te planifikimit lokal, do te kene efekt seksioni 283 dhe dispozitat e specifikuara ne ate seksion, me kusht zbatimin e perjashtimeve ose modifikimeve qe mund te percaktohen per kete qellim.

(5) Ne lidhje me nje korporate zhvillimi urban e cila eshte autoritet i planifikimit lokal si rrjedhim i nje urdheri te bere ne baze te seksionit 149(1) te Aktit te Planifikimit dhe Tokes te Qeverise Lokale te 1980 [1980 c.65.] dhe ne lidhje me nje trust per ndertim banesash te krijuar ne baze te Pjeses III te Aktit te Banimit te 1988 [1988 c.50] qe eshte autoritet planifikimi lokal si rrjedhim i nje urdheri te nxjerre ne baze te seksionit 67(1) te atij Akti, do te kene efekt nenseksionet (1) deri (3) per qellimet e e Pjeses III te ketij Akti te percaktuara ne urdher, dhe ne lidhje me ato zhvillime qe percaktohen njelloj sikur—

(a) ne nenseksionin (1) permendja e zhvillimit nga autoritetet lokale e tokes per te cilen ata jane autoritete te planifikimit lokal te perfshinte permendje te zhvillimit nga korporata, ose sipas rastit, trusti i tokes per te cilen ai eshte autoritet i planifikimit lokal; dhe

(b) ne nenseksionin (2)—

(i) ne paragrafin (a) fjaltet “korporata” ose sipas rastit “trusti” te ishin zvendesuar me “nje autoritet i tille”, dhe fjala “korporate” ose sipas rastit “trust” te ishin zvendesuar me shprehjen “autoritet i planifikimit lokal”; dhe

(ii) ne paragrafin (b) fjala “korporate” ose sipas rastit “trust” te ishte zvendesuar me fjaltet “autoriteti i planifikimit lokal”

Korporata Britanike e
Qymyrgurit

317.—(1) Sekretari i Shtetit per Ambjentin dhe Sekretari i Shtetit per Energjine, mundet qe nepermjet rregullave te nxjerra me pelqimin e Thesarit te udhezojne se secila nga dispozitat e percaktuara ne Pjesen I te Aneksit 16 ose te seksionit 264 qe lidhen me sipermaresit ligjore dhe me token e tyre—

(a) do te zbatohet ndaj Korporates Britanike te Qymyrgurit sikur ajo te ishte sipermares ligjor; dhe

(b) do te zbatohet ndaj tokes (perfshire minierat) se asaj Korporate qe i perket nje klase qe mund te jete percaktuar ne rregullat si toke vepruese.

(2) Rregulla te tilla mund te bejne te zbatueshme ato dispozita me kusht kruejten e adoptimeve, modifikimeve dhe perjashtimeve qe mund te jene percaktuar ne rregulla.

(3) Pa cenuar pergjithesimin e nenseksioni (2), kur rregulla te tilla bejne te zbatueshme ndonje dispozite te tille si rrejdhim i te ciles nje kompensim behet i pagueshem tek Korporata Britanike e Qymyrgurit dhe qe nese do te ishte e pagueshme tek sipermaresit ligjore do te ishte vlersuar ne perputhje me dispozitat e seksionit 280, atehere keto rregulla mund te sigurojne nje baze alternative vleresimi.

Pronat e klerit

318.—(1) Pa cenuar dispozitat e Aktit te Shpronesimit te Tokes te 1981 [1981 c.67.] qe lidhen me njoftime te derguara ne baze te atij Akti, kur si rrejdhim i ndonje prej dispozitave te ketij Akti kerkohet qe te dergohet kopje e njoftimit te pronari i tokes dhe toka eshte prone e klerit, nje njoftim i ngjashem ose kopje e tille do te dergohet tek Komisioneret e Kishes.

(2) Kur pronesia ndaj nje prone te klerit eshte pezull—

(a) nese prona nuk ndodhet ne Wells, atehere per qellimet e percaktuara ne Pjesen VI te Aneksit 16, pronesia do te quhet si pronesi e Komisionereve te Kishes;

(b) ne cdo rast, pronesia, per qellimet e nje blerje te detyruar te prones ne baze te Pjeses IX do te trajtohet si pronesi e Komisionereve te Kishes, dhe per kete duhet derguar njoftim per trajtim ose do te konsiderohet si i derguar nese i eshte cuar Komisionereve te Kishes.

(3) Cdo kompensim i pagueshem ne baze te Pjeses IV, seksioni 186, Pjeses VIII (perjashtuar seksionin 204) ose seksionit 250 ne lidhje me toke qe eshte prone e klerit—

a) do t'i paguhet Komisionereve te Kishes, dhe

(b) dhe do te zbatohet prej tyre per qellimet per te cilat fitimet e shitjes me marveshje te tokes do te ishin te zbatueshme ne baze te nje urdheri ose mase qe autorizon dhe sistemon fitimet e nje shitjeje te tille.

(4) Cdo shume e cila ne baze te dispozitave te specifikuara ne Pjesen III te Skedules 16 eshte e pagueshme ne lidhje me toke e cila eshte ose ne 1 korrik 1948 ishte prone e klerit dhe ne rastet kur nuk zbatohet ky seksion i paguhet nje zyrtari—

(a) do t'i paguhet Komisionereve te Kishes, dhe

(b) do te zbatohet nga ata per qellimet qe permenden ne nenseksionin (3)(b).

(5) Kur nje shume mund te rimeret ne baze te seksionit 111, 112, 133 ose 327 ne lidhje me nje toke te tille, Komisioneret e Kishes mund te zbatojne ndaj pageses se asaj shume, fonde ose aksione qe jane prone e tyre.

(6) Ne kete seksion "prone e klerit" eshte toka e cila i perket nje trashegimtari klerik, ose qe eshte pjese e nje subjekti fetar ne juridiksionin e peshkopit te nje dioqeze ose vendndodhje te nje kishes ose qe eshte pjese e nje varreze qe eshte nen ate juridiksion.

Zbatimi i Aktit per
Ishujt Scilly

319.—(1) Sekretari i Shtetit urdheron zbatimin ne ishujt Scilly te dispozitave te specifikuara ne Pjeset I dhe II te Aneksit 16, seksionet 1(4), 67, 72(5), 97(5), 102(8), 105, 116, 190 (deri ne masen qe zbatohet ndaj urdherave ne baze te Aneksit 9), 294(2) deri (7), 295, 299 deri 301 dhe 303, percaktimet e "zhvillimit qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve" dhe "depozite mineralesh" ne seksionin 336(1), paragrafi 11(4) i Aneksit 1 dhe Aneksit 5, 9 dhe 11, sikur ata ishuj te ishin nje qark me vete.

(2) Ne lidhje me toke ne Ishujt Scilly, dispozitat e specifikuara ne Pjesen III te Aneksit 16 dhe seksioni 225 do te kene efekt sikur ata ishuj te ishin nje rreth dhe Keshilli i ishujve te ishte keshill i atij rrethi.

(3) Sekretari i Shtetit mundet qe te urdheroje zbatimin ne ishujt e Scilly te dispozitave te specifikuara ne Pjesen IV te atij Aneksi sikur keta ishuj te ishin nje qark ose rreth me vete.

(4) Para se te nxjerre nje urdher ne baze te nenseksionit (1) ose (3), Sekretari i Shtetit do te keshillohet me Keshillin e ishujve Scilly.

(5) Cdo urdher i nxjerre ne baze te nenseksioneve (1) dhe (3) mund te siguroje zbatimin e dispozitave ne keta ishuj me kusht berjen e modifikimeve qe mund te jene percaktuar ne urdher.

Seancat e shqyrtimit lokal dhe hetime te tjera

Seancat e shqyrtimit lokal

320.—(1) Sekretari i Shtetit mund te nise mbajtjen e seancave te shqyrtimit lokal per qellimet e ushtrimit te funksioneve te tij qe rrjedhin nga dispozitat e ketij Akti.

(2) Nensesksionet (2) deri (5) te seksionit 250 te Aktit te Qeverise Lokale te 1972 [1972 c.70] (shqyrtimit lokale: provat dhe kostot) zbatohen ndaj cdo shqyrtimi te mbajtur si rrjedhim i ketij seksioni.

Shqyrtime planifikimi qe mbahen para publikut ndaj te cilave zbatohen perjashtime te vecanta

321.—(1) Ky seksion zbatohet ndaj cdo shqyrtimi te mbajtur ne baze te seksionit 320(1), paragrafit 6 te Aneksit 6 ose paragrafit 5 te Aneksit 8.

(2) Me kusht zbatimin e nenseksionit (3), ne cdo shqyrtim te tille, provat gojore do te degjohen ne publik dhe cdo prove e shkruar do te jete e hapur per inspektim nga publiku.

(3) Nese Sekretari i Shtetit ne rastine nje shqyrtimi te tille bindet se—

(a) dhenia e deshmive te nje pershkrimi te vecante ose sipas rastit krijimi i mundesise per ti inspektuar ato mund te rezultojne ne dhenie informacioni si ai qe permendet ne nenseksionin (4); dhe

(b) berja publike e atij informacioni eshte kunder interesave kombetare,

ai mund te udhezohet se prova e pershkrimit te percaktuar ne udhezim mund te degjohet ose te shikohet (sipas rastit) vetem nga ata persona qe ai percakton ne udhezim.

(4) Ceshtjet qe permenden ne nenseksionin (3)(a) jane—

(a) siguria kombetare; dhe

(b) masat qe jane marre ose qe do te merren per te siguruar ambjentet ose pronen.

Urdherat per kostot e paleve kur nuk ka seance shqyrtimi lokal

322.—(1) Ky seksion zbatohet ndaj veprimeve te bera ne baze te ketij Akti kur Sekretarit te Shtetit i kerkohet qe para se te marre vendimin, t'i jape mundesine cdo personi te paraqitet ose te degjohet nga nje person i emeruar prej tij.

(2) Sekretari i Shtetit ka te njejtat kompetenca per te nxjerre urdhera ne baze te seksionin 250(5) te Aktit te Qeverise Lokale te 1972 [1972 c.70.] (urdhera ne lidhje me kostot e paleve) ne lidhje me veprime ndaj te cilave zbatohet ky seksion dhe qe nuk krijojne shqyrtime lokale, ashtu sikurse ai ka ne lidhje me nje shqyrtim lokal.

Procedurat ne raste te vecanta apelimi ose aplikimi

323.—(1) Sekretari i Shtetit mundet qe nepermjet rregullave te percaktoje procedurat qe ndiqen per veprimet e bera ne baze te ketij Akti kur atij i kerkohet qe para se te marre nje vendim, ti jape personave mundesine per tu paraqitur ose degjuar nga nje person i emeruar prej Sekretarit dhe qe kerkohen te zgjidhen pa shqyrtime ose hetime dhe ndaj te cilave zbatohen urdherat e seksionit 11 te Aktit te gjyqeve dhe Shqyrtimeve te 1971 [1971 c.62.]

(2) Rregullat mund te sigurojne ne menyre te vecante procedurat qe duhen ndjekur—

(a) kur jane ndermare hapa me qellim mbajtjen e nje shqyrtimi ose hetimii te cilat nuk ndodhin, ose

(b) kur jane ndermare hapa me synimin per te percaktuar nje ceshtje nga nje person i emeruar nga Sekretari i Shtetit dhe veprimet jane subjekt i nje udhezimi sipas te cilit ceshtja duhet ne fakt te vendoset nga Sekretari i Shtetit, ose

(c) kur jane ndermare hapa si rrjedhim i nje udhezimi te tille dhe pastaj eshte nxjerre nje udhezim tjeter qe anulon udhezimin e pare,

dhe mund te siguroje qe hapa te tille do te trajtohen ne perputhje, pjeserisht ose plotesisht me kerkesat e rregullave.

(3) Rregullat gjithashtu mundet—

(a) te sigurojne nje afat brenda te cilit cdo pale e veprimeve duhet te dorezoje me shkrim perfaqesimet dhe dokumentat mbeshtetes;

(b) te percaktoje afatin (i cili mund te jete i ndryshem per klasa te ndryshme veprimesh) ose mundeson Sekretarin e Shtetit te jape udhezime per te vendosur afatin ne nje rast te

vecante ose klase rastesh;

(c) t'i japin kompetenca Sekretarit te Shtetit te marre nje vendim duke marre parasysh vetem ato perfaqesime dhe dokumenta mbeshtetes me shkrim qe u paraqiten brenda afatit; dhe;

(d) t'i japin kompetenca Sekretarit te Shtetit, pasi njoftohen me shkrim palet pjesemarrrese per synimin e tij, te marre nje vendim pavaresisht se asnje perfaqesim me shkrim nuk u paraqit brenda afatit, por bindet se ka material te mjaftueshem per te marre nje vendim ne lidhje me ceshtjen.

E drejta per te hyre ne parcelen/ndertesën personale.

324.—(1) Cdo person i autorizuar me shkrim nga Sekretari i Shtetit ose nga autoriteti i planifikimit lokal mund te kerkoje te hyje ne toke ne nje ore te pershtatshme me qellim shqyrtimin e saj ne lidhje me—

- (a) pergatitjen, miratimin, adoptimin ose pergatitjen e nje plani te vetem zhvillimi ose nje plani lokal qe lidhet me toke ne te cilen vepron Pjesa II ose per alternimin e nje plani te tille ose plani strukture qe lidhet me toke ne te cilen zbatohet ajo Pjese perfshire dhe kryerjen e shqyrtimeve ne baze te asaj Pjese;
- (b) cdo zbatim ne baze te Pjeses III ose seksioneve 198 deri 200, 220 deri 221 ose ne baze te ndonje urdheri ose rregullash te nxjerra ne baze te atyre dispozitave, per leje, pelqim ose percaktimi ndaj asaj toke ose ndonje toke ne te cilen zbatohet ajo Pjese, ndonje prej atyre seksioneve ose urdherash ose rregullash;
- (c) cdo propozim i autoritetit te planifikimit lokal ose i Sekretarit te Shtetit per te pergatitje, nxjerre ose derguar nje urdher ose njoftim ne baze te Pjeses III (perjashtuar seksionet 94 dhe 96), Pjeses VII ose Pjeses VIII ose ndonje urdheri ose rregullash te pergatitura ne baze te atyre dispozitave.

(2) Cdo person i autorizuar me shkrim nga Sekretari i Shtetit ose autoriteti lokal mundet qe ne nje ore te pershtatshme te hyje ne toke me qellim qe te konstatoje nese ndonje nga funksionet qe rrjedhin nga seksionet 207 deri 209 do te ose mund te ushtrohet ne kete toke ose per qellimin e ushtrimit te ndonjerit prej atyre funksioneve ne ate toke.

Te drejtat e aksesit, per te hyre ne nje prone private

(3) Cdo person i autorizuar me shkrim nga Sekretari i Shtetit ose autoriteti lokal mundet qe ne nje ore te pershtatshme te hyje ne toke me qellim ushtrimin e kompetencave te dhena autoritetit nga seksioni 225 nese—

- (a) toka eshte e pazene; dhe
- (b) do te jete i pamundur ushtrimi i kompetencave nese nuk hyet ne toke.

(4) Cdo person qe eshte punonjes i Zyres se Vleresimit ose qe autorizohet me shkrim nga Sekretari i Shtetit mundet qe ne nje orar te arsyeshem te hyje ne toke me qellim qe ta shqyrtoje ate, ose ta vleresoje ate, ne lidhje me nje kerkese per kompensim nen Pjesen V per ate toke ose ndonje toke tjeter.

(5) Cdo person qe eshte punonjes i Zyres se Vleresimit ose qe autorizohet me shkrim nga Sekretari i Shtetit mundet qe ne nje orar te arsyeshem te hyje ne toke me qellim qe ta shqyrtoje ate, ose ta vleresoje ate, ne lidhje me nje kerkese per kompensim per ate toke ose toke tjeter, kompensim i cili eshte i pagueshem ndaj autoritetit te planifikimit lokal ne baze te Pjeses IV, seksionit 186, Pjeses VIII (vec seksionit 204), seksionit 250(1) ose Pjeses XI (vec seksionit 279(2) ose (3) ose 280(1)(c)).

(6) Cdo person qe eshte punonjes i Zyres se Vleresimit ose qe autorizohet me shkrim nga autoriteti lokal ose Ministri qe eshte autorizuar te bleje toke ne baze te seksionit 226 ose 228 ose nga nje autoritet lokal qe ka kompetencat te bleje toke ne baze te Pjeses IX, mundet qe ne cdo orar te arsyeshem te hyje ne toke me qellim shqyrtimin e saj ose vlersimin e saj ne lidhje me nje propozim per te blere ate toke ose toke tjeter ose ne lidhje me ndonje kerkese per kompensim ne lidhje me nje blerje te tille.

(7) Cdo person qe autorizohet me shkrim nga Sekretari i Shtetit ose autoriteti lokal mundet qe ne nje ore te arsyeshme te hyje ne token ne lidhje me te cilen eshte pergatitur ose nxjerre njoftim ose urdher sikurse permendet ne nenseksionin (1)(c) me qellimin per te vleresuar nese eshte plotesuar urdheri ose njoftimi.

(8) Me kusht zbatimin e seksionit 325, cdo kompetence e dhene nga ky seksion per te shqyrtuar token, do te interpretohet se perfshin kompetenca per te kontrolluar natyren e nentokes ose prezencen ne te te mineraleve.

(9) Ne nenseksionet (1)(c) dhe (7) permendja e autoritetit te planifikimit lokal perfshin, ne lidhje me nje ndertese qe ndodhet ne Londren e Madhe, permendje te Komisionit te Nderteseve

Historike dhe Monumenteve te Anglise.

Dispozita shtese per te drejten e hyrjes

- 325.**—(1) Nje person i autorizuar ne baze te seksionit 324 te hyje ne toke—
- (a) nese kerkohet, do te paraqese prova te kompetencave te tij para se te hyje, dhe
 - (b) nuk do ta kerkoje si te drejte hyrjen ne toke nese zoteruesit te tokes nuk i eshte dhene njoftim 24 ore me pare per ardhjen e tij.
- (2) Cdo person qe me paramendim pengon nje person qe eshte duke ushtruar kompetencat e tij ne baze te seksionit 324 do te quhet se ka kryer vepre penale dhe do te denohet me gjobe qe nuk kalon nivelin 12 te shkalles standarte.
- (3) Nese nje person, ne perputhje me dispozitat e seksionit 324, pranohet ne nje fabrike, punishte ose oficine dhe i jep nje personi te trete informacion rreth proceseve te prodhimit ose sekrete te profesionit te cilat i mori gjate ndodhjes ne ato ambiente, do te quhet se ka kryer veper penale.
- (4) Nenseksioni (3) nuk zbatohet nese dhenia e informacionit behet nga personi gjate kryerjes se detyres se tij ne lidhje me qellimin per te cilin ai ishte autorizuar te hynte ne ate objekt.
- (5) Cdo person qe quhet se ka kryer vepre penale ne baze te nenseksionit (3) do te denohet me gjobe qe nuk kalon maksimumin ligjor ose me burgim me nje afat qe nuk akton dy vjet ose nje gjobe ose te dyja.
- (6) Kur toka demtohet—
- (a) gjate ushtrimit te te drejtes per te hyre te dhene nga seksioni 324, ose
 - (b) ne shqyrtimin per arsye te te cilit u dha e drejta per te hyre kompensimi ne lidhje me ate demtim do te merret nga personi i interesuar ne toke prej Sekretarit te Shtetit ose autoritetit ne emer te te cilit u be hyrja.
- (7) Dispozitat e seksionit 118 do te zbatohen ne lidhje me kompensimin e bere ne baze te nenseksionit (6) njelloj sikurse ato zbatohen ndaj kompenisimeve qe behen ne baze te Pjeses IV.
- (8) Asnje person nuk mund te kryeje ne baze te seksionit 324 punime qe autorizohen si rrjedhin i nenseksionit (8) ne rast se ne njoftimin e bere ne baze te nenseksionit (1) nuk perfshihej

njoftimi per kryerjen e ketyre punimeve.

- (9) Do te kerkohet autoriteti i Ministrit perkates per te kryer punime te autorizuar ne baze te atij seksioni nese toka ne fjale mbahet nga sipermares ligjore dhe keta kundershtojen punimet e propozuara me justifikimin se kryerja e ketyre punimeve demton seriozisht realizimin e sipermarjes se tyre.

Dispozita te pergjithshme dhe te ndryshme

Supozime ne lidhje me lejen e planifikimit per te percaktuar vleren e interesit te tokes

- 326.**—(1) Ne rastin kur vlera ose amortizimi i vleres te interesit ne nje toke do te behet mbi supozimin se leja e planifikimit do te jepet per zhvillim qe specifikohet ne Aneksit 3, atehere do te supozohet se lidhur me zhvillim qe i perket nje klase te percaktuar ne paragrafin 1 ose 3 te atij Aneksi, kjo leje do te jepet me kusht zbatimin e kushteve te caktuara ne Aneskin 10.
- (2) Per qellimet e nenseksionit (1), deri ne masen qe ato zbatohen ne percaktimin e vleres ekzistuese te perdorimit qe percaktohet ne seksionin 144(6)—
- (a) permendja e Aneksit 3 dhe paragrafeve 1 dhe 3 te atij Aneksi do te interpretohet si permendje e Aneksit 3 te Aktit te 1947 dhe paragrafeve korrespondues te asaj Aneksi; dhe
 - (b) ai Aneks do te kete efekt njelloj sikur te permbante nje paragraf qe i korrespondon paragrafit 13 te Aneksi 3.
- (3) Me perjashtim te asaj qe thuhet ne seksionin 111(5), asgje ne nenseksionet (1) dhe (2) ose ne paragrafin 13 ose 14(2) te Aneksit 3 nuk do te ndikojne ne kuptimin e "zhvillimit te ri" ne kete Akt ose ne ndonje percaktim te bere per qellimet e Pjeses V.
- (4) Per te shmangur cdo dyshim, deklarohet se kur ne baze te ndonje dispozite te ketij Akti kerkohet te vleresohet vlera e interesit ne toke me supozimin se leja e planifikimit do te jepet per zhvillim qe eshte ne nje nga klasat e percaktuara ne Aneksin 3, atehere ky supozim do te bazohet ne faktin qe nje zhvillim i tille duhet te perputhet me dispozitat e cdo vendimi pervec Akteve te lanifikimit te cilat mund te zbatohen ne te.
- 327.**—(1) Ne lidhje me njoftimet e rregjistruara ne baze te seksionit 57 te Aktit te 1954 (qe siguron rregjistrimin e noftimeve te pagesave te bera ne baze te seksionit 59 te Aktit te 1947), do te kene efekt seksionet 133 dhe 134 njelloj sikurse ato kane

Marrja ne zhvillimin pasardhes e apgesave te bera ne idhje me toke te demtuar nga lufta

efekt ne lidhje me noftime te rregjistruara ne baze te seksionit 132 por qe ndaj te cilave zbatohen dispozitat e meposhtme.

(2) Cdo permendje ne seksionin 133 ose 134 e kompensimit te specifikuar ne njoftim do te interpretohet si permendje e pageses te specifikuar ne kete menyre.

(3) Seksioni 133 do te supozohet se zbatohet ne cdo pershkrim te zhvillimit te ri.

(4) Asnje shume nuk do te merret nga Seretari i Shtetit si rrjedhim i ketij seksioni ne lidhje me toke per te cilen nje shume mund te rimeret ne baze te seksionit 309.

(5) Per qellimet e ketij seksioni, nje pageese ne baze te seksionit 59 te Aktit te 1947 do te trajtohet si e ndare midis pjeseve te ndryshme te tokes me te cilen lidhet, ne te njejten menyre ne te cilen ajo pageese do te mund te ndahej nese, ne baze te nje skeme te bere ne baze te atij seksioni, autoritetit qe percakton shumen qe do te paguhet do ti ishte kerkuar (ne perputhje me te njejtat parime qe zbatohen ne percaktimin e shumës) ta ndante ate midis pjeseve te ndryshme te asaj toke.

Toke e vendosur dhe toka e universiteteve dhe kolegeve

328.—(1) Qellimet e autorizuar per zbatimin e parave kapitale—
(a) nga seksioni 73 i Aktit te Tokes se Vendosur te 1925 [1925 c.18] dhe nga ai seksion qe zbatohen nga seksioni 28 i Aktit te Ligjit te Pronesise te 1925 [1925 c.20.] ne lidhje me trustet per shitje; dhe
(b) nga seksioni 26 i Aktit te Pronave te Universiteteve dhe Kolegeve te 1925 [1925 c.24],
do te perfshije pagesen e cdo shume qe merret ne baze te seksionit 111, 112, 133 ose 327.

(2) Qellimet e autorizuar si qellime per te cilat mund te mblidhen para nepermjet hipotekes—

(a) nga seksioni 71 i Aktit te Tokes se Vendosur te 1925 dhe nga ai seksion qe zbatohet ne ket menyre; dhe

(b) nga seksioni 30 i Aktit te Prones se Universiteteve dhe Kolegeve te 1925,

do te perfshije pagesen e cdo shume qe mund te merret ne kete menyre.

329.—(1) Cdo njoftim ose dokument qe kerkohet ose autorizohet te dergohet ose jepet ne baze te ketij Akti, mund te dergohet ose

Dergimi i njoftimeve

jepet ose—

(a) duke e derguar tek personi qe duhet ta marre ate; ose
(b) duke e lene ate tek banesa e fundit e njohur e atij personi ose ne rastin kur eshte dhene nje adrese nga ky person, tek kjo adrese e dhene; ose

(c) duke e derguar ate me leter te rregjistruar ose me sherbim korrier te rregjistruar, qe i drejtohet atij personi ne banesen e fundit te njohur ose banesen e zakonshme ose ne rastin kur eshte dhene nje adrese nga ky person, tek kjo adrese e dhene; ose

(d) ne rastin e nje kompanie ose grupi, duke e derguar tek sekretaria e kompanise ose grupit ne zyren e rregjistruar ose zyren kryesore ose me sherbim korrier te rregjistruar qe i adresohet sekretarise te kompanise ose grupit ne ate zyre.

(2) Kur njoftimi ose dokumenti kerkohet ose autorizohet ti dergohet nje personi qe ka interes ne objekt, dhe emri dhe adresa e atij personi nuk mund te percaktohet pas nje kerkimi te arsyeshem, ose kur njoftimi ose dokumenti kerkohet te dergohet tek nje person qe eshte zenesi i objektit, ai njoftim ose dokument do te konsiderohet se eshte derguar nese—

(a) i drejtohet atij ose ne emer ose me pershkrimin e "pronarit" ose sipas rastit "zenesit" te objektit (duke e pershkruar ate) dhe dergohet ne menyren e percaktuar ne nenseksionin (1)(a), (b) ose (c); ose

(b) eshte adresuar ne menyre te tille qe siguron se identifikohet si dokument ose njoftim i rendesishem dhe—

(i) dergohet ne objekt me leter te parapagar te rregjistruar ose me sherbim korrier te rregjistruar dhe nuk i kthehet autoritetit qe e nis, ose

(ii) i dergohet disa personave ne ato objekte ose ngjitet ne ambientet e atyre objekteve.

(3) Kur—

(a) njoftimi ose dokumenti kerkohet te dergohet ose t'i jepet te gjithë personave qe kane interesa ne ose jane okupues te objekteve qe perfshihen ne nje toke, dhe

(b) autoritetit te cilit i kerkohet te dergoje njoftimin ose qe eshte i autorizuar te beje kete, i duket pjese te kesaj toke nuk jane te zena,

njoftimi ose dokumenti do te quhet i derguar tek te gjithë personat qe kane interesa ose zenesit e objektit qe eshte pjese e tokes (pervec personit qe i ka dhene autoritetit nje adrese per kete sherbim per ti derguar dokumentin osenjoftimin) nese i eshte adresuar "pronareve dhe cdo zenesi" te asaj pjese te tokes (duke e pershkruar ate) dhe ngjitet ne nje vend te dukshme ne

ate toke.

Kompetencat per te
kerkuar informacion per
interesat ne toke

330.—(1) Me qellim qe Sekretari i Shtetit ose autoriteti lokal te kene mundesine te pergatisin nje urdher ose te dergojne njoftim ose dokument tjeter te cilin u kerkohet ta bejne ne baze te dispozitave te ketij Akti, atehere Sekretari i Shtetit ose autoriteti lokal mundet qe me njoftim me shkrim t'i kerkojne okupuesit te objektit dhe cdo personi i cili ose drejtperdrejt ose indirekt merr qera nga ky objekt, te jape me shkrim nje informacion te tille ne lidhje emceshtjet e permendura ne nenseksionin (2) nese i kerkohet te veproje keshtu.

(2) Ato ceshtje jane—

- (a) natyra e intersit ne objektin e personit qe merr njoftimin;
- (b) emri dhe adresa e cdo personi tjeter per te cilin ai ka dijeni se ka inters ne objekt;
- (c) qellimet per te cilat perdoret objekti;
- (d) koha kur filloi perdorimi;
- (e) emri dhe adresa e cdo personi per te cilet prsoni qe merr njoftimin ka dijeni se kane perdorur objektin per ate qellim;
- (f) koha kur filloi ushtrimi i ndonje aktiviteti ne objekt.

(3) Njoftimi ne baze te nenseksionit (1) mund te kerkoje qe informacioni te jepet brenda 21 ditesh nga data e dergimit te njoftimit ose afat me i gjate qe percaktohet ne njoftim ose afati qe lejon Sekretari i Shtetit ose sipas rastit autoriteti lokal.

(4) Cdo person i cili pa justifikim te arsyeshem nuk i permbahet njoftimit te derguar atij ne baze te nenseksionit (1) do te konsiderohet se ka kryer veper penale dhe do te denohet me gjobe qe nuk kalon nivelin 3 te shkalles standarte.

(5) Cdo person te cilit i kerkohet te jape informacion nepremjet nje njoftimi te derguar ne baze te nenseksionit (1), me dije jep nje informacion te gabuar ne lidhje me te, do te konsiderohet se ka kryer veper penale dhe do te denohet me gjobe qe nuk kalon maksimumin ligjor ose denohet me burgim qe nuk kalon dy vjet ose me gjobe, ose me te dyja.

331.—(1) Kur nje veper penale ne baze te ketij Akti e kryer nga korporata, provohet se eshte bere me lejen ose dijenine e, ose i atribohet moskujdesit te—

- (a) nje drejtori, menaxheri, sekretari ose punonjesi te ngjashem te korporates, ose

Veprat penale nga
korporatat

(b) cdo personi qe vepron ne ate pozicion, ai si dhe korporate do te quhet se kane kryer vepre penale dhe do te denohen me masat e duhura.

(2) Ne nenseksionin (1) "drejtor" per cdo korporate—

- (a) e cila u krijua nga ose me vendim per te realizuar ne baze te pronesise kombetare nje industri ose pjee te industrise ose sipermarje, dhe
- (b) veprimateria e te ciles menaxhohet nga anetaret e saj, eshte nje anetar i asaj korporate.

Aplikimet e kombinuara

332.—(1) Rregullat e nxjerra ne baze te ketij Akti mund te sigurojne kombinimin ne nje dokument te vetem, te pergatitur ne nje forme te tille dhe qe i dergohet nje autoriteti te tille sikurse percaktohet per kete qellim, te—

- (a) nje aplikimi per leje planifikimi ne lidhje me cdo zhvillim; dhe
- (b) nje aplikimi qe kerkohet, ne baze te nje vendimi te specifikuar ne rregullat, t'i dergohet autoritetit lokal ne lidhje me ate zhvillim.

(2) Para pergatitjes se rregullave ne baze te ketij seksioni, Sekretari i Shtetit do te keshillohet me autoritetet lokale ose shoqatat e autoriteteve lokale qe sipas tij lidhen me to.

(3) Keto rregulla mund te kene dispozita te ndryshme per zona ne te cilat jane ne fuqi vendime te ndryshme.

(4) Nese nje aplikim qe kerkohet t'i dergohet autoritetit lokal ne baze te vendimit te percaktuar ne ndonje nga keto rregullate, dhe behet ne perputhje me dispozitat e rregullave, atehere ai do te jete i vlefshem pavaresisht nga ato kushte te atij vendimi qe percaktojne ose mundesojne nje autoritet te percaktoje formen ose menyren sipas te ciles duhet bere nje aplikim i tille.

(5) Nenseksioni (4) do te kete efekt pa cenuar—

- (a) vlefshmerine e cdo aplikimi te bere ne perputhje me vendimin ne fuqi; ose
- (b) cdo dispozite te atij vendimi qe mundeson nje autoritet lokal te kerkoje me shume hollesi per ceshtje me te cilat lidhet aplikimi.

(6) Ne kete seksion "aplikimi" perfshin nje dorezim.

333.—(1) Sekretari i Shtetit mund te nxjerre rregulla ne baze te

Rregullat dhe urdherat

ketij Akti—

- (a) per te percaktuar formen e nje njoftimi, urdheri ose dokumenti te autorizuar ose qe kerkohet nga ky Akt te dergohet, te pergatitet ose nxirret nga autoriteti lokal;
- (b) per cdo qellim per te cilin rregullimet autorizohen ose kerkohen te behen ne baze te ketij Akti (pervec qellimit per te cilin rregullat autorizohen ose kerkohen te behen nga nje Minister tjetër).

(2) Cdo kompetence e dhene nga ky Akt per te bere rregulla do te jete e ushtrueshme nga instrumenti ligjor.

(3) Cdo instrument ligjor qe permban rregulla te bera ne baze te ketij Akti (pervec rregullave ne baze te seksionit 88 dhe rregulla te cilat si rrejdhim i ketij Akti nuk kane efekt nese nuk jane miratuar me rezolute nga secila nga Dhomat e Parlamentit) do te jene subjekt i anulimit ne baze te nje rezolute nga secila Dhome e Parlamentit.

(4) Kompetencat per te nxjerre urhdhera zhvilimi dhe urdhera ne baze te seksioneve 2, 28, 55(2)(f), 87, 149(3)(a) dhe 139 do te jene te ushtrueshme me instruent ligjor.

(5) Cdo instrumetn ligjor—

- (a) qe permban nje urdher ne baze te seksionit 2 i cili eshte nxjerre pas mbajtjes se nje seance shqyrtimi lokal ne perputhje me neneseksionin (2) te atij seksioni; ose
- (b) qe permban nje urdher zhvillimi ose nje urdher ne baze te seksionit 28, 87 ose 149(3)(a),

do te jete subjekt i anulimit ne baze te nje rezolute nga cdo Dhome e Parlamentit.

(6) Pa cenuar nenseksionin (5), kur nje urdher zhvillimi ka dispozita per perjashtimin ose modifikimin e nje vendimi qe permbahet ne nje Akt te pergjithshem publik (pervec vendimeve te specifikuara ne Aneksin 17) atehere urdheri nuk do te kete fuqi deri sa ajo dispozite te jete miratuar me rezolute nga cdo Dhome e Parlamentit.

(7) Pa cenuar seksionin 14 te Aktit te Interpretimeve te 1978 [1978 c.30.], cdo kompetence e dhene nga ndonje prej dispozitave te ketij Akti per te nxjerre nje urdher, do te perfshije kompetenca per te ndryshuar ose anuluar cdo urdher te tille ose urdher pasardhes.

Licensimi i zonave te planifikimit

334.—(1) Kur ne nje rreth te bashkuar per te cilin me urdher te nxjerre ne baze te seksionit 2, krijohet nje bord planifikimi i perbashket qe perfshin nje license per zone planifikimi, ose i gjithë ky rreth ose pjese e tij ndodhet ne nje license te zones se planifikimit, Sekretari i Shtetit mund te urdheroje revokimin ose ndryshimin e cdo urdheri ne fuqi ne baze te Pjeses VII te Aktit te Licensimit te 1964 [1964 c.26.] deri ne masen qe mund te jete e nevojshme ose praktikisht e mundeshme si rrjedhim i urdherit te nxjerre ne baze te seksionit 2.

(2) Me kusht zbatimin e nenseksionit (1), asgje ne nje urdher te nxjerre ne baze te seksionit 2 nuk do te ndikojë vlefshmerine e nje urdheri ne fuqine baze te Pjeses VII te Aktit te Licensimit te 1964 nese eshte bere para dates se urdherit en baze te seksionit 2.

Akt qe nuk perjashtohet me vendime te vecanta

335. Per te shmangur dyshimet, deklarohet se dispozitat e ketijAkti si dhe cdo kufizim ose komptence e dhene soe qe rrejdhi nga ky Akt ne lidhje me token, zbatohen dhe mund te ushtrohen ne lidhje me cdo toke pavaresisht se dispozita eshte nxjerre nga nje vendim ne fuqi me kalimin e Aktit te 1947 ose nga nje Akt lokal i kaluar ne cdo kohe gjate Sesionit te Parlamentit te mbajtur gjate viteve mbreterore 10 & 11 Geo. 6. per autorizimin ose rregullimin e zhvillimit ne toke.

Interpretim

336.—(1) Ne kete Akt, pervec se kur kerkohet ndryshe nga konteksti ne varesi te dispozitave te meposhtme.—

- "Akti i vitit 1944 " do te thote Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1944;
- "Akti i vitit 1947 " do te thote [1947 c. 51.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1947;
- "Akti i vitit 1954 " do te thote [1954 c. 72.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1954;
- "Akti i vitit 1959" do te thote [1959 c. 53.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1959;
- "Akti i vitit 1962 " do te thote [1962 c. 38.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 962;
- "Akti i vitit 1968 " do te thote 1968 c. 72.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1968;
- "Akti i vitit 1971 " do te thote [1971 c. 78.] Akti mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1971;
- "autoritet bleres" ne lidhje me blerjen e nje interesi mbi toke (i detyrueshme ose me mareveshje) ose propozimi per te blere

nje interere te tille, do te thote departamenti i qeverise, autoriteti lokal apo ndonje trup tjetër i cili ka propozuar te bleje interesin;

- "reklame" do te thote cdo fjale, germe, model, shenje, pllake, tabele, njoftim, mjet prezantimi, i ndricuar apo jo ne natyren, dhe i vene teresisht apo pjeserisht per qellime te reklamimit, njoftimit apo dhenies se drejtimeve dhe (pa cenuar dispozitat e mepareshme te ketij perkufizimi) perfshin cdo strukture te perdorur ose te adoptuar per tu perdorur per afishimin e reklamave dhe referenca per afishimin e reklamave do te merren perkatesisht;
- "kusht pas kujdesit" ka kuptimin e dhene ne paragrafin 2(2) te Aneksit 5;
- "skeme e kujdesit te mepasem" ka kuptimin e dhene ne paragrafin 2(3) te Aneksit 5;
- "bujqesi" prfshin hortikulturen, ritjen e frutave, rritjen e farave, bulmetin, shtimin dhe mbajtjen e bagetive, (duke perfshire krijesa te mbajtura per ushqim, lesh, lekure apo pelice, ose per qellime te punimit te tokes), perdorimin e tokes si livadh, kopshte me lule dhe shtreter te ngrohete, dhe perdorimin per pyje ne ndihme te bujqesise, dhe "bujqesor" do merret perkatesisht.
- "Ministri perkates" ka kuptimin e dhene ne seksionin 265;
- "autoriteti qe ka fuqi blerje te detyrueshme" ne lidhje me blerje te detyrueshme te nje interesi mbi token do te thote cdo person apo grup personash, qe bejne blerje dhe ne lidhje me ndonje shkembim tjetër te interesit mbi token do te thote nje person apo grup personash qe mund te jene autorizuar te blejne interesin detyrimisht per qellime te cilat shkemmimi hyri ne fuqi ose grupi (keshilli i famullise, keshilli i komunitetit, apo mbledhje e famullise) qe eshte autorizuar nga keshilli i rrethit ose keshilli i qarkut;
- "autoritetit te cilit i aplikohet Pjesa II e Aktit te vitit 1959" do te thote nje grup i vecante i percaktuar ne Pjesen I te Aneksit 4 te Aktit te vitit 1959;
- "rruge kembesoresh" ka te njejtin kuptim si ne Aktin mbi Autostradat 1980;
- "the Broads" ka te njejtin kuptim si ne Aktin mbi Norfolk dhe Suffolk Broads 1988 dhe ka te beje me pejsazhet ujore;
- "ndertese" perfshin cdo strukture apo ngritje, dhe cdo pjese te ndertesave, por qe nuk perfshin punishte a makineri te permbajtur ne ndertese;
- "ndertesa apo punime" perfshijne plehrat, apo mbeturinat dhe materiale te tjera te depozituara ne toke, dhe referenca per ngritjen apo konstruksionin e ndertesave apo punimeve

do te merren perkatesisht;

- "punime ne ndertese" perfshin punimet per rindertim, ndryhime strukturore ose shitesa te ndertesave, dhe punime te tjera qe normalisht kryhen nga nje person qe ka biznes si ndertues;
- "vend karvani" ka te njejtin kuptim te dhene ne skesionin 1(4) te Aktit mbi Vendet e Karvaneve dhe Kontrollat mbi Zhvillime 1960;
- "pastrimi" ne lidhje me token do te thote heqja e ndertesave, materialeve, nivelimi i siperfaqes se tokes, dhe kryerja e punimeve sic mund te jene percaktuar;
- "e perbashket" perfshin toke ne varesi te Aktit mbi Perfshirjen 1845 deri 1882, dhe cdo qytet dhe fshat i gjelber;
- "blerje e detyruar" nuk perfshin dhenien e nje prone te nje Akti i Parlamentit te dhene dikujt tjetër me pare;
- "zone e mbrojtur" do te thote nje zone e caktuar sipas seksionit 69 te Aktit te Planifikimit 1990;
- "zhvillim" ka te njejtin kuptim te dhene ne seksionin 55, dhe "zhvilloj" do te merret perkatesisht;
- "zhvillime qe konsistojne ne perpunimin dhe nxjerrjen e mineraleve" pefshijne nxjerrjen e mineraleve nga nje depozite;
- "urdherese zhvillimi" ka te njejtin kuptim te dhene ne seksionin 59;
- "plan zhvillimi" do te merret ne perputhje me seksionet 27 dhe 54;
- "dhenie apo heqje" do te thote dhenie me shitje, shkembim apo qera, ose me kalimin e te drejtave ne ndonje menyre tjetër, pervec seme pervetesim, dhurate, hipotekim, dhe "jep" do te merret perkatesisht.
- "miratim" perfshin miratime nga nje Akti i Parlamenti privat apo lokal dhe nje urdher, rregull, skeme te bera nga nje Akti i Parlamenti;
- "njoftim zbatimi" do te thote nje njoftim sipas seksionit 172;
- "punime inxhinierike" perfshin krijimin e hyrjes ne nje autostrade;
- "skeme e nje zone siper marrjeje" do te thote nje skeme ose skeme e modifikuar qe ka efekt per dhenie te lejes se planifikimit ne perputhje me seksionin 88;
- "ngritje", ne lidhje me nje ndertese perfshin zgjerimin, ndryshimin dhe ri-ngritjen;
- "certificate e vendosur perdorimi" ka te njejtin kuptim sic jepet ne seksionin 192;
- "trotuar" ka te njejtin kuptim si Aktin mbi Autostradat 1980;

- "Zone naftë" do të thote cdo pjese toke të përdorur si vend naftë ose fushe sipas Aktit të Përfshirjes;
 - "funksione" përfshin fuqite dhe detyrat;
 - "departamenti i qeverisë" përfshin Ministrin e Mbreterisë;
 - "Plani për Zhvillimin e Londres së Madhe" do të thote plani i zhvillimit i paraqitur tek Ministri i Strehimit dhe Qeverisë Lokale sipas seksionit 25 të Aktit mbi Qeverinë e Londres 1963 dhe i aprovuar nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 5 të Aktit të vitit 1962 dhe dispozitave korresponduese të Aktit të vitit 1971;
 - "autostradë" ka të njëjtin kuptim si në Aktin mbi Autostradat 1980; "permiresim", në lidhje me një autostradë, ka të njëjtin kuptim si në Aktin mbi Autostradat 1980;
 - "bord i planifikimit të përbashkët" ka të njëjtin kuptim si në seksionin 2;
 - "tokë" do të thote një prone apo trashëgimi, që përfshin një ndërtesë dhe në lidhje me blerjen e tokës sipas Pjesës IX, përfshin interesin mbi token;
 - "qera" përfshin një marrëveshje për qera, por nuk përfshin mundësinë për të marrë qera apo hipotekim dhe "interesi i qeramarresit" do të thote interesi i qeraxhiut sipas qerësë;
 - "autoritet lokal" (përveç në seksionin 252 dhe në varesi të seksionit (1) do të thote—
 - (a) një autoritet ngarkues, një autoritet marrës, një autoritet i kombinuar me autoritet policie apo me autoritet zjarri sikur sic përcaktohet në seksionin 144 të Aktit mbi Financat e Qeverisë Lokale 1988;
 - (b) një grup sipas kuptimit të seksionit 74 të atij Akti; dhe
 - (c) një grup të cilit i aplikohet seksioni 75 i atij Akti;
- dhe përfshin cdo bord të përbashkët ose komitet të përbashkët në qoftë se të gjithë autoritetet përberëse janë autoritete brenda paragrafit (a), (b) ose (c);
- "autoritet lokal i autostradave" do të thote një autoritet autostradë përveç Sekretarit të Shtetit;
 - "autoritet planifikimi lokal" do të merret në përputhje me Pjesën I;
 - "zona e Londres" përfshin Qytetin e Londres, referenca për keshillin e zonës së Londres, në lidhje me Qytetin janë referenca për Keshillin e Komunave, dhe qytetin

- respektivisht;
- "menyra të hyrjes" përfshin menyra të hyrjes private apo publike për automobilat, ose kembësoret dhe përfshin një rrugë;
 - "modifikime të kompensimeve minerare" ka kuptimin e dhënë në paragrafin 1 të Aneksit 11;
 - "autoritet i planifikimit mineral" ka kuptimin sipas seksionit 1(4)
 - "depozite e përpunimit mineral" do të thote cdo depozite e materialeve që mbesin, pasi janë nxjerrur mineralet nga toka ose ndryshe, nga kryerja e punimeve për nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve nën, mbi, ose në tokë;
 - "minerale" përfshin të gjithë mineralet dhe substancat në ose nën tokë për nxjerrje me punime nën-tokësore ose mbitokësore; përveç nuk përfshin prapë për shitje;
 - "Minister" do të thote cdo Minister i Mbreterisë ose i departamenteve të tjera të qeverisë;
 - "hipoteke" përfshin cdo ngarim për të siguruar para apo vlerë;
 - "zhvillim i ri" ka të njëjtin kuptim si në seksionin 55(6);
 - "hapësirë" do të thote një vend që është lulishtë publike, ose e përdorur për qëllime argetimi, ose që është një varreze e përdorur;
 - "tokë veprimi" ka të njëjtin kuptim të dhënë në seksionin 263;
 - "pronar" në lidhje me një tokë, do të thote (përveç seksioneve 66, 67, dhe 71) një person, përveç një pengënesi, i cili, nëse me të drejtën e tij ose në emër të dikujt, ka të drejtë të marrë qera, ose ka të drejtë mbi token sikur të ishte dhënë me qera;
 - "Akti mbi planifikimi" do të thote ky Akt Planifikimi (Ndertesat e Listuara dhe të mbrojtura) 1990, Akti mbi planifikimin (Substancat e rrezikshme) dhe Akti mbi Planifikimin (Dispozita Rrjedhese 1990);
 - "vendime planifikimi" do të thote vendime të bera me aplikime sipas Pjesës III;
 - "leje planifikimi" do të thote leje sipas Pjesës III, dhe në referencat për lejen e planifikimit për të zhvilluar tokë dhe kryerja të zhvillimeve në tokë, ose me aplikime për leje të tilla, do të merren sipas seksionit 63(3) dhe (5);
 - "leje planifikimi e dhënë për një periudhë të kufizuar" ka kuptimin e dhënë në seksionin 72(2);
 - "përcaktuar" (përveç se në lidhje me ceshtje që kerkohen ose autorizohen nga ky akt të përcaktohen në menyre tjetër) do të thote përcaktime sipas rregullave të këtij Akti;
 - "përpjestim i mëparëshëm" në lidhje me një ndarje

propocionale per qellime te dispozitave te caktuara eshte ndarje e bere perpara ndarjes ne fjale qe eshte—

- (a) nje ndarje per qellime te dispozitave te caktuara, te konfirmuara ose te ndryshuara nga Gjykata e Tokave ne referim asaj Gjykate; ose
- (b) nje ndarje per keto qellime qe mund ti jene referuar Gjykates se Tokave ne baze te dispozitave te caktuara, kur koha per nje referim te tille ka skaduar, pa u kerkuar te referohet, dhe referimi eshte terhequr perpara se Gjykata te marre vendim; ose
- (c) nje ndarje e bere nga ose me aprovimin e Bordit te Tokes Qendrore ne lidhje me aprovime nga Bordi sipas seksionit 2(2) te Aktit mbi Planifikimin ne Qytet dhe Fshat 1953 te nje caktimi te nje pjese te perfitimit te kerkuar (sic percaktohet nga paragrafi 1(4) i Skedules 12 te ketij Akti),

dhe ne kete perkufizim "dispozite e caktuar" do te thote cdo dispozite e Pjeses V te ketij Akti, ose Pjeses VII te Aktit te vitit 1971; ose te Pjeses VI te Aktit te vitit 1952 te cdo dispozite sic aplikohen nga dispozita te tjera te ketij akti apo atyre Akteve dhe dispozitave te Aktit te vitit 1959;

- "furnizues publik gazi" ka te njejtin kuptim si ne pjesen I te Aktit mbi Gazin 1986;
- "njoftimper blerje" ka te njejtin kuptim si ne seksionin 137;
- "urdher i caktuar" ka te njejtin kuptim si ne paragrafin 11 te Aneksit 11;
- "zevendesimi hapësirës", ne lidhje me nje zone, do te thote kthimi i kesaj toke per t'u perdorur si hapësirë, ose ne nje gjendje te pazhvilluar, ne zevendesim per toke ne ate zone qe eshte perdorur si e tille;
- "kusht restaurimi" ka te njejtin kuptim te dhene ne paragrafin 2(2) te Aneksit 5;
- "kufizime ne nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve" ka te njejtin kuptim si ne paragrafin 10 te Aneksit 11;
- "zone planifikimi e thjeshtezuar" ose skeme e zones se planifikimit te thjeshtezuar" do te merret ne perputhje me seksionet 82 dhe 83;
- "konsultime te vecanta: ka kuptimin e dhene ne paragrafin 12 te Aneksit 11;
- "sipermarres ligjore" dhe sipermarje ligjore kane te njejtin kuptim si ne seksionin 262;

- "masa per mbrojtjen e mjedisit" ka te njejtin kuptim te dhene ne paragrafin 5(4) te Aneksit 9;
- "njoftime ndalimi" ka te njejtin kuptim te dhene ne seksionin 183;
- "urdher pezullimi" ka te njejtin kuptim te dhene ne paragrafin 5 te Aneksit 9; dhe
- "urdher pezullimi suplementar" ka kuptimin e dhene ne paragrafin 6 te Aneksi 9;
- "qeramarrje" ka kuptimsi ne Aktin mbi Pronaret dhe Qeramarrsesit 1954 ;
- "urdher per mbrojtjen e pemeve" ka kuptim si ne seksionin 198;
- "zone e zhvillimit urban" dhe "korporate e zhvillimit urban" kane kuptimin si ne Pjesen XVI te Aktit mbi Qeverine Lokale dhe Planifikimin 1980;
- "perdorim" ne lidhje me token, nuk perfshin perdorimin e token per ndertimin e ndertesave dhe punimeve te tjera ne te;
- "Zyre Vleresimi" do te thote Zyra e Vleresimit te Departamentit mbi te Ardhurat ne Toke;
- "demtime lufte" ka kuptim sipas Aktit mbi Demtimet e Luftes 1943.

(2) Ne qofte se, ne lidhje me kerkesat apo autorizimet e bera ne kete Akt, cdo ceshtje qe ngrihet ne lidhje me se kush eshte Ministri ose Ministri perkates ne lidhje me sipermarresit ligjore, ajo ceshtje do te vendoset nga Thesari.


3) Ne qofte se del ceshtja nese toka e sipermaresve ligjore eshte toke veprimi, kjo ceshtje duhet te vendoset nga Ministri ose nga ministri perkates ne lidhje me ato sipermarres.

(4) Fjalet ne kete Akt qe perbejne referenca per dhenie te njoftimit do te merren qe perfshijne referenca per dhenie njoftimi ne baze te nje miratimi, ose qe do te jipen.

(5) Ne lidhje me referenca ne kete Akt per vendime planifikimi-

- (a) ne lidhje me vendime per te ndryshuar me berje apelimi me ane te hedhjes poshte ose ndryshim te nje pjese apo ne teresi do te merren si referenca per vendime te ndryshuara;
- (b) ne lidhje me vendime te mbeshtetura, referenca te tilla do te merren si referenca per vendime te autoritetit te planifikimit lokal dhe jo per vendimin e Sekretarit te Shtetit per apelim;

- (c) ne lidhje me vendime te dhena me apelim ne rrethanat e permendura ne seksionin 78(2), referenca te tilla do te merren si referenca te ketyre te vendimeve te dhena;
- (d) koha e vendimit te planifikimit, ne rastin kur nuk ka apelim, do te merret si kohe e marrjes se vendimit nga autoriteti i planifikimit lokal.
- (6) Seksioni 56 do te aplikohet per te percaktuar qellimet e ketij Akti kur zhvillimi i tokes do te merret qe ka filluar.
- (7) Ne lidhje me shitjen ose blerjen e interesit mbi token—
- (a) ne rastet kur interesi eshte caktuar pa nje kontrate paraprake, referencat ne kete akt per kontrate jane referenca per caktimin; dhe
- (b) referencat per berjen e kontrates jane referenca per kryerjen e tij.
- (8) Ne kete Akt—
- (a) referenca per nje person nga i cili eshte marre titulli nga nje person tjetër perfshijne referenca per cdo paraardhes te titullit; (b) referenca per nje person qe e ka titullin nga nje person tjetër perfshijne referenca per pasardhësit;
- (b) referenca per tituj jane referenca per tituj te marre direkt apo indirekt.
- (9) Referenca ne Aktet e planifikimit per dispozita ne Pjesen V te Aneksit 16 perfshijne, reference per ato dispozita sic modifikohen sipas seksionit 316(1) deri (3).
- (10) Ne seksionin 90. Kapitulli I i Pjeses VI, dhe seksionet 324(2) dhe 330 "autoritet lokal" ne lidhje me token Broads (siperfaqet ujore me vlera pejsazhistike), eshte Autoritetin e Broads.
- 337.—**(1) Ky Akt mund te permendet si Akti i Planifikimit te Qytetit dhe vendit i 1990.
- (2) Me perjashtim te asaj qe sigurohet nepermjet Pjeses II dhe ne Aneksin 4 te Aktit te Planifikimit (Dispozitat shtetese) te 1990 [1990 c.11.], ky Akt hyn ne fuqi ne fund te periudhes tre mujore nga data ne te cilen u kalua.
- (3) Ky Akt zbatohet vetem ne Angli dhe Uells.



ANEKSET (SKEDULAT):

Aneksi (Skedula) 1:

Seksioni 1:

Autoriteti Lokal i Planifikimit: Shperndarja e funksioneve

Hyrje

1. - (1) Ne kete Aneks (Skedule), "ceshtje e qarkut" ne lidhje me cdo aplikim, urdher apo njoftim eshte-
 - (a) nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve mbi ose nen toke (ne siperafeqe ose me germime nentokesore) ose ngritja e ndertesave, punishteve ose makinerive -
 - (i) qe propozohet te perdoret per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve ose me trajtimin ose derdhjen e tyre ne token qe eshte prane vendit te punes, ose
 - (ii) te cilen nje person i perfshire ne perpunimin e mineraleve propozon ta perdore per ndarjen, larjen ose thyerjen e mineraleve;
 - (b) perdorimi i tokes, ose ngritja e godinave, punishteve ose makinerive per kryerjen e proceseve per pergatitjen ose adoptimin per shitje te mineraleve ose prodhimin e artikujve nga mineralet ku -
 - (i) toka eshte pjese ose ndodhet prane vendit qe perdoret ose qe eshte propozuar te perdoret per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve; ose
 - (ii) minerali eshte, ose propozohet te sillet ne kete toke nepermjet nje tubi, konvejeri, ajrit, ose makinerie te ngjashme, ose nepermjet nje rruge private tokesore, detare ose hekurudhore nga nje vend qe perdoret ose propozohet te perdoret per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve;
 - (c) kerkimi dhe testimi i depozitave te mineralit ose ngritja e ndertesave, punishteve ose makinerive te cilate propozohen te perdoren per to;
 - (d) shkarkimi i mbeturinave te mineraleve
 - (e) perdorimi i tokes per te githa qellimet qe lidhen me transportimin nepermjet hekurudhes ose ujit te agregateve (dmth secila prej ketyre te permendura me poshte -

- (i) rere dhe zhavorr;
- (ii) gur i thyer;
- (iii) materiale artificiale ngjashem ne pamje me reren, zhavorin ose gurr te thyer qe jane prodhuar nga mbeturinat e hekurit ose celikut, hi, lende djegese e pulverizuar, mbeturine argjilore ose minerale), ose ngritja e godinave, punishteve ose makinerive qe propozohen te perdoren ne lidhje me to.
- (f) ngritja e godinave, punishteve ose makinerive te cilate propozohet te perdoren per mbulimin e gurrit te rruges ose prodhimi i betonit ose prodhimeve prej betoni ose agregateve artificiale, ku ndertesa, punishtja ose makinerite do te ndertohen ne ose mbi token qe eshte pjese ose bashkon vendin qe perdoret ose propozohet te perdoret -
 - (i) per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve, ose
 - (ii) per ndonje prej qellimeve te permendura ne paragrafin (e) me siper;
- (g) ngritja e cdo ndertese, punishte ose makineri qe propozohet per prodhimin e cimentos;
- (h) kryerja e punimeve ne, mbi, poshte dhe siper tokes, ose perdorimi i tokes, ku toka eshte ose ben pjese ne vendin e punimeve qe perdoret ose qe eshte perdorur me pare per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve dhe ku veprimet ose perdorimi mund te jene ne konflikt ose cenojne mosperputhjen me kushtet e rikuperimit ose me kushtet e kujdesit pas perfundimit te punimeve;
 - (i) kryerja e punimeve ne, mbi, poshte dhe siper tokes, ose perdorimi i tokes e cila ndodhet pjeserisht brenda dhe pjeserisht jashte nje Parku Kombetar;
 - (j) kryerja e veprimit i cili ne lidhje me zonen ne fjale eshte veprim i paracaktuar ose veprim i nje klase te paracaktuar ose cdo perdorim i cili ne lidhje me ate zone eshte perdorim i paracaktuar ose perdorim i nje klase te paracaktuar.

(2) Ne nenparagrafin (1) "nxjerrja dhe perpunimi i materialeve" perfshin nxjerrjen e mineraleve nga nje depozite punuese minerale.

Planet e zhvillimit

2.- Funksionet e autoritetit te planifikimit lokal ne seksionet 30 deri 33 dhe 50 (1) deri (5) jane te ushtrueshme nga

autoriteti i planifikimit te qarkut dhe permendja ne ato seksione e autoritetit te planifikimit lokal duhet te percaktohet si duhen.

Planifikimi dhe kontrolli i vecante

3.- (1) Funksonet e autoritetit te planifikimit lokal qe vendosin per—

- (a) aplikimet per leje planifikimi;
 - (b) aplikime per te vendosur sipas seksionit 64 nese kerkohet nje aplikim per leje te tille;
 - (c) aplikime per per nje certifikate perdorimi te percaktuar sipas seksionit 192;
- sipas nenparagrafit (2) do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te rrethit.

(2) Funksonet e autoritetit te panifikimit lokal per te vendosur per aplikimin qe permendet ne nenparagrafin (1) i cili sipas autoritetit te planifikimit te rrethit lidhet me ceshtje te qarkut, do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te qarkut.

(3) Cdo aplikim qe permendet ne nenparagrafin (1) duhet t'i dergohet autoritetit te planifikimit ne rreth.

(4) Autoriteti i planifikimit te rrethit duhet t'i dergoje autoritetit te planifikimit te qarkut sa me shpejt dhe per cdo rast jo me shume se shtate dite pasi e ka marre ate, nje kopje te cdo aplikimi per leje planifikimi qe sipas tyre lidhet me qarkun.

(5) Sipas nenparagrafit (6), autoriteti i planifikimit te rrethit duhet t'i dergoje autoritetit lokal te rrugeve, ndoshta menjehere pasi ka marre nje kopje te cdo aplikimi per leje planifikimi qe sipas tyre nuk duket se lidhet me qarkun.

(6) Nese autoriteti lokal i rrugeve percakton nje rast ose nje klase rastesh ne te cilat nje aplikim i tille i cili permendet ne nenparagrafin (5) nuk duhet t'i dergohet atij, pergjegjesia qe i vishet autoritetit te planifikimit te rrethit nga nenparagrafi (5), nuk duhet te ushtrohet ne ato aplikime per te cilat behet fjale ne udhezim.

(7) Dispozitat e meparshme te ketij paragrafi nuk zbatohen ne

aplikimet qe lidhen me toke ne Park Kombetar, ne vend te tyre do te zbatohet paragrafi 4.

4-(1) Secili nga keto aplikime—

- (a) aplikimet per leje planifikimi;
- (b) aplikime per te percaktuar sipas seksionit 64 nese kerkohet nje aplikim per leje te tille;
- (c) aplikimet per certifikate perdorimi te caktuar sipas seksionit 192; dhe
- (d) aplikime per lejen e vendosjes se reklamave sipas seksionit 220,

nese lidhen me toke ne Park Kombetar, do t'i behen autoritetit te planifikimit ne rreth i cili me perjashtim te rastit kur ai lejohet te marre vendim lidhur me to, ia dergon autoritetit te planifikimit te qarkut dhe ne rast te nje aplikimi per leje planifikimi duhet t'i dergoje nje kopje autoritetit lokal te rrugeve, me perjashtim te rastit ku autoriteti lokal i rrugeve eshte autoritet i planifikimit lokal dhe me perjashtim te rastit ose klases se rasteve ne te cilat autoriteti lokal i rrugeve udhezon ndryshe.

(2) Aty ku nje aplikim i tille qe lidhet me toke ne Park Kombetar ose nje aplikim qe lidhet me aprovimin e nje ceshtjeje te rezervuar sipas nje leje planifikimi brenda kuptimit te seksionit 92 duhet te percaktohet nga autoriteti i planifikimit te qarkut, ky autoritet para se te vendose per aplikimin duhet te konsultohet me autoritetin e planifikimit te rrethit per zonen ne te cilen ndodhet toka per te cilen eshte bere aplikimi.

5. -(1) Sekretari i Shtetit mund te perfshije ne nje urdher zhvillimi dispozita te tilla te cilat sipas tij mundesojne autoritetin lokal te rrugeve t'i vendose kufizime autoritetit lokal te planifikimit ne dhenien e lejeve per leje planifikimi per llojet e meposhtme te ndertimeve qe lidhen me toke ne zonen e autoritetit lokal te rrugeve—

- (a) krijimin, shtrirjen ose alternimin e cdo lloj hyrjeje ne nje rruge qe klasifikohet ne seksionin 12(3) te Aktit te Rrugeve 1980 [1980 c.66] ose seksioni 27 te Aktit te Qeverisjes Lokale 1966 [1966 c. 42] ose te nje rruge te propozuar aksi i te ciles eshte adoptuar me vendim te autoritetit lokal te rrugeve dhe i eshte njoftuar si e tille autoritetit te planifikimit lokal;
- (b) cdo veprim ose perdorim i tokes qe sipas autoritetit lokal

te rrugeve mund te rezultoje ne rritje materiale te volumit te trafikut qe hyn dhe del nga nje rruge e tille e klasifikuar ose e propozuar, te cenoje permiresimin ose ndertimin e nje rruge te tille ose te rezultoje ne nje ndryshim material te trafikut qe hyn, del ose perdor nje rruge te tille.

(2) Perdorja ne nenparagrafin (1) e autoritetit lokal te planifikimit nuk duhet te konsiderohet si perfshirje e permendjes se nje korporate te zhvillimit urban e cila eshte autoritet i planifikimit lokal si rrjedhim i nje urdheri nen seksioni 149 te Aktit te Qeverisjes Lokale [1980 c. 65], Planifikimit dhe Aktit te Tokes 1980 dhe asnje dispozite e nje urdheri zhvillimi qe perfshihet ne te si rrjedhoje e atij paragrafi nuk duhet te interpretohet se aplikohet ne nje korporate te tille.

(3) Sekretari i Shtetit mund te perfshije ne nje urdher zhvillimi dispozita qe mundesojne autoritetin lokal te rrugeve te vendose kufizime ne dhenien e lejes e cila jepet nga korporata e zhvillimit urban qe eshte autoritet planifikimi lokal per lejen e planifikimit per nje pershkrim te tille te zhvillimit ashtu sikurse mund te jete percaktuar ne urdher.

6.—(1) Nje urdher zhvillimi mund te perfshije gjithashtu dispozita qe i kerkojne autoritetit te planifikimit te qarkut qe vendos mbi aplikime te cilat permenden ne paragrafin 3 dhe qe lidhen me ceshtje te qarkut, ose per aplikime per miratim te nje ceshtje te rezervuar nen lejen per planifikim sipas kuptimit te seksionit 92, t'i jape autoritetit te planifikimit te rrethit per siperfaqen ku ndodhet toka per te cilen eshte bere aplikimi, mundesine per t'i bere rekomandime autoritetit te planifikimit te qarkut rreth menyres se marrjes se vendmit per aplikimin dhe per te marre parasysh rekomandime te tilla.

(2) Urdheri i zhvillimit mund te perfshije gjithashtu dispozita qe i kerkojne autoritetit te planifikimit te qarkut ose te rrethit qe kane marre aplikime te permendura me siper ose aplikime per miratim (perfshire aplikime qe lidhen me toke ne Park Kombetar) te njoftojne autoritetin e planifikimit te rrethit ose sipas rastit te qarkut per kushtet e vendimit te tyre, ose kur aplikimi i eshte referuar Sekretarit te Shtetit, daten ne te cilen eshte bere referimi, dhe kur behet njoftimi i tyre, kushtet e vendimit te tij.

7.—(1) Eshte detyre e autoritetit te planifikimit lokal ne nje qark jo-metropolitan qe kur ushtron funksionet e tij sipas seksioneve 70 ose 71 te kerkoje arrijten e objektiveve te pergjithshme te planit strukture per periudhen qe eshte ne fuqi ne zonen e tij.

(2) Sipas nenparagrafit (4), autoriteti i planifikimit te rrethit duhet te keshillohet me autoritetin e planifikimit te qarkut per zonen e tij para se te vendose per aplikime ne te cilat aplikohet ky nenparagraf.

(3) Nenparagrafi (2) zbatohet ndaj cdo aplikimi per leje planifikimi per kryerjen e—

(a) cdo ndertimi ne toke i cili do te konfliktoje materialisht ose cenoje zbatimin e—

(i) cdo politike ose propozimi te pergjithshem qe perfshihet ne nje plan strukture qe eshte miratuar nga Sekretari i Shtetit;

(ii) cdo politike ose propozimi te pergjithshem qe perfshihet ne propozimet per ndryshimin ose anullimin dhe zvendesimin e nje plani strukture qe i eshte dorezuar Sekretarit te Shtetit per miratim;

(iii) cdo propozimi per ndryshimin ose anullimin dhe zvendesimin e nje plani strukture ne menyre te tille qe te perfshije ne plan cdo ceshtje te cilen autoriteti i planifikimit te qarkut e ka bere publike sipas seksionit 33;

(iv) dispozitave themelore te nje plani zhvillimi ne te cilin zbatohet paragrafi 2 i Pjese III te Aneksit 2, per aq kohe sa plani i zhvillimit eshte ne fuqi ne zonen e autoritetit te planifikimit te rrethit;

(v) cdo propozimi qe perfshihet ne nje plan lokal i cili eshte pergatitur nga autoriteti i planifikimit lokal (pavaresisht nese plani eshte adoptuar ose jo nga autoriteti ose miratuar nga Sekretari i Shtetit);

(vi) cdo propozimi per te perfshire ne nje plan lokal i cili po pergatitet nga autoriteti i planifikimit te qarkut te cdo ceshtje e cila eshte bere publike nga ai sipas seksioneve 39 ose 40;

(vii) cdo propozimi per te perfshire ne ndryshimet qe autoriteti i planifikimit te qarkut propozon ti beje planit lokal, ceshtje qe ai e ka bere publike sipas seksioneve 39 ose 40;

(b) cdo zhvillimi ne toke i cili per shkak te permasave ose natyres ose vendndodhjes se tokes do te kete rendesi kryesire per zbatimin e planit strukture;

(c) cdo zhvillimi ne toke qe ndodhet ne nje zone per te cilen autoriteti i planifikimit te qarkut ka njoftuar me shkrim autoritetin e planifikimit te rrethit si zone ne te cilen zhvillimi mund te ndikojte ose ndikohet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve te tjera pervec qymyrit;

(d) cdo zhvillim ne toke per te cilen autoriteti i planifikimit te qarkut ka njoftuar me shkrim autoritetin e planifikimit te rrethit si toke ne te cilen ai do ta zhvilloje vete;

(e) cdo ndertimi ne toke qe do te cenoje realizimin e zhvillimit te propozuar nga autoriteti i planifikimit te qarkut per te cilat autoritetit te planifikimit te rrethit i eshte dhene njoftim sipas paragrafit (d);

(f) cdo zhvillimi ne toke ne Angli ne lidhje me te cilen autoriteti i planifikimit lokal te qarkut ka njoftuar me shkrim autoritetin e planifikimit te rrethit se propozon t'a perdore per depozitim mbeturinash;

(g) cdo zhvillimi ne toke i cili do te cenoje perdorimin e propozuar te tokes per depozitim mbeturinash per te cilen autoriteti i planifikimit te rrethit eshte njoftuar sipas paragrafit (f).

(4) Autoriteti i planifikimit te rrethit mund te vendose se mbi cilat aplikime zbatohet nenparagrafi (2) pa bere konsultimin e kerkuar nga ky paragraf, nese autoriteti i planifikimit te qarkut i ka dhene atij udhezim qe e autorizojne te veproje ne kete menyre.

(5) Nje udhezim sipas nenparagrafit (4) mund te lidhet me nje klase aplikimesh ose nje aplikimi te vecante.

(6) Sipas nenparagrafit (7), kur autoriteti i planifikimit te rrethit i kerkohet te konsultohet me autoritetin e planifikimit te qarkut para se te vendose per aplikimin per leje planifikimi—

(a) ai duhet te njoftoje autoritetin e planifikimit te qarkut se propozon marrjen ne shqyrtim te aplikimit dhe i dergon atij nje kopje te tij, dhe

(b) ai nuk duhet te vendose per te derisa te mbaroje periudha e shqyrtimit qe fillon ne daten e dhenies se njoftimit, sikurse mund te percaktohet nga urdheri i zhvillimit.

(7) Autoriteti i planifikimit te rrethit mund te vendose per aplikimin per leje planifikimi para se periudha e permendur ne nenparagrafin (6)(b) te mbaroje ne rastet kur—

(a) lidhur me aplikimin ka marre prezantime te derguara

nga autoriteti i planifikimit te qarkut para perfundimit te kesaj periodhe; ose

b) autoriteti i planifikimit te qarkut i ka njoftuar se nuk deshiron te beje prezantime.

(8) Kur autoritetit te planifikimit te rrethit i kerkohet te konsultohet me autoritetin e planifikimit te qarkut para se te vendose per nje aplikim per leje planifikimi, ne marrjen e vendimit ai duhet te marre parasysh cdo prezantim qe lidhet me te dhe qe eshte paraqitur nga autoriteti i planifikimit te qarkut para mbarimit te periudhes se permendur ne nenparagrafin (6)(b).

8.—(1) Kur autoriteti i planifikimit te rrethit ose ne nje qark metropolitan, autoriteti i planifikimit lokal njoftohet me shkrim nga keshilli i komunes ose i komunitetit te cilat ndodhen plotesisht ose pjeserisht ne zonen e atij autoriteti per te cilat keshilli deshiron te informohet—

(a) per cdo aplikim per leje planifikimi qe ka te beje me token e komunes ose komunitetit;

(b) per cdo aplikim qe lidhet me miratimin e ceshtjeve qe rezervohen sipas lejes per planifikimi sipas kuptimit te seksionit 92, ose

(c) per cdo pershkrim te nje aplikimi te tille, nese autoriteti merr aplikime te tilla ose, sipas rastit, nje aplikim me pershkrim te tille, ai duhet te njoftoje me shkrim keshillin duke treguar natyren e zhvillimit per te cilen eshte bere aplikimi dhe te identifikojte token te ciles i referohet aplikimi.

(2) Dispozitat qe mund te permbahen ne nje urdher per zhvillim duhet te perfshijne kushte qe i kerkojne—

(a) autoritetit te planifikimit lokal i cili vendos per nje aplikim per te cilin keshilli i komunes ose komunitetit duhet te njoftohet, ti jape ketij keshilli mundesi te prezantoje tek autoriteti i planifikimit lokal per menyren se si duhet te vendoset per aplikimin dhe te marre ne konsiderate keto prezantime.

(b) autoritetit te planifikimit te rrethit, ose ne nje qark metropolitan, autoritetit te planifikimit lokal, ose ne nje qark jometropolitan, autoritetit te planifikimit te qarkut te njoftoje keshillin per termat e vendimit per nje aplikim ose kur aplikimi i dergohet Sekretarit te Shtetit, daten ne te cilen ai eshte derguar dhe kur te marrin pergjigje, termat e ketij vendimi.

9.—(1) Ne qarqet jometropolitane, funksionet e autoritetit te planifikimit lokal ne baze te dispozitave te ketij Akti qe lidhen me skema te zones se planifikimi te thjeshtuar, do te ekzekutohen nga autoritetet e planifikimit te rrethit.

(2) Kur autoriteti i planifikimit te rrethit ne nje qark jometropolitan vepron ne perputhje me paragrafin 5 te Aneksit (Skedules) 7, para se ai te pergatise skemen e propozuar ose ndryshimet, duhet te konsultohet me keshillin e qarkut si autoritet i planifikimit si dhe per shkak te efektit qe do kete ky propozimi ne rruget ekzistuese ose qe do ndertohen ne te ardhmen; dhe kur te kete pergatitur skemen e propozuar ose ndryshimet duhet t'i dergoje keshillit te qarkut nje kopje.

(3) Kur autoriteti i planifikimit te rrethit ne nje qark jometropolitan vepron ne perputhje me paragrafin 6 te Aneksit (Skedules) 7, duhet t'i dergoje keshillit te qarkut nje kopje te ndryshimit te propozuar.

10.- Me perjashtim te Parqeve Kombetare, funksionet e nje autoriteti te planifikimit lokal sipas seksionit 94 do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te rrethit, vecse kur leja e planifikimit eshte dhene nga autoriteti i planifikimit te qarkut, keto funksione qe kane te bejne me kete leje do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te qarkut si edhe autoriteti i planifikimit te rrethit pasi te jete konsultuar me autoritetin e planifikimit te qarkut.

11.—(1) Funksionet e autoritetit te planifikimit lokal te—

(a) dhenies se urdherave sipas seksionit 97 per heqjen ose modifikimin e lejes se planifikimit, ose sipas seksionit 102 per te kerkuar nderprejen e perdorimit, vendosjen e kushteve per vazhdimin e perdorimit ose per te kerkuar ndryshimin ose heqjen e ndertesave ose punimeve, ose

(b) nxjerrja e njoftimeve per zbatim sipas seksionit 172 ose zbatimi i njoftimeve per ndalim sipas seksionit 183, sipas nenparagrafeve (2) deri (4), do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te rrethit.

(2) Ne rastin kur autoriteti i planifikimit te rrethit ne nje qark

jometropolitan mendon se funksionet e permendura ne nenparagrafin (1) lidhen me ceshtje te qarkut, ai nuk duhet t'i ushtroje keto funksione pa u konsultuar me pare me autoritetin e planifikimit te qarkut.

(3) Sipas nenparagrafit (4), ne nje qark jometropolitan keto funksione do te jene te ushtrueshme edhe nga autoriteti i planifikimit te qarkut ne rastin kur atij autoriteti i duket se ato lidhen me ceshtje te cilat duhen kosideruar si ceshtje qarku.

(4) Per ato ceshtje qe jane ceshtje qarku si rrjedhim i dipozitave te paragrafit 1(1)(a) deri (h), funksionet e autoritetit te planifikimit lokal te specifikuara ne nenparagrafin (1)(b) do te ushtrohen vetem nga autoriteti i planifikimit te qarkut ne funksionin e tij si autoritet i planifikimit per mineralet.

12.- Ne seksionet 178(1), 181(4)(6) dhe 190(2) deri (5) cdo permendje e autoritetit te planifikimit lokal do te interpretohet si permendje e autoritetit qe ka nxjerre njoftimin ose urdherin ne fjale, ose ne rastin e nje njoftimi te bere ose urdheri te nxjerre nga Sekretari i Shtetit, autoriteti qe permendet ne njoftim ose urdher.

13.—(1) Autoriteti i planifikimit te qarkut mund te nxjerre urdher per ruajtje te pemeve vetem—

(a) nese behet si rrjedhim i seksionit 197(b);

(b) nese lidhet me toke qe nuk shtrihet plotesisht brenda territorit te nje autoriteti te vetem te planifikimit te rrethit;

(c) nese lidhet me toke ne te cilen autoriteti i planifikimit te qarkut ka interes; ose

(d) nese lidhet me toke ne nje Park Kombetar.

(2) Kur autoriteti i planifikimit lokal ka nxjerre nje urdher ruajtje per peme sipas seksionit 198 ose Sekretari i Shtetit ka nxjerre nje urdher te tille sipas seksionit 202, e drejta per te ndryshuar ose anuluar urdherin dhe e drejta per administrim sipas seksionit 206 ose sherbimi ose paraqitja ne apelim qe lidhet me nje njoftim qe eshte nen seksionin 207 do te ushtrohen vetem nga autoriteti qe ka nxjerre urdherin ose ne rastin e urdherit te nxjerre nga Sekretari i Shtetit, autoriteti qe permendet ne ate urdher.

14.-- Funkcionet e autoritetit te planifikimit lokal sipas seksioneve 69, 211, 214, 220, 221, 224 dhe 225 dhe ne qarqet jometropolitane funksionet sipas seksionit 215, ushtrohen nga autoritetet e planifikimit te rrethit.

15.—(1) Kopja e njoftimit qe kerkohet t'i dergohet sipas paragrafit 4(5) te Aneksit (Skedules) 8 autoritetit te planifikimit lokal, ne rastin e nje propozimi per te cilin departamenti qeveritar duhet te jape udhezim sipas seksionit 90(1) ose zhvillimi qe do te realizohet nga ose ne emer te departamentit qeveritar, do te dergohet ne autoritetin lokal te planifikimit i cili sipas mendimit te Sekretarit te Shtetit do te ishte pergjegjes per t'u marre me aplikimin per leje planifikimi per zhvillimin ne fjale nese nje aplikim i tille nuk do te ishte bere.

(2) Referencat qe i behen autoritetit te planifikimit lokal ne paragrafet 3(2) dhe 5(1) te atij Aneksi (Skedule) do te interpretohen si referenca ndaj autoritetit te planifikimit lokal ne te cilin kerkohet te dergohet ajo kopje.

Kompesimi

16.—(1) Kerkesat per pagimin e kompensimit sipas seksionit 107 (perfshire kete seksion ne baze te seksionit 108) dhe seksioneve 114, 115(1) deri (4), 186 dhe 223, do t'i behen dhe do te paguhen sipas nenparagrafit (3) nga autoriteti i planifikimit lokal i cili ndermori veprimin dhe si pasoje u krijua kerkesa ose, kur veprimi u ndermor nga Sekretari i Shtetit, autoriteti i planifikimit lokal i cili beri apelimin tek ai ose qe referoi ceshtjen tek ai ose ne rastin e nje urdheri te derguar ose njoftimi te kryer nga ai sipas seksioneve 100, 104 ose 185, autoriteti i duhur dhe ne keto seksione referimi qe i behet autoritetit lokal te planifikimit duhet interpretuar ne perputhje me rrethanat .

(2) Ne kete paragraf "autoritet i duhur" do te thote—

(a) ne rastin e nje kerkese per kompensim sipas seksionit 107 ose 108 autoriteti i planifikimit lokal qe aprovoi ose qe per qellimet e seksionit 107 do te trajtohet si autoriteti qe ka aprovuar lejen e planifikimit anullimin ose modifikimin te cilat krijuan nevojën per kete

kerkese.

(b) ne rastin e nje kerkese per kompensim sipas seksionit 115(1) deri (4) ose 186, autoriteti i planifikimit lokal i permendur ne urdherin ose njoftimin per ndalim te Sekretarit te Shtetit;

(c) ne rastin e kerkeses per kompensim sipas seksionit 223, autoriteti i planifikimit te rrethit.

(3) Sekretari i Shtetit mundet qe pas keshillimit me te gjitha autoritetet te udhezoje se kur autoriteti i planifikimit lokal eshte pergjegjes per te paguar kompensim sipas ndonje prej dispozitave te nenparagrafit (1) per nje rast te vecante ose klase rastesh, autoriteti lokal ka te drejte te rimburohet me sasine plote te kompensimit ose me ate pjese te cilen ai e udhazon nga nje ose disa autoritete te specifikuara ne ate udhezim.

(4) Autoriteti i planifikimit lokal te cilit do te paguaje kompensimin dhe te cilit do t'i drejtohen kerkesat per kompensim ne baze te seksionit 144(2) do te jete autoriteti i planifikimit te rrethit.

17. Kerkesat per pagimin e kompensimit ne baze te nje urdheri per mbrojtje pemesh qe rrjedhin nga seksioni 203 dhe kerkesat per pagim te kompensimit sipas seksionit 204 qe rrjedhin nga udhezimet e dhena ne vazhdim te ketij urdheri do t'i behen dhe do te paguhen nga autoriteti i planifikimit lokal qe leshoi urdherin ose ne rastin e nje urdheri te nxjerre nga Sekretari i Shtetit, autoriteti i permendur ne ate urdher; dhe referimi ne seksionin 204(2) i autoritetit qe ushtron funksionet ne baze te urdherit per mbrojtjen e pemeve do te kete fuqi nese ploteson kushtet e ketij paragrafi.

18. Autoriteti i planifikimit lokal i cili sipas seksionit 279(1)(a) do t'i paguaje kompensimin sipermarresit ligjor, sipas rastit do te jete autoriteti qe referoi aplikimin per leje planifikimi tek Sekretari i Shtetit dhe Ministri perkates, ose nga vendimi i te cilit u apelua tek ata ose qe dergoi njoftimin per zbatimin ndaj te cilit u apelua.

Kurora

19.—(1) Pervecse ne nje qark metropolitan ose Park Kombetar, funksionet qe rrjedhin nga seksioni 302 dhe Skedula 15 mbi

autoritetin pergjegjes per zbatimin e kontrollit te planit, sipas nenparagrafit (3) do te ushtrohen nga—

- (a) autoriteti i planifikimit te qarkut ne rastin kur punimet ose perdorimi i tokes sipas mendimit te autoritetit te planifikimit te rrethit lidhen me ceshtje te qarkut;
- (b) ne cdo rast tjeter do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te rrethit.

(2) Ne rastin e nje zone ne Park Kombetar jashte nje qarku metropolitan, keto funksione do te ushtrohen nga autoriteti i planifikimit te qarkut.

(3) Cdo aplikim i cili bazuar ne nenseksionin (3) te atij seksioni i eshte drejtuar autoritetit pergjegjes per zbatimin e kontrollit te planit duhet t'i drejtohet autoritetit te planifikimit te rrethit i cili ne rastin kur aplikimi percaktohet nga autoriteti i planifikimit te qarkut ia dergon ate ketij te fundit.

(4) Autoriteti i planifikimit te qarkut qe vendos per nje aplikim te tille do t'i jape autoritetit te planifikimit te rrethit per zonen ne te cilen ndodhet toka per te cilen eshte bere aplikimi, mundesine t'i jape rekomandime autoritetit te planifikimit te qarkut lidhur me menyren sesi duhet te vendoset per aplikimin dhe duhet te marre parasysh nje rekomandim te tille.

(5) Autoriteti i planifikimit te qarkut ose rrethit qe eshte marre me aplikime te tilla duhet te njoftoje autoritetin e planifikimit te rrethit ose sipas rastit te qarkut per kushtet e vendimit ose ne rastin kur aplikimi i eshte derguar Sekretarit te Shtetit, daten ne te cilen eshte bere dergesa.

Te ndryshme

20.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal te cilit Sekretari i Shtetit duhet t'i marre mendim ne baze te seksioneve 100(3), 104(3) ose 202(1) ose t'i dergoje njoftim te propozimeve te tij ne baze te seksionit 100(4) ose 104(4), do te jete autoriteti i planifikimit te rrethit ose te qarkut, sikurse ai e mendon te pershtatshem dhe permendja e autoritetit lokal ne seksionet 100(2), (3) dhe (4) dhe 104(2), (3) dhe (4) dhe 202 duhet te interpretohet ne perputhje me keto rrethana.

(2) Ne seksionet 96, 182 dhe 185 cdo permendje e autoritetit

te panifikimit lokal do te interpretohet si permendje e autoritetit te planifikimit te qarkut ose rrethit, sikurse e sheh te pershtatshme Sekretari i Shtetit.

(3) Pushteti i autoritetit te planifikimit lokal per te bere marveshje ne baze te seksionit 106 mund te ushtrohet per toke qe ndodhet ne rajonin e nje bordi te perbashket planifikimi edhe nga keshilli i qarkut ne te cilen ndodhet toka; dhe permendja ne ate seksion e autoritetit te planifikimit lokal do te interpretohet ne perputhje m eketo rrethana.

(4) Ne paragrafin 16 te Skedules 13, permendja e autoritetit te planifikimit lokal do interpretohet—

- (a) ne lidhje me toke qe ndodhet ne Park Kombetar jashte nje qarku metropolitan, si permendje e autoritetit te planifikimit te qarkut; dhe
- (b) per toke ne vend tjeter, si autoritet i planifikimit te rrethit.

Seksionet 28 dhe
54

21.—(1) Sipas nenparagrafit (2), dispozitat e kesaj Skedule nuk zbatohen ne Londren e Madhe'

(2) Paragrafi 5(3) i kesaj Skedule (Aneksi) zbatohet ne Londren e Madhe dhe paragrafi 2(3) i Pjeses I dhe Pjeses II te Skedules (Aneksin) 2 zbatohet ne lidhje me zbatimin e perkohshem te paragrafit 7(1) te kesaj Skedule (Aneksi) ne qarqet metropolitane dhe ne Londren e Madhe.

ANEKSI (SKEDULA) 2:

Planet e Ndertimit - Dispozita Kalimtare

Pjesa I: Qarqet metropolitane

Vazhdimesia e planeve te strukturave, planeve lokale dhe plan;ve ekzistuese te zhvillimit

1.—(1) Sipas paragrafeve 2 dhe 3—

(a) plani i strukture

(b) cdo plan lokal, dhe

(c) cdo plan ekzistues zhvillimi,

i cili para hyrjes ne fuqi te ketij Akti ishte ne fuqi ne zonen e autoritetit te planifikimit lokal ne nje qark metropolitan (ose ne te dhe ne zona te tjera) do te vazhdoje te jete ne fuqi per ate zone te atij autoriteti derisa te behet publik nje plan i vetem ndertimi per ate zone sipas Kapitullit I te Pjeses II te ketij Akti ose, kur pjese te nje plani te vetem per zhvillim hyjne ne fuqi ne data te ndryshme, derisa cdo pjese e tij te kete hyre ne fuqi.

(2) Nje plan i cili vazhdon te jete ne fuqi si rrjedhim i ketij paragrafi, per sa kohe eshte ne fuqi, do te trajtohet si pjese e planit te zhvillimit per zonen ne fjale ose si i perfshire ne te per qellimet e ketij Akti, per cdo urdherese qe lidhet me planifikimin ne qytet dhe vend, Aktit te Kompensimit te Tokes 1961 [1961 c. 33.] dhe Aktin e Rrugeve 1980 [1980 c.66.].

(3) Ne kete paragraf "plan i vjeter i zhvillimit" eshte cdo plan i cili ishte ne fuqi ne zonen ne fjale menjehere para hyrjes ne fuqi te ketij Akti si rrjedhim i Aneksit (Skedules) 7 te Aktit te 1971 dhe paragrafit 18 te Aneksit (Skedules) 1 te Aktit te Qeverisjes Lokale 1985 [1985 c. 51.].

Revokimi e planit te strukturave

2.—(1) Kur ne zbatim te kapitullit I te Pjeses II te ketij Akti, Sekretari i Shtetit miraton te gjitha ose ndonje pjese te nje plani te vetem zhvillimi, ai mundet qe me urdher—

(a) te revokojte plotesisht ose pjeserisht nje plan strukture qe eshte ne fuqi sipas paragrafit 1, ose ne gjithe

zbatimin e tij ne zonen e autoritetit te planifikimit lokal ose ne zbatimin e tij ne pjese te kesaj zone; dhe
(b) si pasoje e kesaj te rregulloje planin sikurse e sheh ai te nevojshme ose te pershtatshme.

(2) Para se te nxjerre nje urdher bazuar ne kete paragraf, Sekretari i Shtetit do te keshillohet me autoritetin e planifikimit lokal per zonen me te cilen lidhet plani i vetem i zhvillimit.

(3) Deri ne momentin kur plani i strukture per nje zone ne qark metropolitan pushon se vepruari bazuar ne paragrafin 1 ose ne kete paragraf, ne kete zone do te zbatohet paragrafi 7(1) i Aneksit (Skedules) 1 duke hequr fjalet "ne nje qark jometropolitan".

Planet lokale deri ne fillimin e Kapitullit I te Pjeses II

3.—(1) Deri ne momentin e ardhjes ne fuqi te Kapitullit I te Pjeses II te ketij Akti, ne zonen e autoritetit te planifikimit lokal ne nje qark metropolitan do te zbatohen seksioni 30 dhe dispozitat e Kapitullit II te kesaj Pjese qe lidhen me pergatitjen, ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planeve lokale nga autoritetet e planifikimit lokal te cilet jane autoritete te planifikimit te rrethit si dhe seksioni 54(5). Sa me siper i nenshtrohet dispozitave te meposhtme te ketij paragrafi.

(2) Ne lidhje me ceshtjet te cilave iu referohet nenparagrafi (1) kushtet e meposhtme (te cilat lidhen me autoritetet e planifikimit te qarkut) nuk zbatohen per keshillat e rretheve metropolitane, keto jane seksionet 37, 38(4), 39(4) dhe (5)c, 46(2) deri (6), 47, 48(2) dhe 50(7).

(3) Nje keshill i rrethit metropolitan mundet ne cdo kohe—

(a) te beje propozime per pergatitjen e nje plani lokal ose ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e nje plani lokal te adoptuar nga ai ose nga keshilli i qarkut metropolitan dhe qe ishte ne fuqi ne zonen e atij autoriteti ne 1 prill 1986;

(b) me pelqimin e Sekretarit te Shtetit te beje propozime per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal te miratuar nga ai.

(4) Me ardhjen ne fuqi te ndonje pjese te Kapitullit I te Pjeses II te ketij Akti, cdo plan lokal ose propozim per ndryshim, anulimi ose zvendesim te planit lokal i cili—

(a) eshte pergatitur nga keshilli i rrethit metropolitan (ose nga ky keshill ne bashkepunim me nje ose me shume keshilla te tille); por

(b) nuk eshte adoptuar ose miratuar, do te quhet si i braktisur nga ky keshill ose keshilla.

(5) Paragrafi 1 zbatohet ne plane te cilet jane pergatitur ose ndryshuar si rrjedhim i ketij paragrafi sikurse ai zbatohet ne ato qe permenden ne ate paragraf.

Perfshirja e planit aktual lokal ne 1 plan te vetem te zhvillimi.

4.—(1) Plani i vetem i zhvillimit do te perfshije cdo plan lokal i cili eshte ne fuqi ne zonen ne fjale ne kohen kur plani i vetem i zhvillimit eshte duke u pergatitur por mund ti behen ndryshime, nese ka te tilla, te cilat mund te permenden ne Pjesen II te planit te vetem te zhvillimit.

(2) Plani i vetem i zhvillimit per sa i perket cdo plani te tille lokal duhet te tregojte shkallen, nese ka, te ndryshimeve te planit lokal qe do behen ne perputhje me Pjesen II te planit te vetem te zhvillimit.

(3) Ky paragraf nuk duhet te interpretohet se lejon t'i behen kundershime ndonje pjese te planit te vetem te zhvillimit qe perbehet nga dispozita te nje plani lokal qe nuk jane subjekt i ndryshimeve qe permenden ne nenparagrafin (1).

Publiciteti lidhur me planin lokal

5. Ne percaktimin e hapave qe duhet te ndermeren nga autoriteti i planifikimit lokal ose nga autoritetet e planifikimit lokal per te siguruar qellimet e seksioneve 13(1)(a) deri (c) ose seksioni 23(a) deri (c) lidhur me propozimet e bera per nje plan te vetem zhvillimi, autoriteti ose autoritetet mundet qe ne baze te ketyre kushteve, dhe Sekretari i Shtetit ne baze te te seksionit 13(6), te marrin parasysh cdo hap te ndermarre nga autoriteti ose autoritetet per te siguruar keto qellime per propozime te njejta ose te ngjashme te bera ne lidhje me nje

plan lokal.

Propozime ne pritje nga keshilli i qarkut metropolitan

6. Ne rastet kur para 1 prillit 1986 Sekretari i Shtetit udhezoi se cdo plan lokal ose propozim per ndryshim, anulim ose zvendesim te nje plani lokal qe eshte pergatitur nga keshilli i qarkut metropolitan para 1 prillit 1986 por qe nuk ishte adoptuar apo miratuar, nuk do te hyje ne fuqi vecse atehere kur eshte aprovuar nga Sekretari, ai do te vazhdoje t'a shqyrtoje planin ose propozimet dhe do te jape vendimin e tij lidhur me to, njelloj sikur plani ose propozimet te ishin pergatitur ose dorezuar nga keshilli i qarkut metropolitan zona e te cilit preket nga plani ose propozimet ose kur preken zonat e dy ose me shume keshillave te tille, njelloj sikur plani ose propozimet te ishin nje plan i perbashket ose propozim i pergatitur nga keto keshilla.

Pjesa II: Londra e Madhe

Vazhdimi i planit te zhvillimit te Londres se Madhe, planeve lokale dhe planeve ekzistuese te zhvillimit

1.—(1) Sipas paragrafeve 2 dhe 3—

(a) plani i zhvillimit te Londres se Madhe,

(b) cdo plan lokal; dhe

(c) cdo plan i vjeter zhvillimi

i cili menjehere para hyrjes ne fuqi te ketij Akti ishte ne fuqi ne zonen e autoritetit te planifikimit lokal te Londres se Madhe (ose ne te dhe ne zona te tjera), do te vazhdoje te jete ne fuqi per ate zone nen ate autoritet derisa nje plan i vetem zhvillimi per kete zone te filloje te veproje sipas Kapitullit I te Pjeses II te ketij Akti ose kur pjese te nje plani te vetem zhvillimi fillojne dhe veprojne ne data te ndryshme derisa cdo pjese e tij fillon te veproje.

(2) Nje plan i cili vazhdon te jete ne fuqi si rrjedhim i ketij paragrafi do te trajtohet si plan zhvillimi per zonen ne fjale ose si i perfshire ne te per qellimet e ketij Akti, per cdo urdherese qe lidhet me planifikimin ne qytet dhe vend, Aktit te Kompensimit te Tokes 1961 [1961 c. 33.] dhe Aktin e

Rrugeve 1980 [1980 c.66].

(3) Ne kete paragraf "plan i vjeter zhvillimi" ka te njejtin kuptim si ne paragrafin 1 te Pjese I te kesaj Skedule (Aneksi).

Anullimi i planit te zhvillimit te Londres se Madhe

2.—(1) Kur ne baze te Kapitullit I te Pjese II te ketij Akti Sekretari i Shtetit miraton te gjithë ose ndonje Pjese I te nje plani zhvillimi ai mund te urdheroje—

- (a) anulimin e plote ose te pjesshem te Planit e zhvillimit te Londres se Madhe ose ne pjese te zones se autoritetit lokal te planifikimit ose ne te gjithë zonen; dhe
- (b) kryerjen e ndryshimeve ne kete plan qe rrjedhin si rezultat i kesaj dhe qe sipas tij jane te nevojshme ose te pershtatshme.

(2). Para nxjerrjes se nje urdhri ne baze te ketij paragrafi, Sekretari i Shtetit do te keshillohet me autoritetin e planifikimit lokal ne te cilin ndodhet zona qe lidhet me planin e vetem te zhvillimit.

(3) Deri ne momentin kur Plani i zhvillimit te Londres se Madhe pushon se vepruari ne nje zone bazuar ne paragrafin 1 ose kete paragraf, paragrafi 7(1) i Aneksit (Skedules) 1 do te zbatohet ne ate zone—

- (a) duke hequr fjalet "ne nje qark jometropolitan"; dhe
- (b) me zvendesimin e planit te struktures me fjalën Plan.

Studimet dhe planet lokale

3.—(1) Deri ne hyrjen ne fuqi te Kapitullit I te Pjese II te ketij Akti ne zonen e autoritetit te planifikimit lokal ne Londre ne Madhe, do te zbatohen ne lidhje me kete zone, seksioni 30 dhe paragrafet 4 deri 16 te kesaj Pjese te kesaj Skedule (Aneksi) dhe seksionet 49, 51 dhe 53 (me kusht qe keto seksione te kene te bejne me pergatitjen, ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planeve lokale nga autoritetet e planifikimit lokal te cilate jane keshillat e lagjeve ne Londer) dhe eskioni 54(5), por me kusht zbatimin e kushteve te meposhtme te ketij paragrafi.

(2) Ceshtjet qe do te shqyrtohen ose do te mbahen per rishikim nga keshilli i lagjes ne Londer ne baze te sekionit 30 jane ato ceshtje qe permenden ne ate seksion dhe qe nuk u shqyrtohen apo u mbajten per rishikim nga Keshilli i Londres se Madhe.

(3) Ne zbatimin si rrjedhim i ketij paragrafi, seksioni 53(2)(f) do te kete fuqi duke zvendesuar respektivisht permendjen qe i behet seksionit 39(2)(a) dhe seksionit 39(5)(a) ose 40(2)(a) me permendjen perkatesisht te paragrafeve 8(1)(a) dhe (2).

(4) Me hyrjen ne fuqi ne ndonje zone te Kapitullit I te Pjese II te ketij Akti, cdo plan lokal ose propozim per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal i cili—

- (a) eshte pergatitur nga nje keshill i lagjes ne Londer ose nga nje keshill i tille ne bashkepunim me nje ose me shume keshilla te tille; por
- (b) nuk eshte adoptuar ose miratuar, do te konsiderohet si i braktisur nga ky keshill ose keshilla.

(5) Paragrafi 1 do te zbatohet per planet te cilet jane pergatitur ose ndryshuar ne vazhdim te ketij paragrafi.

4.—(1) Nje keshill lagjeje ne Londer mundet qe ne cdo kohe, nese e shohin te mundshme, te pergatise nje plan lokal per te gjithë ose nje pjese te lagjes (me perjashtim te te gjithë ose nje pjese zone veprimi te G.C.L. qe eshte brenda kuptimit te ketij paragrafi).

(2) Per te njejten zone, mund te pergatiten plane te ndryshem lokale per qellime te ndryshme.

5.—(1) Ne kete paragraf—

- "zone veprimi" eshte cdo zone qe paraqitet nga Plani i Zhvillimit te Londres se Madhe si nje zone qe do te perdoret per zhvillim, rizhvillim ose permiresim te plote si nje e tere, per te cilen Sekretari i Shtetit ka udhezuar te trajtohet si zone veprimi, dhe
- "zone veprimi GCL" eshte nje zone veprimi per te cilen eshte theksuar ne Planin e Zhvillimit te Londres se Madhe se ishte Keshilli i Londres se Madhe dhe jo nje keshill lagjeje ne Londer qe do te pergatise planin lokal per ate zone.

zone.

(2) Sapo te behet e mundeshme, ne rastin e cdo zone veprimi me perjashtim te nje zone veprimi GCL—

(a) nese ajo eshte plotesisht e perfshire ne nje lagje ne Londer, keshilli i asaj lagjeje do te pergatise planin lokal per ate zone, dhe

(b) nese jo, keshilli i cdo lagjeje ne Londer qe ka pjese te kesaj zone duhet te pergatise nje plan lokal per ate zone,

por ky paragraf nuk kerkon qe nje keshill te beje perseri pune qe e ka bere me pare.

(3) Kur nje keshilli i kerkohet nga ky paragraf te pergatise nje plan lokal, ai duhet te ndermarre hapat per adoptimin e ketij plani.

6.—(1) Pa cenuar dispozitat e meparshme, keshilli i nje lagje ne Londer, nese Sekretari i Shtetit i jep nje udhezim qe lidhet me ndonje zone te Londres se Madhe, do te pergatise per ate zone sapo te behet e mundur, nje plan lokal me natyre te tille sikurse eshte specifikuar ne urdher dhe do te ndermare hapa per adoptimin e planit.

(2) Sekretari i Shtetit duhet te keshillohet me keshillin para se ti jape atij udhezim ne baze te ketij paragrafi.

7.—(1) Ky paragraf zbatohet ne cdo plan lokal te pergatitur ne baze te Aneksit (Skedules) 4 te Aktit te vitit 1971 ose te kesaj Skedule (Aneksi) nga autoriteti i planifikimit lokal dhe ne kete paragraf "autoriteti" eshte autoriteti qe pergatit planin lokal.

(2) Plani perbehet nga nje harte dhe nje shkrese dhe—

(a) duhet te paraqese me aq hollesi propozimet per zhvillim dhe perdorime te tjera te tokes ne zonen per te cilen eshte pergatitur plani sikurse shikohet e pershtatshme nga autoriteti, ose per cdo pershkrim te zhvillimit ose perdorime te tjera te tokes (perfshire per te dy rastet masa te cilat autoriteti i quan te pershtatshme per permiresimin e ambjentin fizik dhe menaxhimin e trafikut); dhe

(b) permban ceshtje te tilla sikurse kerkohet.

(3) Plani duhet te permbaje ose te shoqerohet nga grafike,

vizatime dhe materiale pershkrues sikurse autoriteti i quan te pershtatshme per te shpjeguar ose ilustruar propozimet ne plan, ose sikurse mund te jete rene dakort; dhe grafike, vizatime dhe materiale pershkrues te tilla do te trajtohen si pjese te planit.

(4) Ne formulimin e propozimeve ne plan autoriteti do te—

(a) siguroje qe propozimet perputhen pergjithesisht me Planin e Zhvillimit te Londres se Madhe, dhe

(b) marre parasysh cdo informacion i cili sipas tyre eshte i rendesishem, mund te bihet dakort, ose per te cilin Sekretari i Shtetit ne cdo rast te vecante mund ta udhezoje autoritetin qe ta marre parasysh.

(5) Para se t'i jape udhezim autoritetit ne baze te ketij paragrafi, Sekretari i Shtetit do te keshillohet me autoritetin.

8.—(1) Kur nje keshill i lagje sne Londer propozon te pergatise nje plan lokal, keshilli duhet te ndermarre hapa te tille te cilet sipas mendimit te tij sigurojne—

(a) njoftim te hapur ne cdo lagje e Londres qe preket nga plani per cdo ceshtje qe ka dale prej studimit te bere ne baze te seksionit 6 te Aktit te 1971-es ose seksionit 30 te ketij Akti (perfshire cdo studim te perbashket) dhe ceshtjeve qe propozohen te futen ne plan;

(b) qe personat qe mendohet se mund te deshirojne tu jepet mundesia per te prezantuar para keshillit per keto ceshtje, jane njoftuar se nje mundeis e tille ekziston; dhe

(c) qe personave te tille u jepet mundesi e pershtatshme per te prezantuar para keshillit; dhe keshilli do te marre parasysh cdo prezantim te bere para tyre ne periudhen e caktuar.

(2) Pas pergatitjes se planit lokal, keshilli para se t'a adoptoje ose dorezoje ate per miratim sipas paragrafit 10, do te kete kopje te planit te gatshme per inspektim ne zyren e tij dhe i dergon nje kopje Sekretarit te Shtetit.

(3) Cdo kopje e gatshme per inspektim sikurse kerkohet nga nenparagrafi (2) do te shoqerohet nga nje deklarate e afatit brenda te cilit keshillit qe ka pergatitur planin mund t'i behen verejtje per planin lokal; dhe kopja derguar Sekretarit te Shtetit do te shoqerohet nga nje deklarate qe permban hollesi—

- (a) te hapave qe ka ndermare keshilli qe pergatit planin per te vepruar ne perputhje me paragrafin (1), dhe
- (b) keshillimet e keshillit me persona te tjere dhe marrja parasysh e pikpamjeve te tyre.

9.—(1) Per qellime te marrjes parasysh te verejtjeve ndaj planit lokal, autoriteti i planifikimit lokal mund, dhe ne rastin e verejtjeve te bera ne perputhje me rregullat, te nise nje shqyrtim lokal ose hetime te tjera te cilat do te paraqiten para nje personi te emeruar nga Sekretari i Shtetit, ose kur bihet dakort, nga vete autoriteti, dhe—

- (a) nenseksionet (2) dhe (3) te seksioneve 250 te Aktit te Qeverisjes Lokale te 1973 [1972 c. 70.] (pushteti per te mbledhur dhe shqyrtuar deshmitaret) do te zbatohen per investigimin e bere ne baze te ketij paragrafi sikurse ato zbatohen per nje investigim te bere ne baze te atij seksioni;
- (b) Akti i Gjyqeve dhe Investigimeve i 1971 [1971 c. 62.] zbatohet ne shqyrtimin lokal ose hetimeve te tjera te mbajtura sipas ketij paragrafi sikurse kjo zbatohet ne nje shqyrtimi ligjor qe behet nga Sekretari i Shtetit, por me kusht qe ne seksionin 12(1) te ketij Akti (deklaratat e arsyes per vendime) referimi qe i behet vendimit te marre nga Sekretari i Shtetit te lexohet si reference ndaj nje vendimi te marre nga autoriteti lokal.

(2) Rregullat e bera per qellim te nenparagrafit (1) mund—

- (a) te parashikojne emerimet dhe eksperiencen per tu kualifikuar te personave qe do kryejne nje shqyrtim lokal ose hetime te tjera ne baze te atij nenparagrafi, perfshire kushte qe mundesojne Sekretarin e Shtetit te udhezaje autoritetin e planifikimit lokal te emeroje nje person te vecante, ose nje person nga nje liste e vecante ose klase personash;
- (b) te parashikojne pagesen dhe dieten ditore te personit te emeruar per kete qellim.

(3) Kerkesa per nje investigim lokal ose hetim nuk do te zbatohet nese te gjitha personat qe kane paraqitur verejtje provojne me shkrim se nuk duan te paraqiten.

10.—(1) Pas perfundimit te periudhes te dhene per te bere verejtje ndaj nje plani lokal ose, nese nje verejtje e tille eshte bere gjate kesaj periudhe, pas shqyrtimit te verejtjeve,

autoriteti i planifikimit lokal mundet, bazuar ne paragrafin 11 dhe nenparagrafet (2), (3) dhe (4), me vendim te adoptoje planin ose sikurse eshte paraqitur fillimisht ose te modifikuar pasi ka marre parasysh—

- (a) verejtjet e bera;
- (b) cdo verejtje tjeter qe i eshte bere planit;
- (c) te cdo mendimi tjeter qe per autoritetin duket se qendron.

(2) Kur—

- (a) verejtja ndaj planit behet nga Ministri i Bujqesise, Peshkimit dhe Ushqimit (ne kete paragraf "Ministri"); dhe
- (b) autoriteti i planifikimit lokal nuk propozon te ndryshoje planin ne menyre qe te merret parasysh verejtja, autoriteti—
 - (i) i dergon Sekretarit te Shtetit hollesite e verejtjes se Ministris se bashku me nje shpjegim te arsyeve te tij per te mos ndryshuar planin ne menyre qe te marre parasysh verejtjen; dhe
 - (ii) nuk do ta adoptoje planin derisa Sekretari i Shtetit e autorizon te beje adoptimin.

(3) Autoriteti i planifikimit lokal nuk do ta adoptoje planin lokal nese ky nuk perputhet ne pergjithesi me Planin e Zhvillimit te Londres se Madhe.

(4) Pasi kopjet e planit lokal i dergohen Sekretarit te Shtetit dhe para se plani te jete adoptuar nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit mund te udhezaje qe plani nuk do hyje ne fuqi derisa te jete miratuar prej tij.

(5) Ne baze te nenparagrafit (6) kur hollesite e nje verejtjeje ndaj nje plani lokal te bera nga Ministri i jane derguar Sekretarit te Shtetit sipas nenparagrafit (2), eshte detyre e Sekretarit te Shtetit te jape udhezime sipas nenparagrafit (4).

(6) Sekretari i Shtetit nuk ka nevojte te jape kete udhezim nese eshte i bindur se Ministri nuk ka me kundersizim per planin.

(7) Kur Sekretari i Shtetit jep udhezim sipas nenparagrafit (4), autoriteti i planifikimit lokal i dorezon atij planin per miratim, dhe—

- (a) Sekretari i Shtetit mund, pasi te shqyrtoje planin, ose ta

- miratoje ate (te tere ose pjeserisht dhe me dhe pa ndryshime ose rezerva) ose ta refuzoje ate;
- (b) kur shqyrton planin, Sekretari i Shtetit mund te marre parasysh ceshtje te cilat ai i mendon se jane te rendesishme per planin, pavaresisht nese ato ishin marre ose jo parasysh ne planin qe iu dorezua atij;
- (c) sipas paragrafit (d), kur Sekretari i Shtetit shqyrton planin dhe nuk vendos ta refuzoje ate, ai para se te vendose miratimin ose jo te tij—
- (i) do te konsideroje verejtjet qe i jane bere planit, me kusht qe ato te jene ne perputhje me legjislacionin;
- (ii) do t'i jape mundesine nje personi verejtjet e te cilit nuk jane terhequr, te paraqitet dhe te degjohet nga nje person i emeruar prej tij per kete qellim, dhe
- (iii) nese mbahet nje investigim lokal ose hetim, i jep te njejten mundesi autoritetit dhe nje personi te tille sikurse ai e mendon te pershtatshme;
- (d) para e te vendose per miratimin e planit, Sekretari i Shtetit nuk eshte i detyruar te konsideroje verejtje qe i behen planit nese keto verejtje jane marre ne shqyrtim nga autoriteti, ose te filloje shqyrtim ose hetim per ndonje veretje nese nje shqyrtim ose hetim i tille eshte bere ne instancen e autoritetit;
- (e) pa cenuar paragrafin (c), kur shqyrton planin Sekretari i Shtetit mund te keshillohet me ose te marre parasysh pikpamjet e autoritetit lokal ose personave te tjere, por nuk eshte i detyruar te keshillohet me autoritet ose person tjetër, ose, me perjashtim te rasteve qe bazohen ne ate paragraf, te jape mundesi per verejtjesh ose shfaqje mendimesh, ose te mbaje nje shqyrtim lokal ose hetim; dhe
- (f) pas dhenies se udhezimit, autoriteti nuk do te kete pushtet ose detyre te metejshe me te kryeje shqyrtim lokal ose hetim bazuar ne paragrafin 9.

(8) Kur ka konflikt midis dispozitave te nje plani lokal qe eshte adoptuar ose miratuar sipas ketij pragrafi ose sipas seksionit 14 te Aktit te 1971 dhe kushteve te Planit e Zhvillimit te Londres se Madhe, kushtet e e planit lokal do te mbizoterojne mbi te tjerat.

11.—(1) Nese gjate shqyrtimit te deklarates te dorezuar dhe ceshtjeve te perfshira ne nje plan lokal (te perbashket ose tjetër) te pergatitur sipas Aneksit (Skedules) 4 te Aktit te 1971 ose sipas kesaj Skedule (Aneksi) dhe informacioneve te tjera te

derguara nga autoriteti qe pergatiti planin (ose sipas rastit, autoritetet qe u bashkuan per pergatitjen e tij), Sekretari i Shtetit nuk bindet se qellimet e paragrafit 8(1)(a) deri (c) jane plotesuar si duhet nga hapat e ndermare per kete arsye nga autoriteti ose autoritetet, Sekretari brenda 21 ditesh nga marrja e deklarates udhezoi se nuk do te merren hapa te metejshe me per adoptimin e planit pa marre veprime te metejshe qe ai i specifikon se duhet te merren ne menyre qe te plotesohen me mire ato qellime dhe ai te jete i bindur se jane ndermare veprime te tilla.

(2) Autoriteti i planifikimit qe ka marre udhezime nga Sekretari i Shtetit ne zbatim te ketij paragrafi do te—

- (a) terheqe menjehere kopjet e planit lokal qe u pergatin per inspektim sikurse e kerkon paragrafi 8; dhe
- (b) ne rastin kur verejtjet ndaj planit behen nga ndonje person, ta njoftoje ate se Sekretari i Shtetit ka dhene nje udhezim te tille.

12.—(1) Autoritetit i planifikimit lokal mundet qe ne cdo kohe te beje propozime per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal ne fjale, dhe me pelqimin e Sekretarit te Shtetit mundet te beje propozime per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal te miratuar prej tij.

(2) Pa cenuar nenparagrafin (1), autoriteti i planifikimit lokal, nese Sekretari i Shtetit jep udhezim per planin ne fjale ose plan tjetër te miratuar prej tij, sapo te jete praktikisht e mundeshme pergatit propozime te llojit te permendur ne udhezim dhe keto propozime jane propozime per ndryshim, anulim ose zvendesim te planit.

(3) Ne nenparagrafin (1) dhe (2) "plani lokal ne fjale" eshte plani lokal i adoptuar nga autoriteti ose i adoptuar nga Keshilli i Londres se Madhe dhe qe eshte ne fuqi ne zonen e autoritetit ne 1 prill 1986.

(4) Dispozitat e paragrafeve 7(4) dhe (5), 8, 9 dhe 10 zbatohen kur behen propozimet per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal bazuar ne kete paragraf dhe ndryshimeve te planit lokal qe propozohet, sikurse zbatohen ne lidhje me pergatitjen e planit lokal bazuar ne kete Skedule dhe te nje plani lokal te pergatitur bazuar ne te.

Planet e perbashketa

13.—(1) Kushtet e meposhtme te ketij paragrafi kane efekt aty ku dy ose me shume autoritete pergatisin planin lokal se bashku.

(2) Autoritetet e planifikimit lokal do te ndermarrin hapa te perbashket qe sipas mendimit te tyre do te sigurojne—

- (a) qe ne zonat e tyre t'i behet publicitet i pershtatshem ceshtjeve qe propozohet te futen ne plan;
- (b) qe personat qe mund te pritjet se duan te kene mundesine te bejne prezantime ndaj autoriteteve, jane njoftuar se kane te drejte te bejane kete prezantim; dhe
- (c) qe personave te tille u jepet mundesi e pershtatshme per te bere nje prezantim te tille.

(3) Nenparagrafi (1)(b) dhe (c) i paragrafit 8 nuk do te zbatohet kur behet fjale per plane te perbashketa dhe permendja ne nenparagrafin (3) te atij paragrafi e nenparagrafit (1) te atij paragrafi, dhe permendja ne paragrafin 11(1) te nenparagrafit (1)(a) deri (c) te paragrafit 8, te dyja do te perfshijne permendjen e nenparagrafit (2) te ketij paragrafi.

(4) Secili prej autoriteteve te planifikimit lokal prej te cileve eshte pregatitur nje plan i perbashket per cdo pjese te Londres se Madhe do te kete detyren qe i vishet nga nenparagrafi (2) i paragrafit 8 per te bere kopje te planit te vlefshme per inspektim, dhe verejtjet per planin mund ti behen cdo njeres prej ketyre autoriteteve, dhe deklarata e cila sipas nenparagrafit (3) te atij paragrafi qe duhet te shoqeroje kopjet e planit te vlefshme per inspektim, do te theksoje se mund te behen verejtje te tilla.

(5) Ne lidhje me propozime te perbashketa sipas paragrafit 12(1) per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal, permendja ne paragrafin 12(4) e paragrafit 8 do te perfshije permendje te ketij paragrafi.

14.- Secili prej autoriteteve lokale qe ka pergatitur planin e perbashket lokal do te adoptoje planin bazuar ne paragrafin 10(1) dhe keto autoritete mund te veprojne keshtu per cdo pjese te ciles i referohet plani por per cdo ndryshim qe do te adoptohet duhet rene dakort midis te gjithë ketyre autoritete.

15. Kur nje plan lokal eshte pergatitur bashkarisht, pushteti per te bere propozime nen paragrafin 12(1) per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit mund te ushtrohet nga cdo autoritet qe pergatiti ate lidhur me zonat e tyre perkatese dhe Sekretari i Shtetit mundet, bazuar ne paragrafin 12(2) te udhezaje secilen prej tyre te beje nje propozim te tille qe lidhet me zonat e tyre perkatese.

16. Data qe caktohet sipas seksionit 53(5) per hyrjen ne veprim te nje plani lokal te pergatitur bashkerisht nga dy ose me shume autoritete te planifikimit lokal ose per ndryshimin, anulimin ose zvendesimin e planit lokal si rrjedhim i propozimeve te pergatitura, do te jete nje e vetme e pergatitur bashkerisht nga ato autoritete dhe do te specifikohet ne rezolutat e tyre perkatese per adoptimin e planit ose propozimeve.

Perfshirja ei planit aktual ne planin e vetem te zhvillimit

17.—(1) Plani i vetem i zhvillimit do te perfshije cdo plan lokal qe eshte ne fuqi per zonen ne fjale ne kohen kur eshte duke u pergatitur plani i vetem i zhvillimit por te cilave mund t'i behen ndryshime, nese ka te tilla sikurse mund te jete percaktuar ne Pjesen II te planit te vetem te zhvillimit.

(2) Plani i vetem i zhvillimit duhet qe per nje plan te tille lokal te tregojte masen, nese ka te tilla, te ndryshimeve qe mund t'i behen atij ne perputhje me Pjesen II te planit te vetem te zhvillimit.

(3) Ky paragraf nuk duhet te interpretohet se mundeson t'i behen verejtje pjeseve te planit te vetem te zhvillimit qe perbehet nga dispozita te nje plani lokal ndaj te cilave nuk mund te zbatohen ndryshimet qe permenden ne nenparagrafin (1).

Publiciteti per planin lokal

18. Ne percaktimin e hapave qe duhet te ndermeren nga autoriteti i planifikimit lokal ose autoritetet e planifikimit lokal per te siguruar qellimet e seksionit 13(1)(a) deri (c) ose seksioni 23(3)(a) deri (c) lidhur me propozimet e bera per

planin e vetem te zhvillimit, autoriteti ose autoritetet mundet qe sipas ketyre kushteve, dhe Sekretari i Shtetit mundet qe ne baze te seksionit 13(6) te marrin parasysh cdo hap te ndermare nga autoritetet ose autoriteti per te siguruar ato qellimi qe lidhen me te njejtin propozim ose te ngjashem me te, te bera per nje plan lokal.

Pjesa III: Planet ekzistuese te zhvillimit

Hyrje

1. Ne kete Pjese te Aneksit (Skedules) "plan i vjeter zhvillimi" eshte plani i zhvillimit ndaj te cilit u zbatuan menjehere para hyrjes ne fuqi te ketij Akti, paragrafi 2 i Aneksit (Skedules) 7 te Aktit te 1971-it (vazhdimi i qenies ne fuqi te planeve te zhvillimit para se planet e strukture te beheshin operative).

Vazhdimi i qenies ne fuqi i planit te vjeter te zhvillimit

2. Cdo plan i vjeter zhvillimi i cili menjere para fillimit te zbatimit te ketij Akti ishte ne fuqi ne cdo rreth, sipas kushteve te kesaj Pjese te Aneksit (Skedules), do te vazhdoje te jete ne fuqi per ate rreth dhe do te trajtohet si i perfshire ne planin e zhvillimit per ate rreth per qellimet e ketij Akti, e cdo akti qe lidhet me planifikimin ne qytet dhe ne vend, e Aktit te Kompensimit te Tokes 1961 [1961 c. 33] dhe Aktit te Rrugeve 1980 [1980 c. 66].

Plane te tjere qe mbizoterojne mbi planet e vjeter te zhvillimit

3. Sipas dispozitave te meposhtme te kesaj Pjese te kesaj Skedule (Aneksi) ku si rrjedhim i paragrafit 2, plani i vjeter i zhvillimi per cdo rreth trajtohet si i perfshire ne planin e zhvillimit per ate rreth—

- (a) nese ka konflikt ndermjet dispozitave te tij dhe atyre te planit te strukture per ate rreth, ose ne rastin e Londres se Madhe, kushtet e planit te strukture te Planit te Zhvillimit te Londres se Madhe, ky Plan do te mbizoteroje ndaj tij per qellimet e Pjeseve III, V, VI, VII,

VIII dhe IX te ketij Akti dhe te Aktit te Planifikimit 1990 [1990 c. 9.] (Zonat e Ndertesave te Listuara dhe te Ruajtjes) dhe Aktit te Planifikimit (Substancat e Rrezikshme) 1990 [1990 c. 10.]; dhe

- (b) nese ka konflikt ndermjet ndonje prej kushteve te tij dhe atyre te planit lokal, kushtet e planit lokal do te mbizoterojne per keto qellime.

Hartat e autorizimit te rrugeve

- Seksionet 55, 107, dhe 114 4. Kur menjehere para fillimit te zbatimit te ketij Akti, harta e autorizimit te rrugeve e pergatitur ne zbatim te Rregullimeve per Planifikimin ne Qytet dhe ne Vend (planet e zhvillimit) 1965 [S.I. 1965/1453] ose Rregullimeve per Planifikimin ne Qytet dhe ne Vend (planet e zhvillimit per Londren e Madhe) 1966 [S.I. 1966/48], u trajtua per qellimet e Aktit te 1971-it si e adoptuar per plan lokal per nje rreth nga autoriteti i planifikimit lokal, ajo do te vazhdoje te trajtohet si i tille.

Planet e zhvillimit per qellime kompensimi

5. Kur nje rreth nuk ka nje plan lokal ne fuqi, atehere per secilin nga qellimet e Aktit te Kompensimit te Tokes te 1961-it—
- (a) plani i zhvillimit ose plani aktual i zhvillimit per ate distrikt do te konsiderohet secili nga planet e meposhtem i cili kur diskutohet dhenia e lejes per planifikim mendohet si me i favorshmi per pronarin te cilit i blihet toka per kete qellim, keto plane jane plani i strukture ose sipas rastit, Plani i zhvillimit te Londres se Madhe per ate pjese qe lidhet me rrethin dhe cdo ndryshim qe i behet atij sebashku me njoftimin e Sekretarit te Shtetit per miratimin e planit dhe ndryshimeve, dhe plani i vjeter i ndryshimit;
- (b) toka qe ndodhet ne nje zone qe percaktohet ne planin aktual te zhvillimit si zone e zhvillimi te rendesishem do te konsiderohet se ndodhet ne secilen prej zonave te meposhtme te cilat mendohet se cojne ne supozimet qe permenden ne paragrafin (a), perkatesisht cdo zone plotesisht ose pjeserisht brenda atij rrethi qe eshte zgjedhur nga plani i strukture ose sipas rastit nga Plani i zhvillimit te Londres se Madhe si zone veprimi

dhe zona e percaktuar ne kete menyre ne planin e vjeter te zhvillimit.

Mosvazhdimi i funksionimit te planit te vjeter te zhvillimit pas adoptimit te planit lokal

6. Sipas paragrafit 8, me adoptimin ose miratimin e planit lokal ne baze te seksionit 43 ose 45 ose paragrafit 10 te Pjeses II te kesaj Skedule (Aneksi), nuk do te kete me efekt ajo pjese e planit te vjeter te zhvillimit qe lidhet me zonen ku do zbatohet plani lokal.

7. Sekretari i Shtetit me urdher mund te udhezaje mbetjen ne fuqi te kushteve te te planit te vjeter te zhvillimit ne ato zona qe mbulon plani lokal.

8. Nese Sekretari i Shtetit nxjerr nje urdher ne baze te paragrafit 7, kushtet e planit te vjeter te zhvillimit te permendura ne urdher do te vazhdojne te jene ne fuqi deri ne masen qe permendet ne urdher.

9. Sipas paragrafit 10, Sekretari i Shtetit mund te anulloje plotesisht ose pjeserisht me urdher planin e zhvillimit qe vazhdoi te ishte ne fuqi ne baze te kesaj Skedule per zona te autoritetit te planifikimit lokal ne te cilat zbatohet plotesisht ose pjeserisht ky plan dhe i ben amendamentet e duhura planit lokal per kete arsye.

10. Para se te nxjerre nje urdher bazuar ne paragrafin 7 ose 9 per planin e zhvillimit, Sekretari i Shtetit do te keshillohet me autoritetin e planifikimit lokal per zonen te cilen e mbulon plani.

ANEKSI (SKEDULA) 3:

Zhvillimet qe nuk perbejne zhvillime te reja

Pjesa I:

Zhvillime qe nuk renditen per kompesim sipas s. 114

1. Kryerja e—

- (a) e rindertimit, aq here sa mund te linde nevoja e cdo ndertese qe ekzistonte ne 1 korrik 1948, ose e cdo ndertese qe ekzistonte para asaj date por qe u prish ose shemb pas 7 janarit 1937 perfshire riparimin e cdo demtimi lufte qe mbeshtetej ne kete ndertese;
- (b) rindertimit aq here sa mund te linde nevoja e cdo ndertese te ngritur pas 1 korrikut 1948 qe ka ekzistuar ne nje date te dhene;
- (c) kryerja e punimeve per mirembajtje, permiresim ose ndryshim e cdo ndertese, te cilat—
 - (i) prekin vetem interiorin e nderteses ose qe nuk ndikojne materialisht ne pamjen e jashtme te godines, dhe
 - (ii) jane punime qe riparojne demet e luftes, dhe per aq kohe sa volumi i nderteses origjinale nuk kalohet shume.

2.- Perdorimi i dy ose me shume godinave te ndara te nderteses e cila ne nje date materiale eshte perdorur si nje godine e vetme.

Pjesa II:

Zhvillime qe renditen per kompesim sipas s. 114

3.- Zgjerimi, permiresimi ose ndryshime te tjera aq here sa mund te kerkohet e cdo ndertese qe permendet ne paragrafin 1(a) ose (b) ose cdo ndertese qe zvendesohet nga nje ndertese duke kryer veprime qe permenden ne ate paragraf, per aq kohe sa madhesia e nderteses origjinale nuk rritet ose zgjerohet ndjeshem.

4.—(1) Ndertimi ne toke e cila ne nje date materiale eshte perdorur per bujqesi ose pyllezim e nje ndertese ose i veprimeve te tjera qe kerkohen te behen per qellimet e atij perdorimi.

(2) Nenparagrafi (1) nuk zbatohet per veprimet per ngritje, zmadhim, permiresim ose ndryshim te godines ose ndertesas te perdorura—

- (a) per treg, kopesht ose dru; ose
- (b) per qellime te tjera qe nuk lidhen me veprimtari blegtorale ose me kultivimin ose prerjen e pemeve.

5.- Nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve ne toke te mbajtur ose te zene me toke te perdorur per bujqesi dhe qe kerkohet per kete qellim, perfshire—

- (a) pleherimin e tokes qe perdoret ne kete menyre, dhe
- (b) mirembajtja, permiresimi ose ndryshimi i ndertesave ose punimeve ne toke te cilat ane zene ose perdorur per keto qellime.

6.- Ne rastin e nje ndertese ose toke tjeter e cila—

- (a) ne nje date materiale u perdor per qellime qe jane brenda klasave te pergjithshme te permendura ne Urdherin per planifikimin ne qytet dhe ne vend (Klasat e perdorimit per qellime te skedules se trete) 1948 [S.I. 1948/955], ose
- (b) eshte zene gjate gjithë kohes prej 1 korrikut 1948 u perdor per here te fundit per kete qellim (me perjashtim te para 7 janarit 1937), perdorimi i asaj ndertese ose toke per cdo qellim tjeter qe bie brenda te njejetes klase te eprgjitshme.

7. Ne rastin e ndertesave ose tokes te cilat ne nje date materiale ishin te zena nga nje person i cili perdori vetem nje pjese te tyre per nje qellim te caktuar, perdorimi per kete qellim i cdo pjese shtese te nderteses ose tokes qe nuk kalon—

- (a) 1/10 e vellimit kubik te pjese se nderteses te perdorur per kete qellim ne 1 korrik 1948 ose nese me vone, ditën kur ndertesa filloi te perdorej per kete qellim, ose
- (b) 1/10 e zones se tokes te perdorur ne ate date,

ne varesi te rastit.

8. Zbrazja e mbeturinave te dala nga perpunimi i mineraleve ne toke te perfshire ne vendin i cili ne nje date te dhene u perdor per ate qellim deri ne masen qe mund te kerkohet per perpunimin e materialeve.

Pjesa III: Dispozita shtese

9. Kur pas 1 korrikut 1948—

- (a) jane ngritur ndertesa ose kryer punime ose eshte lejuar perdorimi i tokes, dhe
- (b) kushtet e vena ne baze te Pjeses III te ketij Akti qe kufizojne periudhen per te cilen keto ndertesa ose punime mund te ruhen ose perdorimi i tyre mund te vazhdoje, kane efekt ne ato ndertesa ose punime ose perdorime

kjo Skedule (Aneks) nuk vepron me perjashtim te periudhes te percaktuar ne ate kusht.

10.—(1) Cdo permendje ne kete Skedule (Aneks) e vellimit kubik te nderteses do te interpretohet si permendje e ketij vellimi kubik qe eshte vleresuar nga matje te jashtme.

(2) Per qellimet e paragrafit 1 dhe 3 vellimi kubik i nje ndertese rritet ose kalohet ndjeshem—

- (a) ne rastin e banesave nese eshte rritur ose kalon 1/10 ose 533.4 meter kub, ne varesi te faktit se cila nga keto vlera eshte me e madhe; dhe
- (b) ne cdo rast tjeter nese eshte rritur ose kalon 1/10-at.

11. Per qellimet e paragrafit 3—

- (a) ngritja e nderteses shtese qe do te perdoret sebashku me ndertesën origjinale ne token qe eshte pjese e oborrit te ndertesave te permendura ne ate paragraf, do te trajtohet si zmadhim i nderteses origjinale, dhe
- (b) kur dy ose me shume ndertesa te perfshira ne te njejtin oborr perdoren si njesi e vetme per qellimet e ndonje institucioni ose ndermarje, permendja ne ate paragraf e vellimit kubik te nderteses origjinale do te interpretohet si permendje e vellimi kubik qe eshte shume e vellimeve kubike te cdo ndertese.

12.—(1) Ne kete Aneks (Skedule) "ne nje date materiale" do te thote—

- (a) 1 korrik 1948; ose
- (b) data ne te cilen kjo Skedule (Aneks) zbatohet ne rastin e vecante ne fjale.

(2) Nenparagrafi (1)(b) nuk do te zbatohet ne ndertesa, punime ose perdorim toke ne te cilat para ose pas dates te permendur ne nenparagraf ka hyre ose hyn ne efekt nje njoftim i detyrueshem i leshuar para asaj date.

13.—(1) Ne lidhje me nje ndertese te ngritur pas 1 korrikut 1948 e cila ndertohet si rezultat i kryerjes te punimeve qe pershkruhen ne paragrafin 1, cdo permendje ne kete Aneks (Skedule) e ndertesës origjinale eshte permendje e ndertesës ne lidhje me te cilen jane kryere keto punime dhe jo ndertesa e krijuar pas kryerjes se atyre punimeve.

(2) Ky paragraf ka fuqi ne baze te seksionit 326(3).

14.—(1) Ne zbatimin e kesaj Skedule (Aneks) per qellimet e marrjes se vendimit ne baze te seksionit 138(1)—

- (a) paragrafi 3 do te interpretohet si paragraf qe nuk shtrihet ne punimet qe perfshijne rritje te vellimit kubik te nje ndertese te ngritur pas 1 korrikut 1948 (perfshire cdo ndertese te realizuar nga punime te tilla qe pershkruhen ne paragrafin 1); dhe
- (b) paragrafi 7 nuk aplikohet ne nje ndertese te tille.

(2) Nenparagrafi (1) zbatohet po keshtu dhe ne zbatimet e kesaj Skedule (Aneksi) per te marre nje vendim ne te cilin zbatohet seksioni 326(1) dhe per qellimet e atij nenparagrafi, deri ne masen qe eshte e zbatueshme si rrjedhim i ketij nenparagrafi ndaj cdo vendimi per vleren perdoruese ekzistuese qe percaktohet ne seksioni 144(6)—

- (a) permendja e asaj Skedule (Aneksi) dhe paragrafeve 3 dhe 7 do te interpretohet si reference ndaj Skedules (Aneksi) 3 te Aktit te 1947-es dhe paragrafeve korrespondues te kesaj Skedule; dhe
- (b) ajo Skedule (Aneks) do te kete efekt sikur te permbante nje paragraf qe i korrespondon paragrafit 13 te kesaj Skedule.

ANEKSI (SKEDULA) 4:

Kushte te vecanta per token e perdorur ne vitin 1948

1. Kur ne 1 korrik te 1948 toka ishte perdorur perkohesisht per qellim tjetër vec atij qe ishte perdorur zakonisht, per rifillimin e perdorimit te tokes per kete qellim te fundit para 6 dhejtorit 1968 nuk kerkohet leje planifikimi.

2. Kur ne 1 korrik 1948 toka ishte perdorur per nje qellim dhe u perdor po keshtu me raste, me intervale te rregullt ose jo, per qellim tjetër, nuk kerkohet leje planifikimi per perdorimin e kesaj toke per qellimin tjetër ne raste te ngjashme ne ose pas 6 dhjetorit 1968, nese toka eshte perdorur per qellimin tjetër ne te pakten ne nje rast te ngjashem qe prej 1 korrikut 1948 dhe para fillimit te 1968-es.

3. Kur toka nuk ishte e zene ne 1 korrik 1948, por para asaj date ishte zene per nje periudhe ne ose pas 7 janarit 1937, nuk kerkohet leje planifikimi per perdorimin e tokes qe filloi para 6 dhjetorit 1968 per qellimin per te cilin toka u perdor para 1 korrikut 1948.

4. Pavaresisht nga paragrafet 1 deri 3, perdorimi i tokes si vend karvani, si rrjedhim i ketyre paragrafeve, nuk do te trajtohet si perdorim per te cilin nuk kerkohet leje planifikimi, me perjshtim te rastit kur toka u perdor per kete qellim te pakten ne nje rast gjate nje periudhe 2 vjecare qe perfundon ne 9 mars 1960.

ANEKSI (SKEDULA) 5:

Kushtet qe lidhen me perpunimin e mineraleve

Pjesa I:

Kushte te imponuara ne dhenien e lejes

Zgjatja e zhvillimit

Seksionet 72(5),
79(4), dhe Aneksi
(Skedula) 9

1.—(1) Cdo leje planifikimi per zhvillim qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve do te jete subjekt i kushtit qe lidhet me zgjatjen e zhvillimit.

(2) Me perjashtim te rastit kur eshte percaktuar nje kusht sipas nenparagrafit (3), kushti ne rastin e lejes se planifikimit qe eshte dhene ose qe quhet si e dhene pas 22 shkurtit 1982 eshte qe zhvillimi duhet te nderpritet jo me vone se perfundimi i periudhes 60 vjecare qe fillon me daten e lejes.

(3) Autoriteti qe jep lejen pas asaj date ose qe udhezohet se pas asaj date leja e planifikimit do te quhet e dhene, mund te percaktoje nje periudhe me te gjate ose me te shkurter se 60 vjet, dhe nese veprojne keshtu, kushti eshte i tille qe zhvillimi duhet te nderpritet jo me vone se mbarimi i periudhes te percaktuar qe fillon me daten e lejes.

(4) Nje periudhe me e gjate ose me shkurter se 60 vjet mund te jepet per qellimet e nenparagrafeve (2) dhe (3).

(5) Kushti ne rastin e lejes se planifikimit e cila eshte dhene ose qe quhet si e dhene para 22 shkurtit 1982 eshte i tille qe zhvillimi duhet te nderpritet jo me vone se mbarimi i periudhes 60 vjecare qe fillon me ate date.

(6) Kushti i cili si rrjedhim i ketij paragrafi zbatohet ndaj lejes per planifikim per zhvillim qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve—

- (a) nuk do te konsiderohet per qellimet e Akteve te planifikimit si kushti qe eshte permendur ne seksionin 72(1)(b); por
- (b) do te konsiderohet per qellimet e seksionit 78 dhe 79 si

kusht i vendosur nga nje vendim i autoritetit te planifikimit lokal dhe si rrjedhim ndaj tij mund te zbatohet apelim sipas seksionit 78.

Pushteti per te vendosur kushte per perkujdesje te metejshme

2.—(1) Kur—

- (a) jepet leja per planifikim per zhvillim qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve, dhe
- (b) leja i nenshtrohet nje kushti qe kerkon qe pasi veprimet per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve te kene perfunduar, vendi i punimeve duhet te restaurohet prej perdorimit te seciles ose i te gjitha veprimeve, ne nentoke, shtresen e sipërme te tokes dhe materialit te krijimit te dheut,

ajo mund te jepet me kusht qe t'i nenshtrohet kushteve te cilat autoriteti i planifikimit lokal i quan te pershtatshme dhe qe kerkon qe te ndermerren hapa te tille te nevojshem per t'a sjelle token ne standartet e kerkuara per perdorur per—

- (i) perdorim per bujqesi
 - (ii) perdorim per pyje, ose
 - (iii) perdorim per vlere te tokes
- per secilin prej tyre te specifikuar ne kusht.

(2) Ne kete Akt—

- (a) nje kusht i permendur ne paragrafin (b) te nenparagrafit (1) eshte "kusht restaurimi"; dhe
- (b) nje kusht qe kerkon te ndermerren hapat qe permenden ne ate nenparagraf quhet "kushti i perkujdesjes se metejshme".

(3) Nje kusht i perkujdesjes se metejshme mundet ose—

- (a) te percaktoje hapat qe duhen marre; ose
- (b) te kerkoje qe hapat te ndermerren ne perputhje me nje skeme (ne kete Akt ajo quhet "skema e perkujdesjes se metejshme") e miratuar nga autoriteti i planifikimit te mineraleve.

(4) Autoriteti i planifikimit te mineraleve mund te miratoje nje skeme te perkujdesjes se metejshme ne formen qe u dorezua ose mund ta ndryshoje ate dhe ta miratoje ate te ndryshuar.

(5) Hapat qe mund te pecaktohen ne nje kusht te perkujdesjes se metejshme ose skeme te perkujdesjes se metejshme mund te perbehen nga mbjellja, kultivimi, pleherimi, ujitja, kanalizimi ose trajtime te tjera te tokes.

(6) Kur nje hap percaktohet ne skeme ose kusht, mund te percaktohet dhe periudha gjate te ciles ky hap do te realizohet, por nuk do te kerkohet qe te ndermeret asnje hap pas perfundimit te periudhes se perkujdesjes se metejshme.

(7) Ne nenparagrafin (6) "periudha e perkujdesjes se metejshme" eshte nje periudhe pese vjecare qe nga koha e perputhjes me kushtet e restaurimit ose nje periudhe maksimale pas perputhjes me ate kusht; dhe per cdo pjese te vendit te punimeve periudha e perkujdesjes se metejshme do te filloje ne perputhje me kushtin e restaurimit per ate pjese.

(8) Fuqia per te caktuar periudha maksimale te dhena nga nenparagrafi (7) perfshin kompetenca per te caktuar periudha maksimale qe ndryshojne sipas perdorimit te percaktuar.

(9) Ne kete paragraf "pyllezim" eshte rritja e pemeve qe do te perdoren si dru.

Kuptimi i "standartit te kerkuar"

3. -(1) Ne rastin kur—

- (a) perdorimi i percaktuar ne nje kusht te perkujdesjes se metejshme eshte perdorim per bujqesi; dhe
- (b) toka ishte ne perdorim bujqesor ne kohen e dhenies se lejes per planifikim ose eshte perdorur me pare per ate qellim dhe ne kohen e dhenies se lejes nuk ishte autorizuar perdorimi i saj per ndonje qellim tjeter qe prej castit kur pushoi se perdoruri si toke bujqesore; dhe
- (c) Ministri ka njoftuar autoritetin e planifikimit lokal per vecorite fizike te tokes ne kohen qe ajo u perdor per here te fundit si toke bujqesore, toka quhet e sjelle ne standartin e kerkuar kur vecorite fizike te saj jane restauruar, deri ne masen praktikisht te mundshme, ne ato vecori qe kishte kjo toke kur u perdor per here te fundit si toke bujqesore.

(2) Ne cdo rast tjeter kur perdorimi i percaktuar ne nje kusht te perkujdesjes se metejshme eshte perdorim per bujqesi, toka quhet e sjelle ne standartin e kerkuar kur ajo eshte e pershtatshme per ate perdorim.

(3) Kur perdorimi i percaktuar ne nje kusht te kujdesjes se metejshme eshte perdorim per pyllezim, tokat quhet e sjelle ne standartin e kerkuar kur ajo eshte e pershtatshme per ate qellim.

(4) Kur perdorimi i percaktuar ne kushtin e paskujdesjes eshte perdorim per komoditet, toka quhet e sjelle ne standartin e kerkuar kur eshte ne gjendje qe ne te rriten peme, peme te uleta ose bime te tjera.

(5) Ne kete paragraf—

- "i autorizuar" do te thote i autorizuar nga leja per planifikim;
- "pyllezim" ka te njejtin kuptim si ne paragrafin 2; dhe
- "Ministri" eshte—
 - (a) per Angline, Ministri i Bujqesise, Peshkimit dhe Ushqimit; dhe
 - (b) per Uellsin, Sekretari i Shtetit

Keshillimet

4.—(1) Para vendosjes se nje kushti te kujdesjes se metejshme, autoriteti i planifikimit te mineraleve do te keshillohet—

- (a) me Ministrin, kur propozohet se perdorimi i percaktuar ne kushtin e kujdesjes se metejshme eshte perdorim bujqesor; dhe
- (b) Komisioni i Pyllezimit, kur propozohet se perdorimi do te jete per qellime pyllezimi.
per te pare nese eshte e pershtatshme te percaktojen ate lloj perdorimi.

(2) Kur pas keshillimeve te kerkuara nga paragrafi (1) autoriteti i planifikimit te mineraleve eshte i bindur se perdorimi qe ai do te percaktoje eshte perdorim bujqesor ose per pyllezim, ai do te keshillohet me—

- (a) Ministrin, per perdorim bujqesor; dhe
(b) Komisionin e Pyllezimit, per pyllezimin,
per te vendosur nese hapat qe do te ndermerren do te paraqiten ne nje kusht apo skeme te kujdesjes se metejshme.
- (3) Autoriteti i planifikimit te mineraleve do te keshillohet gjithashtu dhe me Ministrin, ose sipas rastit Komisionin e Pyllezimit—
(a) per hapat qe do te percaktohen ne nje kusht mirembajtje i cili percakton perdorimin per bujqesi ose pyllezim; dhe
(b) para miratimit te nje skeme te mirembajtjes qe eshte dorezuar ne perputhje me kushtin e kujdesjes se metejshme i cili percakton nje perdorim te tille.
- (4) Autoriteti i planifikimit mineral gjithashtu do te keshillohet, sikurse e sheh te arsyeshme, me Ministrin ose Komisionin sipas rastit, per te pare nese po realizohen hapat e percaktuar ne kushtin e kujdesjes se metejshme ose skemen e kujdesjes te metejshme.
- (5) Ne kete paragraf "pyllezim" dhe "Ministri" kane te njejtin kuptim si ne paragrafin 3.

Certifikata e plotesimit

5. Nese autoriteti i planifikimit te mineraleve eshte i bindur se kushti i kujdesjes se metejshme eshte plotesuar, leshon nje certifikate plotesimi kur personi qe ka interes ne token per te cilen eshte vendosur nje kusht i kujdesit te metejshem ben aplikimin per nje certifikate te tille.

Pagesa e shpenzimeve per plotesim

6. Nje person qe ka plotesuar kushtin e kujdesjes se metejshme por qe nuk ka kryer vete asnje veprim per nxjerrjen dhe perpunimin e mineraleve ne ose mbi toke, ka te drejte, duke patur parasysh cdo kusht qe parashikon te kunderten ne nje kontrate qe zbatohet ndaj tij nga personi qe kreu per here te fundit veprime te tilla, te marre nga ai person cdo shpenzim te arsyeshem qe eshte bere per

plotesimin e kushtit te kujdesit te metejshem.

Pjesa II:

Kushtet e vendosura per anullimin ose modifikimin e lejes

7. Urdheri i nxjerre ne baze te seksionit 97 per lejen e planifikimit per zhvillim qe perbehet nga nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve, mund te permbaje kushte te kujdesjes se metejshme te cilat autoriteti i planifikimit te mineraleve i quan te pershtatshme nese—

- (a) urdheri gjithashtu permban kusht restaurimi; ose
(b) nje kusht restaurimi i cili rrjedh prej kushteve te ketij Akti eshte imponuar me pare per token qe perdoret.

8. Paragrafet 2(3) deri (9) dhe 3 deri 6 do te zbatohen ndaj nje kushti te kujdesjes se metejshme te vendosur ne kete menyre, njelloj sikurse ato zbatohen ndaj nje kushti te tille qe rrjedh prej paragrafit 2.

SKEDULA 6

Percaktimi i apelimeve te vecanta nga personi i emeruar nga Sekretari i Shtetit

Percaktimi i apelimeve nga personi i emeruar

Seksionet 79, 175,
195, 208

1.—(1) Sekretari i Shtetit mundet qe sipas rregullave te krijojte klasa apelimesh ne baze te seksioneve 78, 174, 195 dhe 208 te cilat do te merret vendimi nga nje person qe emerohet nga Sekretari i Shtetit dhe jo nga vete Sekretari i Shtetit.

(2) Tegjitha keto klasa do te vendosen ne kete menyre me perjashtim—

- (a) kur eshte udhezuar ndryshe per momentin, ose
- (b) sikurse mund te jete percaktuar ne udhezimet e dhena nga Sekretari i Shtetit.

(3) Rregullat e nxjerra per qellimet e ketij paragrafi mund te sigurojne berjen publike te udhezimeve te dhena nga Sekretari i Shtetit ne baze te ketij paragrafi.

(4) Ky paragraf nuk do te preke asnje dispozite ne kete Akt ose asnje instrument te nxjerre si rrjedhim i tij ndaj te cilave ekziston nje apelim ose per te cilat dergohet njoftim apelimi tek Sekretari i Shtetit.

(5) Personi i emeruar ne baze te ketij paragrafi eshte ne kete Aneks (Skedule) "personi i emeruar".

Pergjegjesite dhe detyrat e personit te emeruar

2. —(1) Nje person i emeruar do te kete te njejtat pergjegjesi dhe detyra —

- (a) per apelime nen seksionin 78 sikurse ka dhe Sekretari i Shtetit ne baze te nenseksioneve (1) dhe (4) te seksionit 79;
- (b) per apelime nen seksionin 174, njelloj si ato qe ai ka ne baze te seksioneve 176(1), (2) dhe (5) dhe 177(1) deri

(4);

(c) per apelime nen seksionin 195, si ato qe ka ne baze te nenseksioneve (2) dhe (3) te atij seksioni dhe nenseksioni (5) i seksionit 196;

(d) per apelime nen seksionin 208, si ato qe ka ne baze te nenseksioneve (7) dhe (8) te atij seksioni.

(2) Seksionet 79(2), 175(3), 196(1) dhe 208(5) nuk zbatohen ndaj nje apelimi per te cilin vendos nje person i emeruar por qe para se te vendoset per te, Sekretari i Shtetit do t'i kerkoje apeluesit dhe autoritetit te planifikimit lokal nese ato duan te paraqiten dhe degjohen nga personi i emeruar.

(3) Nese te dyja palet shprehin se nuk duan te paraqiten dhe te degjohen, vendimi per apelimin mund te merret pa i degjuar ata.

(4) Nese te dyja palet shprehin deshiren te paraqiten dhe te degjohen, personi i emeruar do t'u jape te dyjave mundesine te bejne nje gje te tille.

(5) Nenparagrafi (2) nuk zbatohet ne rastin e nje apelimi te bere ne baze te seksionit 78 nese ky apelim i eshte derguar Komisionit te Shqyrtimit te Planifikimit ne baze te seksionit 101.

(6) Kur vendimi per nje apelim eshte marre nga personi i emeruar, vendimi i tij do te trajtohet si vendim i Sekretarit te Shtetit.

(7) Me perjashtim te zbatimit te Pjese XII, vlefshmeria e ketij vendimi do te jete ne cdo rast e pandryshueshme.

(8) Fakti qe vendimi ndaj apelimit u mor nga personi i emeruar dhe jo nga Sekretari i Shteti nuk perben baze per aplikim ne Gjykatën e Larte ne baze te seksionit 288 ose per apelim ne Gjykatën e Larte ne baze te seksionit 290 me perjashtim te rastit kur apeluesi ose autoriteti i planifikimit lokal vene ne dyshim pergjegjesine e personit te emeruar per te vendosur ndaj apelimit para se ai te kete marre vendimin per apelimin.

(9) Kur ne rastine e nje dekreti (perfshire kete Akt) permendet Sekretari i Shtetit ne kontekstin qe lidhet ose qe mund te lidhet me nje apelim ndaj te cilit zbatohet kjo Skedule (Aneks) ose te cdo veprimi te bere, te autorizuar ose qe eshte kerkuar

te behet ndaj ose para Sekretarit te Shtetit per ose ne lidhje me kete apelim, atehere per aq sa e lejon konteksti, kjo permendje ne lidhje me nje apelim per te cilin ka vendosur ose qe duhet te vendose personi i emeruar, do te quhet si permendje e personit te emeruar.

Marrja e vendimit ndaj apelimeve nga Sekretari i Shtetit

3.—(1) Sekretari i Shtetit, nese e mendon te mundshme, mund te udhezaje se nje apelim i cili normalisht duhet te vendoset nga personi i emeruar, duhet te vendoset nga Sekretari i Shtetit.

(2) Nje udhezim i tille duhet te theksoje arsyet per te cilat ai eshte nxjerre dhe duhet realizuar ndaj personit, nese ka te tille te emeruar, autoritetin e te cilit apeluesi, autoriteti i planifikimit lokal dhe cdo person tjeter qe ka bere prezantim ne lidhje me ceshtjen ne fjale duhet ta marre parasysh ne baze te seksionit 71(2)(a).

(3) Kur si rrjedhim i nje udhezimi te tille, vendimi ndaj nje apelimi do te merret nga Sekretari i Shtetit, dispozitat e ketij Akti te cilat lidhen me apelimin, ndaj te cilave zbatohen kushtet e meposhtme, do te zbatohen tek ky apelim sikur kjo Skedule te mos ishte zbatuar asnjehere ndaj ketij apelimi.

(4) Sekretari i Shtetit do t'i jape apeluesit, autoritetit te planifikimit lokal dhe cdo personi qe ka bere prezantime te permendura ne nenparagrafin (2) mundesine per t'u paraqitur dhe degjuar nga nje person i emeruar nga Sekretari i Shtetit per ate qellim nese—

(a) arsyet per nxjerrjen e udhezimit ngrene ceshtje per te cilat asnje prej ketyre personave nuk ka bere prezantim; ose

(b) ne rastin e apeluesit ose autoritetit te planifikimit lokal, asnje prej tyre nuk u pyet ne baze te paragrafit 2(2) nese ata deshironin te paraqiteshin dhe te degjoheshin nga personi i emeruar, ose nuk shprehen asnje deshire ne pergjigje te asaj pyetjeje, ose shprehen deshiren per t'u paraqitur dhe degjuar por nuk iu dha mundesia te vepronin keshtu.

(5) Nenparagrafi (4) nuk zbatohet ne rastin e nje apeli te bere ne baze te seksionit 78 nese apeli i eshte derguar Komisionit

te Shqyrtimit te Planifikimit ne baze te seksionit 101.

(6) Vec rastit kur parashikohet nga nenparagrafi (4), nuk eshte e nevojshme qe Sekretari i Shtetit t'i jape ndonje personi mundesine per t'u paraqitur ose degjuar nga personi i emeruar per qellimin ose berjen e nje prezantimi te ri ose berjen ose terheqjen e nje prezantimi qe eshte bere me pare.

(7) Ne marrjen e vendimit ndaj apelit, Sekretari i Shtetit mund te marre parasysh raporte te derguara tek ai nga personi i emeruar me pare per te marre vendim ndaj apelit.

4.—(1) Sekretari i Shtetit mundet qe me udhezim te metejshem te revokoj nje udhezim bazuar ne paragrafin 3 ne cdo moment para se te jete marre vendimi per apelin.

(2) Nje udhezim i tille i metejshem duhet te theksoje arsyet per te cilat eshte leshuar dhe do te zbatohet ndaj personit, nese ka te tille, qe ishte emeruar me pare te merrte vendim per apelimin, apeluesi, autoriteti i planifikimit lokal dhe personat qe kane bere prezantime lidhur me subjektin e apelit, autoritetin e te cilit iu kerkohet ta marrin parasysh ne baze te seksionit 71(2)(a).

(3) Kur leshohet nje udhezim i tille i metejshem, do te zbatohen dispozitat e kesaj Skedule (Aneksi) qe lidhen me apelimin, me kusht qe te bien ne nenparagrafin (4) duke supozuar se asnje udhezim nuk ishte dhene ne baze te paragrafit 3.

(4) Gjithshka e bere nga ose ne emer te Sekretarit te Shtetit ne lidhje me apelimin dhe qe mund te jete bere nga personi i emeruar (perfshire caktimin e mbajtjes se nje shqyrtimi ose hetimi lokal), pervec rastit kur ky person udhezohet ndryshe, do te trajtohet si te bera nga ai.

Emerimi i nje personi tjeter per te vendosur mbi Apelin

5.—(1) Ne cdo moment para se personi i emeruar te kete marre vendimin ndaj apelit, Sekretari i Shtetit mund—

(a) te revokoj kete emerim; dhe

(b) te emeroje nje person tjeter ne baze te paragrafit 1 per te marre vendim ndaj apelit.

(2) Kur behet nje emerim i tille i ri, trajtimi i apelimit ose shqyrtimi ose hetime te tjera te bera per kete apelim do te fillojne nga e para.

(3) Asgje ne nenparagrafin (2) nuk do te kerkoje—

(a) berjen perseri te pyetjes qe permendet ne paragrafin 2(2) lidhur me personin e ri te emeruar nese para ketij emerimi kjo pyetje i i shte bere personit te emeruar me pare (cdo pergjigje do te trajtohet si e dhene nga personi i ri qe u emerua); ose

(b) qe dikujt t'i jepet mundesia te beje nje prezantim te ri ose te modifikoje ose te terheqe nje prezantim te bere me pare.

Shqyrtimet dhe hetimet lokale

6.—(1) Pavaresisht nese palet e nje apeli kane kerkuar mundesine per tu paraqitur ose degjuar, personi i emeruar—

(a) mund te nise nje shqyrtim lokal ne lidhje me apelin; dhe

(b) vepron ne kete menyre nese e udhezoi Sekretari i Shtetit

(2) Kur personi i emeruar—

(a) nis nje proces pyetjesh si rrjedhim i paragrafit 2(4); ose

(c) nis nje hetim si rrjedhim i ketij paragrafi

Sekretari i Shtetit mund te emeruje nje vleresues i cili ulet me personin e emeruar gjate nje procesi pyetje ose hetimi per t'a keshilluar ate rreth ceshtjeve qe ngrihen, pavaresisht nga fakti qe vendimin per apelimin do ta marre personi i emeruar.

(3) Sipas nenparagrafit (4), kostoja e procesit te pyetjeve dhe hetimit do te caktohet nga Sekretari i Shtetit.

(4) Nenseksionet (2) dhe (5) te seksionit 250 te Aktit te Qeverisjes Lokale 1972 [1072 c.70.] zbatohen ndaj nje procesi shqyrtimi qe kryhet sipas ketij paragrafi me adoptimet e meposhtme—

(a) zevendesimi ne nenseksionin (4) (mbulimi i kostove te kryerjes se shqyrtimit) i Ministrit qe nis fillimin e hetimit me Sekretarin e Shtetit; dhe

(b) zevendesimin ne nenseksionin (5) (urdherat per kostot e paleve) i Ministrit qe nis shqyrtimin me personin e emeruar ose Sekretarin e Shtetit.

(5) Personi i emeruar ose Sekretari i Shtetit kane te njejtat kompetenca te nxjerrin urdhera ne baze te seksionit 250(5) te Aktit (urdhera ne lidhje me shpenzimet e paleve) per veprimet qe behen ne baze te kesaj Skedule (Aneksi) qe nuk cojne ne kryerjen e nje shqyrtimi sikurse kane ne rastin e nje shqyrtimi te tille.

Dispozita shtese

7. Nese para ose gjate marrjes se vendimit ndaj nje apelimi ne baze te seksionit 78 ndaj te cilit duhet te vendoset ne perputhje me paragrafin 1, Sekretari i Shtetit formon mendimin qe permendet ne seksionin 79(6), ai mund te udhezoje se nuk do te filloje marrja e vendimit.

8.—(1) Akti i gjyqeve dhe hetimeve 1971 [1871 c. 62.] do te zbatohet ne nje shqyrtim lokal ose proces tjetër hetimesh qe mbahet ne vazhdim te kesaj Skedule (Aneksi) sikurse ai zbatohet ndaj nje hetimi ligjor te mbajtur nga Sekretari i Shtetit, por me kushtin qe ne seksionin 12(1) te atij Akti (deklarati e arsyeve per vendim) permendja e cdo vendimi te marre nga Sekretari i Shtetit te lexohet si permendje e nje vendimi te marre nga personi i emeruar.

(2) Kur personi i emeruar eshte punonjes i Departamentit te Mjedisit ose i Zyres se Uellsit, funksionet te cilat i vishen atij nga kjo Skedule (Aneks) per te vendosur ndaj nje apeli ose kryerja e veprimeve te tjera lidhur me kete apelim, do te trajtohen per qellimet e Aktit te Komisionerit te Parlamentit 1967 [1967 c.13.]—

(a) nese ai u emerua nga Sekretari i Shtetit per kete periudhe kohe qe te kishte pergjegjesi te pergjithshme ne ceshtjet e planifikimit qe lidhen me Angline, si funksione te atij Departamenti; dhe

(b) nese ai u emerua nga Sekretari i Shtetit per kete periudhe qe te kishte pergjegjesi te pergjithshme ne ceshtje planifikimi per Uellsin, si funksione te Zyres se Uellsit.

ANEKSI (SKEDULA) 7:

Zonat e thjeshtuara te planifikimit

Te pergjithshme

1.—(1) Skema e nje zone te thjeshtuar planifikimi do te perbehet nga harta dhe nje deklarate me shkrim, si dhe grafike, ilustrime dhe materiale pershkruese te cilat autoriteti i planifikimit lokal i quan te pershtatshme per te shpjeguar ose ilustruar kushtet e skemes.

(2) Skema e zones se thjeshtuar te planifikimit do te percaktoje—

- (a) zhvillimet ose klasat e zhvillimit te lejuara nga skema,
 - (b) token per te cilen eshte dhene leja, dhe
 - (c) cdo kusht, kufizim ose perjashtim te cilat jane marre parasysh kur eshte dhene leja;
- dhe do te permbaje ceshtje te tjera sikurse mund te udhezohet.

Njoftim i propozimeve per te bere ose ndryshuar skemen

2. Autoriteti qe vendos ne baze te seksionit 83(2) kryerjen ose ndryshimin e skemes se zones se thjeshtuar te planifikimit, do te—

- (a) njoftoje Sekretarin e Shtetit per vendimin e tij sa me pare; dhe
- (b) percaktoje daten ne te cilen autoriteti do te filloje pergatitjen e skemes ose ndryshimet.

Pushteti i Sekretarit te Shtetit per te udhezuar berjen ose ndryshimin e skemes

3.—(1) Nese nje person i kerkon autoritetit te planifikimit lokal te beje ose ndryshoje skemen e zones se thjeshtuar te planifikimit por autoriteti—

- (a) nuk pranon te veproje keshtu, ose
 - (b) nuk vendos brenda tre muajsh nga data e kerkeses te veproje keshtu,
- ai person mund te kerkoje, ne baze te nenparagrafit (2) t'i dergohet ceshtja Sekretarit te Shtetit.

(2) Nje person nuk mund te kerkoje dergimin e ceshtjes tek Sekretari i Shtetit nese—

- (a) ne rastin e nje kerkese per te bere nje skeme, skema e zones se planifikimit te thjeshtuar qe lidhet teresisht ose pjeserisht me token e permendur ne kerkese eshte adoptuar ose miratuar brenda 12 muajsh para berjes se kesaj kerkese nga ai;
- (b) ne rastin e nje kerkese per ndryshim te skemes, skema per te cilen behet kerkesa ishte adoptuar ose miratuar, ose ndonje ndryshim i saj ishte adoptuar ose miratuar brenda asaj periudhe.

(3) Sekretari i Shtetit menjehere sapo behet praktikisht e mundshme pas paraqitjes se ceshtjes tek ai —

- (a) do t'i dergoje autoritetit nje kopje te cdo prezantimi te bere tek ai nga aplikuesi dhe qe nuk i eshte bere autoritetit, dhe
- (b) do te njoftoje autoritetin se nese ata deshirojne te bjene prezantim ne lidhje me ceshtjen, duhet te veprojen keshtu nepermjet nje kerkese me shkrim brenda 28 ditesh.

(4) Pasi Sekretari i Shtetit ka—

- (a) konsideruar ceshtjen dhe cdo prezantim me shkrim te bere nga aplikuesi ose autoriteti, dhe
 - (b) kryer keshillime me persona qe ai i mendon te pershtatshem,
- ai mund t'i jape autoritetit nje udhezim per zonen e planifikimit te thjeshtuar.

(5) Sekretari i Shtetit do te njoftoje aplikuesin dhe autoritetin per vendimin e tij dhe arsyet e ketij vendimi.

4.—(1) Nje udhezim per zonen e thjeshtuar te planifikimit eshte—

- (a) nese kerkesa ishte per berjen e skemes, udhezim per berjen e skemes te cilen Sekretari i Shtetit e quan te pershtatshme; dhe
- (b) nese kerkesa ishte per ndryshimin e skemes, udhezim

ndryshuar ate sipas menyres qe ai e quan te atshme.

ezim ne baze te nenparagrafit (1)(a) ose (b) mund

ken qe permendet ne kerkesen drejtuar autoritetit, do pjese te tokes te percaktuar ne kete menyre, ose oke e cila perfshin te tere ose nje pjese te tokes te caktuar ne kete menyre; und te udhezaje qe toka t'i shtohet ose t'i hiqet zones uese te planifikimit te thjeshtuar.

Publiciteti dhe keshillimet: te pergjithshme

5.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal qe propozon te beje ose ndryshoje skemen e zones se planifikimit te thjeshtuar, do te veprojne ne perputhjeme ekte paragraf, vec rastit kur zbatohet paragrafi 6.

(2) Ata duhet te marrin hapa te tille qe sipas mendimit te tyre sigurojne—

- (a) dhenien e publicitetit te pershtatshem propozimit e tyre ne zonen qe mbulon skema,
 - (b) qe personat qe mendohet se deshirojne te bejen prezantime rreth propozimit, njihen me faktin se kane te drejte te veprojne ne kete menyre, dhe
 - (c) qe personave te tille iu jepet mundesia e pershtatshme per te bere prezantime te tilla;
- dhe ata duhet te marrin parasysh cdo prezantim te bere para tyre brenda periudhes se caktuar.

(3) Me pas ata—

- (a) do te pergatisin skemen ose ndryshimet e propozuara,
- (b) do te kene ne zyren e tyre te vlefshme per inspektim kopje te ketyre te dokumentave, dhe
- (c) do t'i dergojne nje kopje te tyre Sekretarit te Shtetit.

(4) Cdo kopje e dokumentave e vlefshme per inspektim do te shoqerohet nga nje deklarate per kohen gjate te ciles mund te behen verejtje.

(5) Para pergatitjes se skemes ose ndryshimeve te propozuara, autoriteti i planifikimit lokal do te keshillohet me

Sekretarin e Shtetit qe eshte pergjegjes per rruget lidhur me ndikimin qe propozimi i autoritetit do te kete mbi rruget ekzistuese ose qe do ndertohen ne te ardhmen; dhe pasi te jete pergatitur skema ose ndryshimi i propozuar, autoriteti do t'i dergoje atij nje kopje te tyre.

Publiciteti dhe keshillimet: procedure e shkurtuar per disa ndryshime

6.—(1) Kur autoriteti i planifikimit lokal propozon te ndryshoje skemen e zones se planifikimit te thjeshtuar dhe mendon se ceshtjet e perfshira nuk kane rendesi te mjaftueshme per te kryer proceduren qe percaktohet ne paragrafin (5), autoriteti mund te veproje ne perputhje me kete paragraf.

(2) Autoriteti do te pergatise ndryshimet e propozuara dhe do te—

- (a) kete kopje te gatshme per indpektim ne zyren e tij, dhe
- (b) dergoje nje kopje te tyre Sekretarit te Shtetit.

(3) Cdo kopje e dokumentave e vlefshme per inspektim do te shoqerohet nga nje deklarate per kohen brenda te ciles mund te behen verejtje ose prezantime.

(4) Me pas ai duhet te marre hapat qe mund te caktohen per qellimet e—

- (a) njoftimit te faktit se ndryshimet e propozuara jane te vlefshme per inspektim si dhe vendin, kohen dhe periudhen gjate ciles ato mund te inspektohen, dhe
- (b) berjes se fteses per paraqitjen e prezantimeve ose verejtjeve ne perputhje me rregullat;

dhe ai duhet te marre parasysh cdo prezantim qe behet brenda periudhes se caktuar.

(5) Autoriteti i planifikimit lokal do te dergoje kopje te ndryshimeve te propozuara Sekretarit te Shtetit qe eshte pergjegjes per rruget.

Pushteti i Sekretarit te Shtetit per te siguruar publicitet dhe keshillim te pershtatshem

7.—(1) Dokumentat qe i dergohen Sekretarit te Shtetit nga

ta e kerkeses te
rafit (2) t'i

per t'a ndryshuar ate sipas menyres qe ai e quan te pershtatshme.

(2) Nje udhezim ne baze te nenparagrafit (1)(a) ose (b) mund te shtrihet—

- (a) ne token qe permendet ne kerkesen drejtuar autoritetit,
 - (b) per cdo pjese te tokes te percaktuar ne kete menyre, ose
 - (c) ne toke e cila perfshin te tere ose nje pjese te tokes te percaktuar ne kete menyre;
- dhe mund te udhezoje qe toka t'i shtohet ose t'i hiqet zones ekzistuese te planifikimit te thjeshtuar.

Publiciteti dhe keshillimet: te pergjithshme

5.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal qe propozon te beje ose ndryshoje skemen e zones se planifikimit te thjeshtuar, do te veprojne ne perputhje me ekte paragraf, vec rastit kur zbatohet paragrafi 6.

(2) Ata duhet te marrin hapa te tille qe sipas mendimit te tyre sigurojne—

- (a) dhenien e publicitetit te pershtatshem propozimit e tyre ne zonen qe mbulon skema,
 - (b) qe personat qe mendohet se deshirojne te bejen prezantime rreth propozimit, njihen me faktin se kane te drejte te veprojne ne kete menyre, dhe
 - (c) qe personave te tille iu jepet mundesia e pershtatshme per te bere prezantime te tilla;
- dhe ata duhet te marrin parasysh cdo prezantim te bere para tyre brenda periudhes se caktuar.

(3) Me pas ata—

- (a) do te pergatisin skemen ose ndryshimet e propozuara,
- (b) do te kene ne zyren e tyre te vlefshme per inspektim kopje te ketyre te dokumentave, dhe
- (c) do t'i dergojne nje kopje te tyre Sekretarit te Shtetit.

(4) Cdo kopje e dokumentave e vlefshme per inspektim do te shoqerohet nga nje deklarate per kohen gjate te ciles mund te behen verejtje.

(5) Para pergatitjes se skemes ose ndryshimeve te propozuara, autoriteti i planifikimit lokal do te keshillohet me

Sekretarin e Shtetit qe eshte pergjegjes per rruget lidhur me ndikimin qe propozimi i autoritetit do te kete mbi rruget ekzistuese ose qe do ndertohen ne te ardhmen; dhe pasi te jete pergatitur skema ose ndryshimi i propozuar, autoriteti do t'i dergoje atij nje kopje te tyre.

Publiciteti dhe keshillimet: procedure e shkurtuar per disa ndryshime

6.—(1) Kur autoriteti i planifikimit lokal propozon te ndryshoje skemen e zones se planifikimit te thjeshtuar dhe mendon se ceshtjet e perfshira nuk kane rendesi te mjaftueshme per te kryer proceduren qe percaktohet ne paragrafin (5), autoriteti mund te veprojte ne perputhje me kete paragraf.

(2) Autoriteti do te pergatis ndryshimet e propozuara dhe do te—

- (a) kete kopje te gatshme per inspektim ne zyren e tij, dhe
- (b) dergoje nje kopje te tyre Sekretarit te Shtetit.

(3) Cdo kopje e dokumentave e vlefshme per inspektim do te shoqerohet nga nje deklarate per kohen brenda te ciles mund te behen verejtje ose prezantime.

(4) Me pas ai duhet te marre hapat qe mund te caktohen per qellimet e—

- (a) njoftimit te faktit se ndryshimet e propozuara jane te vlefshme per inspektim si dhe vendin, kohen dhe periudhen gjate te ciles ato mund te inspektohen, dhe
 - (b) berjes se fteses per paraqitjen e prezantimeve ose verejtjeve ne perputhje me rregullat;
- dhe ai duhet te marre parasysh cdo prezantim qe behet brenda periudhes se caktuar.

(5) Autoriteti i planifikimit lokal do te dergoje kopje te ndryshimeve te propozuara Sekretarit te Shtetit qe eshte pergjegjes per rruget.

Pushteti i Sekretarit te Shtetit per te siguruar publicitet dhe keshillim te pershtatshem

7.—(1) Dokumentat qe i dergohen Sekretarit te Shtetit nga

autoriteti i planifikimit lokal ne baze te paragrafit 5(3) do te shoqerohen nga nje deklarate qe permban—

- (a) hapat qe autoriteti ka ndermare per te qene ne perputhje me paragrafin 5(2), dhe
- (b) keshillimet e autoritetit me persona te tjere dhe marrja parasysh e mendimeve te ketyre personave.

(2) Dokumentat qe i dergohen Sekretarit te Shtetit nga autoriteti i planifikimit lokal ne baze te paragrafit 6(2) duhet te shoqerohen nga nje deklarate qe pershkruan hapat te cilat po ndermerr autoriteti per te qene ne perputhje me paragrafin 6(4).

(3) Nese gjate shqyrtimit te deklarates dhe propozimeve dhe ndonje informacioni tjetër qe eshte derguar nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shteti nuk eshte i kenaqur me hapat e marre nga autoriteti, ai brenda 21 ditesh nga marrja e deklarates udhezoi autoritetin te mos marre hapa te metejshme per adoptimin e propozimeve nese autoriteti—

- (a) nuk vepron ne perputhje me paragrafin 5 (nese ai ka vepruar ne fakt sipas paragrafit 6), ose
- (b) per cdo rast, ai nuk ndermerr hapa te metejshem qe percakton Sekretari, dhe ta binde ate qe ka vepruar keshtu.

(4) Autoriteti i planifikimit lokal te cilit i jane dhene udhezime nga sekretari i shtetit—

- (a) menjehere do te terheqe kopjet e gatshme per inspektim te bera sipas paragrafit 5(3)(b) ose 6(2)(a), dhe
- (b) do te njoftoje se Sekretari i Shtetit ka dhene keto udhezime cdo personi i cili ka bere verejtje per propozimin tek autoriteti .

Verejtjet: Hetimet lokale ose procese pyetjesh te tjera

8.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal mund te nise nje shqyrtim lokal ose pyetje te tjera te cilat do te behen me qellimin per te marre parasysh verejtjet qe i jane bere propozimeve te tij per realizimin ose ndryshimin e skemes te zones se planifikimit te thjeshtuar.

(2) Ai do te kryeje shqyrtim lokal ose hetime te tjera ne rastin e verejtjeve te bera ne perputhje me rregullat, me perjashtim te rastit kur te gjithe personat qe kane bere verejtje te tilla

kane deklaruar me shkrim se nuk duan te paraqiten.

(3) Hetimi apo pyetjet lokale do te bahen nga nje person i emeruar nga Sekretari i Shtetit ose, ne raste te tjera kur eshte udhezuar ashtu, nga vete autoriteti.

(4) Rregullat mund—

- (a) te caktojne kushte per emerimin dhe kualifikimet per emerim te personave qe do te mbajne shqyrtim lokal ose hetime te tjera .
- (b) te perfshije kushte qe mundesojne Sekretarin e Shtetit te udhezoi autoritetin e planifikimit lokal te emeroje nje person te vecante, ose dike nga nje liste e caktuar ose klase personash;
- (c) te caktojne kushte per pagesat dhe dietat e personit te emeruar.

(5) Nenseksionet (2) dhe (3) te seksionit 250 te Aktit te Qeverisjes Lokale 1972 [1072 c. 70.] (pushteti per te mbledhur dhe shqyrtuar deshmitaret) zbatohen ne shqyrtimet qe behen ne baze te ketij paragrafi.

(6) Akti i Gjyqeve dhe Hetimeve 1971 [1971 c. 62.] zbatohet ne nje shqyrtim lokal ose hetime te tjera te mbajtura ne baze te ketij paragrafi njelloj sikurse zbatohet ne nje hetim ligjor te mbajtur nga Sekretari i Shtetit duke zvendesuar ne seksionin 12(1) (deklarata e arsyeve per vendim) permendjen e vendimit te marre nga Sekretari i Shtetit me vendimin e marre nga autoriteti lokal.

Adoptimi i propozimeve nga autoriteti i planifikimit lokal

9.—(1) Autoriteti i planifikimit lokal do te marre ne konsiderate cdo verejtje qe i behet propozimeve per realizimin ose ndryshimin e skemes se zones se planifikimit te thjeshtuar te cilat jane bere si duhet ne periudhen e caktuar per berjen e verejtjeve dhe pasi kjo periudhe ka perfunduar, autoriteti, me kusht zbatimin e dispozitave te ketij paragrafi dhe te paragrafit 10, me vendim do te adoptojte propozimet.

(2) Autoriteti mund te adoptojte propozimet sic ishin pergatitur fillimisht ose qe u ndryshuan duke marre parasysh—

- (a) cdo verejtje qe eshte permendur ne nenparagrafin (1) ose

cdo verejtje tjeter per propozimet, ose
(b) cdo mendim tjeter qe per autoritetin eshte material.

(3) Nese para se propozimet te jene adoptuar nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit beson se ato nuk jane te kenaqshme, ai mund te udhezoje autoritetin te marre parasysh ndryshimin e propozimeve sikurse eshte percaktuar ne udhezim.

(4) Autoriteti i cili ka marre kete udhezim, nuk i adopton propozimet derisa—

- (a) ai bind Seretarin e Shtetit se i ka bere te gjitha ndryshimet e nevojshme ne perputhje me udhezimin, ose
- (b) udhezime te jete terhequr.

Njoftimi per dergim te propozimeve per miratim nga Sekretari i Shtetit

10.—(1) Para se propozimet te adoptohen nga autoriteti i planifikimit lokal, Sekretari i Shtetit mund te udhezoje se ato do ti dergohen atij per miratim.

(2) Nese Sekretari i Shtetit jep nje udhezim te tille—

- (a) autoriteti nuk do te ndermare hapa te metejshem per adoptimin e propozimeve, dhe ne menyre te vecante nuk do te mbaje ose veprojen me tej ne lidhje me shqyrtimet lokale ose hetimet e tjera ne lidhje me propozimet ne baze te paragrafit 8; dhe
- (b) propozimet nuk do te hyjne ne fuqi nese ato nuk jane miratuar nga Sekretari i Shtetit dhe nuk do te kerkojne adoptim nga autoriteti.

Miratimi i propozimeve nga Sekretari i Shtetit

11.—(1) Sekretari i Shtetit pasi te shqyrtoje propozimet e dorezuara atij ne baze te paragrafit 10, mund ose t'i miratoje ato, plotesisht ose pjeserisht dhe me ose pa ndryshime, ose t'i refuzoje ato.

(2) Kur shqyrton propozimet, Sekretari i Shtetit mund te marre parasysh ceshtje qe ai mendon se jane me rendesi per

propozimet, pavaresisht nga fakti nese ato u moren parasysh ne propozimet qe iu dorezuan atij.

(3) Kur gjate shqyrtimit te propozimeve, Sekretari i Shtetit nuk vendos ti refuzoje ato, ai para se te vendose miratimin e tyre—

- (a) mer parasysh cdo veretje qe eshte bere ne perputhje me rregullat,
- (b) i jep cdo personi qe beri verejtje te tilla te cilat nuk jane terhequr, mundesine per t'u paraqitur dhe degjuar nga personi i emeruar prej tij per kete qellim, dhe
- (c) nese mbahet nje shqyrtim lokal ose hetime te tjera, gjithashtu t'i jape kete mundesi autoritetit dhe personave te tjere qe ai gjykon te pershtatshem.

(4) Ne shqyrtimin e propozimeve, Sekretari i Shtetit mund te keshillohet me, ose te mare parasysh pikpamjet e autoritetit te planifikimit lokal ose ndonje personi tjeter, por ai nuk eshte i detyruar te veproje keshtu ose te krijojte mundesine per prezantim ose verejtje, ose te nise nje shqyrtim lokal ose hetime te tjera me perjashtim te atyre te percaktuara nga nenparagrafi (3).

Autoriteti baze

12.—(1) Kur si rrjedhim i kushteve te kesaj Skedule (Aneksi)—

- (a) kerkohen te pergatiten skema e zones se planifikimit te thjeshtuar ose propozime per ndryshimin e kesaj skeme, ose
- (b) kerkohen te merren hapa per adoptimin e nje skeme ose propozimesh te tilla,

atehere, nese Sekretari i Shtetit bindet, pas mbajtjes te nje shqyrtimi lokal ose hetimeve te tjera, se autoriteti i planifikimit lokal nuk po ndermerr hapat e duhur per te mundesuar pergatitjen ose adoptimin e skemes ose propozimeve brenda nje periudhe te caktuar, Sekretari mund te beje skemen ose ndryshimet ashtu si e mendon ai te pershtatshme.

(2) Kur sipas ketij paragrafi ajo qe duhej bere nga autoriteti i planifikimit lokal behet nga Sekretari i Shtetit, do te zbatohen kushtet e meparshme te kesaj Skedule (Aneksi), per aq sa eshte praktikisht e mundshme duke i bere te gjitha

ndryshimet e nevojshme ne lidhje me kryerjen e ketyre veprimeve nga Sekretari i Shtetit dhe per realizimin e ketyre veprimeve.

(3) Kur Sekretari i Shtetit kryen shpenzime sipas ketij paragrafi ne lidhje ne realizimin e cdo veprimi qe duhet te ishte bere nga autoriteti i planifikimit lokal, pjesa e ketyre shpenzimeve qe vertetohet nga Sekretari i Shtetit se kane ndodhur si pasoje e kryerjes se funksioneve te atij autoriteti, kerkohet ti paguhet Sekretarit te Shtetit nga autoriteti.

Rregullime dhe udhezime

13.—(1) Pa cenuar dispozitat e mesiperme te kesaj Skedule (Aneksi), Sekretari i Shtetit mund te nxjerre rregulla ne lidhje me—

- (a) formen dhe permbajtjen e skemave te zones se planifikimit te thjeshtuar, dhe
- (b) proceduren qe do te ndiqet ne lidhje me pergatitjen, terheqjen, adoptimin, dorezimin, miratimin, realizimin ose ndryshimin e tyre.

(2) Cdo rregull i tille ne vecanti mundet—

- (a) te siguroje njoftimin ose publicitetin qe do ti jepet—
 - (i) ceshtjeve te perfshira ose qe propozohen te perfshihen ne skemen e zones te panifikimit te thjeshtuar, dhe
 - (ii) adoptimin ose miratimin e nje skeme te tille, ose ndryshimeve te saj, ose ndonje hap tjeter procedural te pershkruar, dhe per publicitetin e procedures qe do te ndiqet ne kete rast.
- (b) te nxjerre dispozita ne lidhje me berjen dhe marrjen parasysh te prezantimeve per ceshtjet qe do te perfshihen ne, ose verejtjet ndaj kesaj skeme ose propozimeve per alternimin e saj;
- (c) pa cenuar paragrafin (a), te siguroje qe personave te vecante t'u jepet njoftimi per adoptimin ose miratimin e nje skeme te zones se planifikimit te thjeshtuar, ose ndryshimit te kesaj skeme nese ata kane patur verejtje per propozimet dhe kane njoftuar autoritetet e planifikimit lokal se deshirojne te njoftohen, me kusht (nese rregulli thote keshtu) pagesen e nje shume te arsyeshme.

- (d) te kerkoje ose autorizojte autoritetin e planifikimit lokal te keshillohet ose te marre parasysh pikpamjet e personave te tjere para se te ndermare hapa proceduriale;
- (e) t'i kerkoje autoritetit te planifikimit lokal, ne rastet kur eshte thene se do behet keshtu ose ne raste te vecanta kur udhezohet Sekretari i Shtetit, per personat qe kane kerkuar te siguroje kopje te cdo dokumenti te bere publik per qellimet qe permenden ne paragrafin 5(2) ose qe kane qene te vlefshme per inspektim sipas paragrafit 5(3) ose 6(2), me kusht (nese parashikohet) qe te paguhet nje shume e arsyeshme;
- (f) te siguroje botimin dhe inspektimin e skemes se zones se planifikimit te thjeshtuar e cila eshte adoptuar ose miratuar ose te dokumentave te adoptuara ose miratuara qe nuk e ndryshojne kete skeme, dhe kopje te kesaj skeme ose te dokumentave te jene ne shitje.

(3) Rregullimet nen kete paragraf mund te shtrihen ne gjithe Angline dhe Uellsin ose ne zonat e percaktuara dhe mund te kene kushte te ndryshme per ceshtje te ndryshme.

(4) Sipas kushteve te mesiperme te kesaj Skedule (Aneksi) dhe te cdo rregulle tjeter ne kete paragraf, Sekretari i Shtetit mund t'i jape udhezime cdo autoriteti te planifikimit lokal ose autoriteteve te planifikimit lokal ne pergjithesi—

- (a) per formulimin e procedures per realizimin e funksioneve te tyre qe rrjedhin nga kjo Skedule (Aneks);
- (b) per t'iu kerkuar atyre t'i japin atij informacion qe mund t'i duhen per realizimin e funksioneve nen kete Skedule (Aneks).